



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 8, 9, 13 SHKURT DHE 1, 13, 14 DHE 15 MARS 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 8, 9, 13. FEBRUARA I 1, 13, 14 I 15. MARTA 2018. GODINE**

**SHKURT/MARS - FEBRUAR/MART  
2018**

## **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të huajt,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pajisjet nën presion,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës,
8. Debat parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me dënimin e disa aktivistëve të këtij subjekti politik,
9. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe GP të Lëvizjes “Vetëvendosjes” lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 04/20, datë 20. 12. 2017 për rritjen e pagave të anëtarëve të Kabinetit qeveritar, Vendimin nr. 05/24, datë 12. 1. 2018, për rritjen e pagave për të gjitha kategoritë e të punësuarve që marrin pagë nga Buxheti i Kosovës, si dhe Vendimin nr. 15/24, datë 12. 1. 2018 për lartësinë e pagesës mujore për familjet në Skemën e Ndhimave Sociale,
10. Debat parlamentar, sipas kërkesës së nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala dhe gjashtë (6) deputetëve nënshkrues lidhur me raportin e 100 ditëve të punës të Qeverisë së Republikës të Kosovës,
11. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës,
12. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi për ratifikimin e nëntë (9) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë,
13. Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016,
14. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016.

## Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Prvo razmatranje N/zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-219 o strancima,
5. Prvo razmatranje N/zakona o zaštiti od zračenja i o nuklearnoj sigurnosti,
6. Prvo razmatranje N/zakona o opremi pod pritiskom,
7. Prvo razmatranje N/zakona o geološkoj službi Kosova,
8. Parlamentarna rasprava, na zahtev PG Pokreta "Vetëvendosje" u vezi kažnjavanja nekoliko aktivista ovog političkog subjekta,
9. Interpelacija Premijera Republike Kosova, g-dina Ramush Haradinaj, na zahtev PG "Lidhja Demokratike e Kosovës" i PG Pokreta "Vetëvendosje" u vezi Odluke Vlade Republike Kosova br. 04/20 od 20. 12. 2017, Odluke br. 05/24 od 12. 01. 2018. god. o povećanju plata svih kategorija zaposlenih koji se plaćaju iz budžeta Republike Kosova i Odluke br. 15/24 od 12. 01. 2018. god. o visini mesečne plate za porodice iz Šeme socijalne pomoći,
10. Parlamentarna rasprava, na zahtev potpredsednika Skupštine Kujtim Shala i šest (6) poslanika -potpisnika o razmatranju Izveštaja o 100 dana rada Vlade Republike Kosova,
11. Razmatranje preporuka Komisije za ljudska prava, nestala lica i peticije u vezi fakturisanja električne energije potrošene u četiri severne opštine Republike Kosova,
12. Razmatranje preporuka Komisije za obrazovanje, nauku, tehnologiju, kulturu, omladinu, sport, inovacije i preduzetništvo o usvajanju liste devet (9) članova Državnog saveta kvaliteta,
13. Razmatranje godišnjeg izveštaja performancije Nacionalne kancelarije revizije za 2016. godinu,
14. Razmatranje izveštaja o stanju životne sredine na Kosovu za 2016. godinu.

## **Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.**

KRYESUESI: Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,  
Të nderuar ministra të Kabinetit qeverisës,  
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 5 shkurt 2018.

### **1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Sipas praktikës, i pari është zoti Rexhep Selimi. Nuk është. Zonja Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Para pak ditësh Bashkimi Evropian ka publikuar strategjinë e zgjerimit, duke përcaktuar një perspektivë dhe angazhim më të gjerë të Bashkimit Evropian në raport me vendet e Ballkanit perëndimor.

E ardhja evropiane e këtij rajonit është cilësuar si investim gjeostrategjik në një Evropë të bashkuar, stabile, të fortë dhe që bazohet në vlera të përbashkëta.

Ndër lajmet më të mira nga kjo strategji është konfirmimi se do të vendosen aranzhime speciale për të mos lejuar që një shtet i Ballkanit Perëndimor ta bllokojë tjetrin në rrugën drejt anëtarësimit.

Strategjia flet se liderët politikë të rajonit nuk duhet të lenë asnjë dyshim se cili është orientimi i tyre strategjik.

Prandaj, të flasim pak për këtë orientim strategjik dhe për këto vlera të përbashkëta, në të cilat bazohet Bashkimi Evropian.

Përgjatë muajve të fundit lidhshipi kosovar, për fat të keq, e ka vënë në dyshim orientimin strategjik që Kosova e ka të përcaktuar për disa dekada.

Duke konfrontuar vazhdimisht me BE-në dhe SHBA-në, duke injoruar bashkëpunimin dhe duke ndërmarrë iniciativa, të cilat kanë dëmtuar raporte të ndërtuara me shumë mund, liderët politikë që sot janë në pushtet u kanë dhënë arsye shumë vendeve të BE-së, përfshirë edhe atyre njohëse, të mendojnë se Kosova nuk meriton përkrahjen e tyre as në kontekstin bilateral e as në organizma multilateralë, siç është BE-ja.

Kjo tregon jo vetëm qasjen e gabuar që ata kanë rreth integritit evropian, por edhe mungesën e përgjegjësisë në një proces, ku më së shumti i bartin pasojat qytetarët e Kosovës.

Pra, edhe pse rruga jonë drejt BE-së është e formalizuar, strategjia e zgjerimit konfirmon se reforma që duhet të ndërmerren duhet të jenë të shpejta dhe të prekshme dhe kjo Qeveri, fatkeqësisht, qysh në ditët e para e ka dëshmuar se nuk ka as vizion, e as njohuri se si të bëhet kjo.

Prandaj, sa më parë që të largohet, aq më shpejt qytetarët e Kosovës do të ecin drejt integritit.

Ashtu siç pritej, në strategji përmendet sundimi i ligjit si kusht kryesor i përparimit në integritime evropiane.

Madje, aty thuhet se sot shtetet e Ballkanit perëndimor tregojnë elemente të qarta të kapjes së shtetit, përfshirë këtu edhe lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Prandaj, në mënyrë që perspektiva evropiane e Republikës së Kosovës të bëhet e qartë, në radhë të parë ashtu siç thuhet në këtë strategji, duhet të shohim rezultate të prekshme në fushën e sundimit të ligjit.

Megjithatë përderisa edhe vendi ynë karakterizohet me nocione që për herë të parë përmenden nga Bashkimi Evropian, siç është ‘kapja e shtetit’ dhe ato drejtpërdrejt lidhen me lidhshimin kosovar, fatkeqësisht ne nuk mund të shohim qartësi në rrugën tonë drejt integritit.

T’i bashkohemi Bashkimit Evropian nuk është vetëm proces teknik. Mbi të gjitha, kjo strategji e sqaron që orientimi strategjik...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Atëherë duhet të paraqitesh se flet në emër të grupit, edhe dy minuta të takojnë.

**VJOSA OSMANI:** E thamë, mirëpo pa mikrofon.

Në mënyrë që orientimi ynë strategjik drejt Bashkimit Evropian të jetë edhe më se i qartë, duhet ta lexojmë shumë drejt këtë strategji dhe atë që thuhet aty.

Mbi të gjitha aty thuhet që t’i bashkohesh Bashkimit Evropian është zgjedhje, është zgjedhje jona. Pra, nuk është që dikush na ka përcaktuar këtë me zor.

Meqenëse është zgjedhje jona, logjika që liderët aktualë shtetërorë po e përdorin duke e fajësuar për gjithçka Bashkimin Evropian dhe duke injoruar detyrat e shtëpisë, të cilat janë të përcaktuara për vite me radhë për Kosovën, është jo vetëm logjikë e gabuar, por edhe logjikë, e cila e bën Kosovën të bëjë hapa prapa.

Prandaj, i ftoj jo vetëm deputetët që janë në këtë sallë, por mbi të gjitha anëtarët e Kabinetit qeveritar që me shumë seriozitet t'i lexojnë të gjitha kriteret që përmenden në këtë strategji dhe, mbi të gjitha, ministrin e Drejtësisë, ministrinë e Punëve të Brendshme dhe ministrat e tjerë që t'i marrin shumë seriozisht kritikën që bëhen në këtë strategji lidhur me mosluftimin e korrupsionit, lidhur me papunësinë e madhe, lidhur me krimin e organizuar, i cili, sipas kësaj strategjie, vjen dhe ka lidhje deri me nivelet më të larta të qeverisjes.

I ftoj po ashtu kryeministrin e vendit, presidentin dhe kryetarin e Kuvendit që të heqin dorë përfundimisht nga çdo iniciativë, e cila dëmton raportet me të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, raporte këto që janë ndërtuar për dekada me radhë dhe mbi të gjitha raportet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse me një logjikë të tillë Republika e Kosovës nuk do të mund të ëndërrojë as për vitin 2025...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi e ka fjalën. Nëse je në emër të grupit, lajmëro.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Zoti ministër i Brendshëm,

Dy hallka ndër më kryesoret e strukturave të sigurisë në Kosovë, Inspektorati i Policisë së Kosovës dhe Departamenti për Hetimin e Krimeve Ekonomike në Policinë e Kosovës, aktualisht janë diskredituar deri në themel, jo pse nuk ka oficerë e inspektorë të mirë aty, po për shkak të krerëve të instaluar në udhëheqje të këtyre dy institucioneve.

Çfarë kemi parë dhe dëgjuar këto ditë për IPK-në dhe për Departamentin e Hetimit të Krimeve Ekonomike në Policinë e Kosovës, janë model i qartë i krimit të kapjes së institucioneve të shtetit.

Ka kohë që në opinion kemi ngritur problematikën e Inspektoratit të Policisë së Kosovës dhe po ashtu, edhe për probleme të tjera në Policinë e Kosovës, që tashmë po duket që këto ishin problematika kronike.

Nga problemi në problem së fundi kemi një skandal që ka rezultuar në shkaktimin e një veprë penale nga ana e kryeshefit të Inspektoratit të Policisë së Kosovës dhe disa bashkëpunëtorëve të tij në IPK.

Ka rezultuar po ashtu edhe me suspendimin nga ana e ministrit e këtij protagonist, pra protagonistit kryesor të këtij skandali, kryeshefit të Inspektoratit të Policisë.

Por megjithatë çfarë kemi parë e dëgjuar në IPK dhe në Departamentin e Hetimeve për Krime Ekonomike, këtu kemi të bëjmë me një rrjet.

Ky rrjet, për fat të keq, nuk është i izoluar vetëm brenda këtyre dy mekanizmave të sigurisë, por po ashtu, siç ka shtrirje deri në maje të Policisë së Kosovës, është i shtrirë edhe në segmente të tjera të shtetit, ku ka kapur edhe majat e Prokurorisë së Kosovës.

Shteti i kapur, apo “state capture” e ka këtë pamje dhe këtë zë, pra si këto incizime që i kemi dëgjuar e si këto pamje që i kemi parë në raportimin e mediave.

Herë një kryeshef i Inspektoratit, herë një drejtor i një Departamenti të Hetimeve në Policinë e Kosovës, herë një prokuror e herë një gjykatës, herë veç e veç e herë të gjithë së bashku, e prapa tyre gjithmonë disa politikanë të fshehur që i kanë emëruar aty, përbëjnë një rrjet joformal të organizuar brenda institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë në Kosovë.

E vlerësojmë masën e suspendimit të kryeshefit të Inspektoratit pas publikimit të skandalit, por gjithsesi kjo është asgjë, përderisa kryesi i veprës është zëvendësuar me bashkëkryerësin tjetër të veprës si ushtruese detyre e kryeshefit të Inspektoratit. Pra është zëvendësuar me një bashkëpunëtorë, e cila po ashtu është e kapur nga media në kryerje të kësaj veprë.

Ky gabim duhet të korrigjohet menjëherë nga ana e ministrit të Brendshëm dhe të shkarkohet kushdo që është përfshirë në vepra të tilla, në mënyrë që t’i hapet rrugë një hetimi të papenguar nga ana e prokurorisë.

Tashmë është gjithçka e qartë, në një vend kur kryeprokurori i shtetit kapet falsifikator i provimit të jurisprudencës, ku drejtori i Departamentit të Hetimeve të Krimeve Ekonomike rrah drejtorin e një institucioni tjetër publik në mes të Prishtinës...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Të thashë, deklarohu. a je në emër të grupit, shtoja dy minuta në emër të grupit.

REXHEP SELIMI: Pra, në një vend ku shohim në media qindra-mijëra euro duke u numëruar në llogari të oficerëve të lartë të Policisë së Kosovës dhe protagonistët kryesorë nuk suspendohen, në një vend ku dëgjojmë në media skandale, sikur ajo e kryeshefit të Inspektoratit, duke i kërcënuar varësit e tij për t'i kryer punësimet e paligjshme, e në fund kur të gjitha këto rezultojnë të jenë në bashkëveprim dhe në mbrojtje të njëri-tjetrit, atëherë s'kemi se si ta quajmë ndryshe këtë përveç se një 'krim i organizuar i sofistikuar', i cili ka kapur segmente të caktuar dhe vitale të shtetit.

Kështu pra duket shteti i kapur, kjo nuk është thjesht një fantazi.

Ministri ka rastin, ka mundësinë dhe do ta ketë mbështetjen tonë që të marrë masa menjëherë, tani, në përputhje me kompetencat e tij. Ministri menjëherë duhet të marrë masa edhe ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, duke e ngarkuar atë me përgjegjësinë kryesore për gjithë këtë gjendje në Policinë e Kosovës.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë do të duhej të merrte masa ndaj varësve të kapur në krye të veprave penale, e jo t'i mbronte ata.

E dimë që këto probleme ministri i ka trashëguar, por kjo nuk e justifikon atë nëse ai nuk merr masa të menjëhershme, në të kundërtën, edhe ai mund të ketë përgjegjësi në gjithë këtë çfarë po ndodh brenda institucioneve të sigurisë së Kosovës.

Në cilindo situatë, ne kësaj pune tashmë do t'i shkojmë deri në fund. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën. Paraqituni kush është në emër të grupit, le të deklarohet vetë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ditëve të fundit ka qenë shumë aktual debati për problematikën e rrezikut të shembjes së shtëpive muze në Lagjen Jasharaj.

Fillimisht dua të falënderoj të gjitha mediat dhe shoqërinë civile për risensibilizimin e kësaj problematike, e cila tani kërkon hapa konkretë për zgjidhjen e saj.

Kuvendi i Kosovës në muajin korrik 2016 ka votuar amendamentin e PDK-së të propozuar nga unë, për investime në konservimin dhe restaurimin e shtëpive muze në lagjen Jasharaj në Prekaz. Amendamenti i votuar në Kuvend do të duhej t'u hapte rrugë punimeve për konservimin dhe restaurimin e të gjitha shtëpive muze në Prekaz, por Agjencia për Mbrojtjen e Komplekseve Memoriale nuk ka kryer punën që i ka takuar. Përkundër ndarjes së mjeteve financiare dhe kodit



buxhetor për restaurimin dhe konservimin e shtëpive muze , puna nuk ka filluar as atëherë e as sot, për me keq, mjetet e planifikuar nuk u shfrytëzuan, por u ridestinuan dhe disa shkuan në suficit.

Kur kam kërkuar ndarjen e mjeteve buxhetore për restaurimin dhe konservimin e shtëpive muze, kam pasur të dhëna të sakta nga mirëmbajtësit e kompleksit nga vizitorë të shumtë dhe nga ato miliona vizitorë për gjendjen e shtëpive që janë para shkatërrimit. Prandaj unë vetëm e kam përcjellë një kërkesë të tyre dhe të miliona vizitorëve të kompleksit të cilët janë të shqetësuar me gjendjen e shtëpive muze në Prekaz. Sot kur kjo çështje është sensibilizuar nga mediat dhe shoqëria civile, nuk dua ta drejtoj gishtin nga askush për atë që nuk është bërë, por kam kërkesë të qartë për atë që duhet bërë, për mjetet që duhet ndarë urgjentisht, për ruajtjen dhe konservimin e shtëpive muze në lagjen Jasharaj, që kompleks të ketë trajtimin e duhur institucional.

Kuvendi i Kosovës nëpërmjet amendamentit të propozuar në vitin 2016 ndau mjete për restaurimin dhe konservimin e shtëpive muze, por punimet nuk filluan dhe gjendja atje mbetet alarmante, kjo duhet të përmirësohet me hapa konkretë.

Ne kemi krijuar Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, edhe MKRS merret me trashëgiminë kulturore, kemi edhe drejtoritë përkatëse, institute, Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, por trashëgimia jonë më e re historike dhe kulturore po shkatërrohet, as nuk po ruhet e as nuk po mbrohet. Për më keq, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Komplexin Memorial në Prekaz nuk e ka paraparë në listën e institucioneve, objekteve e monumenteve që janë në mbrojtje të përhershme.

Në atë listë të propozuar nga KKTK janë në mbrojtje të përhershme 23 objekte, duke përfshirë: shtëpi banimi, komplekse, kisha, manastire, patrikana, xhami, muze, kulla, fusha e hamame...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka, a je në emër të grupit?

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Bash mirë që u ndal aty në 'hamam' fjala.

Unë do të flas për temën e shëndetësisë, por nuk mund të mos e prek pak çështjen e memorialit.

Memoriali është përgjegjësi absolute e PDK-së dhe LDK-së, e para.

E dyta, e Xhavitit a imja. Ok-ej! Kryesorja po, e për t'u arrestuar, duhet arrestuar ai drejtori që e ka përgjegjësi menaxhimin e parave, por kur kam thënë në një emision televiziv që ka njerëz që

kanë vjedhur edhe në varr të Adem Jasharit, unë e kam ditur çka po flas, se kam pasur dokumente. Pak qytetarë e dinë që varrezat në Prekaz i ka ndrequr një turk me para të veta.

As ato varreza që ne shkojmë dhe përkulemi, nuk janë të rregulluara prej buxhetit të Qeverisë. Prandaj, do të duhej një komision hetimor në vijën e asaj që foli Rexhep Selimi, një komision hetimor, ne po shohim ku ka kandisur Policia e Kosovës, ne po shohim hetuesit ku janë katandisur, që i kurdisin hetimet, bëjnë çka donë, po të paktën, brenda Parlamentit do të duhej të formohej një komision hetimor dhe të hetohet çdo qindarkë që është dhënë në emër të memorialit, në emër të varrezave. Pse e them këtë? Sepse është e domosdoshme, kam edhe shumë argumente të tjera.

Pak për çështjen e shëndetësisë.

Të nderuar deputetë,  
Janë 700 pacientë duke pritur për operacionet e zemrës.

Është mirë që Ministria e Shëndetësisë ta zgjidhë këtë problem urgjentisht, duke marrë shembull Kroacinë dhe Shqipërinë që i ndajnë pacientët. Në Kroaci i ndajnë pacientët dhe prej spitalit të përgjithshëm i çojnë nëpër spitale private.

Në Qendrën spitalore, ndoshta keni dëgjuar dje, që dy vjet është blerë një aparaturë, që dy vjet janë paguar paratë dhe aparatura nuk ka ardhur në Kosovë, aparatura është në Austri. Është e çuditshme, këtu zbuloj çka të duash dhe nuk ndodh asgjë, sepse prokuroria nuk intervenon.

Prandaj, zoti ministër,  
Çështja e 700 pacientëve, të cilët janë duke pritur për stenda dhe operacion të zemrës, ndoshta mund të zgjidhet dhe kam një propozim për ju si Ministri e Shëndetësisë.

Ju lutem, respektoni listën e pacientëve, jo në bazë të postit politik, po edhe një qytetar i thjeshtë, edhe një bujk, në qoftë se është në listën e pritjes, ai njeri duhet të çohet për trajtim jashtë shtetit, e jo vetëm pse dikush është njeri publik ose pse dikush ka qenë ministër ose kryeministër. Faleminderit, kryesues!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Është e vërtetë që çështja e Kompleksit Memorial është shqetësuese, jo vetëm për ne deputetët, por për shumicën e opinionit publik.

Këtë temë fillimisht e ka ngritur Arben Ahmeti, një gazetar, publicist, shumë i zoti, është përcjellë me shkresa të shumta edhe të Jusuf Thaçit, po ashtu një ish-koleg bashkëluftëtar dhe tash një aktivist, por sa për informim, në legjislaturën e kaluar ka kaluar Ligji për komplekset memorialë të Adem Jasharit, pastaj ka rënë Kuvendi dhe ky ligj është rikthyer prej pikës zero. Ka dy javë, i kemi këtu anëtarët e të gjitha partive politike që janë në komision, që kemi kërkuar që ky ligj të procedohet dhe të amendamentohet sa më shpejt dhe ta marrë drejtimin e duhur dhe, natyrisht, të zgjidhet ky problem.

Por, është edhe një fakt, nuk po dua të hyj në detaje çka tha edhe Milaim Zeka, por është e vërtetë që ka pasur fonde të ndara për Kompleksin Memorial tash e sa vite, ka pasur një projekt të bërë para tetë vjetëve prej Përparim Ramës, një arkitekt shumë i mirënjohur nga Londra, e që ka mbetur në sirtarë a nuk dihet ku ka mbetur. Është edhe një fakt i pamohueshëm që raporti i Agjencisë për Mbikëqyrjen e Memorialëve vitin e kaluar, në fakt para dy vjetëve më shumë është marrë se kush ka drejtë ta shpallë tenderin sesa në çfarë gjendje janë memorialët tona. Por, sa për informim, tash e kemi konkursin e ri, prandaj i ftoj publikisht kushdo që është i interesuar për të garuar, le të vijë le të garojë, i ka tre muaj afat. Ne si anëtarë të Komisionit do t'i intervistojmë, do t'i sjellim në Kuvend dhe t'i japim drejtimin e duhur.

Unë pres që edhe kolegët e mi deputetë t'i bëjnë pyetje edhe ministres së Planifikimit Hapësinor, meqë edhe ajo duhet të japë përgjigje për shkak se është në kompetencën e saj se si është trajtuar ky rast, a ka ndarë fonde, a janë interesuar dhe deri ku ka shkuar kjo procedurë. Në rast se nuk i marrim masat urgjentisht, ato objekte do të rrënohen për shkak të reshjeve të mëdha të shiut dhe po shihet hapur që në horizont nuk duket një interesim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Duda Balje e ka fjalën. Në emër të grupit, apo personal? Deklarohu!

DUDA BALJE: Faleminderit, nënkryetar!

Flas në emër të grupit

Poštovani potpredsedniče,

Poštovani ministri,

Poštovani poslanici,

Poštovani građani Kosova,

Sa ove iste govornice smo im pre dve godine, i pre godinu dana otvorili pitanje izgradnje hidrocentrala, žao što je ministarka danas nije sa nama, iako nam je pružila podršku od samog uzimanja mandata, i ovog puta sam ovde da podelim moju brigu kao poslanika i svih Bošnjaka, i svi stanovnika regije Župe, svih 15 sela koje se nalaze tamo oko aktivnosti u cilju zgrade hidrocentrala nasrtane na njihovom privatnom imovinu, na prirodne resurse, na životnu sredinu.

Pokretali smo ovo pitanje puno puta, saznali smo da od naših odbornika u opštini Prizren da se takve aktivnosti dešavaju, obavestili smo naše meštane, bili smo u kontaktu sa njima stalno, pre dve godine smo odneli peticiju Ministarstvu za zaštitu sredine, koja praktično bila potpisana od svih stanovnika Župe. Verujte mi, čitali smo sve zakone, konsultovali smo sa stručnjacima kontaktirali smo partiju Zelenih, kontaktirali smo g. Janesa Igora Šulca, poslanika u Evropskom parlamentu, i ne samo kod nas nego i u svim državama u regionu izgradnje ovakvih hidrocentrala na malim rekama, kao što je Bistrica koja protiče kroz Župu može da donese mnogo više štete nego same koristi.

U martu mesecu 2016. godine službeno smo obavestili Vladu Kosova i Skupštinu, i ministra za Zaštitu životne sredine, i Ured za energetiku, i Ministarstvo za ekonomski razvoj, premijera kao i predsednika Parlamenta o malverzacijama koje su se dešavale za dobijanje dozvolu, odnosno licencu za izgradnje istih. Bilo je prilika da je po zakonom moralo da dobiju saglasnost meštana da bi se jedna takva hidrocentrala izgradila. Znamo i imamo dokaze da su potpisi meštana o davanju prava falsifikovana.

Desilo su se jako velike stvari, posle naših političkih aktivnosti to je nekako zastalo to je, međutim u zadnjim danima imamo ponovo informaciju da će se hidrocentrale graditi i to u opštini Prizren u Župi, negde od 11 do 15 malih hidrocentrala, koliko mi imamo informacija, kako ih oni nazivaju "mini", koji mogu praktičnu da isuše celu reku koja bila u Župi, a on dobro zna da je Župa tako locirana da su pored reke praktično sve kuće, a imamo mesta u kojima su i škole blizu, i groblje blizu, i to će nanesti veoma veliku štetu, naročito zbog toga zato što Župu planiramo kao mesto za turizam i za seoski turizam, i ulažemo sve napore da se ona razviju u tom pravcu.

Pre par dana imali smo sastanak ponovo sa predstavnicima Župe, ponovo smo spremili peticiju s obzirom da smo čuli da se aktivnosti ponovo usmeravaju u tom pravcu, odneli smo ministarstvom, razgovarali sa ministarkom, i očekujem podršku ministarke, a podršku očekujem i do vas kolega, jer je se definitivno životna sredina biodiverzitet, flora i fauna, totalno biti uništeno ukoliko budemo dozvolili tako nešto.

Ja znam i to da Kosovo ima obligaciju da proizvodi električnu energiju sopstvenim resursima, ali treba da vam napomenem da recimo u opštini Prizren u Župi ima godišnje 285 sunčanih dana, ima jako puno vetra, i mislim da bi mogli možda da nađemo neke druge alternative za izgradnju istih hidrocentrala.

Ono što mogu da kažem jeste da ja kao poslanik i moja partija naravno stojimo iza naroda Župe, iz njegovog protivljenja u izgradnji ovakvih hidrocentrala, i naravno ćemo dati sve naše napore da do takvih isti ne dođe.

Moram da napomenem još jedno da smo pre par dana u selo Nebregošte imali veliki odron zemljišta koji bio vrlo rizičan za maštane, jer se desio takođe kroz selo, i ovom prilikom zahvaljujem i premijeru, i lokalnim vlastima na tome što su bili ekspeditivni i na vreme uspeali da rešimo probleme. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Glauk Konjufca!

GLAUK KONJUFCA: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Në Kosovë tashmë është e qartë që ka marrë formë të plotë një metodë shumë e rrezikshme se si vepron krimi i organizuar ekonomik dhe neve na kanë ndodhur katër raste ku kemi të bëjmë me qindra miliona euro, të cilat Prokuroria e Shtetit nuk i ka hetuar dhe e kanë formën e qartë të krimit të organizuar.

Pra, po flas për njëfarë metodologjie, e cila ka lidhje edhe me pushtetin, që pushteti në kontratat në të cilat hyn të bëjë shkelje të qëllimshme, prej të cilave Kosova humb qindra miliona euro dhe përfundojmë bile edhe nëpër arbitrazhe ndërkombëtare. Na ka pas ndodhur rasti i pasaportave më herët, rasti i dytë ka qenë me Z-Mobile, rasti i tretë me Axos-in, për të cilin Kosova ende ndodhet në arbitrazh, kurse rasti i katërt me “Bechtel&Enka”, që ndodhi tash së fundi.

Qeveria Thaçi atë kohë e pati nënshkruar një kontratë, e cila ka qenë skandaloze për nga kushtet, por edhe për nga çmimi i asfaltit, sepse e bëri Kosovën me asfaltin më të shtrenjtë në botë, pra shteti më i varfër që e paguan asfaltin më të shtrenjtë në botë.

Qeveria e kaluar, si duket, nuk e respektoi kontratën dhe Kosova rrezikon që të gjobitet me 63 milionë euro. Kurse Qeveria aktuale nuk ka çfarë të bëjë në këtë rast, përveçse më duket që po funksionon më shumë si arkëtar sesa si Qeveri e vërtetë. Ministri paraprak po ia hedh përgjegjësinë ministrit aktual, kurse Qeveria aktuale ka shpjeguar se përgjegjësitë faktikisht i takojnë Qeverisë së kaluar. Penalltitë që mund t’i merr Kosova natyrisht kanë të bëjnë me çështjen e vonesës së pagesave, sepse është nënshkruar një kontratë, e cila ka kushte shumë rigorozë sa u përket afateve kohore të kryerjes së pagesave. Kosovës faktikisht një muaj mospagesë apo vonesë i kushton 14 milionë euro.

Janë paguar shuma të plota për vitin 2014, 2015 dhe 2016, por jo edhe në vitin 2017 dhe tash Kosova ndodhet përpara një sfide serioze që “Bechtel&Enka” të na i marrë edhe 63 milionë euro të tjera.

Pra, shihni se çfarë shteti po ndërtojmë ne dhe se çfarë praktike të pushtetit. Qeveritarët gabojnë, kurrkush nuk jep përgjegjësi, e populli duhet të paguajë, sepse buxheti i këtij shteti ndërtohet prej popullit, prej tatimeve që i paguajnë qytetarët, prej obligimeve, prej bizneseve, prej korporatave,

e kështu me radhë. Unë i bëj thirrje Prokurorisë së Shtetit që ta hetojë këtë krim, sepse ky krim nuk mund të mbetet kështu i pandëshkuar.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bunjaku e ka fjalën.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuara deputete dhe ju deputetë,

Sot po e ngre në Kuvend vendimin joligjor të ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për shkarkimin e Bordit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë. Neni 7, paragrafi 5 i Ligjit për arsimin e lartë përcakton: nëse më shumë se 1/3 e anëtarëve të Bordit zëvendësohet për çfarëdo arsye brenda një viti, ministri duhet t'ia raportojë këtë Kuvendit.

Me vendimin e tij për shkarkimin e gjithë bordit, ministri e ka shkelur ligjin, nuk ka raportuar në Kuvend, pa asnjë arsye e ka shkarkuar tërë bordin. Është thënë në medie nga kryeministri se shkarkimi i bordit është bërë me arsyetim se ka pasur parregullsi. Nëse kjo është e vërtetë, si është e mundur të kalohet aq lehtë, pa kërkuar hetime rreth këtyre parregullsive? Si është e mundur që kryeministri konstaton se ka pasur parregullsi serioze dhe të mos e shtojë edhe denoncimin se për çfarë parregullsish bëhet fjalë, për çfarë shkeljesh bëhet fjalë, cilat vendime janë shkelur, cilat vendime nga ky bord kanë bërë shkelje, a janë anuluar vendimet që kryeministri pretendon se janë shkelje ligji? Pa e sqaruar këtë shkelje të ligjit nga ministri nuk mund të kalohet në zgjedhjen e anëtarëve të ri të bordit.

Grupi ynë do të kërkojë interpelancë për këtë çështje dhe varësisht nga debati në atë interpelancë do t'i propozojmë masat që do të ndërmerren. Ne nuk mund të lejojmë që të shkelet ligji, në mënyrë që të krijohet mundësi për akomodim të individëve, të partisë në pushtet në këtë bord shumë të rëndësishëm për universitetet dhe për arsimin e lartë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dy të fundit janë Emilija Rexhepi dhe Islam Pacolli. Koha ka kaluar, por s'po ju lë të pritni deri në mbledhjen e ardhshme.

EMILIJIA REDŽEPI: Zahvaljujem se potpredsedniče Parlamenta!

Uvaženi ministri,

Poštovani kolege poslanici,

Poštovani građani,

Želim da govorim o velikoj vremenskoj nepogodi koja je proteklih dana pogodila prizrensku opštinu, odnosno Župski kraj, oblast u kome živi najveći broj Bošnjackog naroda na Kosovu, i želim ilustrativno da vam pokažem slike kako to izgleda na samom terenu. Veliko klizište odron erozivnog zemljišta u selu Nebregošte narušava bezbednost svih naših meštana, i postoji velika mogućnost da se ponovi ovih dana zbog obilnih kiša i snega. Podrška predsednika opštine Prizren i nadležnih direktorijata nam je izašlo u susret u samom startu, ali nedostatak opštinskog

budžeta za hitne intervencije, jer je jako mali, pa nam je hitno potrebna podrška Vlade, podrška ministra Finansija, pre svega podrška ministra Infrastrukture.

Potrebni su nam potporni betonski zidovi, velike duge kaskade, betonske vodovodne cevi koji će izvor vode koja je uzrok ovog klizišta odvesti u tok reke. Poštovani ministre Infrastrukture, u toku je izrada predlog-projekta od strane nadležnih organa i opštinskih inženjera, tako da ćemo doći u što skorijem vremenskom periodu da vas posetimo i dostavimo naš projekat, i nadam se da ćete nam izaći u susret. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pacolli e keni fjalën!

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryesues!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Medie, faktor ndërkombëtar,

E kam një kërkesë për ministrin Sefaj, një sqarim me vendimin e marrë nr. 01/17, datë 1. 12. 2017, të kryeministrit Ramush Haradinaj, ju jeni autorizuar që 'ië ndërmerni të gjitha veprimet e nevojshme për përmbushjen e obligimeve financiare në lidhje me rastin e pasaportave të Kosovës. Siç e dinë të gjithë, çështja e skandalit të pasaportave është dërguar në Gjykatën e Arbitrazhit, e kjo e fundit merr vendim që Republika e Kosovës obligohet t'i përmbushë të gjitha detyrimet financiare mbi 6 milionë euro ndaj kompanisë austriake, OESD. Prandaj, ju lutem zoti ministër, që të na sqaroni për këtë çështje.

E dyta, po dua ta cek që ne në janar ishim në një vizitë studimore në Bruksel, dhe të gjitha rekomandimet që i kemi marrë atje janë rekomanduar që ne të heqim dorë nga Gjykata Speciale, e cila na ka kthyer për dhjetë vite mbrapa, pavarësisht se ne konsiderojmë të gjithë që në nuk është e dobishme, dhe t'i jepet viza e lirë demarkacionit. Për arsye që ne duhet t'u tregojmë qartë qytetarëve që obligimi dhe përgjegjësia është te ne për të shkuar përpara.

E treta, që po dua të cek në fund, ne në ditët e fundit kemi pasur kritika rreth një takimit të Kabinetit qeveritar në vilën e ish-Presidentit të Republikës së Kosovës, zotit Pacolli. S'e di kujt i pengon kur nuk preket Buxheti i Kosovës, ose kanë dhimbje që nuk i kanë restaurantet atje që t'i dërgojnë faturat nëpër ministritë e tyre. Prandaj, përkrahini ata që kontribuojnë, e jo ata që e varfërojnë taksën e qytetarit të Kosovës dhe pikërisht ata mund të bëjnë kritika, ata që janë në rregull me ligjin, e jo të cilët nuk janë në rregull me ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar ministri i Brendshëm, zoti Flamur Sefaj. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës ka përfunduar.

MINISTRI FLAMUR SEFAJ: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Po i trajtoj çështjet ashtu siç kanë ardhur me rend, duke u nisur nga të fundit. Çështja e pasaportave, e zgjedhjes së problemit të pasaportave u ngre nga deputeti Islam Pacolli, po ashtu u përmend edhe nga deputeti Konjufca.

Unë kam qenë i autorizuar nga kryeministri që ta trajtoj çështjen, që ta mbyll çështjen, e cila e ka pasur një kosto shumë të lartë, sepse ne e kemi humbur kauzën në arbitrazh dhe i kemi pasur borxh kompanisë furnizuese diku 5 milionë e 600 mijë euro për t'i paguar dhe ka qenë vendim decidiv.

Pasi Qeveria ka ndarë 5 milionë e 600 mijë euro për t'i paguar, e kam marrë të drejtën që ta trajtoj edhe një herë çmimin me kompaninë, e cila ka bërë furnizimin, dhe pas punës mjaft të gjatë, e cila ka zgjatur dy ditë nga 12 orë, bisedimeve dhe tratativave me këtë kompani, së bashku me stafin e Ministrisë së Punës së Brendshme dhe me stafin politik kemi arritur që të vendosim një çmim prej 4 milionë e 950 mijë për ta mbyllur rastin. Po ashtu, kusht për ta paguar këtë shifër ka qenë edhe zhbllokimi i 15 milionë eurove të Republikës së Kosovës, të bllokuara në bankat e Austrisë. Kjo çështje është mbyllur, i kemi kursyer diku 650 mijë euro, i kemi zhbllokuar 15 milionë të Republikës së Kosovës. Banka Qendrore e ka marrë prapë pronësinë e kontos, e cila ka qenë e bllokuar në Austri, ato 650 mijë euro, ndoshta e dini, ndoshta jo, unë kam kërkuar si ministër që të shpërndahen, në mënyrë që të bëhet distribucioni i barabartë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Regjia, lejoja fjalën ministrit të sqarojë!

MINISTRI FLAMUR SEFAJ: ...që t'i ndahen Policisë për fundvit dhe kjo ka ndodhur. Domethënë është bërë një punë e mirë, është mbyllur rasti, janë kursyer mjete dhe janë zhbllokuar mjetet prej 15 milionëve, që sot janë dispozicion të Republikës së Kosovës.

Sa i përket ngritjes së çështjes të problemeve, të cilat i kemi në agjencitë e Ministrisë së Punëve të Brendshme, unë kam vepruar menjëherë në bazë të ligjit dhe Rregullores, dhe të gjitha atyre autorizimeve që unë kam për të vepruar në çështjen e Inspektoratit. E kam suspenduar kryeshefin, e kam emëruar një ushtrues detyre, në mënyrë transiti dhe të përkohshme, sepse ai person e ka ushtruar gjithmonë atë detyrë dhe ka qenë rast emergjent, sepse ka ndodhur në mbrëmjen e të premtës, por kjo nuk do të thotë që unë prapë nuk do të veproj konform ligjeve.

Por, sot dua të them diçka: unë këto probleme i kam gjetur, këto janë materializuar tani, por kanë ekzistuar dhe janë stratifikuar me vite e vite të tëra nëpër këto agjenci. Unë si ministër nuk veproj



në bazë të spektaklit dhe fishekzjarrëve, ndërmarr masa racionale, proporcionale në harmoni me ligjet dhe ju premtoj që gjithmonë ashtu do të veproj. Nuk do të ketë spektakël në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në decenien e parë të pavarësisë së këtij shteti, sidoqoftë ne duhet nganjëherë t’u kërkojmë falje qytetarëve tanë për skenat që jemi duke i parë në medie, jo vetëm këtë rast, por po ashtu duhet t’u falënderohemi shumë pjesëtarëve të cilët punojnë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, stafit civil, stafit politik, policëve, grave dhe burrave në Inspektorat, të cilët e kryejnë punën e tyre në mënyrë të devotshme, të drejtë dhe të sinqertë.

Unë ju falënderoj, kërkoj falje që nuk isha në komision, sepse isha i sëmurë herën e kaluar, por kërkoj nga ju që së bashku të punojmë që t’i zgjedhim problemet, të cilat janë krijuar tash e diku 18 vjet, nëse nuk gaboju, mund të zgjidhen, mund të bëhen intervenime strukturore, edhe në këtë rast në Ligjin për Inspektoratin e Policisë, duke amendamentuar ligjin, por kërkoj këshilla nga ju, kërkoj asistencë dhe kërkoj që të mos veprohet në bazë të agjendës së medieve, sepse më së paku atë të drejtë të veprimit e ka Ministria e Punëve të Brendshme që merret me punë mjaft delikate, mjaft komplekse, ku gërshetohen shumë ligje, shumë rregulla, shumë rregullore dhe principe të ndryshme. Ju kisha lutur që kur të ngrihen probleme të tilla dhe dalin në sipërfaqe, po e përdor një fjalë që mund të themi që “mbreti ishte i zhveshur” dolën edhe disa probleme tjera, dolën që kur unë kërkoja që të anulohet konkursi në Inspektorat, disa institucione erdhën tek unë dhe më thanë që ajo nuk është e ligjshme.

Po ashtu, dhe këtu ka pas deputetë të tillë. Ju lutem që të merreni edhe me ato çështje, sepse disa institucione, si Avokati i Popullit, apo të tjera, duhet të merren me çështje madhore, duhet të merren me të vërtetë me të drejtat e njeriut dhe të drejtat e qytetarëve tonë, së paku të mos paguajmë panevojshëm rrymë për qytetarët tjerë, të cilët nuk janë duke e paguar. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Për replikë është lajmëruar zoti Rexhep Selimi.

**REXHEP SELIMI:** Faleminderit, zoti nënkryetar!

Po, ministër, edhe në atë çfarë fola më herët ua ofruam mbështetjen tonë dhe pse jo dhe mirënjohjen për hapat tuaj dhe po ashtu edhe një herë po dua të them që është e vërtetë që ju i keni trashëguar të gjitha këto probleme, por adresimi im ishte goxha i fokusuar në individë të caktuar. Normalisht unë atij nuk ia përmenda emrin, por kur kam përmendur emër drejtori i përgjithshëm i Policisë, dihet kush është drejtori i përgjithshëm i Policisë, kur e kam përmendur unë emrin e shefit të Departamentit të Hetimit të Krimeve Ekonomike, dihet. Kur e kam përmendur emrin e kryesuesit të Inspektoratit Policor të Kosovës dihet, këta kanë emra dhe mbiemra, është Shpend Maxhuni, Nazim Sahiti, nëse më lejohet të përmenden është Hilmi Mehmeti e tjerë e tjerë. Pra, unë nuk desha të flas me detaje, por kjo nuk do të thotë që unë kam dhënë vërejtje dhe mosmbështetje për Policinë dhe kjo nuk do të thotë që unë kam vërejtje dhe mosmbështetje për punën shumë të madhe të Policisë edhe brenda stafit të tyre.

Sa u përket medie, ministër, mendoj që mediet kanë bërë mirë, por nuk është hera e parë që këto problematika ngrihen. Edhe në këtë Parlament, unë personalisht në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” e kam ngrehur çështjen e këtij departamenti, i cili sot po del problematik që më 2013 dhe 2015. Prandaj, edhe një herë dua të ju them, që ne jemi të fokusuar në individë dhe të piketuar thjesht te individët, të cilët i bartin këto përgjegjësi dhe kjo kritikë nuk shkon për Policinë, e aq më tepër punën shumë të mirë të tyre që po e bëjnë. Sa i përket Avokatit të Popullit, unë jam në anën tuaj, sepse mendoj se Avokati i Popullit në këtë rast doli që nuk kishte të drejtë kur reagoi në formën çfarë ka reaguar dhe vetë skandali ju dha të drejtë juve, prandaj ju do ta keni mbështetjen tonë për aq sa do ta goditni çfarëdo lloj krimi të organizuar brenda Policisë së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Uran Ismajli, ministër i Shëndetësisë.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Desha të flas pak për çështjen të cilën e shtroi deputeti Zeka, sa i përket listës së gjatë të pritjes ai e mori një klinikë, por realisht është që listat e pritjes janë në disa klinika në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës dhe jemi duke punuar intensivisht që ato të mos mbeten të tilla, pra lista të pritjes, por që të bëhen shërbime për qytetarë.

Sa i përket rastit konkret për listën e pritjes, besoj se është bërë edhe publike që ne kemi filluar një shërbim 24-orësh në mënyrë që infarkti akut dhe shendimi, i cili është emergjent të ndodhë tani 24 orë. Pra, kjo i kontribuon që listat e pritjes të mos jenë më, të mos shtohen, të mos ketë numra që vijnë, por ato që vijnë në këto 24 orë të trajtohen menjëherë. Pra, është hera e parë që ndodh që për qytetarët e Republikës së Kosovës që pas orareve, domethënë që 24 orë të kenë mundësi të marrin një shërbim duke pasur mundësi të shpëtojnë jetë, por në anën tjetër të shpëtojnë edhe mijëra-mijëra euro, të cilat ju kanë shkaktuar qytetarëve vetëm për arsye se nuk ofrua një shërbim i tillë. Prandaj, konsideroj se është një hap shumë i madh i cili ka ndodhur, që për herë të parë të bëhet një shërbim i tillë.

Sa i përket listës së pritjeve për stenda është e gjatë, unë e kam edhe një pyetje sot parlamentare sa i përket pajisjes të cilën ju e përmendët, pra angiografi i cili është paraqitur që dy vite dhe për dy vite nuk ka ardhur ende në Kosovë. Ne që dje e kemi marrë dhe iniciuar fillimin e punimeve, procedurave për punime të cilat do të përfundojnë brenda dy muajve dhe do të sjellë angiografin në Kosovë, i cili është bërë një lloj odiseade, sepse nuk ka ardhur në Kosovë që dy vit, ai do të vijë dy-tre muaj maksimum do të jetë në Kosovë dhe do të fillojë shërbimet. E me ardhjen e angiografit do të përfundojnë edhe listat e pritjeve.

Sa u përket preferencave politike këtu puna e parë është që ne mos të intervenojmë, puna e parë është që asnjë politikanë nga të gjitha anët të mos intervenojmë. Kur nuk intervenojmë ne, atëherë nuk do të ketë preferenca politike. Prandaj, unë i kam siguruar të gjithë udhëheqësit e klinikave që ta mbajnë rendin në bazë të shërbimeve si vijnë, jo në bazë të çfarëdolloj intervencash. Dhe, intervencat, të ju them të drejtën, nuk vijnë tek unë, intervencat shkojnë direkt në klinika dhe aty politikanët apo këdo që e quajti deputeti, shkojnë direkt dhe bëjnë presion. Prandaj, në qoftë se dëshironi që të mos ketë, ne duhet të vetëdisiplinohemi vetë dhe të mos krijojmë preferenca për disa persona e për disa tjerë jo.

Unë e di që ka probleme të mëdha në shëndetësi, kemi filluar t'u japim zgjidhje atyre. Është një hap shumë i madh me shërbimin 24 orë, do t'i ulim listat e pritjes në të gjitha klinikat dhe do t'i japim shërbimet që qytetarët kanë nevojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka kërkuar fjalën për replikë.

MILAIM ZEKA: Replikë nuk kam, por kam një sugjerim si deputet dhe si "Nismë".

Zoti ministër, edhe ju edhe ministri i brendshëm, në qoftë se ju nuk i ftoni mekanizmat veprues të drejtësisë, Prokurorinë e shtetit me e hallakatë Qendrën Universitare Spitalore edhe jam shumë i bindur se ato 90% kush kanë qenë drejtorë ka 1 milion fakte për t'i arrestua. Në qoftë se, ju dy nuk... ju të dy jeni te ajo kënga "A vritet pafajësia", ju asnjëri s'keni bërë krime, se s'keni pasur kohë hala, as të vidhni, as të shpallni tenderë, as të zhyteni në krime. Prandaj, shfrytëzoheni këtë privilegj. Disa ministra që nuk jeni zhytur në krim merreni guximin qytetar për ta thirrur atë Prokurorin të korrumpuar, po qatë e kemi, ishalla ministri i Drejtësisë e bën vetingun atje, u mëshon sakicë edhe atyre, edhe Policisë, se pa një spastrim të Policisë, të Prokurorisë, ky shtet s'ka për të ecur përpara.

Të presësh një aparat, ministër, dy vjet në Austri, të japësh para, të paguhet aparati e të mos vijë në Kosovë... këtu veç Prokuroria se ti s'ke çfarë të bësh, ti s'mund të marrësh një hu në krah e të hysh e t'i rrahësh drejtorët në spital, po Prokurorisë duhet me i bë thirrje ti personalisht edhe ministri i brendshëm dhe me e çua këtë vend përpara, për arsye se është gjendje e tmerrshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani, Besa, ti e ke kërkuar fjalën, po ti s'ke qenë në ato pyetjet që janë bërë. Besa Baftiu e ka fjalën.

BESA BAFTIU: Kryesues!

Desha të lidhem me ministrin Uran Ismajli, i cili tha se shërbimi 24-orësh në Kardiokirurgji është për herë të parë.

Ministër, nuk e di nëse e dini se edhe në 2014-ën ka pas filluar shërbimi 24-orësh, mirëpo nuk ka vazhduar. Prandaj, urojmë që ky shërbim jo vetëm të fillojë, po edhe të vazhdojë, sepse me të vërtet listat e pritjes janë të gjata ashtu siç u tha, por jo vetëm në shërbimin e Kardiokirurgjisë, po kemi lista të gjata të pritjes pothuajse në të gjitha klinikat e QKUK-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë mendoj se është edhe interes publik që të na sqarojë ministri për këto çështje edhe një herë. Faleminderit!

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit shumë!

E nderuara deputete,

Informatat i kam, informatat kanë qenë që shërbimi është dhënë deri në orën 7:00, jo në 24 orë, domethënë është hera e parë që ndodhë që shërbimi të jetë 24 orë, pra edhe pas orës 7:00. Është filluar në vitin 2014, është ndalur. Kjo nuk më bën, nuk më dekurajon që të mos fillojmë prapë.

Unë kam pasur shumë skepticizëm në atë kohë kur kemi filluar me shërbimin 24 orë, pyetje të shumta si: nuk do të ndodhë, nuk do të mund ta mbajnë, ndoshta nuk do të ndodhë... Cila është mundësia që ne të ecim përpara, në qoftë se nuk provojmë?

Prandaj, duke filluar aty e kanë marrë personeli mjekësor mbi vete, ka kërkuar mbështetje, ua kam dhënë mbështetjen, u kam dhënë të gjitha furnizimet që kanë pasur nevojë, të gjitha... ta themi se edhe pakon lehtësuese të cilët kanë pasur nevojë. Shërbimi ka filluar, është shumë i nevojshëm. Po atë ditë që ka filluar ne kemi pasur tri raste emergjente, të cilat kanë shkuar dhe kanë marrë shërbim. Po ato tri raste, sikur të mos kishin marrë shërbim në spital do të kishin kërkuar një, mos ta quaj ndoshta kishte mundur të jetë rast fatal, ose në anën tjetër, do të kishte pasur mundësi që... dihet çfarë do të ndodhte, do të shkonte në një spital privat, që do t'i kushtonte me mijëra e mijëra euro.

Prandaj, faleminderit shumë për përkrahjen dhe besoj se do të vazhdojmë që edhe shërbimet tjera t'i bëjmë në të gjitha klinikat.

Deputetë, sa i përket hurit, s'po përtojmë edhe me hu po ta dinim se kryejmë punë, por po dua të ju them se rastin... Çfarë është fokus për mua për momentin? Për mua fokus për momentin është me e sjellë aparatit në Kosovë, sepse në qoftë se nuk vjen aparati është duke na kushtuar shëndet njerëzish, është duke na kushtuar mijëra e mijëra euro për pacientët tanë dhe fokusi im i parë është bërja e zgjidhjes. Dhe, e kam filluar zgjidhjen. Dje i kam marrë specifikacionet teknike nga Philipsi sepse kur e kanë bërë atë renovimin e objektit nuk e kanë bërë në bazë të specifikacioneve që i ka dërguar prodhuesi dhe dje mbrëmë natën, me shumë presion, na e kanë dërguar e-mail-in dhe do t'i fillojmë procedurat për 45 ditët e ardhshme ta përfundojmë, ta sjellim aparatit. Kjo ishte e para.

E dyta, nuk i shpëton kurrkush, të paktën në kohën time, në kohën time nuk i shpëton kurrkush, dikush që na i ka vonuar proceset nga dy vjet, tri vjet, na ka bërë dëm dy-tri vjet a katër, nuk po dua ta quaj çfarëdolloj dëmi por po e quaj dëm, nuk i shpëton faktit për të mos e dërguar te organet e drejtësisë.

Edhe thatë, sa jeni të rinj e keni kohë... nuk është çështje kohe, është çështje integriteti, të cilin besoj se e kemi dhe do ta mbajmë, nga se i kemi synimet e përbashkëta, që sistemin e shëndetësisë ta drejtojmë për të gjithë qytetarët tanë, pa preferenca politike, ta drejtojmë për të gjithë qytetarët tanë. Andaj, do të jem i gatshëm edhe për çfarëdolloj iniciative, të cilën edhe ju si deputetë e ndërmerri, që ta kthejmë rendin dhe rregullin në to. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë po kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1, të Rregullores së Kuvendit koha për pyetje parlamentare zgjatë 60 minuta. Ka pyetje mjaft. Shpresoj që ministrat do të përgjigjen në përputhje me kërkesat e deputetëve.

Zonja Luljeta Veselaj-Gutaj, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Zonja Gutaj e keni fjalën.

LULJETA BESELAJ-GUTAJ: I nderuar kryesues i seancës,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Të nderuar qytetarë të republikës së Kosovës,  
Pyetja ime ka të bëjë me parimin e orientimit profesional, i cili është një ndër parimet në të cilat mbështetet sistemi i ri arsimor kosovar, që ka të bëjë me zhvillimin dhe përdorimin efikas të aftësive, shprehive dhe sjelljeve të individit.

Për aktivizimin e potencialeve intelektuale dhe fizike të njeriut është e nevojshme që ato të zbulohen dhe kultivohen që nga çerdhet e kopshtet e deri te orientimi shkollor, që nënkupton klasën e nëntë, po ashtu edhe arsimin profesional.

Zoti ministër, pyetja është, a keni paraparë ndonjë projekt konkret rreth orientimit profesional?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryesues,  
Të nderuar deputetë,  
Të nderuar kolegë ministra,

E nderuara deputete,

Faleminderit për pyetjen e juaj të parashtruar!

Konsideroj se është një pyetje tejet e rëndësishme dhe pikërisht për arsyen e rëndësisë së kësaj pyetje, që në momentin kur ne kemi filluar të krijojmë parimet programore të qeverisjes së ardhshme, e kemi futur arsimin profesional si një ndër pikat kryesore të programit tonë qeverisës.

Përveç legjislacionit i cili tanimë pothuajse është i finalizuar, përfshi kurikulën bërthamore bazë që është bërë për arsimin profesional, ne kemi projekte konkrete që shkollat profesionale të zhvillohen në nivelin të cilët do të krijojnë të rinjtë tanë për të qenë të shkathtë për të gjetur një vend pune në mënyrën më të lehtë të mundshme. Kjo është nisur për vetë faktin, sepse kemi parë një disbalancë nëse e shohim numrin e të papunësuarve në Kosovë dhe kërkesat që janë për punë, pra kemi një disbalancë në mes vete. Kemi mjaftë të rinj të papunësuar, por kur kërkohet një vend i lirë për punë është shumë vështirë të gjendet kuadro adekuate me profesione të caktuara.

Mbi këtë bazë ne jemi duke marrë hapat e parë. Viti 2018 do të jetë vit që nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë do të shpallet viti për strategji nacionale të shkollave profesionale. Planifikohet që nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të të futet sistemi i modelit arsimor, kur do të bëhet vlerësimi i nxënësve në trekëndëshin prind-nxënës-arsimtar, ku normalisht do të përfshihen edhe pedagogë e psikologë, në mënyrë që në klasën e 9-të, pra në bazën e kurrikulave që i kemi bazë bërthamore, të bëjmë ndarjen e nxënësve që do të shkojnë në shkolla profesionale dhe në gjimnaz. Në këtë bazën e ndarjes së shkollave profesionale jemi në fazën e përgatitjes, ku kemi nevojë që ta kemi një fushatë vetëdijesuese, më shumë me prindër dhe mësimdhënës, në mënyrë që të rinjtë tanë të përgatiten për karrierë, sepse aktualisht mbizotëron ideja që vetëm nxënësit e dobët mund të shkojnë në shkolla profesionale.

Tutje, në modelin tonë të zhvillimit të shkollave profesionale kemi filluar një aktivitet me diskutime me biznese dhe marrëveshje me biznese, në mënyrë që të identifikohen profilet e nevojshme të shkollave profesionale. Tek planifikimi i strategjisë nacionale planifikojmë që pas përcaktimit të profileve të nevojshme për hapjen e shkollave profesionale, një pjesë të madhe të këtij stafi mendojmë ta dërgojmë jashtë vendit për specializime të veçanta të profileve të veçanta.

Pas specializimit këta mësimdhënës do të kthehen në Kosovë dhe do të jenë bartës të këtyre institucioneve, pra të shkollave profesionale. Dua të përmend në këtë rast, që është me rëndësi të themi se projektin për shkolla profesionale janë duke e ndihmuar shumë partnerë tanë, të cilët na përkrahin në zhvillimin e shkollave profesionale. Kemi filluar tri projekte të mëdha, të cilat janë të përkrahura nga Qeveria Gjermane, nga Qeveria e Luksemburgut, nga Komisioni Evropian dhe nga Qeveria Austriake dhe Zvicerane.

Konsideroj që ideja e strategjisë nacionale me përkrahjen e këtyre shteteve do të jetë e jetësuar në vitin 2018. Faleminderit!

KRYESUESI: Keni parasysh, se keni tre minuta kohë për t'u përgjigjur. Faleminderit! Pyetje shtesë? Jo. Zonja Bunjaku, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi prapë. Zonja Bunjaku e keni fjalën.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Faleminderit!

Po këto pyetje janë parashtruar me muaj të tërë dhe nuk e di për cilën pyetje konkretisht tanimë është fjala, se unë i kam parashtruar afër pesëmbëdhjetë pyetje dhe nuk e di cila ka ardhur tash sot këtu në Kuvend.

KRYESUESI: Atëherë me shifër pyetja është DO229, nëse e ke të shifruar me numër qysh e ke dorëzuar.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Nëse është pyetja, se me numër këtu nuk e kam, është më 22 nëntor kur është parashtruar kjo pyetje, është se çka ka ndërmarrë ministri i arsimit për të rritur rezultatin e efikasitetin për rezultatin PISA, që Kosova nuk ka qenë e radhitur mirë. Por këtë pyetje kemi pasur rastin të bashkëbisedojmë me ministrin edhe në Komisionin për Arsim.

KRYESUESI: Zoti Bytyqi e keni fjalën.

SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, Valentina!

Deputete e nderuar, konsideroj që e kemi sqaruar, por ndoshta është e nevojshme ta sqarojmë prapë edhe për publikun.

Gjendjen në të cilën e kemi gjetur, me masat të cilat është dashur të ndërmerren me rezultate tejet të dobëta që kanë rezultuar nga testi PIZZA 2015, faktikisht ka qenë një gjendje jo e mirë, sepse ka qenë një komision i formuar për ta përcjellë gjendjen dhe masat që duhet marrë për ndryshimin e situatës së testit PIZZA 2015 nuk janë ndërmarrë. Një komision i cili edhe për mua ka qenë inekzistent, sepse asnjëherë nuk është tubuar dhe nuk e ka bërë asnjë aktivitet.

Me marrjen tonë të detyrës ne menjëherë e kemi shkarkuar atë komision që ka qenë inekzistent, kemi formuar komisionin e ri, i cili komision menjëherë është vënë në punë. Ka bërë një plan tejet dinamik të punës për periudhën e shkurtë që e kemi, sepse siç e di opinioni, në fund të prillit duhet të mbahet testi PIZZA 2018.

Tutje, është përpiluar udhëzimi administrativ, i cili i bën përgjegjës duke filluar nga ministri e deri poshtë tek mësimdhënësi, për përgjegjësinë që do ta kenë testi PISA, 2018. Jemi duke bërë punë në terren, sepse jemi duke diskutuar me të gjitha komunat, me drejtorët komunalë të

arsimit, me përgjegjësit e shkollave, me mësimdhënës, për ta shtuar peshën dhe rëndësinë e testit PISA 2018.

Ajo çka ne duhet të theksojmë është se jemi në përfundim të përgatitjes së testit të parë provues, i cili do të mbahet këtë muaj, test i cili do t'i familjarizojë nxënësit tanë, sepse për herë të parë do të mbahet në formë digjitale. Tutje, është një fushatë e përgjithshme që ta ngremë nivelin e përgjegjësisë dhe t'ia shtojmë peshën e mbajtjes së testit. Është e pamundur që për këtë periudhë të shkurtër të ndryshojmë në cilësinë e gjendjes së mësimit nga nxënësit, por konsideroj se kjo përpjekje e jona, ky sensibilizim i përgjithshëm dhe kjo kërkesë e përgjegjësisë së madhe nga secili që është akter i pjesës së testit PISA, do të na japë rezultate më të mira se sa që kanë qenë në vitin 2015. Nuk presim rezultate, të themi shumë të larta, por nga vetë përgjegjësia konsideroj që të jemi shumë më mirë, se që kemi qenë. Janë të planifikuara të gjitha detajet, deri në detajin e fundit të mbajtjes në ditën finale të testit. Po ashtu, kemi kërkuar nga të gjitha shkollat, të cilat janë të përzgjedhura nga PISA për 2018, që të kemi orë shtesë me nxënësit të cilët do t'i nënshtrohen këtij testi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Jo, faleminderit! Ne jemi konsultuar edhe në Komisionin e Arsimit me ministrin.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Osmani, pyetje për ministrin Rrustem Berisha. Zonja Osmani s'është këtu. Zonja Kusari-Lila, pyetje për ministrin Valdrin Lluka.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Pyetja gjithashtu është dorëzuar në muajin nëntor. Ka qenë e njëjta pyetje për ministrin Lluka dhe për ministren Reshitaj. Ka të bëjë me objektin e KRU, tash Gjakova, e i cili objekt është i ndërtuar pa leje në komunën e Gjakovës. Flasim për ndërmarje publike, e cila është kompetencë e Ministrisë së Zhvillimit. Në vitin 2016 është kërkuar prej Ministrisë së Mjedisit dhe inspektoratit që të japin përkrahimin, gjegjësisht arsyetimin e tyre, prej të cilëve nuk ka pasur as leje mjedisore dhe as leje të ndërtimit.

Pyetja për ministrin Lluka ka qenë, a është Ministria e Zhvillimit Ekonomik e vetëdijshme që janë bërë investime qindra e mijëra euro në këtë objekt pa leje nga komuna, pa leje nga Ministria e Mjedisit, pa vlerësim mjedisor, ndërsa mbi të gjitha, ekziston një dokument valid i cili është tërheqja e lejes, se fillimisht është kërkuar restaurimi i objektit të rojeve, që kanë qëndruar pranë Liqenit akumulues Radoniqi, pastaj është revokuar për shkak se kompania ka dështuar që t'i sjell kriteret që duhet t'i plotësojë paraprakisht për marrjen e lejes dhe sot e kemi objektin i cili është një objekt P+2 ose P+3, nëse nuk gaboj, i cili është i ndërtuar dhe ende më keq, i cili ka filluar ose ka pasur informacione që ka filluar t'u ofrohet kompanive hoteliere për shërbime hoteliere



pranë liqenit akumulues. Sipas ligjit dhe udhëzimit administrativ rrezja prej 200 metrash është rreze e cila absolutisht nuk lejohet asnjë ndërtim, përderisa edhe në perimetrin e dytë mund të jenë ndërtime të ulëta, ose të përkohshme, ndërsa ne flasim për një investim qindra e mijëra eurosh.

Ministër, është në kompetencën tuaj dhe të ministrisë që ju e drejtoni menaxhimi dhe mbikëqyrja e ndërmarrjeve...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Lluka, e keni fjalën.

VALDRIN LLUKA: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë,

E nderuar deputete,

Referuar shqetësimit tuaj, unë normalisht kërkova të marr informata të menjëhershme nga ministria që drejtoj lidhur me këtë çështje dhe veçanërisht lidhur me projektin e ndërmarrjes publike Radoniqi, të cilën e përkrahim pjesërisht në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Me këtë rast ju përcjell informatat e projektit të bashkëfinancuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës përmes ministrisë. Projekti i ekzekutimit të fazës së dytë të përpunimit të ujit të pijes, linjës së ujit Anadrini dhe kanali derivues i basenit të Radoniqit i ndarë në tri lloje, nga ana e MZHE-së është i mbështetur në dy lloje të kësaj faze, lotin 2 dhe 3. Ndërsa, në lotin 1 të kësaj faze MZHE nuk është bashkëfinancues dhe pjesë e këtij loti qenka edhe objekti të cilin ju e adresoni, siç u informova saktësisht nga zyra e njësisë për monitorimin e ndërmarrjeve publike.

Lidhur me çështjen e adresuar ju bëj me dije, se Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk bartë përgjegjësinë lidhur me pjesën e procedurave ligjore të ndërmarrjeve publike në përgjithësi, në rastet e menaxhimit të tyre e as në rastet e investimeve kapitale për kërkesat ligjore ndaj autoriteteve përkatëse, sikurse në rastin të cilin e keni adresuar për lejen e ndërtimit. Lidhur me këtë nuk dua të them se nuk shfaqim interesimin për mbarëvajtjen ligjore të ndërmarrjeve publike, por është pjesë e cila na kufizon me ligj dhe si e tillë kjo duhet të përfilllet nga vetë ndërmarrjet publike, përkatësisht stafi menaxheria i tyre.

Gjithashtu, ju informoj se Ministria e Zhvillimit Ekonomik përmes njësisë monitoruese bën monitorimin e ndërmarrjeve publike, por që nuk e ka në mandat aprovimin e planeve të punës së tyre. Kjo është e rregulluar si çështje e brendshme e ndërmarrjeve dhe autoriteteve të bordit të ndërmarrjeve.

Për sa i përket lejes së ndërtimit e kam shikuar një... se e kam parë edhe përgjigjen e ministres së Ambientit, unë me sa vërejtja në përgjigjen e ministres, por prapë shpresoj se ajo do të vijë dhe do të japë përgjigje, leja u është dhënë në muajin mars të vitit 2017 për ndërtimin në fjalë. Prapë po them, kjo nuk është përgjigje ndoshta që unë mund të flas me kompetencë, për arsye se është pjesë e Ministrisë së Ambientit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Lila?

MIMOZA KUSARI-LILA: Po. Flasin për një objekt tërësisht pa leje. Nuk ka leje për shkak se Komuna e Gjakovës nuk ka lëshuar leje për atë objekt. Objektin të cilin ju e përmendni, ministër, është objekti i Fabrikës së Ndërtimit për kapacitetin e ujit të pijes, ndërsa objekti për të cilin unë po flas është tërësisht i karakterit administrativ. Ndërsa, me Ligjin e menaxhimit të ndërmarrjeve publike Njësia për monitorimin e ndërmarrjeve nëse ka devijime serioze nga plani menaxhues dhe implementimi nga ky bord kërkohet edhe ndërhyrja e juaj e drejtpërdrejtë në ndërmarrjen publike.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, keni përgjigje? Në rregull. Faleminderit! Deputeti Hoti, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Kryeministri nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen? E shtynë për mbledhjen e ardhshme.

Deputeti Hoti, prapë pyetje për ministrin Abelard Tahiri.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Ju e dini që Kosova është në proces gjyqësor në Gjykatën e Arbitrazhit, kjo nga se shoqëria e investimeve Axos Kapital Partners ka hapur proces arbitrazhi, pra në Qendrën Ndërkombëtare të Arbitrazhit mbi investimet në Uashington, sepse Qeveria Thaçi më 2013 e tërhoqi marrëveshjen e negociuar për privatizimin e PTK-së atëherë. Tash Kosova rrezikon të humbë qindra milionë euro në këtë proces gjyqësor. Atë që dëshiroj të di, është se në çfarë faze ka arritur kjo çështje në Gjykatën e Arbitrazhit, çfarë ka ndërmarrë Qeveria në 3-4 muajt e fundit, sepse, sipas informatës që kemi, është mbajtur një seancë përfundimtare në nëntor, ku nuk ka pasur përfaqësim adekuat të Qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Tahiri, e keni fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar zoti deputet,

Procesi i arbitrazhit në lidhje me padinë e AXOS-it për procesin e privatizimit të PTK-së, i parashtruar pranë Qendrës Ndërkombëtare të Arbitrazhit për zgjidhjen e kontesteve në fushën e investimeve është duke u zhvilluar që nga fillimi i vitit të kaluar.

Në lidhje me këtë proces Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Drejtësisë, Avokati i Shtetit dhe Zyra e Kryeministrit si dhe institucionet e tjera të përfshira në këtë proces kanë koordinuar dhe ndërmarrë veprime ligjore dhe procedurale sipas mandatit për të lehtësuar përfaqësimin e Republikës së Kosovës në këtë proces.

Gjatë periudhës paraprake në tremujorin e vitit të kaluar, avokati përfaqësues i Republikës së Kosovës, nga kompania “Squire Patton Boggs”, e ka përgatitur reagimet kundërshtare në lidhje me padinë.

Republika e Kosovës, përmes përfaqësuesit ligjor, ka përgatitur përgjigje në padinë dhe e ka dorëzuar atë në Tribunalin më 1 shtator të vitit të kaluar.

Avokati ligjor i Kosovës, në bazë të dokumentacionit në lidhje me projektin, ka përgatitur përgjigje në çështje të ngritura në padi si dhe ka koordinuar procesin e deklaratave të dëshmitarëve dhe raporteve të ekspertëve ligjorë dhe financiarë.

Më 1 shtator të vitit 2017 kanë paraqitur në Tribunal kundërshtimin e saj mbi juridiksionin e Tribunalit nëpërmjet raportit, raporteve të ekspertëve profesionalë dhe nëpërmjet deklaratave me shkrim të dëshmitarëve.

Pra, më 1 tetor të vitit 2017, një muaj më vonë, deri në seancën dëgjimore përfaqësuesi ligjor i Kosovës ka punuar intensivisht në përgatitjen për përfaqësimin e Kosovës gjatë seancës dëgjimore të mbajtur në Odën Tregtare Ndërkombëtare në Paris, pra në Francë.

Seanca dëgjimore është mbajtur nga 6 deri më 13 nëntor, ku avokati ligjor i Republikës së Kosovës ka argumentuar çështjen e juridiksionit, meritave dhe vlerësimit të dëmit bazuar në dokumentin tenderues për këtë projekt dhe provat materiale.

Argumenti kryesor i paraqitur në seancë ka qenë se Kosova ka gëzuar të drejtën e anulimit të procesit për çfarëdo arsye deri në momentin e nënshkrimit të kontratës.

Kjo bazuar në dokumentacionet e nënshkruara nga pala paditëse.

Si rezultat është kundërshtuar juridiksioni në mungesë të investimit nga investitori si dhe çështjet meritorë në lidhje me këtë proces.

Me përfundim të seancës dëgjimore trupi i përbërë nga arbitrit në Tribunalin e Arbitrazhit sipas rregullave procedurale do të shqyrtojë, do të ekzaminojë dhe do të administrojë të gjitha faktet, provat dhe dëshmitë e paraqitura nga palët në proces, përfshirë dëshmitarët dhe ekspertët që kanë marrë pjesë në këtë seancë.

Vendimi final i trupit të Tribunalit pritet të shpallet në gjysmën e dytë të këtij viti, të vitit 2018.

Andaj, meqenëse ky proces është në fazën më kritike të vendimmarrjes nga ana e Tribunalit është e rëndësishme të kemi parasysh kompleksitetin dhe sensitivitetin e informatave në lidhje me këtë proces të rëndësishëm për Republikën e Kosovës.

KRYESUESI: A ka pyetje shtesë? Jo, atëherë në rregull është, zoti ministër.

Vjosa Osmani, pyetje për ministrin Berisha.

VJOSA OSMANI: Po, për ministrin e FSK-së.

Zoti ministër,

Neni 5.2 i propozimit gjithëpërfshirës për statusin e Kosovës, e njohur si Marrëveshja e Ahtisarit, e cila ka përcaktuar shumë detaje në fushën e sigurisë thotë se FSK do të jetë e armatosur lehtë dhe nuk do të posedojë armë të rënda, si tanke, artileri të rënda apo kapacitet ajror ofensiv. Megjithatë do të përbëhet prej jo më tepër se 2 500 pjesëtarëve aktivë dhe 800 pjesëtarëve rezervë.

Pyetja është kjo: Sa është numri i përgjithshëm i ushtarakëve rezervë në FSK? Pse FSK ka dështuar të rekrutojë numrin e paraparë prej 800 ushtarëve rezervë tash e 10 vjet nga shpallja e pavarësisë? Si mund të kërkojmë kompetenca shtesë për FSK-në, kur edhe ato që na janë dhënë deri tani nuk janë duke u përmbushur? A mendoni se mosrekrutimi i plotë i ushtarëve rezervë ndikon në sigurinë e përgjithshme në vend, por edhe në planin e transformimit të FSK-në në Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën, për çështjet që s'kanë relevancë publike, mund të mos flisni.

MINISTRI RRUSTEM BERISHA: Faleminderit për pyetjen, e nderuar deputete!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Zonja e zotërinj,

Çështja e përbërjes dhe përcaktimit të numrit të komponentit aktiv dhe komponentit rezervë, krahas asaj që ju e thatë, është e përcaktuar edhe me Ligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me ligjin numër 03/L-046, më saktësisht neni 14, ku thotë se komponenti rezervë përbëhet prej më së shumti 800, domethënë përbëhet prej më së shumti 800 pjesëtarëve.

Që nga themelimi e deri në vitin 2012 realisht Forca e Sigurisë së Kosovës ka rekrutuar dhe ka trajnuar 359 pjesëtarë të komponentit rezervë.

Që nga viti 2012 nuk ka pasur rekrutim të pjesëtarëve rezervë, arsyet janë shumë ngjarje që janë zhvilluar, rishikimi strategjik i sektorit të sigurisë, pastaj janë çështje të tjera që kanë pasur të bëjnë me strukturën e re që do të formohet dhe ka qenë arsyeja tjetër që nuk ka pasur edhe kërkesa nga njësitë për plotësimin e vendeve rezervë.

Sidoqoftë, është një gjendje që unë e kam trashëguar, një prej objektivave të mi do të jetë edhe plotësimi i komponentit rezervë në të ardhmen, por është një gjendje çfarë edhe e kemi trashëguar nga ministrat më herët.

Kurse sa u përket pyetjeve të tjera, se sa ndikon kjo në strategjinë ose në sigurinë e përgjithshme, mendoj se plotësimi i komponentit rezervë, duke marrë parasysh misionin çfarë e ka FSK-ja, deri më tani nuk ka ndikuar në sigurinë e përgjithshme, por është një çështje që në kuadër të ligjeve ne sa më parë duhet ta plotësojmë këtë komponentë rezervë me pjesëtarët rezervë.

Ne si ministri, edhe Qeveria e Republikës së Kosovës një prej objektivave kryesore ka transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forca të Armatosura të Republikës së Kosovës, edhe në kuadër të kësaj, në këtë drejtim ne kemi bërë shumë hapa konkretë që kjo të ndodhë sa më shpejt që është e mundur. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Pyetje shtesë?

VJOSA OSMANI: E para, si koment çështjet e sigurisë, natyrisht, gjithnjë kanë relevancë publike.

Kurse sa i përket pyetjes shtesë, zoti ministër, meqenëse në buxhetin që e kemi miratuar në këtë Kuvend nuk është paraparë buxhet shtesë për rekrutime dhe meqë ju e konfirmuat që është synim juaji që të rritet edhe numri i ushtarëve rezervë si pjesë e ngritjes së kapaciteteve, a do të kërkonte ju si ministri dhe a e keni diskutuar brenda Qeverisë që së paku në vitet pasuese të parashihet buxheti, në mënyrë që të mos keni probleme buxhetore për rekrutimet shtesë dhe që të plotësohet ky numër që tashmë lejohet, ende pa u bërë transformimi.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI RRUSTEM BERISHA: Sa i përket buxhetit të alokuar nga Ministria e Financave është paraparë për 3 324 pjesëtarë, këtu përfshihen pjesëtarë të ministrisë aktuale, në misionin aktual përfshihen pjesëtarët e Ministrisë së Forcës së Sigurisë, FSK-së, pjesa civile, pjesa rezervë, edhe kadetët që i kemi në kuadër të strukturës.

Pra, nuk kemi paraparë buxhet shtesë për atë pjesën deri me 800 pjesëtarë, por sidoqoftë ne e kemi biseduar këtë çështje dhe besoj që bashkëpunimi me Ministrinë e Financave do ta

rregullojmë këtë çështje në të ardhmen që të kemi hapësirë dhe mundësi ta plotësojmë komponentin rezervë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Edhe pse kjo çështje është elaboruar më herët, por dua të jap ca detaje,

I nderuar ministër,

Ministria e Shëndetësisë në vitin 2015 e ka ndryshuar projektin e sallës hibride në një projekt më të vogël për blerjen e disa aparaturave për Kardiologjinë Invazive në Qendrën Klinike Universitare.

Ky projekt nga Ministria e Shëndetësisë është quajtur modernizimi i shërbimeve të Kardiologjisë invazive në QKUK, i planifikuar të realizohet nëpërmjet kredisë Kosovë - UniCredit Banka Austria, për çka e falënderojmë Qeverinë e Austrisë për mbështetjen.

Por punët nuk kanë ecur si duhet në Ministrinë e Shëndetësisë dhe kritika ime ka qenë e vazhdueshme për këtë projekt dhe ngecjet të cilat po ndodhin sot e arsyetojnë kritikën që unë e kam bërë me kohë, sepse në fillim është planifikuar që kjo shumë të jetë 2,1 milionë, e më pas është rritur në 2,6 milionë.

Prandaj, për këtë arsye Kuvendi në shkurt 2016 nuk e votoi këtë projekt dhe më pas në qershor 2016 është votuar me klauzolën që Komisioni për Shëndetësi do të monitorojë implementimin e këtij projekti.

Në raportimin e ish-ministrit të Shëndetësisë në Komisionin për Shëndetësi në mbledhjen e datës 15 mars 2016 është deklaruar nga ai se rritja e shumës së kredisë prej afro 500 mijë euro ka të bëjë me trajnimin dyjavor për përdorim të aparaturës dhe për zgjatje të garancisë si dhe për mirëmbajtje dhe për rregullimin e hapësirave ku do të vendoset aparatura. Ndërsa, aparatura sot nuk po vendoset mu për shkak të mungesës së hapësirës.

Prandaj, sot kemi këto ngecje, të cilat janë dyvjeçare dhe po duket që do të zgjasin edhe muaj të tjerë.

I nderuar ministër,

Do të duhej një informatë të plotë rreth kësaj çështjeje, sepse pyetja ime është para një muaj e gjysmë, mirëpo për shkak të mungesës së punës së Kuvendit tani ka ardhur në rend të ditës.

Prandaj, kërkojmë një sqarim të detajuar rreth këtij projekti dhe në veçanti...

KRYESUESI: Po, ti e di sa minuta i ke, përfundoje pyetjen.

BEKIM HAXHIU: Mbeta vetëm pa e thënë se pacientët tanë po vuajnë, nuk kanë mundësi të marrin shërbimin, sigurisht që përgjegjësit për këto ngecje do të duhej të dërgoheshin në institucionet përgjegjëse të prokurorisë së shtetit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit!

Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Faleminderit, deputet Haxhiu, për pyetjen,

Realisht është një projekt që jeni të vetëdijshëm, nga se ka kaluar edhe nëpërmjet Kuvendit, duke marrë një aprovim, është projekt i vitit 2015, ka mbetur vonë, nuk di a mund ta quaj është neglizhuar ndoshta, por e dimë që ka pasur një vonesë të madhe.

Dhe si e tillë ka krijuar një mungesë të një aparature që është aq e nevojshme për shërbimet mjekësore, duke krijuar ndoshta edhe lista të gjatë të pritjes dhe duke mos pasur mundësi të japim shërbime që kemi pasur në nevojë.

Është projekt kapital, shumë i rëndësishëm, është shumë mirë që është bërë, por është shumë keq që është vonuar. Kjo është e keqja e kësaj pune.

Prandaj, mund të them që neglizhimi është bërë gjatë projektimit, është bërë një projektim, i cili më pastaj nuk ka arritur të realizohet, kanë dalë probleme teknike gjatë realizimit, ka pasur shkëmbime, ta quaj, të informatave nga njëra palë tek tjetra, mirëpo në asnjë moment nuk është bërë një zgjidhje, e cila ka pasur mundësi ta rehabilitojë hapësirën.

Ne kemi marrë një iniciativë që kësaj here të inkorporojmë edhe komentet e prodhuesit, pra prodhuesit të aparaturës, nga se ai ka pasur disa komente specifike se si duhet të jetë hapësira, pra për mungesë rrezatimesh ose për hapësira të tjera.

Dhe, e dyta, ka qenë në mungesë të renovimit ashtu siç duhet të jetë, mund të rrezikojmë të mos kemi fare garanci.

Kështu që ne kemi bërë që gjithçka në hapësirë të jetë sipas specifikacioneve teknike.

Çështja do të mbyllet shpresoj për tre muaj, jam i bindur që do të mbyllet në tre muajt e ardhshëm dhe do të kemi një aparaturë, pas një zhargitje dyvjeçare, unë mund të them që do të

mbyllet për tre muajt e ardhshëm dhe do të kemi një shërbim shumë të nevojshëm për qytetarët tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Po, zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar ministër për sqarimin, U tha edhe nga kolegët e tjerë, sepse në vitet 2014 dhe 2015 në Kardiologjinë invazive lista e pritjes për pacientë ka qenë një javë, ndërsa tani është gjashtë muaj. Pra, kemi të bëjmë me menaxhimin, do të thotë se edhe pa këtë aparaturë ju arritët të ofroni shërbime 24 orë. Prandaj, insistimi im atëherë ka qenë që këto mjete të investohen në emergjencë, në intensive, në sallat e operacionit, aty ku luftohet për jetën.

Prandaj, pyetja ime shtesë është: Planifikimet tuaja për investime në sallat e operacionit dhe në diagnostikim, në emergjencë dhe në intensiv, kur do të jenë?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit!

I nderuar deputet,

Realisht gjendja në Qendrën Klinike Universitare, po edhe në shumë spitale tona nuk i ofron kushtet, ta them, edhe të punës dhe për personelin tonë mjekësor. Ne duhet të jemi të vetëdijshëm se, në qoftë se nuk i ofrojmë kushte, nuk investojmë në institucione tona shëndetësore, atëherë edhe shërbimet do të fillojnë të degradojnë.

Ne kemi filluar me investime në emergjencën e vjetër, pra kemi një projekt të ri, do ta rinovojmë emergjencën, duke krijuar edhe salla të pritjes për qytetarët tanë, të mos presin qytetarët tanë siç presin sot në sallën e emergjencës, disa hyjnë nga e majta, disa nga e djathta, futen të gjithë duke i krijuar vështirësi për personelin, por në anën tjetër, duke krijuar edhe stres e paqartësi për qytetarët.

Prandaj, nga ajo kemi filluar, jemi duke punuar po ashtu edhe në krijimin e ambulanteve, hapësira për ambulanca, të cilat ju veç i dini janë në radhë të gjatë në qendrat klinike presin të stërmbushura.

Investimet të cilat i kemi planifikuar do të shihni muajve me radhë, do ta lëshojmë edhe intensiven, edhe ortopedinë. Jemi duke filluar në ortopedi, po ashtu, që të krijojmë, ngase janë ndarë në dy hapësira dhe kemi lëvizje të qytetarëve nga një hapësirë në një hapësirë, pra jemi duke bërë një sërë investimesh në Qendrën Klinike Universitare dhe po ashtu po punojmë edhe me spitalet rajonale që të fillojmë investimet edhe atje, ta përmirësojmë infrastrukturën fizike që të kemi edhe një përmirësim të shërbimeve shëndetësore për gjithë qytetarët. Faleminderit!



KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Xhevahire Izmaçu, pyetje për ministrin Flamur Sefaj.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Këtë pyetje e kam marrë, kështu që s'ka nevojë të përgjigjet, ministrit faleminderit për gatishmërinë.

KRYESUESI: Deputeti Zafir Berisha, pyetje për ministrin Sefaj.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Flitet, zoti ministër, se Inspektorati Policor ka gjetur një numër të madh të pjesëtarëve të policisë që janë kategorizuar si invalidë. A keni informata, sa është numri i tyre dhe cila është shkalla e invaliditetit të atyre zyrtarëve, pasi dyshohet se ka edhe zyrtarë të lartë të Policisë që në të njëjtën kohë janë invalidë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sefaj e ka fjalën.

MINISTRI FLAMUR SEFAJ: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti Berisha,

Për çështjen që ju e keni ngritur janë rreth 148 zyrtarë policorë, të cilët nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale janë lëshuar vendime për njohjen e të drejtës për pension të invalidëve të UÇK-së.

Me vendime është përcaktuar shkalla e invaliditetit, është e ndryshme dhe dallon prej një zyrtari në tjetrin.

Pozitat që i mbajnë këta zyrtarë brenda Policisë së Kosovës variojnë, duke filluar nga pozitat administrative, operative, hetuese të specializuar edhe menaxhuese.

Inspektorati Policor i Kosovës është duke e trajtuar këtë çështje dhe Policia e Kosovës do të veprojë konform rekomandimeve që do t'i jepen nga IPK-ja.

Desha ta shfrytëzoj vetëm edhe për një përgjigje të shkurtër, nëse bën, kryesues, sepse më herët trajtuam çështjen e Inspektoratit dhe Policisë.

Është me të vërtetë e rëndësishme që në takime të tilla parlamentare politike kur përmenden emrat e diriguesve të këtyre institucioneve, është mirë që të paraqiten edhe fakte, sepse po flasim për institucione shumë të rëndësishme që garantojnë sigurinë e shtetit tonë dhe garantojnë atë të drejtë elementare të çdo qytetari që të ndihet i sigurt.

Unë mund të them që kam bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë me menaxhmentin e Policisë, natyrisht të gjitha institucione kanë vend për përmirësime, por nuk duhet të pranojmë akuza të tilla pa fakte ose së paku ndonjë indicie. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë ka zoti Berisha.

ZAFIR BERISHA: Sigurisht, ministër, këtë pjesën e dytë nuk e pate për mua. Ok-ej! Këtë desha ta sqaroj.

Në anën tjetër, zoti ministër, unë po mendoj se ju e dhatë një shifër që unë dyshoj sipas burimeve të mia t'i informacionit, se numri duhet të jetë më i madh, po pak rëndësi ka, me rëndësi se ka invalidë.

Dyshohet se disa prej atyre që janë invalidë, janë edhe të lajmëruar si invalidë që nga lufta kanë dalë me pasoja të krizave psikike. Në rast se një zyrtar i lartë i Policisë ka edhe atë shkallë të invaliditetit, sa jemi të sigurt se ai zyrtar mund të bëjë ndonjë skandal që nuk përjashtohen në Kosovë dhe thjesht të mos japë përgjigje para organeve të drejtësisë, sepse në fund të fundit i ka letrat që s'është në terezi. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FLAMUR SEFAJ: I nderuar deputet,

Dua ta precizoj këtu se ky fenomen është i shtrirë në të gjitha kategoritë profesionale, jo vetëm në kategoritë, të cilat bëjnë pjesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, po sidoqoftë, për rastin konkret për të cilin ju e keni ngritur çështjen kemi të bëjmë me 148 pjesëtarë të Policisë dhe 2 pjesëtarë të Inspektoratit.

Mund të them që grupi hetimor, i cili është duke u marrë me këtë rast, në këtë rast Inspektorati merret me Policinë, tani është në fazën përfundimtare rasti, në fazën përfundimtare të hetimeve dhe pas konsultës me prokurorin e çështje do të vendoset rreth ngritjes së kallëzimeve penale. Është në procesim i gjithë ky fenomen.

Duhet të kemi parasysh që patjetër duhet të zbatohet ligji, por edhe një komponent tjetër është i rëndësishëm që duhet ta kemi parasysh edhe çështjen humane të trajtimit të këtyre rasteve, se kemi të bëjmë edhe për ish-luftëtarë, të cilët me të vërtetë kanë pësuar gjatë luftës, kanë plagë, kanë trauma, por pa tjetër do të zbatohet ligji ashtu siç është e paraparë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi, pyetje për kryeministrin.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Pyetja ime është lexuar në seancën e kaluar dhe ka të bëjë me heshtjen, zvarritjen si do ta quani, të hetimit të pavarur të plotë ndërkombëtar të rastit Astrit Dehari.

Zoti kryeministër e ka pritur familjen e Astrit Deharit, i ka premtuar se një gjë e tillë pas vendimit të Qeverisë së Kosovës do të lejohet, tani mbi tre muaj nuk ka asnjë veprim në atë drejtim, përveç veprimeve mediatike, ku bëhet një luftë mes prokurorisë, ministrit të Drejtësisë dhe të tjerëve se si do të bëhet ky hetim ndërkombëtar. Vërtet bëhet një përpjekje përmes mënyra perfide që të devijohet i tërë koncepti i hetimeve të plota ndërkombëtare që është kërkuar nga familja. Kjo është e tëra.

KRYESUESI: Faleminderit! Nëse jeni dakord, ministri i Drejtësisë dëshiron të sqarojë lidhur me këtë çështje diçka, nëse jeni dakord, nëse jo. Zotit kurteshi fjalën.

SAMI KURTESHI: Po, unë jam dakord, pyetja i është drejtuar kryeministrit, për arsye se kryeministri e ka pritur në takim zyrtar familjen Dehari. Kush ka qenë në atë takim zyrtar, unë nuk e di, po ministri i Drejtësisë është njëri ndër personat përgjegjës në tërë çështjen, për arsye se sigurisht e ka atë dosjen në dispozicion.

Prandaj, përgjigja e tij zyrtare është e nevojshme.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Abelard Tahiri e ka fjalën, ministër i Drejtësisë, besoj që do të japë një informatë.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar zoti deputet,

Ashtu siç ju kam njoftuar edhe përmes mediave, tashmë kemi marrë dhe hapa konkretë në këtë çështje. Përpos që i kemi ndarë mjetet, kemi kërkuar mirëkuptimin nga Prokuroria e Kosovës që të respektojë vullnetin e familjes dhe ta anashkalojë rekomandimin e Kuvendit të Kosovës.

Dhe, zyrtarisht nga kryeprokurori i shtetit dhe nga prokurori i rastit kam marrë njoftimet e para që kanë filluar kontaktin me institutin në Zvicër konform kërkesë së familjes dhe tashmë jam në kontakt me ta përmes Ambasadës së Zvicrës në Republikën e Kosovës.

Si ministër i Drejtësisë, si person përgjegjës për ndërlidhje për çështje për bashkëpunim ndërkombëtar juridik, kam shprehur gatishmërinë dhe vullnetin që ta përcjell nga afër këtë çështje dhe nëse është e nevojshme, do të ndajmë edhe mjete tjera shtesë dhe konform kërkesës së familjes edhe kjo çështje ta marrë epilogun e vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë ka zoti Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Zoti ministër, faleminderit!

Ky është një sqarim i një natyre tjetër nga sqarimet e dhëna në media dhe nga ajo që citohet në mediat nga prokuroria dhe ju.

Aty në media del se Prokuroria e Kosovës është duke mbledhur dokumentacionin që të dërgohet në Zvicër për ekspertizë dhe super ekspertizë. Kjo nuk është kërkesa e familjes, familja nuk kërkon auditim të dokumenteve të mbledhura, sepse rasti është shumë më i ndjeshëm. Familja kërkon një hetim të plotë, të pavarur, ndërkombëtar nga një institut me renome botërore, në vend të ngjarjes deri në zhvarrosjen e trupit të Astrit Deharit të ndjerë. Kjo është kërkesa origjinale e familjes. Edhe ky është një obligim...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër e ka fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Takimit, të cilit ju iu referuat me kryeministrin e Republikës dhe familjarët e të ndjerit, unë kam qenë i pranishëm dhe i kemi diskutuar rekomandimet e Kuvendit që bëhet fjalë për ekspertizë, super ekspertizë apo ekspertizë shtesë në institutin që ka kërkuar familja e të ndjerit.

Dhe, konform asaj kërkesë, konform shkresës së avokatit të të ndjerit, zotit Tomë Gashi, ne kemi kërkuar pa dashur të ndërhyjmë në punën e prokurorisë, sepse ne as deputetë, as ministrat nuk mund t'i tregojmë se si duhet ta bëjnë punën prokurorët, në fund janë ata. Unë e kam theksuar edhe më herët që në Ministrinë e Drejtësisë nuk ka rast, rastin e ka një prokuror, është në Prokurorinë e Prizrenit dhe përmes atyre ne do ta adresojmë. Kemi kërkuar mirëkuptimin edhe vullnetin e tyre që konform legjislaturës së kaluar, rekomandimeve që ky rast të marrë një epilog.

Unë shpresoj që në një të ardhme shumë të afërt punën e këtij instituti që do ta bëjë në raport me këtë rast do ta kemi përpara të gjithë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Nezir Çoçaj, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi. Zoti Çoçaj e keni fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

I nderuar ministër i Arsimit,

Bashkëpunëtorët profesionalë në shkolla, sidomos pedagogu i shkollës luan rol jashtëzakonisht të madh në rritjen e cilësisë në arsim, duke ndihmuar nxënësit, mësuesit, prindërit, drejtorin dhe të gjithë aktorët e tjerë në realizimin e kurrikulës dhe të çështjeve pedagogjike, didaktike, metodike

dhe metodologjike të punës në hartimin e plan-programit, vlerësimit të performansës së mësuesve. Prandaj, angazhimi i tyre në shkolla nënkupton realizimin e objektivave të kornizës kurrikulare të Kosovës dhe dokumentacionit pedagogjik.

Prandaj, pyetja ime është çfarë do të ndërmerrni që pedagogët të kthehen në procesin edukativo-arsimor? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër Bytyqi, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë ministra,

Deputet Çoçaj, faleminderit për pyetjen.

Është një pyetje e cila ka një peshë të rëndësishme, sepse po flasim gjithmonë për cilësinë e arsimit dhe pjesa e pedagogëve dhe psikologëve realisht e luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.

Ajo çka ne aktualisht jemi duke bërë, përkundër vështirësive të cilat i kemi me buxhet, tash e dimë që kemi një buxhet të kufizuar, qoftë në nivelin e ministrisë, por qoftë edhe në nivelin lokal, për një kategori të rëndësishme të ngritjes së cilësisë së arsimit.

Megjithatë ne si ministri, përkatësisht Divizioni për Zhvillim Profesional të Mësimdhënësve, si pjesë e Këshillit shtetëror për licencimin e mësimdhënësve, është duke bërë planifikimin dhe hartimin për aprovimin e Udhëzimit administrativ që ka të bëjë me licencimin e bashkëpunëtorëve profesionalë.

Në këtë drejtim parashihen që pedagogët dhe psikologët, të cilët tashmë janë pjesë e shërbimeve profesionale nëpër shkolla, pra në kuadër të objektivit të strategjisë tre, për sigurimin e cilësisë, parashihet që ky numër i pedagogëve të rritet dhe ne planifikojmë që minimumi të arrijë në 100 pedagogë.

Normalisht që na duhet një përkrahje buxhetore, në mënyrë që në numrin e paraparë të nxënësve, bazuar në një pedagog, të arrijmë si realizim i përgjithshëm dhe të jemi tani të kompletuar me pedagogë.

Normalisht ne do të vazhdojmë që të kemi një zhvillim të shpejtë legjislativ që të mos jetë pengesë çështja legjislative dhe tutje të bëjmë përpjekje për sigurimin e buxhetit që të jenë të përfshirë pedagogët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Çoçaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit!

Zoti ministër,

Unë këtë pyetje i kam parashtruar edhe ministrit paraprak, po nuk është ndërmarrë asgjë, për fat të keq, ajo farë demagogjia e dhënies së përgjigjes së ministrit është e tmerrshme, ka qenë e tmerrshme. Shpresoj shumë që ju që do të ndërmerrni diçka.

Po sqaroj, 175 pedagogë kanë qenë të paraparë në kornizën afatmesme të shpenzimeve, ka qenë buxheti i ndarë për 175, po drejtoritë komunale të arsimit, gjegjësisht drejtorët nëpër komuna kanë punësua mësues që i kanë pasur të angazhuar dhe i kanë hequr pedagogët nga shkolla.

Unë shpresoj shumë se ju e dini rëndësinë e vlerësimit të performansës së shkollës edhe mësimdhënësve. Pedagogu është roli kryesor në shkollë. Andaj, kërkoj kthimin edhe insistimin që edhe ju të kërkonin nda drejtoritë komunale që të punësohen pedagogë, e jo mësues, apo ata që angazhohen me nga katër orë mësimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, në qoftë se doni.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Nuk do të doja të diskutoja çështjen e të kaluarës, unë do të merrem me gjërat tani e tutje.

Ne jemi duke biseduar me secilën drejtori komunale të arsimit, në mënyrë që vërtet vendet të cilat janë të rezervuar për pedagogë, duhet të jenë për pedagogë dhe presim që këtë gjendje ta realizojmë.

Unë konsideroj që do ta gjejmë mirëkuptimin, po përveç mirëkuptimit, ne do t'i rregullojmë me legjislacion, në mënyrë që të mos ketë devijime të tilla të punësuarve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Çoçaj, prapë pyetje për ministrin Bytyqi.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit!

Faleminderit, zoti ministër!

Pyetja e radhës ka të bëjë me edukimin parashkollor, është i përfshirë një numër i konsiderueshëm i fëmijëve, e sidomos në çerdhet private.

Mirëpo këto çerdhe përballen me probleme të shumta, por ajo më shqetësuese është përgatitja joadekuate dhe joprofesionale e stafit edukativ, në të shumtën e rasteve, si dhe mosshpërndarja e dokumentacioneve dhe materialeve pedagogjike të hartuara nga institucionet përkatëse që do të ndihmonin punën më të suksesshme edukative.

Pyetja është: Kur do ta parashihni mbajtjen e trajnimeve të stafit profesional të çerdheve dhe a do t'u shpërndahen këto dokumente pedagogjike atyre? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, deputet Çoçaj!

Lidhur me trajnimin e pjesës së edukatorëve që ka të bëjë me pjesën parashkollore, në këtë vit parashihen të trajnohen rreth 100 edukatorë që punojnë me fëmijë në mosha zero deri në trevjeçar, sipas programit të ri të aftësimin.

Afati kur do të mbahet trajnimi është paraparë të jetë prill-nëntor të këtij viti.

Po ashtu, për edukatorët që punojnë me fëmijë të moshave tre deri në pesë vjet do të vazhdojë trajnimi për zbatimin e kompetencave edukative, pra trajnim i cili është i planifikuar të mbahet gjatë muajve korrik-gusht të këtij viti.

Trajnimet e tjera për zbatimin e kurrikulës bërthamë për parashkollorët, ku përfshihen edukatorët, janë të paraparë të bëhen në shtatë institucione parashkollore.

Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimit ka filluar, tani një numër i tyre edhe ka qenë pjesë e organizimit të trajnimit nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe nga donatorët e ndryshëm, të cilët na kanë përkrahur në këtë drejtim.

Tani jemi edhe në procesin e trajnimit me kurrikulën e re për nivelin parafillor të moshës pesë deri në gjashtë vjet, të organizuar në bashkëpunim me Divizionin për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve të MASHT-it.

Ndërsa moshat tre deri në pesë vjet zhvillojnë programet e tyre për kurrikulat e vjetra, me standarde të zhvillimit të fëmijëve të hershëm.

Sa i përket dokumentacionit pedagogjik, institucionet private të licencuara nga MASHT-i posedojnë këtë material, ata varësisht nga grupi i moshave, ku grup moshat pesë deri në gjashtë vjet posedon dokumentacionin e ri bazuar në kurrikulën e re.

Nuk qëndron vlerësimi si institucionet parashkollore, pra në sektorin privat, personeli i tyre është i pakualifikuar, nga ajo të cilën janë të licencuara nga MASHT-i. Në dokumentacionin përkatës, i cili dorëzohet nga secili institucion që bën një kërkesë për licencim, është i përfshirë edhe dokumentacioni që tregon se edukatorët e kanë përgatitjen, e cila është e kërkuar sipas kërkesave legislative.

Ne jemi të vetëdijshëm që mund të ketë lëvizje të stafit të edukatorëve nga një çerdhe në çerdhen tjetër dhe kjo mund të ketë lëvizje të përkohshme, por sipas procedurave asnjë institucioni parashkollor nuk i lëshohet licenca nëse nuk i plotëson kushtet sipas përgatitjeve të edukatorëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Nga praktika dhe nga vizitat që kemi bërë në shumë çerdhe, besoj se të gjithë tash e dinë se 4,5% janë përfshirë në institucionet publike në edukimin parashkollor, ndërsa totali është rreth 70% në institucionet private, parashkollore. Unë po them për ato çerdhe, ju kuptoj juve, të licencuara a të palicencuara, po fëmijët po vazhdojnë të shkojnë në ato institucione, të licencuara a të palicencuara. Unë kam hallin për çerdhet e palicencuara që s'kanë përgatitje, i kam vizituar vetë dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës ka bërë hulumtime lidhur me këto, çfarë përgatitjesh kanë dhe sa për qind janë të kualifikuar prej drejtorit deri te stafi pedagogjik.

Po ju kisha lutur që nëse nuk janë të licencuara, të ndalohen, apo të trajnohen, të përgatiten, nëse s'kanë edhe përgatitje profesionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Deputet i nderuar,

Çdo institucion parashkollor, i cili nuk është i licencuar, ministria ka për obligim përmes Inspektoratit këto institucione t'i mbyllë në rast se nuk i plotësojnë kushtet. Normalisht, në momentin kur Inspektorati has këtë gjendje të rëndë, ne marrim masa për ta mbyllur këtë institucion.

Mund të jenë disa institucione private, të cilët mund të jenë në procedurë të licencimit, por ajo çka ne kërkojmë edhe nga prindërit dhe çdokush, secili kërkon që të jemi më të përgjegjshëm. Ne të gjitha institucionet parashkollore, të cilat janë të licencuara i kemi të publikuara në ueb faqen e ministrisë dhe u kisha kërkuar edhe prindërve që në momentin kur i dërgojnë fëmijët e tyre në këto institucione, ta shikojnë se vërtet a janë të licencuara apo jo.

Ne vazhdimisht, me buxhetin e kufizuar bëjmë përpjekje të bëjmë trajnime të edukatorëve, por në asnjë mënyrë jo institucionet që nuk janë të licencuara. Pra, kushti i parë është që këto institucione duhet të licencohen dhe tutje pastaj të kërkojmë trajnime shtesë për edukatorët, pra po flasim edhe për sektorin publik, por edhe për sektorin privat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Zonja Albulena Haxhiu ka pyetje për ministrin Abelard Tahiri.



ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Në dhjetor të vitit të kaluar disa nga anëtarët e Komisionit për Legjislacion kanë realizuar një vizitë në Qendrën Korrektuese në Dubravë, por po ashtu edhe në Lipjan kemi qenë si Komision për Legjislacion, disa nga anëtarët e komisionit. Aty jemi përballur me shumë kërkesa të të burgosurve, por unë do t'i veçoj vetëm tri nga kërkesat e tyre që kanë të bëjnë me ndryshimet e fundit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Pra, janë tri çështje: e para ka të bëjë me pakon e ushqimit. Pra, me ndryshimet e fundit atyre nuk u lejohet të kenë pako të ushqimit nga familjarët, por po ashtu kjo ka ndodhur për shkak, siç është thënë, të kontrabandës. Po ashtu, ditët e vikendit nga 21 ditë në vit sa i kanë pasur, tani i kanë vetëm 7 ditë në vit, po ashtu 25%-shi i dënimit, domethënë fillimisht ka qenë kompetencë e drejtorit, pastaj me ndryshimet e fundit i ka kaluar gjykatës. Këto janë tri nga shqetësimet e tyre dhe sigurisht e kam marrë përsipër që t'i ngre në formë të pyetjeve parlamentare lidhur me atë që a jeni në dijeni për këto kërkesa, për këto shqetësime dhe po ashtu, cilat janë veprimet e Ministrisë së Drejtësisë në këtë drejtim?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: E nderuar deputete,

Ju falënderoj për kujdesin që po tregoni për personat e privuar nga liria. Në këtë drejtim çështjen e ngritur nga ju tashmë ka kohë që e kam adresuar. Aktualisht jam duke zhvilluar procesin e rishikimit të legjislacionit për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe njëra nga aspektet kryesore që do të jetë objekt i rishikimit është pakoja e ushqimit, zvogëlimi i ditëve të vikendit, si dhe çështja e lirit të parakohshëm për personat që janë në vuajtje të dënimit.

Kam themeluar grupin punues për adresim të këtyre shqetësimeve dhe aspekteve të tjera, të cilat i kam pranuar dhe personalisht gjatë vizitave të shumta që kam realizuar gjatë këtyre pesë muajve në qendrat korrektuese të Republikës së Kosovës. Në këto ndryshime, propozimi im që do t'ju vijë shumë shpejt përpara do të jetë rikthimi i ditëve të pushimit ashtu siç i kanë pasur, 21 ditë domethënë nga 14 siç i kanë me ligjin aktual dhe unë do të propozoj të rikthehen 21 ditë qysh i kanë pasur me ligjin e vjetër. Do të jetë në dorën tuaj nëse do më përkrahni apo jo, mirëpo ky propozim do t'ju vjen. Sa u përket pakove ushqimore, shteti i Kosovës, Republika e Kosovës e ka obligim t'u sigurojë kushte të mira të gjithë të burgosurve, pa pasur nevojë të kenë përkrahje nga jashtë për pako ushqimore dhe në këtë rast e kam rritur edhe buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë për këtë vit dhe konsideroj që nuk do të ketë nevojë të sjellin pako ushqimore nga jashtë, qofshin nga familjarët, qoftë nga kushdo tjetër. S'ka dyshim që kjo është edhe një prej arsyeve pse e kemi bërë për shkak të eliminimit të futjeve të shumë gjërave ilegale brenda Shërbimit Korrektues të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja deputete?

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Në pyetjet tona se a është ndalur kontrabanda pas ndryshimit të këtyre neneve, përgjigja ka qenë jo. Domethënë nuk është ndalur, madje është rritur në të shumtën e rasteve, pra po del që pavarësisht që ne ua kemi hequr këtë të drejtë atyre, nuk është ndalur kontrabanda dhe si zgjidhje ata e parashihnin blerjen e një skaneri, për të cilin thoshin që nuk kushton shumë dhe është më i efektshëm për ta ndalur kontrabandën.

Po ashtu, sa u përket ushtruesve të detyrës, sidomos në Qendrën e Dubravës, numër i madh i të punësuarve janë ushtrues detyre. Dhe, po ashtu ka nepotizëm të madh, sidomos në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Unë kam kërkuar nga zoti Ylber Topalli, në Ministrinë e Drejtësisë, për të na pajisur me një raport në lidhje me punësimin...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Dua të ndërlidhem te pozita që janë ushtrues detyre. Në momentin kur e kam marrë udhëheqjen e Ministrisë së Drejtësisë në kuadër të Shërbimit Korrektues i kam gjetur gjithsej 89 pozita, të cilët janë me ushtrues detyre dhe pa dyshim që kjo ndikon edhe në efektivitetin e punës së Shërbimit Korrektues të Kosovës. Sa u përket skanerëve, Ministria e Drejtësisë dy vjetët e fundit është përballur me mungesë të buxhetit për t'u pajisur me mjete të sigurisë, domethënë në këtë rast, në qendrat korrektuese.

Thashë edhe në përgjigjen e mëparshme që e kemi rritur buxhetin dhe do të pajisen me të gjitha pajisjet shtesë që kanë nevojë qendrat korrektuese. Sa i përket kontrabandës, unë ju siguroj që në tri kontrollet e fundit, pasi kam kërkuar të shpeshtohet kontrolli nga Policia e Republikës së Kosovës në qendrat korrektuese, unë ju siguroj që policia nuk ka arritur të gjejë asgjë të paligjshme në qendrat korrektuese të Kosovës. Gjë që kjo është një sukses që edhe Shërbimi Korrektues i Kosovës po e kryen punën me efektivitet të madh. Ndërsa, sa i përket numrit të oficerëve korrektues është po ashtu një problem që është ballafaquar Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe tash me përkrahjen e Ministrisë së Financave, Shërbimit Korrektues të Kosovës për vitin 2018 do t'i shtohen edhe 120 oficerë korrektues shtesë, që është një numër i konsiderueshëm që do të ndikojë po ashtu në efektivitetin e punës së Shërbimit Korrektues të Kosovës. S'e di a harrova ndonjë çështje tjetër të përmend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Arbër Rexhaj, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

ARBËR REXHAJ: Meqenëse u kam premtuar ish-punëtorëve të KEDS-it, të cilët kanë pritur që t'u vijë radha prej seancës tjetër, më duhet ta bëj këtë pyetje dhe të pres përgjigjen e kryeministrit për shkak të përgjegjësisë që ka.

Dhe, pyetja ka të bëjë me 93 ish-punëtorë të KEDS-it, të cilët kanë pasur kontrata të përhershme dhe atyre u është ndërprerë kontrata e punës pa asnjë lloj shpjegimi në vitin 2016. Punëtorët e larguar të KEDS-it kanë ngritur rastin në gjykatë, Inspektorati i Punës, me vendim ekzekutiv ka dhënë vendim për kthimin e tyre në punë. Dhe, ajo çka neve na intereson është se çka do të bëhet me fatin e këtyre punëtorëve dhe në këtë rast kryeministri ka pritur këta 93 punëtorë në zyrën e tij, u ka premtuar që do të angazhohet së paku ta shtyjë çështjen e tyre përpara, sepse e drejta është në anën e punëtorëve.

Këto korporata, edhe pse janë privatizuar, nuk duhet t'i mundojnë punëtorët qoftë me punë të ndryshme, sidomos me këtë çështjen e largimit, prandaj unë përgjigjen e pres në seancën e ardhshme.

KRYESUESI: Faleminderit, por kjo është çështje ligjore, nuk ka të bëjë Ramushi me këtë punë. Por, sidoqoftë e keni edhe një pyetje për ministrin Valdrin Lluka, Arbër.

ARBËR REXHAJ: Unë po e përmend për ministrin çështjen, është fjala për rezervarin "Kalaja", i cili është ndërtuar në vitin 1945, përgjatë kalasë, një trashëgimi historike. Të dy komorat e rezervarëve janë të lidhura për shkak të kapacitetit shumë të vogël të akumulimit prej 480 metra kub, rezervuari përdoret vetëm si strukturë për balancimin e rrjedhjes. Deri te rezervuari mund të arrihet vetëm në këmbë, gjë që ka vështirësuar rehabilitimin në vitin 2004. Në vitin 2004 janë zëvendësuar pajisjet përbrenda komorës së valvulës. Gjatë këtyre punëve është dëmtuar kontrolli i nivelit dhe uji ka hyrë në komoren e valvulës, gypat për kapërderdhje, derdhja e ujit të tepërt, nuk mund të funksionojnë pasi që gypi për kapërderdhje në komoren e djathtë është më e lartë se muri i rezervuarit dhe të dy komorat janë të lidhurat në mënyrë hidraulike.

Zëvendësimi i pajisjeve është bërë në mënyrë joprofesionale, nuk janë gjetur as vizatime, e as skica për zëvendësimet, ndërrimet. Nuk janë instaluar gypat për ajrosje në pjesën e poshtme të valvulës hyrëse të vijës së gravitetit. Gypi kryesor që shkon lart nga stacioni i pompimit ka nevojë për një valvulë ajri me funksion të dyfishtë në pjesën e poshtme të valvulës hyrëse. Duket se rezervuari nuk e lëshon ujin. Rezervuari është tërësisht i mbuluar me dhe, por nuk është i rrethuar dhe, në fakt vizitorët e Kalasë i tërheq struktura, rekomandohet përreth rezervuarit të rrethohet një truall prej 400 metra katror. Zoti Lluka, a mund të na tregoni se a jeni në dijeni për këtë çështje dhe kur do të intervenoni për rregullimin e këtij problemi?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Lluka, e keni fjalën.

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputeti Rexhaj,

Unë mora informatën, faktikisht s'kam qenë në dijeni dhe në ministri u interesova nuk kishte informata dhe në fund u informova që kjo qenka obligim i kompanisë së ujësjellësit të regjionit jugor, së bashku me Komunën dhe Ministrinë e Kulturës, si investim. Pra, nuk është që ne si Ministri e Zhvillimit Ekonomik kemi pasur ndonjë ndikim apo kemi ndonjë ndikim në atë projekt, por sidoqoftë për ta shikuar më thellë problemin, ditët në vijim do të interesohem dhe do të komunikoj me kohë ta shikojmë se si mund ta rregullojmë këtë problem. Kjo është çështja, dhe kjo është problemi faktikisht përgjigjen që mund ta marrësh nga ministria. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë? Po!

ARBËR REXHAJ: Ministri i Zhvillimit Ekonomik i dërgon tre përfaqësues atje, pra bordin që përmenda ministër, ndërsa është ministri i Kulturës këtu dhe është nga qyteti i Prizrenit dhe besoj që ka informacione të bollshme që të na tregojë ky.

KRYESUESI: Konsideroj që koha për pyetje të deputetëve drejtuar ministrave është shterur, ftoj deputetët që janë jashtë të futen në sallë për të vazhduar seancën.

Para se të fillojmë seancën e rregullt, dua t'ju njoftoj se kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, me shkrim ka kërkuar që pika e dhjetë e rendit të ditës, debat parlamentar sipas kërkesës së nënkryetarit të Kuvendit, zotit Kujtim Shala dhe gjashtë deputetëve nënshkrues lidhur me raportin e 100 ditëve të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës të shtyhet për seancën e radhës, me arsyetimin se gjendet në vizitë zyrtare në SHBA.

Do të ishte mirë deklarimi i zotit Shala lidhur me këtë çështje dhe pastaj të shohim se si po veprojmë.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Jo vetëm pikën e dhjetë të rendit të ditës, por unë propozoj që edhe pika e nëntë, meqë është një interpelancë me kryeministrin e Republikës së Kosovës, të shtyhen, por të keni parasysh që sipas Rregullores duhet të mbeten si pika të hapura, sepse s'mund të kalojnë në një seancë tjetër. I bie që ne të vazhdojmë të kalojmë në pikat që janë para dhe prapa këtyre dy pikave dhe pastaj Kryesia të vendosë një datë tjetër për vazhdimin e kësaj seance, e që lidhet vetëm me këto dy pika. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besoj që edhe kjo është në rregull. Atëherë, e lëmë për seancën e radhës kur të vijë edhe kryeministri. E vazhdojmë seancën, se s'kemi pse mban mbledhje Kryesia, kryetari e thërret vazhdimin e seancës.

Atëherë, në sallë janë 55 deputetë, nuk e di a ka deputetë në bufë a s'ka? Domethënë, s'kemi kuorum as për t'i miratuar procesverbalet dhe as për të vazhduar me pikat e tjera të rendit të ditës.

Atëherë, kemi kuorum të mjaftueshëm, zoti Hoti e ka kërkuar fjalën për një mocion.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Te pika e deklarimeve jashtë rendit të ditës, deputetja Bunjaku e ngriti çështjen e vendimit joligjor të ministrit të Arsimit për shkarkimin e Bordit të Këshillit të Cilësisë. Mendoj që çështja është e qartë këtu, se është shkelur neni 7, paragrafi 5 i Ligjit për arsimin e lartë, i cili përcakton që nëse më shumë se 1/3 e anëtarëve të Bordit zëvendësohet për çfarëdo arsye brenda një viti, ministria duhet t'i raportojë Kuvendit. Kjo gjë nuk ka ndodhur, prandaj ne nuk mund të procedojmë me pikën 12 të rendit të ditës, për të zgjedhur Bordin e këtij këshilli përpara se ministri të raportojë në Kuvend për arsyet e shkarkimit.

Prandaj, ne kërkojmë që pika 12 të hiqet nga rendi i ditës i seancës së sotme. Faleminderit!

KRYESUESI: A dëshirojnë shefat e grupeve që të deklarohen, apo të futemi në votim drejt? E nxjerrim në votim mocionin e zotit Hoti. Në sallë janë 63 deputetë. A po votojmë me dorë apo me kartelë? Ok, me kartelë po kërkojnë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim lidhur me mocionin e ushtruar, votojmë tash.

Po e përsëris edhe një herë, kanë votuar vetëm 53 deputetë. E përsëris votimin edhe një herë lidhur me mocionin e paraqitur nga zoti Hoti në emër të grupit parlamentar. Votojmë tash!

Atëherë, nuk miratohet, sepse s'po votojnë deputetët, unë s'po kuptoj pse. Mendoj që është mirë ta votoni për ose kundër, tash kush qysh voton më mirë të mos flas. Atëherë, sa u përket pikave që u shtruan nga zoti Shala ne vendosëm të shtyhen për seancën e radhës ose kur të piqen kushtet për të vazhduar seancën, mbesin si vazhdim për seancat e ardhshme.

### **3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme**

Pyes nëse keni vërejtje në procesverbalet e seancave të Kuvendit të mbajtura më 14 dhjetor 2017 e 25 janar 2018, më 25 e 26 janar 2018 dhe më 31 janar e 1 shkurt 2018. A ka dikush vërejtje? Nuk ka! Atëherë, në sallë janë 65 deputetë.

Konstatoj që Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave të Kuvendit të mbajtura më 14 dhjetor 2017 e 25 janar 2018, më 25 e 26 janar 2018 dhe më 31 janar e 1 shkurt 2018.

### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të huajt**

Komisioni FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcave të Sigurisë së Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Ftoj

ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Sefaj, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Sefaj, e keni fjalën.

MINISTRI FLAMUR SEFAJ: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Më lejoni të prezantoj para jush Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/l-219 për të huajt, i sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të huajt është hartuar duke u bazuar në Programin Legjislativ të Qeverisë së Kosovës për vitin 2017, në pajtim me Kushtetutën dhe me legjislacionin përkatës në fuqi të Republikës së Kosovës. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të huajt rregullon kushtet dhe procedurat e hyrjes, qëndrimit dhe largimit të të huajve nga territori i Republikës së Kosovës, shpalljen e të huajve persona të padëshirueshëm, si dhe dërgimin e atashëve për migrim jashtë Republikës së Kosovës.

Po ashtu, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të huajt është paraparë në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-s. Gjatë hartimit të këtij projektligji janë transpozuar tri direktiva dhe një kod i BE-së, të cilat kanë të bëjnë me fushën e migrimit, e që janë si në vijim:

- Direktiva 2014/66/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në suaza të transfereve brenda korporatave,

- Direktiva 2014/36/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim të punësimit si punëtorë sezonalë,

- Direktiva 2016/801 BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim hulumtimi, studimi, trajnimi, shërbimi vullnetar, skema të shkëmbimit të nxënësve apo projekte arsimore si dhe ai i paringut.

Po ashtu:

- Rregulloren nr. 610/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit që ndryshon Rregulloren nr. 562/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit që nxjerr Kodin e Bashkësisë mbi rregullat mbi të cilat rregullohet lëvizja e personave përtej kufijve (Kodi i Kufijve të Shengenit), Konventa mbi zbatimin e Marrëveshjes së Shengenit, Rregulloret e Këshillit, nr. 1683/95 dhe nr. 539/2001 dhe Rregulloret nr. 767/2008 dhe nr. 810/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

Për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat përkatëse, siç janë: Opinioni për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor nga Ministria e Financave dhe Opinioni Ligjor i Përputhshmërisë me Legjislacionin e BE-së nga Ministria e Integritimit Evropian.

Të nderuar, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij projektligji, nevojën e avancimit të kuadrit ligjor, si dhe duke pasur parasysh prioritetet të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me zbatimin e MSA-s, kërkoj nga ju miratimin në parim të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, zoti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje për Kabinetin qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 26. 01.2018 shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të huajt dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë rekomandim që të miratohet projektligji në fjalë në parim.

Ky ligj i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret që të shkojë në lexim të parë dhe është në pakon e ligjeve, të cilat hyjnë si obligim i shtetit tonë në programin kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe besoj që me punën që do të bëjë komisioni, do të përmbushë të gjitha ato parametra me inkorporimin e rregulloreve të propozuara për t'u inkorporuar rregulloret e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian.

Në qoftë se më lejoni, kisha vazhduar edhe për grupin parlamentar.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, cili e keni fjalën? Zoti Selimi!

REXHEP SELIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Lëvizja “Vetëvendosje” e ka shqyrtuar këtë projektligj, ashtu siç kemi dhënë kontributin tonë edhe në shqyrtim në komisionin parlamentar, dihet që ky projektligj për plotësim dhe ndryshim respekton dhe i nënshtrohet disa direktivave të Bashkimit Evropian dhe për këtë ne kemi dhënë vlerësimet tona. Lëvizja “Vetëvendosje” do ta votojë në parim dhe kontributin tonë do ta japim në komision. Normalisht që ka shumëçka të amendamentohet dhe të vlerësohen parametra të caktuar të këtij projektligji, por kontributin tonë do ta japim gjatë punës së grupit punues, i cili tashmë është i formuar në Komisionin për Siguri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Unë dua të kthehem prapë te mocioni, të ciline ne e shtruam në këtë seancë. Deputetët janë në sallë, sepse ju e deklaruat që ka kuorum prej 64 deputetëve, po duket se disa deputetë nuk po marrin pjesë në votim, ne nuk interferojmë në mënyrën se si votojnë ata për ose kundër, ose abstenojnë, është çështje e tyre, por ata duhet të marrin pjesë në votim, përndryshe nuk ka kuptim të vazhdojë më tutje seanca dhe unë ju garantoj që grupi ynë parlamentar nuk do ta votojë asnjë ligj nëse fillon kjo lojë të bëhet nga shumica parlamentare. Pra, grupi ynë nuk e voton asnjë ligj në seancën e sotme nëse nuk kthehet në votim dhe nuk votojnë deputetët për, kundër ose abstenojnë në mocionin që sapo ne e prezantuam përpara juve.

KRYESUESI: Zoti Hoti, unë sa herë kërkon që ta fusni në votim, unë e fus, kjo është detyra ime. Në qoftë se s'ka kuorum, unë nuk e fus as në diskutim, sepse e kemi mocionin, kjo është mundësia ime si kryesues i seancës. Kurdo që të vijë radha e pikës në fjalë, ajo e ka një mocion që do të thotë duhet të votojnë 61 deputetë të paktën për ose kundër, kaq mund të ta mundësoj, më shumë s'kam çka bëj. Zoti Hoti, edhe një herë fjalën.

AVDULLAH HOTI: Zoti kryesues, ne ishim në pikën e diskutimit të rendit të ditës dhe ne e propozuam një mocion për rendin e ditës. Seanca nuk mund të vazhdojë më tutje pa u aprovuar ose pa u hedhur poshtë ai mocion.

KRYESUESI: Jo, seanca mund të vazhdojë, sepse ka pika të tjera të rendit të ditës. Po them, ajo pikë është e padiskutueshme përderisa është mocioni dhe përderisa nuk votojnë 61 deputetë, kjo është në rregull, mendoj.

Nuk ju prish kurrgjë punë, as juve si grup parlamentar besoj, as Parlamentit dhe as çështjes për të cilën e keni ngritur.

Po, zoti Shala, e keni fjalën!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Sipas Rregullores, kur ke një çështje të hapur për të cilën duhet të vendoset me votë, nuk mund të kalosh te një çështje tjetër, do të thotë duhet të zgjidhet për ose kundër çështja e mocionit që të vazhdoni me pikën tjetër të rendit të ditës. Faleminderit!

KRYESUESI: A ka mundësi të di ku shkruan, cila rregullore?

KUJTIM SHALA: Lexojeni Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të cilës do të duhej ta drejtonit seancën.



KRYESUESI: Ne kemi shqyrtuar edhe ligje që na kanë mbetur kështu të pavotuara, edhe këtë, në qoftë se doni të diskutoni dhe të debatoni lidhur me pikën, mund të debatojmë, por çështja e votimit nuk e ndal punën e Kuvendit. Ne vazhdojmë me pikën tjetër, kur të bëhen 61 vetë për të votuar, ajo është çështje e hapur dhe votojmë.

Vazhdojmë, fjalën e ka zoti Xhelili në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

KRYESUESI: Prit se Kujtimi e ka edhe një herë fjalën. Unë s'e kam ndërmend ta ndal seancën, Kujtim.

KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Ju e vendosni atë, por këto që po thoni ju dhe praktikës të cilës po i referoheni ju është në kundërshtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

KRYESUESI: Zoti Xhelili, e keni fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Projektligjin për të huajt dhe do ta japë kontributin e vet në grupet në komisione për ligjin, i cili i rregullon kushtet dhe procedurat për të huajt, qëndrimin dhe mënyrën e llogaritjes së qëndrimit në shtetin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharrem Nitaj, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë,

Po pres që të vendoset njëfarë lloj qetësie në sallë, zoti kryesues i Kuvendit, po presim kolegët e Lidhjes Demokratike të Kosovës deri sa ta bojkotojnë përfundimisht seancën e sotme.

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të huajt dhe e mbështet në parim.

Sigurisht që Grupi Parlamentar i AAK-së do ta japë kontributin e vet në komisionin që e trajton këtë çështje, mirëpo sot e mbështetim në parim në leximin e parë të tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar "6+", Bahrim Shabani e ka fjalën.

BAHRIM ŠABANI: Zahvaljujem se potpredsedniçe!

I mi kao Parlamentarna grupa "6+" razmatrali smo Nacrt-zakona o strancima. Uzimajući u obzir važnost ovog zakona, Parlamentarna grupa "6+" u načelu će podržati ovaj zakon. Svakako da ćemo svoj doprinos dati kroz rad komisije. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka, në emër të grupit? Zoti Zeka, në emër të Grupit Parlamentar "Nisma".

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar! Po të them kryetar, se ti po na i drejton seancat kështu... më shpesh. Faleminderit!

Edhe ne si grup i "Nismës" e mbështetim këtë projektligj, por dëshiroj të them si deputet që lëshimi i sallës nga deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e tregon një papërgjegjësi totale ndaj qytetarëve të Kosovës. Ne ashtu-kështu si Parlament jemi shumë të vonuar në miratimin e shumë ligjeve. Kemi njëqind tema dhe po shihet që një pjesë e njerëzve këtu vijnë për të bërë vetëm shou mediatik. Edhe ndoshta, Lidhjes Demokratike i është mbushur mendja kështu që do të shkojmë në zgjedhje goxha shpejt, por s'ma merr mendja kështu se "Vetëvendosja" nuk është dakord për të shkuar në zgjedhje të parakohshme, kështu që do të vazhdojmë kështu minimum edhe nja një vit, në bazë të konsultave që i kam pasur me "Vetëvendosjen", me Bacën Adem dhe me Sami Kurteshin.

Por, sidoqoftë kryetar, këta seriozisht janë bërë nëna e cirkut, LDK-ja, edhe vetë interpelancat që i thërrasin këtu janë cirk më vete, janë hajgare. Kanë thirrur interpelancë për 100-ditëshin e Qeverisë, e ne sa ditë i kemi bërë, zoti Krasniqi, s'e di se është problem për t'i numëruar, por i kemi bërë 120 ditë, a po? Eh, tani këto interpelanca dhe pyetjet, jo thotë "ne nuk e dimë pse ministri i Arsimit e ka shkarkuar Bordin", e pas dy minutash thotë "e dimë". Njëherë thotë "s'e dimë", pastaj thotë "e dimë". E deputetja e LDK-së, edhe ajo është cirkus, kështu që është mirë që qytetarët e Kosovës po na shohin nëpërmjet kamerave televizive dhe inshalla u kthjelllet truri dhe në zgjedhjet e ardhshme nuk e votojnë lloj-lloj njeriu që të vijë e të bëjë hajgare me qytetarë "jo, pse s'e votuat ju, ne po e lëshojmë sallën". Lëshimi i sallës është injorim dhe poshtërim i çdo qytetari të Kosovës, sepse nuk kemi ardhur këtu... në këtë javë s'kemi pasur seancë, sot e enjte, sot kemi seancë, sot po e lëshojmë sallën. Nuk e di... unë me të vërtetë jam shumë i shokuar, kryetar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Këtu u ngreh...

KRYESUESI: Glauk... A po do Sami? Samiu e ka kërkuar për replikë.

SAMI KURTESHI: Unë e dëgjova kolegun Zeka. Mund ta marr me mend se në ëndërr ka folur edhe me mua, edhe me Adem Mikullovcin për atë çështje, por në realitet s'kemi folur asnjëherë. Vetëm këtë desha ta sqaroj, s'kam tjetër. Për pjesën tjetër, ai e mban vetë përgjegjësinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Milaim, hajde kundër-replikë ke të drejtë.

MILAIM ZEKA: Jo, shumë mirë e tha zoti Kurteshi, tha ëndërr, po ne këtu gjysma për ëndërra këtu jemi kah flasim në Parlament. Është e vërtetë Sami, ëndërr kam folur me ty. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Konjufca, urdhëro!

GLAUK KONJUFCA: Është mirë që disa deputetë, sidomos ata që kanë probleme me ligjin, edhe me disa krime shumë të ndërlikuara, të shikojnë pak ku i kanë punët personalisht për vete, se "Vetëvendosja" është duke u munduar t'i zgjidhë problemet e saj përbrenda dhe vetë.

Sa i përket këtij mocioni, të cilin e paraqiti Lidhja Demokratike e Kosovës, po flitet për një çështje, në të cilën...

KRYESUESI: Për ligjin jemi duke folur, kemi hyrë në tjetër çështje. Mos na kthe tash te mocioni.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë, më fal, kërko falje që të tjerëve ua lejove të flasin për mocionin. Më fal!

KRYESUESI: Në emër të grupit parlamentar e keqpërdore. Çka mund të bëj unë? Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Të nderuar deputetë,

Të nderuara deputete,

Nuk ka dyshim që Kosova është një vend me një migracion të theksuar, edhe pse nuk kemi të dhëna të sakta, afërsisht 800 000 shqiptarë të Kosovës jetojnë jashtë vendit, kryesisht në vendet e Bashkimit Evropian dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Këtu dhe në këtë sallë të Kuvendit janë një mori deputetësh që kanë jetuar jashtë vendit apo jetojnë akoma, e deri te ministrat, përfshirë këtu edhe kryeministrin. Ata që pak a shumë kanë qenë në rrjedhë të politikave për migracion të këtyre vendeve, apo që kanë qenë të goditur personalisht, pra drejtpërdrejt, me ligjet e ashpra të këtyre vendeve, mund ta kuptojnë nëse nuk kanë harruar se çfarë do të thotë të konfrontohesh me ligjet e tilla, që e vështirësojnë qëndrimin

në një vend, marrjen e lejes së punës, bashkimin familjar, lejen e qëndrimit, revokimin e lejes së qëndrimit, nganjëherë edhe për arsye krejt banale.

Sikur nenet e propozuara për ndryshimin e Ligjit për të huaj të aplikoheshin në formën që ne e kemi para nesh, shumë shtetas të Republikës së Kosovës sot nuk do të kishin leje qëndrimi në Gjermani, Zvicër apo Francë. Shumë prej tyre do ta kishin të pamundur realizimin e qëndrimit të pakufizuar, e të tjerë do të detyroheshin të pritnin gjatë për të arritur bashkimin familjar, e shumë të tjerë do të dëboheshin nga vendi për shkak të shkeljeve të vogla ligjore, apo për shkak të rrezikimit të marrëdhënieve të shteteve mikpritëse me Serbinë dhe Maqedoninë.

Kosova nuk është vend, i cili konfrontohet me një migracion të madh, as në fushën e punësimit dhe as në fushën e strehimit politik. Nuk e di pse duhet ta kemi një ligj kaq të ashpër karshi të huajve, aq më shumë kur nuk gjen familje në Kosovë, të cilat nuk kanë pjesëtarë që jetojnë jashtë vendit. Thjesht, më vjen turp që Republika e Kosovës, republika që ka kaq shumë shtetas jashtë vendit e ndjek një politikë kaq diskriminuese karshi të huajve, edhe pse numri i tyre është jashtëzakonisht i vogël dhe nuk paraqet ndonjë rrezik, si në fushën e punësimit, strehimit politik, por edhe atë të sigurisë.

Jam i vetëdijshëm që ka kërkesa për harmonizimin e Ligjit për të huaj me ligjet e Bashkimit Evropian, por njëkohësisht duhet të them se ka mjaft hapësirë për një politikë më liberale, e cila nuk e vështirëson pa arsye këtu jetën në Kosovë të atyre që dëshirojnë të jetojnë këtu. Edhe në Bashkimin Evropian politikat e migracionit ndryshojnë nga shteti në shtet. Pavarësisht që ka parime të përgjithshme, shtetet e ndryshme gjithmonë kanë qenë më liberale, të tjerat më pak liberale, apo restriktive, sa i përket politikës së migracionit.

Para pak më shumë se një viti, shkrimtarja e njohur zvicerane Elizabeta Kesli është detyruar të largohet nga Kosova, pikërisht për shkak të ligjit ekzistues, i cili nuk ia mundësoi të qëndrojë në Kosovë një pensionisteje, për të cilën u konsiderua se nuk i plotëson kushtet sipas ligjit të Kosovës për të jetuar këtu, edhe atë një shtetase e Zvicrës, në vendin e të cilës jetojnë më shumë se 200 000 qytetarë e qytetare nga Kosova. Pse u largua zonja Kesli? Pikërisht për shkak të këtij ligji, u largua pikërisht për shkak të politikave restriktive që ndjek Qeveria e Kosovës karshi të huajve.

A nuk i kemi provuar edhe vetë këto politika restriktive të vendeve të tjera karshi qytetarëve të Kosovës? I kemi provuar, e kemi provuar sesa vështirë është për familjet që ndahen, sesa vështirë është kur ndahen fëmijët nga prindërit, kur ndahet burri nga gruaja për shkak të politikave të tilla.

A nuk është shkelje elementare e të drejtave të njeriut për t'i ndarë çiftet, për t'i ndarë prindërit nga fëmijët? Sipas nenit 66, propozimit për ndryshim, lejen e qëndrimit në Kosovë e humbin të

gjithë të huajt që jetojnë më shumë se 30 ditë pa arsye jashtë Kosovës. Nuk e di nëse jeni të vetëdijshëm edhe si deputetë, por edhe ju, zoti ministër, se nëse ky nen do të aplikohet sot në Gjermani, apo në Zvicër, shumë pensionistë invalidorë dhe, mbi të gjitha, shumë pensionistë të moshës, shtetas të Republikës së Kosovës, do ta humbnin lejen e qëndrimit në Zvicër dhe në Gjermani, por edhe në vende të tjera. Besoj se këtë nuk e dëshironi për qytetarët e Kosovës. Atëherë, pse e kërkon për shtetasit e huaj që jetojnë në Kosovë.

Neni 66a, personat e padëshiruar, pika 1.3, thotë: “Personi i padëshiruar është ai i cili përbën kërcënim për vendin, ose cenon marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me vendet e tjera”. Po të zbatohet një nen i tillë në Gjermani, shtet i Bashkimit Evropian, apo në Zvicër, shtet jashtë Bashkimit Evropian, të gjithë ata që mblodhën fonde për 3%-shin, fonde për “Vendlindja Thërret”, që organizuan vullnetarë për luftën e UÇK-së, e të tillë ka shumë, jashtëzakonisht shumë, do të duhej të shpallehin persona të padëshiruar, sepse rrezikonin prishjen e marrëdhënieve të Gjermanisë dhe Zvicrës me Republikën e Serbisë. Aq më keq kur nene të këtilla mund të keqpërdoren nga politika, meqë vendos ministria, pra ministri, siç ishte rasti i dëbimit të Bojken Abazit dhe Dejana Mihajlit në Republikën e Shqipërisë, dy aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje”, që u konsideruan si rrezik për vendin.

E çfarë do të duhej të bënte Republika e Shqipërisë për gjithë ata ushtarë të UÇK-së, që mobilizoheshin dhe vepronin nga Shqipëria për çlirimin e Kosovës. Sipas nenit 47, pika 6.3, i huaji që dëshiron të ketë leje qëndrimi në Kosovë duhet të ketë sigurim shëndetësor. Sipas këtij neni, sot asnjë i huaj nuk i plotëson kushtet për të qëndruar në Kosovë, sepse ne nuk kemi sigurim shëndetësor.

Ishin pra, disa prej shembujve që tregojnë sesa i ashpër është ky ligj dhe sa diskriminues ndaj të huajve. Unë si mërgimtar i dikurshëm, por edhe i tashëm, duke pasur parasysh pasojat e ligjit për të huaj, do të votoj kundër këtij ligji. Vota ime kundër është protestë karshi një politike diskriminuese dhe represive të Republikës së Kosovës karshi të huajve, që nuk paraqesin asnjë rrezik, vërtet asnjë rrezik për vendin tonë. Unë ju ftoj edhe juve si deputetë që së paku një herë të votoni të gjithë së bashku kundër këtij ligji për ta dhënë një sinjal dhe për të treguar një solidaritet me të huajt, duke pasur parasysh solidaritetin e madh që është treguar në vendet tjera për qytetarët e Kosovës.

E di që projektligji duhet të ndryshojë, e di që këto ndryshime do të bëhen gjatë mbledhjeve të komisionit. Jam edhe unë për atë që të ndryshohet dhe të miratohet një ligj i mirë, por megjithatë ju ftoj që ta jepni një sinjal, që të tregoni që i keni parasysh interesat e emigrantëve, duke pasur parasysh që një pjesë e juaja kanë qenë pikërisht emigrantë në këto vende, duke përfshirë edhe juve që jeni përpara, edhe juve që jeni mbrapa. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Saranda Bogujevci e ka fjalën.

SARANDA BOGUJEVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë e kam vetëm një propozim, ashtu siç edhe zoti Sami Kurteshi e ka propozuar herën e fundit, që Projektligji për azil të shkojë edhe nëpërmjet Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Peticione dhe Persona të Pagjetur, që edhe ky projektligj duhet të shkojë edhe nëpërmjet Komisionit për të Drejta të Njeriut. Kisha propozuar që edhe projektligjet tjera të ngjashme, që paraqiten në komisione të caktuara, të jenë edhe pjesë e Komisionit për të Drejtat e Njeriut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë përsëri po e marr fjalën, jo në këtë seancë, por lidhur me këtë çështje.

Zoti Topalli foli për një pjesë shumë të rëndësishme që përmban ligji dhe kjo është shumë e rëndësishme, sepse ka të bëjë me karakterin humanitar të një shoqërie. Megjithatë, ligjet bëhen për shtetin, por shteti është në shoqëri dhe kjo tendencë restriktive ndaj të huajit, dhe këtë mbiemër “i huaj” shumë prej nesh e kemi provuar. Ne e dimë çka do të thotë kjo, prandaj nuk i bën nder shoqërisë kosovare. Shoqëria kosovare, që të mos them gjysma, por një të tretën e banorëve e ka që jeton në Botën e Jashtme dhe, në fund të fundit, pa marrë parasysh statusin e tyre atje, konsiderohen të huaj. Kjo është e dhembshme, secili prej nesh, në ndonjë moment, jo të gjithë, e kemi provuar çka do të thotë “i huaj”. Logjika restriktive, po e them edhe një herë, nuk i bën nder shoqërisë kosovare.

Çështja tjetër, që në të vërtetë është ajo që e tha edhe zonja Bogujevci, unë po e vërej se Ligji për azilin, Ligji për të huaj, por edhe ligjet që kanë të bëjnë me njerëzit, me të drejtat dhe liritë e tyre, me rregullimin e statusit të njeriut në shtetin dhe shoqërinë kosovare, shihen vetëm nga prizmi i sigurisë. Por, kjo është vetëm njëra anë e medaljes. Njerëzit para se të jenë faktorë të sigurisë, ose të pasigurisë, janë njerëz që kanë të drejta dhe liri të garantuara, edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, edhe me të gjitha standardet ndërkombëtare të integruara në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Prandaj, kërkesa ime përsëri është: Të gjitha këto ligje që prekin të drejtat dhe liritë e njeriut, në cilëndo formë, të mos kalojnë në asnjë lexim pa iu dërguar Komisionit për të Drejtat e Njeriut, të Pagjeturit e kështu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Kërkesa për ta marrë fjalën është ngase më intriguan diskutimet e zotit Topalli dhe Kurteshi, faktikisht me gjithë respektin për qëllimin e mirë të diskutimeve të tyre, duke dashur të tregoj falënderimin për shtetet që kanë pritur qytetarët tanë në ato periudha të vështira, po del që ne jemi duke e aprovuar një ligj jo humanitar dhe një ligj që i cenon të drejtat dhe liritë e individëve, përkatësisht të të huajve. Është fjala për një nen të ligjit, i cili përshkruan faktikisht se për ata persona të cilët konsiderohet se mund të jenë të rrezikshëm dhe që paraqesin kërcënim për shtetin, normalisht është fjala për ata persona dhe ekipet tona e instrumentet e shtetit tonë kanë metoda dhe mënyra për ta bërë analizën dhe verifikimit të profileve të atyre personave.

Në qoftë se janë nisur të diskutojnë prej periudhës '98-'99, e rrethanat kanë ndryshuar në konceptin e sigurisë globale, se rreziqet tash me veprimet e individëve në shumë shtete faktikisht paraqet kërcënim dhe një person, e të mos flas për shumë persona. Kështu që ai nen është me vend dhe ai nen do të qëndrojë, pa e mohuar asnjëherë të drejtën e atyre individëve dhe personave që kanë nevojë për ta marrë lejen e qëndrimit në shtetin tonë, qoftë të përkohshëm, qoftë për punësim sezonal, qoftë për studime, qoftë për kërkime a hulumtime, apo edhe për bashkim familjar. Janë ligjet që bazohen edhe në direktivat e Komisionit Evropian dhe në rregulloret e Këshillit Evropian dhe këto ligje janë punuar me grupet punuese, në të cilët kanë participuar edhe ekspertët e EULEX-it, CITAP-it dhe të OSBE-së dhe asnjë prej ligjeve të aprovuara në këtë fushë-lëmi, qoftë Ligji për azil, qoftë Ligji për të huajt, qoftë Ligji për mbikëqyrjen dhe kontrollin e kufirit, nuk është përvjedhur asnjë nen që i cenon të drejtat dhe liritë e njeriut. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën. Replikë? Me kë? Mirë Faton, urdhëro!

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Po, është e kuptueshme që ka kërkesa në Bashkimin Evropian që kjo çështje të rregullohet dhe ne kemi nevojë për rregullimin e ligjit, megjithatë ka hapësirë të mjaftueshme që ky ligj të jetë më liberal. Dikush që kalon 30 ditë jashtë Kosovës pa arsye, pse nuk mund ta vazhdojë lejen e qëndrimit?

Unë ju thashë edhe një herë që po të respektohej ky ligj sot në cilindo vend të Bashkimit Evropian, ku ne kemi migracion, atëherë shumë qytetarë të Kosovës do të duhej të ktheheshin dhe të jetonin në Kosovë, për arsye se e kanë shkelur ligjin. Tjetra është te bashkimi familjar, ta zëmë. Pse duhet që dikush të presë dy vjet për ta marrë familjen, për t'u bashkuar me gruan apo fëmijët? Pse? A kemi ne një migracion jashtëzakonisht të madh? Nuk e kemi.

Ajo që thashë, në fund të fundit, është që ne kemi mjaft hapësirë që brenda kornizave të Bashkimit Evropian ta kemi një ligj për qytetarët e huaj që jetojnë në Kosovë, i cili është më liberal, i cili është më human. Prandaj edhe pres nga deputetët e Kosovës, pres edhe nga qytetarët

e Kosovës, edhe nga Qeveria, që në këtë pikëpamje të tregohen zemërgjerë, sepse pikërisht në vendet ku ata vetë kanë jetuar, ku e kemi një diasporë jashtëzakonisht të gjerë, kemi pasur ligje shumë liberale dhe pikërisht falë këtij liberalizmi në këto vende qytetarët tanë jetojnë edhe sot atje.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

E mora fjalën në emrin tim për të thënë, sepse në emër të grupit parlamentar qëndrimin e tha zoti Zeka, që duke pasur parasysh rëndësinë e fushës që mbulon ky ligj, ne duhet të gjithë së bashku, sidomos, siç thanë edhe kolegët, disa nga ne të cilët kemi jetuar jashtë, ndoshta ndiejmë apo bashkëndiejmë shumë më shumë me këtë kategori të njerëzve, të cilët kanë nevojë për të ardhur dhe për të jetuar në Kosovë.

Por, unë do ta kisha shtruar edhe një rrafsh tjetër. Natyrisht që ligji duhet të kalojë në lexim të parë, në emër të “Nismës”, e tha zoti Zeka, por ka nevojë për përmirësime. Ka nevojë për shtesa dhe ka nevojë që disa nga nenet të jenë pak më liberale, sidomos duke pasur parasysh faktin se ky ligj prek kryesisht shqiptarët nga Presheva, të cilët fatkeqësisht konsiderohen shtetas të huaj, qytetarë të huaj, nuk janë shtetas dhe qytetarë të Kosovës, prek ata nga Maqedonia, prek apo mund të prekë ata nga Shqipëria, të cilët janë shtetas dhe nuk kanë dyshtetësi, pra nuk prek shumë minoritete tjera apo komunitete tjera, të cilat kanë dyshtetësi me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Dyshtetësi nuk kanë shqiptarët e Luginës, pra të tri komunave shqiptare, të Maqedonisë dhe të Shqipërisë, me automatizëm nuk e kanë, dhe ata kanë nevojë që nëpërmjet këtyre procedurave të shndërrohen në banorë apo qytetarë, e më vonë ndoshta edhe shtetas të Republikës së Kosovës.

Pra, duke e pasur parasysh këtë fakt, se ky ligj do ta atakojë pikërisht këtë kategori të njerëzve, gjithsesi që janë disa nga nenet që duhet të jenë më liberale. Nuk po flas për kategorinë e delinkuentëve, që e sqaroi zoti Xhelili në emër të komisionit dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, por po flas për kategorinë, apo për pjesën e qytetarëve të ndershëm, të sinqertë, të cilët vijnë këtu për të jetuar, apo për ta ndërtuar një jetë në Kosovë.

Në Zvicër, si njëri nga vendet pak më të shtrënguara, për shembull, vetëm gjashtë muaj ke të drejtë të mungosh. Të gjithë e dimë që kush e ka pasur vizën B, gjashtë muaj ka pasur të drejtë të mungojë pa asnjë arsye dhe të kthehet në Zvicër, askush s’ka mundur t’i thotë “pse ke munguar”. Kush e ka pasur vizën C ka pasur të drejtë deri në 2 vjet. Pra, dua të them që duhet të kategorizohen, të marrim modele të shteteve sa më liberale, mund të marrim në Suedi, mund të marrim në Norvegji, sepse janë më liberale se disa vende, të cilat përballen shumë me migracion të madh.



Mendoj që të gjithë së bashku, edhe Komisioni për të Drejta të Njeriut, edhe Komisioni për Siguri, edhe Komisioni për Legjislacion, të gjithë deputetët, në përgjithësi, të të gjitha grupet parlamentare, do të ishte mirë që së bashku ta gjejmë një mes dhe të amandamentojmë, ta sjellim ligjin në harmoni me Kushtetutën, por edhe në harmoni me standardet më të larta për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Unë jam shumë i sigurt që do ta gjejmë një model të gjithë së bashku, që ligji të jetë edhe i mirë, por edhe mikpritës, sepse nëse ligji nuk është mikpritës, atëherë cili është mesazhi që ne e përcjellim kur më shumë se gjysmën e kombit, madje jo vetëm banorë të Kosovës, e kemi diku në mikpritje. E kanë pritur të tjerët në rrethana nga më të ndryshmet tash e 50 vjet. Ne nuk bëjmë asgjë tjetër, vetëm se çdo 20 vjet nga 100 deri 200 mijë njerëz na i pret dikush atje jashtë. Pra, le t'i harmonizojmë këto dyja, edhe Kushtetutën, edhe standardet më të larta të të drejtave të njeriut, por edhe aspektin e sigurisë për kategorinë e veçantë, të cilët edhe në vendet tjera zbatojnë masa më restriktive për të gjithë ata për të cilët një kohë të caktuar është vërtetuar, qoftë nëpërmjet delikuençave, qoftë nëpërmjet informacioneve të ndryshme se mund të jenë të rrezikshëm për rendin dhe sigurinë. Për ata duhet të vlejë ndoshta edhe ndonjë ligj tjetër, por jo... sigurisht se duhet të rregullohet me këtë ligj, por gjithsesi edhe me ndonjë ligj tjetër.

Ky ligj duhet të merret kryesisht me çështjen e të drejtës për të ardhur, për ta filluar një jetë dhe për ta ndërtuar një jetë, e jo t'u vështirësohet nëpërmjet formave të cilat ky ligj i parasheh, por gjatë periudhës nga ky lexim deri në miratim në lexim të dytë, jam shumë i sigurt se të gjithë së bashku do ta bëjmë një ligj shumë të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sveçla.

XHELAL SVEÇLA: I nderuar kryesues,  
Të nderuar kolegë,

Qeveria e Kosovës me Qeverinë e Shqipërisë tashmë kanë pasur katër mbledhje të përbashkëta, në të cilat, sipas informatave, kanë arritur 12 marrëveshje. Njëra ndër to është edhe heqja e lejeve të punës për shtetasit e të dyja vendeve. Kjo nuk ka mundur të implementohet për shkak të mungesës së rregullativës ligjore dhe mendoj se ky është rasti që në këtë ligj të reflektohet njëra ndër këto marrëveshje, duke mundësuar që qytetarët apo shtetasit e shteteve të mund të punojnë pa leje pune në shtetet respektive.

Prandaj, mendoj që ky duhet të jetë edhe njëri ndër amendamentet në këtë projektligj, në këto ndryshime, të cilat shpresoj se do të gjejnë mbështetje, si nga komisioni, po ashtu edhe nga të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zeka, e keni fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

Është njëri nga ligjet më specifike. Kisha pasur dëshirë ta dimë edhe ne si deputetë, po edhe vetë ministria përkatëse, që e ka sjellë këtë propozim, që ky ligj nuk bëhet për të huajt, por ky ligj faktikisht bëhet për Diasporën shqiptare, sepse asnjë njeri në këtë dynja s' do të vijë në Kosovë, të paktën edhe nja pesëdhjetë vjet, për të kërkuar azil. Ne sikur të mundnim të gjithë do të iknim prej këtij vendi, duke e përjashtuar Berishën këtu, por është problemi që ky ligj po bëhet për Diasporën donë. Ne e dimë që Qeveria gjermane, për shembull, i kushtëzon mërgimtarët tanë ta lënë nënshtetësinë e Kosovës për ta marrë nënshtetësinë gjermane, sepse nuk aplikojnë nënshtetësi të dyfishtë.

Në bazë të asaj që dëgjova prej deputetëve parafolës, në qoftë se guxoj t'ia përmend emrin Samiut, se pastaj mos po kërcen ndonjë zorrë në prush para atij, kështu të çartet, e në qoftë se i referohem edhe Fatonit çfarë tha me shumë të drejtë, askund në botë nuk shkruan që një muaj ta lëshojë, sepse një muaj mund të shkosh pushim në skijim e ta humbësh të drejtën e vazhdimit të lejes së qëndrimit. Është ligj shumë specifik, që duhet t'i kemi për bazë edhe martesat, edhe fëmijët dhe mbi bazën e kësaj, unë propozoj që ne si deputetë, të paktën në këtë ligj të ulemi, të bashkëpunojmë, t'i çojmë vërejtjet tona. Dhe, në fund, edhe unë të garantoj, Faton, në qoftë se ky ligj diskriminon vetëm 00,1% qytetarët, edhe të huajt, e sidomos Diasporën tonë, edhe unë natyrisht nuk e votoj një ligj të tillë, por që kërkon një bashkëpunim të jashtëzakonshëm ndërmjet nesh. Edhe inshalla ministri thërret ekspertë ligjore, të cilët e njohin ligjin e emigracionit, jo vetëm në Bashkimin Evropian, sepse çdo vend i Bashkimit Evropian i ka specifikat e veta për ligjin ndaj të huajve. Për shembull, në Suedi automatikisht e fiton nënshtetësinë, në qoftë se vetëm njëri prind është nënshtetas suedez. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kolegë deputetë,

Ministra,

Desha shkurtimisht, meqë janë të bazuara këto që u thanë, t'i jap disa shpjegime të shkurtra dhe mendimin tim.

E para, jo krejt çfarë u tha këtu do të jetë në materien e plotësim-ndryshimit të këtij ligji. Bëhet fjalë vetëm për një pjesë, e cila gati që nuk i trajton ato shqetësimet tona. Duhet ta dimë, edhe unë jam njëri prej tyre, që në njërin prej seancave e kam shtruar problematikën që ka vendi ynë në trajtimin që ka vendi ynë me njerëzit që vijnë nga Lugina e Preshevës, e që kanë probleme me statusin e tyre këtu. Dhe, e kam shtruar si çështje që mund ta trajtojmë me këtë, ose ndonjë mënyrë tjetër, me një ligj tjetër, qoftë edhe si vetëdijesim, qoftë edhe si shfrytëzim i legjislacionit në fuqi, e deri te kompetencat e Presidentit për dhënien e shtetësisë.

Por, ky ligj shkon përtej këtyre. Si njëri prej atyre që kam punuar në versionin e parë të këtij projektligji, ju them se është ndër ligjet ndoshta kryesore të fushës së sigurisë që jemi monitoruar edhe si kriter për liberalizim të vizave, edhe për ecjen tonë drejt BE-së. Është një ligj, meqenëse vendi ynë llogaritet ndër vendet që jemi edhe transit në komunikimet e në qarkullimin e njerëzve prej një regjioni në regjionin tjetër, prej Lindjes në Perëndim, jemi monitoruar dhe do të monitorohemi edhe më shumë, jo vetëm si e kemi ligjin, por edhe se si do të zbatohet ky ligj, meqenëse jemi si aspirant në BE.

Ajo që e kërkova e që po e shfrytëzoj fjalën, ndoshta zoti ministër, meqenëse ka më pak informacione në opinion, edhe këtu në Kuvend, përtej kësaj pjesës shpjeguese që është dhënë në projektligj, ndoshta është me rëndësi edhe për opinionin, e për të tjerët, të dihet me shifra, për aq sa mund të thuhet publikisht, sa njerëz qarkullojnë, kanë kërkesa, vijnë këtu, Ministria e Punës madje e ka edhe një regjistër të njerëzve të huaj që vijnë nga Lindja, në një mënyrë ose në një tjetër, punojnë ose kanë leje pune këtu dhe janë në procedura për marrjen e shtetësisë, të shihet edhe njëfarë trendi se cilat janë lëvizjet e këtyre shtetasve dhe kah po shkon lakorja, ose trendi i kërkesave për shtetësinë e tjerë e tjerë. Por, në plan të parë, edhe një herë po them, pa i neglizhuar të drejtat e njeriut, të cilat i parasheh ky projektligj, sepse asnjë direktivë e BE-së nuk e përjashton direktivën tjetër, që ka të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve.

Po e them një material shpjegues, ose informata shpjeguese, për ta pasur të qartë edhe opinionin se ky ligj nuk i dedikohet një kategorie, ose një kategorie tjetër, por thjesht shtetit tonë për të ecur me standarde të sigurisë, sikur janë të gjitha vendet tjera të BE-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FLAMUR SEFAJ: I nderuar kryesues,  
Të nderuar deputetë,  
Të nderuar kolegë ministra,  
Ju falënderoj për këtë debat konstruktiv!

Edhe unë vij nga Diaspora. Ky projektligj është vërtet i rëndësishëm, lidhet edhe me MSA-në. Është mirë që të kalojë. Pastaj, të gjitha instrumentet që ne i kemi në dispozicionin tonë t'i modifikojmë në bazë të nevojave dhe kërkesave që ne i kemi si popull. Por, shumë çështje që u shtruan, çështja e organizatave të mbledhjes së fondeve, 3%-shi e këto, këto jashtë nuk kanë qenë të rregulluara nga ligji për të huaj, por nga ligji në regjistrimet e OJQ-ve dhe organizatave tjera, kështu që këtu nuk mund ta përfshijmë. Ndërsa, sa u përket qytetarëve nga Lugina e Preshevës dhe territoret tjera të Republikës së Serbisë, ky ligj do ta japë dhe e jep mundësinë që ata ta rregullojnë statusin e tyre, që të jenë fillimisht rezidentë dhe pastaj mund të bëhen edhe qytetarë të Republikës së Kosovës.

Patjetër që unë do të dokumentohem më shumë për herën tjetër dhe do të debatojmë me fakte dhe me shifra empirike në këtë rast. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konstatoj që është harxhuar, e kemi përfunduar debatin lidhur me ligjin. Kuorum për ta votuar ligjin nuk kemi. Unë jap pauzë deri në orën 14:45 dhe i ftoj kryetarët e grupeve parlamentare që t'i thërrasin deputetët që pas pauzës të jenë në sallë.

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës.*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Unë desha, të nderuar kolegë, të bisedojmë pak.

Ne e kemi mundësinë e debatit për çështje të ligjeve që janë, por kuorum për të votuar nuk kemi. A po mendoni ta vazhdojmë, që procedurat e votimit t'i lëmë për nesër.

Pra, edhe shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-2012 për të huajt mbetet vetëm votimi për nesër ose kur të krijohen kushtet.

## **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguri bërthamore**

Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zotin Rrustem Berisha, ministër i Forcës së Sigurisë së Kosovës, që para deputetëve të paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Berisha, e keni fjalën.

MINISTRI RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni që para jush të paraqes Projektligjin për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguri bërthamore.

Projektligji për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 04/2017 të datës 4 dhjetor 2017.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji konsiston në avancimin e kornizës ligjore, e cila mbron shëndetin e njerëzve dhe mjedisin nga efektet e dëmshme të rrezatimit dhe siguron nivel të lartë të sigurisë bërthamore, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Me Projektligjin për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguri bërthamore përcaktohen masat mbrojtëse për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe mjedisit nga efektet e dëmshme të rrezatimit, masat e sigurisë bërthamore gjatë veprimeve lidhur me aktivitetet bërthamore, menaxhimin e mbetjeve radioaktive, mbikëqyrjen e zbatimit të masave, detyrimet e ndërmarrjeve që ushtrojnë praktika si dhe sanksionet.

Jam i nderuar që pata rastin t'ju informoj në pika të shkurtra për përmbajtjen e këtij projektligji dhe ju propozoj që të njëjtin ta miratoni, në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen me këtë projektligji të vihen në suaza të kornizës ligjore adekuate. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Ftoj kryetarin e Komisionit Hapësinor, zotin Daut Haradinaj, që të paraqesë dhe ta arsyetojë raportin e komisionit. Zonja Musliu, atëherë.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhje plenare shqyrtoi projektligjin në parim dhe Kuvendit i paraqet raportin me rekomandim.

Komisioni pas shqyrtimit në parim të Projektligjit numër 06/L-029 për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguri bërthamore vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 56 të Rregullores së Kuvendit dhe njëzëri e miratoi këtë projektligj në parim dhe i rekomandon edhe seancës që ta miratojë në leximin e parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zotit Salihu e ka fjalën.

SALIH SALIHU: Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” në parim e përkrah këtë projektligj, vetëm se është mirë të shtohet që ekziston edhe agjencia për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore, i cili ka vetëm pesë vetë. Ne mendojmë se janë shumë pak pesë vetë, është me interes të rritet numri i njerëzve në këtë agjenci, sepse është një agjenci shumë e rëndësishme.

Tjetër është se kjo agjenci nuk ka pajisje laboratorike apo laborator, e që mendojmë se për Kosovën, duke pasur parasysh edhe numrin e vdekshmërisë së madhe nga kanceri në Kosovë, do të ishte me interes që kjo agjenci të pajiset edhe me instrumente, edhe me kuadro të reja, në mënyrë që ky ligj të implementohej ashtu qysh duhet. Përndryshe, në këtë formë qysh është, nuk ka mundësi të bëhen analiza të mirëfillta se ku ka, për shembull, rrezatim, ku ka radioaktivitet dhe, në këtë kuptim, shkalla e vdekshmërisë që është e madhe në Kosovë, ne nuk e dimë prej nga vjen.

Si Lëvizje “Vetëvendosje” kërkojmë që kjo agjenci të fuqizohet edhe me njerëz, edhe me pajisje laboratorike, e jo, për shembull, ne t’i marrim të dhënat nga KFOR-apo apo ndonjë organizatë tjetër e huaja për këto analiza, sepse është një fushë shumë e rrezikshme dhe aq më pak në kuadër të kësaj agjencie nuk kemi fare ekspertë të kësaj fushe.

Pra, mendoj se si Kuvend duhet dhënë mbështetje kësaj agjencie, ta përkrahim dhe ta mbështesim edhe financiarisht, edhe me instrumente e laborator. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar materialin ose thjesht Projektligjin për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore dhe konstaton se ky projektligj i plotëson kushtet për t'u votuar në lexim të parë.

Prandaj, i ftoj të gjithë deputetët që ta përkrahin dhe t'i japin mbështetje këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharrem Nitaj, në emër të AAK-së. Apo Dauti?

DAUT HARADINAJ: Jo, Muharrem Nitaj do të flasë në emër të AAK-së.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet në parim shqyrtimin e parë të Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti, në emër të "Nismës" e ka fjalën.

ENVER HOTI: Grupi i "Nismës" e ka trajtuar Projektligjin për rrezatim dhe siguri bërthamore dhe e mbështesim plotësisht, por njëkohësisht kërkojmë që institucionet përkatëse të marrin masa shtesë për të ngritur kapacitetet edhe profesionalisht, sepse nga trajtimi që kemi pasur në komision është vërejtur se ka mungesë edhe te pajisjet për çështje të tilla, edhe të kuadrit profesional, po ashtu ka edhe një moskoordinim të institucioneve, të cilat do të jepnin kontribut dhe do të bënim funksional ligjin.

Mendojmë se kjo është e domosdoshme të arrihet, të realizohet, por ka nevojë që të merren masa shtesë në funksionalizimin e këtij projektligji në fazën e zbatimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të "6+", zoti Danush Ademi e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi "6+" Projektligjin për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore e ka shqyrtuar me vëmendje dhe në parim do ta përkrahë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Duke mos qenë njohës i fushës, e besoj që shumica e deputetëve janë të tillë, e kam lexuar me shumë kujdes Projektligjin për mbrojtjen nga rrezatimi dhe siguri bërthamore, duke u përpjekur

për të kuptuar se çfarë synon ligji, çfarë rregullon dhe cilat janë përfitimet që ne i kemi qytetarët e Kosovës.

Nga ajo që unë kuptoj në cilësinë e laikut, ligji është shumë i nevojshëm.

Vetëm leximi i këtij ligji ka qenë për mua një sensibilizim për problematikën që rregullon ky ligj, por të njëjtën kohë, edhe një moment i frikës për ambientin në të cilin ne jetojmë si qytetarë të Kosovës dhe mungesën e mbrojtjes minimale nga rreziqet bërthamore.

Kjo frikë bëhet akoma më e madhe kur kemi parasysh që kemi një Agjenci të Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, e cila ka, në fakt, gjashtë punonjës, njëri prej të cilëve punon në administratë dhe njëri është drejtor, pra një kapacitet krejt i vogël.

Kjo agjenci le që nuk ka mjete, por nuk ka asnjë laborator të mirëfilltë për të analizuar situatën, pra nuk mund të luajë fare ndonjë rol të rëndësishëm sa i përket çështjes për të cilën po diskutojmë.

Projektligji që ne kemi para vetes është mirë që rregullon shumë çështje në këtë fushë, madje mirë që ndalon prodhimin dhe përdorimin e armëve bërthamore, se s'i dihet, na del ndonjë premtim elektoral i ndonjë kandidati për kryeministër për armë bërthamore dhe pastaj e humbim përsëri liberalizimin e vizave.

Por, kjo pjesë është vetëm për harmonizim, pra, ky ligj është vetëm për harmonizim me ligjet e Bashkimit Evropian, prandaj dhe është mirë që është futur edhe kjo pjesë në ligj, sepse kështu Bashkimit Evropian i japim sigurinë që ne nuk prodhojmë, e aq më pak të përdorim armë bërthamore, së paku jo para se të mësohemi se si të krijojmë një sistem, i cili na mundëson që të dimë sa barna esenciale i kemi dhe kujt ia kemi dhënë ato, në mënyrë që të mos keqpërdoren.

Ajo që mua me preokupon më shumë është fakti që sot nuk kemi asnjë laborator në Kosovë, i cili së paku do të merrej me vlerësimin e ndotjes së ujit dhe të tokës. Pra, po krijojmë një super ligj modern, por nuk kemi asnjë laborator.

Nuk e dimë cila është cilësia e ujit në Kosovë, nuk e dimë çfarë uji pimë, nuk e dimë se sa është e kontaminuar toka.

Dhe, aty ku jemi gjithashtu të rrezikuar seriozisht nuk i dimë përmasat e rreziqeve dhe dëmeve që eventualisht shkaktojnë institutet radiologjike.

Mjerisht, mostrat e ujit duhet të dërgohen në Institutin për radio-elementet të Brukselit për të vlerësuar mostrat e ujit, sepse ne nuk kemi laboratorë të tillë.



Nuk kemi personel të mjaftueshëm të kualifikuar, mjete pune, po nuk kemi as institut për hulumtime bërthamore, pra jemi të rrezikuar seriozisht dhe nuk e perceptojmë këtë çështje si rrezik.

Nuk e dimë si qëndron puna edhe me përdorimin e armëve gjatë luftës me uran të varfëruar, është thënë që efekti i predhave të përdorura gjatë luftës me uran të varfëruar pas 17 apo 18 vjetësh bie. Megjithatë ne nuk kemi të dhëna të sakta lidhur me rastet e kancerit në Kosovë, kemi rritje apo zbritje të rasteve të tilla dhe sa është kjo e lidhur me predhat me uran të varfëruar. Pra, mungojnë të dhënat konkrete. Ndoshta këto të dhëna mund të na i japë ministri i Shëndetësisë.

Këtu në Prishtinë ne kemi Klinikën e Radiologjisë, Onkologjisë dhe Mjekësisë Bërthamore. Derisa Klinika e Onkologjisë dhe Mjekësisë Bërthamore i plotëson deri diku standardet, po e theksoj, deri diku, këto standarde nuk i plotëson aspak Klinika e Radiologjisë, së paku kështu është thënë nga drejtori i Agjencisë së Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore.

Por si qëndron puna me institucionet jashtë Prishtinës, si qëndron puna me institucionet private që ofrojnë shërbime radiologjike?

Unë pajtohem që duhet të ketë një rregullim, por që ky rregullim duhet të implementohet jo vetëm për shkak që kërkon Bashkimi Evropian, Qeveria, karshi përpilimit dhe miratimit të ligjit duhet të ndaheshin edhe mjetet e nevojshme për zbatimin e ligjit.

Përndryshe, ky ligj mund të vendoset në vitrinat e ligjeve dekor për hatër të Bashkimit Evropian, por të pazbatueshme në praktikë, për shkak të kostove buxhetore.

Edhe pse ligji është i rëndësishëm, ashtu si rregullimi i nevojshëm dhe i domosdoshëm, ashtu si mbrojtja, ky ligj ka qenë i gatshëm në tetor të vitit 2016 dhe është sjellë tek tani në Kuvend. Kjo tregon paka shumë qasjen tonë për shëndetin dhe rreziqet nga elementet e radiologjisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur, përfaqësuesi i Qeverisë, e dëshiron fjalën prapë? Jo.

## **6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pajisjet nën presion**

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Zhvillimit Ekonomik, zotin Lluka, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Lluka, e ke fjalën.

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Përshëndetje, deputetë!

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë,

Ju prezantoj për miratim Projektligjin për pajisjet nën presion.

Ky projektligj ka për qëllim të përcaktojë parimet themelore që mundësojnë garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion, si dhe kushtet dhe kërkesat themelore të sigurisë që duhet të respektohen nga operatorët ekonomikë që prodhojnë, administrojnë apo shfrytëzojnë enët e thjeshta nën presion, pajisjet nën presion, pajisjet transportues nën presion apo aerosolët.

Ky projektligj përfshin kushtet dhe kërkesat themelore të sigurisë që duhet të zbatohen për projektim, prodhim, vlerësim të konformitetit, shfrytëzim dhe mirëmbajtje të pajisjeve dhe instalimeve nën presion që nënshtrohet një presioni punues manometrik të lejuar më të lartë se 0,5 bar.

Projektligji është në përputhje me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian për pajisjen nën presion dhe përmbush kërkesat kryesore të këtyre akteve.

Pjesa tjetër e zbatueshmërisë mbetet të përfundohet me nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse nga ana e ministrisë.

Andaj, të nderuar deputetë,

Duke pasur nevojë që për një ligj të ri për pajisjet nën presion, kërkoj nga ju miratimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit Funksional.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Ministra të pranishëm,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për pajisjet nën presion dhe në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, ky komision në mbledhjen plenare të rregullt ka marrë këtë vendim që projektligji, meqenëse i plotëson kushtet e parapara, i rekomandon Kuvendit për miratim.

Nënkryetar, në qoftë se është e mundur, po e vazhdoj edhe në emër të grupit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës gjithashtu e ka shqyrtuar Projektligjin për pajisjet nën presion, do ta mbështesë në parim dhe kontributin do ta japim gjatë fazës së amendamentimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare, zoti Nitaj është paraqitur në emër të AAK-së.

MUHARREM NITAJ: Nënkryetar, meqenëse është bërë si ‘templeit’ që të gjitha grupet parlamentare e kanë shqyrtuar me kujdes këtë projektligj, faktikisht të gjitha projektligjet, edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës po them që e ka lexuar projektligjin dhe i jep mbështetje në leximin e parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Balje, në emër të “6+”.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna grupa “6+” je analizirala Zakon o opremama pod pritiskom i svoj rad na završavanje ovog Zakona daće kroz rad u komisijama. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të PDK-së, Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Nënkryetar, unë tashmë e thashë fjalën time.

KRYESUESI: Mirë. Në emër të “Nismës”, zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Po, edhe “Nisma” e mbështet në parim projektligjin dhe brenda dy leximeve do të japim kontributin tonë për të përmirësuar ligjin në pjesë të ndryshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Islam Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje. kryesues, faleminderit!

AKR-ja e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe njëkohësisht e përkrah. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Ministër, dëshironi ta merrni fjalën prapë apo jo? Jo! Atëherë konsideroj që debati ka përfunduar, mbetet vetëm votimi.

## **7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës**

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Ftoj ministrin e Zhvillimit Ekonomik, zotin Lluka, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Zoti Lluka, e keni fjalën.

MINISTRI VALDRIN LLUKA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni ta prezantoj Projektligjin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

Çështjet kryesore të trajtuara në këtë projektligj janë aktivitetet që përfshin hulumtimet, kushtet dhe mënyrat e kryerjes së hulumtimeve gjeologjike, studimet gjeologjike në përgjithësi dhe studimet gjeologjike hulumtuese në veçanti.

Si proces që i paraprin lëmenjve të tjerë nxjerrëse të industrisë dhe mundësi për të zgjeruar njohuritë e veprimtarive shkencore aplikative që ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, me ndikim të drejtpërdrejtë socio-ekonomik.

Gjithashtu dispozitat e këtij projektligji përcaktojnë kompetencat, detyrat dhe funksionet e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, duke përfshirë veprimtarinë në fushën e shkencave gjeologjike në territorin e Republikës së Kosovës.

Shërbimi Gjeologjik i Kosovës, si organ këshillimor, teknik dhe shkencor, kryen veprimtarinë në fushën e shkencave gjeologjike, si studime gjeologjike sistematike, nëpërmjet hartografimeve komplekse të shkallëve të ndryshme, studime gjeokimike të territorit të Kosovës dhe përpilimin e hartave gjeologjike në shkallë të ndryshme. Plotësimin e hartave ekzistuese me informacione të reja për territorin e Republikës së Kosovës, studime të thelluara shkencore për gjeologjinë dhe metalogjeninë në territorin e Republikës së Kosovës si dhe kryerjen e veprimtarive të tjera me interes të vendit.

Dispozitat e projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës nuk janë të rregulluara në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe, si e tillë, kjo fushë e veprimtarisë mbetet në kompetencën e brendshme të shteteve.

Konsiderojmë që dispozitat e këtij projektligji nuk cenojnë parime themelore të legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Andaj, i nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e materies që ky projektligj do të rregullojë, ju rekomandoj për miratimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj zonjën Berisha-Shala, që në emër të Komisionit Funkcional ta arsyetojë raportin e komisionit.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit!

Gjithashtu Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Punës së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më datë 30 janar 2018 e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe Kuvendit i paraqet rekomandimin të miratohet në parim Projektligji për shërbimin gjeologjik të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga grupet parlamentare nuk është paraqitur askush. Zonja Berisha-Shala, edhe një herë e ka kërkuar fjalën në emër të grupit.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje Projektligjin për Shërbim Gjeologjik dhe e mbështet në parim, duke dhënë mundësi që gjatë fazës së amendamentimit të japim kontributin tonë të mëtutjeshëm.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kosova është vend me pasuri mjaft të mëdha natyrore minerale, duke e bërë atë një vend më atraktiv për hulumtim, shfrytëzim dhe përpunim të mineraleve dhe zhvillimin e gjeo-shkencave.

Zhvillimi i gjithanshëm dhe i qëndrueshëm ekonomik e social i Republikës së Kosovës, sipas shumë studimeve dhe strategjisë minerare të vitit 2012-2025, në masë të madhe mbështetet në pasuritë natyrore vendore, të cilat nuk i mungojnë Kosovës.

Spektori i nxjerrjes së mineraleve është jo vetëm një treg i veçantë atraktiv në vetvete, por edhe burim për zhvillimin e jetës ekonomike dhe sociale në vend.

Studimet gjeologjike në përgjithësi dhe studimet gjeologjike hulumtuese në veçanti, si proces u paraprijnë lëmenjve të tjerë të industrisë dhe japin mundësi për të zgjeruar njohuritë e veprimtarive shkencore-aplikative që në instancë të fundit ndihmojnë zhvillimin ekonomik të vendit si dhe kanë ndikim direkt socio-ekonomik në shoqëri.

Sot në vendet e zhvilluara nuk flitet se a duhet të ekzistojë gjeologjia si shkencë në vendet e tyre për nevoja hulumtimi, por diskutohet për të arriturat më të reja shkencore, të cilat janë rezultat i ngritjes së kapaciteteve dhe modernizimit të laboratorëve dhe përgatitjes shkencore të stafit të tyre.

Sidoqoftë, institucionet të cilat merren me planifikim, zhvillim dhe administrim të territoreve, duke përfshirë pushtetin lokal, deti të ministritë e linjës dhe investuesit potencialë kërkojnë një burim të besueshëm të informatave relevante gjeo-shkencore për planifikimin dhe investimet e kapitalit të tyre. Ky burim i informatave institucionale dhe të dhënave është roli të cilin e ka Shërbimi Gjeologjik i Kosovës.

Gjeologjia si shkencë dhe degët e tjera të gjeologjisë inxhinierike dhe mjedisore është element i rëndësishëm i kompleksit të metodave për studimin dhe monitorimin e gjeo-mjedisit dhe të gjendjes teknike të ndërtimeve që ne më së paku si Kosovë i marrim parasysh këto dhe kjo ka ndikim direkt dhe në planet urbanistike të hartuara qoftë nga niveli lokal, po edhe në nivelin qendror.

Sot, sipas informacioneve të sigurta shkencore nuk ka investime të sigurta, andaj sot tërheqja e investime është një nga prioritetet kryesore të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe në këtë drejtim, përveç reformave ligjore dhe plotësimit të legjislacionit sekondar, ngritjen e kapaciteteve hulumtuese shkencore të sektorit të gjeo-shkencave në përgjithësi do të ndikonin në hapjen e perspektivës së re në ngritjen e kapaciteteve të reja hulumtuese për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Sidoqoftë, investuesit potencialë kërkojnë një burim të besueshëm pra të informatave, ky burim i informatave është duke u bazuar në ekspertizën e të dhënave, është roli kryesor i Shërbimit Gjeologjik që është i rekomanduar për tërheqjen e investitorëve. Shërbimi Gjeologjik ka mision të luajë rolin e tërheqjes së investimeve të huaja direkte në sektorin e burimeve natyrore të Kosovës, si dhe plotësimit të nevojave të vendit. Unë për të mos u përsëritur me ministrin në ekspozenë e tij në lidhje me këtë projektligj, do të kisha përmendur sidomos nevojat e studimeve që kanë të bëjnë me studimet gjeologjike për gjeo-mjedisin, gjeologe-inxhinierike, gjeologo-agrogjeologjike, erozionin, e sidomos me monitorimin sistematik të tërmeteve, vlerësimin e rrezikut sizmik dhe mikrosizmik të territorit të Kosovës dhe jorastësisht thuhet se gjeologu është një psikolog i tokës, duke i përcjellë të gjitha këto fenomene që ndodhin në natyrë.

Në fund, të nderuar kolegë deputetë, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës ju ftoj ta votoni, ta mbështesni në parim. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Nitaj e ka fjalën në emër të AAK-së.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës po ashtu i jep mbështetjen në parim Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe nesër besoj që do të kemi mundësi që ta votojmë, jo sot për shkak të kuorumit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Edhe “Nisma” mbështet në parim projektligjin dhe besojmë që në mes të dy leximeve do të japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e doni fjalën për ligjin? Jo! Atëherë, konsideroj që edhe për pikën e shtatë të rendit të ditës: Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, debati është shteruar, ka ngelur vetëm votimi.

## **8. Debat parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me dënimin e disa aktivistëve të këtij subjekti politik**

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me dënimin e disa aktivistëve të këtij subjekti politik. Kush do ta marrë fjalën i pari për këtë punë? Ftoj zotin Albin Kurti që ta marrë fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,

Qytetarë të Republikës,

Kabinet i Qeverisë,

Viti 2015 pati nisur me protestat e janarit që kanë çuar në shkarkimin e ministrit të atëhershëm Jabllanoviq. Viti 2015 u përmbyll me vendimin e Gjykatës Kushtetuese që thoshte se Asociacioni apo Bashkësia e komunave me shumicë serbe, përkatësisht ‘Zajednica’, nuk është në përputhje me 23 nene të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Viti 2016 pati nisur me demonstratat më të mëdha të Kosovës së pasluftës, më 9 janar dhe 17 shkurt, kundër ‘Zajednicës’ së Serbisë dhe demarkacionit me Malin e Zi.

Gjatë asaj kohe janë bërë me qindra arrestime të aktivistëve e deputetëve opozitarë, deri më 29 gusht të vitit 2016, kur arrestohen 6 aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje” për sulmin me predhë në ndërtesën e Kuvendit më 4 gusht. U arrestuan Astrit Dehari, Frashër Krasniqi, Atdhe Arifi, Egzon Haliti, Adea Batusha dhe Petrit Ademi.

Prej datës 5 gusht deri më 25 gusht, sipas Policisë së Kosovës janë hetuar 4 persona krejtësisht të tjerë. Gjithçka që pasoi tregonte për inskenimin e sulmit të armatosur mbi ndërtesën e Kuvendit

të Kosovës, duke fshehur autorët e vërtetë, për të fajësuar Lëvizjen “Vetëvendosje” me qëllime të caktuara politike.

Policia e Kosovës organizonte konferenca për shtyp dhe emisione televizive, ku zyrtarët më të lartë të saj sulmonin publikisht aktivistët e arrestuar dhe subjektin tonë politik. Dendësi e tillë e deklaratave publike nga Policia e Kosovës, sidomos nga e ashtuquajtura “Njësi Kundër Terrorizmit”, nuk ka pasur as më herët dhe as më vonë në Kosovë sikur me rastin e arrestimit të këtyre 6 aktivistëve. Gjykimi nuk kishte filluar ende, mirëpo Policia tashmë kishte bërë ndëshkimin. Ajo po na dënonte publikisht nëpër studiot televizive dhe para kamerave të mediave. Nuk vepronte gjykata, nuk fliste prokurori, por dënonte Policia. I gjithë sistemi i drejtësisë duhej veçse ta ndiqte Policinë që po përndiqte “Vetëvendosjen”. Gjykata bëhej e ashpër, sepse policia ishte brutale, gjykatës nuk i interesonin faktet e provat, sepse as policisë nuk i interesonin ato. Qëndrimi policor ndaj Lëvizjes “Vetëvendosje” sundonte me faktet, qoftë kur ato mungonin apo edhe atëherë kur merrnin mundin t’i fabrikonin ato. Ndërkaq, prokuroria ishte veçse hallkë formale që ndërlidh gjykatën me policinë, ku policia prin e gjykata vulos, policia vepron e gjykata justifikon. Gjykatësi nuk është marrë me të pandehurit, sepse ai vetë është i marrë nga policia. Gjashtë aktivistët në burg ishin arrestuar nga policia. Gjykatësi, në këtë proces ishte po ashtu i arrestuar nga policia. Policia na e kishte bërë tashmë gjyqin, natyrisht që gjykatësi në seancë mandej na e bënte policin. Kur e vërteta është policore, gjykata është e pavërtetë.

Mirëpo, shtrohet pyetja, pse po na persekutonte policia? Çfarë zori kishte ajo që na përndiqte ashtu? Urdhrat politikë sigurisht se janë shkak, e kemi thënë këtë dhe e përsërisim, sepse Kosova është shtet i kapur. Megjithëkëtë, nuk besoj që kjo shter shkaqet. Kishte diçka më shumë se kaq, diçka edhe përtej urdhrit politik mbi neve opozitarët politikë të këtij regjimi partiak. Unë besoj se kjo ishte hakmarrja. Policia po hakmerrej ndaj Lëvizjes “Vetëvendosje” për protestat që kishim bërë gjatë 20 muajve të fundit. Zaten, kur policia ta bën drejtësinë, kjo mund të jetë vetëm si hakmarrje. Ajo çfarë ngjau me 6 aktivistët ishte hakmarrje policore, të cilën normalisht që dështuan ta arsyetojnë prokuroria dhe gjykata, sepse ajo ishte hakmarrje dhe veçse hakmarrje ndaj “Vetëvendosjes”.

Nuk ishte hera e parë, më 28 nëntor 2015 ishin thyer zyrat e Lëvizjes “Vetëvendosje” nga njësitë antiterror, të cilat nuk janë përdorur as në veri të Kosovës. Ndërhyrja nga forcat elitare antiterror ishte operacion që përbëhej nga qindra policë, të cilët rrahën e arrestuan 97 aktivistë. Tri javë më vonë, më 18 dhjetor 2015, kemi bërë 80 kallëzime penale për dhunën policore, ndaj të cilave Policia e Kosovës reagoi menjëherë publikisht, duke thënë se ajo i paska 166 policë të lënduar në protestat e muajve të fundit, pra, duke pranuar kështu hakmarrjen ndaj nesh me 28 nëntor. Edhe “Amnesty International” e Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës kanë reaguar me komunikata zyrtare kundër kësaj ndërhyrjeje policore brutale më 28 nëntor 2015. E, policia e arsyetoi këtë me policët e lënduar nëpër protesta. Pra, policia e pranoi që ishte hakmarrë



ndaj neve për ata 10 muaj të opozitarizmit më të fuqishëm që kishte parë ndonjëherë Kosova e pasluftës.

Arrestimi i 6 aktivistëve më 29 gusht 2016 ishte hakmarrja e dytë policore ndaj Lëvizjes “Vetëvendosje”, për 10 muajt e dytë të opozitarizmit, gjithnjë më të fuqishmit në Kosovën e pasluftës.

E, sërish jo vetëm kaq. Hakmarrja synonte edhe të maksimizonte efektin. Arrestimi i 6 aktivistëve ngjau vetëm dy ditë para protestës së 1 shtatorit 2016 kundër ratifikimit të demarkacionit këtu në Kuvend. Dhe, si për çudi, sërish vetëm dy ditë para balotazhit në zgjedhjet lokale, pra më 17 nëntor 2017, këta aktivistë dënohen gjithsej me 21 vjet burgim, pasi që Astrit Dehari ishte mbytur në burg një vit më parë.

Kur më arrestuan mua, më 28 nëntor 2015, më dërguan në Burg të Sigurisë së Lartë, aty me të burgosur që akuzoheshin për terrorizëm. A e dini pse? Sepse, njësitë antiterror të policisë ishin ato që më kishin arrestuar. Meqenëse, më arrestoi antiterrori, duhej të më shpinin në burg për terroristë. Ngjashëm, meqenëse Astrit Dehari vdiq dhunshëm në burg, katër aktivistët e tjerë të burgosur u dënuan rëndë. 21 vjet burgim nuk janë dënimi i Gjykatës mbi aktivistët e pafajshëm, por mbrojtja e Gjykatës nga faji i regjimit për vdekjen e Astritit.

Gjykata e prokuroria, Ministria e Drejtësisë në Kosovë vrapojnë pas policisë. Mandej, ato arsyetojnë policinë, pas së cilës vrapojnë dhe vetveten e tyre në vrapin e tyre pas policisë. Gjykata e Prokuroria ishin pakçka jashtë këtij vrapin të tyre pas policisë.

As prokuroria dhe as gjykata nuk kanë arritur të mbledhin dhe të ofrojnë asnjë provë materiale që do të mund të përdorej si dëshmi kundër aktivistëve tanë. Provat materiale, analizat e forenzikës, analizat krahasimore të ADN-së të mostrave të gjetura në vend të ngjarjes dhe të aktivistëve, analizat e mostrave dhe shenjave të gjetura të armës së përdorur, analizat e shenjave të motoçikletës së djegur, analizat e thirrjeve, sinjaleve, mesazheve të telefonave apo kompjuterëve të sekuestruar, analizat e bëra nga FBI-ja për krahasimin e personave të fotografuar nga kamerat, të gjitha dëshmitë e dëshmitarëve të rastit flasin kundër këtij dënimi që gjykata ua shqiptoi aktivistëve.

Këtë e ka pranuar edhe vetë prokurori i rastit. Kjo dëshmohet edhe nga vetë aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës prej 42 faqesh. Asnjë provë materiale e listuar dhe e cekur në këtë aktgjykim nuk dëshmon asnjë fakt kundër aktivistëve të dënuar. Të gjitha provat, dëshmitë e ofruara, dëshmitarët, analizat shkencore, kriminalistike dhe medicinale, vendore e ndërkombëtare, vërtetonin pafajësinë e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Dënimi nuk u dha pse ai kishte rëndësi për ligjin, shoqërinë dhe të pandehurit, por pse ai kishte rëndësinë për policinë, e cila moti kishte ndëshkuar e dënuar aktivistët. Kur vdiq Astriti, nuk foli as gjyqësia, as prokuroria, as ministria, as burgu, por policia. Foli komandanti i Policisë i rajonit të Prizrenit.

Drejtësia për Astritin dhe lirimi i aktivistëve janë parakushti i drejtësisë dhe lirisë për qytetarin në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdojmë me diskutuesit e tjerë, fjalën e ka zonja Haxhiu. Meqenëse s'keni bërë renditje, unë po i lexoj kështu siç jeni paraqitur.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari, është goxha e turpshme nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që nuk qëndrojnë në sallë teksa po diskutohet për një dënim të disa aktivistëve politikë, pra të Lëvizjes “Vetëvendosje” për një vepër ndër më të rëndën që njih legjislacioni penal. Pra ata s’e kanë marrë mundin, dikush me qëllime të caktuara, dikush nuk e sheh në interesin e tij që katër qytetarë të Republikës së Kosovës janë dënuar pa asnjë fakt, pa asnjë provë. Le të mbetet në ndërgjegjen e tyre.

Unë do të kem një fjalim më shumë përgjithësues dhe natyrisht që përfaqësuesit tjerë të “Vetëvendosjes”, Dardan Molliqaj, por po ashtu edhe zoti Sami Kurteshi do të flasin në detaje edhe për aktgjykimin, por edhe për të gjitha provat, të cilat i shfajësojnë aktivistët e Lëvizjes “Vetëvendosje”. Gushti i vitit 2016, në fakt, në përgjithësi ata muaj pas gushtit të vitit 2015 ishin tejet të vështira për qeverisjen e kaluar të zotit Isa Mustafa, po ashtu për Hashim Thaçin edhe Kadri Veselin. Madje, edhe sot edhe tani, mendoj që arsyeja kryesore sepse Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, por po ashtu edhe pjesa dërmuese e PDK-së sot nuk janë këtu. LDK-ja e lëshoi sallën pikërisht për shkak të përgjegjësisë që ka Isa Mustafa karshi montimit të këtij rasti. Isa Mustafa, Kadri Veseli dhe Hashim Thaçi, kjo treshe ishin përgjegjëse për nënshkrimin dhe mbrojtjen që i bënë dy projekteve të dëmshme dhe asokohe të kapluar nga të këqijat kishin humbur betejën edhe me qytetarët e Republikës së Kosovës, por kishin humbur argumentet edhe përballë opozitës, kështu filluan egërsisht përmes një lufte speciale t'i kundërviheshin Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Nuk është më sekret, nga dëshpërimi dhe humbja e pashpresë nisën tentimet për të shpallur Lëvizjen “Vetëvendosje” organizatë terroriste. Kështu, më 29 gusht të vitit 2016 u arrestuan gjashtë aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Astrit Dehari, aktivisti ynë vdiq dhunshëm në Burgun e Prizrenit, ndërsa Egzoni, Adea, Frashëri dhe Atdheu ende që 18 muaj po vazhdojnë të përballen me një proces politik e të montuar, madje u dënuan nga shkalla e parë me mbi 21 vjet burgim.

Ne në vazhdimësi e kemi kritikuar sistemin e drejtësisë, kemi argumentuar dhe kundërshtuar kapjen e sistemit të drejtësisë, por prej kohës kur janë dënuar me mbi 21 vjet katër aktivistët e Lëvizjes “Vetëvendosje” për një vepër, siç e thashë edhe më përpara, ndër më të rëndat që njeh legjislacioni penal dhe që s’e kanë kryer, dhe as që nuk kanë lidhje me të, unë përnjëmend jam jashtëzakonisht e shqetësuar me kahun që po merr ky sistem dhe me kahun që po merr vendi ynë. Po, sot e pranoj, unë s’kam menduar ndonjëherë që ata që e kanë kapur shtetin mund të shkojnë aq larg. Sot vetëm pse e kundërshton pushtetin dhe je kritik i proceseve të dëmshme, shpallësh lehtësisht terrorist.

Prej studentëve dhe aktivistëve të zellshëm, sistemi i kapur i drejtësisë të shpallë granatahedhës. Dhe, tani po i kuptoj drejt e saktë fjalët e gjyqtarit Beqir Kalludra, i cili pothuajse në secilën seancë gjyqësore thoshte, po citoj: “Shyqyr që vendimet e mia mund të apelojnë dhe s’janë përfundimtare”. Merreni me mend, ai as vetes nuk i beson, edhe në rastin e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, por edhe në rastin e gjyqimit të deputetëve për veprime politike, ai në vazhdimësi në secilën seancë thoshte se “shyqyr që vendimet e mia mund të apelojnë dhe s’janë përfundimtare”!

Pra, ai nuk vepron sipas ligjit, mirëpo vepron ashtu siç i thonë “ata” dhe siç e shtyjnë njerëzit e klanit “Pronto” dhe ata të cilët janë përgjegjësit kryesorë që e kanë degraduar sistemin e drejtësisë. E gjithë aktakuza kundër aktivistëve tanë ishte në fakt një farsë e bazuar në kontradikta, shpifje, madje prokurori, i cili ngriti këtë aktakuzë është njeri i klanit “Pronto” dhe u caktua Prokuror Special pikërisht në atë kohë dhe jashtëligjshëm. Pra, pikërisht kur ka nisur të akuzohen, pra procesi kundër aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, pikërisht Abdurrahim Islami është vendosur në krye të, në fakt është bërë pjesë e Prokurorisë Speciale dhe atë pa i plotësuar kriteret, sepse është njeri i klanit “Pronto” dhe klanit Mustafës dhe natyrisht që këtyre njerëzve u intereson që të kenë njerëz të tyre, në mënyrë që të montojnë raste të tilla.

Aktgjykimin e datës 19 dhjetor e kam lexuar dhe rilexuar disa herë, sot s’po ndalem unë, për shkak se do të kenë mundësinë deputetët e tjerë dhe është e turpshme, por edhe e dhimbshme që nga ana e atyre, të cilët janë zgjedhur për të vendosur drejtësi dalin aktgjykime të tilla politika, skandaloze e të paprecedent. Kam qenë po ashtu në seanca gjyqësore, secili pretendim i prokurorisë është dëshmuar që ka qenë i paqëndrueshëm e i montuar dhe dëshmon për pafajësinë e aktivistëve tanë. Madje, në seancën e parafundit, pra para fjalës përfundimtare prokurori Abdurrahim Islami e pranoi vetë, edhe atë po citoj: “Provat e marra në vendin e ngjarjes, analizat e ADN-ve dhe raportet e ekspertimit të pajisjeve elektronike nuk tregojnë për ndonjë lidhje në mes të akuzuarve dhe sulmit në Kuvend”. Mirëpo, këto fare nuk janë marrë parasysh si prova shfajësuese në favor të aktivistëve, sepse gjyqtari Kalludra kishte punë tjetër, puna e tij ishte manipulimi i provave, paragjykimi, inskenimi e dënimi në bazë të indiceve, me një fjalë, prokurori e gjyqtari thonë se ne e dimë që provat dëshmojnë pafajësinë e aktivistëve, por ama

krimin e kanë kryer në mënyrë të perfeksionuar, siç thuhet në aktgjykim. Kjo është skandaloze, është e dhimbshme, madje!

Pra, i gjithë ky proces ishte një shpërfaqje e luftës së egër të pushtetit të asaj kohe dhe klanit “Pronto” kundër nesh. Gjykata e Apelit më 22 shkurt e ka caktuar tashmë seancën gjyqësore lidhur me këtë aktgjykim skandaloz. Gjykata e Apelit duhet t’i japë fund kësaj farse, jo vetëm për shkak të aktivistëve tanë, por edhe për hir të drejtësisë, për të cilën aq shumë ka nevojë vendi ynë. Secili prej jush, por edhe kushdo tjetër jashtë kësaj salle, duhet ta dijë që Lëvizja “Vetëvendosje” nuk do të ndalet derisa të ketë liri të plotë për aktivistët tanë dhe, po ashtu derisa të ketë drejtësi për Astrit Deharin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit!

Që ky rast është i montuar fund e krye, këtë e di secili në Kosovë. Unë dua të ndalem në dy momente të këtij procesi: e para, është kualifikimi i veprës për të cilën u akuzuan aktivistët tonë, kurse e dyta, tek arbitrariteti i pashembullt i vendimit të gjykatës.

Pesha, ngarkesa dhe konotacioni i termit “terrorist” nuk lidhen thjesht me përcaktimet formale, taksative të Kodit Penal. Çfarë i vjen ndërmend sot një qytetari të zakonshëm kur shqiptohet ky term?! Vrasjet masive, sulmet vetëvrasëse e luftërat në Lindjen e Mesme. Duke ua ngjitur këtë damkë Astritit, Adeas, Frashërit, Egzonit dhe Atdheut, qëllimi primar ishte dënimi shoqëror. Terroristi është njeri imoral, irracional, i izoluar, shkatërrues dhe i rrezikshëm për shoqërinë. Pasi e quan dikë “terrorist”, duke arrestuar, thjesht e çon në vendin e tij, dhe duke qenë kështu edhe rrjedha e procesit kundër katër aktivistëve kishte karakter të përmbysur. Nuk kishim prezumim të pafajësisë për të filluar me hetim, shqyrtim të provave dhe pastaj vendim merititor përmes aktgjykimit. Jo! Ata fillimisht u dënuan, e pastaj u gjykuan si të dënuar, sepse siç thoshin, terroristi nuk mund të jetë i pafajshëm, apo jo? Duke na shpallur kështu të gjithëve terroristë, ata kishin disa qëllime, në rend të parë dëshiruan të na frikësojnë, dhe kjo nuk është e çuditshme, sepse bëhej fjalë për një rezistencë të jashtëzakonshme dhe të paparë, e cila ndodhi për herë të parë në një mënyrë kaq të organizuar prej pasluftës. Rezistencë kundër marrëveshjeve të dëmshme, të cilat këta duhej t’i arsyetonin në forma dhe mënyra të ndyta. Andaj, edhe filluan këto përpjekje për frikësim të qytetarëve përmes etiketimeve të tilla.

Tani më lejoni të kthehem tek administrimi i rastit. Të gjitha hallkat e aparatit shtetëror, nëse ju kujtohet, ishin koordinuar. Ishte një propagandë policore dhe ishte një polici propaganduese. Emisione inkriminuese një pas një për një javë rresht, aksione spektakulare policore me njësitet antiterror, konferenca shtypi ku ekspozoheshin armë e emisione të ndryshme me deklarata e intervista të prokurorit.

Mirëpo, fotografia doli e thyer. Kontrasti midis pesë të rinjve që po punonin, po shkolloheshin, po investonin për të ardhmen e vendit të tyre nuk shkonte me portretizimin monstruoz që regjimi projektonte për ta. Imagjinaria e terroristit nuk mbushet dot me fytyrat e tyre të kthjellëta. Vetëm 48 orë më pas, ata që fillimisht u cilësuan si armiq të popullit, ose ata që përbënin rrezik për shoqërinë, dy prej tyre u lanë në arrest shtëpiak, kurse ata që u mbajtën të izoluar për tre muaj nuk u vizituan nga prokurori, dhe historia vazhdon. Prokurori thotë se ky grup sulmoi Kuvendin me zollë. Në fillim u morën analizat e ADN-së nga vendi i ngjarjes dhe sakaq u vërtetua se ato nuk përputheshin me ato të të arrestuarve. Mirëpo, kjo nuk mjaftoi. Abdurrahim Islami tha se unë e di që këta janë sulmuesit, veçse fotografia nuk po i nxjerr qartë pamjet nga kamera.

Pastaj kërkoi ekspertizë deri në Byroën Federale të Hetimeve për këtë punë dhe kush më mirë se Amerika di ta bëjë këtë punë dhe edhe nga atje, përgjigjja ishte prapë negative. Për hir të së vërtetës, prokurori Abdurrahim nuk u bind, por e pranoi se provat që kishte s'vërtetuan bash asgjë. Mirëpo, absurdi dhe dështimi përfundimtar i sistemit gjyqësor ndodh kur paneli gjyqësor me Kalludrën në krye e beson tregimin e prokurorit që vetë kishte pranuar mungesën e provave dhe Kalludra shpall pa iu trembur syri: ti tetë vjet burg, ti gjashtë vjet, ti pesë vjet, ti dy vjet. Nuk duhet të harrojmë se duke qenë pjesë e këtij procesi, i persekutuar dhe i dhunuar, Astrit Dehari vdiq në burg, në rrethana shumë të dyshimta. Dhe, gjithë ky proces, nga arrestimi e propaganda nën akuzën për terrorizëm e deri te shpallja e vendimit pa asnjë provë, flet veçse për terror, mirëpo, të nderuar kolegë deputetë, ky është terror shtetëror ndaj njerëzve të pafajshëm.

Më 17 nëntor vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë përbën kalimin e kufirit të lejueshëm, asgjë më shumë s'mund të bëjmë. E kemi parë arbitraritetin e pastër pa asnjë shpjegim, pa mbështetje ligjore dhe mbi të gjitha, pa asnjë provë, as materiale dhe as gojore. Gjyqësia pa prova është inkuizicion. E mira në këtë rast është se dënimi prej 21 vjetëve është marrë vetëm në shkallën e parë. Pra, në këtë fazë nuk guxojmë t'i humbim shpresat, pavarësisht gjithë asaj që ka ndodhur. Besojmë që, megjithatë, në ditët në vijim do të ketë mundësi të korrigjimit të kësaj përndjekjeje të paparë të një grupi të të rinjve, të aktivistëve, të cilët u dënuan dhe po mbahen në burg pa prova, pa fakte, të pafajshëm dhe të cilët vendin e kanë në Universitet, e kanë vendin në qytet, në shtëpitë e tyre, pranë familjeve të tyre, e jo në Burgun e Dubravës, atje ku po mbahen edhe sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne besojmë se debatet janë të shëndetshme për demokracinë dhe për shoqërinë, por si deputetë duhet të jemi të kujdesshëm se për çfarë çështje jemi të thirrur të debatojmë.

Kuvendi nuk është arenë e zgjidhjes së problemeve të atyre që bien ndesh me drejtësinë. Duhet të vlerësojmë se sa janë në interes për publikun temat që ne trajtojmë. Debati i kërkuar nga Lëvizja “Vetëvendosje” është vazhdimësi e shumë kërkesave politike, që këta i kanë kërkuar dhe, siç dihet, zakonisht e keqpërdorin të drejtën e tyre procedurale për të thirrur seanca të tilla. Nëpërmjet kësaj synohet për të manipuluar me rastin dhe të goditet politikisht drejtësinë aty ku s’u pëlqen, e të lavdërojnë profesionalisht atëherë kur u pëlqen.

Duhet të dimë se sistemi i drejtësisë është i shkallëzuar dhe për këtë rast, për të cilin sot po debatojmë, akoma nuk kemi vendim përfundimtar të rastit konkret. Ky lloj i politikëbërjes synon t’i godasë të arriturat edhe ashtu jo të mjaftueshme në sistemin e drejtësisë në vendin tonë. Ky debat është tendencë e hapur për të krijuar huti dhe mosbesim në drejtësi tek opinioni publik, që më pastaj t’u jepet e drejtë veprimeve të tyre të mundshme, që mund të bien ndesh me ligjin në të ardhmen.

Pushtetet janë të ndara. Drejtësia është e ndarë nga politika dhe kushdo që ndeshet me të duhet të marrë përgjegjësi ligjore, e jo përgjegjësi politike. Është paradoks të thirret seanca për të debatuar dhe për t’i mbrojtur arrestimet e atyre që janë të dyshuar për vepra të dënueshme sipas ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës, ligje të cilat ne i kemi nxjerrë në këtë Kuvend. Ne jemi deputetë, nuk jemi as prokurorë për të kërkuar lartësinë e dënimit, nuk jemi as gjyqtarë për të gjykuar, nuk jemi as avokatë për ta kërkuar pafajësinë, por ne këtu duhet të kërkojmë që drejtësia ta kryejë punën e vet, të mos dëmtohet kurrkush nga drejtësia, por jo të interferojmë në drejtësi. Ky debat s’ka synim, për mendimin tim, për të trajtuar diçka humane. Është tendencë për të ndërhyrë në sistemin e drejtësisë dhe për habinë time dhe tuajën besoj, kjo po bëhet nga ata që çdo ditë thirren në sundim të ligjit. Nga ajo se çfarë në të vërtetë opinioni e di se ka ndodhur, është një fakt se dikush i ka sulmuar institucionet më të larta në vend, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe këtë vetëm drejtësia e zbardhë. Ne nuk mund ta zbardhim kush e ka sulmuar Kuvendin, por janë organet kompetente në këtë vend, të cilat do ta çojnë deri në fund dhe ne e përkrahim vendimin, i cili është në interes të drejtësisë, por jo, nuk jemi për një dënim, në këtë rast të aktivistëve, por as për ta mbrojtur dikë nëse ka bërë shkelje.

Ne këtu nuk paragjykojmë. Nëse flasim politikisht, atëherë ne të gjithë e dimë se kush i ka fryrë zjarrin dhe i ka mbështetur këto veprime, direkt apo indirekt. E dimë se mbi dyshime të bazuara për këto vepra e kemi një vendim gjyqësor të shkallës së parë. Dikush për interesa politike dëshiron ta keqpërdorë këtë Kuvend, të nxjerrë konkluzione që do ta dëmtojnë rëndë procesin gjyqësor me marrjen e vendimit përfundimtar rreth këtyre veprimeve, të cilat për momentin janë në procedurë gjyqësore.

Ky debat sot më jep një arsye më shumë që të besoj se po synohet të pengohet drejtësia, e jo të ndihmohet. Pa dyshim se kjo ka për qëllim t’i përkthejë vendimet e drejtësisë në vendime politike, e kjo jo që është shqetësuese sot, por është e dëmshme për të ardhmen e këtij vendi. Ne

jemi të vetëdijshëm se as qytetarët, as ne si deputetë, nuk u besojmë tendencave për të manipuluar me procese gjyqësore. Nëse shikojmë në retrospektivë të ngjarjeve dhe deklarimeve politike e publike të Lëvizjes “Vetëvendosje”, shihet tendenca e hapur për të përfituar politikisht nga ky rast. Jo vetëm nga sulmet ndaj institucioneve, por edhe nga fatkeqësitë e njerëzve, siç ishte rasti me të ndjerin Dehari.

Ne si deputetë kërkojmë që drejtësia t’i kryejë obligimet e saj, ashtu siç parasheh Kodi Penal dhe i Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Duhet të bindemi se pushtetet në këtë vend janë të ndara, e kemi pushtetin gjyqësor, legjislativ dhe ekzekutiv dhe nuk është mirë ne të interferojmë në sistemin e drejtësisë, por ta presim derisa të vijë një vendim përfundimtar.

Konsiderojmë se nuk duhet paragjykuar rastet dhe drejtësia nuk duhet penguar nga zbardhjet e saj. Kushdo që ka rënë ndesh me drejtësinë duhet të marrë përgjigje të merituar, sipas ligjeve që janë të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka kërkuar zonja Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Po, meqë iu referua fjalës sime, veç për të treguar se sa hipokrizi është kur prapa kamerave flasim tjetër gjë, e këtu pretendojmë ta mbrojmë atë, për të cilën jemi të sigurt që nuk është e vërteta.

Më 15 dhjetor 2017, Hajdar Beqaj ka shkuar në Burgun e Dubravës dhe i ka vizituar aktivistët tanë, dhe u ka uruar lirim, duke konfirmuar që është i vetëdijshëm, siç jemi të vetëdijshëm të gjithë ne se ata janë të pafajshëm dhe po mbahen aty padrejtësisht. Prandaj, të shkosh në Burg të Dubravës, t’i vizitosh, t’u thuash këto fjalë dhe të vish në Parlament e ta flasësh krejt të kundërtën, është shumë e pandershme, është hipokrizi dhe është e padrejtë, në rend të parë ndaj tyre, por edhe ndaj qytetarëve dhe në përgjithësi ndaj asaj që po përpiqet ta mbrojë sot deputeti.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Beqaj, kundër-replikë!

HAJDAR BEQAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Fillimisht nuk iu referova fjalës suaj, deputete. Është e vërtetë që në emër të komisionit kam shkuar dhe i kam vizituar edhe aktivistët e “Vetëvendosjes” dhe shumë njerëz që janë në burg, kemi qenë me punë zyrtare. Më ka ardhur keq, e them me sinqeritetin më të madh, për ata djem që janë në burg aty dhe kam thënë: “Inshalla nuk keni faj!”. Ata e dinë më së miri çfarë kam thënë. Dëgjo, më ka ardhur keq kur kam shkuar për çdo të burgosur, se unë i kam parë edhe këta, edhe njerëzit e UÇK-së i kam vizituar, kryesisht njerëzit që kanë qenë pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare. Kam thënë, “inshalla jeni të pafajshëm, ju e dini”. Drejtësia duhet të dalë në shesh dhe drejtësia në fund e thotë fjalën përfundimtare.

Ne nuk jemi ata që duhet të interferojmë në vendimin e drejtësisë dhe unë nuk jam pishman që kam shkuar e i kam parë. Edhe atyre, po të shkoja që prapë t'i shoh, do t'ua thosha të njëjtat fjalë, por ju nëse i keni keqpërdorur...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Përshëndetje, kryesues!

Kolegë të nderuar,

Sidomos ju kolegë të nderuar të “Vetëvendosjes”,

Këtu sot temë debati është një rast jashtëzakonisht i ndjeshëm. Është jashtëzakonisht i ndjeshëm edhe për faktin se këtu në këtë rast e ka humbur jetën një djalë i ri, një student i mrekullueshëm, një aktivist, një shqiptar i mirë, të cilin kam pasur rastin edhe ta njoh, edhe babanë e tij, edhe atë personalisht. Prandaj, nuk e kam lehtë të flas për këtë. U mendova të dal, a të mos dal të flas, megjithatë vendosa të dal të flas.

Pikërisht duke pasur parasysh faktin se përpos dënimeve të djemve dhe vajzës, e kemi rastin që një njeri, një djalë i ri, e ka humbur jetën, ai më nuk kthehet. Në burg kam qenë edhe vetë i dënuar, i kam mbajtur 5 nga 15 sa m'i kanë caktuar. E di që nuk është lehtë, por janë të gjallë, janë aty, janë djem të rinj dhe unë shpresoj shumë që e vërteta e tyre në fund të jetë edhe e vërteta e drejtësisë.

Unë nuk pres, as nuk dëshiroj që e vërteta e letrave të shndërrohet në të vërtetë përfundimtare. Jo pse unë jam i informuar, jo pse unë e di se si është, jo se e di se kush e ka bërë, apo kush nuk e ka bërë atë, por thjesht dua të besoj se në tërë atë aktivitet që ishim së bashku në kundërshtimin e dy vendimeve të padrejta të Qeverisë së kaluar nuk i ka shkuar dikujt mendja që të përdorë djem apo vajza për ta kaluar “rubikonin”, për të shkuar një hap më tej, për të përdorur mjete të cilat në asnjë rast, kur kemi bashkëpunuar në opozitë, nuk i kemi përdorur, as nuk i kemi përmendur, as nuk kanë qenë në rend të ditës. Pra, nuk dua të besoj se dikush ka mundur të shkojë aq larg. Prandaj, besoj që ajo e vërteta e tyre në fund të jetë edhe e vërteta e drejtësisë.

Ajo që thuhet, është bërë zakon të thuhet, se nuk është mirë të përzihemi në punët e drejtësisë. Do të isha njeriu më i lumtur të jetoj, të vijë një moment, ku jetoj, në Kosovë, në një vend ku drejtësia, politika, akademja, të gjitha të jenë të ndara, të gjithë t'i kenë punët e tyre, të punojnë sipas ligjit dhe sipas përkushtimeve dhe dedikimeve që ua jep ligji. Nuk jemi në atë situatë, nuk jemi në atë shoqëri. Nuk është seanca e parë që po flitet për rastet e drejtësisë. Shpresoj të jetë e fundit. Por, nuk e besoj. Nuk e besoj që do të jetë e fundit, për faktin se ende jemi shoqëri në tranzicion. Mirëpo, është rasti i parë për të cilin po flasim dhe që është kryekëput, krejtësisht, tërësisht, një rast të cilin e ka administruar drejtësia vendore.



Këtu në këtë sallë kemi mbajtur seanca kur na i kanë dënuar njerëzit në Hagë, kur na ka dënuar UNMIK-u, kur na i ka dënuar EULEX-i. Kemi mbajtur seanca, nuk po flas tash për raste veç e veç, sepse të gjithë e dimë për cilat kemi mbajtur dhe e dimë që kemi marrë kritika nga ata që na monitorojnë, ata që vazhdimisht na e përsëritin se këto gjëra duhet të ndahen.

Gjithsesi pajtohem, por mendoj se na nevojitet më shumë kohë sesa që të gjithë kemi dëshirë të përfundojë ky lloj i tranzicionit. Unë thashë dhe vazhdoj të besoj se nuk besoj që ne do të mund të ndihmojmë nga kjo foltore. Shoqëria është e ndarë në dysh, të gjithë e dimë. Dikush e beson një të vërtetë, dikush e beson një të vërtetë tjetër. Unë jam i vetëdijshëm, e di që fakti se nuk ke prova të mjaftueshme, askush nuk të jep të drejtë ta shpallësh dikë fajtor, për të mbuluar një çështje, por le të përqendrohemi, sidomos familjarët, “Vetëvendosja”, që atyre t’u ofrohet asistencë më e mirë e mundshme juridike vendore që ka dhe të vërtetën e tyre ta përçojnë bindshëm, ta dërgojnë bindshëm atje ku tash së shpejti do të merret vendimi.

Besoj që në shkallën e dytë, po e përsëris, të dalë në shesh e vërteta. Dhe, unë ju siguroj që kjo Qeveri, besoj që edhe pa ju thënë unë e dini, nuk ka qëllime të tilla për të ndikuar në drejtësi, në mënyrë që gjithsesi vendimet që mund të jenë të padrejta, unë nuk dua të paragjykoj këtu, jo se nuk jam në “Vetëvendosje” dhe me “Vetëvendosjen”, por se do të ishte një precedent jashtëzakonisht i keq dhe i rrezikshëm për demokracinë në vend dhe për zhvillimin e sistemit të drejtësisë në të ardhmen.

Nëse të gjitha këto që u thanë këtu arrihen të përcillen tek organi që do të vendosë në Apel dhe pastaj në Supreme, sepse me sa di unë është edhe një shkallë mbi Apelin, nëse nuk gabo, por sidomos në Apel të bëni gjithçka që është e mundur, që atje t’u ndihmohet në mënyrë profesionale. Ne këtu mund të shfaqim pikëpamjet tona, mendimet tona, dikush nga dhembja, dikush nga... ku ta di unë... motive të tjera, por dua të besoj që këtu secili nga ne kemi interes dhe qëllim dhe kemi dëshirë që asgjë, pos të vërtetës, të mos vulozet në asnjë proces gjyqësor, sidomos në raste të tilla, kur të gjithë e dimë se ka qenë një periudhë shumë e vështirë. Ka qenë një periudhë kur vendi ka qenë buzë një situatë shumë të rëndë. Nuk besoj se sot është vendi, koha, momenti, për të folur për ato rrethana, por le ta shndërrojmë këtë seancë në diçka, apo ta shfrytëzojmë në atë mënyrë që të përcjellim mesazh, ku nuk po kërkojmë asgjë më shumë sesa që drejtësia të vihet në vend.

Dhe, drejtësia vihet në vend më së miri kur, siç u tha edhe këtu, të gjitha klanet, kushdo qoftë, cilido klan, të heqë dorë nga sistemi i drejtësisë. Le t’i lënë t’i administrojnë provat që i kanë, dhe mbi bazën e provave le të sillat vendimi.

Unë në emër të “Nismës”, edhe një herë i shpreh ngushëllimet familjes. Ju them që neve na ka dhembur po aq sa atyre, por nëse jo po aq, së paku për aq sa na ka takuar na ka dhembur dhe vazhdon të na dhembë. Drejtësia për Astritin gjithsesi, tash besoj që me vendimin e

Kryeministrit, e me sa di unë edhe të Prokurorisë, të sistemit të drejtësisë, të bëhet aty ku familja kërkon, në Zvicër, do të vihet në vend dhe gjithsesi nuk duhet të ndalemi derisa të ndriçohet në tërësi e vërteta sesi erdhi momenti që e humbi jetën Astriti në ato rrethana.

Ndërsa, edhe një herë po e përsëris, le të ngadhënjejë drejtësia. T'u ofrojmë, edhe një herë po bëj thirrje, apel, mbështetjen dhe mbrojtjen sa më të mirë juridike të mundshme, në mënyrë që në fund të ngadhënjejë vetëm drejtësia. Asgjë më shumë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Arbër Rexhaj e ka fjalën.

ARBËR REXHAJ: Përshëndetje të nderuar qytetarë!

Përshëndetje të nderuar aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje”

Dënimi i Frashërit, Atdheut, Egzonit dhe Adeas më 21 vjet burgim nga një gjyqtar, i cili motivohet nga thëniet magjike të Hitlerit, sidomos pas asaj thënies së territ: “Kur je në terr, nuk të ndjekë askush!”, ka bërë që aktivistët tanë të cilët ende nuk e kanë mbushur pragun e 30-ve t'i fusë në terr. Mbase, i motivuar nga xhaxhai i tij ideologjik Hitleri, donte që aktivistët tanë të burgoseshin gjatë, e po të mund t'i linte përgjithmonë në terr. Dhe, në këtë terr nga një gjyqtar që nuk ka siklet të përdorë frymëzime fashiste, e që shfaqet i përkushtuar që me çdo kusht dhe me çdo çmim t'i dënojë pa asnjë provë të vetme, u përpoq t'i luftojë aktivistët tanë saktësisht siç kanë ditur fashistët t'i luftojnë, sepse nuk mjaftoi fakti që ADN-të e tyre të mos përputheshin me gjurmët nga vendi i ngjarjes, nuk mjaftoi fakti që në pajisjet e tyre elektronike nuk u gjet asnjë gjë e vetme inkriminuese, nuk mjaftoi ekspertiza e FBI-së që tha se asnjëri prej tyre nuk mund të lidhet me sulmin në Kuvend, nuk mjaftuan deklaratat e dëshmitarëve që thanë se asnjëri prej tyre nuk mund ta identifikojnë si pjesëmarrës apo të përfshirë në këtë rast, nuk mjaftuan deklaratat e dëshmitarëve që treguan se Policia u ka shtuar deklaratat pa dijeninë e tyre.

Nuk mjaftoi përgjigjja e “Google” që ishte tërësisht shfajësuese për ta. Nuk mjaftuan alibitë e tyre të pakontestueshme mbi vendndodhjen e tyre në kohën kur ishte kryer sulmi në Kuvend. Nuk mjaftoi terrorizmi që u shtrua mbi ta e përmbi ta për një vit e gjysmë. Nuk mjaftoi vdekja e dhunshme e Astritit, që po mbahej padrejtësisht në burg.

Jo rastësisht, gjykatësi Beqir Kalludra me ngulm insistonte që ky proces të kryhej para balotazhit, dy ditë para zgjedhjeve lokale. Në këtë mënyrë ai donte ta dëmtonte Lëvizjen “Vetëvendosje” edhe në rezultatin zgjedhor. Pushteti i kaluar i Kosovës duhet të japë llogari për vdekjen e dyshimtë të Astrit Deharit, sepse ai ka vdekur në duart e shtetit, në vendin që do të duhej të ishte vendi më i sigurt në botë. Ai ka vdekur nga asfiksia, zënia e frymës nga një mjet i fortë. Mbase vdekja e tij po tentohet të harrohet dhe stërzgjatja e hetimit ndaj vdekjes së dyshimtë të tij po bëhet qëllimisht, sepse ata e vranë Astritin dhe tash duhet ta vrasin edhe emrin e tij me harresë.

Dhe, sigurisht që ata nuk duan assesi ta bëjnë këtë. Institucionet dhe drejtuesit e tyre përgjegjës për rastin duhet të japin llogari menjëherë. Asnjëri prej tyre nuk e bëri këtë atëherë kur duhej. Nuk pati asnjë dorëheqje dhe asnjë shkarkim nga pozita në kohën e duhur. Si zakonisht, ato pak thirrje në përgjegjësi që i bëri Dhurata Hoxha, u bënë tepër vonë dhe pa efekt. Dhurata Hoxha atëherë si ministre e Drejtësisë, edhe pse tash e ka ndërruar dikasterin, ajo vazhdon të jetë në Qeveri. Nuk ndodhi as shkarkimi i Shpend Maxhunit, që është drejtor i përgjithshëm i Policisë, as i Nexhmi Krasniqit, komandant në rajonin e Prizrenit, as i Fatos Makollit në kuadër të Policisë si drejtor kundër terrorizmit që paraqiti para opinionit fakte të rreme.

Nga Këshilli Prokurorial kemi kërkuar shkarkimin e tre prokurorëve që ishin të kyçur në rastin e pesë aktivistëve: Sylë Hoxha, Metush Biraj dhe Abdylrrahim Islami. Në një shtet normal, ku një qytetar, një aktivist politik e humb jetën mbi baza të dyshimta në burg, do të duhej të kishim dorëheqje apo shkarkime. Asnjëra prej këtyre nuk ndodhi, përkundrazi pati dënime të motivuara politikisht. Dhe, pikërisht për këtë, rasti Dehari u vazhdua me persekutim politik të montuar ndaj aktivistëve: Frashërit, Atdheut, Egzonit dhe Adeas me dënime me burg. Ata duhej të dënoheshin patjetër, madje pa bërë fajin, njëjtë sikur Josefi i “Procesit” të Kafkës, sepse ishte një proces i cili duhej të përfundonte. Përndryshe, pafajësia e tyre e shpallur në gjykatë do të ishte një fajësim i madh për gjyqtarët, prokurorët dhe zinxhirin komandues të Policisë për rastin e aktivistëve dhe rastin e Astritit.

Në Kosovë, aktivistët politikë nuk duhet ta kenë fatin e “Procesit” të Kafkës në asnjë mënyrë. Nuk duhet të tolerojmë procese të tilla, ku vriten e dënohen njerëz të pafajshëm, sepse kanë padëgjueshmëri qytetare. Ndaj këtij rreziku ne duhet të reagojmë dhe padrejtësitë në realitet duhet t’i ndalojmë me çdo kusht.

Astrit Dehari dhe katër aktivistët tanë të dënuar me 21 vjet burg nuk e kanë bërë asnjë faj, përpos se kanë protestuar si mijëra qytetarë të Republikës së Kosovës kundër padrejtësive dhe kundër “Zajednicës” e demarkacionit të padrejtë. Ata u arrestuan, u burgosën, u dënuan e Astriti u vra në duart e shtetit, vetëm pse janë aktivistë të Lëvizjes “Vetëvendosje”. Kjo padrejtësi duhet të marrë fund, herët a vonë.

Por, do të ishte në nderin e kësaj Qeverie që t’i ndërmarrë masat për shkarkimet e zyrtarëve të përfshirë në këtë rast të rëndë, edhe këtë pa vonesë, përndryshe edhe këta do të bëhen përgjegjës për vonimin e zbardhjes dhe vendosjes në vend të drejtësisë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

**MILAIM ZEKA:** Faleminderit, kryetar!

Në radhë të parë, seanca e thirrur nga Lëvizja “Vetëvendosje”, të gjithë po e dimë se është një seancë politike, por është edhe një seancë që në të shumtën e rasteve i ngjan pak ish-

kryeministrit Thaçi, që sa herë që krijoheshin kriza rreth tij, ai tak e qitke njëfarë 'bedati', thërriste "duam ta bëjmë ushtrinë..." për ta kaluar opinionin e qytetarëve te problemet reale në probleme, të cilat ne sot me këtë seancë nuk do t'i zgjidhim. Pse nuk do t'i zgjidhim? Sepse, këtu nuk është problem gjykatësi Kalludra, as Makolli, as Milaimi, por është problem sistemi dhe për këtë sistem nuk dëshiron as Lëvizja "Vetëvendosje", disa individë, nuk po them të gjithë deputetët, të bëjmë ndryshme, as ndoshta ne deputetët tjerë.

Ne shohim këtu në Parlament se ka njerëz, deputetë, kolegë që flasin me paragjykime dhe në raport me drejtësinë. Kur u konvenon atyre, ajo që e bën gjykata, prokuroria, hetuesit kundër aktivistëve të "Vetëvendosjes" qenka e gabueshme, qenka e dënueshme, qenka shkelje ligjore, kur e bën kundër deputetëve të tjerë, qenka krejt normale, qenka faktike, paska prova. Këto paragjykime janë, nën një, fillim i injorancës së njeriut, nën dy, janë konfrontim i madh ndërnjerëzor mes kolegëve, mes partisë dhe ndoshta janë pikërisht paragjykime të tilla që kanë sjellë edhe shkatërrimin e partive të ndryshme politike, qoftë majtas, qoftë djathtas, qoftë në mes.

Unë po i referohem një deputeti, i cili në seancën paraprake gjuajti pak me rrotulla, por unë nuk jam i prirë t'i paragjykoj kolegët e mi, të cilët janë dënuar nga gjykata për terrorizëm. Në mënyrë absolute nuk i gjykoj ata, sepse boll i ka dënuar gjykata dhe nuk është në nderin e në etikën time edhe unë t'i paragjykoj, t'i dënoj edhe një herë.

Nuk më ka ardhur fare mirë, përkundrazi, përkundrazi, qoftë edhe për Frashër Krasniqin, me të cilin unë kam pasur një konflikt fizik. Më ka ardhur tepër rëndë në momentin kur e kam marrë lajmin se është dënuar tetë vjet, në mos për asgjë tjetër, për atë se unë jam i dënuar më 81, jam djalë i vetëm sikurse Frashëri dhe kam menduar çka mendon nëna e Frashërit në momentin që i shkon lajmi se djali iu dënuar tetë vjet. Edhe për deputetë të tjerë, pa hyrë në atë që mua nuk më takon, a janë dënuar me fakte, me prova a pa fakte, sepse ne e dimë që përtej "Procesit" të Kafkës, e kemi pasur këtu procesin e rastit Kiçina.

Ne kemi me qindra e mijëra padrejtësi që janë dënuar njerëzit faj e pa faj, por nuk e rregullojmë ne sistemin e drejtësisë duke folur mirë për vete e keq për atë tjetrin.

Të krijojmë një komision hetimor parlamentar, e të hetojmë prokurorinë dhe gjykatat mbi bazën e të cilave fakte po i dënojnë ata njerëz.

Zoti kryesues, unë kam fakte që hetuesit e Policisë në Pejë gjatë kontrollit ia kanë futur dy gramë kokainë një mërgimtari tonë në Gjermani vetëm pse ka para.

Ne kemi fakte se në çfarë mënyre i bëjnë montimet policët hetues të Kosovës, një pjesë e tyre, e kryetari i Parlamentit një ditë tha qysh mund të na marrë në pyetje ne një hetues kur e ka në dorë orën 30 mijë euro.

Unë pajtohem plotësisht me fjalën e Rexhep Selimit, po tash sjellja e policëve nuk mund të jetë e keqe ndaj “Vetëvendosjes” dhe e mirë ndaj deputetëve ose ndaj qytetarëve të tjerë, o është e mirë, o është e keqe.

Tani, e kam një shqetësim edhe më të madh: qysh nuk u kujtua asnjë deputet, asnjë anëtar i Kryesisë t’ia bëjë një pyetje kryetarit të Parlamentit të Kosovës, zoti Kadri Veseli, a ia ke drejtuar t’i ndonjë shkresë ndonjëherë kryeprokurorit Lumezi, kryeprokurori a ka dhënë ndonjëherë raport para Kryesisë dhe para kryetarit të Parlamentit, apo kujt t’i teket mund të na arrestojë neve sikur na të ishim rrugaçë, jo deputetë të Parlamentit të Kosovës.

Prandaj, kjo më shqetëson mua, më shqetëson ndërtimi i sistemit të padrejtë gjyqësor, më shumë më shqetëson kjo se sa dënimi i kujtdo qoftë, brenda a jashtë sallës.

Mbi bazën e kësaj po u bëj thirrje të gjithëve si kolegë, pozitë e opozitë, ta ndryshojmë sistemin, sepse pa e ndryshuar sistemin, kot e kemi. Ne e kemi faktin kur në Inspektoratin e Policisë së Kosovës, për shembull, ata që kanë qenë duke e hetuar krimin dhe e kanë nxënë njeriun në flagrancë, ky që zihet në flagrancë gradohet, këta që i bëjnë hetimet, përjashtohen prej pune.

Prandaj, edhe një herë ju bëj thirrje, leni paragjykimet, ta kuptoni që sistemi i drejtësisë është i kapur, as bile ne nuk po e dimë as pas kujt është i kapur, se është aq keq i kapur e nuk po e dimë a e kontrollon Hashim Thaçi, a e kontrollon Kadri Veseli, a e kontrolloj unë, a e kontrollon “Vetëvendosja”. Dëgjoni, aq është krimi i thellë në hetuesi të Policisë së Kosovës, që po ta dija unë në kohën kur kam qenë gazetar që aq janë zhytur në krim hetuesit e Policisë së Kosovës, ju garantoj me jetë që së bashku me gruan dhe fëmijët e mi isha kthyer në Kosovë. E të mos shesin këtu moral: o e dini, o nuk e dini. Në qoftë se nuk e dini, mos kallëzoni përralla, në qoftë se e dini, hajde ta krijojmë komisionin, t’i hetojmë këta, t’i hetojmë prokurorët. Në gjykata vjen prokurori me duar në xhepa.

A e dini ju, të nderuar deputetë, që gjykatësi i Kosovës është vetëm noter i prokurorit, nuk është gjykatës, është noter i prokurorit, faqezi, kriminel, që çka t’i thotë, ai veç i thotë mirë e ki, mirë e ki, mirë e ki dhe kjo më shqetëson. Le t’i dënojnë ata, pse i kanë dënuar për terrorizëm, tanë e dimë, unë personalisht po them, në jetën time nuk mendoj që ata djem janë terroristë, në mënyrë absolute. Por, sistemi është terrorist këtu, sistemi është bërë terrorist dhe këtë sistem terrorist ne mund ta rrëzojmë vetëm në qoftë se bashkohemi pozitë dhe opozitë dhe e hetojmë edhe prokurorinë, edhe hetuesinë. Kaq. Faleminderit dhe më vjen shumë keq edhe për Astritin, se tash edhe unë po shes pak patriotizëm. Unë i njoh prindërit e Astritit dhe s’e di a ka ndonjë njeri që nuk i vjen keq për Astrit Deharin. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Po më duket, po e teprojmë pak, institucionet kushtetuese të Kosovës janë të përcaktuara, rregullat janë dhe nuk është mirë të flitet paushall dhe të fyhen të

gjitha institucionet e drejtësisë. Tash po u dashka t'i fyejë secili që flet këtu, pa argumente. E kemi një rast, ndoshta nuk është dashur të diskutohet këtu, është dashur ta kenë besimin tonë në drejtësi, po mos e teproni në formën që e dëgjova tani, nuk është krejt ashtu zi, besoj, Kosova, nuk është krejt ashtu zi.

Zoti Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: Të nderuar qytetarë të Republikës,  
Të nderuar deputetë,

Sa për informatën tuaj, ne këtë debat parlamentar e kemi kërkuar më 7 dhjetor 2017 dhe po ashtu u tha pak më herët, desha veç ta konfirmoj që Lëvizja “Vetëvendosje” ka reaguar sa herë ka vërejtur padrejtësi, qoftë për rastin Kiçina, qoftë edhe për rastet e arrestimit të ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Besoj që të gjithë i mbani në mend edicionet e lajmeve të Radiotelevizionit të Kosovës, muaj rresht para sulmit të ndërtesës së Kuvendit të Republikës që ndodhi më 4 gusht 2016.

Mediumi i kapur nga Hashim Thaçi e Kadri Veseli, që keqpërdorën në mënyrë më të rëndë hapësirën publike, që është besuar me ligj nga shoqëria, për muaj me radhë u përkujdes që në edicionet e lajmeve të mënyrë të hapur apo të tërthortë të sulmojë Lëvizjen “Vetëvendosje”.

Besoj i mbani në mend edhe lajmet nga gazetatat e shkrimet në mediat e pushtetit, të gjitha në lajme, tekste, në mes të rreshtave e si pa dashur të vërehen bënin përdorimin e termave “rrezik”, “terrorizëm”, “gjuhë e ashpër”, “subjekt politik”, Lëvizja “Vetëvendosje”, thuajse insistoni që domosdo në mendjen e qytetarit të bënin një lidhje në mes të këtyre fjalëve.

A thua se shkruanin skenarë ose kishin marrë detyrë që nga përsëritja e tepërt e këtyre termave të synonin t'i paraqisnin si të vërtetë.

Sikurse besonin që duke përsëritur shumë gënjeshtër bëhet e besueshme, si të jetë e vërtetë.

Me të njëjtën logjikë vazhdojnë të thurni lavdin e edicionit qendror për Thaçin e Veselin ose tentojnë t'u japin ngjyrimet pozitive rezultateve të punës së tyre herë skandaloze, e herë fatale për politikën e vendit tonë.

Po t'u kthehem lajmeve të asaj kohe e gjuhës së përdorur, nëse i shihni me informata që kemi sot, e ngjarjet që ka ndodhur të duket thuajse për disa media e disa persona në Republikën tonë koha ecën mbrapshtë.

Pra, të duket që për ata që njëherë vjen 30 gushti, e më pas 29 gushti, më parë vjen 4 gushti, e më pastaj ta zëmë, 5 qershori.

Si shembull, mund ta lexoni komunikatën e lëshuar nga Radiotelevizioni i Kosovës ose më mirë të thuhet komunikatën e Qeverisë më 29 gusht 2016 dhe do ta vëreni se ata e dinë paraprakisht kush është i akuzuar për terrorizëm.

Pak a shumë, sikur të jetojnë në një realitet si personazhi i filmit hollivudian Benjamin Button.

Vlen të theksohet që as nuk u përmend më ç' ndodhi me hetimet e policisë për sulmet e fundit të gushtit 2016, e që me aq shpejtësi reagoje Qeveria e Veselit, duke bërë ndërlidhjen e sulmeve me një subjekt parlamentar opozitar, Lëvizjen “Vetëvendosje”.

Në natën mes 29 dhe 30 gushtit policia nën dyshimet për terrorizëm arrestoi Astrit Deharin, Egzon Halitin, Adea Batushën, Atdhe Arifin dhe Frashër Krasniqin.

Aktivistët tanë u mbajt në paraburgim për muaj të tërë, pa u marrë fare në pyetje.

Ndërkohë Policia bënte shfaqje pompoze, me paraqitje qesharake për ndërlidhjen e aktivistëve tanë me rastin.

Më 5 nëntor 2016 në Burgun e Prizrenit vritet aktivisti e studenti shembullor, Astrit Dehari.

Vetëm disa ditë pasi Kadri Veseli, mu në këtë sallë, në Parlamentin e kësaj Republike, u tha deputetëve të “Vetëvendosjes”: “Kujdes, mos e vrani veten”.

Atë të shtunë kur u vra Astriti, komandanti i Policisë së Rajonit të Prizrenit deklaroi që ai është vetëvrasës me medikamente, më pas u vërtetua që vdekja e Astritit u shkaktua nga asfiksia mekanike. Prokuroi shumë shpejt shpalli vetëvrasjen dhe hetimet u mbyllën.

Familja angazhoi ekspertë të pavarur, e raporti i tyre theksoi diçka krejt tjetër nga rasti i obduksionit, i përgatitur nga Komisioni mjekësor.

Pas publikimit të raportit të ekspertëve të angazhuar nga familja, ministrja e Drejtësisë atë kohë, Dhurata Hoxha, kërkoi të kryhen hetime për keqpërdorim të detyrës zyrtare ndaj avokatit Tomë Gashi, ekspertit të mjekësisë ligjore Besim Ymaj dhe patologut Besim Latifaj, të cilët kanë marrë pjesë në obduksionin e Astrit Deharit.

Personi që ka qenë në të njëjtën qeli me Astritin dhe potencialisht dëshmitari kryesor për këtë rast vdiq disa muaj më pas në Burgun e Lipjanit. Për një vit Qeveria pamundësoi hetimin e pavarur ndërkombëtar për rastin.

Tri ditë para se të vdiste në ditarin e tij Astriti shkroi: “Ditën po jam i qetë, nuk po kam probleme, e njëjta vlen edhe natën, i vetmi interval në të cilën sadopak po kam brengë e mërzi është zgjimi në mëngjes. Përkundër pafajësisë së plotë, jam duke përgatitur veten për gjithçka, dënim të gjatë, tortura, tortura, shpifje”.

Një vit pas vrasjes së Astrit Deharit, trupi gjykues, i kryesuar nga gjyqtari Beqir Kalludra, shpalli fajtor aktivistët tanë, duke i dënuar me 21 vjet burgim.

Njëherë i mbajtën në paraburgim, pa i marrë në pyetje, derisa e mbytën Astritin, e më pastaj i dënuan katër aktivistë të tjerë, si për të dashur ta arrestojnë mbajtjen e Astrit në paraburgim.

Asnjë dëshmi e përdorur për rastin nuk dëshmon lidhjen me aktivistët tanë të akuzuar. Nuk janë nxjerrë profilet e ADN-ve, ndërsa edhe vetë FBI ka deklaruar që me dëshmi të përdorura nuk mund të faktohet që bëhet fjalë për persona të akuzuar.

Dëshmitari kryesor ka deklaruar në seancë gjyqësore që pamja e aktivistëve nuk përkon me personat që kishte parë datën e 4 gushtit. Megjithatë, gjykata vendosi që t'i shpallë aktivistët fajtorë pa fakte. Në aktgjykimin për rastin shkruan:

“Ndërsa sa i përket çantës ngjyrë kafe me të cilën është bartur raketa hedhësi dhe vetë raketa hedhësi shtytës i predhës antitank, sipas raportit të ekspertimit të Agjencisë Kosovare për Forenzikë, laboratorit për serologji dhe ADN i datës 18 gusht 2016 nuk është fituar ndonjë profil i ADN-së”.

Pra, aq të kujdesshëm kanë qenë tani të akuzuarit Egzoni dhe Atdheu, sa që kanë marrë masa preventive që të mos lënë gjurmë që mund të bëjnë identifikimin e tyre.

Një rast tjetër i paprecedent për këso formulimesh.

Trupi gjykues merr vendim duke u bazuar në paragjykim, pra gjykata merr vendim edhe nëse nuk mund ta bazojë në fakte.

Sipas kësaj, secili qytetar i Republikës mund të akuzohet e të shpallet fajtor për një krim përderisa përshtypja e trupit gjykues të jetë që ai person është i fajshëm.

Tash në shtetin tonë, secili mund të akuzohet e të dënohet për secilin krim.



Këta e kanë kthyer përmbys parimin e drejtësisë: “Më mirë dhjetë fajtorë në liri se një i pafajshëm në burg”.

Këta e kanë bërë parim të pafajshmit aktivistët e drejtësisë në burg, që shefi të qëndrojë jashtë.

Këta i kanë kthyer përmbys institucionet që quhen të drejtësisë dhe i kanë bërë institucione të padrejtësisë.

Këta që e bënë ‘sui generis’ Republikën, po e bëjnë ‘sui generis’ edhe sistemin, e që quhet i drejtësisë.

Së dyti, përderisa mund të shpallin fajtor secilin që ia merr mendja trupit gjykues, është për t’u theksuar që zgjodhën të akuzojnë e të dënojnë padrejtësisht aktivistë politikë të “Vetëvendosjes”.

Këta mbytën dhe dënuan aktivistin shqiptar aktiv në Kosovë, Astritin, me prejardhje nga Kumanova, që angazhohej pa ndërprerë për drejtësi e zhvillim të shtetit të tij dhe kombit.

Këta vazhdua traditën e dënimit e vrasjes së shqiptarit të angazhuar aktivisht për ndaljen e shtypjes së padrejtësisë ndaj tij.

Forcuan rrënjët e padrejtësisë, duke i institucionalizuar edhe në sistem të drejtësisë.

Këtyre që Republikën, për të cilën u luftua gjatë, na e ndanë nga UÇK-ja që po e ndryshojnë historinë që rreken në dreka e darka që edhe sot e kësaj dite na lanë të varur nga Beogradi, çdo ditë e më shumë po u bie maska, pas së cilës janë fshehur.

Qytetarë të Republikës,

Aktivisti politik shembullor vdiq në burg i pafajshëm, aktivistët e tjerë na i dënuan me burgim nga gjykata, pa fakte, edhe pse me emër tjetër e në gjuhën tonë, historia po përsëritet. Sado që po ndryshojnë ngjyrat, nuancat, karakteri i shtypjes po mbetet i njëjtë.

Shqiptarët e mbetur jashtë Republikës së Shqipërisë për shumë gjenerata vazhdojnë të jetojnë në shtete që vrasin aktivistët më të mirë politikë e gjykata që dënon vetëm pse njeriu ka qenë i zëshëm ndaj padrejtësive.

Në këtë rast padrejtësinë...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues,

Të nderuara kolege,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë sot do të fokusohem kryesisht në gjendjen e gjyqësorit dhe të sektorit të drejtësisë në Republikën e Kosovës, duke e ilustruar këtë gjendje me një shembull të vetëm, i cili nuk përbën ndonjë përjashtim as absolut, as relativ, por përbën rastin më të rëndë, më tragjik, për nga pasojat të katandisje së gjyqësorit dhe të drejtësisë kosovare në përgjithësi, në sektorin e drejtësisë, ku përfshihen Policia, Prokuroria edhe Gjyqësori.

Deri tani u fol në terma politikë e ligjorë për rastin e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje” dënuar me mbi 21 vjet burgim, po natyrisht këtu nuk u fol për përndjekjen disavjeçare të anëtarëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”, që në mënyrë kumulative kanë marrë mbi 6 vjet burg të shqiptuara.

Nuk u fol as për rastin e arrestimit dhe të mbajtjes në burg të anëtarit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, profesor Sadri Ramabajës, i cili tani e disa muaj mbahet në burg në mënyrë krejtësisht të pafajshme, pa aktakuzë, pa asnjë fakt apo dëshmi të vetme nën akuzën e zakonshme për anëtarët e Lëvizjes “Vetëvendosje”, për terrorizëm.

Profesor Ramabaja mbahet sot në burg për shkak se është autor librash, mësimdhënës universiteti dhe për shkak se redakton libra të tjerëve.

Sidoqoftë, unë po kthehem në temën konkrete në dënimin e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje” nën akuzën për terrorizëm.

Ky shembull që do të paraqes është dëshmi se gjyqësori i Kosovës jo veç është i kapur, po edhe u përmend përpara, është i ngufatur tërësisht, i janë zgurdulluar sytë dhe është para vdekjes, ky është problemi kryesor.

Unë dua të filloj me gjuhën origjinale të kryetarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë që ka përdorur në aktgjykimin që është, megjithatë, dokument zyrtar.

Ai fillon me gjuhë të tillë: “Në rrethana shumë specifike që thuaj se nuk ka ndodhur në praktikën gjyqësore, ua zë për të madhe aktivistëve tanë që të akuzuarit nga momenti i parë i marrjes në pyetje u mbrojtën në heshtje”. Pastaj i akuzon thonë: “Por të njëjtin nuk qëndruan besnik ndaj këtij parimi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor kundërshtuan provat dhe parashtruan pyetje, bile”. Merrni me mend, ky është problemi që ka gjyqtari. Bile pyetje me karakter kërcënues edhe palëve, edhe dëshmitarëve, këto askush nuk i ka konstatuar. Kundërshtuan dëshmitë e dëshmitarëve, sepse ato duhet të pranohen, sipas tij, bënë vërejtje, paraqitën alimet fjalime e fjalë përfundimtare prej shumë faqesh, e këtu u dallua edhe udhëheqësi i këtij grupi, Frashër Krasniqi. E konstaton gjykatësi, se u dallua shefi i grupit.

Dhe, nëse shihet volumi i fjalës përfundimtare, automatikisht konstatohet se ky është shefi, dhe po të shihet çka thuhet këtu, vlerësimi moral i veprimeve ligjore kualifikohet si rrethanë rënduese. Kjo është gjykata e Kosovës, kësaj i thonë hesht, nuk bën, fol, nuk bën, logjika e tillë e përjashton ekzistencën e njeriut.

Kemi edhe margaritarë të tjerë që duhet të lexohen në këtë aktgjykim. Thotë se aksidentalisht nga goja e njërit të akuzuarve, një djalë i shkolluar me almet diploma, janë bërë gabime, edhe gjykata vlerëson kështu qëndrimin e tij, ky djalë nuk e mohon ekzistimin e një fakti real që instinktivisht u pranua, domethënë hyn në psikologji dhe këtu sipas gjykatësit, i thonë instinkt natyror i të vërtetës në raport me vetëdijen. Ky është psikologu i gjyqësorit kosovar dhe kjo çka e them tash është maja.

Edhe ky thotë se “vetëdija kriminale djallëzore për një moment nuk ishte e kujdesshme...” Kjo është gjuha juridike e një gjyqtari në Republikën e Kosovës, mbani në mend, këto fjali, këto shprehje do të mbesin në arkivat e gjyqësorit të Republikës së Kosovës, kjo është e vërteta e vetme.

Unë e pranoj se ne nuk jemi engjëj, ashtu si nuk jemi edhe djaj, po të ishte kjo gjuhë e përdorur në xhami a në kishë, u konceptet e djallit dhe të engjëllit janë ndër konceptet qendrore dhe përdoren për shërbimin, për shpëtimin e shpirtit në botën e përtejme, kjo do të ishte krejt e zakonshme, po kjo gjuhë mbetet trashëgimi e dokumentuar në gjyqësorin kosovar, institucion i cili nuk duhet të merret me shpëtimin apo dënimin e shpirtit në botën e përtejme, por merret në përcaktimin e fajësisë ose pafajësisë në këtë jetën tonë tash.

Ne kemi edhe shumë gjëra të ndryshme që mund të nxirren nga këto, mirëpo shprehjet e përdorura nga gjykatësi Kalludra, “instinkt natyror i vetëdijes intelektuale”, “vetëdije kriminale djallëzore”, janë shprehje të përziera të karakterit parapsikologjik, religjioz, me mendësi naziste, prirjen për një mendësi të tillë e ka dëshmuar ky gjykatës edhe me citimet në statuset e veta në Facebook, ne e kemi edhe një varg faktesh tjera që janë të tmerrshme, që janë përdorur dhe i përmendën kolegët e tanë, por unë dua të them diçka tjetër. E ajo që dua të them, në pjesën për provat shfajësuese, në të gjitha ekspertizat e ADN-së, grafologjisë, daktiloskopisë, raportit të FBI-së, mandej raportit të ekspertimit të Agjencisë Kosovare të Forenzikës, Laboratori për Serologji, mandej raporti i ekspertimit të armëve të zjarrit, të gjurmëve relevante dhe të veglave të gjetura, mandej raporti i ekspertimit për eksploziv. Raporti i ekspertimit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë konstaton se nga dëshmitë e marra për ekspertim janë nxjerrë profile të ADN-së të Adea Batushës, Frashër Krasniqit, Atdhe Arifit, Egzon Halitit dhe nuk janë fituar profile që përputhen me profilet e gjetura në vendin ku ka ngjarë ajo.

Ne e kemi edhe raportin e ekspertimit të Agjencisë Kosovare të Forenzikës. E kemi raportin e Drejtorisë së Teknikës Kriminalistike. E kemi raportin po ashtu të Agjencisë Kosovare të

Forenzikës më 9 gusht. Kemi po ashtu raport të Forenzikës që konstaton dhe nuk kanë dhënë ndonjë mundësi identifikimi, ndërsa me disa nga këto prova nuk ka qenë e mundur të bëhet ekzaminimi daktiloskopik. Edhe në raportet e vëzhgimit të Adea Batushës, që është vëzhguar shumë ditë, është përcjellë nga Policia, vërtetohet se tani e akuzuara Batusha është vëzhguar, monitoruar në lëvizjet e saj dhe nëpërmjet tyre nuk vërtetohet ndonjë fakt relevant në këtë çështje penale. Ne kemi edhe konstatime jashtëzakonisht të tmerrshme të kësaj gjykate, që të gjitha provat shfajësuese që janë prova materiale të vërtetuara shkencërisht nuk dëshmojnë asnjë lidhje ndërmjet sulmit të kryer mbi Kuvendin e Kosovës edhe aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Po të lexohet me kujdes, pa pasur nevojë që dikush të jetë jurist, vërtetohet se të gjitha akuzat janë inskenime. Prandaj, për fund, duke qenë se i gjithë aktgjykimi bazohet në thashetheme krejtësisht të padëshmuara, të pavërtetuara, të pabazuara, dhe kur të gjitha provat materiale, dëshmitë objektive të analizuara nuk i lidhin aktivistët tanë, në mënyrë të logjikshme shtrohet pyetja: Kush janë aktorët e vërtetë të sulmit me armë zjarri natën e 4 gushtit 2016? Kush është organizatori dhe zbatuesi i projektit të inskenuar për burgosjen e aktivistëve për këtë sulm? Kush janë ideatorët e këtij inskenimi monstruoz kundër aktivistëve të Lëvizjes? Kush e vrau Astrit Deharin në Qendrën e Paraburgimit në Prizren dhe në mënyrë logjike për shkak të këtij inskenimi monstruoz, për shkak të involvimit të drejtpërdrejtë, për shkak të përpjekjes së kundërligjshme për t’i dënuar aktivistët tanë, për shkak të dyshimit të bazuar në involvimin e drejtpërdrejtë të qarqeve të larta të Policisë së Kosovës, Prokurorisë Speciale dhe Gjyqësorit, kërkojmë nga ky Kuvend që për rastin e sulmit në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 4 gusht, të kërkohet dhe të mundësohet një hetim i plotë i pavarur ndërkombëtar i tërë rastit nga ndonjëri nga vendet perëndimore në Bashkimin Evropian, përfshirë edhe vendet neutrale të Evropës Perëndimore, edhe Zvicrën, veçmas rastin e Astrit Deharit. Po ashtu, kërkohet shkarkimi i...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Tash unë po ia filloj prej njëfarë lloj qëndrimi politik, i cili zakonisht vjen prej qarqeve të ndryshme të pushtetit, i cili pikënisjen e vet për ta justifikuar këtë çfarë i ndodhi “Vetëvendosjes” e ka këtë klisheë e zakonshme, që tashmë ka marrë njëfarë forme të etabluar që duhet t’u besojmë institucioneve. Dikujt duhet t’i besojmë. Tash unë po dua të dekonstruoj këtë qëndrim të pushtetit, është edhe Forenzika e Kosovës institucion i Kosovës?!

Tash ju po thoni nuk duhet t’i besojmë institucionit të Kosovës, por duhet t’i besojmë prokurorit, i cili nuk i beson institucionit të Kosovës. Kjo është skandaloze! Ne do t’u besojmë atyre që qëndrimin e institucioneve e interpretojnë varësisht a është në funksion të dënimit të

“Vetëvendosjes”, apo jo. Kjo është besueshmëria në institucione sipas kategorisë politike të pushtetit, qysh e mendon pushteti besueshmërinë në institucione. Tash këtu është vërejtur që ky rast ka dimension të qartë politik menjëherë pas sulmit të 4 gushtit 2016. Pse? Sepse, për 20 ditë Policia ka hetuar me një pistë tjetër, e ka hetuar në pistën në të cilën duhet të hetohet. Kjo tregon që pushteti nuk ka mundur që krejt procesin, se është e pamundshme edhe në shtetin më të kapur, ta projektojë manipulimin në të gjitha hallkat e sistemit. Edhe policët që aty e nisnin ta hetojnë këtë rast, janë ata që nuk e dinë vendimin politik dhe hetojnë në një drejtim të caktuar, bash në drejtimin e kriminelëve, në drejtimin e kriminelëve të vërtetë.

Po, më 25 gusht vjen një vendim politik. Nuk e di prej kujt saktësisht, por duhet të hamendësojmë, prej atyre që e udhëheqin këtë vend, prej atyre që u pengonte rezistenca e Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe opozitës së atëhershme lidhur me dy projektet, ato më të rëndësishmet të vitit 2016, që kanë qenë “Zajednica” dhe demarkacioni. Dhe, më 25 gusht shënjestra drejtohet qartë. Prej një piste paraprake, e cila ka qenë krejt e ndryshme, shënjestrohet politikisht kah Lëvizja “Vetëvendosje”, dhe për katër ditë konstruktohet ai spektakli i ndërhyrjes edhe bastisjes, edhe i arrestimit të terroristëve që i paskan gjetur, e që qenkan Lëvizja “Vetëvendosje” dhe gjashtë aktivistët tanë përfundojnë të burgosur. Një herë kam pas thënë në këtë Kuvend që pas këtij aktgjykimi, që e kam marrë me vete, nëpërmjet të cilit dënohen aktivistët tanë, katër prej tyre, ky i ka 42 faqe dhe ky është një rast studimi, qysh e tha edhe deputeti Sami Kurteshi - për studiuesit e drejtësisë. Lexojeni këtë aktgjykim dhe nuk keni nevojë të bëni studime të mëtutjeshme për nivelin e drejtësisë në Kosovë dhe cilat janë standardet për të të kategorizuar si terrorist edhe për t’i ngrënë 21 vjet burg.

Mjafton që ta shqyrtoni këtë, i ka 42 faqe, nuk ka shumë. E lexojnë edhe studentët e Fakultetit Juridik, edhe ata që janë duke magjstruar dhe duke doktoruar, sidomos në të drejtën penale, dhe e kupton kriminalizimin e vërtetë të sistemit të drejtësisë në Kosovës, sepse këtu është fare e qartë që kemi hyrë në një epokë të re të drejtësisë në Kosovës, e kjo është epoka e dënimit pa prova materiale. Në Kosovë dënohesh pa prova materiale. Kjo është shumë e rrezikshme, e kur mendohet që shteti është i kapur, e më së shumti sistemi i Gjyqësorit, merreni me mend çka do të thotë kjo për kundërshtarin politik, edhe për procesin politik në përgjithësi, për betejën politike, e cila duhet të zhvillohet në fushën e demokracisë, në fushën e një loje me rregulla.

Të gjitha ato që i kanë sjellë, se tash prapë po i kthehem besueshmërisë, duhet t’i besojmë dikujt. T’i besojmë dikujt, por jo Forenzikës. Duhet t’i besojmë dikujt, por jo FBI-së. Duhet t’i besojmë qëllimit tonë politik, thotë pushteti dhe hidhet poshtë gjithçka tjetër që e kundërshton këtë drejtim, këtë qëllim politik. Kjo ajo që është edhe më e rrezikshme e që ka të bëjë me një montim të procesit për të cilin ka edhe xhirime filmike, ka xhirime në Radiotelevizionin e Kosovës. Kur i ka bastisur Policia këta, për të treguar, për të bërë ndërlidhjen që janë terroristë të vërtetë, i pati vënë disa armë aty plot. Janë xhirimet. Prokuroria duhet të merret me këtë rast. A e di çka janë ato armë? Ato armë nuk kanë lidhje me ata aktivistë që janë futur në burg. I ka marrë Policia që i

ka grumbulluar prej rasteve tjera, prej kriminelëve tjerë dhe i vendos aty përpara televizionit dhe e shpjegon, do ta krijojë një lidhje në opinionin publik, edhe psikologjike, edhe asociative, që “shikoni se çfarë armësh kemi gjetur te ata terroristë”. Ec e mos e beso që këta janë terroristët e vërtetë! Këto duhet t’i hetojnë Prokuroria, e Gjyqësori lirisht le të marrë vendim le t’i lirojë ata aktivistë. Hetimet e vërteta duhet të bëhen në këto pista, kush e ka montuar këtë rast? Këtu është krimi i vërtetë.

Pastaj, montimet në sistemin e Gjyqësorit, qysh kanë ardhur dhe unë vetëm po i shtroj tri pyetje, e ju mendoni vetë a mund të jenë të rastësishme. A mund të jetë e rastësishme që Sylë Hoxha, pasi ia bën këtë “Vetëvendosjes”, në nëntor dhe dhjetor 2016, në janar 2017 prej Prokurorisë së Prizrenit avancohet dhe vjen në Prokurorinë Speciale të Kosovës. A mund të jetë kjo e rastësishme, mendoni vetë me vete. E dyta, a mund të jetë e rastësishme që Beqir Kalludra, edhe i dënon aktivistët tanë me 21 vjet burg, e në të njëjtën kohë bash ai e merr rastin e hedhjes së gazit lotsjellës, me ç’rast tentohet të dënohet Lëvizja “Vetëvendosje”, dhe u dënuan bile, me vendim të tij, deputetët e “Vetëvendosjes”, duke e interpretuar gazin lotsjellës si armë të rrezikshme. Edhe të dënon këtu në Parlament, edhe t’i dënojë atje aktivistët për terroristë. A është e rastësishme? Kjo është pyetja ime e dytë. Dhe, a është e rastësishme që pas Sylë Hoxhës, zgjidhet Metush Biraj. Metush Biraj, i cili në Prizren, vëllain e Sylë Hoxhës, që është i dënuar për korrupsion me katër vjet burg, ia lehtëson dënimin me vendimin e tij. A është edhe kjo e rastësishme, apo bash këta tre njerëz të drejtësisë po u dashka të merren bashkë me “Vetëvendosjen”, dhe ta vendosin pushtetin aty.

Këtu kemi të bëjmë me një proces krejtësisht të montuar politik. Edhe ato fjalitë që i tha edhe zoti Sami Kurteshi, janë edhe dy tjera që unë i kam shtuar, përpos asaj që thotë “duhet të dënohen këta, se nuk kemi gjetur prova materiale, por këta ishin shumë profesionistë, këta terroristët. Këta nuk po linin kurrëgjë, po vendosnin dorëza, po u përgatitnin... Nuk kemi gjetur ne kurrfarë ADN-je, e kurrfarë lidhje, mirëpo këta duhet të dënohen paraprakisht”. Kjo është gjendja e drejtësisë këtu në Kosovë. Kjo duhet të hetohet, Prokuroria e ka rastin gati.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi e keni fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit!

Unë do të përpiqem të flas shkurt, por të kthehem pak në të kaluarën e punës së këtij Kuvendi. Për të gjithë ata që mendojnë që po ndërhyjmë në drejtësi, dua të kthehem dhe ta rivlerësojmë edhe një herë nëse gabuam në të kaluarën, kur dikush na thoshte, ose i thoshim njëri-tjetrit në atë kohë, që për seanca të caktuara që kërkonim ne, pavarësisht nga cili grup, thuhej nganjëherë se kjo është ndërhyrje në drejtësi, sepse në këtë Parlament kemi kërkuar seanca me të drejtë edhe për shumë çështje tjera, të cilat, jo që kanë qenë ndër duart e drejtësisë, por kanë qenë objekt i padrejtësisë. Në këtë Kuvend kemi debatuar edhe për raste tjera, kemi debatuar edhe kur janë arrestuar pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kemi ndërhyrë dhe kemi bërë mirë, sepse

ajo s'ka qenë ndërhyrje në drejtësi, ka qenë reagim ndaj padrejtësisë. Kemi reaguar edhe për rastet tjera të montuara që kanë rezultuar pastaj edhe me pafajësin më vonë, por kemi bërë mirë që kemi ndërhyrë edhe në rastin e vëllezërve Ramadani e Kiçina. Pra, edhe atëherë kemi reaguar dhe kemi bërë mirë që kemi reaguar dhe koha e vërtetoi që ata kanë qenë të pafajshëm, e do ta vërtetojë edhe më shumë në të ardhmen.

Kemi reaguar edhe kur janë arrestuar dhe po mbahen të arrestuar shumë komandantë dhe ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës sot padrejtësisht nëpër burgjet e Kosovës. Edhe atëherë kemi ndërhyrë dhe kemi bërë mirë. Por, gjithmonë ka qenë dikush në këtë sallë që ka thënë që kjo është ndërhyrje në drejtësi. Madje, kanë pas thënë që kjo është ndërhyrje në drejtësi edhe në rastet tjera kur ka pasur të arrestuar edhe jashtë Kosovës, siç ka qenë rasti i kryeministrit Haradinaj, por ka pasur njerëz të tjerë që kanë thënë "lërvani drejtësisë". Por, një gjë ta kemi parasysh, edhe sot ne nuk po ndërhyjmë në drejtësi, ne po reagojmë ndaj padrejtësisë dhe mendoj që po bëjmë shumë mirë dhe kështu duhet të bëjmë sa herë që një deputet, ose një grup parlamentar, sa herë që ne si deputetë dhe Parlament e vlerësojmë që një padrejtësi po rëndon mbi dikë. Në këtë rast, kjo padrejtësi ka rënduar aq tepër sa që si pasojë e arrestimit të padrejtë sot e kemi Astrit Deharin, pra si target i kësaj padrejtësie që i ka kushtuar me jetë.

E kemi një deputet, i cili nuk është në ulëset e Parlamentit si pasojë e kësaj padrejtësie. Prandaj, jo vetëm që po bëjmë mirë sot, por ju inkurajoj që gjithmonë të reagojmë ne të parët ndaj çfarëdo lloji padrejtësie, sepse vetëm duke reaguar ndaj padrejtësisë ne i lëmë terren të hapur drejtësisë nëse ekziston diku, edhe nëse ekziston diku në horizont. Prandaj, mendoj që Parlamenti i Kosovës dhe grupi ynë parlamentar po e bëjmë punën e duhur si përfaqësues të qytetarëve, si deputetë, e mbi të gjitha si bashkaktivistë të atyre, të cilët sot po mbahen padrejtësisht të arrestuar, dhe si bashkaktivistë të atij që u arrestua në pranga dhe u kthye në arkivol. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Dardan Molliqaj.

DARDAN MOLLIQAJ: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Dua ta nis diskutimin tim për deklaratimet e mëhershme të disa prej deputetëve të PDK-së, e jo vetëm të PDK-së, të cilët deklarojnë që diskutimi në Parlamentin e Kosovës për rastet e drejtësisë është ndërhyrje në drejtësi. Këta ose janë naivë, ose janë dashakeq, e mendoj që disa prej tyre janë të dytë. Pse? Në plot vende demokratike në botë ka ndodhur me dhjetëra e qindra herë që rastet e vendimeve gjyqësore, të cilat kanë nxitur interes publik, janë diskutuar nëpër institucione të ndryshme. Ndërhyrja në mes të sistemeve të ndara nënkupton kur marrim vendime, por jo kur diskutojmë për procese të caktuara, edhe të rasteve të drejtësisë. Por, kjo është pjesa si të themi më shumë konceptuale.

Pjesa jokonceputale, këta të PDK-së sot qenkan fshehur, ose janë duke pirë kafë për shkak se ua kanë kryer punët gjykatat. Një debat për këtë rast është mbajtur në vitin 2017. Dhjetëra deputetë të PDK-së patën mbajtur fjalime. Na patën shpallur fajtorë, ideatorë, terroristë e të ngjashëm, e jo vetëm të PDK-së, por edhe të LDK-së. Pra, të njëjtit njerëz që sot thanë, zoti Beqa njëri prej tyre, që të mos flasim për drejtësi, e kishte mbajtur një fjalim këtu shumë të zellshëm, kur e akuzonte “Vetëvendosjen”. Pra, atëherë kur gjykata nuk kishte marrë vendim, e prej tutës që nuk po ia kryen punën gjykata, ai e bënte gjykimin politik këtu. Sot ishte i kujdesshëm, shpresoj që të kthehet në seancë që ta dëgjojë këtë diskutim. E dyta, dallimi ndërmjet nesh edhe këtyre të klanit “Pronto” dhe të SHIK-ut është ky: Ne flasim publikisht për padrejtësitë që ndodhin në Kosovë. Këta thërrasin darka e me telefona. Pra, këta i emërojnë gjyqtarët me telefona, i thërrasin gjyqtarët në telefon për të marrë vendim, por ajo është në rregull se s’është në seancë, nuk është në televizion, mundësisht derisa nuk bëhet publike ajo s’ka ndodhur, por, për fat të keq, u është bërë publike. Dhe nuk mund të flisni qysh ne po ndërhyjmë në drejtësinë e Kosovës.

Ndërhyrja në drejtësinë e Kosovës është faktuar nga eksponentët e pushtetit, përkatësisht të SHIK-ut. Pra, kjo është ajo sa i përket edhe ndërhyrjes në drejtësi, por edhe parimit të ndarjes së pushtetit. Për mua është e rëndësishme ta diskutojmë këtë rast edhe në një rrafsh tjetër. Pse, sipas nesh, rasti ndaj aktivistëve është politik? Shumë shpesh, sa herë që dikujt s’i kanë pëlqyer vendimet gjyqësore, kanë thënë është politike. Por, unë po mundohem t’i them të paktën tri elemente, të cilat për mua, kushdo të kishte qenë, pashmangshëm çojnë në ndikime politike dhe në konstruksione politike ndaj aktivistëve tanë.

Arrestimi - E tha pak Glauku, pas sulmit ndaj Kuvendit të Kosovës, për dy javë rresht më shumë se katër persona kanë qenë të dyshuar për sulmin ndaj Kuvendit të Kosovës. Asnjëri prej tyre nuk është arrestuar. Janë marrë në pyetje, janë lëshuar, por nuk janë arrestuar. Për tri ditë prej momentit që ka marrë vendim Prokuroria t’i zgjerojë hetimet ndaj aktivistëve tonë, aktivistët tonë janë arrestuar. Pse bash tri ditë, ose katër përkatësisht? Sepse u arrestuan më 30 gusht, e më 1 shtator ishte protesta e opozitës së bashkuar, më shumë e “Vetëvendosjes”, kundër demarkacionit, që atë ditë ishte në rend dite. Pra, pikërisht një ditë para se të ndodhë, përkatësisht dy ditë para se të ndodhte protesta, u arrestuan këta. Katër ditë u hetuan, asnjëherë nuk u morën në pyetje, ndërsa njerëzit tjerë, që me të njëjtat aspekte procedurale për dy javë mbetën të dyshuar, u morën në pyetje, por nuk u arrestuan. Ky është elementi i parë, që e bën rastin politik. Pra, i hetojnë dhe i arrestojnë pa i marrë në pyetje fare, ndërsa për të tjerët standard i dytë.

E dyta, në kallëzimin penal të prokurorit thuhet tekstualisht kështu: “të gjithë personat e dyshuar i takojnë një subjekti politik”, më vonë i shprehur si VV, pra “Vetëvendosja”, shkurtesa VV. Nëse prokurori për një moment ka dashur të thotë që kjo është një e përbashkët e tyre, janë edhe disa të përbashkëta tjera që prokurori nuk i cek. Të njëjtit janë në të njëjtin universitet, pra në Universitetin e Prishtinës. Të njëjtit janë të grupmohës së njëjtë, të njëjtit janë shqiptarë, të njëjtit po ashtu banojnë në të njëjtën lagje, të njëjtit janë..., Asnjëri prej këtyre nuk i thotë. Pse është më e rëndësishme të thotë që janë veç “Vetëvendosje”? Ose është dashur t’i thotë të gjitha,



ose s'ka lidhje pse janë “Vetëvendosje”. Por, ky e ka dhënë një sugjestim aty menjëherë, që po “Vetëvendosja” e kundërshton demarkacionin, këta janë të ‘Vetëvendosjes’”. Katër ditë s'ke nevojë as të presësh, i arreston dhe i dërgon në mbajtje. Pra, ky është elementi i dytë që ata e kanë shkruar në tekst, jo të cilin po e themi ne.

Po ashtu, e tha edhe Glauku, ju e dini që janë mbajtur konferenca për shtyp më së shumti ndonjëherë në historinë e Policisë së Kosovës përkitazi me një rast dhe gjykimi është bërë publik, ka nisur me RTK-në, ka vazhduar me Policinë, më vonë me Prokurorinë, tash me Gjykatën. Dhe, kanë ekspozuar armë, përveç që disa s'janë fare as të konfiskuara në shtëpitë e tyre, por kjo për mua është më pak e rëndësishme. Më e rëndësishme se kjo është se asnjë prej provave që është ekspozuar në ato fotografi dhe video-regjistrime nuk është pjesë e procesit ndaj aktivistëve. Pra, kanë ekspozuar diçka që është paraqitur në opinionin publik si prova që këta janë të dyshuar, e ju lutem hyni dhe lexojini procesverbalet dhe aktvendimet, asnjë prej atyre provave nuk është pjesë e procesit. Pra, ti ke dashur të ndërtosh terren që këta aktivistë janë të fajshëm dhe këtë gjë e ka bërë “Vetëvendosja”.

Ajo çfarë ka ndodhur në këtë proces është e ngjashme me një proces që ka pasur edhe më herët Kosova. Aktivistët e “Vetëvendosjes” janë dënuar mbi dyshimin e bazuar dhe mbi bazën e indiceve, madje nuk kanë shkruar as të dyshimi i bazuar mirë, që është një cilësim tjetër në procedurë, pra vetëm të dyshimi i bazuar. Asnjë fakt dhe asnjë provë, jo vetëm materiale, siç tha zoti Konjufca, por as verbale, nuk ekziston sa u përket aktivistëve tanë. Katër janë pretendimet e Policisë së Kosovës, përkatësisht Prokurorisë, tash së fundmi edhe Gjykatës, sa i përket vendimit. Një motor me dy pasagjerë që janë parë nga dy dëshmitarë, të cilët pasi u krye sulmi kanë vazhduar. Në këtë motor ka pasur video, të cilat janë dërguar për ekspertizë të FBI-së. Dhe, FBI ka treguar dhe ka kthyer një përgjigje të saktë. Pamjet që i kemi ne duke i krahasuar me fotografitë e të të dyshuarve që ju na i keni dërguar nuk kanë asnjë përputhje. Paramendoni, për mua, skandalin më të madh me vendimin e trupit gjykues, përkatësisht të gjyqtarit Kalludra, është ky: deklaron në ditën e vendimi që sulmin ndaj Kuvendit e ka kryer Egzoni dhe Atdheu. Pra, ne kemi çuar ekspertizë, jo ne po vetë Prokuroria, te FBI dhe FBI thotë nuk ka përputhje, ndërsa gjyqtari del dhe thotë “këta e kanë kryer sulmin dhe kanë hipur në motor”.

Gjyqtari edhe mund të marrë ndonjëherë vendim duke u bazuar në prova të tjera edhe të thotë, përkundër që një provë i shfajëson prova të tjera i fajësojnë, veç të dalë gjyqtari dhe të japë mendim e të bëjë deklaram përkundër ekspertizës, unë nuk kam parë në asnjë rast në Kosovë deri më tani. Ky është deklaram publik i regjistruar edhe në medie edhe në procesverbalet atje.

E dyta është që një dëshmitar i cili ka pretenduar që motorin ua ka shitur tre dëshmitarëve. Në deklaratën e parë thotë kanë qenë tre, në deklaratën e dytë identifikon vetëm dy, pra jo Astritin, dhe kemi një shkresë të një polici të Kosovës, i cili thotë: pas hulumtimeve të rrjeteve sociale e kemi kuptuar se personi i tretë është Astrit Dehari. Pra, veç e kanë shikuar kush me kë është në

Facebook, “këta tre qenkan shokë, i treti duhet të jetë Astrit Dehari...”, janë shkresa të lëndës. Dhe, i njëjti dëshmitar në procesin gjyqësor deklaroi dhe thotë që nuk jam i sigurt se këta njerëz që janë këtu në bankën e të akuzuarve janë ata, të cilëve ua kam shitur motorin.

Një tjetër tregon që thotë “Një telefon ia kam shitur Adea Batushës.” Përgjigjja nga Google që ka ardhur, thotë: “Më 29 korrik është krijuar e-maili “Rugovasi”, nga IME-i i atij telefoni, ndërsa i njëjti thotë që e ka shitur telefonin më 5 gusht, gjashtë ditë pasi është krijuar llogaria. Pra, nëse e ka blerë Adea telefonin më 5 gusht, kush e krijoi me atë telefon e-mail-in 6 ditë më herët. Dhe, e fundit është përgjimi i telekomunikimeve dhe lokacioneve. Edhe këtu të gjitha tregojnë në favor të aktivistëve tanë. Krejt kjo u bë për ta akuzuar “Vetëvendosjen” dhe krejt kjo është vazhduar për ta dëmtuar “Vetëvendosjen” edhe për shkak se s’po mund të vendoset drejtësi për rastin e Astritit.

Dhe elementi i fundit që është politik, ditën kur është shpallur vendimi ndaj aktivistëve të “Vetëvendosjes” është shpallur ditën e fundit të fushatës, para balotazhit. Ka pasur afat ligjor edhe shtatë ditë dhe nuk e kanë vendosur, por e kanë vendosur...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

E para, pajtohemi plotësisht që kemi të drejtë të debatojmë dhe vetë ftesa për këtë seancë është për të debatuar për një temë, e cila mendoj se është preokupim i të gjithë deputetëve dhe mendoj edhe i shoqërisë në Kosovë.

Më mbetet pak hatri pse nuk u distancau “Vetëvendosja” më së pari prej sulmit në Kuvend. Është dashur me thënë që është një sulm kriminel dhe si i tillë duhet të gjykohej... Qetësohu, po flas këtu për këto sot...

E dyta,... qetësohuni, qetësohuni, merrni frymë. Pritni veç pak!

E dyta, Glauk, the “për 20 ditë kanë shkuar hetimet në drejtimin e duhur, pastaj është ndryshuar drejtimi”. Edhe këtu do të ishte mirë të shpjegosh për çfarë orientimi ka qenë, se unë s’jam ekspert e nuk e di, po mirë është ta dijë opinioni publik se kah kanë qenë hetimet edhe përfundimin në fund të seancës ta nxjerrim një përfundim se kah duhet çuar këtë debat dhe çfarë konkluzash do të biem dhe si do të procedohet.

Pajtohemi plotësisht, që shumë fyese është ose ndjenjë më të poshtër s’ka, se sa të flas unë sot këtu e Frashëri të jetë në burg, por të njëjtën kohë, në rast se janë të vërteta këto që i thonë, unë

shpresoj që edhe Prokuroria është duke i dëgjuar dhe ata duhet t'i marrin masat, kushdo qoftë ai të përgjigjet për këtë.

Edhe më herët u fol për rastin Dehari, kërkesa eksplicite e familjes ka qenë që të ndahet një buxhet, të kërkohet hetim ndërkombëtar i pavarur, të cilin e ka kërkuar eksplicit me emër e mbiemër cilën kompani, me ia dhënë një kompanie zvicerane. Buxheti është ndarë në linja të veta, ka shkuar në ministri, ministria e ke proceduar në Prokurori, Prokuroria i ka shkëmbyer letrat komunikuese me kompaninë në fjalë, familja është pajtuar dhe është një proces që kurrë lidhje më s'ka ekzekutivi me këtë temë. Dhe krejt çka duhet tash është ekspert i ligjor, ose mbrojtësi i ligjor i familjes ta ndjek këtë procedurë se si po shkon.

Nuk besoj që ka qytetar në Kosovë që nuk e pret të vërtetën për Astrit Deharin. Unë e kam njohur edhe personalisht, jo vetëm Astritin, por edhe babanë e tij dhe e di se është një burrë i madh, që i ka dhënë shumë këtij vendi dhe bashkëndej me të për atë humbje, jo vetëm për Astritin po edhe për djalin e mëhershëm. Por, nuk është mirë tash me thënë, po e përsëris edhe një herë, e kam njohur vetë, kemi ndenj bukur disa ditë në shi e në borë, pikërisht duke e kundërshtuar “zajednicën” e demarkacionin, por mendoj dhe besoj shumë që edhe ju kolegë duhet t'i jepni të drejtë versionit final, cilido që të vijë përfundimi nga organet e Zvicrës, për shembull, nëse vinë dhe e hetojnë, sepse edhe po i ngremë emocionet e njerëzve pa pasur prova dhe fakte bindëse. Në rast se Astrit Dehari është vrasë, duhet të përgjigjet dikush, në rast se është vetëvrasë, duhet të japin përgjegjësi ligjore, për shembull, në institucionet përkatëse ku është vetëvrasë. Por, nuk mund të themi në rast se ai instrument, i cili ka krijuar vetëvrasje është i lejueshëm brenda organit korrektues, siç quhet, atëherë kurrkush nuk jep përgjegjësi, sepse kemi raste të panumërta që kanë ndodhur në Kosovë, që janë vetëvrasë në burg. Edhe Albini ka ndenj më shumë se unë në burg, e di edhe ky më mirë se unë, që po qe se një qytetar i arrestuar dëshiron të vetëvritet i gjen format. Unë nuk po flas për Astrit Deharin, por e dini shumë mirë që kemi raste të panumërta.

E pata edhe një gjë në fund, kolegë të mi. Po ju them sinqerisht, nuk po dua as të shitem patriot, as të kallëzohem më burrë e as më “papë”, por po ju them se të gjithë këtu që jemi, jemi të interesuar për t'u dhënë drejtim shumë temave, me të cilat të gjithë jemi lodhur. Nëse flasim për demarkacion, po i dëgjoj disa që po thonë, “jo kanë hequr dorë, jo s'kanë hequr...”, presionin publik po e shihni, presionin ndërkombëtar po e shihni. Edhe kjo nuk është e vërtetë që dikush po heq dorë, as nuk do të heqim dorë për asnjë metër, por natyrisht se duhet me i bashkua fuqitë për t'i dhënë drejtim, sepse në fund të ditës, ju këtu që jeni deputetë, qytetarëve na kanë votuar të gjithëve.

Kurrkush nuk po thotë me ia dhënë, as Kullën, as Qakorrin, Malit të Zi, por një zgjidhje duhet gjetur, se nuk mund të shkojë deri në pafundësi. Nëse flasim për “Zajednicën”, këtu do të jemi, do ta shohim kush ka hequr dorë e kush jo. Edhe për Astrit Deharin jemi të gatshëm çdo

kontribut me e dhënë. Edhe për rastin në fjalë të Frashërit dhe të kolegëve të tij, nëse doni të krijojmë komision, pikërisht juve opozitës u takon të krijoni komision hetimor, jo pozitës, ne do ta japim përkrahjen. Por, në fund dilni me një qëndrim konkret se çfarë po kërkon. Nëse po kërkon komision të ri hetimor parlamentar, kuptohet, jo qysh për shembull, s'po ia përmend emrin një kolegut tim emrat që po i përflasin policët, se ai është kriminel, ai është kështu e ai ashtu, është e pandershme se në fund të ditës i kemi 9 700 policë në Kosovë që na garantojnë jetën dhe lirinë e qytetarëve tanë, në mesin e tyre shumë prej tyre janë luftëtarë të zotë, shumë prej tyre janë me pozita të ndershme dhe të fuqishme, shumë prej tyre, sot u diskutua edhe për invalidë, se a duhet a s'duhet me ia heq të drejtën e policit, që është gabim fatal, se e përcakton ligji që u lejon, por me një fjalë domethënë të gjithë kërkojmë drejtësi, edhe për Astrit Deharin, edhe për Frashër Krasniqin dhe për të gjithë të tjerët që jetojnë në Kosovë, sepse në fund të ditës krejt jemi qytetarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë? Mirë! Glauk Konjufca, replikë!

GLAUK KONJUFCA: Po tash, nëse analizojmë shumë mirë atë që tha zoti Haradinaj, sikur u bë pjesë pak e atij korit kështu të pushtetit të mëhershëm, që të krijojë përshtypjen që "Vetëvendosja" është fajtorë, kur thotë nuk jeni distancuar nga sulmi në Kuvend. Çfarë po do të thotë me atë, nuk e di. Domethënë, njerëzit qenkan tuajt, po t'i duhet të distancohesh nga ata që janë tuajt. Këtë nuk e ka bërë Lëvizja "Vetëvendosje". Lëvizja "Vetëvendosje" nuk ka nevojë të distancohet. Lëvizja "Vetëvendosje" e ka dënuar, që është më shumë se distancim. E ka dënuar, është pjesë e rezolutës këtu të Kuvendit, ku ne me të gjitha subjektet tjera parlamentare e kemi lëshuar një rezolutë, është vendim i Kuvendit, kur ai sulm është quajtur i papranueshëm, i dënueshëm. Çfarë distancomi këtu? S'ka distancim!

Ti distancohesh kur dikush brenda llojit tënd, dikush i yti bën diçka prej të cilës ti thua "mirë ata të mitë janë, e kanë bërë, por unë nuk qëndroj prapa tyre". Kjo është me shumë sherr. Të thuash të distancohet Lëvizja "Vetëvendosje" është me shumë sherr dhe ka prapavijë politike edhe është bash në koordinata të këtij pushteti që po na dënon, veç për shkak të mendimeve politike.

Nuk është e dhembshme kjo që e tha zoti Haradinaj prej kësaj foltoreje, mirëpo është e dhembshme që Lëvizjes "Vetëvendosje" i ka ndodhur kur kemi qenë opozitë e bashkuar. E tash, kur po u ulka njeriu në një karrige tjetër, po niska të mendojë ndryshe. Kjo është më e dhembshmja!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Glauk, e para, kauzën e përbashkët që e kemi pasur, unë e përsërita edhe po ta përsëris edhe njëmijë herë, nëse dëshiron, e kemi të njëjtë. kam qenë kundër demarkacionit dhe "Zajednicës" edhe jam. E dyta, thashë sot në këtë seancë, ose në këtë debat, thashë "është

mirë me e dënua atë sulm edhe me e pa edhe ne të gjithë, që Frashër Krasniqi, i cili është edhe deputet dhe që të gjithë po kërkojmë drejtësi e që besoj edhe unë se edhe ai është i pafajshëm. Unë nuk e bëra Frashër Krasniqin e “Vetëvendosjes” pjesë në sulm, këtë nuk e thashë. Edhe mos u bëni viktimë, burrë, se na keni lodhur. Hajt, mos u bëj viktimë, se na keni lodhur, si LDK-ja këtyre herë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi e ka fjalën. Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti kryesues,

Njëri nga parafolësit që u deklarua kundër këtij debati kërkoi që drejtësia të kryejë punën e saj dhe të mos ndërhyhet në drejtësi. Këto dy kërkesa të deputetit Beqa janë synim edhe i këtij debati të iniciuar nga Lëvizja “Vetëvendosje”.

Është e sigurt se sikur drejtësia të ishte duke e kryer punën e vet dhe të mos kishte ndërhyrje në punën e sistemit të drejtësisë, nuk do të kishte kërkesë nga deputetët e pozitës dhe të opozitës, që drejtësia ta kryejë punën e vet dhe të mos ketë ndërhyrje në drejtësi. Prandaj, duhet konstatuar, sepse ky konstatim doli nga ky debat, se në punën e drejtësisë ka ndërhyrje, prandaj ata, pra sistemi i drejtësisë, nuk mund ta kryejë punën profesionalisht, ashtu siç duhet.

Prandaj, përmes këtij debati po përpiqemi ta ndihmojmë drejtësinë duke mos ndërhyrë në punët e saj. Derisa po flasim për ndërhyrjen është me rëndësi të definohet çka quajmë ndërhyrje. A është ndërhyrje debati apo diktati mbi sistemin e drejtësisë? Përderisa diktati është ndërhyrje, për të cilën u konstatua se ekziston, debati e ndihmon korrigjimin e punës së sistemit të gjyqësorit. Prandaj, debati për punën e sistemit gjyqësor, si për çdo çështje tjetër që ndikon në jetën e qytetarëve të Republikës së Kosovës, jo vetëm se është e drejtë e këtij Kuvendi, por është obligim, natyrisht me qëllim të përmirësimit të gjendjes në këtë rast të sistemit të drejtësisë e në rastet tjera në fushat, për të cilat mund të diskutojmë.

Duke pasur parasysh se qëllimi i këtij debati të ftuar nga Lëvizja “Vetëvendosje” ka për qëllim zbardhjen e rastit të Astrit Deharit dhe aktivistëve të dënuar për terrorizëm e një gjë e tillë nuk arrihet me drejtësi të ndikuar nga jashtë, do të duhej të kundërshtohet nga të gjithë, sepse kështu e kemi obligim ta ndihmojmë drejtësinë dhe natyrisht, duke e ndihmuar drejtësinë do ta ndihmojmë edhe këtë rast, për të cilin po diskutohet sot në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Diskutuesja e fundit është Arbërie Nagavci. Albini, në qoftë se keni rekomandimet e shkruara, ose që dëshironi t'i lexoni, ka të drejtë pastaj në fjalën e tij përfundimtare. Zonja Nagavci, urdhëro!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar,

Sot kur do të duhej të ishim të gjithë bashkë, jo vetëm fizikisht, por edhe me një pjesëmarrje me debat konstruktiv në këtë debat parlamentar për të diskutuar për aktivistët e rinj të këtij vendi, që në mënyrë shumë jo profesionale, tendencioze dhe pa asnjë provë materiale, u dënuan me më shumë se 21 vjet burg, shumë nga deputetët nuk janë të pranishëm e kemi madje edhe deklarata tendencioze në këtë drejtim.

Adea, Egzoni, Frashëri dhe Atdheu u dënuan padrejtësisht, e po vazhdojnë të mbahen padrejtësisht në burg, përderisa Astrit Dehari tashmë nuk është në mesin tonë. Sido që të themi, Astriti është e vërtetë se vdiq dhunshëm në duart e shtetit. Secili pretendim i Prokurorisë ishte i paqëndrueshëm dhe nuk kishte asnjë bazë juridike për të dënuar katër aktivistët tanë, pasi që u mbajtën në paraburgim dhe në arrest shtëpiak, pasi në fakt në secilën seancë u vërtetua pafajësia e tyre. Por, kjo nuk mjaftoi që katër të rinj të këtij vendi, të rinj të mbushur me energji e shpresë për një të ardhme më të mirë, të vazhdojnë të mbahen të burgosur, të ndërpriten nga studimet, nga jeta e tyre rinore, nga angazhimet e tyre shoqërore e nga aktiviteti i tyre politik.

Në këto rrethana, në kushtet që tashmë i dimë të gjithë, kur secili qytetar është i bindur tashmë se Astriti, një student i shkëlqyeshëm i cili u ndërpre dhunshëm nga angazhimi i tij për të qenë një mjek i suksesshëm i këtij vendi, akuzave se kjo është seancë politike në fakt u përgjigjem se është një përpjekje për të kontribuar në çkapjen e institucioneve tona shtetërore, për të kërkuar liri për të pafajshmit dhe drejtësi për Astritin.

Sot unë si qytetare e këtij vendi, si grua, si nënë, jam seriozisht dhe sinqerisht e brengosur për të ardhmen e fëmijëve të mi, për të ardhmen e të rinjve tanë në këtë vend, ku kryeparlamentari thotë nga foltorja e Kuvendit që të kemi kujdes se mund të vrasim veten, ku akoma ministra e zëvendësministra gjuajnë me armë zjarri nga odat, ku kryeministri ia rrit pagën vetes e deklaroi se “s’bëhet nami që gjuhet me armë”, se tradita kështu po e dashka, në këtë vend ku të rinjtë tanë, aktivistët e shkëlqyeshëm, akuzohen me shpifje e burgosen pa faj, fatkeqësisht nuk shoh afër dritë për të ardhmen, për të rinjtë tanë. Nuk shoh sigurinë se ky vend mund të bëhet më i mirë vetvetiu, andaj edhe konsideroj se vërtet është momenti i fundit, që të tejkalojmë vetveten, interesat e ngushta partiake e të angazhohemi për të rinjtë tanë, të mos lejojmë që të na shpallen terroristë djemtë e vajzat, që mos të na burgosen aktivistët për veprimtarinë e tyre politike e të mos na shëtisin të lirë kriminelët e të korruptuarit.

Andaj, po. Ky rast i aktivistëve të burgosur duhet të shqyrtohet në të gjitha forumet, në Kuvend, nga shoqëria civile, nga qytetarët, me kërkesën e vetme e të drejtë të kërkojmë gjykata profesionale, të ndershme e me integritet, që në shqyrtimin e rasteve e marrjen e vendimeve bazohen në argumente e fakte, e jo në dëshira të individëve.

Pra, po. Ne duhet të kërkojmë besueshmëri në institucione, por në institucione që besueshmërinë e fitojnë në bazë të punës së tyre e jo në bazë të deklaratave të personave, që vetë kanë ndikuar në humbjen e kësaj besueshmërie. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti, a keni rekomandime apo doni..., Samiu? Atëherë, ia jap fjalën Sami Kurteshit për t'i lexuar rekomandimet e Grupit Parlamentar, pastaj për votim e bëjmë në seancën e ardhshme.

SAMI KURTESHI: Sipas kërkesës sonë dhe në bazë të fakteve të gjetura nga vetë aktgjykimi i shkruar i Gjykatës Themelore të Prishtinës, logjikisht dhe ligjërisht shtrohen pyetje të pashmangshme. Po i përsëris edhe një herë, për ta ditur çfarë po kërkojmë:

- Kush janë aktorët e vërtetë të sulmit me armë zjarri në natën e datës 4 gusht 2016?

- Kush është organizatori dhe zbatuesi i projektit të inskenuar për burgosjen e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje” për këtë sulm?

- Kush janë ideatorët e këtij inskenimi monstruoz kundër aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”?

- Kush e vrau Astrit Deharin në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, më 5 nëntor 2017?

Në mënyrë logjike për shkak të këtij inskenimi monstruoz, për shkak të këtij inskenimi monstruoz, për shkak të involvimit të drejtpërdrejtë, për shkak të përpjekjes së kundërligjshme, kundërkushtetuese, kriminale, për fajësimin e aktivistëve të aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe të Lëvizjes “Vetëvendosje” si subjekt politik, për shkak të dyshimit të bazuar të involvimit të drejtpërdrejtë të qarqeve të larta në Policinë e Kosovës, në Prokurorinë Speciale dhe në Gjyqësorin e Kosovës, ne si Lëvizje “Vetëvendosje” kërkojmë nga ky Kuvend:

#### R e k o m a n d i m e t

1. Për rastin e sulmit në ndërtesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, më 4 gusht 2016, të kërkohet dhe të mundësohet një hetim i plotë i pavarur ndërkombëtar i tërë rastit nga ndonjëri nga vendet perëndimore të Bashkimit Evropian, përfshirë vendet neutrale të Evropës Perëndimore dhe Zvicrën, por këtë duke e veçuar nga rasti i Astrit Deharit.

2. Shkarkim i të gjithë personave nga Policia e Kosovës, të involvuar në këtë rast të inskenuar.

3. Shkarkimi dhe suspendimi i të gjithë personave që kanë qenë kompetentë dhe përgjegjës në hierarkinë shtetërore kur ka ndodhur rasti i Astrit Deharit.

Këto janë kërkesat e Lëvizjes “Vetëvendosje”. Sa për informim, megjithatë, edhe zotit Daut Haradinaj, edhe të gjithë të tjerëve, sot Prokuroria Themelore në Prizren e ka lëshuar vendimin për lejimin e të gjitha veprimeve hetimore për rastin e Astrit Deharit, pa u kufizuar në asnjë mënyrë. Edhe kjo është njëra nga kërkesat e para dhe themelore të Lëvizjes “Vetëvendosje” më datën 5 nëntor 2017. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, po vazhdojmë me pikat tjera. Besoj që i kryejmë shpejt, se edhe s’besoj që ka shumë diskutues të interesuar për të diskutuar këto çështje.

### **11. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës**

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione e ka shqyrtuar raportin me rekomandime të Avokatit të Popullit në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar për 4 komunat veriore të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandime për miratim.

Fjalën e ka zonja Balje.

DUDA BALJE: Faleminderit!

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur 12 dhjetor dhe 18 dhjetor 2018 shqyrtoi raportin me rekomandimet e Avokatit të Popullit në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës dhe vendosi, që Kuvendit t’i paraqesë këto rekomandime:

Ne kemi rekomanduar këto veç në datë 18. 12. 2017, tash unë do t’i lexoj dhe kemi pak një ndryshim, sepse gjendja ka ndryshuar pak.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ta shqyrtojë në seancë plenare çështjen e faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës t’i miratojë tri rekomandime që dalin nga raporti i lartpërmendur dhe të nxjerrë vendimin, si vijon:

- Zyra e Rregullatorit të Energjisë, ZRRE, urgjentisht të ndalë praktikën e kundërligjshme të faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në veri të Republikës së Kosovës;



- Qeveria e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me ZRRE-në dhe KEDS-in të gjejë një mënyrë alternative për t'iu shmangur humbjeve në veri të vendit, duke trajtuar gjendjen e konsumatorit në mënyrë të barabartë sipas normave kushtetuese dhe ligjeve kundër diskriminimit.

- ZRRE në pajtim me Ligjin numër 5/L-074 me Rregulloren e Energjisë të nxjerrë vendim, me anë të të cilit do të miratohet zbritja e tarifës deri në atë masë që do të mundësojë kompensimin e konsumatorëve, të cilët padrejtësisht janë faturuar.

Për arsytim, ne kemi pasur takim edhe me Avokatin e Popullit dhe me përfaqësues të ZRRE-së dhe kemi konstatuar se ata kanë shkelur pesë ligje në Kosovë, Ligjin për Rregullatorin e energjisë, Ligji për energjinë elektrike, Ligji për marrëdhëniet e detyrimeve, Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi dhe Ligji për mbrojtjen e konsumatorit.

Ne si Komision për të Drejtat e Njeriut mendojmë se duhet të votojmë për këtë rekomandim dhe të gjenden mënyrat të dilet nga ky problem.

Gjykata në Prishtinë ka marrë masa të përkohshme dhe prej dhjetorit 2017 nuk faturon shpenzimet më, por ata nuk kanë marrë një vendim përfundimtar, edhe ne tash nëpërmjet Kuvendit duhet marrë një vendim përfundimisht dhe të gjendet një zgjidhje për t'i kompensuar qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e grupeve parlamentare. Nga Lëvizja “Vetëvendosje”, Sami Kurteshi e ka fjalën.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne edhe në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, ashtu siç e shpërfaqti edhe zonja Duda Balje, kryetare e komisionit, edhe në grupin tonë parlamentar e kemi diskutuar disa herë këtë çështje.

Ne kemi analizuar me shumë kujdes raportin e Avokatit të Popullit që është një gjetje, ta quaj ashtu, që zë në flagrancë një shkelje të jashtëzakonshme ligjore që nuk mund të quhet ndryshe, përveç se zhatje e qytetarëve të Republikës së Kosovës, edhe atë, ashtu siç e quan Avokati i Popullit, zhatje politike.

Pas disa letërkëmbimeve pas hetimeve që i ka bërë Avokati i Popullit, pas letërkëmbimeve me institucionet relevante, në radhë të parë me ZRRE-në, pas kundërshtimit të sqarimit të rrethanave se si ka ardhur deri te ngarkesa e qytetarëve të Republikës së Kosovës për vite me radhë, për diçka që ata nuk e kanë marrë, nuk e kanë shpenzuar, nuk e kanë konsumuar, megjithatë në fund ka arritur të nxjerrë një raport, i cili në mënyrë ligjore konstaton për shkelje të rënda, të cilat janë bërë nga institucionet. ZRRE-ja është institucion shtetëror, me gjasë, me dijeninë dhe me

përkrahjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Është fjala për ngarkesën e qytetarëve të Republikës së Kosovës, për pagesën e shpenzimit të rrymës elektrike, e cila u është ngarkuar atyre në mënyrë të padrejtë për shpenzimet e rrymës elektrike që janë bërë në katër komunat: Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok dhe pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës.

Avokati i Popullit ka gjetur dhe pastaj, pas shpjegimeve në takimin e përbashkët që ka pasur Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, në ballafaqimin e Avokatit të Popullit dhe të Zyrës së Rregullatorit për Energji del edhe një fakt tjetër, se qytetarët e Republikës së Kosovës për gjashtë vjet me radhë kanë paguar në mënyrë të padrejtë, në mënyrë të paligjshme ose u është marrë prona e tyre në mënyrë të paligjshme dhe u është përvetësuar nga subjekte të tjera që nuk kanë qenë të ditura nga qytetarët, por janë bërë me dijeninë e institucioneve publike, edhe me dijeninë e Qeverisë, është fjala për gjashtë vjetët e kaluara për rreth 50 milionë euro edhe kjo gjendje vazhdon edhe sot.

Ne plotësisht e përkrahim raportin e Avokatit të Popullit me të gjeturat që janë bërë edhe plotësisht e përkrahim kërkesën e Komisionit për të Drejtat e Njeriut që shprehu pak më parë zonja Duda Balje për një vendim të gjykatës për suspendimin e kësaj mase deri në gjetjen e metodave të tjera.

E dyta, për një vendim të drejtë të gjykatës në Kosovë për kthimin e pronës që u është marrë qytetarëve të Republikës në mënyrë të padrejtë tani e disa vjet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Topalli e ka fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë e kolege,

Kryetarja paraprakisht e paraqiti para nesh shqyrtimin e raportit me rekomandime të Avokatit të Popullit në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës.

Po ashtu ne të gjithë e dimë se kjo çështje ka qenë e njohur edhe nëpërmjet mediave, po ashtu është shqyrtuar edhe në Komisionin për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

Të nderuar qytetarë,

Zyra e Avokatit të Popullit, sipas detyrës zyrtare kishte iniciuar hetimet lidhur me faturimin e paligjshëm të energjisë elektrike të shpenzuara në veri të qytetarëve të pjesës tjetër të Kosovës.

Avokati i Popullit kishte gjetur se 8 milionë euro ishin shpenzuar nga komunat në veri të Kosovës, kryesisht të banuara me shumicë serbe, ndërsa shpenzimet e kësaj energjie i ishin faturuar pjesës tjetër të qytetarëve të Kosovës.

Lidhur me këtë çështje Avokati i Popullit kishte dërguar pyetje në ZRRE, nga të cilët kishte pranuar përgjigje se vendimi i atakuar përcakton nivelin e reduktimit të humbjeve të energjisë në tërë territorin e Kosovës, përfshirë edhe komunat në veri.

Në raportin e Avokatit të Popullit kemi përgjigje që ZRRE-ja, ku është thënë se rryma e shpenzuar në veri të Kosovës konsiderohet si humbje komerciale dhe se ka qenë e domosdoshme që kjo humbje të mbulohet duke ua faturuar qytetarëve në mbarë territorin e Kosovës, në pamundësi për t'u faturuar shpenzimi i energjisë në veri.

Lidhur me të gjeturat Avokati i Popullit u ishte adresuar me rekomandime ZRRE-së, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Avokati i Popullit institucioneve relevante u kishte rekomanduar që urgjentisht të ndërpritet praktika e paligjshme e energjisë elektrike të shpenzuar në veri dhe që Qeveria e Kosovës, ZRRE-ja e KEDS-i t'i gjejnë mënyrat alternative të faturimit, duke mos shkelur të drejtat e qytetarëve të Kosovës.

Realisht para komisionit është paraqitur se ka tendencë për t'i mbuluar këto shpenzime nga Qeveria.

Avokati i Popullit ka thënë se nuk duhet të ndodhë kjo, por kemi bazën e subvencioneve për veriun ose bazën e kontributeve të Qeverisë dhe këto mjete mund të inkasohen nga Fondi për zhvillimin e veriut. Sa u përket dëmeve morale, kjo do të duhet të jetë një pjesë e veçantë që do të duhej të paguheshin nga vetë kjo kompani, e cila do të duhej të bëhej mbi bazën e një ekspertize gjyqësore.

Lidhur me këto pretendime Avokati i Popullit ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Të nderuar kolegë,

Tashmë ne kemi një vendim të Gjykatës Themelore të Prishtinës që pezulloi faturimin e shpenzimeve të rrymës në veri qytetarëve të pjesëve të tjera të Kosovës.

Gjykata Themelore e Prishtinës ka gjetur se vazhdimi i ekzekutimit të vendimit të Bordit të ZRRE-së do të shkaktonte një dëm që do të ishte i pariparueshëm.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për konfliktin administrativ, ka pezulluar ekzekutimin e këtij vendimi.

Po ashtu pjesa prej 3,5% e energjisë së shpenzuar për veri është hequr nga faturat e qytetarëve nga 1 dhjetori me një vendim të përkohshëm, derisa të bëhet funksional Bordi i ZRRE-së.

Kryesuesi i Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, Arsim Janova, deklaroi para Komisionit për të Drejtat e Njeriut se për të marrë veprime konform vendimeve gjyqësore duhet të kompletohet Bordi i ZRRE-së.

Andaj, në fund mund të them se edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i ka shqyrtuar këto tri rekomandime që dalin nga raporti i Avokatit të Popullit dhe po ashtu me një diskutim konstruktiv sot brenda këtij Kuvendi besoj të dalim me ndonjë propozim apo me një ide për t'i eliminuar të gjitha dilemat që dalin para nesh. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën, në emër të AAK-së.

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit,

Sot para vetes kemi një raport të komisionit, i cili ka disa rekomandime për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Po që në fillim falënderoj Avokatin e Popullit si institucion, i cili për herë të parë ngriti një shqetësim që shumë më parë ishte dashur të jetë në vëmendjen e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Pra, ne kemi disa rekomandime të komisionit që normalisht kërkojnë votimin e deputetëve, por për mua personalisht është shqetësuese kur Kuvendi i Republikës së Kosovës ende nuk ka arritur të zgjedhë anëtarët e Bordit të ZRRE-së, përderisa rekomandimet janë pikërisht për këtë institucion, kërkesa jonë është urgjente që të ndalen këto praktika të kundërligjshme të faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në pjesët veriore të Republikës së Kosovës dhe të nxjerrë një vendim.

Por, është pika e dytë e këtyre rekomandimeve që presim nga institucioni, pikërisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës, kuptohet në bashkëpunim edhe me ZRRE-në, por nuk e di derisa nuk është funksional vetë bordi që KEDS-i të gjejë mënyrën alternative për të shmangur humbjet në veri dhe duke trajtuar të gjithë konsumatorët në mënyrë të barabartë sipas normave kushtetuese dhe ligjeve kundër diskriminimit.

Ajo që është shumë shqetësuese vetë Avokati përmend që janë shumë ligje, të cilat i atakojnë, thjesht tregojnë se janë shkelje të të drejtave të njeriut. Kjo mënyrë e faturimit të energjisë elektrike përbën shkelje të disa ligjeve, siç janë Ligji për Rregullatorin e energjisë elektrike, Ligji 05/L-85 për energjinë elektrike, Ligji numër 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, Ligji 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi, Ligji numër 04/L-121 për mbrojtjen e konsumatorit.

Dhe, për fund, normalisht se kërkohet nga Kuvendi të miratohen këto rekomandime, por sinqerisht edhe një herë po them, a po e kryejmë punën ne si Kuvend, në mënyrë që sa më parë të zgjedhim dhe të jenë funksional këto borde, edhe pse kemi dilema shumë të mëdha, pikërisht me vetëdije të plotë ky bord ka lejuar për vite të tëra të plaçkiten qytetarët e vendit.

Unë uroj që këtu të jetë fillimi i ecjes mbarë edhe i integritit të qytetarëve të asaj pjese, sepse diskriminimi pozitiv shumë herë është diskriminim që tregon që nuk sjell integritet të atyre qytetarëve, po përkundrazi, është një distancim i plotë dhe nuk i kontribuon marrëdhënieve që të gjithë qytetarët në vend të trajtohen të barabartë.

Andaj, duke shpresuar që të bëjmë diçka si Kuvend, unë pres të votohen të gjitha rekomandimet, por me një sugjerim që sa më të parë vetë Kuvendi të sjellë në Kuvend votimin e anëtarëve të Bordit të ZRRE-së dhe të kompletohet ky bord, në mënyrë që të jetë funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Halimaj e ka fjalën.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Po mendoj që raste të tilla nuk është mirë të presim që dikush, qoftë individ a institucion, të shohë nëse është në rregull një çështje ose jo.

Në këtë rast, nëse Avokati i Popullit nuk do ta hapte këtë çështje, nuk do ta gjente si shkelje, atëherë mendoj se edhe tash, e besa edhe do të vazhdonte kjo shkelje deri në pafundësi, po falë Avokatit të Popullit ne sot po debatojmë këtu.

Dua t'i bëj publike, për informimin e qytetarëve, disa pyetje që janë bërë nga Komisionit i të Drejtave të Njeriut, pra, ZRRE-së.

Në pyetjen që i ka shtruar komisioni është: a ka Elektroekonomia e Serbisë qasje në rrjetin e furnizimit në pjesën veriore të Kosovës dhe nëse ka, në cilat forma dhe sa ka qasje?

Përgjigjja e ZRRE-së është: "Sipas informatave që posedojmë, operatori serb e përmend kompaninë që ka qasje, operon ilegalisht në katër komunat veriore të Kosovës". Pra, si ka mundësi që ne të gjithë ose ata e kanë ditur që ata operojnë ilegalisht në komunat veriore dhe t'i lejnë këto parregullsi sikurse asgjë. Ato kompani as nuk janë të licencuara, veprojnë ilegalisht dhe askush nuk i ka trajtuar deri tash.

Në pyetjen tjetër që i ka bërë komisioni ZRRE-së është: Në komunat veriore të Republikës së Kosovës a shpërndahen faturat për pagesën e energjisë nga ana e Elektroekonomisë së Serbisë dhe ZRRE-ja përgjigjet që nuk ka informata zyrtare në lidhje me këtë çështje, por sipas informatave të siguruar nga burime jozyrtare, operatori ilegal, që ia përmend emrin, bën

faturimin dhe inkason pagesat për energji elektrike. Shtrohet pyetja, kujt i shkojnë ato para që janë të energjisë së Kosovës? Pra, ku shkojnë paratë e qytetarëve, të cilët as ata vetë nuk paguajnë, humbjet e tyre i paguajnë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në pyetjen tjetër që është shumë e rëndësishme, e që shumë qytetarë nuk e kanë ditur është: A ka pasur përveç në pjesën veriore të komunave të Republikës së Kosovës fenomen të tillë edhe në pjesë të tjera të Republikës së Kosovës të banuara me qytetarë serbë?

Përgjigja nga ZRRE është: “Duhet theksuar se deri në vitin 2009 disa zona me shumicë serbe nuk kanë paguar faturat e energjisë elektrike”, pra deri në vitin 2009 nuk kanë paguar faturat të energjisë elektrike qytetarët me shumicë serbe.

Unë e falënderoj Avokatin e Popullit që e ka bërë këtë gjetje dhe besoj që edhe debati ynë do të ndikojë e ta zgjidhim këtë çështje në mënyrën më të mirë të mundshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Balje, në emër të Grupit Parlamentar, e ka fjalën.

DUDA BALJE: Hvala vam!

Vi ste do sad imali priliku da čujete sve jedno možda prvo pitanje koliko bi se ovo dužilo da Narodni advokat nije pokrenuo verovatno bi se i dalje fakturisala ova električna energija.

Mi smo u toku istraživanja ovog problema razumeli da Elektro privrede Srbije ima dva preduzeća na Kosovu koja funkcionišu, koja su sudeći po rečima ZRRE ilegalna, takođe imamo i kopiju fakture koji stanovnici na severu Kosova plaćaju električnu energiju Srbiji.

Ovde se otvarao veoma veliki broj pitanja i možda za stanovnike Kosova je najvažnije način na koji će se ova sredstva kompenzirati.

U kontaktu sa ministrom za financije mi smo ovde dali neki preporuke za koje bi smo stvarno želeli da se glasaju. U kontaktu sa ministrom za financije on je rekao da se angažovali neki stručnjaci iz Nemačke koji bi trebali da rade na ovom pitanju.

Ono što je najvažnije i što je stav Parlamentarne grupe “6+” jeste to da se što pre nađe način da se stanovnicima Kosova kompenziraju novci koji su oni plaćali za nešto što nisu trošili. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Po vazhdojmë me diskutimet. Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari, duhet theksuar një fakt që ne jemi mësuar që institucionet e Republikës së Kosovës të mos e bëjnë punën e tyre, por nuk është rasti i njëjtë edhe me Institucionin e Avokatit të Popullit,

si në të kaluarën, si tani, ku në krye të këtij institucioni është zoti Hilmi Jashari, përnjëmend e kryen detyrën me përgjegjësi të lartë.

Unë kam pasur takime me zoti Hilmi Jashari, Avokatin e Popullit. Jam njoftuar për së afërmi në lidhje me këtë çështje që sot po e diskutojmë në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe sigurisht që jam e shqetësuar pikërisht duke marrë parasysh që rasti i ngjashëm dyshohet që është edhe me faturat e ujit e të mbeturinave.

Pra, edhe me faturat e ujit, edhe të mbeturinave, njësoj qytetarët e Republikës së Kosovës kanë paguar me një vendim të jashtëligjshëm dhe skandaloz të ZRRE-së për borxhin e qytetarëve serbë që jetojnë në veri.

Sigurisht që si grup parlamentar, e tha edhe zoti Kurteshi, e mbështesim raportin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, por shtrohet pyetja: çka do të bëhet me ato rreth 50 milionë euro që u janë marrë qytetarëve përmes faturave të energjisë elektrike? Kush do t'i kthejë ato te qytetarët e Republikës së Kosovës?

Nuk po flasim ose nuk e kemi rastin që qytetarët e Kosovës janë qytetarë të pasur dhe që nuk e ndjejnë në faturën e tyre në qoftë se u faturohet një borxh i tjetërkujt për çdo muaj, me vite të tëra. Po flasim për qytetarë, të cilët shumica janë të papunë dhe i kanë goxha vështirë t'i paguajnë faturat e energjisë, por edhe të ujit e të mbeturinave e fatura të tjera, edhe ata të cilët sot punojnë dhe kanë një pagë mesatare prej 400 eurosh.

Këtu nuk u fol për diçka që është tepër e rëndësishme për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të ZRRE-së, domethënë e kanë marrë vendimin që qytetarëve të pjesës tjetër të Kosovës t'u faturohet borxhi i qytetarëve serbë.

Unë konsideroj që kjo është tepër e rëndësishme, ata të cilët kanë vendosur jashtëligjshëm, i kanë shkelur pesë ligje që janë në fuqi me atë vendim, e kanë shkelur edhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ata duhet të shkarkohen, e po ashtu ky Kuvend duhet të kërkojë që të nisin hetimet penale për këta zyrtarë, individualisht, për secilin veç e veç, që kanë keqpërdorur detyrën zyrtare. Kjo është besoj tepër e rëndësishme dhe sigurisht që duhet të diskutojmë edhe mënyrën se si duhet t'u kthehen parat qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Është skandaloze deklarata e Qeverisë Haradinaj, kur u kuptua kjo gjendje.

Zoti Haradinaj tha, mirë, nuk do të paguajnë më qytetarët nëpërmjet faturave, por që do t'i kryejë këto obligime, borxhet e qytetarëve serbë Qeveria e Kosovës. Pra, prapë me paratë e qytetarëve të Republikës, se nuk janë paratë e Ramush Haradinajt e as paratë e ministrave të këtij Kabineti qeveritar, janë para që merren nga taksat e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Pra, është deklarata e papërgjegjshme, është zvatje e buxhetit të shtetit dhe sigurisht për këtë duhen edhe hetime penale. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Gutaj e ka fjalën.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Çështja e faturimit të energjisë elektrike në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës është çështje tejet e ndjeshme dhe diskriminuese.

Ngritja e çmimit të energjisë elektrike është në disproporcion me gjendjen reale ekonomike që ne e kemi në vend dhe unë konsideroj se fryrja e faturave të energjisë elektrike me qëllim për të kompensuar humbjet komerciale 5 deri 8 milionë euro në vit për komunat në veri të Kosovës, është shkelje e të drejtave të njeriut.

Në vazhdimësi ne po punojmë për integrimin e qytetarëve të komunave veriore për një jetë më të mirë, por është e padrejtë dhe diskriminuese ndaj qytetarëve që dikush të shpenzojë dhe tjetri t'i paguajë detyrimet e tij, e aq më tepër pa qenë i njoftuar fare. Në pjesën veriore të Kosovës, inkasantët as që e dinë sesa shpenzohet, kurse në anën tjetër ekipet kontrolluese futen nëpër shtëpitë e qytetarëve pa leje dhe pa shoqërim. Kjo nuk është një praktikë e mirë dhe po ashtu reflekton diskriminim ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës. Andaj, unë si anëtare e Komisionit të të Drejtave të Njeriut konsideroj që është një shkelje dhe ZRRE-ja në këtë rast duhet t'i heqë këto praktika të kundërligjshme, njëkohësisht Bordi i ZRRE-së duhet të japë llogari para qytetarëve dhe duhet të kompletohet në mungesë të anëtarëve tjerë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Megjithëse arsyeja e diskutimit tim, në fakt shumë prej elementeve që unë doja t'i përmendja, i përmendën kolegët e deritashëm, po e lexoj bukur me vëmendje raportin e rekomandimeve të komisionit, rekomandimi i tretë thotë se ZRRE-ja në pajtim me Ligjin nr. 05 për Rregullatorin e Energjisë duhet të nxjerrë një vendim me anë të cilit do të miratohej zbritja e tarifave deri në masën që do të mundësonte kompensimin e njerëzve që kanë paguar për rrymën e shpenzuar në pjesët tjera të Kosovës, posaçërisht në veri.

Unë besoj për shembull që ky rekomandim do të duhej të ishte shumë më i saktë dhe do të duhej që Kuvendit të Republikës së Kosovës t'i jepet një rekomandim i saktësuar deri në fund se si do të kompensohen qytetarët e Kosovës, të cilët për gjashtë vjet e kanë paguar shpenzimin e energjisë elektrike për disa qytetarë të tjerë, me çka në fakt janë shkelur ligjet e shtetit, është shkelur Kushtetuta e Republikës.



E dyta, ata që e kanë marrë këtë vendim, gjashtë vjet më herët dikush e ka marrë një vendim me anë të të cilit i ka shkelur ligjet e vendit, i ka shkelur të drejtat e qytetarëve, të konsumatorëve të këtij shteti, duhet jo vetëm që të shkarkohen, por duhet të thirren edhe në përgjegjësi penale. Së fundi, nuk po besoj për shembull që deklarata e kryeministrit Haradinaj ka qenë skandaloze, kur ka thënë se Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i marrë përsipër obligimet që tash e tutje të paguajë për shpenzimet që kryen në veri të vendit. Në fakt, kryeministri Haradinaj e ka marrë një vendim të guximshëm, që nënkupton ndërprerjen e një praktike të kundërligjshme dhe kundër Kushtetutës së vendit që është aplikuar tash e sa vjet. Çështja e kthimit të mjeteve, unë besoj që do të duhej të ishte çështje e debatit, e përfundimeve dhe e rekomandimeve që do të dilnin nga seanca e Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Pacolli.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

Sinqerisht sot më bën të mendoj shumë dhe të them kush është shumicë në Republikën e Kosovës, derisa neve na shkelen të drejtat si qytetarë, prej kujt po shkelen këto të drejta? Këta njerëz, të cilët i kanë marrë këto vendime për ta ndëshkuar qytetarin e Republikës së Kosovës duhet të sillen para drejtësisë, duhet të japin llogari. Si është e mundur që kaq shumë vite të ndëshkohet qytetari dhe në mënyrë tinëzare, edhe pse ka pas plot ekspertë që e kanë ngrehur këtë çështje, po ashtu edhe qytetarë, që nuk i kanë besuar asaj faturës, atij kalkulimi, por kjo gjë ka vazhduar vazhdimisht.

Unë e përshëndes rekomandimin e Avokatit të Popullit, në këtë rast e ka bërë një punë të mirë. Nuk është që qytetarët kanë qenë të hutuar dhe nuk e kanë ditur, por ata kanë qenë të pafuqishëm ndaj një padrejtësie të vazhdueshme e të stërzgjatur. Prandaj, unë kërkoj që këta njerëz të shkarkohen urgjentisht, por të mos largohen nga përgjegjësia, të fillojnë hetimet dhe të sillen para drejtësisë. E dyta, të gjithë qytetarëve që ua kanë shkelur të drejtat janë mbingarkuar me shpenzimin e tyre, që t'u kthehet ajo e drejtë, ato para, të cilat i kanë paguar deri më tani padrejtësisht. Prandaj, shteti, Qeveria, Parlamenti janë të kësaj republike, duhet t'i ndërmarrin veprimet konform ligjit dhe t'i çojmë tutje përpara dhe të mos vazhdojë kështu me këtë çështje, pasi vërtet të bën të mendosh, a nuk janë ata të ZRRE-së njerëz të Republikës së Kosovës, apo janë mbi ligjin, dhe bën ta ndëshkojnë çdo qytetar në Republikën e Kosovës, apo qenka dikush për të cilin duhet të paguajnë të tjerët.

Kjo formë këtyre herë i kanë thënë është haraç, e me të vërtetë qytetarëve të Republikës së Kosovës, në këtë rast pjesën jugore dhe në përgjithësi shqiptarët janë ndëshkuar, u kanë vënë haraç që sa vite. Është jo e moralshme, jo e ndershme, të gjithë ata njerëz që bëjnë pjesë në këto vendime, megjithatë thotë një fjalë e urtë e popullit "më mirë vonë se kurrë". Edhe në qoftë se është pak vonë, ata duhet të japin llogari dhe ju lus që këtu në Parlament të jemi të gjithë të bashkuar, të kërkojmë që të gjithëve qytetarëve t'u kthehen këto të holla, se përpos shkelje e të

drejtave të njeriut, është edhe ndëshkim. Normalisht i kanë dëmtuar qytetarët, i kanë dëmtuar edhe bizneset. Prandaj, është e padrejtë, t'u kthehet ajo e drejtë e tyre, por këto vendime, ky hetim të vazhdojë menjëherë. Le të hyjë në fuqi kërkesa jonë dhe të fillojnë, se të mbeten ende ata në këtë bord, mendoj që nuk duhet as të ekzistojë, duhet të largohet sa më shpejt për arsye që kanë bërë shkelje. Në çfarëdo forme, në çfarëdo mënyre që bëhet shkelja është e padrejtë dhe është vepër penale, duhet të paraqiten para drejtësisë.

Ne i përkrahim fuqishëm rekomandimet e Avokatit të Popullit, njëkohësisht kërkojmë shkarkimin e Bordit menjëherë, të jetë i menjëhershëm, po ashtu të merret vendimi dhe t'u kthehen mjetet të gjithëve qytetarëve, të cilët janë mbingarkuar padrejtësisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

I mbështetim fuqishëm rekomandimet e Avokatit të Popullit, po ashtu kërkojmë nga Qeveria që të qëndrojë ashtu siç ka thënë që qytetarëve t'u shpaguhet ai dënim që u është bërë, e po ashtu kërkojmë që të merren masa për përgjegjësit. Kjo është një çështje tanimë u trajtua nga shumë kolegë dhe po shihet që është një dëm që u është bërë qytetarëve të vendit, janë dënuar dhe kjo nuk është dashur të ndodhë fare.

Unë do ta shfrytëzoj këtë rast që ta ngre edhe një temë tjetër, mendoj që është po kaq e rëndësishme dhe shumë e rrezikshme për qytetarët e vendit. Të gjithë jemi të vetëdijshëm se ka ndodhur ngritja apo ndërtimi i linjës energjetike Kosovë-Shqipëri, e cila nuk po futet në funksion për shkak të bllokimeve që vijnë nga Serbia. Dhe, kolegë të nderuar deputetë, këtu dua të vëmë theksin që pas gjashtë vjetëve të vijmë në situatën sikur kjo që ka ndodhur me pagesat e faturimit që u janë adresuar dhe shpenzimet janë bërë nga qytetarët serbë, sepse ajo linjë është ngrehur mbi bazën e një kredie. Kredia ka filluar të kthehet. Nga raporti që ne e kemi pasur prej KOST-it, rezulton se faturimi u adresohet dhe kredia ka filluar të kthehet nga xhepi i konsumatorëve të vendit. Pra, nga ata që shpenzojnë dhe ata janë qytetarët.

Unë po e bëj këtë paralajmërim, sepse kjo do t'u kushtojë shumë shtrenjtë qytetarëve të Kosovës. Ne nuk e kemi asnjë deklaram nga Qeveria dhe asnjë masë që e ka ndërmarrë për të parandaluar dhe për të bërë diçka për ta bërë këtë linjë funksionale. Këtu ishte dashur të ishin ministrat, së paku ministri i Zhvillimit Ekonomik, sepse jemi para një rreziku, i cili do ta rëndojë akoma më shumë gjendjen e qytetarëve të vendit, konsumatorë të energjisë. Prandaj, unë po e përmbyll duke bërë apel që të jemi proaktivë dhe të marrim vendime me kohë, derisa këto shuma nuk kalojnë miliona, shumëfish më të mëdhenj se sa kjo që ka ndodhur, për shkak të atij vendimi të ZRRE-së gjashtë vjet më herët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të ju thënë të drejtën, unë pak jam konfuz, nuk po di se çka realisht po ndodh. Pyetja që kërkon përgjigje është se a janë vjedhur qytetarët e Kosovës nga një vendim i ZRRE-së? Nëse përgjigja është “po”, atëherë lind pyetja tjetër, a është arrestuar dikush për këtë vjedhje?

Nëse flasim për drejtësi, nëse flasim për një shtet ku zotëron drejtësia, atëherë dikush duhet të japë përgjegjësi për këtë dhe a duhet apo a ka kush far reperkusioni për këtë shkelje të ligjit? Po flas për ata të cilët e kanë marrë një vendim jashtëligjor, me të cilin janë vjedhur qytetarët e Republikës së Kosovës. Ne nuk jemi kundër banorëve serbë në veri, hallin e kemi edhe me ZRRE-në, edhe me KEDS-in, që po na i marrin neve paratë për energjinë që tjetërkush po e shpenzon. Po thuhet se janë mbuluar humbjet komerciale. Humbjet komerciale i bie që banorët e veriut, të cilët s’i kanë paguar fatura të energjisë elektrike, si dhe të fortët në pjesën tjetër, të cilët ose e vjedhin, ose nuk e paguajnë energjinë elektrike. Kështu që kjo praktikë duhet të ndalet domosdoshmërisht, por po ashtu duhet që paratë e qytetarëve t’u kthehen në një formë apo tjetër, qoftë si para, qoftë si zbritje nga faturat në të ardhmen, por po ashtu nëse pretendojmë që ligji të sundojë në Kosovë, atëherë të gjithë ata, të cilët e kanë marrë një vendim të jashtëligjshëm, e pastaj në bazë të këtij vendimi qytetarët janë vjedhur, duhet të sillen para ligjit dhe të dënohen sipas ligjeve në fuqi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolege dhe kolegë deputetë,

Ju të pranishëm,

Është shumë interesant që pothuajse diskutimet e deputetëve shkuan në të njëjtat valë, mirëpo është mirë nganjëherë të bëjmë pak me gisht drejt vetvetes që ne si deputetë a po i kryejmë obligimet tona. Natyrisht që edhe unë do ta ripërsëris se edhe unë pajtohem se faturimi i shpenzimit të energjisë elektrike nga një pjesë e Kosovës, që e paguan një pjesë tjetër e Kosovës, pavarësisht se qytetarët i takojnë një etnie, apo asaj etnie tjetër, se pjesa tjetër e Kosovës që i paguan shpenzimet e komunave të veriut janë edhe shqiptarë, boshnjakë, romë dhe të tjerë, dhe sidoqoftë para së gjithash janë qytetarë të shtetit tonë, të cilët padrejtësisht e dëmtojnë xhepin e tyre, duke paguar një mall në këtë rast, që s’e kanë konsumuar.

Kjo është krejt në rregull. Pajtohem të gjithë. Mirëpo, për mua është paksa e çuditshme dhe më tingëllon jo e sinqertë një qasje e tillë, sepse mendoj që edhe rekomandimet, por edhe të gjitha diskutimet që shkuan, janë trokitje në një derë që mbyllur që po e mban Kuvendi të mbyllur. Pse po e mban? Zyra e Rregullatorit të Energjisë në prill e bën një vit që është ende pa bord dhe në mungesë të bordit nuk mund të marrë vendime. Do të pajtohem të gjithë se këto vendime të

dëmshme për një pjesë të qytetarëve të Kosovës janë marrë në vitin 2012, por tani edhe ekzekutimin e gjykatës në fjalë nuk mund ta bëjë ZRRE-ja, sepse nuk ka bord.

Unë mendoj se qytetarët e Kosovës po vazhdojnë ende të dëmtohen në këtë drejtim, sepse Kuvendi nuk po i kryen obligimet e veta. Ne e kemi marrë një vendim të Qeverisë, një propozim-vendim të Qeverisë për ta plotësuar Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë në dhjetor të vitit të kaluar dhe tani jemi në shkurt dhe nuk kemi arritur si deputetë që ta plotësojmë atë bord për arsye jashtëzakonisht të parëndësishme në relacion me rëndësinë e plotësimit të atij vakumi institucional. Madje, unë mendoj se është shumë lehtë të thuhet e mbështesim raportin e komisionit, por çështja është se kush do ta zbatojë atë raport të komisionit. Po e përsëris, nuk kemi bord. Dëmi për Kosovën dhe qytetarët e saj vazhdon të shtohet duke e ditur se Zyra e Rregullatorit i përgjigjet Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe anëtarët e Komisionit për Zhvillim Ekonomik nuk kanë arritur t'i thonë "po" atij vendimi dhe me votë të fshehtë pastaj të vendoset që të plotësohet ai vakum.

Ne e kemi marrë në nëntor të vitit të kaluar si komision një letër shumë serioze nga sekretariati i komunitetit të energjisë, me të cilën kërkon me urgjencë dhe emergjencë që të plotësohet vakumi institucional i atij institucioni shumë të rëndësishëm, siç është Zyra e Rregullatorit të Energjisë, për arsye se në mungesë të këtij bordi Kosova po humb shumë. Nuk ka kush të aplikojë për certifikimin e KOST-it, mandej presim shumë aplikacione që kanë të bëjnë me energjinë alternative, që Kosova është e obliguar ta plotësojë edhe atë kriter dhe edhe shumë çështje tjera, ndërkohë që unë habitem se pikërisht se kryetarja e këtij komisioni që e paraqiti raportin është pjesë e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, që nuk i ka thënë "po" vendimit të Qeverisë që ta plotësojë raportin, e pikërisht edhe deputetët tjerë të një partie - "Vetëvendosje", të cilët nuk i kanë thënë "po", por përkundrazi e kanë penguar dhe e kanë ndalur procesin e mëtutjeshëm që të plotësohet ky bord.

Andaj, të nderuar deputetë, unë kërkoj që të bëjmë së pari me gisht nga vetvetja, të mos na i kujtojë neve Avokati i Popullit punët tona që duhet t'i kryejmë, por ne duhet të përvishemi dhe t'i kryejmë punët tona bashkërisht, sepse janë shumë çështje në favor të qytetarëve të Kosovës dhe janë pak çështje që mund të na ndajnë si ngjyime politike, sepse e kemi marrë besimin e qytetarëve të Kosovës dhe në momentin kur ne jemi në këto ulëse të këtij Parlamenti duhet t'i kryejmë detyrat tona, të cilat lidhen kryekëput në të mirën e qytetarëve. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zonja Balje, replikë!

**DUDA BALJE:** Faleminderit!

Ne kemi bërë shumë takime me qytetarët e Kosovës. Tash në këtë moment qytetarët e Kosovës janë të interesuar për punët e burokracisë, punët e Bordit, puna e Qeverisë, për punën e gjyqeve

në Kosovë. Ata janë të interesuar që në këtë moment t'i marrin të hollat që i kanë shpenzuar deri tash.

Por, ne kemi problem institucional brenda institucioneve dhe zgjedhja e Bordit është shumë interesante, por tash në këtë moment me këtë rekomandim që e kemi paraqitur para jush, gjyqi do të vendosë kush është fajtor dhe ta paguajë dënimin dhe Qeveria do të vendosë. Ne do ta obligojmë Qeverinë që ta gjejë mënyrën qysh t'i kompensojë qytetarët e Kosovës, e unë mendoj që në këtë moment këto janë më të rëndësishme për qytetarët e Kosovës dhe për Kosovën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, deputetja Sala Berisha-Shala!

SALA BERISHA-SHALA: Ndoshta jo kundër-replikë, por mirëkuptim me kolegen deputete, por unë e kam veç një pyetje shumë të thjeshtë: Qysh do të zbatohet rekomandimi i tretë, ku thuhet "ZRRE-ja në pajtim me ligjin ta nxjerrë një vendim me anë të të cilit do të miratohej zbritja e tarifave deri në atë masë që do të mundësonte kompensimin e konsumatorëve, të cilët padrejtësisht janë faturuar dhe vazhdojnë të faturohen". Ne e dimë që është padrejtësisht, po qysh të zbatohet, kur ne e kemi mbyllur atë derë dhe nuk ka kush ta kryejë këtë obligim.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Nga ajo çka u dëgjua deri më tash del se vendimi për të mos inkasuar më nuk ka ardhur si rezultat i faktit se tash do të paguhet rryma elektrike - energjia e shpenzuar, por do të kompensohet nga Qeveria, pra nga Buxheti i Republikës së Kosovës, që i bie jo nga të gjithë qytetarët, por vetëm nga qytetarët taksapagues.

Nëse Qeveria mund të ndajë mjete për ta mbuluar këtë humbje në të ardhmen, duke mos ua marrë qytetarëve, atëherë shumë lehtë mund ta marrë një vendim që po ashtu nga Buxheti i Kosovës t'i kompensoj tërë paratë që i ka mbledhur ndër vite nga qytetarët tjerë në mënyrë të padrejtë.

Pra, si konkluzion, nëse mund të vazhdojë t'i mbulojë ato humbje nga buxheti, le ta marrë një vendim, siç e ka marrë atë vendim për të vazhduar që t'i mbulojë humbjet në të ardhmen, që në mënyrë retroaktive t'i kthejë të gjitha mjetet te qytetarët, të cilat i ka marrë në mënyrë të padrejtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Të mos përsëris, por t'i theksoj disa elemente, të cilat nuk u thanë deri më tani.

Është e vërtetë se ZRRE-ja e ka marrë një vendim i cili është i kundërligjshëm dhe thuhet se në mungesë të faturimit në veri, ose për shkak se qytetarët në veri nuk paguajnë rrymë janë faturuar qytetarët në pjesën tjetër të Kosovës. Do të thotë, qytetarët shqiptarë paguajnë kushtimisht për ata serbë në pjesën veriore të Kosovës.

Është edhe një fakt që në pjesën veriore të Kosovës, qytetarëve serbë dhe shqiptarë atje u shkojnë faturat e rrymës dhe ato u shkojnë nga Distribucioni “Elektrosërbi” në veri dhe ata paguajnë rrymë atje. Nuk i paguajnë shtetit të Kosovës, por i paguajnë Serbisë.

Kjo e përbën edhe një element tjetër interesant për t'u analizuar dhe për të dëshmuar që në pjesën veriore të Kosovës, Serbia ende vazhdon të mbajë institucione paralele.

Se a është e vërtetë kjo energji e faturuar në faturat tona, energjia që ka shkuar në veri, ka dilema të mëdha. Pse ka dilema të mëdha? Sepse ne e dimë që ajo pjesë andej shumicën e energjisë e merr nga trafostacioni në Vallaç, që nuk menaxhohet nga institucionet e Kosovës.

Pastaj, një pjesë e asaj energjie vjen drejtpërdrejt nga Serbia për qytetarët dhe në bazë të lidhjeve të energjisë nga Serbia.

Pra, a ishte vërtet i shpenzuar ky faturim nga distribucioni ynë për qytetarë dhe sa është humbja? Këtu ka orëmatës prej momentit të prodhimit të energjisë elektrike e deri te energjia që është transferuar te qytetarët në cilën do pjesë të Kosovës. Mos është një mashtrim edhe më i madh? Në emër të ndjenjës së patriotizmit, këtu dikush brenda po vjedh, edhe po vjedh keq, dhe po krijon inat ndërmjet qytetarëve, sepse faturat e qytetarëve në pjesën jugore vërtet janë ngritur. Por, veç këtij diskriminimi të qytetarëve në pjesë tjera të Kosovës, po ndodh një diskriminim i dyfishtë për qytetarët shqiptarë në pjesën veriore të Kosovës. Ata edhe ia paguajnë rrymën “Elektroserbisë”, e jetojnë në Kosovë, e ia kryejnë obligimet shtetit të Kosovës e detyrohen t'ia paguajnë rrymën atje “Elektroserbisë”.

Kur vite më parë filloi KEK-u t'i shpërndante faturat e rrymës në pjesën veriore, kishte ankesa sepse po u shkonin dy fatura për pagesë nga dy shtete, nga dy elektro-distribucione, edhe nga i Kosovës, edhe nga ai i Serbisë. Prandaj, këto të Kosovës u ndërprejnë me shpresën se në bisedimet në Bruksel do të zgjidhej ky problem. U bënë disa hapa nga Edita Tahiri, ku do të licencohet një kompani në pjesën veriore, punë e cila ka ngecur, por që atje vazhdon të operojë një operator ilegal, një operator i licencuar në Serbi, por jo në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Konsideroj që është një temë shumë me rëndësi për qytetarët e Republikës së Kosovës, e ndoshta edhe për Qeverinë. Mendoj se ka qenë e domosdoshme që në këtë seancë e në këtë debat të jetë edhe ministri i Zhvillimit Ekonomik, që çështja të jetë më serioze. Konsideroj që këtë çështje, ne si ligjvënës që e ka ngrehur Avokati i Popullit në interes të qytetarëve të vendit tonë duhet ta çojmë deri në fund.

Unë e përgëzoj edhe punën e Avokatit të Popullit, edhe ata të cilët e kanë informuar Avokatin e Popullit, por në veçanti Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, që i ka bërë këto rekomandime, të cilat si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës i mbështes në tërësi. Por, nëse i marrim edhe këto pikat e rekomandimit, atëherë dalin edhe obligime nga secili paragraf i këtij rekomandimi. Nëse e marrim te Zyra e Rregullatorit të Energjisë pikën 1, urgjentisht të ndalet praktika e kundërligjshme të faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar, që nëse e përkthejmë juridikisht këtu i bie që kemi shkelje ligjore. Se a ka ndodhur ky skandal i madh, i cili i ka dëmtuar të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që i kanë paguar faturat e energjisë elektrike, kjo është dëshmuar.

Si deputet i Republikës së Kosovës më habit fakti se si organet e drejtësisë qëndrojnë indiferente karshi një skandali kaq të madh, ku dyshohet se më shumë se 100 milionë euro u janë marrë qytetarëve të vendit tonë. Do të thotë, u janë marrë në mënyrën më të padrejtë dhe aq më shumë, kur e shikojmë se në çfarë gjendje sociale, ndoshta një familjeje me gjendje sociale i këputet rryme, kurse këto para KEDS-i i ka kompensuar si në emër të humbjeve dhe në emër të pagesave që është dashur t'i bëjnë qytetarët e Republikës së Kosovës në 4 komunat e veriut të Republikës së Kosovës.

Unë si deputet konsideroj që, përveçse duhet të kompensohen qytetarët, jo nga Qeveria, por nga përfituesi në këtë rast, nga këto fatura e në këtë rast e kemi një kompani, e cila bën faturimin dhe menaxhon, që është KEDS-i, e unë mendoj që kjo duhet t'i shkojë jo në barrë të Buxhetit të varfër të Republikës së Kosovës, por është një kompani e cila operon dhe është përgjegjësi, edhe juridike, edhe faktike e saj që ta bëjë faturimin dhe t'i ndalë humbjet. Megjithatë, ne kemi edhe probleme politike ndoshta në atë pjesë. Qeveria duhet ta thotë edhe ajo fjalën e vet.

Unë si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës kërkoj dhe konsideroj që është e domosdoshme për një rast të tillë kaq të madh, kur qytetarët dëmtohen rreth 100 milionë euro, të krijohet një komision hetimor në Parlament, i cili do ta bëjë një analizë të thukhtë dhe ta bëjë një raport të detajuar për të gjithë deputetët. Ne këtu po flasim sipas informatave nga Avokati i

Popullit, nga rekomandimet e komisionit, nga ato që kemi dëgjuar dhe realisht po bindem që është një gjë që ka ndodhur. Andaj, edhe një herë e përsëris që institucionet në fjalë, e aq më shumë ne si ligjvënës, do ta marrim shumë më seriozisht, po ashtu edhe Qeveria e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Debati ishte i mirë. Mendoj që Kuvendi ka të drejtë t'i ketë rekomandimet e tij shtesë. Besoj që grupet parlamentare do t'i shqyrtojnë bashkë edhe një herë këto rekomandime dhe t'i heqin ato që s'janë për ne, ose që s'mund të kenë, meqenëse s'është ai bordi i famshëm, mendoj që kjo është më shumë çështje ligjore që duhet të shkojë në Gjykatë, sesa të bisedohet dhe t'i dërgohet prapë atij Bordit të ZRRE-së.

Replikë? Më fal, me kë e ke? A ta ka përmendur emrin, a? S'po ta ndal fjalën, por s'ta ka përmendur emrin kurrkush.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Është interesant se qëllimi i disa diskutuesve këtu, përfshirë edhe zotin Beqa, është që me diskutimet e tyre, që janë kot fare, e kanë për qëllim që qytetarët t'i bëjnë për ta ndërruar kanalën, në mënyrë që pastaj të mos dëgjohen diskutimet e Lëvizjes "Vetëvendosje". Kjo është e qartë, por s'ka rëndësi. Ne e kemi gjetur formën në vazhdimësi se si t'i themi qëndrimet tona.

Këtu shumë shpesh u përmend nga deputetët e PDK-së dhe u kritikua Komisioni për të Drejtat e Njeriut, që unë mendoj se është gabim të kritikohet, megjithatë rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut janë në rregull. Zoti Haxhiu e përmendi Marrëveshjen e prillit 2013, elektro-serverin, mirëpo s'e di a e di zoti Haxhiu që pikërisht Thaçi e ka negociuar elektro-serverin. Me Marrëveshjen e prillit 2013, madje në atë kohë thurte lavde për atë marrëveshje dhe kështu vetëm sa e thelloi vjedhjen e shumëfishtë nga "Limak&Çalik" dhe KEDS dhe abuzimin e Serbisë në veri të vendit.

Dhe tjetra, zonja Sala-Berisha po mundohet të duket këtu që kinse përnjëmend është për të vendosur të drejtën e të tjera si këto, sikur të ishte kështu atëherë do t'i ishte përgjigjur pozitivisht ftesës së Komisionit për Legjislacion për një takim të përbashkët ndërmjet komisioneve, ku do të mund ta adresonim përnjëmend ndoshta shumë më mirë këtë çështje bashkërisht, përfshirë edhe Komisionin për të Drejta të Njeriut. Madje as nuk je përgjigjur në ftesën që ta kam bërë si kryetare e komisionit në emër të deputetëve anëtarë të Komisionit për Legjislacion.

Qëllimi këtu është që në Bordin e ZRRE-së t'i vendosin njerëzit e tyre, siç kanë bërë në vazhdimësi. Prandaj, ne jemi kundër dhe nuk do të lejojmë që të çoni njerëz të PDK-së, përfshirë këtu koalicionin qeverisës në këto borde. Faleminderit!



KRYESUESI: Faleminderit! Tani e ke hapur frontin për replika. Zoti Hajdar Beqa ka kundër-replikë.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar!

Unë nuk po e kuptoj mësuesen Albulenë, apo deputeten, a qysh ta quaj tash këtu. Unë e kuptoj që ka frustrime të brendshme, nuk di as cilin klan këtu po e prezanton, apo e përfaqëson, gjithë ditën po flasim klanin Pronto, ne i kemi pasur tre muaj ditë dy klane të këta, që realisht është për të të ardhur keq t'ua përmend çfarë emrash kanë këto klane.

Unë konsideroj që është një temë shumë e rëndësishme dhe më seriozisht e marrim në si pozitë që ta ngremë sesa ju si opozitë, dhe u desh ta merrni, se është në interes të qytetarëve dhe konsideroj se deputetja Haxhiu duhet të jetë pak më serioze, se nuk është mësuese këtu, është njëra prej deputeteve, e kanë votuar qytetarët dhe është mirë të punojë në interes të atyre, e jo të vijë këtu si lektore apo si mësuese, sepse nuk po tregon diçka që ia vlen të theksohet. Nëse do të hyjë në ndonjë debat konkret, flasim për çka të duash, edhe “hajt pak” ia nisim prej fillimit, Albulenë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Mendoj se kolegja e arriti qëllimin që të fokusohet edhe një herë në fund të debatit, sepse debati i të gjithë kolegëve vërtet ishte rreth problematikës. Është e vërtetë që në pjesën veriore ka vepruar dhe vazhdon të operojë distribucioni serb dhe është e vërtetë që me bisedimet në Bruksel është menduar që të pamundësohet kjo, do të thotë të arrihet një marrëveshje që atje të shtrihen institucionet e Kosovës dhe nëse dëshiron vërtet ta zhvendosësh vëmendjen nga ajo që diskutuar, mendoj që ajo që e thashë vërtet qëndron.

Besoj që i njoh problematikat, e në veçanti ato që janë të qytetarëve shqiptarë në pjesën veriore dhe të cilat asnjëherë këtu nuk i përdorim për qëllime politike, ashtu siç bëni ju. Mendoj që të fokusoheni në atë që është vërtet esenciale, duke mos u ikur atyre çështjeve për të cilat qytetarët kanë nevojë, sepse kjo është një brengë, sepse njerëzit janë të ngarkuar me faturat e energjisë padrejtësisht nga dikush që ka përgjegjësi dhe ju që tani thoni “ne do ta lëmë kështu” një Bord të ZRRE-së, një institucion, për shkak të paragjyqimeve që ju i keni. Faleminderit!

KRYESUESI: Edhe Sala Berisha ka replikë.

SALA BERISHA-SHALA: Nënkryetar!

Nuk është replikë. Mos ma ndërprit fjalën në kuptimin e minutës së replikës, sepse edhe unë dua t'i përgjigjem të nderuarës kolege deputete.

Është e vërtetë që ia ka dërguar një letër komisionit, po atëherë e paska bërë veç sa për formalitet, ndërkohë që deputetët e saj në komision e kanë penguar plotësimin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe merreni me mend, thotë “nuk kemi dashur t’i çojmë njerëzit e PDK-së”. Unë dua t’ua rikujtoj qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe deputetëve se në procesin e rekrutimit të këtij konkursi për ta plotësuar Bordin ka marrë pjesë Ambasada Britanike, si rezultat i një memorandumit që e ka nënshkruar Qeveria e Kosovës, fuqizimi i qeverisjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve në Kosovë, ndërkohë që të gjitha grupet parlamentare e kanë marrë një letër nga Ambasada Britanike lidhur me kandidatët e përzgjedhur dhe u ka rekomanduar që sa më parë ta plotësojnë atë bord. Unë nuk mund ta kuptoj ndryshe qasjen e koleges sime, përveç se një hipokrizi. Në njëherë anë thotë “hajde takohemi si komisione ta bëjmë këtë zgjidhje”, në anën tjetër e pengon plotësimin e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, e i nderuar nënkryetar the “njëfarë bordi”. Por, ai nuk është “njëfarë bordi”, është një institucion jashtëzakonisht i rëndësishëm. Për të mos marrë kohë këtu para deputetëve, për t’i radhitur pse është i rëndësishëm, i përmenda dy elemente jashtëzakonisht të rëndësishme. Qytetarët e Kosovës vazhdojnë të vuajnë në mungesë të atij bordi nëpërmjet formave të ndryshme dhe nëpërmjet këtij faturimi të famshëm, që e ka identifikuar Avokati i Popullit, në vend se ta identifikojmë ne si deputetë.

Përndryshe, dua ta përmend këtu edhe një rast tjetër. Ne si komision jemi përcaktuar për ta monitoruar zbatimin e Ligjit për energjinë elektrike, që në ndërkohë kolegët e saj, të partisë së saj, janë pjesë dhe ende e udhëheqin atë grup, e kemi formuar në nëntor të vitit të kaluar atë grup punues...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Balje, nuk keni të drejtë në replikë. S’ta ka përmendur emrin fare. Jo, jo, unë ia jap fjalën, por shiko, diskutimet nuk bëhen nga dhjetë herë për një çështje një njeri, të mësohemi. Një herë diskuton, e ke një qëndrim tëndin dhe e përfundon. Në emër të komisionit si përfundim, mund të flasë.

Sipas Rregullores ka të drejtë përfaqësuesi i Qeverisë dhe kjo është e drejta e tërësishme. Komisioni e ka dhënë fjalën e tij, zonja Balje fjalën e saj në emër të komisionit tri herë ka folur. Edhe një herë fol Dudë, nja dy minuta, dhe kryeje.

DUDA BALJE: Faleminderit!

Ne kemi përzier shumë gjëra tash. Ne jemi Komision për të Drejtat e Njeriut. A ka qenë shkelje e të të drejtave të njeriut? Po! Mos e bëni tash një pasqyrë pa Bordin, qytetarët e Kosovës mund të marrin kompensim. Me Bordin e ZRRE-së, ne kemi bërë shkelje të ligjit. Kjo është e vërtetë. Tash pa Bordin ne s’mund ta paguajmë borxhin, kjo s’është e vërtetë. Ne duhet ta formojmë

shumë shpejt Bordin, edhe unë jam anëtare e komisionit, por tash është pyetja për sa kohë ne mund t'i kthejmë borxhet te qytetarët e Kosovës.

Ne si Komision për të Drejtat e Njeriut jemi shumë të qartë, se këtu ka qenë shkelje e të drejtave të njeriut. Unë si kryetare e këtij komisioni, nuk më intereson si po shkon puna, çka ka ndodhur, qysh ka ndodhur, për ne ka ndodhur shkelje e të drejtave të njeriut dhe kjo duhet shkuar deri në fund dhe për kompensimin e qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, edhe kjo pikë për t'u votuar mbetet në vazhdimin e seancës.

## **12. Shqyrtimi i vendimit të Qeverisë për ratifikimin e anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë së Agjencisë së Akreditimit**

Për këtë pikë e kemi një mocion, i cili nuk e ka pasur numrin e duhur të deputetëve që kanë votuar, dhe unë e konsideroj mungesë kuorumi dhe nuk e hedh për shqyrtim, derisa të votohet mocioni i propozuar nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike. Pra, mbetet fillimisht që të votohet mocioni, pastaj kjo.

Po, ministri dëshiron ta bëjë një sqarim rreth kësaj.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë e kam parasysh që duhet formalisht ta lexojmë edhe ekspozenë tonë, që të kërkojmë nga deputetët miratimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, por më lejoni para se të vijmë te kjo pikë, pasi edhe sot është e pamundur të votohet, është shprehur një interesim i madh edhe i disa deputetëve, por edhe grupeve parlamentare. Më vjen keq që Grupi Parlamentar i LDK-së nuk është këtu, sepse ata shprehën një pakënaqësi lidhur me shkarkimin e Bordit.

Ne mund të ju informojmë, se përveç...

KRYESUESI: Zoti ministër, ta informoni Kuvendin nuk keni të drejtë sot. Veç ditën që..., pasi të kalojë mocioni hyjmë në çështjen e kësaj. Është me rregull. Është Rregullore. Mua më vjen keq që jam i detyruar të ta tërheq vërejtjen dhe të të mos lejoj, sepse po biem në kundërshtim pastaj me grupet parlamentare dhe nuk kam qejf, as për ty s'është interes. Po më mirë është kur të jenë krejt deputetët të sqarohen, se sa tash kur s'i kemi deputetët.

E shtymë pikën e rendit të ditës dhe nuk mund të hyjmë në pikën e rendit të ditës, në të cilën ministri e merr fjalën. Kuptomë drejt, kjo është Rregullore e Kuvendit, kështu procedojmë, as s'e

kam për ta mbështetur dikë, as për të ta marrë ty të drejtën, por unë bëj shkelje në qoftë se e filloj pikën e rendit të ditës.

Nesër në seancë jemi të gjithë këtu prapë dhe e ke të drejtën të flasësh sa të duash. Më kupto drejt!

### **13. Shqyrtimi i raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016**

Këtu i kemi dy përfaqësues, nga Komisioni Funkcional është Driton Selmanaj dhe nga Komisioni për Buxhet është Lumir Abdixhiku.

Së pari dua të di si zëvendësues të këtyre, a jeni marrë vesh kush do ta lexojë, apo ta lëmë edhe këtë në mungesë të tyre. A mund ti ta kryesh detyrën e zëvendësuesit?

Atëherë, Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e kanë shqyrtuar raportin vjetor të performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016 dhe raportin e pasqyrave financiare të audituara për vitin 2016 dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tyre me rekomandimet e komisioneve.

E ftoj përfaqësuesin e Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, zotin Selmanaj. Kush e merr fjalën? Zoti Lushtaku e paraqet raportin dhe arsyetimin me rekomandimet e komisionit.

**MËRGIM LUSHTAKU:** Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Siç dihet, kryetari i këtij komisioni për arsyet e tij nuk është në këtë seancë, nuk e ka vazhduar seancën, andaj më lejoni t'i prezantoj rekomandimet e këtij komisioni.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në bazë të neneve 62 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 16 nëntor 2017, e shqyrtoi raportin vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016 me numër 06 -248 dokumentin 181, si dhe raportin e pasqyrave financiare të audituara për vitin 2016 dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këto:

#### **R e k o m a n d i m e**

Të miratohet raporti vjetor i performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016, së bashku me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, si në vijim:

1. Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë auditimit për periudhën 2017-2018 të fokusohet në rekomandimet e dhëna nga Auditori i Brendshëm sesa ato rekomandime po zbatohen nga menaxhmenti i institucioneve.

2. Zyra Kombëtare e Auditimit ta rrisë numrin e auditimeve të performansës, e veçanërisht për ndërmarrjet publike; dhe

3. Gjatë auditimeve të ndërmjetësve, Zyra Kombëtare e Auditimit ta mbikëqyrë zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga viti paraprak.

Këto janë rekomandimet që i ka prezantuar komisioni për miratim dhe ne u sugjerojmë të gjithë deputetëve që t'i votojnë këto rekomandime.

Gjithashtu, do të flisja edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, nëse më lejoni. Kryesues? Po vazhdoj.

Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e kemi shqyrtuar raportin vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit, i cili ka bërë një punë të mirë në realizimin e misionit dhe objektivave të saj të punës konform legjislacionit në fuqi, që rregullon veprimtarinë e saj.

Në këtë proces ka ndikuar edhe miratimi i Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit dhe hartimi i akteve nënligjore, të cilat si të tilla ia kanë forcuar pavarësinë funksionale, financiare dhe operative Zyrës Kombëtare të Auditimit. Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë periudhës raportuese ka arritur t'i përfundojë brenda afatit të gjitha raportet e auditimit të rregullsisë, të planifikuar sipas planit të paraparë.

Një element i rëndësishëm krahas punës së bërë në publikimin e raportit të auditimit të rregullsisë është edhe trendi i rritjes në publikimin e raporteve të auditimit të performansës, si dhe raporteve të auditimit të projekteve të financuara nga donatorë. Auditimi i performansës e promovon përgjegjshmërinë dhe ndihmon në përmirësimin e qeverisjes, prandaj është e domosdoshme që të vazhdojë më tutje me rritjen e numri të realizimit të këtyre auditimeve dhe në veçanti në fushat që gëzojnë prioritet, sikur arsimi, shëndetësia, mjedisi, zhvillimi ekonomik dhe sistemi i teknologjisë së informacionit.

Nëpërmjet realizimit të këtyre auditimeve do të ndikohet drejtpërdrejt në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të financave publike dhe të performansës së përgjithshme në nivel të ndryshëm të qeverisjes. Një nga treguesit kryesor të matjes së performansës së auditimit është shkalla e zbatimit dhe rekomandimeve. Megjithatë, edhe nëpërmjet këtij raportimi është evidentuar një

sfidë të cilën e kemi theksuar edhe më parë, se niveli i zbatimit të rekomandimeve nuk është i kënaqshëm.

Kjo argumentohet edhe nga të dhënat e raportit, ku vetëm 30% e rekomandimeve të tyre janë zbatuar plotësisht dhe sidomos përmbushja e rekomandimeve nga komunat mbeten në nivel të ulët.

Adresimi i rekomandimeve mbetet ende një aspekt që duhet të gëzojë prioritetin e angazhimeve tona të përbashkëta dhe t'i kushtohet vëmendje e veçantë, duke raportuar për progresin e arritur në mënyrë që të mos kemi përsëritje të dobësive dhe mangësive nga viti në vit.

Duke e vlerësuar punën e bërë në përmirësimin që në vitin vijues të kemi rritje të bashkëpunimit me Kuvendin me qëllim të rritjes së llogaridhënies në institucionet publike dhe implementimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit, rritjen e numrit të auditimeve të ndërmarrjeve publike, si një fushë që e pasqyron nevojën për përmirësim të menaxhimit të tyre, vazhdimin e trendit në rritje të numrit të auditimeve të performansës dhe projekteve që financohen nga donatorët, po ashtu fillimin e realizimit të auditimeve dhe të projekteve që financohen nga huamarrja shtetërore, me këtë edhe një herë ne si grup parlamentar ju sugjerojmë që t'i votojmë këto rekomandime. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti Lushtaku! Fjalën e ka zonja Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016. Gjatë shqyrtimit në bazë të Rregullores së Kuvendit, edhe në bazë të Ligjit parashihet që Zyra e Auditimit krahas raportit të përgjithshëm ta dorëzojë edhe një raport financiar.

Gjatë shqyrtimit të këtij raporti financiar ka qenë i pranishëm edhe Auditori i Përgjithshëm, i cili u është përgjigjur të gjitha kërkesave që kanë dalë nga Komisioni për Buxhet, u ka dhënë sqarim të gjitha çështjeve me interes për deputetët që janë anëtarë të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Në fund, është përkrahur unanimisht raporti financiar i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, pasi është konstatuar se raporti përmbush obligimet ligjore për raportim, të parapara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta përkrahë raportin financiar të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Prandaj, i ftojme deputetët që ta miratojnë këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të paraqitur për diskutime. E lëmë vetëm për votim.

#### **14. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016**

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk është. Kryetari i Komisionit Hapësinor, zoti Daut Haradinaj nuk është. Zonja Ganimete Musliu, në emër të komisionit, urdhëro!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Meqë mungon përfaqësuesi i Qeverisë, gjithashtu edhe kryetari i komisionit, me kërkesën e tij, zotit Daut Haradinaj dhe në mungesë të deputetëve për ta shqyrtuar dhe debatuar për këtë raport, ne kërkojmë që të shtyhet për seancën tjetër, ose thjesht ditën kur do të trajtohen edhe pikat që na kanë mbetur.

Kështu që i propozojmë seancës që sot të mos e ketë në rend dite këtë pikë.

KRYESUESI: Në rregull. Atëherë kanë ngelur që të vazhdohet seanca: Votimi i projektligjeve dhe rekomandimeve fillon nesër në orën 11:00 dhe besoj që do të jeni të pranishëm. Dua t'juja tërheq vërejtjen paraprakisht, që ata që nuk vijnë nesër për të votuar, nëse vjen kryetari do të kërkoj prej tij t'ua heq mëditjen, nëse nuk vjen kryetari unë do ta nxjerr vendimin për t'ua hequr mëditjet të gjithë atyre që nuk vijnë. Faleminderit!

\* \* \*

*E premte, 9 shkurt 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 8 shkurt 2018*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Në sallë i kemi 71 deputetë.

Ju lus që të votojmë për praninë, votojmë tash.

Gjashtë janë pa kartelë, katër nuk janë paraqitur, veç dy. Në rregull, 71 janë në sallë. Vendosi kartelat dhe besoj që në rregull është.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se për pikat 4, 5, 6, 7, 8, 11 dhe 13 të rendit të ditës diskutimet kanë përfunduar në seancën plenare më 8 shkurt 2018, por në mungesë të kuorumit për vendimmarrje nuk janë vënë në votim. Andaj, në seancën e sotme do të bëhet votimi si dhe do të shqyrtohen pikat 12 dhe 14, ndërsa pika 9 dhe 10 mbeten për një ditë tjetër.

Po filloj me votimin që ka mbetur pezull, t'i kryejmë votimet, pastaj e kemi çështjen e Komisionit për Bujqësi për ta shqyrtuar çështjen e mocionit të Lidhjes Demokratike.

#### ***4. Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-219 për të huajt***

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! Faleminderit!

Kanë votuar 69 me kartelë, dy janë pa kartelë. A je për a kundër? Kundër.

69 me kartelë, për janë 60, kundër 6 me kartelë e një pa kartelë, 7, kanë abstenuar 3.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-219 për të huajt.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

#### ***5. Votimi në parim i Projektligjit për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore***

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 69 deputetë, 69 janë për, asnjë kundër, asnjë abstenim.



Konstatohet se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta ndryshojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

#### ***6. Votimi në parim i Projektligjit për pajisjet nën presion***

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 72 deputetë, 71 për, asnjë kundër, një abstenim.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për pajisjet nën presion.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta ndryshojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

#### ***7. Votimi në parim i Projektligjit për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës***

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 72 deputetë me elektronikë, 2 pa elektronikë, për janë 71 deputetë, asnjë kundër, një abstenim.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta ndryshojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

#### ***8. Votimi i rekomandimeve lidhur me debatin parlamentar, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” lidhur me dënimin e disa aktivistëve të këtij subjekti politik***

Kërkohet deklarimi me votim për miratimin e propozim-rekomandimeve të paraqitura nga deputeti Sami Kurteshi, në emër të Grupit Parlamentar Lëvizja “Vetëvendosje” .

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kanë votuar 61 deputetë, për janë 38 deputetë, kundër 10, kanë abstenuar 13. Edhe 2 për. Janë 40 vota për, 10 kundër dhe 13 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi i miratoi rekomandimet lidhur me dënimin e disa aktivistëve të “Vetëvendosjes”.

***11. Votimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore për Persona të Pagjetur dhe Peticione në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës***

I votojmë rekomandimet e Komisionit Funkcional në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës.

Votojmë tani!

Kanë votuar 67 deputetë me kartelë, dy pa kartelë, 69 deputetë.

Për janë 55 me kartelë dhe dy pa kartelë, bëjnë 57, asnjë kundër dhe kanë abstenuar 12 vetë.

Konstatoj që Kuvendi i miratoi rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore për Persona të Pagjetur dhe Peticione në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës.

***13. Votimi i raportit vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016 dhe raporti i pasqyrave financiare të audituara për vitin 2016***

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Faleminderit! Kanë votuar 70 deputetë me kartelë, dy pa kartelë. A jeni për a kundër? Për! 63 janë me kartelë për, plus dy pa kartelë, bëjnë 65 për. Dy janë kundër, 5 abstenime.

Konstatoj që Kuvendi e miratoi raportin vjetor të performansës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016 dhe raportin e pasqyrave financiare të audituara për vitin 2016, së bashku me rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

***14. Shqyrtimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016***

Me kërkesë të kryetarit të komisionit, diskutimi është shtyrë për sot. Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016 dhe i ka rekomanduar Kuvendit për miratim. E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, nëse do të diskutojë, s’është paraqitur askush. Fjalën ia jap kryetarit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe

Planifikim Hapësinor, zotit Daut Haradinaj, për arsyetimin e raportit. Zoti Haradinaj, e keni fjalën!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Mendova që po e nxjerr në votim edhe mocionin e Lidhjes Demokratike të djeshme, se sot kemi kuorum. Sido që të jetë, Komisioni Funkcional më 29.01.2018 e ka shqyrtuar raportin e gjendjes në mjedis për vitin 2016. Ju e dini që javën e kaluar kemi pasur një situatë aspak të mirë të mjedisit, sidomos ndotjen e ajrit në Prishtinë, por komisioni në përbërje të plotë e ka miratuar dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sami Kurteshi, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ne kemi biseduar gjerë e gjatë, kemi diskutuar javën e kaluar për gjendjen e ndotjes së ajrit në Prishtinë, sepse shumica e njerëzve janë në Prishtinë, e siç duket preken drejtpërdrejt, e ndjejnë pak më shumë, por kjo është vetëm një pjesë e asaj çka ngjet në tërë Kosovën.

Ne kemi pasur një raport si çdo vit tjetër, raporti bëhet i bukur, i bën disa dhjetëra faqe, stilizohet mirë dhe në fund të ditës, vitin e ardhshëm ne konstatojmë përsëri se gjendja e ndotjes së mjedisit edhe ajrit, sepse ajri na ka munduar këto ditë, është përkeqësuar. Ne kemi një ligj për mbrojtjen e ambientit, e sidomos të ajrit nga ndotja nga viti 2010. Edhe ne në vitin 2018 po diskutojmë për një gjendje alarmante me premisa të rrezikut për shëndetin e njeriut për ndotjen e ajrit në Prishtinë dhe jemi fokusuar, siç thashë, vetëm në ndotjen e ajrit. Nëse ky Kuvend nuk ndërmerr asnjë hap për kontrollimin edhe marrjen e masave për zbatimin e këtyre ligjeve, për implementimin e këtyre ligjeve, edhe për kontrollin ndaj institucioneve përgjegjëse shtetërore, ne kemi disa masa jashtëzakonisht të rëndësishme, atëherë vetëm do të votojmë për raporte, ato sigurisht do t'i kalojmë, se në momente të caktuara do të ketë interesa për dhe kundër, por unë frikësohem se vitin e ardhshëm do të diskutojmë përsëri në këtë periudhë kohore për afërsisht kur edhe kushtet atmosferike do të jenë të tilla që mundësojnë një koncentrim të ndotjes së ajrit në Prishtinë, dhe frikësohem se do të konstatojmë se zhurma e madhe në Kuvend, diskutimi i flaktë dhe emocional nganjëherë, natyrisht shpeshherë edhe çdoherë politik, sepse ne jemi institucion politik këtu, nuk ka pasur ndonjë vlerë, për arsye se masat e proklamuar nuk janë zbatuar.

Ne kemi një degradim të vazhdueshëm, në mënyrë lineare, të ambientit në Republikën e Kosovës. Sot nuk ka asnjë lumë të madh në Republikën e Kosovës, shtrati i të cilit nuk shkatërrohet, në të shumtën e rasteve në mënyrë ilegale, me gjithë ekzistimin e inspektorateve dhe me gjithë ekzistimin e institucioneve shtetërore, përgjegjëse edhe kompetente për të ruajtur ambientin. Ne kemi shkatërrimin e ambientit të ujit në gjithë Kosovën. Kemi komuna në Republikën e Kosovës ku asnjë rrjedhë natyrale e ujit nuk është e pandotur. Për të gjitha

komunat nuk mund të flas, edhe pse kaloj nëpër to, por për komunën e Gjilanit flas me një siguri të qindpërqindtë. Asnjë rrjedhë natyrale e ujërave në komunën e Gjilanit nuk është e pandotur, edhe thënë e helmuar.

Ne kemi një ndotje të jashtëzakonshme në periudha të ndryshme kohore edhe të ajrit, edhe të tokës, sidomos gjatë verës, me djegien e atyre që ne i quajmë stërnishta, hamulloreve, edhe shpeshherë është kërkuar ndërmarrja e masave, deri sot vazhdon me intensitet të njëjtë. Ne kemi shkatërrimin e maleve tona për gurthyesit me licencë e pa licencë që shkatërrojnë ambientin, shkatërrojnë edhe bukuritë dhe gjithçka tjetër.

Kemi një gjendje të kujdesit ndaj këtyre vendeve ku mblidhen mbeturinat që janë rajonale, e unë po flas me kompetencë të madhe për Gjilanin. Unë them se hapësira ku është vendosur ky mbledhësi rajonal i mbeturinave është jo një bombë e vogël, po është një bombë jashtëzakonisht e madhe, e cila mund të eksplodojë në çdo moment, edhe atë po e them në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Aty përveç ndotjes së ujërave nëntokësore, ndotet i tërë ambienti rreth atij lokacioni ku mblidhen këto mbeturina, madje kemi edhe viktimë njerëzore që kanë humbur jetën nëpër këto lokacione dhe askush nuk ka marrë përgjegjësi.

Përveç këtyre, kemi edhe një ndotje të jashtëzakonshme nga zhurma, sidomos në qytetet e mëdha. Unë e di se dikush thotë “jo më pak, jo më shumë”. Në qytetet e mëdha të Republikës së Kosovës shpeshherë, sidomos në sezonin e verës njerëzit në pjesë të ndryshme të qyteteve nuk mund të flenë tërë natën për shkak të zërit të lartë të muzikës. Unë e di se shumë njerëz e kanë ngritur edhe çështjen e kabanave të kishës, apo zërit të xhamisë, po ato janë çështje që mund të rregullohen dhe rregullohen sipas ligjit. Por, ne duhet ta ngremë në të njëjtin nivel edhe çështjen e zhurmës së madhe që bëhet nga burime të ndryshme që shumë herë tejkalon norma të caktuara.

Ne mund ta kalojmë këtë raport, nuk është ndonjë problem, siç kemi kaluar edhe shumë raporte të tjera, por unë megjithatë po them se ne nuk mund t'i mbyllim sytë e veshët pas votimit të raportit dhe të presim një vit ose disa muaj, e pastaj të alarmohemi për gjendjen e ndotjes qoftë ujit, tokës apo ajrit. Edhe krejt për fund, nëse ne nuk tregojmë ndonjë përgjegjësi për zbatimin e ligjeve, jo për votimin apo mosvotimin e raporteve, por për zbatimin e ligjeve që kemi për mbrojtjen e ambientit, përveç përgjegjësisë sonë ligjore, ne e bëjmë edhe një shkelje jashtëzakonisht të madhe dhe dëshmojmë si gjeneratë se jemi të papërgjegjshëm dhe më josolidarë me gjeneratat e ardhshme, sepse ky vend mbetet, të gjithë ne do të shkojmë një ditë. Po, kemi përgjegjësi jashtëzakonisht të madhe çka po u lëmë gjeneratave të ardhshme. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hoti, me radhë, ashtu si jeni paraqitur. Në emër të grupit, zoti Hoti e ka fjalën.

ANDIN HOTI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshendetje, kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë po flas edhe në emër të grupit, edhe në emër timin, kryesues. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, ne e përkrahim raportin me rekomandime lidhur me raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë, për vitin 2016, raport i cili ka ardhur nga Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Nëse më lejoni tash edhe në emër timin, zoti kryesues. Ky raport paraqet gjendjen reale të mjedisit në Kosovë, në veçanti për tokën, ujën, ajrin dhe mbeturinat. Ne jemi dëshmitarë të asaj se çfarë po ndodh me mjedisin në Kosovë, me ajrin të cilin e absorbojmë qytetarët e Republikës së Kosovës, me degradimin e lumenjve dhe tokave bujqësore, me kundërmimin e mbeturinave anekënd Kosovës. Pra, asnjë dikaster mjedisor nuk është në gjendje normale. Por, siç duket, ne jemi mësuar se çdo gjë të na zërë të papritur, e atëherë të na bie ndërmend dhe si pasojë e kësaj na është vështirësuar edhe esencjalja për jetesë, pra na është vështirësuar edhe ajri, këto ditë ka qenë shumë aktuale në Kosovë. Jemi dëshmitarë të shumë epidemive të ndryshme në Kosovë, si dhe hasim çdo ditë në lajme të tilla, siç është rritja e përvitshme e rasteve të kancerit në Kosovë.

Pra, edhe kanceri është bërë gripoz në vendin tonë. Uroj dhe besoj fuqishëm, por kërkoj që ky raport të trokasë në ndërgjegjen e atyre që janë përgjegjës për një mjedis kaq të rëndë në Kosovë dhe të marrin masat e menjëhershme dhe serioze në trajtimin e këtyre çështjeve që janë në këtë raport dhe jashtë tij. Ne kemi obligim që të përmirësojmë jetën e qytetarëve të Kosovës, e fëmijëve tuaj dhe tanë.

Dhe, për fund, shikoni se sa të përparuar jemi si vend. Ne sot duhet të flasim, të diskutojmë për një raport të para dy vjetëve, do të thotë për vitin 2016, në vend se të flasim për raportin e gjashtë muajve të fundit dhe në vend se të flasim për rekomandimet për mjedis për vitin 2018-2019 e tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, zoti Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ne kemi raportin e Drejtorisë së Mjedisit, e kemi trajtuar në komision, po ashtu e kemi mbështetur, edhe pse i kemi vërejtjet që do t'i themi këtu.

Gjendja e mjedisit në Kosovë është jo e mirë, është bukur e rëndë e faktor kryesor është faktori njeri. Këtu s'kemi asnjë dilemë! Ajo që është duke ndodhur me degradimin e mjedisit, ka adresën, dihen, ka operatorë, të cilët nuk japin përgjegjësi dhe nuk zbatojnë asnjë masë, të cilën e marrin institucionet përkatëse dhe unë do t'i veçoja, do t'i ndaja kështu: degradimi që po ndodh

në mjedis dhe kemi pasoja të rënda si për shëndetin, po ashtu edhe për ambientin, ekonominë dhe në të gjitha sferat dëmet janë të mëdha dhe me pasoja afatgjate, ndodhin si në fazën e planifikimit, ashtu edhe në fazën e zbatimit të atyre planeve, të cilat realizohen nga institucionet përkatëse.

Planifikimi nuk bëhet siç duhet, bëhet me të meta dhe bëhet për të mos u realizuar. Ne kemi pas drejtorin, zotin Morina, në komision dhe e kemi dëgjuar me vëmendje disa informacione që i ka paraqitur aty. Ka thënë që ka mungesë të inspektorëve, ka mungesë të kuadrit profesional, ka mungesë të pajisjeve dhe të gjitha ato mund të qëndrojnë. Po kush është faktori, kush është fajtori, sepse këto kapacitete nuk janë plotësuar në institucionet, të cilat duhet të merren me mbrojtjen e mjedisit. Ne themi dhe jemi të bindur se janë prapë drejtuesit e institucioneve, organet qeveritare në të gjitha nivelet.

Mandej, kemi hasur në penalizime dhe në pak masa, të cilat kanë guxuar t'i marrin inspektorët, po e them edhe po e theksoj edhe një herë, kanë guxuar, sepse ata shpeshherë nuk guxojnë edhe të shkojnë t'i shohin se si veprojnë operatorët, se si e shkatërrojnë ambientin, qoftë në lumenj, qoftë nëpër gurthyes, mandej kemi edhe pasojat ku, për shembull, në Ostrazub ka edhe plasaritje të shtëpive nga shfrytëzimet që bëhen në formë të egër dhe pa kurrfarë masa mbrojtëse. Edhe nëse ata guxojnë të shkojnë t'i inspektojnë ata operatorë, të cilët e shkatërrojnë mjedisin, prapë ato masa ngelin në gjysmë. Nuk funksionojnë masat penalizuese, as në sistemin e drejtësisë dhe as në sistemin e policisë.

Këto ditë e patëm një gjendje bukur të rëndë. Sa herë të vijë dikush në pushtet thotë kam filluar të ndërtoj një planifikim, kam filluar të bëj diçka, e kam nisur, duhet ta bëjmë e do ta bëjmë, kjo është një gjendje e cila kërkon përgjegjësi shtesë. Është një gjendje, e cila kërkon një aktivitet këmbëngulës dhe masa të vendosura e të zbatueshme. Po them, të zbatueshme, sepse pengesat bëhen kryesisht nga njerëzit, të cilët kanë përfitime dhe nëpërmjet mosrealizimit dhe funksionimit të atyre masave, ata i realizojnë përfitimet e tyre, mandej edhe ato përfitime që i realizojnë, as ato pak përgjegjësi financiare që i kanë për t'u ofruar atyre komunave, ku më së shumti bëhet degradimi i tyre, nuk i kryejnë as ato obligime ligjore që mund të jenë shumë simbolike në krahasim me ato çka përjetojnë banorët e atyre komunave dhe vetë ato komuna.

Qoftë me planet e tyre hapësinore, qoftë me planet e tyre për zhvillim ekonomik, qoftë në jetën e qytetarëve, prandaj po themi që jemi para një gjendje bukur të rëndë, shumë të vështirë dhe do të bëhet akoma më e vështirë nëse institucionet përgjegjëse nuk marrin masa që t'i zbatojnë planet e tyre dhe masa efektive penalizuese. U dëgjua këtu shpeshherë, edhe në seanca të tjera, se ndotësit duhet të paguajnë. A kemi ndonjë listë? Cilët janë ata ndotës? Cilat janë penalizimet e tyre? Kush janë ata operatorë ekonomikë? Kështu që ne e mbështesim këtë raport, mirëpo kërkojmë që ndoshta në një ardhme të afërt ministria përkatëse të na sjellë edhe ndonjë listë të këtyre shkatërruesve të mjedisit dhe të ambientit, ta kemi një listë të qartë kush janë ata njerëz

dhe kush janë ata operatorë ekonomikë që po e bëjnë gjithë këtë zullum, do të thosha, në mjedisin dhe ambientin që na rrethon. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është e drejtë jona që të kërkojmë, është mirë ta kërkojmë. Faleminderit! Danush Ademi nga Grupi “6+” e ka fjalën

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Grupi “6+” e ka shqyrtuar raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016. Është diskutuar para disa ditëve edhe për ndotjen e ajrit në Kosovë që ishte goxha alarmante, po asnjë nuk e dëgjuam, sepse komunitetet vazhdimisht një pjesë e numrit të të varfërve shkojnë nëpër kontejnerë tërë ditën dhe nuk është diskutuar për ta, sepse a është në pyetje edhe prishja e ajrit përderisa ata tërë ditën janë nëpër kontejnerë dhe vrapojnë pas kamionëve, ku i hedhin mbeturinat nëpër deponi, për të siguruar një ekzistencë për komunitete. Shtrohet pyetja, ajri a është i ndotur edhe për ata persona?

Unë mendoj se institucionet duhet të mendojnë edhe për këtë kategori e të mos i lënë, jeta e qytetarëve duhet të jetë e barabartë për të gjithë, e jo për dikë të jetë pak më pozitive, e për dikë të jetë pak më negative. Unë mendoj që duhet të mendohet edhe për këtë kategori të njerëzve, të cilët janë të papunë dhe vazhdimisht shkojnë me padurim i presin hedhjen e mbeturinave, mbledhin kënaçe për të siguruar një ekzistencë të fëmijëve të vet. Unë mendoj që edhe aty është një prishje e ajrit ndoshta, por asnjëherë ata nuk e kursejnë vetveten vetëm për të siguruar një ekzistencë të fëmijëve.

Mendoj që institucionet duhet të jenë pak më syçelur, e thashë edhe më herët dhe kam dalë nga seanca kur ka qenë për ndotjen e ajrit, sepse kam dashur ta them atëherë këtë temë, por tash prapë më erdhi mundësia. Unë mendoj që duhet të mendohet për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës pa dallim.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në mes të shkurtit të vitit 2018, po e shqyrtojmë raportin për gjendjen e mjedisit të vitit 2016. Tash duke parë këtë distancë kohore, nuk e di sa është serioze apo i dobishëm ky diskutim. Qëllimi i këtij diskutimi është që Parlamenti të njoftohet dhe nëse është e nevojshme, të shtyjë marrjen e masave për të ndryshuar situatën.

Tash, jo vetëm se ka nevojë për angazhime shtesë, por në ndërkohë situata në terren ka ndryshuar, përgjithësisht për keq. Kosova është vend me territor relativisht të vogël, si rrjedhojë secili nga ne mbërrin të jetë dëshmitar edhe okular i degradimit të mjedisit kudo. Nëse lexojmë

raportin e paraqitur, kjo pak a shumë edhe konfirmohet. Po t'i krahasoni raportet e të paktën këtyre 4 vjetëve të fundit, do të gjeni të njëjtat konkludime. Nëse i trajtojmë të dhënat për nivelin e ndotjes së ajrit, s'ka se si të mos bëjmë lidhshmëri me situatën katastrofave të ndotjes së ajrit në Prishtinë, e të mos flasim për ndotjen e ajrit në komunën e Kastriotit, në Drenas dhe komunat përreth "Sharrcem"-it.

Tash për shkak të ndotjes së ajrit edhe statistikat mbi sëmundjet kardiovaskulare e respiratore janë vështirë të përditësohen me saktësi, për shkak të rritjes enorme të numrit të qytetarëve të prekur nga këto sëmundje, si dhe mungesës së sistemit informativ shëndetësor. Ky raport, po ashtu konfirmon raportime të tjera të bëra nga shumë palë mbi ndotjen e ujërave në vendin tonë. Situata është më se alarmante, shumica e lumenjve të vendit rezultojnë të mbindotur, ndotësit kryesorë të ujërave janë derdhja e drejtpërdrejtë e ujërave të zeza, të patrajuara fillimisht, shirat acidike si rrjedhojë e ndotjes së ajrit, shpëlarjes së tokave bujqësore të trajtuara me plehra kimik, si dhe shkarkimit industriale të veprimtarive të ndryshme.

Nuk ka ditë ku nuk vijohet me degradimin e shtretërve të lumenjve nga eksploatimet e egra. Tash po listoj vetëm disa nga masat që duhet të merren e të cilat janë emergjente.

Sa më parë duhet rregulluar shtretërit e lumenjve, të ndërtohen kolektorët që parandalojnë derdhjen e ujërave të zeza në lumenj, si dhe të ndërtohen impiante që trajtojnë këto ujëra. E po ashtu rreptësisht duhet të ndalohet derdhja e shkarkimeve industriale të veprimtarive të ndryshme. Edhe ndotja apo degradimi i tokës është në nivel tmerrësisht keq, prerja ilegale e pyjeve, gurthyesit që në mënyrë të egër, të pakthyeshëm degradojnë tokën tonë. Këtij problemi në masë të madhe i kontribuon ndryshimi i destinimit të tokës nga tokë bujqësore në atë ndërtimore, si nga ndërtimet me leje, e posaçërisht nga ato pa leje.

Të dhënat që dalin nga ky raport, si dhe të dhënat e tjera për gjendjen aktuale na obligojnë që seriozisht të debatojmë për këtë problem jetik tonin. Nëse gjendja nuk është përmirësuar nga 2016 e deri tash, e sipas të gjitha informatave veçse sa është degraduar, atëherë ky Kuvend duhet të detyrojë të gjitha instancat përgjegjëse të mobilizohen drejt përmirësimit afatgjatë të mjedisit tonë. Ky raport si ndotësit më të mëdhenj identifikon KEK-un, "Ferronikel"-in, dhe "Sharrcem"-in, e më e keqja është se edhe matjet e ndotjes u janë lënë atyre t'i bëjnë e t'i paraqesin. Por edhe pse më të mëdhenj, fatkeqësisht nuk janë të vetmit. Që gjendja të përmirësohet radikalisht, ashtu siç ka nevojë, ne duhet të rrisim nivelin e përgjegjësisë e po ashtu edhe vetë mënyra e sjelljes sonë. E nëse nuk ka sjellje të përgjegjshme, duhet të ketë patjetër ndëshkime. Më mirë sot nga sistemi, se sa nesër nga natyra. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Nezir Çoçaj e ka fjalën.



NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Bazuar në raportin e vitit 2016, gjendja e mjedisit në vendin tonë nuk është e mirë, por njëkohësisht përmirësimit të saj nuk i kushtohet vëmendje e duhur dhe si e tillë paraqet sfidën më të madhe, me të cilën do të përballet shteti ynë me synimin e përgjithshëm strategjik drejt integritimit evropian dhe implementimit të standardëve duke përbushur në sektorin e mjedisit.

Shfrytëzimi i egër resurseve natyrore, mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura, menaxhimi i dobët i deponive industriale dhe të amvisërisë, ndërtimet pa kritere, teknologji të vjetruara paraqesin problemet kryesore mjedisore në vend. Ndotja e ajrit në zonat urbane dhe veçanërisht në ato në zonat industriale vlerësohet të jetë e lartë. Aktualisht kontribuuesit më të mëdhenj në këtë ndotje janë termocentralet, impiantet me djegie të mëdha, sektori i transportit, impiantet me djegie të vogël, aktivitetet bujqësore, deponitë e mbeturinave, deponitë sanitare, e tjerë. Deponitë ilegale janë në numër të madh nëpër komunat tona dhe kjo është tepër shqetësuese për rritjen e vazhdueshme të numrit të tyre. Po ashtu edhe mbeturinat spitalore dhe industriale janë në rritje e sipër.

Karakteristikë negative e këtyre deponive janë rrjedhjet e ujërave nga deponitë në mjediset përreth dhe mosmenaxhimi i duhur i kompanive. Edhe degradimi i tokës nuk ka të ndalur, dukuritë negative, si prerja dhe djegia e pyjeve, erozioni dhe degradimi i lumenjve nga shfrytëzimi i pakriterit të tyre. Degradimi i natyrës, humbje e burimeve tokësore dhe ndryshimeve të destinimit të tokës, ndërtimet pa kriter janë ndër faktorët e denigrimit të tokës, duke përfshirë edhe industrinë, bujqësinë, mbeturinat, transportin që janë ndotës të tokave në Kosovë. Shumë tokë bujqësore në Kosovë, sidomos ajo që është përreth shtratit të Drinit të Bardhë, e cila është shumë pjellore, por që ka mbetur e papunuar që një kohë të gjatë dhe, në fakt, është shkatërruar edhe rrjedhja natyrore e Drinit për shkak të këtyre faktorëve.

Niveli i lartë i varfërisë dhe ekonomia joformale ka bërë të rrezikohet kapaciteti ekonomiko-mjedor i tokës. Ky presion reflektohet nëpërmjet shfrytëzimit pa kriter të lëndëve minerale, druve dhe fryteve pyjore, si dhe zbatimi i praktikave jo të qëndrueshme për pylltari dhe bujqësi. Pasojat e një praktike të tillë reflektohen me dëmtime të ndryshme të tokës, si erozioni, ngjeshja e tokave, si dhe zvogëlimi i plleshmërisë së tokës. Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2015 ishte 410 427 hektarë, pjesa më e madhe janë livadhe dhe kullota që përshin rreth 53%, ndërsa tokat e kultivuara janë rreth 45%. Sipas Ministrisë së Bujqësisë, rreth 6 mijë e 800 hektarë kanë qenë tokë bujqësore të pashfrytëzuara.

Kosova po ashtu ka rreth 464 800 hektarë pyje që janë diku rreth 8% më shumë se matjet e mëparshme, por që nuk janë të nivelit të duhur. Ndikimet e shpyllëzimeve vërehen në shtimin e erozionit të zonave malore, degradimin e tokave pyjore, zvogëlimet e llojit të florës dhe faunës,

reduktimin e prodhimit të oksigjenit, vërshimet e tokave bujqësore, si dhe ndryshimet e peizazhit. Po ashtu vërehet destabilizim i ekosistemit, ndryshimet klimatike, e tjerë. Kështu që do të duhej të pyllëzoheshin sa më shumë tokat pyjore. Mbrojtja e dheut, gjegjësisht e tokës bujqësore është kryesisht përgjegjësi e Qeverisë, nëpërmjet legjislacionit që ndalon ndërtimin në tokën e destinuar për qëllime bujqësore. Unë po shpresoj që Qeveria do të marrë masat e duhura, por po e shoh që asnjëri nga ministrat përkatës, as ministrja e Mjedisit dhe as ministri i Bujqësisë nuk janë, por po shpresoj që Qeveria në përgjithësi do ta ketë prioritet këtë situatë.

Edhe gjendja e resurseve ujore në Republikën e Kosovës është e vështirë, në përgjithësi nuk ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme mbi cilësinë dhe sasinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, si edhe për përdorimin e tyre. Ujërat nëntokësore vlerësohen të jenë të ndotura sidomos përgjatë aluvialeve në të dyja anët e pellgut të lumit Drini i Bardhë dhe lumit Sitnica. Monitorimi vazhdon të mbetet çështje problematike, edhe pse janë bërë disa intervenime në rrjetin e monitorimit të ujërave sipërfaqësore, por ende nuk kemi një sistem të rregullt monitorues.

Të dhënat për rrjedhat në lumenjtë e Kosovës mbeten vetëm një vlerësim i bazuar në vrojtimit hidrologjike të pasqyruara në masterplanin e ujërave 1983-2000. Megjithatë, disa të dhëna janë të disponueshme nga disa studime apo projekte të financuara nga Komisioni Evropian dhe të implementuara nga kompani të ndryshme të shteteve të BE-së. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pantina e ka fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Mua po më vjen keq që ministrja Reshitaj nuk është sot këtu, sepse mendoj që çështjet e mjedisit do të duhet të diskutoheshin edhe më shpesh, jo vetëm kur vijnë raporte të tilla, ose siç e kishim javën e kaluar, kur gjendja bëhet aq alarmante sa që çdo diskutim pastaj nuk ofron zgjidhje.

Sa i përket raportit unë dua ta tërheq vëmendjen e shpresoj që zonja Reshitaj do të njoftohet më vonë me të gjitha diskutimet e deputetëve, por për dy çështje thelbësore ose, në fakt, edhe një më pak, e cila po e degradojnë tej mase mjedisin e pasojat e të cilëve veç kemi filluar t'i ndiejmë, por do të bëhen akoma më të rënda në qoftë se nuk ndërmerren masa të menjëhershme, masa serioze, jo thjesht strategji e plane të veprimit që mbesin në letër e duken bukur kur i lexon, por që asnjëherë nuk zbatohen në praktikë. Kur jemi te mjedisi dhe raporti, unë dua të tërheq vëmendjen e para për shkatërrimin e lumenjve që po bëhen.

Unë para pesë vjetëve kam qenë vetë anëtare e një iniciative të një grupi të njerëzve dhe organizatave të shoqërisë civile atë kohë, që patëm filluar një iniciativë për mbrojtjen e lumit Drini i Bardhë nga shkatërrimi. Shkatërrime, të cilat natyrisht bëhen nga dora e njeriut, por që janë dy lloje të tyre. E para është hedhja e mbeturinave që bëhet kryesisht nga bizneset që

operojnë përreth lumit Drini i Bardhë, por edhe nga qytetarët, të cilët e përdorin dhe jo vetëm lumin Drini i Bardhë, por shumicën e lumenjve në Kosovë si një deponi, ku ata i hedhin mbeturinat. Natyrisht se ky është problem, por me një vullnet dhe gatishmëri të institucioneve mund të sanohet më shpejt, sepse thjesht duhet të ndërmerret angazhim serioz për pastrimin e lumenjve, por rreziku i dytë që vjen, e që është më vështirë i sanueshëm, është eksploatimi i rërës që bëhet në lumenj.

Nëse e shikoni përgjatë lumit Drini i Bardhë, por edhe lumenjtë e tjerë, sidomos te komuna e Rahovecit, në pjesën ku kalon Drini i Bardhë, mund të shihni se tashmë edhe shtrati i lumit ka devijuar dhe kjo shumë shpejt, nëse do të kemi reshje të mëdha të shirave, do të bëhet problem për vërshim të atij lokacioni përgjatë lumit Drini i Bardhë. Ndonëse ka pasur disa iniciativa nga Inspektorati dhe disa nga bizneset janë paraqitur edhe në Polici, por rastet kanë shkuar deri në gjykata, as gjykatat nuk e kanë kryer punën e tyre përfundimisht, sepse shumë pak këta keqbërës janë dënuar.

Çështja e dytë, e që prapë lidhet me ujin në mënyrë indirekte, ka të bëjë me gurthyesit. Tashmë pjesa më e madhe e Kosovës ku ka gurore janë shndërruar në gurthyes, ku shumica prej tyre, siç e pati pranuar edhe ministri i mëhershëm, nuk posedojnë as pëlqim mjedisor apo leje mjedisore. Ato që posedojnë leje mjedisore janë të detyruara që pas eksploatimit të gurëve që ata i përdorin për ta shndërruar në zhavorr, duhet të bëjnë sanimin e gjendjes, varësisht se me çfarë obligimi e kanë marrë lejen mjedisore, por shumica prej tyre nuk e bëjnë gjë të tillë.

Unë vetë vij nga rajoni i Klinës, ku një lokacion atje është shumë i pasur me gurë dhe janë mbi 7 gurthyes që operojnë aty, dhe vitin e kaluar, e kam frikë se ky problem do të jetë edhe këtë vit, banorët e asaj ane, përveç që kanë pasur problem nga dridhjet, nga detonimet, e përmendi edhe zoti Hoti nga “Nisma”, ku shumë shpesh edhe shtëpitë janë çarë për shkak të detonimeve të mëdha, por kanë filluar të kenë problem edhe me ujin e pijshëm, sepse burimi kryesor i ujit atje ende mbeten puset, ende nuk ka ujësjellës, ku do të përpunohej uji, por furnizohen direkt nga puset, e për shkak të këtyre gurthyesve ujërat nëntokësore kanë devijuar dhe si pasojë qytetarët e këtyre zonave kanë pasur problem me ujë të pijshëm.

Këtu fajtorë kryesorë natyrisht se mbetet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, të cilët duhet të kujdesen që këta gurthyes, e para, kur i marrin lejet dhe pëlqimet mjedisore, t’i marrin ato në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, e dyta, të monitorohet puna e këtyre gurthyesve, për të parë nëse ata po i zbatojnë kriteret në bazë të të cilave janë pajisur me leje mjedisore.

Dhe, çështja e tretë, po ashtu që ka të bëjë me mjedisin, e që po ashtu fajtori kryesor është faktori njeri, por njeri në kuptimin njerëzit që mbajnë pozita në institucione, shkatërrimi i pyjeve. Dhe kjo ndodh çdo vit, ku një pjesë e madhe e njerëzve, të cilët ngrohen me drurë, i prenë pyjet pa

kriter, jo vetëm pyjet që janë në pronësi e tyre private, por edhe ato që janë pronësi shtetërore. Këtë e bëjnë me miratimin e atyre që, në fakt, janë përgjegjës për ruajtjen e tyre. Natyrisht që edhe këtu kemi elemente të veprave penale, por edhe gjyqësori, si në çdo fushë tjetër, ka qenë tejte neglizhues edhe në rastet kur këto kanë mbërritur në gjykata. Pra, ne ende jemi në fazën kur mund të parandalojmë shkatërrimin që po i bëjmë mjedisit.

Unë shpresoj që edhe diskutimi i sotshëm do të jetë një tërheqje vërejtjeje, në mënyrë që Ministria e Mjedisit, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit, por edhe të gjitha institucionet e tjera përgjegjëse të marrin masa, e që ne të mos detyrohemi të vijmë në një pikë të diskutojmë për pasojat, ashtu siç diskutuam ditë më parë për pasojat e ndotjes së ajrit në Prishtinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Pacolli.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Përsëritje kolegë,

Përsëritje Kabinet qeveritar,

Me të vërtetë është për keqardhje të diskutohet për një raport të dy vjetëve më herët, por megjithatë ne e mbështesim këtë raport si AKR, por dua të shtoj diçka tjetër. Gjendja e mjedisit mund të rregullohet me një projekt nacional, pasi që duke marrë parasysh që gjendja e mjedisit është të mos them katastrofë, por për keqardhje.

Duke filluar me një projekt nacional dhe duke filluar te respektimi i ligjit dhe të mos jetë asnjë njeri i përjashtuar nga ligji, atëherë kjo gjendje mund të rregullohet. Sigurisht që janë shumë faktorë, ne përmendën disa prej tyre, si KEK-u, “Ferronikeli”, “Sharrcem”-i, po jo vetëm. Nuk janë vetëm këta, këta janë kryesorët, se sot për sot janë gurthyesit, devijimi, degradimi i lumenjve, pyjeve, tokave bujqësore, të cilat po degradohen çdo ditë. Pse? Po kthehem prapë te pika e mëhershme, duke marrë parasysh që nuk respektohet ligji, dikush është mbi ligjin e dikush s’ka mundësi as brenda ligjit të jetë.

Ne këtë çështje duhet ta rregullojmë në rend të parë, pastaj të rregullojmë çështje të tjera. Ky projekt nacional është i rëndësishëm, të rregullojë sot për sot, kemi shumë sëmundje, sidomos me kancer. Prej nga vijnë?! Prej nga ndotja e ajrit, nga mbeturinat, nga të gjitha këto që u përmenden, nga lëndët djegëse, që sot Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ende nuk e kryen detyrën mjaftueshëm mjaftueshëm, që do të jenë një kontroll adekuat i cili nuk toleron për askënd. Për lëndët djegëse i kërkoj Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë të mos ua shikojë ngjyrën, por të bëjë kontrollimin adekuat dhe ne e mbështetim atë. Sigurisht se nuk është sot, kjo është me vite duke vazhduar. Besoj se tani do të ndryshojë kjo gjendje. E lus ministrin që ta ketë parasysh. Ministria e Zhvillimit, natyrisht këto kritere e kushte që i kemi vënë duhet t’i realizojë dhe të gjitha ministrinë tjera, pa i përmendur këtu me radhë. Sot, për shembull, ekziston Miniera e Artanës, e tutje vazhdon të ndotet lumi nga miniera. A nuk është e mundur të bëhet një zgjidhje,

të ndahet një buxhet nga ministria përkatëse, hartim i projektit dhe të rregullohet ajo çështje. Sot e ka një ngjyrë tërësisht tjetër, për shkak se ndotet nga Miniera e Artanës dhe prej fillimit e tutje nuk ka asnjë gjallesë në këtë lumë. Do të thotë, është një dëm i madh.

Duhet t'i përcaktojmë këto kritere, këto pika dhe ne t'i realizojmë e t'i respektojmë këto rregulla. Të mos jetë asnjë njeri mbi ligjin, nëse e duam Kosovën. Ky është vendi ynë dhe ne duhet ta respektojmë ligjin, së pari ne vetë, e pastaj të kërkojmë prej të tjerëve. Domethënë, kërkon një respektim të veçantë, të cilin ne duhet ta respektojmë dhe ta çojmë përpara.

Janë për keqardhje të gjitha këto degradime. Besoj që ka mundësi të rregullohen. Sigurisht, e përshëndes edhe aksionin që u mor pak më herët, para ca ditësh, nga Ministria e Ambientit dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Komuna e Prishtinës, por kjo nuk mjafton për arsye se jo vetëm Komuna e Prishtinës, e Kastriotit, e Fushë-Kosovës, Drenasit, të gjitha këto janë të dëmtuara nga mosrespektimi i ligjit, për arsye se të gjithë këta faktorë që e ndotin ambientin duhet pasur kritere dhe të mos lejohet asnjëri që të vazhdojë me ndotjen e ambientit pa kriter. Duhet hyrë brenda rregullave, brenda ligjit dhe ne të ecim përpara. Në asnjë moment ndryshe nuk do ta përkrahja.

Prandaj, kërkoj që të merren parasysh kërkesat tona, shqetësimet tona dhe normalisht ne e përkrahim këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Driton Çausi e ka fjalën.

DRITON ÇAUSHI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Deputetë të pranishëm,

Me siguri se të gjithë mund të flasim për aspekte të ndryshme të ndotjes dhe të gjendjes së rëndë të mjedisit në Republikën e Kosovës, megjithatë ky diskutim është thirrur për një raport që e trajton gjendjen e mjedisit.

Mendoj që është për keqardhje që ky raport ka kaluar në Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor. Ka qenë një situatë urgjente, të themi, e ndotjes së ajrit në Prishtinë dhe besoj që kur e lexon pak më në detaje dhe e analizon këtë raport, është gjithçka tjetër përveçse një pasqyrë e gjendjes së mjedisit në Republikën e Kosovës. Do t'i përmend disa aspekte nga ky raport, të cilat na çojnë vetëm në një përfundim, se nuk do të ishte e drejtë që një raport me kaq shumë mangësi të kalojë, ose ta marrë mbështetjen e këtij Kuvendi.

Në fillim, në hyrje të këtij raporti, te qëllimet, thuhet se ky raport duhet ta paraqesë gjendjen e mjedisit dhe ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës. Janë dy gjëra, dy qëllime, shumë të rëndësishme të cilat nuk i përmbush në asnjë aspekt, duke filluar nga ajri, mënyra sesi paraqiten ndotësit, emetimi i tyre dhe ndikimi i tyre në ajër është absolutisht joprofesionale. Ndotësit

kryesorë, siç janë dioksidi i sulfurit, dioksidi i azotit, grimca të madhësive të ndryshme, paraqiten në grafikone përgjatë gjithë vitit dhe kjo është problematike, kjo është me ose pa vetëdije, manipulim i opinionit, për shkak se këto grimca ose këta ndotës paraqesin problem në sezonin e dimrit. Kur i shpërndan përgjatë gjithë vitit si të dhëna vjetore, shumica prej tyre na dalin nën nivelet e lejuara, pra nën atë pragun që paraqet rrezik për shëndetin. Sipas këtyre grafikave, gjendja e ajrit në Prishtinë, po edhe në Republikën e Kosovës, nuk del problematike.

Një problem tjetër të monitorimi i cilësisë së ajrit është mungesa e plotë e trajtimit të emetimeve të metaleve të rënda, siç janë plumbi, arseniku dhe të tjerë. Duhet thënë se plumbi është metali më neuro-toksik, ose më i dëmshëm, që lirohet nga termocentralet. Në këtë raport nuk trajtohet fare prania e plumbit, pra nuk ka asnjë matje për plumbin, duke e ditur se është problem serioz që rrjedh nga termocentralet Kosova A dhe B, e sidomos nga Kosova B, por edhe në zonat tjera të Republikës së Kosovës. Pra, nuk ka asnjë matje për plumbin.

Uji gjithashtu nuk merr kurrfarë trajtimi që duhet të ketë në këtë raport, pra mjafton fakti që ujërat nëntokësore nuk maten fare për cilësinë e tyre në Republikën e Kosovës nga kjo agjenci. Pra, nuk kemi asnjë të dhënë për ujërat nëntokësore. Kjo është shumë problematike për shkak se ne e dimë se menaxhimi i ujërave të zeza është në gjendje të rëndë në Republikën e Kosovës. Menaxhimi i mbeturinave sipas këtij raporti është çdo ditë e më i keq. E kemi një intensifikim të blegtorisë, proces i cili shkakton ndotje më të madhe të ujërave nëntokësore, por në këtë raport nuk kemi asnjë matje të cilësisë së ujit dhe ky është burim serioz i ndotjes së tokës, së ushqimit dhe përfundimisht të shëndetit publik.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm, i patrajtuar fare në këtë raport, është gjendja e tokës. Këtu thuhet qartë se nuk ka monitorim të ndotjes së tokës. Pra, kjo është nga ky raport. Kjo, duke pasur parasysh industrinë, e cila në aspektin e ndikimit ambiental është absolutisht e pakontrolluar nga institucionet e Republikës së Kosovës, njëjtë edhe blegtorisë, është shumë problematike. Pra, nuk kemi asnjë të dhënë duke pasur shumë burime të qarta të ndotjes së tokës, asnjë të dhënë për gjendjen e tokës.

Ndotja nga operatorët ndotës mjafton një shembull, rasti i “Ferronikelit”, kemi pasur shumë raportime për dëmin që i shkakton ambientit përreth këtij vend-përpunimi të metaleve. Të dhënat që ky raport i propozon, pra raporti i Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit, vijnë nga vetë kompania që menaxhon me “Ferronikelin”. Pra, nuk mund të presim që një kompani që ka për qëllim eksploatimin e nëntokës dhe përfitimin të na paraqesë ndotjen reale që shkakton, edhe pse për këtë kemi mjaft informacione nga burime të tjera.

Nëse i shohim të dhënat e prezantuara nga raporti, që vijnë nga “Ferronikeli”, të gjitha dalin brenda normave. Pra, krijohet përshtypja që nuk ka fare ndotje nga kjo fabrikë.

Duke vazhduar te biodiversiteti, këtu shpërfaqet prapë një mungesë e madhe e profesionalizmit të atyre që e kanë përpiluar këtë raport. Nuk ka asnjë të dhënë kuantitative se sa është sipërfaqja e pyjeve, që në baza vjetore, ose për vitin 2016, është dëmtuar nga shkelësit e ligjit, si në pyjet private, ose në ato publike. Pra, asnjë e dhënë për dëmin që u është shkaktuar pyjeve. Thuhet se shkaktohet dëm i vazhdueshëm, mirëpo nuk mund të jetë raport serioz ky që nuk na jep asnjë të dhënë të saktë.

Thuhet se gjendja e faunës është e mirë, prapë nuk ka asnjë të dhënë që e vërteton këtë gjë. Thuhet se kjo gjendje është e tillë për shkak të zonave të mbrojtura. Nuk ka asnjë vend në botë që ka arritur ta konservojë gjithë faunën e një vendi, duke u bazuar vetëm në zonat e mbrojtura. Thuhet se dëmtimi ndodh nga gjuetia ilegale, ky është prapë njëfarë konstatimi shumë joprofesional. Dëmtimi më i madh i faunës ndodh pikërisht për shkak të prishjes së ekosistemit, e që në rastin tonë i bie për shkak të prerjes së vazhdueshme dhe në masa të tmerrshme të pyjeve të Republikës së Kosovës.

Unë i përmenda disa aspekte që duhet t'i trajtojë ky raport. Fola për ajrin, ujin, tokën, për biodiversitetin, që nuk janë fare të mbuluara nga ky raport dhe sugjerimi im do të ishte, me gjithë faktin dhe me keqardhjen që ky ka kaluar në Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, që të kemi dhe të marrim përgjegjësi, e të mos e kalojmë derisa kjo agjenci të na e ofrojë një raport cilësor dhe të bazuar në matje dhe në rezultate të vlerësimeve shkencore për mjedisin në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Rexhepi e ka fjalën.

EMILIIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se potpredsednice Parlamenta!

Uvaženi ministri,

Poštovani građani,

S obzirom da nam je danas na dnevnom redu razmatranje izveštaja o stanju životne sredine za 2016 godinu, koja se ne razlikuje dovoljno od prethodnih godina, ja neću govoriti o zagađenosti vazduha na Kosovu, jer smo govorili i na jednoj od prethodnih sednica o celokupnoj zagađenosti vazduha, ne samo u našem glavnom gradu u Prištini, nego na celokupnoj teritoriji Kosova, ali moj govor želim usmeriti na jednoj velikoj prostornoj geografskoj površini, odnosno Nacionalnom Parku Šar, pitanje Prevalca, gde je dugogodišnje haotično stanje i gde naša Vlada nema razumevanja i ne postoji dobar ekonomski razvojni plan da se ta geografska celina zaštiti, s obzirom da imamo zakone koji štite Nacionalni Park Šar.

Govoriću takođe o nelegalnoj izgradnji vikendica, dugogodišnjoj nelegalnoj izgradnji, gde se mešaju kompetencije lokalne samouprave i Ministarstva za ambijent, i niko ne snosi odgovornost i posledice zbog takvog stanja. To rezultira velikim otpadnim vodama. Kanalizacioni sistem ne

postoji i narušava se bezbednost i sigurnost svih naših građana koji žive znači od Prevalca, Gornjeg Sela, Mušnikova, Rečane, grada Prizrena, pa sve do Drima, gde se Bistrica uliva.

Govoriću takođe i o ilegalnoj seči šuma. Znači da veliki broj prijava krivičnih prijava u opštini Prizren postoji niz godina i taj se problem ne rešava, to je faktički stanje pojedinaca, koji su od toga napravili biznis.

Da ne govorim o pokušaju izgradnja hidrocentrali, o netransparentnosti i bez saglasnosti sa stanovništvom koje gore živi. Da ne govorimo o zaštiti biodiverziteta koji uopšte ne postoji. Neću govoriti takođe i o problematici, jer sam govorila u dva moja obraćanja oko lovačkog zaštitnog područja na toj teritoriji, jedno veliko geografsko područje, koje je uzurpirano od strane opštine Suva Reka.

Mi takođe želimo jasnu sliku ekonomskog razvoja Vlade tog našeg kraja. Ukoliko ne postoji, mi možemo to proglasiti putem lokalne samouprave, putem decentralizacije, referendumom. Ne možemo večno čekati da li će Župa dobiti svoju opštinu, nego možemo i drugom putanjom to dobiti. Ne postoji ekonomski razvoj tog kraja putem izgradnje sportsko-rekreativnih centara, putem vazdušnih banja. Posedujemo veliki broj prirodnih i privrednih resursa, posedujemo veliki broj izvora prirodnih voda od koga se može napraviti dobar biznis i zaposliti veliki broj naših ljudi gore.

Nemamo dobar razvoj seoskog turizma, zimskog turizma. Nemamo dobar razvoj plasiranja domaćih proizvoda na terenu. Sve ovo govorim kako bi Vlada imala sluha i razumevanja, kako bi određeni ministri pojedinih resursnih ministarstava koji se dotiču životne sredine i zaštiti nacionalnog parka imali u obzir da to provedu na terenu.

Mi posedujemo ekonomsku održivost tog kraja. Urađen je elaborat koga smo dostavili Ministarstvu za lokalnu samoupravu, i očekujemo pozitivno rešenje po pitanju buduće opštine Župa, a ukoliko Vlada nema razumevanja sigurno nećemo dozvoliti da se taj naš prirodni kraj zloupotrebljava, da pojedinci prave svoj privatni biznis uz podršku određenih političara i sigurno nećemo odustati od ekonomskog razvoja tog kraja, zato što posedujemo i ljudske resurse, zato što posedujemo prirodna bogatstva, a pre svega možemo to ubrzati i bez neke volje od strane Vlade. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Salih Salihu e ka fjalën.

SALIH SALIHU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,



Si anëtar i komisionit, raportin e kemi shqyrtuar dhe atë ditë në komision, dhe mandej natyrisht që edhe e kemi analizuar në grup.

Shihet qartë që raporti është disi i shkruar në terma të përgjithshëm, nuk është i saktë dhe nuk jep detaje për të gjithë faktorët e mjedisit që ndikojnë në cilësinë e jetës së qytetarëve të Kosovës. Në përgjithësi, mund të thuhet se në bazë të raportit mund të silllet një konkludim se duke u nisur prej ajrit, ujit, e tokës në përgjithësi ka defekte dhe gjendja e këtyre tre faktorëve është alarmante.

Është me interes të thuhet, në qoftë se vetëm i merr rekomandimet e këtij raporti, tregohet qartë se gjendja është shumë më e rëndë krahasuar me atë që i kanë paraqitur në raport. Dhe, është paksa për t'u çuditur që edhe këto rekomandime që janë bërë, nuk janë bërë në mënyrë të saktë duke iu adresuar institucionit përgjegjës, por vetëm është folur në terma të përgjithshme, se është..., duhet të bëhet kjo..., ose duhet të bëhet ajo. Sa i përket cilësisë së ajrit, në raport është konstatuar se vazhdimisht kemi tejkalime të thërimeve të pluhurit me 2,5 dhe 10 pm, gjë që tregon se ne në Kosovë vazhdimisht e kemi ajrin e ndotur, sidomos gjatë sezonit të dimrit.

Sa i përket cilësisë së ujërave, raporti tregon se ujërat janë të ndotur, kryesisht nga ujërat e zeza, domethënë kanalizimet, por edhe nga përdorimi shtëpiak i detergjenteve, pra nga shpenzimi kimik që bëhet nëpër familje, e që pa u trajtuar derdhet në lumenj dhe kështu e bëjmë ndotjen serioze të lumenjve, duke e shkatërruar edhe botën e gjallë nëpër lumenj.

Sa i përket ndikimit të mjedisit në shëndetin publik, nga ky raport shihet qartë që kemi rritje të ndjeshme të sëmundjeve të përgjithshme. Për shembull, në vitin 2015 i kemi 12 744 sëmundje, ndërkaq në vitin 2016 sëmundjet janë rritur përreth 7 000 më shumë. Kjo tregon se nga viti 2015 në vitin 2016 kemi rritje të përgjithshme të sëmundjeve që janë pasojë e ndotjes së mjedisit.

Gjithashtu, sa i përket ndotjes së tokave, raporti tregon se kemi një ndotje të ndjeshme të tokave dhe nuk ka parametra të saktë të matjes se sa hektarë dhe ku janë vendet e ndotura, sepse edhe në rekomandim qartësohen, mirëpo duhet përmendur një fakt që tokat bujqësore në Kosovë po helmohen nga përdorimi i tepërt i pesticideve, e që ne nuk kemi matje për këto gjëra, por edhe nga ndërtimi i egër, e që në fakt Ministria e Bujqësisë nuk e ka asnjë inspektor për mbrojtjen e tokave bujqësore.

Tash është për t'u befasuar se si është e mundur ne ta mbrojmë tokën bujqësore, kur në kuadër të një ministrie nuk e kemi asnjë inspektor për mbrojtjen e tokave bujqësore. Do të ishte mirë që të gjithë këta zëvendësministra që i kemi në Qeveri, së paku të mos u ndalet rroga, por le ta kryejnë punën e inspektorëve, se ka shumë nevojë edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për inspektorë, por edhe Ministria e Bujqësisë.

Sa u përket mbeturinave, raporti tregon se e kemi një trend të rritjes së mbeturinave nga viti 2015 diku për 3 600 tonë më tepër në vitin 2016. Në raport tregohet se i kemi diku rreth 1 117 deponi ilegale, që paraqesin rrezik permanent për shëndetin publik të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Gjithashtu shihet qartë që me ligj obligohen që të mbrohet natyra, të mbrohet ambienti e mjedisi, por nga raporti tregohet se i kemi vetëm 57 inicime në Gjykatën për Kundërvajtje. Paramendoni, a ka mundësi të mbrohet një ambient i Kosovës, i shkatërruar në të gjitha anët, me vetëm 57 inicime në Gjykatën për Kundërvajtje. Kjo tregon se sa janë në funksion institucionet tona për ta mbrojtur mjedisin ku ne jetojmë.

Në përgjithësi, sa i përket buxhetit, në raport tregohet se buxheti është rritur ndjeshëm, mirëpo një nga problemet që duhet përmendur është fakti se buxheti për shpenzime kapitale në shumë raste nuk orientohet në projektet mjedisore, por në projekte tjera, që realizimi i tyre nuk ka ndikim në përmirësimin e mjedisit. Pra, nuk specifikohet se çfarë projektesh tjera ka dhe pse këto mjete që ndahen për investime kapitale nuk shkojnë në drejtim të përmirësimit të gjendjes së mjedisit.

Në përgjithësi, mund të themi se gjendja e pyjeve është shumë e rëndë dhe konsideroj se asnjëherë askush nuk ka marrë përgjegjësi për mijëra hektarë pyje që janë shkatërruar në Kosovë. Do të ishte mirë që sot ministrja të jetë e pranishme, pasi që po flasim për një raport që ka të bëjë me dikasterin e saj, por ajo si duket nuk e ka parë të udhës që të jetë e pranishme. Mirëpo, shihet qartë që në Kosovë janë shkatërruar pyjet, janë prerë ilegalisht, e mandej edhe janë ndezur, d.m.th. janë djegur. Kjo e ka dëmin e dyfishtë, për arsye se në aspektin profesional një trup apo një dru që pritet në mal, indeksi i korrjes, që nënkupton që sasia e drurit që shkon për përpunim ose për djegie është 0,4 apo 40%, që i bie se 40% e trupit shkon si lëndë djegëse dhe përpunim, ndërkaq 60% janë rrema apo degë që mbeten në mal. Dhe kjo masë drunore paraqet një sasi shumë të madhe të drurit, e cila kur janë temperaturat e larta e bën një flakë shumë të lartë, deri në 5 metra, duke i shkatërruar edhe fidanët e rinj, drunjtë e ri, kështu duke i shkatërruar komplet pyjet.

Në plan të veprimit është dashur të inkorporohet që këto rrema, ky 60%-sh i degëve që mbeten në pyje të angazhohen punëtorë sezonalë dhe t'i mbledhin, në mënyrë që të mos krijohet masë për djegie, për shkatërrim të mëtutjeshëm të pyjeve, por të grumbullohen dhe të bëhen pelet, e në këtë kuptim do të kishte pasur mundësi që për çdo kilogram të peletit që prodhohet të shpëtohet një dru apo një lis në pyll.

Gjithashtu sa i përket shfrytëzimit të zhavorrit nga kodrat është shumë me interes që të intervenohet sa më shpejt që është e mundur, sepse, përveç ndotjes së ajrit nga gurëthyesit, kemi edhe shkatërrim të kodrave të bukura apo të pyjeve, të cilat me të vërtetë kur të kalosh përreth tyre duken sikur gojë të hapura, sikur një lloj kanceri i kodrave apo i natyrës. Edhe këtu ekziston një model i mirë i shfrytëzimit të zhavorrit nga vendet perëndimore.

Unë po jua sjell një përvojë nga Austria, ku gjatë kohës kur janë ndërtuar autostradat në Austri nuk janë shfrytëzuar zhavorret apo rëra nga kodrat, por është përdorur rëra nga sipërfaqet e rrafshëve, janë bërë gropa të thella dhe pastaj në ato gropa janë bërë shpime të thella dhe janë mbushur me ujë, duke i shndërruar në liqene artificiale, domethënë me një rrugë, me një punë, në njërën anë e kanë shfrytëzuar zhavorrin për ta shtruar autostradën, në anën tjetër kanë krijuar liqene artificiale. Kështu kemi me qindra liqene në rrethinën e Vjenës, ndërkaq në Kosovë paramendoni ne kemi shumë pak rezerva apo akumulime të ujit dhe në vend që, për shembull, secilës kompani që kërkon ta shfrytëzojë zhavorrin nga kodrat t'ua japim lejen për shfrytëzimin e zhavorrit në sipërfaqe të rrafshëta, ku ujërat nëntokësore janë afër tokës, në mënyrë që të krijojmë sa më shumë liqene artificiale dhe akumulime të ujit. Por, tek ne ndodh e kundërta. Shkatërrohen kodrat e bukura dhe ne fare nuk kemi liqene artificiale. Një praktikë do të mund të inkorporohej në planin e veprimit nga ministrja e tanishme.

Dua ta theksoj edhe një herë që ky raport është i vitit 2016, me keqardhje këtë raport ne do të duhej ta analizonim në vitin 2017, ndërkaq kaq vonë, një vit prapa, ne sot do të duhej të flisnim për raportin e vitit 2017 se çfarë po ndodh me gjendjen e ajrit, e jo të flasim për raportin e vitit 2016 dhe deri më tani në këtë drejtim, sa i përket mjedisit, asnjë institucion, as Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e as Ministria e Bujqësisë dhe asnjë ministri tjetër që lidhet me ambientin nuk janë në funksion të kryerjes së detyrës dhe nuk janë në zbatim të ligjit.

Edhe një herë po e theksoj nuk ka mundësi të mbrohet ambienti në Kosovë me vetëm 57 iniciime në Gjykatën për Kundërvajtje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Millaku e ka fjalën.

DRITA MILLAKU: Faleminderit!

Diskutimi për raportin, e thanë të gjithë parafolësit e mi, se jo veç se është i vonuar, por është shumë shqetësues dhe alarmant. Ndotësit kryesorë në të gjitha rastet e kanë vetëm një emër, e ai është faktori njeri. Se ndotësit duhet të vetëdijesohen vetë, besoj që kjo nuk do të ndodhë. Edhe pse e kemi ngritur zërin, aktualisht asgjë nuk është bërë deri më tani. Veprojnë deponitë ilegale, impiantet e ujërave të zeza, siç është rasti në fshatin Landovicë të komunës së Prizrenit, ku shumë herë ka ndodhur që banorët e kësaj zone të infektohen nga uji dhe kanë kaluar në epidemi.

Por, avazi i njëjtë ka vazhduar përsëri. Nuk e dimë se kujt i konvenon kjo gjendje e ndotjes së mjedisit, ku qytetarët janë ata që i bartin pasojat dhe asnjëherë nuk janë marrë parasysh reagimet e tyre. Degradimet që po ndodhin janë bërë nga një planifikim joadekuat, por nëse në të gjitha rastet nuk merren parasysh edhe ankesat që bëhen, atëherë konsiderojmë që këto po bëhen të qëllimshme.

Vitet e fundit është shqetësues edhe insistimi me çdo kusht i ndërtimit të hidrocentraleve sa i përket zonës së Zhupës, përmes Lumëbardhit, kur dihet se dëmtimet do të jenë edhe më të mëdha. Si përfaqësuese e kësaj zone të Prizrenit, konsiderojmë që gjendja e mjedisit do të bëhet edhe më alarmante. Po ashtu, shqetësuese është edhe deponia e mbeturinave në fshatin Zhur i Ri. Andaj, nuk duhet të lejojmë që këta faktorë të na bëjnë vendin të pabanueshëm dhe ata të na sjellin në një gjendje, në të cilën askush nuk ndëshkohet.

Sot kur po e diskutojmë këtë raport, e thanë të gjithë folësit para meje, ajo që duhet ta dëgjojë zërin e secilit deputet këtu, ministrja, nuk është e pranishme dhe të paktën nuk e ka marrë as mundin që t'i dëgjojë këto shqetësime, e lëre më të zotohet se do të marrë masa që t'i parandalojë. Kaq kisha! Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! I fundit është Bekim Haxhiu.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është kjo koha brenda një periudhe të shkurtër kohore që ne diskutojmë për ambientin, për shkak se me të vërtetë gjendja e ambientit, përveç diskutimeve, kërkon edhe hapa konkretë për marrjen e masave, që ajo të përmirësohet.

Ndërmarrja e masave tani për ambientin nuk pritet që ato të jenë shumë efektive menjëherë, mirëpo që këto pastaj të japin rezultate në vitet në vijim, sepse jemi dëshmitarë që prej përfundimit të luftës shumë pak i është kushtuar vëmendje dhe rëndësi mbrojtjes së ambientit në të gjitha sferat, duke përfshirë nga shkatërrimin e pyjeve, e deri në zonat urbane, ku edhe në ato pak zona të gjelbra që kanë qenë nëpër qytete, për shkak të ndërtimeve, diku me leje e diku edhe pa leje, janë shkatërruar hapësirat e gjelbra. Prandaj, kjo gjendje e ambientit është kështu.

Mendoj se raporti i përpiluar duhet të ndryshojë nga qasja e përpilimit të këtij raporti dhe agjencia në hartimin e këtij raporti, pasi t'i marrë të gjitha informatat, do të duhej që me aktorët kryesorë të diskutonte, jo vetëm rekomandimet, por edhe të gjeturat, sepse ato të gjetura duhet të jenë të sakta dhe të përpiluara në mënyrë korrekte, duke filluar nga diskutimet me të gjitha drejtoritë përkatëse në komuna, sepse nuk mund ta pasqyrojmë një raport nga një agjenci për tërë nivelin e Kosovës dhe ai pastaj të përfshihet në diskutim këtu, përderisa nuk ka pasur një bashkëbisedim me drejtoritë përkatëse në nivel të Kosovës në të gjitha komunat. Kur të na vijë raporti këtu, le të vijë me të dhëna të sakta me të gjitha masat, aty ku janë marrë masat adekuate, në të gjitha komunat e Kosovës të jenë të përshkruara në raport, sepse nuk mund t'i përfshijë të gjitha komunat e Kosovës, ngase kjo ndryshon nga komuna në komunë.

Te çështja e mbeturinave në Kosovë ka vite që gjendja ka filluar, në veçanti në përmirësimin e trajtimit të tyre nëpër deponi. Jua kujtojmë se në vitin 2010 dhe 2011 saktësisht gjendja e mbeturinave ka qenë, në veçanti në sezonin e verës alarmante, kur deponitë e mbeturinave kanë qenë të përfshira nga flakët, ndërsa kompania për menaxhimin e deponive ka qenë buzë falimentimit me konto të bllokuara për shkak të një keqmenaxhimit paraprak dhe për shkak të investimeve, të cilat në këto deponi nuk janë kryer konform standardeve evropiane, edhe pse janë proklamuar si të tilla dhe një dëshmi më e mirë për këtë është deponia e Mirashit, e cila edhe sot kërkon një investim shtesë prej 3,5 - 5 milionë euro, në mënyrë që të sanohet gjendja aty.

Në raport nuk janë përfshirë në mënyrë të rregullt dhe të saktë disa deponi ilegale, që vërtet janë ilegale, e të tillat trajtohen si deponi të licencuara, siç është deponia në fshatin Koshtovë, që është një bombë ekologjike, e cila e rrezikon jo vetëm ambientin përreth Koshtovës, por edhe më gjerë, sepse gjithë rrjedhja kalon pastaj në lumin Ibër dhe kemi një rrezikim të ambientit, që nuk është përfshirë në këtë raport në mënyrë të saktë.

Prandaj, kërkohet që para se ky draft të jetë final, që agjencia bashkë me aktorët të diskutojnë edhe një herë që ky raport kur të na vijë në Kuvend të jetë i detajuar. Dua ta marr një shembull, që është shumë me rëndësi, sepse tarifat për grumbullimin e mbeturinave nuk kanë ndryshuar ndër vite. Më herët, autoriteti përkatës për mbeturina dhe ujëra nuk ka bërë ndonjë ndryshim të tarifës, por tani në kompetencë edhe të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ka ndryshuar një gjë.

Ne jemi vendi i vetëm në rajon, e mund të them edhe në botë, që e kemi tarifën e njëjtë të grumbullimit të mbeturinave për familje dhe trajtimin e tyre për ton në deponi përkatëse. Pra, tarifa e grumbullimit të mbeturinave për një familje është 4,80 centë, ndërsa trajtimi i një toni mbeturina është 5,30 centë. Pra, vetëm në Kosovë ndodh që një grumbullim familjar të jetë i barabartë me atë dhe ministria nuk i ka marrë masat e duhura që kjo vërtet të trajtohet. Asnjë vend në rajon trajtimin e mbeturinave nuk e ka më të ulët se 11 euro për ton, ne jemi të vetmit që e kemi 5,30 dhe ministria nuk e ka bërë një hap të duhur për sanimin e kësaj gjendjeje.

Ajo që institucionet përkatëse do të duhej të merrnin përgjegjësi që kjo gjendje të përmirësohet do të ishte me investimin konkret edhe në trajtimin e mbeturinave, në veçanti në grumbullimin e mbeturinave për çdo familje, që kjo të ketë pastaj edhe kosto më të lehtë për familjet, të cilat e selektojnë këtë mbeturinë dhe nuk do të krijonin pastaj mundësi për krijimin e deponive ilegale në Republikën e Kosovës.

Pra, le të mbetet ky raport kësaj radhe në këtë formë me këto rekomandime, pa diskutuar me aktorët që janë përgjegjës për ambientin, që radhëve të tjera vërtet fillimisht të diskutohet me përgjegjësit dhe pastaj të vijë në diskutim në Kuvend dhe të marrë miratimin e Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Para se ta përmbledhim atë që u diskutua dhe të shohim nëse kemi kuorum për të votuar, dua të ju njoftoj se vazhdimi i seancës do të jetë të martën, në orën 10:00, për t'i shqyrtuar...

*(Reagime nga salla)*

Qysh? Jo, jeni këtu! Jeni këtu, e keni të ndaluar kur ka seanca të shkoni jashtë dhe s'guxon kurrkush... Hiç, s'ka jashtë! Seanca me debat... Nait, çfarë...? Jo, jo, s'ka grupe punuese, asnjë grup punues s'do të funksionojë. Seancë kemi të martën, në orën 10:00, për ta vazhduar me pikën 12.

Nuk do të shkojë. Komisioni nëse shkon, s'ka për ta marrë asnjë beneficion dhe do të penalizohet me mëditje. Ne kemi seancë, nuk na intereson asgjë tjetër. Kjo është puna jonë. Të martën, në orën 10:00 shqyrtohet pika 12 e rendit të ditës, pika 10 dhe pika 9 e rendit të ditës. A ka kuorum? Edhe votimi i kësaj pike.

Mirupafshim të martën, në orën 10:00!

\* \* \*

*E martë, 13 shkurt 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 8 dhe 9 shkurt 2018*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Meqenëse për sot kemi caktuar seancë, por kryeministri akoma nuk ka arritur në Kosovë, pasi ai kthehet në orën 11:45, prandaj do të ju njoftojmë se kur do të vazhdojë seanca, besoj të bashkëkoordinohen kryetari i Kuvendit me kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe VV-së, sepse kërkesa është e tyre, dhe në këtë raport duhet të diskutojmë bashkë se kur do ta caktojmë seancën dhe të merremi vesh edhe me kryeministrin kur të vijë.

Nëse ju jeni dakord, ne e fillojmë tash, për mua nuk është ndonjë problem, ministra ka mjaft.

Nëse mendoni që duhet ta caktojmë sot, ne po e caktojmë sot, por unë mendoj që kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së të koordinohet me kryetarin e Parlamentit, por nëse doni e caktojmë për të enjten pasnesër. Ku është Avdullahu? Armend!

Atëherë me pëlqim të dy grupeve parlamentare të Lidhjes Demokratike dhe të “Vetëvendosjes”, seanca mbahet të enjten, në orën 10:00. Faleminderit!

\* \* \*

*E enjte, 1 mars 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 8, 9 dhe 13 shkurt 2018*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,  
I nderuar kryeministër,  
Të nderuar zëvendëskryeministra,  
Ministra të Kabinetit qeveritar,  
Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 8 dhe vazhduar më 9 shkurt 2018.

Fillojmë me shqyrtimin e pikave të papërfunduara me seancën plenare. Albulena e ka kërkuar fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Në mbledhjen e Kryesisë, kur është caktuar për vazhdimin e seancës së 8 shkurtit, ka pasur një gabim procedural, unë u mundova ta sqaroj edhe më herët me ju, për shkak se interpelanca jonë, të cilën e kemi thirrur lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Astrit Dehari, është deponuar më 13 shkurt, ndërsa seanca e sotshme është vazhdimi i seancës së 8 shkurtit.

Prandaj, Kryesia ndoshta për shkak të problemeve me demarkacionin dhe zhvillimeve të fundit ka bërë një gabim procedural dhe e ka radhitur sot.

Propozimi ynë është që kjo pikë të mbahet nesër, pas pyetjeve parlamentare dhe për këtë, natyrisht duhet të vendosë seanca, ose javën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Proceduralisht keni të drejtë, por a jeni për nesër, a javën e ardhshme?

Zoti Kujtim Shala e ka fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Këta mund të kërkojnë të tërhiqet, por ajo është përfshirë në këtë seancë, domethënë në rendin e ditës, në bazë të Rregullores, është në përputhje me Rregulloren, sepse kur të kërkohet interpelanca dhe Qeveria nuk kthen përgjigje, sipas Rregullores ajo pikë duhet të përfshihet në seancën, e cila është duke u zhvilluar. Faleminderit!

KRYESUESI: Tani mocioni është i Lëvizjes “Vetëvendosje”, kërkesa mund të bëhet për tërheqje, krejt kur do parashtuesi, në fund të fundit, po këta po kërkojnë të shtyhet për nesër ose për javën e ardhme.



Unë duhet ta nxjerr në votim, po sidoqoftë, kërkesa të jetë decisive, javën e ardhshme apo nesër. Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Edhe një herë, nuk është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, sepse kjo seancë është vazhdim i seancës së 8 shkurtit. Ne po e bëjmë propozimin konkret që për shkak se agjenda e nesërme është jashtëzakonisht shumë e ngarkuar që interpelanca jonë të jetë në seancën e ardhshme, pra javën e ardhshme, për këtë vendos Kryesia në mbledhjen e Kryesisë, ky është propozimi ynë. Natyrisht nuk tërhiqemi nga interpelanca, por kërkoj mbështetjen e deputetëve të Kuvendit që kjo pikë të shtyhet për javën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Kujtim, s'ë besoj që ka nevojë. Zoti Shala e ka fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Që ta dëshmoj që është në përputhje me Rregulloren, s'po e kontestoj mocionin, vendosin ata, neni 44, pika 6, interpelanca vihet në rendin e ditës së mbledhjes plenare në afat prej 7 ditësh pasi të merret përgjigje nga Qeveria.

Nëse Qeveria brenda afatit të paraparë në paragrafin 5 të këtij neni nuk e dërgon përgjigjen për interpelancën, ajo vihet pikë e fundit e rendit të ditës të mbledhjes plenare të Kuvendit që është në zhvillim e sipër. Faleminderit!

KRYESUESI: Në rregull! Grupi Parlamentar i LDK-së e bëri kërkesën për mocion për shtyrje të interpelancës.

Fjalën e ka Grupi Parlamentar i LDK-së sa i përket mocionit, e jo Rregullores.

AVDULLAH HOTI: Ne do ta përkrahim kërkesën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje".

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike?

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Do të ishte në rregull që t'i kthehet Kryesisë mbrapa, pastaj Kryesia në bazë të vlerësimit të vet ta renditë në njërin nga seancat e ardhshme si pikë e rendit të ditës.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar i AAK-së?

AHMET ISUFI: Edhe ne pajtohemi që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës.

KRYESUESI: Lista serbe?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!

I Poslanička grupa Srpske liste se slaže da se ova tačka odlaži za narednu sednicu.

KRYESUESI: Nga “Nisma”, zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Si partner i koalicionit, po e mbështes kërkesën e partnerëve të koalicionit.

KRYESUESI: Nga Grupi Parlamentar “6+”, zoti Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah kërkesën e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, edhe ne jemi pro që të shtyhet kjo për seancën e radhës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po shkojmë me një votim formal për ta shtyrë për seancën e radhës.

Kush është për? A ka kundër?

Me shumicën absolute të deputetëve, 72 vota janë për. Shtyhet interpelanca ose miratohet mocioni i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” që interpelanca sa i përket ‘çështjes Dehari’ të shtyhet për seancën e radhës pas javës së ardhshme.

KRYESUESI: Po vazhdojmë me pikat e rendit të ditës për sot:

**9. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së GP të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe GP të Lëvizjes “Vetëvendosjes” lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 04/20, datë 20. 12. 2017 për rritjen e pagave të anëtarëve të Kabinetit qeveritar, Vendimin nr. 05/24, datë 12. 1. 2018, për rritjen e pagave për të gjitha kategoritë e të punësuarve që marrin pagë nga Buxheti i Kosovës, si dhe Vendimin nr. 15/24, datë 12. 1. 2018 për lartësinë e pagesës mujore për familjet në Skemën e Ndhimave Sociale**

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” kanë parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, zotin Haradinaj, lidhur me këto vendime.

Ju njoftoj që në bazë të Rregullores së Kuvendit, interpelanca mund të zgjasë deri në 3 orë.

Propozuesi i interpelancës mban të drejtën e fillimit të debatit në kohëzgjatje deri në 10 minuta dhe në fund të debatit deri në 5 minuta, neni 44.7 të Rregullores së Kuvendit.

Në bazë të nenit 44.8 të Rregullores së Kuvendit, kryeministri Ramush Haradinaj e paraqet dhe e arsyeton qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për çështje të ngritura për interpelancë në kohëzgjatje prej 15 minutash, koha e ndarë për diskutim sipas grupeve parlamentare dhe deputetëve të grupeve parlamentare është si në vijim:

Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, gjithnjë në bazë të Rregullores, 32 deputetë, ka 48 minuta,

Grupi Parlamentar i LDK-së ka 40,5 minuta,

Grupi Parlamentar i PDK-së ka 34,5 minuta,

Grupi Parlamentar i AAK-së ka 15 minuta,

Grupi Parlamentar Lista serbe, 15 minuta,

Grupi Parlamentar “Nisma”, 6 deputetë, 9 minuta,

Grupi Parlamentar “6+”, 9 minuta,

Pa grup janë 6 deputetë dhe i kanë 9 minuta.

Tani kush do të raportojë, zoti Avdullah Hoti, në emër të propozuesve të interpelancës ta marrë fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Dy interpelanca janë bërë bashkë, unë do të mundohem që për 4-5 minuta të prezantoj qëndrimin e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe mandej Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” pjesën tjetër.

Në bazë të nenit 65.9 të Kushtetutës dhe nenit 44 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka thirrur në interpelancë kryeministrin lidhur me vendimin e Qeverisë për rritjen e pagave për kryeministrin dhe anëtarët e tjerë të Kabinetit qeveritar.

E para, ne vlerësojmë se ky vendim është në kundërshtim me ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Në mandatin e kaluar Kuvendi e ka ndryshuar Ligjin për menaxhimin e financave publike, me nenin 22 c që lidhet me kufizimin e rritjes së pagave. Në pikën 1 theksohet se rritja e pagave në baza vjetore nuk tejkalon normën e rritjes së bruto prodhimit vendor.

Kjo reformë substanciale është bërë nga Qeveria Mustafa, me të vetmin qëllim që të krijohet një siguri për financat publike nga vendimet e papërgjegjshme, siç është ky vendim.

E dyta, përveç që bie ndesh me Ligjin për menaxhimin e financave publike, vendimi i Qeverisë është në kundërshtim me etikën qeverisëse dhe është konflikt i hapur interesi.

Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit, në nenin 9, thekson: “Gjatë ushtrimit të funksionit publik zyrtarit të lartë i ndalohe të marrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t’i përshtaten interesit të tij personal apo personave të afërt dhe të besueshëm”.

Pra, shihet qartë se ka konflikt të interesit dhe kjo është dëshmuar edhe me opinionin e Agjencisë Kundër Korrupsionit, datë 29. 1. 2018.

E treta, vendimi i qeverisë i tejkalon kompetencat e përcaktuara me Rregulloren e Punës së Qeverisë, e cila në asnjë dispozitë të saj nuk përcakton kompetenca dhe përgjegjësi të Qeverisë për caktimin e pagave për kryeministrin dhe Kabinetin qeveritar.

E katërta, pavarësisht këtyre argumenteve për shkelje, ky vendim është i papranueshëm, pasi krijon një diferencë të madhe me elemente diskriminuese në mes të të ardhurave të grupeve të ndryshme shoqërore me pagat e zyrtarëve të Kabinetit qeveritar.

Me këtë vendim diferenca e pagave mes zyrtarëve të Kabinetit qeveritar dhe një shërbyesi civil është rritur nga një me katër, sa ka qenë, në një me tetë, e ata që marrin pensione dhe ndihma sociale, kjo diferencë është një me njëzet.

Vendimi i tillë është i pamatur, pasi krijon implikime financiare pa mbulesë.

Ligji për gjykatat dhe Ligji për prokurorinë aplikon standardin e nivelimit të pagave në organet e drejtësisë dhe të ekzekutivit. Paga e kryetarit të Gjykatës Supreme dhe e kryeprokurorit të shtetit bazohen në pagën e kryeministrit dhe pagat e vartësve të tyre në gjykata dhe prokurori janë të lidhura me pagat e këtyre.

Duke qenë se paga e kryeministrit është dyfishuar, atëherë edhe pagat e të gjithë gjyqtarëve edhe prokurorëve duhet të dyfishohen dhe kjo krijon një kosto buxhetore prej rreth 20 milionë, që nuk është e reflektuar në buxhetin e vitit 2018.

Të nderuar deputetë,

Nisur nga këto argumente dhe në përputhje me nenin 44 të Rregullores së Kuvendit, Grupi ynë Parlamentar kërkon që Qeveria të anulojë menjëherë vendimin e kundërligjshëm për rritjen e pagave Kabinetit qeveritar dhe në afatin sa më të shkurtër të sjellë para Kuvendit Ligjin për pagën në sektorin publik.

Unë ju ftoj që pas debatit që mund të kemi, të votojmë këtë mocion. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” në të njëjtën ditë e kemi proceduar interpelancën lidhur me Vendimin nr. 0420 të Qeverisë së Republikës së Kosovës për rritjen e pagave për kryeministrin, zëvendëskryeministrat, ministrat dhe të tjerë, sikurse në Vendimin e datës 20 dhjetor, po ashtu, për Vendimin nr. 0524 të Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me rritjen e pagave për punonjësit e shërbimit civil dhe të gjithë atyre që paguhen nga buxheti i shtetit me vetëm 4%. Po ashtu, Vendimi nr. 1524 i Qeverisë së Republikës së Kosovës për lartësinë e pagesës së familjeve në skemë sociale të datës 12 janar 2018.

Ashtu siç u tha, më 20 dhjetor 2017 Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj mori vendimin për rritjen e pagave që ishte dyfish sa e kanë aktualisht. Më datë 22 dhjetor Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 0420 u dërgua në Agjencinë Kundër Korrupsion nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, për shkak se përmbajtja e këtij vendimi përbën shkelje sipas kuptimit të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia Kundër Korrupsion më 29 janar ka konsideruar që ky vendim është i paligjshëm, rrjedhimisht Qeveria ka konsumuar veprën penale të konfliktit të interesit dhe ne kemi kërkuar po ashtu nga Agjencia Kundër Korrupsion që të deponojë kallëzimet penale për kryeministrin dhe ministrat që kanë marrë pjesë në këtë vendim. Ne, po ashtu, si grup parlamentar bashkë me tre deputetët e LDK-së e kemi proceduar në Gjykatën Kushtetuese këtë vendim, për shkak se i njëjti është në shpërputhje me Kushtetutën, sepse cenon kompetencat e Kuvendit, por po ashtu është në shpërputhje me standardet socio-ekonomike.

Ky vendim u kundërshtua edhe nga qytetarët, mediat dhe shoqëria civile, ku edhe organizuan një aksion simbolik, nëpërmjet të cilit qytetarët shprehën mospajtimin me këtë vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili po ashtu në deklaratimet e tij publike, pra kryeministri aktual e mbështeti këtë vendim me justifikimin për shpenzimet që kanë zyrtarët e lartë për veshje dhe për parandalimin e korrupsionit të tyre. Më 12 janar 2018, Qeveria e Republikës së Kosovës pa asnjë sqarim paraprak apo ndonjë dokument publik, ku analizohej financiarisht dhe mbështetej mbi të

dhëna, mori vendimin për rritjen vetëm me 4% të pagesës apo pagës së shërbyesve civilë, pastaj Këshilli Ekonomik Social kishte kërkuar gjatë vitit 2017 heqjen e kategorizimit sipas moshës, pra ndryshimin e vendimit të vitit 2011 të Qeverisë Thaçi 2 ku paga minimale për të punësuarit mbi moshën 35-vjeçare është 170, kurse nën këtë moshë 130 euro, vendim ky plotësisht i padrejtë dhe i pabazuar. Po ashtu, gjatë këtij viti Këshilli Ekonomik Social ka propozuar rritjen e pagës minimale, kërkesë e cila nuk është adresuar ende nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Qeveria e Kosovës po ashtu miratoi Vendimin nr. 1524, lidhur me rritjen e pagesës së skemës sociale, ku thuhet se rritja është 20%, respektivisht familja me një anëtar paguhet 60 euro në muaj dhe ajo me 15 anëtarë me 180 euro në muaj.

Kujtojmë se indeksi i harmonizuar i çmimeve, shkalla e inflacionit, e matur në muajt nëntor 2016-2017 ishte 0,9%, konsumi për ekonomitë familjare 2016 - 2017 ka qenë mbi 7 mijë e 500 euro, kurse për kokë banori rreth 1 mijë e 400 euro. Kurse, shporta mujore bazë e një qytetari në Kosovë llogaritet të jetë 115 euro.

Ne kemi kërkuar po ashtu rezolutë, më duhet të theksoj këtu që ne mbështesim pikat apo propozimet e LDK-së që i ka proceduar në interpelancë, edhe për shfuqizim të vendimit për paga, por po ashtu edhe për nxjerrjen e Ligjit për pagat, procedimin e tij dhe po ashtu kemi propozuar tri pika që është shfuqizimi i vendimit, pra për të cilën po flasim për rritjen e pagave të zyrtarëve të lartë, heqja e kategorizimit sipas moshës për pagën minimale dhe përshtatja e saj të bëhet në baza vjetore, referuar të dhënave social-ekonomike dhe tregut të punës dhe po ashtu, lartësia e pagesës së skemës sociale për çdo vit të përshtatet në varësi të lëvizjes së çmimeve dhe të standardit të jetesës, sipas të dhënave zyrtare të Republikës së Kosovës. Unë kërkoj mbështetjen e deputetëve të Kuvendit për këtë rezolutë, po ashtu në qoftë se ka propozime të tjera, natyrisht që mund t'i diskutojmë pas përfundimit të kësaj interpelance. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Tani radhën e ka kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj.

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** I nderuar kryesues, zoti Haliti!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të nderuara media,

Fillimisht kërkoj falje për shtyrjen e kësaj seance për interpelancë, ka qenë periudha e ditëve të përgatitjeve për festimin e dhjetëvjetorit, ndërsa tani po ashtu faleminderit për mundësinë që t'ju drejtohem lidhur me temën, të cilën e keni ngritur për interpelancë.

Rritja e pagave të Kabinetit qeveritar ka ndodhur me një vendim të Qeverisë në përputhje me praktikat e marrjes së vendimeve të tilla dhe si i këtille ka mundësuar nivelimin e pagave. Më duhet t'ju them, të nderuar deputetë dhe qytetarëve të vendit, se me listën e renditjes së nivelit të

pagave kryeministri i vendit tuaj është numër 69 me vendimin e mëhershëm, pra janë 69 zyrtarë të tjerë që marrin pagë më të madhe se kryeministri. Njëkohësisht, numër 69 është edhe kryetari i Këshillit Prokurorial, i atij gjyqësor dhe kryeprokurori i vendit. Nëse është në rregull për të gjithë ju, edhe për mua vlen, të pajtohemi kështu pra.

Pse është kështu dhe pse është lënë kështu në të kaluarën, kjo është një pyetje që duhet t'ia bëjnë të gjithë vetes, mirëpo në bazë të renditjes së përgjegjësive dhe në bazë të rangut të përgjegjësive që mban zyrtari shtetëror, kryeministri i vendit, ministrat, kryetari i Këshillit Gjyqësor, ai i Këshillit Prokurorial, nuk mund të jenë numër 69. Nëse është në rregull, prapë po them mirë, por rezultat i këtyre praktikave, mosguximin për t'u përballë me disa situata, e shihni si e kemi vendin. Në fakt, ky vendim i rritjes së pagave, e kam parë vlerësimin e AKK-së, ne në Kosovë po jetojmë, i dimë pak a shumë pikëpamjet e secilit zyrtar, të gjithë jemi jopartiakë a partiakë, edhe e kemi parë mënyrën si i kanë argumentuar ato. Tani për mua është kështu gjendja: ky vendim, pra kjo temë është në Gjykatën Kushtetuese, unë pres përgjigjen e gjykatës, e kemi pezulluar, sido që të vendosë Gjykata, ne e respektojmë, mirëpo mos harroni, edhe një herë ju them që është e habitshme, pra indiferenca që ka ndodhur në të kaluarën, po e lëmë këtë rast kryeministrin ose po e lëmë ministrin, por kryetari i Këshillit Gjyqësor të lihet numër 69 në rangim të listës së pagave, edhe kryetarin e Këshillit Prokurorial ose kryeprokurorin numër 69, i shihni në listë si janë pagat e tjera, për të mos folur për cilat paga e kam fjalën, tregon vetvetiu se cili ka qenë orientimi ynë dhe sa ne e kemi kuptuar se si mund të avancojë vendi ynë.

Për më tutje, në detaje të tjera lidhur me atë se a paraqet kjo shkelje të Ligjit për pagat, të buxhetit, e tjera, e lus ministrin Hamza kur ka kohë, pra mund të ndodhë edhe tash, njëkohësisht sa u përket skemave sociale, të gjitha detyrat që i kemi kryer, obligimet që i kemi kryer qoftë ndaj kategorive të lirisë, qoftë ndaj kategorive që janë në skemë sociale, i kemi obligim. Nuk jemi lavdëruar asnjëherë me to, por megjithatë lus për një fjalë të shkurtër ministrin Reçica, por një herë nëse bën ministri Hamza, e pastaj ministri Reçica. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, vazhdon zoti Hamza për sqarime.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar zoti nënkryetar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti kryeministër,

Ministra,

Të nderuar të pranishëm,

Sot po flasim për tri vendime. Sa i përket vendimit të parë që ka të bëjë me rritjen e pagave të kryeministrit, ministrave, kategorive të tjera brenda Qeverisë që pastaj ka implikime si rezultat edhe i lidhjes së pagave të prokurorëve, gjyqtarëve, me nivelin e pagave të kryeministrit dhe të Kabinetit qeveritar, është një vendim, të cilin e sqaroi edhe kryeministri, nuk ka prodhuar deri

tani asnjë efekt financiar. Do të thotë, nuk është zbatuar, sepse dëshirojmë të ketë qartësi juridike, lënda është në Gjykatën Kushtetuese, vendimi është i pezulluar dhe varësisht prej vendimit të Gjykatës Kushtetuese, do të jenë veprimet vijuese.

Mirëpo, edhe deri më tani, kushdo që ka bërë këtë, është dashur të hyjë dhe të hulumtojë pak, se qysh janë caktuar pagat e Kabinetit qeveritar deri sot. E kam thënë edhe publikisht, po e deklaroj edhe këtu, sektori i pagave duhet të rregullohet me ligj, ligjet që lidhen me reformën e administratës publike duhet të vijnë sa më shpejt në Kuvend dhe të aprovohen. Është një reformë, e cila është obliguese për neve, të reflektojmë gjendjen, nuk jam këtu duke e luajtur rolin e avokatit të asnjë vendimi, mirëpo nuk jam këtu për të atakuar asnjë vendim pa bazë.

Zonja deputete Haxhiu,

Pa më thuaj ti një vend, bash një vend, ku shumica e vartësve e kanë pagën më të madhe se të ministrit? Ma thuaj ti një vend ku deputeti e ka dyfishin e pagës së ministrit?! Merre pak me qetësi, edhe kur të ngresh çështje, ti apo kushdo tjetër, duhet të jenë në parim. Prandaj, sa i përket vendimit të parë, nuk ka pasur asnjë efekt financiar, nuk është në zbatim, është duke u qartësuar situata juridike, çfarëdo vendimi të sjellë Gjykata Kushtetuese, ne do ta respektojmë. Sa i përket çështjes së dytë, sinqerisht kur e pashë interpelancën, nuk e kisha krejt të qartë, po tash u qartësua. Zoti Hoti e tha që është bërë një reformë e mirë, është caktuar rregulla e pagave, e përcakton ligji, kur e dëgjova zonjën Haxhiu doli e kundërta e saj. Sa i përket çështjes për, po vendimet edhe një herë po kthehem, këtë vendimin e parë e ka marrë si kryeministër Bajram Rexhepi, të dytin zoti Ramush Haradinaj, ku mbi bazën e këtij vendimi ende jepen pagat për zëvendësministrat, për shumë pozita, të tretin e ka marrë Agim Çeku, si kryeministër, të katërtin e ka marrë zoti Thaçi, të pestin, ku gjithashtu flitet për paga e ka marrë zoti Mustafa, e kam edhe një tubë tjetër të vendimeve, po veç këto i përmenda, ka pasur praktika që pagat edhe të pozitive të caktuara politike janë vendosur me vendime të Qeverisë.

Sa u përket vendimeve të tjera që kanë të bëjnë me rritjen e pagave për të gjithë ata që realizojnë paga përmes buxhetit të Kosovës, të gjitha kategoritë e të punësuarve që marrin paga nga buxheti i Kosovës, më lejoni t'ju informojmë më detajisht mbi procesin dhe kronologjinë e vendimeve të Qeverisë për rritjen e pagave. Fillimisht, siç e dini, Ministria e Financave, para propozimit të Projektligjit për buxhetin e vitit 2018 ka bërë analizë përkatëse për të gjitha kategoritë e shpenzimeve, duke përfshirë këtu edhe kategorinë e pagave dhe mëditjeve dhe natyrisht për mundësitë e financimit. Duke pasur për bazë këto analiza brenda afatit ligjor, pra para fundit të tetorit të vitit 2017, ka paraqitur në Qeveri dhe më pas Qeveria ka proceduar në Kuvend Projektligjin e buxhetit të vitit 2018, ku, ndër të tjera përmban edhe linjën buxhetore të kategorisë ekonomike - paga dhe mëditje.

Propozimi për këtë kategori në kohën kur është përgatitur projektbuxheti për vitin 2018 ka pasur për bazë këto dy elemente: Ligji mbi financat publike dhe përgjegjësisë, respektivisht neni 22c,



dhe paragrafët përcjellës të këtij neni, ku ndër të tjera përcaktohet se “me rastin e planifikimit të rritjes së buxhetit për paga dhe mëditje duhet të merret për bazë norma e rritjes vjetore të bruto produktit vendor nominale. Rritja eventuale duhet të aplikohet në faturën totale të pagave dhe mëditjeve”. Sipas nenit 22c pika 1.1., thuhet: “Për qëllim të këtij neni fatura e pagave është e definuar si total i shpenzimeve për paga dhe kompensime, të cilat përfshijnë pagat, përfitimet personale, pagesat për sigurime pensionale shëndetësore dhe sociale, si dhe pagesat për shërbimet profesionale për të gjithë të zgjedhurit, respektivisht zyrtarët e emëruar si dhe të gjithë punëtorët e përkohshëm dhe të përhershëm në të gjitha organizatat buxhetore të nivelit qendror dhe komunal”.

Rritja e faturës së pagave duhet të jetë konsistente me stabilitetin e financave publike dhe me një ekonomi konkurruese. Në linjë me kërkesat ligjore dhe mundësitë për financim kemi marrë parasysh nevojat për financim të qëndrueshëm për fushat me prioritet, në veçanti në këtu e kemi pasur parasysh fushën e sigurisë dhe të drejtësisë.

Pra, duke u bazuar në këto parime, ne e kemi propozuar total-buxhetin për paga dhe mëditje prej 590 milionë euro, që krahasuar me buxhetin e vitit 2017, sipas rishikimit, është një rritje prej mbi 4%, dhe kjo është në linjë dhe e respekton në tërësi nenin 22/c të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Më pas, pas miratimit të Ligjit për Buxhetin nga Kuvendi, Qeveria, më 12 janar 2018, ka marrë vendim për rritjen e pagave për të gjitha kategoritë e të punësuarve, që marrin paga nga Buxheti i Kosovës, vendimi nr. 05/24, dhe kjo rritje ka filluar të zbatohet nga 1 janari 2018.

Sipas këtij vendimi, paga bazë për të gjitha kategoritë e të punësuarve që marrin paga nga Buxheti i Kosovës rritet për 4%, duke përfshirë këtu edhe rritjen prej 0,5%, që është si rezultat i përvojës së punës. Tani, duke e ditur se, në fakt, shpenzimet për paga në vitin 2017, në fund të dhjetorit rezultojnë të jenë më të vogla se ato të planifikuara sipas rishikimit, në vend të 566 milionë të planifikuara, në Buxhetin e rishikuar kemi pasur një shpenzim prej 551 milionë, apo 15 milionë më pak, kjo ka mundësuar që me Buxhetin e vitit 2018 të akomodohet rritja e pagave prej 4%, plus plotësimi i vendeve të lira të punës për sektorët me prioritet.

Sipas kësaj analize del që Buxheti i rishikuar të masa e pagave ka qenë 556 milionë, Buxheti i aprovuar është 590 milionë, rritja në krahasim me Buxhetin e rishikuar është 4,2%, rritja në krahasim me Buxhetin e realizuar është 7,1%, masa e pagave për janar dhe shkurt është rreth 48 milionë, e nëse vazhdon kjo dinamikë është rreth 576 milionë, dhe pjesa e mbetur prej 590 në 576 milionë është e mjaftueshme për mbulimin e punësimeve, pozitave të reja dhe pagesave tjera. Dhe, vendimi tjetër që ka të bëjë me rritjen e Buxhetit për skemat e ndihmës sociale është jashtëzakonisht...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: E merr kohën e pozitës.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Sa i përket rritjes së Buxhetit për ndihmat sociale është në kuadër të programit të Qeverisë, është objektiv i Qeverisë që, përveç pjesës më të madhe të Buxhetit që shkon për investime kapitale, të përkrahët sektori i rendit dhe ligjit, shëndetësia, arsimit, t'i kemi kujdes edhe çështjet sociale dhe në këtë drejtim kemi reflektuar në rritjen e pagave për të gjithë të punësuarit që realizojnë paga nëpërmjet Buxhetit të Kosovës, rritjen e pagesave për familjet me asistencë sociale për 20%. Nuk është rritje e vogël, e dimë që s'është e mjaftueshme, por jemi të vendosur që të vazhdojmë në këtë drejtim, përfshirjen e tri skemave të reja, të cilat kanë qenë me ligj të obliguara, por kanë qenë të pabuxhetuara dhe për herë të parë këtë vit fillojnë dhe besoj që në proceset e ardhshme buxhetore prapë do të trajtohen kategoritë që përfitojnë prej Buxhetit.

Këto ishin disa sqarime të nevojshme. Ne jemi këtu për të dhënë edhe sqarime më të detajuara, mirëpo rritja e pagave me vendim të Qeverisë nuk ka krijuar precedent, sepse ka ndodhur edhe në të kaluarën. Sektori i pagave dhe gjithë kjo diskrepancë dhe mospërputhshmëri, mosrregullshmëri, duhet të rregullohet me ligje të kësaj fushe dhe vendimi nuk ka pasur asnjë efekt financiar, sepse jemi duke pritur të qartësohet situata prej Gjykatës Kushtetuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani rreth skemës sociale, ministri për Çështje Sociale, zoti Reçica.

MINISTRI SKËNDER REÇICA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Sot do të flas në veçanti për vendimin e 12 janarit 2018, që ka të bëjë me rritjen e ndihmës sociale për ata qytetarë, të cilët janë në mbështetje të asistencës sociale, por para se të hyj te kjo temë dua t'i ndaj nja dy-tri fjalë me ju dhe qytetarët për angazhimin dhe zotimin tonë si Qeveri dhe ne si Ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale që të jemi pranë qytetarëve, atyre kategorive me nevojë të veçantë dhe jo vetëm kaq, ne vazhdimisht me angazhimin tonë dhe me përkushtimin tonë që nga ditët e para kemi treguar përkushtimin që të jemi pranë të gjitha kategorive me nevoja të veçanta, përfshirë këtu edhe veteranët, përfshirë këtu edhe viktimat e dhunës të luftës së fundit, e të tjerë...

Të nderuar deputetë,

Pensionet dhe ndihmat sociale janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për familjet, sidomos për ato që kanë të ardhura të ulëta. Në veçanti, ndihma sociale është një burim i rëndësishëm i të ardhurave për familjet, të cilat janë kryekëput të varura nga këto të ardhura. Me një nivel relativisht të lartë të varfërisë, zhvillimi i një rrethi të mbrojtjes sociale është qenësor, që të varfërve dhe familjeve të rrezikuara t'u mundësojë një menaxhim më të mirë të riskut ekonomik.

Pensionet, e në veçanti skemat e pensioneve bazë, luajnë rol të rëndësishëm në zbutjen e varfërisë dhe së bashku me ndihmat tjera janë domethënëse për buxhetet e familjeve të varfra. Në Kosovë, instrument kryesor për këtë është skema e ndihmës sociale, nëpërmjet së cilës u ofrohet mbështetje familjeve në shuma monetare në bazë të numrit të anëtarëve të familjes.

Vlera mujore e ndihmës sociale që nga themelimi i skemës së ndihmës sociale ka pasur ngritje vetëm dy herë, në vitin 2009 minimumi 35 euro, sa ka qenë për çdo familje, është rritur për 5 euro, dhe në vitin 2015 vlera e ndihmës është rritur për 25%. Megjithëse dispozitat ligjore në baza vjetore parashohin përshtatje të përfitimit në proporcion me shportën minimale të konsumit, kjo nuk ka ndodhur dhe nuk janë zbatuar këto dispozita gjatë viteve të kaluara. Duke marrë parasysh faktorët e cekur më lart, shuma prej 50 eurove në muaj për familjen njëanëtarëshe, vlera minimale e ndihmës sociale, e cila ka qenë deri në dhjetor të vitit 2017, ka qenë më e ulët se kufiri i varfërisë së skajshme.

Aktualisht nga skema e ndihmës sociale përfitojnë mbi 26 000 familje me mbi 106 mijë anëtarë, të cilët marrin ndihmë sociale në bazë të numrit të anëtarëve të familjeve, duke filluar nga 60 euro për familjet me një anëtar, deri 180 euro për familjet 15-anëtarëshe. Bazuar në legjislacionin në fuqi, shuma mujore e ndihmës sociale përcaktohet sipas numrit të anëtarëve të familjes dhe kostos së çmimit të konsumit të shportës së ushqimit, e cila duhet të harmonizohet me indeksin e çmimeve të konsumit të shportës së ushqimit, të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Me gjithë lëvizjet e çmimeve të artikujve në kuadër të shportës së ushqimit, shuma e ndihmës sociale nuk është ngritur nga viti 2015 dhe me këtë rast nuk është harmonizuar me indeksin e çmimeve. Bazuar në hulumtimet e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, organizatave të ndryshme ndërkombëtare dhe lëvizjes së çmimeve të artikujve të shportës së ushqimit, është propozuar dhe është marrë vendim që vlera e ndihmës sociale për çdo familje të rritet 20% nga vlera aktuale e ndihmës sociale dhe kjo ka filluar të zbatohet nga 1 janari 2018.

Rritja e vlerës së ndihmës sociale, përveç që do të ndikojë në rritjen e mirëqenies së këtyre familjeve, do të ndikojë edhe në zvogëlimin e shkallës së varfërisë, sidomos asaj ekstreme. Buxheti i aprovuar për skemat e ndihmës sociale për vitin 2018 do të mbulojë rritjen prej 20%, duke pasur parasysh dhe duke llogaritur që personat nga skema e ndihmës sociale do të

përfshihen në masat aktive të tregut të punës dhe gjithashtu do të ketë mbikëqyrje dhe kontroll më të lartë në sistemin e skemave me qëllim që të identifikohen dhe largohen personat që nuk meritojnë të jenë pjesë e kësaj skeme. Prandaj, bazuar në analizën tonë, konsiderojmë se buxheti i planifikuar do ta mbulojë rritjen për këtë vit.

Jemi të vetëdijshëm se rritja prej 20% nuk është mjaftueshme për këto familje, por Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në kuadër të planeve të punës e kanë përcaktuar si objektiv që nëpërmjet masave aktive të tregut të punës të angazhohet në punë të paktën nga një anëtar i familjeve nga kategoria e dytë e përfituesve të asistencës sociale, të cilët do ta ndihmojnë buxhetin familjar dhe nuk do të jenë të varur nga ndihmat sociale.

Gjithashtu, një rëndësi e veçantë do t'u kushtohet mekanizmave të mbikëqyrjes, kontrollit dhe shkëmbimit të të dhënave që identifikohen si mashtrim nga përfituesit e skemave të ndihmës sociale.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se për ta rritur efikasitetin e ngritjen e mirëqenies sociale të qytetarëve në nevojë, gjithashtu është e rëndësishme që ta kemi një analizë dhe rishikim të skemës sociale nëpërmjet ndryshimit të Ligjit për skemën e ndihmës sociale. Në këtë aspekt, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në kuadër të dokumenteve të saj strategjike dhe programe dhe në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare, si Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, e ka filluar një studim për skemën e ndihmës sociale, i cili do të ofrojë një analizë dhe do të nxirren rekomandimet për ndryshimet e nevojshme për Ligjin e skemës së ndihmës sociale, i cili pas këtyre rekomandimeve do të jetë subjekt i trajtimit të menjëhershëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit për ekspozenë! Tani radha është e grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, fjalën e ka zoti Albin Kurti. Replikë? Kush do replikë? Zoti Hoti, replikë, por minutazhin tuaj e keni, siç u lajmëruat për replikë, si ashtu.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Më lejoni t'i sqaroj dy-tri gjëra.

Vendimi i Qeverisë për rritje të pagave është i datës 20 dhjetor 2017, Buxhetin e kemi aprovuar më 22 dhjetor 2017. Është fakt që ky vendim i Qeverisë nuk është i reflektuar në Buxhetin e vitit 2018.

E dyta, në Qeverinë Mustafa asnjëherë nuk i kemi rritur pagat për Kabinetin qeveritar. Është një vendim, i cili ju ka lejuar që edhe zëvendësministrave t'u paguhen pagat për gjashtë muaj pas mbarimit të mandatit të tyre.

Dhe, e treta, le të supozojmë një gjë, që vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk e kundërshton vendimin e Qeverisë. Le të themi që Agjencia Kundër Korrupsionit nuk ka pasur të drejtë kur e ka nxjerrë atë opinion, prapë është konflikt i hapur interesi mbi baza të etikës së marrjes së vendimit, sepse vendimi prek vetëm ata që e kanë marrë vendimin, pra vetëm Kabinetin qeveritar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, ke të drejtë!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Unë i përmenda këtu vendimet nga të gjithë kryeministrat. Ka më shumë vendime, por e përmenda nga një prej tyre, duke filluar prej zotit Bajram Rexhepi, zotit Ramush Haradinaj, Agim Çeku, e kështu me radhë... Disa këto vendime e përcaktojnë pagën e kryeministrit, disa i caktojnë pagat e ministrave, disa i caktojnë pagat e zëvendësministrave. Edhe sot, le të dalë e të ma shpjegojë dikush këtu, nëse ka mundësi që, përpos vendimeve të Qeverisë, qysh janë përcaktuar dhe qysh paguhen pagat e Kabinetit qeveritar, me cilin ligj, përpos vendimeve të Qeverisë?

Çështja tjetër, sa i përket impaktit buxhetor, nëse vendimi i Qeverisë ka impakt buxhetor deri në nivel të caktuar dhe mund të akomodohet brenda rregullës së pagave, nuk mund të jetë në kundërshtim me ligjin. Prandaj, ne po e presim këtë situatë që të qartësohet nga Gjykata Kushtetuese, vendimi është marrë në dhjetor, nuk është implementuar as për dhjetor, as për janar. Nuk ka të bëjë kjo me institucionet tjera, se institucionet tjera kanë dalë me vendim shumë më vonë. Në dhjetor ka mundur të implementohet vendimi, mirëpo po presim qartësim të situatës juridike. Kur situata të qartësohet juridikisht, pastaj do të merren vendime në përputhje me vendimet e organeve kompetente. Ndërsa unë besoj, edhe është më se e nevojshme, Ministria e Financave e ka dhënë vlerësimin e ndikimit buxhetor sa i përket koncept-dokumentit për ligjet që e rregullojnë këtë fushë dhe besoj që ministria e linjës, në këtë rast Ministria e Administratës Publike, do të vijë nëpërmjet Qeverisë në Kuvend me pakon e ligjeve që e rregullojnë këtë fushë dhe vendosin barazi.

Nuk ka diskrepancë veç te pagat e shërbyesve të lartë publikë, ka edhe te shërbyesit civilë. Për punën e njëjtë, për kualifikim të njëjtë, brenda të së njëjtës organizatë buxhetore, ka pagesa të ndryshme. Prandaj, është kusht, është pjesë kontraktuale, është pjesë dhe kërkesë e MSA-së që kjo fushë të rregullohet me ligje dhe ne jemi duke punuar që të rregullohet me ligje.

Ne si Qeveri nuk jemi të përcaktuar të zvogëlojmë rroga, nuk jemi të përcaktuar të ulim paga. Ne jemi duke punuar për t'i rritur pagat, i kemi rritur dhe do të vazhdojmë t'i rritim në përputhje me mundësitë reale buxhetore. Dhe, kanë përfituar të gjithë punëtorët që realizojnë paga nëpërmjet Buxhetit të Kosovës.

*(Reagime nga salla)*

Jo, jo, zonja Haxhiu! Ma gjej një vend që paga e deputetit në total, me të gjitha pranimet, jo veç paga bazë, që është dyfish paga e ministrit. Po, ne nuk e kemi ndërmend t'ua zvogëlojmë pagat deputetëve, e kemi ndërmend deputetëve t'ua përmirësojmë kushtet të gjithë të punësuarve t'u përmirësohen kushtet, po në të njëjtën kohë me ligj do të bëhet edhe nivelimi i pagave për shërbyesit e lartë publikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,  
Kabinet i Qeverisë,

Kosova është vend relativisht i vogël, me qeveri absolutisht të madhe. Janë 5 zëvendëskryeministra, 21 ministra dhe 70 zëvendësministra. Besoj që së paku 2 zëvendëskryeministra janë të panevojshëm, së paku 7 ministri janë të panevojshme dhe më shumë se një zëvendësministër për ministri janë të tepërt. Pra, do të duhej të zvogëloheshin së paku 40% të zëvendëskryeminstreave, së paku 1/3 e ministrave dhe së paku 4/5 e zëvendësministrave, pra që në vend se 70, të jenë 14.

Sikur kjo të mos mjaftonte, më 20 dhjetor, kur i mbushi 100 ditë, kjo qeveri e madhe ia dyfishoi pagat vetvetes, duke u bërë kështu edhe qeveri e rëndë. Meqë ajo u kritikua dhe u akuzua ashpër për këtë vendim nga qytetarët, shoqëria civile dhe gazetarët, tri javë më vonë ua rriti pagat edhe shërbyesve civilë me 4% si dhe pagesën e skemës sociale me 20%, siç u tha. Tamam si te ajo shprehja e popullit: “Nuk të japin bukë për ta ngopur barkun, por për ta mbyllur gojën”.

Për qeverinë e tij me 21 ministra, 5 zëvendëskryeministra dhe 70 zëvendësministra (gjithnjë me mundësi rritjeje të këtyre të fundit), Haradinaj ka deklaruar se nuk është pare e humbur kjo. Domethënë nuk tregon se si është fitim, por se si nuk humbim. Në fakt, atij i vjen keq të thotë se pikërisht kjo është fitim! Po, pra, fitim i rehatisë së partnerëve të koalicionit të gjerë qeverisës. 70 veta janë rehat. Me ta edhe familjet e tyre, ndoshta edhe disa miq biznesmenë të tyre, por gjithsej nuk bëjnë as 1.000 veta në Kosovën që ka rreth 1,8 milionë banorë. Gjithsesi pakicë e imtë njerëzish që sundon duke blerë pak njerëz të tjerë me paratë që grumbullohen nga të gjithë. Kur nuk ke qeverisje zhvillimore, nuk mund të ndalesh vetëm te një degradim: nga zhvillimi në administrim, rrëzohesh mandej edhe nga administrimi në rehatim.

Rezultati në punë e aktivitet, sipas shumë studimesh, është funksion i aftësisë dhe motivimit në varësi nga rrethana: Pra, rezultati varet nga aftësia dhe motivimi proporcionalisht, gjithnjë duke u varur nga rrethanat. Shumica dërrmuese e njerëzve, rreth 75% sipas disa studimeve, besojnë që motivimi kryesor për punë për njerëzit e tjerë është rroga, mirëpo ata përgjithësisht nuk e mendojnë këtë për veten e tyre, pra njerëzit besojnë që të tjerët i motivon rroga dhe jo ata vetë: rrogën e kanë në vendin e tretë për vetvete, të paraprirë prej kënaqësisë dhe përmbushjes që vjen

nga punët ekzaltuese dhe sfiduese - pra, jo nga shpërblimet e jashtme, por nga ato të brendshme. Rrjedhimisht, rritja e pagave nuk do të reflektohet në performansë.

Vetes së tij si kryeministër Haradinaj ia dyfishoi pagën, kurse shefit të kabinetit të tij ia trefishoi. Kjo mu në kohën kur e nënshkruan kontratën e frikshme me “Contour Global”-in, që kërkon 18,5% shkallë të kthimit të brendshëm në kapital, t’ia garantojmë tregun dhe kredinë dhe ia jep 15 hektarë për 10 euro. Pra, duan që të paguhen më shumë për dëmet më të mëdha që ia shkaktojnë Kosovës.

Të nderuar deputetë,

T’ia rrisësh pagën vetes është hajni, është vjedhje. Vjedhja nuk është vjedhje sepse bëhet tinëz, por për shkak se është vjedhje. Ka vjedhje aq, p.sh. kjo rritje e pagave.

Por kjo është veçse pasojë e fundme e një fenomeni të hershëm: edhe me këtë Qeveri, sikurse me të tjerat, ne nuk flasim e nuk bëjmë ekonomi, por veçse financa. Kapitali financiar merr pjesë në ndarjen e shkallës mesatare vjetore të profitit që tashmë është dhënë, dhe jo në formimin e shkallës mesatare të profitit. Sipas pikëpamjes sonë socialdemokrate, rritja e pagave nuk duhet ta ndjekë thjesht rritjen ekonomike (pavarësisht strukturës së rritjes), por produktivitetin në ekonomi (nga i cili varet struktura e rritjes). Ama me këtë qeveri është edhe shumë më keq se kaq: kjo qeveri edhe i rrit pagat pavarësisht rritjes ekonomike/ edhe këtë ia bën veçse vetvetes.

Në vend se të bëhen kursime të vogla që së bashku bëjnë shumë, në shpenzimet qeveritare, dhe të jemi të lirshëm në rangun makro në Fondin e Kursimeve Pensionale dhe Fondin e Privatizimit, bëhet e kundërta: rriten shpenzimet qeveritare për qeverinë, kurse këto dy fonde mbeten jashtë ekonomisë së vendit pa kurrfarë fasilimiti të zhvillimit.

Shteti i Kosovës, edhe me këtë qeveri vazhdon të jetë si një byro për punësim, mirëpo jo një byro për punësim që të gjen pune diku tjetër, por të gjen vend pune vetëm në këtë byro për punësim! Pra, byro për punësim që të gjen vend pune në byro për punësim. Shteti zhvillimor nënkupton që zhvillimi buron nga brenda dhe ndihmohet prej jashtë; ai vendos bashkëpunimin e shtetit me bizneset dhe i jep prioritet prodhimit. Shteti zhvillimor ka bankë zhvillimore. Merreni me mend, BE-ja ka Bankë zhvillimore në Kosovë, e vetë Kosova nuk e ka një të tillë për veten e saj. Nuk mund të zhvillohemi pa bankë zhvillimore investive, veçse me këto banka komerciale. Kapitali i bankës është shumë i shtrenjtë, kurse ai i mërgatës është shumë i lirë - dy ekstreme të humnerës ekonomike të Kosovës janë pikërisht këto: kapitali i bankës shumë i shtrenjtë e kapitali i mërgatës shumë i lirë.

Drejtësia dhe punësimi janë dy gjërat vendimtare për Kosovën si shtet. Tash, kemi aq shumë korrupsion dhe papunësi, e pranojnë të gjithë. Shtrohet pyetja, si bëhet që Kosova ka aq shumë korrupsion dhe ministrat e brendshëm e të drejtësisë kurrë nuk u shkarkuan a u dorëhoqën asnjëri

asnjëherë?! Sepse asnjëherë nuk kishim qeveri të përgjegjshme që jep llogari, por vetëm qeveri që rehatohet për vete e ty t'i merr paratë. E ky korrupsion bëhet faktor shtesë në mungesën e zhvillimit, përveçse mungesa e zhvillimit është ajo e cila i jep hov korrupsionit.

Në Kosovë gati 3/4 e të papunëve janë të papunë afatgjatë, pra për më shumë se 12 muaj të papunë. Dhe, pothuajse 1/3 e të rinjve të moshave midis 15 dhe 24 vjeç nuk janë as të punësuar, as në shkollim dhe as në ndonjë trajnim. Shkalla e punësimit te këta është vetëm 8,5%. Po e përshkruaj e shpjegoj kontekstin në të cilin ka ndodhur rritja e pagave të qeverisë për veten e saj. Shkalla e papunësisë në Kosovë është 32,9%, mirëpo shkalla e punësimit është shumë e ulët, vetëm 25,2% në raport me popullsisë, sepse popullsi ekonomisht aktive konsiderohen pak: 2/3 e popullsisë janë shpallur ekonomisht joaktive dhe mbi 80% të grave janë shpallur ekonomisht joaktive! Në Shqipëri, raporti i punësimit me popullsinë është dyfish më i lartë sesa në Kosovë: 52,9%! Madje edhe Bosnjë-Hercegovina është rregullisht më mirë se Kosova, duke na lënë neve në vendin e fundit në Ballkan.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Nëse do ta shikonim “punën” thjesht si mall që hyn në kërkesën dhe ofertën e tregut, ku secili individ ka zgjedhjen e lirë për të punuar ose jo, do të bënim një gabim të madh. Nëse do ta shikonim pagën në punë thjesht si çmimin për fuqinë punëtore, që është e lirë të zgjedhë nëse do të punojë ose jo dhe në cilën punë do të angazhohet, atëherë do ta thellonim këtë gabim. Kur flasim për të varfrit, kur flasim për njerëzit e diskriminuar në shoqëri, të cilët në Kosovë përbëjnë më shumë se gjysmën e popullsisë, puna nuk është çështje zgjedhjesh individuale dhe dëshirash, puna është nevojë jo vetëm për t'u përmbushur individualisht e për të kontribuar në shoqëri, por pikësëpari puna është domosdoshmëri për të siguruar jetesën përmes pagës. Për të varfrit puna dhe paga në punë nuk kanë alternativë, për ta nuk ka zgjedhje. Të varfrit duhet patjetër të punojnë e të paguhen për punën e tyre në mënyrë që të jetojnë. Në mënyrë që të mbijetojnë!

Prandaj, çështja e punës me një rrogë të drejtë që siguron jetesën dhe dinjitetin njerëzor, është çështje themelore e të drejtave të njeriut. Në preambulën e statutit të Organizatës Botërore të Punës, e cila është një prej Agjencive të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, shkruan se “sigurimi i një page për një jetesë të përshtatshme është një prej kushteve për paqe universale dhe të qëndrueshme të bazuar mbi drejtësinë sociale”.

Që shteti e ka këtë të drejtë ndërhyrëse dhe rregulluese për këtë çështje, është tashmë temë e shteruar, sepse Republika e Kosovës e ka të caktuar pagën minimale për të gjithë qytetarët në vlerën 170 euro për ata mbi 35 vjeç, dhe 130 euro për ata nën këtë moshë. Nuk jemi duke folur sot nëse duhet apo jo shteti të ndërhyjë, për këtë kemi rënë dakord që më herët si shoqëri, pra që shteti duhet të ndërhyjë, e aq më tepër për sigurimin e një prej të drejtave themelore të njeriut siç është paga minimale për një jetë dinjitoze në Kosovë. Sot jemi këtu për të diskutuar e vendosur për heqjen e dallimit në pagë minimale bazuar mbi moshën e një punëtori. Ky dallim edhe është



diskriminues, edhe e penalizon rrinë e Kosovës që përbën grupmohën më të madhe të shtetit të Kosovës. Ndërhyrja në caktimin dhe rritjen e rrogës minimale konsiderohet si normale jo vetëm në shumicën dërrmuese të vendeve të Evropës dhe të demokracive liberale në botë, por edhe më gjerë.

Ashtu siç veprohet edhe në shtetet e Evropës Perëndimore, e sidomos asaj Veriore, edhe në Kosovë kapitalizmi duhet orientuar dhe menaxhuar. Populli në Kosovë nuk mund të vazhdojë të jetojë nën një sistem të egër. Socialdemokracia e ka për synim rishpërndarjen për të ulur pabarazinë në shoqëri. Rishpërndarja nuk është thjesht e dëshirueshme nga ana sociale, por siç ka shpjeguar ekonomisti i mirënjohur anglez, John Mayard Keyenes, rishpërndarja është edhe racionale nga këndvështrimi ekonomik. Sa më e vogël pabarazia në shoqëri, aq më e madhe kërkesa agregate në atë shoqëri. Një ekonomi dinamike ka nevojë për një kërkesë më të madhe në treg. Prandaj, pikërisht zvogëlimi i pabarazisë i ndihmon edhe ekonomisë, jo vetëm shoqërisë. Prandaj, ne angazhohemi që të hiqet dallimi i moshës për pagën minimale dhe kjo përbën një prej pikave të mocionit tonë sot.

Paga minimale nuk do të duhej të varej as nga rritja ekonomike. Paga minimale përcaktohet nga nevojat elementare të njeriut. Paga mesatare le të varet nga rritja ekonomike dhe produktiviteti.

Në Kosovën e pasluftës, vazhdimisht kemi pasur parti të djathta që kanë rehatuar së pari veten në qeverisje. Orientimi i tyre është i dështuar. Duke qeverisur, ato i kanë institucionalizuar dështimet. E kanë lodhur shtetin pa punë, e kanë dobësuar shtetin me forcë. Kosova ka nevojë për qeveri progresiste. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

*(Reagime nga salla)*

KRYESUESI: Unë e thërras publikisht kryeministrin të kthehet në sallë, sepse deputetët po e kërkojnë, po problemi është a kthehet a jo, është çështje e tij.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë nuk do të flas për barazinë, edhe më pak për sektorin bankar në Kosovë, besoj që këto kërkojnë ditë të veçanta të trajtimit, por do të flas për temën për çfarë edhe kemi thirrur këtë interpelancë, për pagat edhe rritjen e pagave të kryeministrit dhe Kabinetit të tij.

Tash unë e kuptoj pozicionin e kryeministrit, sepse nuk ka dëshirë të renditet i 69-ti në listën e të paguarve në Kosovë, por s'mund të mirëkuptoj asnjëherë rritje arbitrare të pagës së tij për dy arsye.

E para, sepse përbën konflikt interesi, kur dikush i rrit pagën vetit dhe në demokraci të zhvilluara konfliktet e interesit janë të parandaluara.

Dhe, e dyta, më tepër ka të bëjë me arsyetimin e dhënë dhe janë dy arsye të dhëna publike pse rritet paga, të parën s'e marrë seriozisht, çështjen e blerjes së kravatave, por të dytën, për shmangien e korrupsionit e marrë më seriozisht. Pra, rritja e pagës nuk bëhet për të parandaluar zyrtarët që janë në Qeveri për të mos u angazhuar në aktivitetet korruptive, por besoj që lufta kundër korrupsionit është çështje e bindjes. Pra, kur ke bindje nuk varesh prej nivelit të pagës.

Tash, unë po them edhe një herë, e mirëkuptoj pozicionin e shpërprthjes dhe konsideroj se ka shpërprthje enorme në sektorit publik sa u përket pagave.

Vetëm në këtë institucion kemi këshilltarë të kryetarit të Kuvendit që e kanë pagën 2 000 euro dhe në qoftë se një këshilltar i kryetarit të Kuvendit e ka pagën 2 000 euro neto, e një kryeministër i një vendi e ka 1.400 euro natyrisht se e mirëkuptoj këtë pozicion.

Ka raste që në Kosovë një drejtor i një organizate financiare ka pagën 6 000 euro neto dhe sado që po mundohemi të bëjmë punën e reduktimit të pagave të tilla, ajo është e pjesshme, nuk është e plotë, po nuk u trajtua siç do të argumentoj më vonë me ligj.

Tash në punën që e bëjmë në Komision për Buxhet dhe Financa kemi filluar reduktimin e shtesave, të pagave në institucione ku mundemi dhe jemi thënë të drejtën të trishtuar edhe me sasinë e shtesave të tjera që vijnë mbi paga. Pra është një kulturë e tërë e shfrytëzimit të parasë publike, të mos flasim për mëditjet për punë përtej pagës që e bëjnë, të mos flasim për mëditjet jashtë vendit e të mos flasim për sigurime. Pra, kanë zbuluar edhe terme shtesë të marrjes së parasë, sigurime për shkak të rrezikshmërisë së punës që e bëjnë.

Dhe, natyrisht zgjidhja në situata të tilla të një shpërprthjeje kaq enorme ndërlidhet me Ligjin për paga dhe Ligji për paga, një, do të bënte nivelimin e pagave në mënyrë që një këshilltar i një kryetari të Kuvendit mos ta ketë rrogën dy herë më të madhe se të kryeministrit.

Po e dyta, më e rëndësishme është që të merret për bazë standardi i jetës në Kosovë.

Pra, nuk ka kuptim që kryeministri t'i rritë pagën vetit në nivel 3 000 eurove, e paga minimale në Kosovë të jetë 170 euro. Pra, s'mund të ketë proporcion një me tetëmbëdhjetë, nuk ka vend në

rajon e në Evropë që ka një proporcion të tillë, ku paga minimale është 170 euro, e paga e kryeministrit është 3000 euro.

Dhe, e dyta, përveç Ligjit për paga, ne do të duhej të bënim edhe Ligjin për Qeverinë, sepse pavarësisht nivelimit të pagave dhe standardizimin me ambientin ekonomik në vend, neve prapë do të na kushtojnë shumë mirëmbajtja e 22 ministrive e 72 zëvendësministrave, pra duhet vënë kufizime edhe në Qeveri.

Dhe, e treta, jo më pak e rëndësishme, është reforma në administratën publike. Konsideroj se sot në mënyrë të padrejtë sektori publik paguhet shumëfish më tepër se sa sektori privat, i cili nuk ka mundësinë e rritjes as për 4% në një ambient të tillë ekonomik, edhe më tepër sektori privat shihet si një mundësi e artë punësimi për të gjithë që do të rehatohet, të marrë pagë të lartë e të bëjë punë pak. Pra, në qoftë se i bëjmë këto tri reforma, atëherë ka kuptim edhe nivelimi, edhe standardizimi i pagave në Kosovë.

Në mënyrën se si është bërë deri më tani është arbitrare, paraqet konflikt të pastër interesi dhe nuk respekton së paku dinjitetin e kosovarëve që jetojnë me shumë më pak në vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri Jagxhilar e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit!

I nderuar kryesues i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Vërtet në sistemin legjislativ të Republikës së Kosovës nuk ekziston një ligj bazë i cili rregullon pagat sa i përket sektorit publik ose më mirë të thuhet nga përfituesit nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Ministria e Administratës Publike, në koordinim me Ministrinë e Financave jemi duke punuar në Ligjin për pagat e përfituesve nga buxheti i Republikës së Kosovës. Koncept-dokumenti tashmë është në Zyrën e kryeministrit dhe shpresojmë që së shpejti do të aprovohet ky koncept-dokument, e pastaj sipas agjendës evropiane edhe strategjisë legjislative në muajin qershor, në pako edhe me Ligjin për zyrtarët publikë ose shërbyesit civilë, por gjithashtu edhe me Ligjin për organizimin e administratës publike do të aprovohet në Parlament edhe Ligji për pagat nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Deri tash me të vërtetë të gjitha pagat janë ndërlidhur me shumë ligje, por ligji bazik nuk ekziston. Kështu që ka ndodhur që pagat e funksionarëve publikë të bëhen sipas vendimeve të

ndryshme të Qeverisë, sipas vendimeve të ndryshme edhe nga Kryesia e Kuvendit të Kosovës, pastaj për agjenci të ndryshme ka ndodhur që shumë paga, sidomos për Zyrë të Rregullatorit ose agjencitë e pavarura kushtetuese të caktohet nëpërmjet komisioneve të ndryshme parlamentare. Ndërsa pagat e nëpunësve civilë kanë historikun prej rregullores së kohës së UNMIK-ut, sepse Ligji për pagat e nëpunësve civilë nga aspekti i koeficienteve dhe pagave nuk është zbatuar në tërësi. Kështu që vërtet ka nevojë së pari të hartohet një ligj bazik dhe duhet të punojmë së bashku që në muajin qershor së paku të procedojmë në Kuvend dhe së bashku të vazhdojmë punën dhe të aprovojme ligjin.

Sa i përket gjendjes së pagave në Republikën e Kosovës, fillohet prej Agjencisë së Privatizimit, drejtori i të cilës ka pagën më të lartë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Ndërsa presidenti, sipas analizave, është në vendin e nëntë, pastaj kryetari i Kuvendit të Kosovës është në vendin e njëzet, vazhdohet me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, i cili është në vendin e 38-të, ish-kryetari të Kuvendit të Kosovës në vendin e 54-t, kryetari i Komunës së Prishtinës në vendin e 63-të, anëtarët e Kuvendit ose deputetët në vendin e 66-të, vazhdohet me dekanin ose me rektorin e universitetit në vendin e 78-të, kryeministri vejnë në vendin e 85-të, sipas pagës ekzistuese. Ndërsa ministrat ose të gjithë kryetarët e komunave e kanë pagën më të madhe, edhe ministri është në vendin e 130-të dhe ashtu vazhdohet.

Sa i përket pagës më të ulët, të mos themi minimale, në buxhetin e Republikës së Kosovës, paga më e ulët është 241 euro. Janë të gjitha shënimet, tash janë afro 1500 pozita paga të ndryshme të cilat përfitohen nga buxheti i Republikës së Kosovës, janë të gjitha ato renditje të cilat edhe mund t'i ofrojmë.

Kështu që edhe nga aspekti i mosekzistimit të ligjit bazik, ka nevojë për ligjin, por edhe disproporcioni i pagave të ndryshme në sektorin publik duhet të rregullohet.

Ndërsa është edhe një çështje shqetësuese, si vazhdimësi e pagave, shtesat dhe kompensime. Edhe në këtë fushë nevojitet një disiplinë më e madhe, ku është vendosur prej institucioneve përkatëse për përfitimin e shtesave dhe kompensimeve.

Në këtë aspekt vërtet ka qenë vendim i Qeverisë, pra gjithmonë ka ekzistuar vendimi i Qeverisë sa i përket rritjes së pagave. A ka nevojë për aprovimin e ligjit? Ka. Duhet të punojmë të gjithë së bashku, sepse janë në buxhetin e Republikës së Kosovës afro 80 mijë njerëz, të cilët përfitojnë pagën dhe janë të gjitha në fusha të rëndësishme. Në këtë aspekt ne do të vazhdojmë punën në procedimin e ligjit dhe besoj dhe shpresoj që në muajin qershor ligji në fjalë do të jetë në Parlament për aprovim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar dhe kryesues i seancës,  
Zoti kryeministër,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Qytetarë të nderuar,

Ishte e qartë, po tash u sqarua që kjo interpelancë i ka tri nivele të diskutimit dhe ka të bëjë me ngritjen e pagave. Sa i përket çështjes së parë, interpelanca e ka humbur kuptimin, meqë çështja është adresuar në Gjykatën Kushtetuese dhe realisht neve po na ndodh shpesh që po diskutojmë për çështje, të cilat janë ende në procedurë gjyqësore dhe nuk e di sa po i bëjmë nder edhe këtij Kuvendi, por edhe vetes, kur jemi ata, të cilët edhe nxjerrim ligje edhe tentojmë t'i mbikëqyrim ato ligje.

Kjo interpelancë, para se ta kemi një vendim të gjykatës, është ndërhyrje dhe presion publik dhe institucional në vendimin e Gjyqësorit, dhe kështu është e panevojshme të diskutohet dhe të mbahet për të. Pa diskutim që njëra nga çështjet kyçe është që kjo materie, kjo çështje të rregullohet me ligj dhe domosdo që ne si Parlament, por edhe Qeveria, si iniciues dhe propozues, do të duhej t'i përshpejtojë hapat, në mënyrë që ne ta kemi të rregulluar me ligj dhe të dihet saktësisht në bazë të pozitave, në bazë të pozicionit dhe në bazë të përgjegjësisë, të cilën e ka, të paguhet ose ta marrë pagën secili njeri i institucioneve tona. Ne e dëgjuam me vëmendje kryeministrin edhe ministrin e Financave, edhe ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dua të them që ministri i Financave është hera e tretë që është këtu në Qeveri, një herë si zëvendës ministër, pastaj në dy mandate si ministër, dhe do të kisha pas dëshirë që të bëhet një bilanc me numra se sa ka pasur ngritje pagash gjatë mandatit të tij, si zëvendësministër dhe si ministër? Dhe, normalisht atë duhet të pasur parasysh edhe kryeministrat, të cilët i ka pasur si përgjegjës të drejtpërdrejtë.

Ndoshta pikërisht pse kjo Qeveri dhe ky ministër është tash ministër i Financave ne po diskutojmë për ngritje të ndjeshme të pagave të të gjithë të punësuarve në të gjithë sektorët. Diskutimet, të cilat po bëhen dhe të cilat nuk janë parimore, e kanë një tendencë edhe të politizimit, por edhe një betejë politike, mendoj që nuk e kanë vendin këtu. Më e rëndësishme dhe më me peshë për ne si deputetë dhe për qytetarët do të ishte që ne të diskutonim pak më tepër dhe pak më drejtpërdrejt për investimet e mundshme kapitale në këtë vend, për hapjen e vendeve të reja të punës dhe për çështjet, të cilat e forcojnë shtetin këtu, sigurojnë lirinë e lëvizjes dhe e forcojnë sistemin ekonomik të shtetit, e njëkohësisht edhe pagat.

Të nderuar kolegë,

Nëse flasim për çështjen se cilat kategori përfitojnë nga vendimi numër 04/20 i datës 20 dhjetor, kanë qenë me paga edhe jo të harmonizuara karshi përgjegjësive që kanë dhe normalisht që, e thashë edhe më herët, kjo çështje duhet të rregullohet me ligj dhe është një domosdoshmëri. Nuk mund, nëse e bëjmë një analizë dhe një krahasim, nuk mund që një këshilltar të paguhet më pak

se një punëtor i një ndërmarrjeje publike. Kryeministri apo ministri nuk ka aspak logjikë që të paguhet më pak se deputeti dhe ne e diskutuam nëse do ta bëjmë harmonizimin, a do ta bëjmë atë çfarë e tha ministri, që të mos u zvogëlohen pagat atyre, po t'u rriten atyre që kanë nevojë. Kjo çështje duhet të rregullohet me ligj dhe duhet ta debatojmë këtu.

Janë me mijëra persona në sektorin privat dhe publik në bazë të të dhënave nga Trusti Pensional, që paguhet më shumë se ministri. Duhet parë edhe këtë. Një këshilltar paguhet me pagë mesatare të sektorit publik dhe sa gjysma e një asistenteje të një ndërmarrjeje publike. Normalisht që do të duhej parë edhe këtë çështje. A mund që një profesor fakulteti, që e ka pagën 2 mijë euro, ta marrë pozitën e një këshilltari të një ministri ose kryeministrit që paguhet 500 euro, nëse ne kemi nevojë për dijen e tij, për përvojën e tij dhe për mbështetjen e tij ose ndihmesën e tij. Kuvendi patjetër është dashur më herët të merret me këto çështje. Edhe për çështjen e Kabinetit qeveritar, pagat e tyre, të kryeministrit dhe ministrave, por edhe çështjet tjera që u diskutuan më lart dhe do të diskutohen edhe gjatë ditës së sotme. Në të ardhmen, ne do ta mbështetim çdo propozim të Ministrisë së Financave dhe kryeministrit dhe Qeverisë si tërësi për rritje të pagave, veçanërisht nëse ato janë të bazuara me ligj dhe specifiku për pagat e mjekut, mësuesit, ushtarit, policit, shërbyesit civil, veteranit, invalidit dhe gjyqtarit e prokurorit dhe për të gjithë ata që e përbëjnë bazën e shtetit.

Duhet të bëjmë përpjekje maksimale ne si deputetë pastaj që ta rritim performancën e tyre dhe njëkohësisht ta mbikëqyrim punën dhe angazhimin e tyre. Qeveria duhet ta rrisë kujdesin për sektorin privat, duke e mbështetur zhvillimin e sektorit privat, mbikëqyrjen dhe respektimin e të drejtave të punëtorëve. Kjo besoj ajo është esenciale për të qenë tërheqës dhe që qytetarët tanë të synojnë për t'u punësuar në sektorin privat. Nëse e kemi një dallim aq të madh sa që është tash, atëherë normalisht që secili qytetarë do të tentojë dhe do të provojë, dhe do të kërkojë që të jetë i punësuar në sektorin publik. Vendimi 12/24 i janarit të këtij viti i Qeverisë së Kosovës për rritje 20% të pagës së përfituesve të skemës sociale është vendim i qëlluar dhe Qeveria aktuale krahas stabilitetit buxhetor ka arritur që të sigurojë stabilitet buxhetor sa u përket pagave të veteranëve dhe kategorive të tjera.

Ka arritur të sigurojë rritje të ndjeshme në pagesën për personat që përfitojnë nga skema sociale, po ashtu ka siguruar dhe ka buxhetuar për kategoritë tjera të ndjeshme të shoqërisë, siç janë viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës së Kosovës.

Do ta mbështetim çdo vendim të Qeverisë që është në shërbim të kategorive që kanë dhënë më së shumti për lirinë dhe shtetin e Kosovës. Në këtë dhjetëvjetor të shtetit të Kosovës, që sapo e përmbyllëm, kemi arritur që sadopak të jemi mirënjohës dhe kontribuues për ish të përndjekurit politik, familjet e dëshmorëve, deputetët e 2 Korrikut, veteranët, invalidët e UÇK-së, viktimat e luftës në Kosovë, viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës dhe kjo është një çështje që ne duhet ta vlerësojmë dhe nuk them që duhet t'i vëmë pikë, por ne duhet të angazhohemi në mënyrë

proaktive që të fuqizohen sa i përket aspektit material të gjitha këto kategori. Ne jemi shumë të interesuar që edhe punëtorët arsimorë dhe shëndetësorë, të cilët kanë kontribuar gjatë viteve të '90-ta, t'i mbështetim konform mundësive buxhetore çfarë i kemi dhe nuk duhet të harrojmë që pjesë e angazhimeve edhe për lirinë e Kosovës dhe për pavarësinë e Kosovës kanë qenë edhe ata punonjës.

Mirëpo, nga të gjithë deputetët kisha kërkuar, meqë kemi çështje shumë të rëndësishme para vetes, kemi mundësi shumë të mëdha, do të duhej që ne të fokusohemi në çështje të cilat janë interes i Kosovës dhe çfarë kërkojnë qytetarët e Kosovës. Normalisht, në të gjitha vendimet dhe veprimet ne si Grup Parlamentar i PDK-së do ta mbështetim edhe kryeministrin, edhe Qeverinë, do të jemi në dispozicion me të gjitha kapacitetet për të qenë afër tyre, për t'i trajtuar dhe për të dhënë mendime dhe për t'i mbështetur të gjitha ato vendime dhe veprime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga AAK-ja, kush e ka fjalën? Zoti Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Edhe pse shumica e kolegëve i cekën disa çështje, e unë veç kam qenë i përgatitur t'i them, po nisem prej disa çështjeve shumë konkrete. E para, kjo iniciativë për interpelancë është nisur edhe mbi bazën e etikës qeverisëse, e unë po flas për një etikë tjetër, për etikën shtetërore që ka të bëjë me çështjen e pagave. Mbi 320 zyrtarë deputetë, anëtarë të bordeve publike, qendrore dhe lokale, bartës të institucioneve të pavarura, e kanë pagën më të lartë se kryeministri i Republikës së Kosovës.

120 deputetë këtu sa jemi brenda në këtë sallë e kemi pagën më të madhe se kryeministri i Republikës së Kosovës. Edhe nismëtarët, edhe ata që i prijnë kësaj nisme, e kanë pagën më të madhe se kryeministri i Republikës së Kosovës. Për shembull, zonja Albulena Haxhiu e ka pagën 100% më të madhe, ose në fund të vitit merr pagë më të madhe se kryeministri i Republikës së Kosovës. Edhe unë që tash po flas e kam pagën 48% mbi pagën e kryeministrit të Republikës së Kosovës. Disa shokë të mi, të cilët janë anëtarë të bordeve të disa ndërmarrjeve, e kanë pagën 400% më të lartë se kryeministri i Republikës së Kosovës dhe ata takohen vetëm 12 herë në vit, ose më mirë të themi i kanë 12 ditë pune brenda vitit. E ne si deputetë kemi votuar, ua kemi dhënë mundësinë për këto paga. Edhe ndërmarrjet, të cilat merren me menaxhimin e bërllokut, edhe ato e kanë pagën më të madhe se kryeministri i Republikës së Kosovës. Pra, mbi 320 që unë jam munduar t'i nxjerr nga baza e të dhënave që nuk ka qenë e lehtë, zyrtarët e ndryshëm, deputetë, anëtarë të bordeve, e kanë pagën mbi kryeministrin e vendit.

Shtrohet çështja, a është kjo etike, apo rritja e pagës së kryeministrit është etike? E kam një propozim, ne sot duhet o të votojmë, o ta përkrahim rritjen e pagave që kanë të bëjnë me kryeministrin e vendit, ose të propozojmë t'i zvogëlojmë pagat e 320 zyrtarëve, deputetëve, anëtarë të bordeve të ndërmarrjeve publike, qendrore, atyre lokale, bartësve të institucioneve.

Kemi dy mundësi, mundësinë e tretë unë nuk e di, mund të japin propozim edhe nismëtarët e këtij debati që unë i falënderoj shumë, sepse kjo do të jetë një bazë për t'i marrë disa vendime që janë të rëndësishme për shtetin. Duam shtet, apo do të bëhemi sikur duam shtet? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Haxhiu, replikë. Ia ka përmendur emrin.

ALBULENA HAXHIU: E para, për shkak të kolegëve nuk po e zgjas shumë, sepse edhe të tjerët do të paraqiten për fjalë. Zoti Kuçi, Kosova në imazhin tënd duket që është republikë qeveritare. Domethënë kështu, duke të dëgjuar çka po flet, ti konsideron që Kosova është republikës qeveritare, e po harron në fakt që Kosova është republikë parlamentare dhe institucioni më i lartë në këtë vend është Kuvendi i Republikës së Kosovës. Unë pajtohem plotësisht me ty që pagat e deputetit janë të larta. Janë të larta! Prandaj, do të mbështes çfarëdo nisme që ka për qëllim uljen e pagave të deputetëve. Për mua është e papranueshme që deputeti të marrë pagë ndoshta shtatëfishhtë më shumë se paga mesatare në vend, e këtë po e them jo vetëm unë, edhe Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” do ta mbështesë uljen e pagave për deputetët. Ata që kanë nevojë për rritje janë qytetarët e Republikës së Kosovës, i përmendëm edhe arsytet tona më përpara.

Prej vitit 2012 kemi kërkuar reformë totale në Administratën Publike, pikërisht për ta shmangur arbitraritetin me vendimet që merr Qeveria e Republikës së Kosovës. Prandaj, është e papranueshme, madje është qëllimkeqe të hedhen akuza të tilla, sepse kam parë edhe prej portaleve tuaja që akuzoni, thuajse unë ia kam rritur pagën vetes. Asnjëherë dhe s'do ta bëj një gjë të tillë. Do të votojë kundër rritjes së pagave për deputetët e Kuvendit. Pra, kjo duhet të adresohet sa më parë.

KRYESUESI: Replikë, zoti Kuçi!

BLERIM KUÇI: Çështja shtrohet pse iniciativa nuk është bërë në kohën e duhur, në formën paraprake. Asnjë deputet, e as zonja Haxhiu asnjëherë nuk ka kërkuar zvogëlimin e pagës, mirëpo ka të bëjë me çështjet filozofike. A duam që orientimin vektor ta orientojmë kah plusi, apo kah minusi. Në këtë vektor do ta orientojmë kah plusi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: S'po e di rendin e procedurave kur duhet të kyçem dhe qysh shkon, por shikoni kolegë, unë kam qenë para plot dilemave dhe në çdo vendim ka dilema. Unë nuk mendoj që është në rregull që njerëzve që ua besoni përgjegjësitë, për shembull deputeti duhet ta ketë rrogën e dinjitetshme. Është i zgjedhur i popullit, merr vendime për fatin e vendit të vet dhe duhet ta ketë një rrogë të dinjitetshme. Duhet të jetë i mbrojtur edhe në këtë aspekt. Për shkak se shumica e atyre vendimeve kanë edhe vlerë materiale, mund të ndikojnë në vlerë materiale të vendit në atë se çka ndodh me vendin.



Njëjtë është për presidentin, për kryeministrin, e ministrat, e mendoj që me këtë e mbron vlerën materiale të vendit tuaj, të qytetarëve, pikërisht të atyre që i përfaqësojmë. Por, ajo çka është shumë me rëndësi, diku kam dëgjuar, për të mos qenë krejt preciz, se ende s'e kemi kryer vitin 2012 nëpër gjykatat e vendit tonë. Pra, supozohet që lëndët që kanë qenë të parapara të përmbyllen në vitin 2012, ne po i trajtojmë tash. Nëse kjo nënkupton gjashtë vjet kohë, gjashtë vjet të humbura, ky vendim i Qeverisë e ka një implikim direkt te pagat e gjyqtarëve, prokurorëve, kryeprokurorit, kryegjyqtarit, Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial. Instrumentet tjera për t'ua rritur pagën këtyre direkt edhe për ta forcuar pozicionin e tyre nuk ka njëherë. Urdhëro!

*(Ndërhyrje nga salla)*

KRYESUESI: Ju lutem, mos ndërhyri në fjalën e kryeministrit!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Jo, s'ka lidhje! Shikoni, ne kemi kërkuar e Ligjin a quhet nivelim a kategorizim i pagave, është një proces a fakt që kurrkush para meje s'e ka bërë. Unë jam tani gjashtë muaj në punë, nuk e di a janë bërë gjashtë a sa, por s'ka pasur një ligj të tillë. Asnjë qeveri deri sot s'ka mbërri ta bëjë, ndoshta e kanë përgatitur, kanë punuar në të, por nuk është final. Ky vendim është vendim i menjëhershëm dhe ka implikim direkt rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Bëjeni një matematikë, qeveritarët dalin një pakicë e vogël në këtë rast, pra qeveritarët përfitues të pagave, bëjeni një matematikë të thjeshtë, e shihni sa dalin. Po, janë një pakicë krejt e vogël, ndërsa shumicë si kategori që përfitojnë nga ky vendim janë gjyqtarët dhe prokurorët.

Të ju them të drejtën, më dhimbset ky vendim nëse kjo bie, jo për shkak timin, as të ministrave, por më dhimbset për shkak të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e Listës serbe, s'ia ka përmendur emrin kurrkujt. Nuk e do kurrkush fjalën. "Nisma", zoti Bilall Sherifi e ka fjalën. Replikë, s'ia ka përmendur emrin! Jo, pa e përmendur emrin s'ka replikë!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Kanë filluar edhe ato pak minuta që i ka "Nisma" të rrjedhin, kështu që ju lutem pritni, mos polemizoni ju dy, njëri nga ulësja lart, tjetri nga poshtë, pritni kohën tuaj.

Zoti kryesues,

Të nderuar kolegë,

Këtu e kemi një interpelancë për një vendim të kryeministrit, të Qeverisë, e cila po shqyrtohet në dy rrafshje, po trajtohet e po debatohet në dy rrafshje: në rrafshin e aspektit ligjor, a është i ligjshëm, apo nuk është i ligjshëm, dhe në rrafshin e asaj a është i drejtë apo nuk është i drejtë; a

është etik apo nuk është etik; a është i ligjshëm, apo nuk është i paligjshëm? Ministri Hamza e nxori një numër të madh të dokumenteve nëpërmjet të cilave bëri përpjekje të na bindë se nuk ka ligj që e rregullon këtë çështje dhe rrjedhimisht del që nuk është i paligjshëm. Por, megjithatë, është në Gjykatën Kushtetuese ky vendim i sfiduar dhe e presim epilogun e kësaj çështjeje nëpërmjet aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese, prandaj nuk dua të lëshohem në atë rrafsh, por do t'i them disa fjalë në këtë rrafshin tjetër, a është i drejtë, apo nuk është i drejtë?

Se a është apo nuk është vendimi i drejtë, kryeministri u përgjigj me një pyetje: a është e drejtë që kryeministri të jetë i 69-ti? Dhe, a është në rregull që kryeministri të jetë i 69-ti në listë për t'u paguar, apo siç i kishte numëruar kolegu nga AAK-ja diku i 330-ti, apo i 340-ti me pagë. Mirë që ra kjo punë e u pa, mirë që u mor ky vendim dhe filloi debati rreth nivelimit, kategorizimit, shqyrtimit të pagave të secilit veç e veç, të secilit institucion veç e veç, të secilit nga ata që paguhen me para nga Buxheti i Kosovës, se e kam përshtypjen që këtu nganjëherë ngatërrohen menaxherët e ndërmarrjeve publike me ata që paguhen nga Buxheti i Kosovës.

Menaxherët nuk paguhen nga Buxheti, as i Postës, as i KEK-ut, as i askujt. Supozohen që ata si pjesëmarrës në treg i gjenerojnë pagat e tyre përmes fitimit, përmes rritjes së kompanisë, përmes rritjes së fitimit dhe nëse në një kompani publike nevojitet një mendje e ndritur, shumë e ndritur, atëherë edhe pagat duhet të jenë të ndritura. Nuk kemi asgjë kundër kësaj, sepse nuk kemi shumë kompani publike profitabile. Paradoksi qëndron këtu se kompanitë nuk janë profitabile, sepse nuk udhëhiqen nga mendjet e ndritura, edhe pse pagat vazhdojnë t'i kenë të ndritura. Pra, çështja e kompanive publike mendoj që duhet të ndahet nga çështja e pagave që kanë të bëjnë me pagesat e atyre që marrin para nga buxheti i shtetit, e këtu duhet urgjentisht që ministri jo të na thotë neve "duhet ta bëjmë", as kryeministri të na thotë se "duhet të bëhet", por duhet të vijmë me një ide, me një projekt se si duhet të dalim nga kjo situatë. Që këtu të fillojmë ta zgjidhim këtë çështje njëherë e përgjithmonë. Nuk është se s'kanë ditur, por fakt është se nuk e ka bërë deri tash asnjë qeveri. Nuk është se s'kanë pasur kohë të gjitha qeveritë me radhë deri më tani ta bëjnë, por nuk e kanë bërë. Pse nuk e kanë bërë? Nuk do të hyjë në teori konspirative, as spekulative, por po bëj apel këtu që të mos vazhdojmë ta luajmë lojën "ju deputetët i keni pagat e mëdha, ne ministrat i kemi pagat e vogla". Ministër i Financave, po të jetë ashtu qeveritë shantazhohen që nëse nuk më lë deputetë, unë ta rrëzoj qeverinë, por këtu kemi dëgjuar duke thënë që "nëse nuk më bën ministër, edhe pse jam deputet, nuk ta votoj qeverinë".

Pra, vrap për t'u bërë nga deputeti ministër e ka një arsye. Nuk ka ndonjë vrap nga ministri për t'u bërë deputetë. S'ka, s'kam dëgjuar deri më tani. Prandaj, i lëmë këto goditje të ulëta reciproke kundër njëri-tjetrit, kundër bartësve të institucioneve, qoftë deputeti në drejtim të ministrit, qoftë ministri apo kryeministri, e kryeministrat në drejtim të deputetëve, por të ulemi të gjithë së bashku Qeveri, mazhorancë e opozitë, dhe ta arrijmë një konsensus, atë që e konsiderojmë të drejtë ta shndërrojmë edhe në të ligjshme, sepse është evidente që ka anomali në nivelin e pagave. Është evidente që dikush për më pak punë merr më shumë, dhe dikush për më shumë

punë dhe më shumë përgjegjësi merr më pak para, por kjo nuk na jep të drejtë ta vazhdojmë anomalinë, por na obligon që të gjithë së bashku pozitivë e opozitivë të ulemi, të bisedojmë, ta gjejmë një rrugëdalje, duke filluar nga idetë që u hodhën këtu, e që janë hedhur disa herë, që ta caktojmë një nivel të pagave, nga më e ulëta në të lartën, sa mund të jetë paga më e lartë, sa më e ulët, sa fish duhet të marrë deputeti, sa fish ministri, e kështu me radhë. Le ta ndalim këtë debat, për mendimin tim legjitim, por pak a shumë më shumë politik sesa që ka ndonjë qëllim për t'u dhënë zgjidhje këtyre çështjeve.

Edhe kjo është legjitime, është e drejtë e opozitës që edhe këtë rrugë ta përdorë për të ardhur në shprehje idetë dhe pikëpamjet e saj, por bëhet fjalë për para të taksapaguesve, të gjithë atyre, të cilët, edhe pse merr 170 apo 200 euro pagë në muaj është i detyruar të ndajë diçka për të mirën e përgjithshme, për të mirën e përbashkët, për të mirën e shtetit.

Le të ulemi të gjithë së bashku, le t'i caktojmë standardet kah duam të shkojmë dhe ta shndërrojmë në diçka të ligjshme nëpërmes së cilës pastaj asnjë qeveri nuk do të mund të lëvizte nga një vendim, nga një ligj që do ta rregullojmë të gjithë së bashku. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga "6+" kush e ka fjalën? Zoti Kinolli, e keni fjalën!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kolegë deputetë,

Jemi duke diskutuar për një vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e pagave të Kabinetit qeveritar dhe si vendim i tillë që është marrë nga kryeministri, duke pasur parasysh përgjegjësitë e një kryeministri të shtetit dhe pozitën e tij, unë mendoj se edhe Grupi Parlamentar "6+" mendon se, nëse nuk jam i tepërt, mund të them me përgjegjësi të plotë se paga e tij aktuale për mua është nënçmuese, është jo e dinjitetshme dhe dëgjuam numrat se shifrat radhitet si i 69-ti, i 79-ti, mirëpo kjo është pak e rëndësishme krahasuar me punën, pozitën dhe përgjegjësitë që i ka një kryeministër i një shteti.

Vendim i drejtë apo jo i drejtë, mendoj se mirë është ta presim vendimin e Gjykatës Kushtetuese, pasi është në proces. Unë e falënderoj edhe ministrin e Financave që na dha shpjegime dhe qartësime të mjaftueshme për këtë çështje. Ndërsa sa i përket çështjes së tretë, pagës mujore për familjet që përfitojnë nga skemat e ndihmave sociale, unë dëshiroj ta falënderoj edhe kryeministrin, po edhe ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale për këtë ngritje prej 20%, për të cilën prapëseprapë mendoj se është e pamjaftueshme për një jetë të dinjitetshme të njerëzve të kësaj kategorie, mirëpo mendoj se është marrë vendim i duhur dhe vendim krahas mundësive që i kemi tani për tani.

Mendoj se në të ardhmen duhet ta kemi një kujdes të veçantë edhe më të përgjegjshëm ndaj këtyre kategorive dhe shpresoj që edhe viteve në vijim do të ketë sërish rritje, gjë që këta njerëz që janë përfitues nga skemat e ndihmave sociale e meritojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë desha vetëm t'ia përkujtoj kryeministrit, ministrit të Financave dhe Qeverisë që ne e kemi çdo vit një Raport të Progresit të Bashkimit Evropian, i cili kërkon pavarësimin e buxhetit të Kuvendit nga kontrolli qeveritar dhe duhet ta keni parasysh që këtë duhet ta bëjmë, sepse është një ndër kushtet që duhet t'i plotësojmë dhe sa më shpejt që të bëhet aq më mirë, që të hiqen vërejtjet, sepse mund të bëhet.

Sa për rroga, unë s'e kam ndërmend të flas, por kjo çështje është tepër e rëndësishme dhe duhet të rregullohet me ligj. Është dhe ka qenë tendencë që nëpërmjet buxhetit të kontrolluar të Qeverisë të kontrollohet edhe Administrata, edhe Kuvendi, në përgjithësi. Faleminderit!

Radha është e diskutuesve. Partitë politike nuk kanë dërguar listë, unë do të futem në radhë siç janë paraqitur në këtë tabelën që e kam unë përpara. Zonja Pantina është e para.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesues!

Shumica e gjërave që kam dashur t'i ngre tashmë u thanë prej kolegëve, kështu që pa dashur t'i përsëris edhe një herë, megjithatë, dua t'i theksoj disa që janë më të rëndësishme.

Vendimi për rritjen e pagave është i jashtëligjshëm. Faktet që i përmendi zoti Hamza për vendimet e mëhershme, do të thotë që ka precedent, nuk e bëjnë të ligjshëm vendimin e tanishëm dhe as nuk e legjitimojnë atë. Megjithatë, unë jam dakord që paga e kryeministrit duhet të jetë më e lartë në krahasim me disa prej pozitave.

Natyrisht se është e pakuptimtë që, ta zëmë, një drejtor i një ndërmarrjeje, siç është ai i Trustit, ta ketë pagën katërfish më të madhe se sa të kryeministrit, apo ta zëmë drejtori i Radiotelevizionit të Kosovës, i cili e merr pothuajse dyfishin e pagës së kryeministrit. Por, kjo nuk e arsyeton vendimin e Qeverisë. Në fakt, për mua, ky problem është pak më i thellë sesa thjesht buxhetor apo ligjor. Për mua, ky problem tregon se Qeveria dhe kryeministri si drejtues i saj nuk e ka pasur gatishmërinë e duhur për ta zgjidhur problemin, sepse çështja e pagave është problem, dhe me vendime të tilla në fakt vetëm sa e ka përkeqësuar atë.

E përmendi edhe kryesuesi i seancës se në çdo Raport të Progresit, secilin vit radhazi, njëra nga vërejtjet kryesore, kur flitet për administratën publike, është edhe çështja e pagave, e cila bëhet në baza jomeritore. Këtë çështje e kemi diskutuar edhe në legjislaturën e kaluar, edhe në këtë legjislaturë, dhjetëra herë me ministrin Jagxhillar. Ka pasur iniciativë për hartimin e Ligjit të pagave, sepse ky është problemi thelbësor. I gjithë ky diskutim do të ishte i panevojshëm nëse sot ne do ta kishim Ligjin e pagave. Qeveria e kaluar e pati hartuar një ligj të pagave, por i cili

asnjëherë nuk erdhi në Kuvend. Deputetët asnjëherë nuk e patën rastin ta kenë në dorë dhe ta shqyrtojnë atë, edhe pse në medie u bë zhurmë shumë e madhe, pse deputetët po ua rritin pagat vetes, e deputetët në fakt nuk e kishin parë fare ligjin.

Çështja tjetër dhe arsyeja, mendoj unë, se përse kjo çështje nuk po rregullohet dhe Ligji i pagave nuk po vjen, nuk janë thjesht pagat, por ka diskrepancë dhe papajtueshmëri të madhe në pagesa edhe në pozitat brenda Administratës Publike. Ta zëmë, një kirurg, të cilit i duhen 20 vjet shkollim, e nga i cili varet jeta jonë, dhe punon 40 orë në javë paguhet 700 euro, kurse një anëtar bordi i cilësdo ndërmarrje publike apo secilit institucion, po e marr shembull RTK-në sërish, sepse e njoh më mirë, se raportojnë te komisioni ynë, për një mbledhje në muaj, për të cilën ndoshta i duhen rreth 8 orë për t'u përgatitur maksimumi, i merr mbi 1 000 euro në muaj. Natyrisht se kjo është e padrejtë. Por, për mua problemi pse nuk po vjen Ligji i pagave nuk janë vetëm pagat, janë beneficonet tjera, të cilat janë problem dhe janë shtesat, dhe edhe ministri e ka pranuar disa herë në komision se ka raste kur zyrtarët publikë e marrin dyfishin e pagës, domethënë marrin më shumë mëditje dhe shtesa, sesa që e kanë pagën bazë. E, kjo është çështje që duhet të diskutohet dhe kjo është çështje që duhet të ndalet njëherë e mirë.

Në fakt, kjo puna e mëditjeve dhe shtesave, për mendimin tim, ka filluar të bëhet problem edhe në funksionimin e punës së Qeverisë, bile edhe të Kuvendit. Pse e shoh problem? Për ta hartuar një ligj, një rregullore, një dokument çfarëdo qoftë, zyrtarët tanë qeveritarë preferojnë dhe jo vetëm që preferojnë, por e bëjnë të pamundurën që grupi punues të mos punojë këtu në Kosovë, por të shkojë në Durrës, apo në Tiranë. Dhe, më shumë angazhohen të gjejnë mënyra sesi ta organizojnë një punëtori në Durrës, e "Belvedere" është vendi ku po më duket se disa qeveritarë më shumë flenë atje se sa në shtëpitë e tyre, sesa si ta hartojnë dokumentin, ligjin. Dhe, këtë e bëjnë për mëditje, sepse për dy ditë pune që ata i kalojnë në "Belvedere", apo kudo tjetër, paguhet katër ditë mëditje, sepse dy ditë tjera janë vajtje-ardhje. Ngjashëm nuk është më mirë hiç as puna në Kuvend. Për ta hartuar një ligj, ose më mirë për ta shqyrtuar një ligj, deputetët fillimisht preferojnë ta bëjnë një vizitë studimore, e nganjëherë edhe më shumë, dhe prapë arsyeja pse bëhet kjo është për mëditje.

Kështu që ne jemi bërë peng i mëditjeve dhe i shtesave tjera. Prandaj, unë për këtë mocionin e sotëm e kam edhe një propozim, që fillimisht Qeveria të marrë vendim që t'i ndalë mëditjet për udhëtimet për punëtori. Unë e kuptoj se edhe zyrtarët qeveritarë, por edhe deputetët kanë nevojë për të udhëtuar jashtë shtetit për arsye të ndryshme, por është plotësisht e pakuptimtë, është krejtësisht e pakuptimtë, të shkohet në Durrës për ta hartuar një ligj, apo për ta shqyrtuar atë. Edhe Qeveria, edhe Kuvendi, kanë salla të mira, kanë kushte të mira, dhe kjo mund të bëhet në Kosovë. Mendoj se fillimisht kryeministri duhet ta nxjerrë një vendim për Qeverinë, e Kuvendi po ashtu ta nxjerrë një vendim për Kuvendin që të ndalohen organizimet e punëtorive jashtë Kosovës dhe, po ashtu, edhe Kryesia e Kuvendit duhet të jetë shumë më e kujdesshme kur t'i miratojë vizitat studimore jashtë Kosovës.

Është e pakuptimtë që për një projektligj të organizohen tri vizita studimore të ndryshme. Kjo mandej do ta bënte edhe punën më efikase, sepse zyrtarët tanë, në vend se të mendojmë si t'i gjejmë mundësitë për ta organizuar një punëtori jashtë Kosove, do të ulëshin këtu në zyrat e tyre dhe do t'i hartonin ligjet e tyre.

Prandaj, unë i ftoj deputetët, i ftoj ata që do t'i hartojnë në fund rekomandimet, që si rekomandim ta futin edhe çështjen e ndaljes së udhëtimeve jashtë vendit dhe i ftoj deputetët që ta votojnë atë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kryeministër dhe ju ministra,

Ka kaluar kohë kur ju zoti kryeministër e keni marrë këtë vendim. Aferim për këtë, ngase keni dalë edhe në gazeta ndërkombëtare, duke u cilësuar si një kryeministër me një jetë luksoze i një vendi shumë të varfër, me qytetarë të varfër dhe besoj se në këtë drejtim keni arritur mjaft për reputacionin tuaj.

Për atë që e cilësoni si betejë politike disa nga ju, dua të them se është betejë për drejtësi minimale edhe për qytetarët e vendit, ngase janë politikëbërësit ata që duhet të kujdesen që çfarëdo e mire të shpërndahet në mënyrë të njëjtë. Mosdedikimi në këtë çështje shkakton dallime të mëdha edhe në kategori, por edhe privilegje në sektorin publik. Ne edhe herë tjera kemi e ngrehur nevojën për kujdes edhe më të madh në sektorin privat, në mënyrë që qytetarët të jenë ata që i drejtohen edhe këtij sektori për punësim dhe të mos jetë vetëm sektori publik, i cili i gëzon këto privilegje dhe si rrjedhojë e kësaj pakujdesie e kemi një diskriminim të shtuar në atë sektor dhe, në fund të fundit, edhe rritje të papunësisë.

Unë kam pritur që për këtë çështje, e kemi pasur edhe ministrin për Punë dhe Mirëqenie Sociale në Komisionin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kam pritur që ai të reagojë pak më tepër, edhe me përgjegjësinë shtesë si kryetar i Këshillit Ekonomiko-Social, besoj juve zoti Reçica u takon që të jeni një rregullator i jetës në Kosovë, ngase duhet të jeni ai që i masni parametrat, qoftë edhe të zhvillimit, edhe të varfërisë, të dominimit të varfërisë, dhe problemet tjera që, për fat të keq, po bien në kurriz të kësaj popullate. Unë mendoj se ju do të kalkuloni shumë më mirë në këtë drejtim. Presim progres në këtë punë.

Është e domosdoshme reforma në Administratën Publike që prek esencën e kësaj problematike, në mënyrë që mos të thuhet se është betejë politike këtu, në mënyrë që ta japë atributin e asaj që është një betejë për të mirën e qytetarëve, në përgjithësi. Kjo është esenciale dhe duhet të dalë si përfundim i krejt kësaj interpelance, me krejt çështjet tjera, me Ligjin për pagat, Ligjin për

Qeverinë gjithashtu. Natyrisht se vetë subjekti, i cili e ka zgjedhur një formacion, apo koalicionet qeveritare e kanë zgjedhur një formacion tepër enorm për ta udhëhequr këtë qeverisje, do të mund të arsyetohen me atë se nuk e kanë shkelur ndonjë ligj për faktin se ky ligj i mungon Kosovës dhe është tepër i nevojshëm, që të mos degradojë deri në masën e pazarllëqeve politike, por duhet të jetë i precizuar mirë me ligj dhe për rritjen, apo formacionin e vetë Qeverisë.

Fakti se ju, kryeministër, pretendoni ta përfitoni një pagë të tillë, e cila është hiç më pak se shtatëfishi më e lartë se sa paga mesatare e një shërbyesi civil, apo krahasuar me ndihmën e asistencës sociale i bie që ju merrni pagë sa 29 familje përfituese të asistencës, të cilat mesatarisht kanë nga pesë anëtarë, e që në total me vlerën e pagës suaj njëmuajore i bie të ushqehen 145 persona që marrin asistencë sociale.

Besoj, kryeministër, se ko vlerë apo ky numër flet shumë për pretendimin tuaj shumë enorm. Kjo është e pamenduar mirë, është diskriminuese e, në fund të fundit, edhe eksploatuese ndaj qytetarëve. Përpos gjithë këtyre gjërave, besoj se ministri i Punës dhe Mirëqenies do ta shohë mirë edhe rritjen e skemave të familjeve dhe anëtarëve përfitues, e cila nuk është e kalkuluar mirë për numër të anëtarëve të cilët përfitojnë. Mendoj që në rishikim të këtij vendimi, zoti ministër, e keni shansin që të jeni shumë më korrekt edhe me kategorinë përbrenda atyre që përfitojnë nga këto skema.

Besoj se ka shumëçka, por mbi të gjitha është edhe roli ynë, të nderuar deputetë, si Kuvend, që ligjet që e rregullojnë këtë çështje ta përjashtojnë edhe etikën e një kryeministri, i cili për përfitime të ndryshme mund të kalkulojë në forma të tilla. Dhe, ndoshta pak për ta shtruar çështjen, për t'i shtuar asaj që e tha deputetja Pantina, përveç përfitimeve në mëditje në daljet jashtë vendit, është edhe një problem tjetër që e lëndon në esencë edhe çështjen për të cilën merren anëtarë të ndryshëm brenda Qeverisë për ta punuar një ligj, apo një punëtori me temë të caktuar, ngase duke menduar gjithherë te personi që e gëzon mëditjen, ne nuk i çojmë njerëzit kompetentë, të cilët ndoshta janë shumë më të specializuar për fushën e caktuar, por vetëm mendojmë se cili do të jetë ai që do të përfitojë nga mëditja jonë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Zoti Haradinaj e ka kërkuar fjalën.

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** Po dua t'i bëj nja dy refleksione, ose të reflektoj në atë që po dëgjoj.

E para, kur flasim për skemën sociale edhe për kategoritë sociale, e mirëpres Lëvizjen “Vetëvendosje”, “Nismën”... E di se janë parti të krahut të majtë dhe mendojnë në këto aspekte. Deri diku është e kuptueshme, në bazë zgjedhore, në bazë... Habitem me disa të tjerë, që shumicën e kohës dhe krejt kjo temë po trajtohet në njëfarë fokusimi të kursimit, për ta kursyer paranë e publikut, që është krejt në rregull.

Por, unë mendoj se energjia e deputetëve mund të jetë shumë më e vlefshme nëse do të kishin shkuar kah projekte që krijojnë ndonjë të hyrë të re ekonomike, ndonjë investim, ndonjë zhvillim, do të ndryshonte gjendje e Kosovës. Kjo ideja e shumë prej jush se sa të ndershëm jeni për ta kursyer popullin, po del edhe hipokrite dikur, besoni, se ne të gjithë e njohim njëri-tjetrin dhe e dimë që i keni marrë krejt këto mëditje kur u ka ardhur rendi, keni shkuar e jeni kthyer, kemi ardhur, kemi hyrë e kemi dalë... Aman, ndaluni diku se janë gjëra që i di populli, i di të gjitha, ja i kemi listat kush ka marrë mëditje, mund t'i nxjerrim e t'ua publikojmë diku. Edhe të gjithë marrin. Nëse është problemi... krejt po i trajtojmë sot, po e bëjmë një paketë dhe po merremi vesh çka. Shikoni, unë s'kam bërë reklamë gjatë punës sime. Këto ditë që jam në punë, kurrë s'kam dalë as të lavdëroj, as të shpjegoj, as të them diçka për një vendim timin, as të Qeverisë sonë, por jam duke u munduar të punoj e të krijoj vlerë të re në vend.

Është pak e habitshme për mua, besoni, po ju them, është njëfarë fukarallëku që po e shoh ku po doni të vini. Edhe pak e duam t'i kursejmë edhe letrat, pra mos t'i blejmë nja dhjetë letra. Ooo, shteti është shtet, i ka do obligime, ka reprezentacion, jep para edhe në të zezën, ka raste të caktuara kur shteti jep për projekte të caktuara, për tema të caktuara, si në planin e brendshëm, si ndërkombëtar. Analizojeni pak mirë, e dini, ka mënyra të shmangies së procedurave, ka veprime për tema të caktuara.

Nuk mund ta kthesh shtetin në atë farë “kursimi special”. Po racionalizimi, po përgjegjshmëria, po preciziteti në të, veç nuk di ku po doni të ndaleni.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka Bekim Haxhiu.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar nënkryetar Haliti!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo temë pothuajse veç i ka kaluar afatet e saj kohore për shqyrtim, përkundër asaj që tani është në Gjykatën Kushtetuese. Mendoj që nëse për asgjë tjetër, do të na shërbejë për sensibilizimin e një çështjeje, e cila është më se e nevojshme për kategorizimin dhe nivelimin e pagave në të gjithë sektorët e nevojshëm, jo vetëm në atë që u tha “kategorizim” apo “nivelim”, por kategorizim dhe nivelim, sepse ka diskrepanca të mëdha. Te profesione të caktuara paguhen paga të ndryshme në sektorë të ndryshëm.

Po e marr një shembull, te profesionistët shëndetësorë, të cilët ndryshe paguhen në Qendrën Klinike Universitare, pagë tjetër kanë në Spitalin Rajonal të Prizrenit, tjetër pagë në Spitalin e Pejës, e tjetër pagë në Spitalin Regjional të Mitrovicës.



Kur flasim për kategoritë të cilat vërtet për vite vazhdojnë të mos paguhen në mënyrë meritore, ashtu siç janë, mjekët specialistë e kanë pagën 659 euro, jo 700. Veç 659 euro mjekët specialistë të të gjithë sektorëve! Ndërsa një mjek i përgjithshëm e ka pagën 565 euro. Pra, po flasim për njerëz, të cilët kujdesen për shëndetin e popullatës. Në atë kategorizimin që u tha këtu se këtu është niveli i ministrit, i deputetit dhe i kryeministrit, mjekët dhe profesionistët shëndetësorë vazhdojnë të jenë shumë poshtë atje, përkundër përgjegjësive të mëdha dhe detyrave të cilat ata i kryejnë. Pra, më se e nevojshme, ka pasur shumë kërkesa nga Oda e mjekëve dhe profesionistëve të tjerë shëndetësorë, që ky kategorizim dhe nivelim vërtet të rregullohet dhe për këtë mendoj se do të duhej të diskutonim bashkërisht, jo për qëllime politike, po për ta rregulluar atë sektor.

Dhe kur flasim edhe për shërbyesit civilë dhe për ata që paguhen nga buxheti i shtetit, ne nuk do të duhej ta shfrytëzonim si temë për vete, për subjektet politike të cilave u takojmë, ose sa herë që është një kryeministër këtu ta atakojmë atë dhe Qeverinë që ai udhëheq për të përfituar politikisht, sepse tani e 18 vjet është një çështje e parregulluar, që nga koha e administratës së UNMIK-ut, e pastaj nuk e kanë rregulluar këtë problem qeveritë e njëpasnjëshme.

Është më se evidente që ka pasur një ngritje të pagave në qeveritë e kaluara, por jo nga viti 2000-2007, pa dashur të adresoj asnjë kritikë ndaj atyre që kanë udhëhequr në atë periudhë kohore, por nga viti 2008-2014, po e marr një shembull, vetëm te kategoria e invalidëve të luftës, të cilët në vitin 2007 janë paguar 52 euro, ndërsa sot marrin pagën mbi 350, apo pension invalidor mbi 352 euro. Pra, ka pasur një ngritje evidente dhe edhe ai që quhet sektori i arsimit, dhe i shëndetësisë, dhe i Policisë, dhe e Gjyqësisë, ka pasur ngritje evidente. Ka pasur në dy qeveritë e kaluara, por nuk kishte ngritje nga viti 2014 deri në 2017.

Nëse për asgjë tjetër, vendimi i Qeverisë së Kosovës për ngritjen e pagave ka arritur ta sensibilizojë këtë çështje. Nëse është menduar që me ngritjen e pagave të rritet përgjegjshmëria dhe efikasiteti i Qeverisë, mendoj se të gjithë do ta përkrahim dhe vërtet do të kërkonim edhe përgjegjshmëri, edhe efikasitet, e në veçanti jo t'i vajtojmë sot rastet sociale, por të punojmë më shumë që këto raste sociale mos të ekzistojnë në Kosovë. Jo të vajtojmë për pensionistët invalidorë e për rastet tjera sociale që marrin 75 euro, por të gjithë bashkërisht të punojmë që të ketë sa më pak raste të tilla, që ato vërtet të shuhen dhe të ketë një mirëqenie më të mirë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

I nderuar kryeministër,

Unë dëshiroj vërtet nga zemra që ju të jeni një kryeministër i suksesshëm i vendit tim për shumë arsye. Një, sepse ky vend pret nga ju dhe, e dyta, duke pasur parasysh vlerat tuaja, edhe personale, edhe familjare, dëshiroj që ju të jeni i suksesshëm. Të jeni i suksesshëm në rrugën që e keni filluar, e në veçanti kjo rrugë duhet të orientohet në zhvillimin ekonomik, në rregullimin e këtij sektori që investitorët në Kosovë ta shohin një mundësi më të mirë për zhvillim ekonomik. E kjo mund të bëhet vetëm në hapjen e perspektivës evropiane të Kosovës, duke kaluar tema të

mëdha që i kemi pasur këto ditë, siç është demarkacioni dhe pastaj në një luftë të pakompromis kundër korrupsionit që investitorët të besojnë në Kosovë dhe ata të vijnë këtu, pastaj ne nuk do të diskutonim për rastet sociale, po do të diskutonim për një mirëqenie më të mirë për të gjithë qytetarët.

Prandaj, mendoj që këtu nganjëherë edhe po e përdorim këtë çështjen e pagave të deputetëve, edhe të qeveritarëve, sa për të thënë diçka ose për të bërë politikë.

Po dua t'juaj përkujtoj një gjë që në këtë Kuvend këtu kam kërkuar nga të gjithë deputetët nga një mëditje për një doktor të sëmurë, i cili kishte nevojë për shërim jashtë vendit, pra kam kërkuar këtu në seancë që një mëditje ta japim për të dhe nuk kishte gatishmëri.

Tani të mos e përdorim këtë çështjen e mëditjeve të deputetëve për nevoja politike, sepse ne duhet të krijojmë dhe të punojmë jo për veten, po për qytetarët, pra të punojmë për ta, jo për veten, sepse kur kjo mundësi përdoret që deputetët këtu të mendojnë vetëm për pagën e tyre, ose ata që i synojnë karriget e Kuvendit mendojnë vetëm për veten e tyre, por jo për të zgjedhurit, atëherë niveli i diskutimit kalon deri në mëditje.

I nderuar kryeministër,

Ju uroj punë të suksesshme, tani pothuajse do të bëhen gjashtë muaj nga puna juaj në udhëheqje të qeverisë dhe gjashtë muaj ke pasur kohë të mjaftueshme për të reflektuar edhe për të punuar, pastaj edhe kritikata mos i merr si personale, po merri me qëllimin më të mirë të punës për vendin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

I nderuar kryeministër,

Qytetarë të nderuar,

Sot kjo interpelancë, nëse ka diçka prej saj, është një çështje e rëndësishmja, është shpërputhja e madhe që ekziston në sektorin publik, e sidomos edhe në sektorin privat sa u përket pagave të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Dhe, nëse duam që vërtet të bëjmë diçka në dobi të qytetarëve të Kosovës, të punëtorëve të të gjithë sektorëve, atëherë duhet të thërrasim nismë ligjore, e cila e ndryshon gjendjen nëpërmjet Ligjit për nivelimin e pagave. Nëse nuk është thirrur kjo interpelancë për të propaganduar, për të bërë më shumë një fjalor të përgjithësuar për të humbur kohë, atëherë më së mirë është nga deputetët ta nisim menjëherë iniciativën për nismë ligjore, në mënyrë që të bëhet niveli i duhur i pagave në Kosovë.

Vetëm çka kanë sjellë sot në Kuvend ministri Hamza dhe ministri Yagcilar, është parë çfarë diskrepance ka në pagat e qytetarëve, të cilët vërtet një pjesë e madhe janë diskriminuar, një pjesë të favorizuar padrejtësisht, e kjo e bën që Kosova të mos mund të funksionojë ashtu si duhet si shtet që duhet të jetë në mesin e shteteve që krijojnë bazë ligjore të duhur.

Po ashtu, u pa një grumbull i dokumenteve, të cilat ministri Hamza i prezantoi dhe nuk është e vetmja Qeveri, të gjitha qeveritë kishin bërë ngritje pagash dhe kjo duhet të stopohet në kuptimin e bazës ligjore që duhet të krijohet. Ndryshe, ne veç mund të bëjmë më shumë propagandë, më shumë të humbim kohë, është e drejtë e opozitës që të thërrasë interpelancë, po vërtet nëse thërrasin interpelancë, atëherë duhet t'i japin një kuptim pse është thirrur interpelanca jo vetëm në një rast, po në të gjitha rastet ku ka pasur veprime, të cilat kanë mundur të jenë veprime antiligjore, siç po quhen.

Njëkohësisht është mirë të pritët vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe të shohim, sepse me që është dërguar lënda në Gjykatën Kushtetuese, atëherë asnjë arsye s'ka që të bëjmë zhurmë në Parlamentin e Kosovës.

Prandaj, ju kisha kërkuar që sa më konkret të jem, ta bëjmë nismën ligjore, t'i nivelojmë pagat në nivel Kosove dhe ta kryejmë punën tonë si deputetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zeka, i ke 57 sekonda.

MILAIM ZEKA: I kam marrë edhe të "6+", m'i kanë dhënë katër minuta.

Kryesues, unë desha të them diçka për punën e mëditjeve. Ne nuk e zgjidhim problemin duke folur kështu jashtë temave, desha të them një vendim të Kuvendit të Kosovës që ekziston në vitin 2012 për përcaktimin e pagave, po disa që kanë qenë deputetë në të kaluarën, edhe në Qeveri të kaluara, nuk kanë të drejtë as të diskutojnë këtu, sepse ata e kanë lënë këtë vend pa ligje, pa ligj të Qeverisë, pa ligj të nivelimit të pagave.

Prandaj, gjysma që po flasin këtu, po flasin veç për fushatë elektorale.

Ne kemi qenë në Mal të Zi dhe e dimë, 36 euro e kemi paguar hotelin, edhe 60 euro kemi pasur mëditje. Kështu që të mos manipulojnë me publikun.

A e zgjas edhe pak.

M'i ka dhënë "6 +" katër minuta, seriozisht, desha të flas.

KRYESUESI: Ata duhet t'i deklarojnë, jo ti. Më vjen keq! Fjalën e ka Fitore Pacolli.

FITORE PACOLLI: Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Sipas Agjencisë së Statistikave është vlerësuar se 22,8 % e popullsisë jeton në varfëri. 17.6% e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë, me 1,82 euro në ditë dhe 5.2 % e popullsisë jetojnë nën kufirin e varfërisë së skajshme, me 1,30 euro në ditë.

Shkallët e varfërisë mbeten më të larta, sidomos te këto kategori:

1. Në familjet ku kryefamiljari është grua - 18% e grave në Kosovë që burim kryesor të të ardhurave kanë ndihmat sociale jetojnë në varfëri;

2. Në familjet që jetojnë në vendbanimet rurale - derisa rreth 65 për qind e popullsisë jeton në vendbanimet rurale në vitin 2015, përqindja e të varfërve 65,7 për qind, ndërsa 73 për qind në varfëri të skajshme. Përqindja e të varfërve që jetojnë në vendbanimet rurale ka shënuar rritje nga viti 2014;

3. Në familjet me shumë anëtarë - rreth 23 për qind e ekonomive familjare të madhësisë mesatare (5-anëtarëshe) në Kosovë janë të varfra;

4. Tek fëmijët: shkalla e varfërisë të fëmijët në vitin 2015 ishte 20,7 për qind, ndërsa 6,6% e fëmijëve jetojnë në varfëri të skajshme;

5. 23,5 % e personave me aftësi të kufizuar që burim kryesor të të ardhurave kanë ndihmat sociale jetojnë në varfëri.

Këto të dhëna tregojnë se shkalla e varfërisë në vend është e lartë. Përderisa 22,8 % e popullsisë jeton me më pak se 1,50 euro në ditë, Kryeministri për vete dhe për kabinetin e tij ka rritur pagat për 100%. Paga e Kryeministrit nga 1443,20 euro është rritur saktësisht në 2,950 €, me arsyetimin se ka përgjegjësi të madhe politike. Pas kësaj, disi për të larë veten me Vendimin nr. 05/24 u është rritur paga edhe të gjithë të punësuarve që marrin paga nga buxheti i Kosovës për 4% mbi pagën bazë. Por, prapëseprapë kjo rritje nuk është e barabartë për të gjithë, ngaqë për disa punëtorë për të cilët paga bazë është 300€, me rritje merr vetëm 12€ më shumë, ndërsa atij që merr pagë bazë 800€ u bëhet gati 900€ në muaj. Pra, prej këtij vendimi dikush i fiton 12€, e dikush 100€.

Skemat e ndihmave sociale u rritën simbolikisht, edhe pse 20% mund të tingëllojë shumë kjo rritje, është shumë e vogël: për 1 anëtar vlera totale llogaritet 60 euro, 2 anëtarë 82.5 euro dhe 3 anëtarë vlera është 90 euro. Sa më i madh numri i anëtarëve, aq më e vogël ndihma sociale. Familjet me mbi 10 anëtarë pritet të jetojnë me më pak se 50 cent në ditë.

Një familje në Kosovë me ndihmën sociale që merr nga shteti nuk mund t'i sigurojë as nevojat bazike për të mbijetuar, e lëre më të bëjë një jetë të dinjitetshme.

Niveli i pagesës së skemës sociale nuk përshtatet me çmimet dhe standardit të jetës. Në Vendimin nr. 15/24 që ka marrë Qeveria e Kosovës më 12 janar 2018, konsideron se një familje 5-anëtarëshe mund t'ia dalë muajit me njëqind e pesë euro (105 €). Kurse shporta mujore bazë e një qytetari në Kosovë llogaritet të jetë 115 euro. Kjo duhet të ndryshojë, pra lartësia e skemës sociale çdo vit duhet të përshtatet në varësi të lëvizjes së çmimeve dhe standardit të jetesës, sipas të dhënave zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në vendet me politika sociale, ndihma sociale që u jepet këtyre familjeve ka për qëllim të përmirësimit të mirëqenies sociale-ekonomike. Të avancimit të asaj familje nga statusi social në familje me një status të mesëm ekonomik. Por, tek ne këto ndihma përveç që nuk e nxjerrin familjen nën përkujdesje sociale nga gjendja jo e mirë, ky nivel i ndihmës vetëm sa e thellon dhe e siguron që edhe brezat e ardhshëm të këtyre familjeve të mbesin të varfër.

Fëmijët, të cilët po rriten në këto familje, përveç se nuk do të mund të barazohen me bashkëmoshatarët e tyre jashtë Kosovës, ata nuk do të arrijnë të barazohen as me moshatarët e tyre në vend.

Përveç se këta fëmijë do të vuajnë nga pasojat që sjell kequshqyerja dhe niveli i dobët i edukimit që marrin, e ardhmja e tyre dhe e fëmijëve të tyre përcaktohet nga gjendja ekonomike në të cilën gjenden sot. Dhe, kështu do të kenë të pamundur të dalin nga ky rreth vicioz. Në vend se kjo qeveri të punojë për të ngushtuar këtë dallim pabarazish, po e thellon atë më tutje.

Këtë nuk do ta lejonte Lëvizja “Vetëvendosje”, po të ishte sot në qeveri. Përkundër këtyre, ne do të kishim zgjedhur të fillonim me:

Sigurimin e shtesave për secilin fëmijë nën moshën 15-vjeçare. Shuma prej 10 eurosh në muaj, këto shtesa do të paguheshin në emër të nënës;

Me hartimin e Planit zhvillimor mbështetur nga krijimi i Fondit Sovran të Republikës së Kosovës, Agjencisë Zhvillimore të Kosovës dhe Bankës Zhvillimore të Republikës së Kosovës;

Me hartimin dhe zbatimin e planit për banimin e përballeshëm dhe banimin social;

Me rritjen e pensioneve për pensionet bazë dhe kontributdhënës;

Po ashtu, me Sigurimet Shëndetësore për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës;

Me hapjen e çerdheve të reja në bashkëpunim me komunat dhe me rimëkëmbjen e shkollave, veçanërisht me mjetet didaktike dhe shkencore, duke siguruar ushqim falas për fëmijët e klasave fillore nga klasa e parë deri në të pestën në të gjitha shkollat publike.

Po shihet tashmë qartë që kjo qeveri, duke vijuar me avazin e vjetër, nuk po punon për të mirën e qytetarëve të saj, por po mundohen ta mbajë pjesën më të madhe të buxhetit të shtetit në xhirollogaritë e tyre, ndërkohë që përpiqen t'ua mbyllin gojën shtresave të tjera me rritje minimale pagave të ulëta dhe me ndihma shumë të vogla.

Shteti zhvillimor që bën përpara drejt procesit të integritimit nuk duhet të duket kështu, as nuk mund të mbërrihet me këto praktika. Nuk na bën heqja dorë nga territori ynë më të zhvilluar e më social. Përkundrazi, qeveritë që janë të afta për kësi lloj padrejtësish nuk e kanë vështirë të shtypin edhe më tej qytetarët e vet.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: E nderuar deputete Pacolli, Ju dëgjova me vëmendje, ju po e kategorizoni Qeverinë si të paimterësuar për qytetarët, edhe po e ndërlihdni me këtë vendim të rritjes së pagave, e po jepni vlerësime kategorizuese deri në fund. Ky mund të jetë mendimi juaj personal, keni të drejtë në këtë mendim edhe si parti opozitare, po e vërteta është pak më ndryshe.

Gjashtë muaj të kësaj Qeverie punë me rëndësi, të vlefshme, të mira për këtë vend janë kryer. Nëse nuk doni t'i shihni, e drejtë juaja është, po janë kryer punë të mira në shërbim të këtij vendi, edhe po kryhen, po nuk mund t'i korrigjoj 20 vjet për një ditë, as me një veprim. Mund të thuash, mirë, e korrigjove pagën për një ditë. Po diku në vend përgjegjësia duhet t'i ketë parametrat e vet.

E pse po ju them që janë kryer punë të mira për këtë vend?

Ne e kemi gjetur Qeverinë pa ligj, nuk di kush i ka ndaluar qeveritë që 20 vjet ta bënin një ligj për Qeverinë. Nuk di a i kemi penguar dikë, nuk kemi gjuajtur gaz për të mos bërë ligj, ndoshta për tema të tjera po, por e kanë pasur mundësinë të bëjnë ligj për Qeverinë, t'ia sillnin Parlamentit dhe sot nuk ishte temë që rëndon mbi mua, do të ishte e kryer, Ligj për nivelim të pagave, pse nuk u bë, këtu jemi. E kam gjetur kështu gjendjen.

Ju tregova për radhitjen, numër 69. Unë e di, kam qenë deputet, i kemi rritur pagat në atë kohë, po sendi më normal që i kanë rritur pagat, duhet paga për deputetin.

Nja 120 vetë vendosin për fatin e 2 milionë njerëzve, pse duhet t'i lënë këta pa paga të dinjitetshme, s'po mund t'i kuptoj ku është qëllimi i diskutimit.

Çka fitojnë 2 milionë të tjerë nëse 120 vetëve po ua heqim nga 100 euro, a po ua përmirësojmë gjendjen sociale atyre të tjerëve që po i deklaroni ju me 1/80 e me 2/80, këto janë do farë pallavrash që i shesin.

Gjendja sociale e këtyre njerëzve bëhet duke ua rritur rrogën atyre që punojnë në orare të gjata, që u dhemb për tema, që hapin vende të punës, që bien investime, ashtu përmirësohet gjendja në vend, me njerëz që punojnë, luftojnë për interesa të këtij vendi edhe që mbështeten disi.

E keni lënë Kosovën në një farë morali të rrejshëm, të rrejshëm ordiner, edhe po doni ta mbijetoni atë moral të rrejshëm. Nuk është ashtu më, nuk është koha që duhet pasur jakën e këmishës të shqepur për të treguar që je i ndershëm ose që po i pike nja dy kafe më shumë e je i keq, ka shkuar ajo kohë.

Vetë janë deklaruar për një rend shoqëror, për një ekonomi të tregut, për punë.

Ftojme, nëse doni ta zhvillojmë këtë vend, mbani mend çka po ju them, mos i leni njerëzit që kanë përgjegjësi të nëpërkëmbur, si imunitetin e deputetit që e kemi hequr. Tash po mundohemi ta kthejmë, po qysh. Dikush e paska hequr, edhe këta të gjykatës janë të dikujt, të gjithë jemi pa pari e me parti, e dimë qysh jemi.

Ju lutem, nuk jam kundër për kritikë për vendimin e rritjes së pagës, është kritikë me vend, e kam mirëpritur çka kanë thënë qytetarët, i kam mirëpritur edhe kravatat dhe përnjëmend më ka mbetur merak një, të sigurt, e kam parë të varur në rrethojë, më është dukur e bukur. Nuk kam qenë në vend, kur kam ardhur, i kishin pas hequr.

Mos, aman, me moral të rrejshëm, se e morëm në qafë këtë vend kështu.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhi Avdyli e ka fjalën.

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryesues,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Sot në Kosovë kemi nevojë për Ligjin për kategorizimin e pagave edhe për një arsye urgjente, për shkak se në Kosovë ju jeni të informuar se është rritur tensioni social, janë rritur ankesat e punëtorëve në sektorin publik, në sektorin e shëndetësisë, kemi pasur greva në sektorin e arsimit, ky tension social është edhe pasojë e vendimit të kryeministrit për rritjen e pagave për qeveritarët. Në këtë drejtim kjo rritje e pagës ka shkaktuar edhe një diskrepancë edhe më të

madhe në dallimin mes pagave të punëtorëve të shërbimit publik dhe në të njëjtin kohë i ka kontribuar edhe deklarimeve të ndryshme që kanë irrituar këta punëtorë, se ne kemi nevojë për t'u veshur më mirë dhe për të jetuar më mirë kur e dimë që punëtorët e arsimit jetojnë me një pagë relativisht të ulët dhe ata kanë nevojë po ashtu që para nxënësve dhe para qytetarëve të dalin në një gjendje sa më të përgatitur.

E dimë që arsimi kushton shtrenjtë, por mosarsimimi është edhe më i shtrenjtë, u kushton qytetarëve të Kosovës.

Po ashtu, mendoj që edhe deklarata e kryeministrit se ne kemi pasur hallin edhe të Këshillit Prokurorial, edhe të kryeprokurorit nuk qëndron, sepse nuk është bërë rritja me atë qëllim, po është bërë rritja e zyrtarëve qeveritarë dhe, në të njëjtën kohë kjo mënyrë automatike e ka rritur pagën për prokurorët dhe tash ankohe mi se po i lëmë keq prokurorët, mund të gjejmë mënyra që t'ua rritim pagat prokurorëve.

Mendoj që është për të ardhur keq ky dallim, kjo diskrepancë e madhe me punëtorët e sektorit privat, të cilët janë duke punuar me një sistem skllavërues, nëse e krahasojmë pagën e qeveritarëve dhe pagën e sektorit publik, e kjo nuk jep shpresë për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të Kosovës.

Po ashtu dua ta vë theksin edhe te punëtorët shëndetësorë, të cilët janë duke bërë një punë shumë të madhe, punë dinjitoze, të cilët e kanë një punë me një stres të shtuar dhe nuk e kanë pagën në nivel me përgjegjësitë e tyre.

Mendoj që zgjidhja më e mirë për punëtorë shëndetësorë do të ishte pagesa sipas performansës, e cila do t'i zgjidhte shumë padrejtësi që bëhen te punëtorët shëndetësorë dhe të shpërblehen ata punëtorë shëndetësorë, të cilët kanë punë më të madhe, kanë përgjegjësi më të madhe.

Po ashtu dua të vë theksin që para disa ditëve kemi pasur edhe një protestë të specializantëve, të cilët fare nuk po paguhën. Unë dua të vë theksin se një punë të madhe në spitalet tona i bëjnë këta, mu këta specializantë, të cilët mbajnë barrën më të madhe të këtyre punëve, është një kontingjent i tërë i tyre, të cilët janë pa paga dhe ata po kërkojnë një pagë, sado të vogël, që të futen në sistemin e pagave dhe jo paga të rritura dhe kësaj kur u shtohet edhe premtimet e bëra nga qeveritarët gjatë fushatës zgjedhore, se ata do të futen në sistem, kjo po i irriton edhe më shumë këta punëtorë dhe po shkakton një parregullsi në sistemin shëndetësor.

Në fund unë kam një lloj pyetje, ngase kryeministri ka deklaruar që pagat po i rrit edhe për ta luftuar korrupsionin brenda Qeverisë. A do të thotë kjo që me mosrritjen e pagave për ministrat dhe për qeveritarët po u jepni të drejtën tash edhe të korruptohen, meqenëse ju po e thoni që rritja e pagave e ul korrupsionin, tash mosrritja çka do të thotë? Faleminderit!



KRYESUESI: Zoti Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Qeveria e madhe 25 do të thotë edhe ministra 22, edhe zëvendëskryeministra, e dimë që është harxhim, e dimë që rritja e pagave të këtyre ministrave, e kryeministrit, është harxhim i vendit, mund të jenë nja 30 mijë në muaj, 300 mijë a 400 mijë në vit, po i marrim ato dhe të shohim çka mund të bëjmë me to. Kur të doni i shpërndajmë tjetërkund dhe e shihni çka përmirësoni.

Në anën tjetër, puna e korrupsionit. Është pak e shpjegueshme hierarkia. Shikoni, unë nuk jam, unë e di që jemi Republikë parlamentare, si tha zonja Haxhiu më herët, se karrierën e kam filluar këtu ku jeni ju. Më shumë jam ulur atje në jetën time, kur nuk kam qenë në burg, se sa këndej, këndej kam përvojë më së paku, një herë i kam 100 ditë, e tash nja gjashtë muaj. Gjashtë muaj asnjë minutë lezet nuk ia di kësaj pune të kryetarit të Qeverisë, duke vrapuar prej teme në temë, tema të akumuluar, tema të kontaminuar, probleme në këtë vend. Vrap, besoni, sido që të jetë, po kthehem pak në fillim, në Kushtetutën e vendit tonë përgjegjësitë janë radhitur, i pari në protokoll të shtetit është presidenti, i dyti është Parlamenti, i treti është ekzekutivi. Për kah puna në Kosovë, puna më e rëndë, ma merr mendja mua, nëse punohet, është e kryetarit të Qeverisë, nuk e di që ka, urdhëroni? Mua më duket që është puna më e rëndë, ndoshta ka ndonjë më të lehtë ose më të rëndë. Në krejt hierarkinë e pagave gjendja është kaos, po kaos 20-vjeçar, nuk e kam krijuar unë qe 5-6 muaj. Jam për ligj të kategorizimit të pagave, jam për ta zgjidhur çështjen e mjekëve, e kirurgëve, të atyre që u thanë, jam për të zgjidhur plot tema të këtij vendi, mirëpo nëse i leni vendimmarrësit, po ju them edhe një herë, edhe i nëpërkëmbni qoftë edhe me pagë, nuk është tregues i mirë për atë vend.

Edhe vendet e tjera, qoftë të zhvilluara, qoftë mesatarisht të zhvilluara e kanë këtë hierarki të pagave. Dikush e merr rrogën 300 euro, po asnjë përgjegjësi përpos vetes nuk mban, shkon me 300, kthehet në shtëpi, kaq e ka. Po dikush që mban përgjegjësi për 2 miliardë të buxhetit ose për qindra milionë ose për qindra aspekte të tjera të ndjeshmërisë që e përfaqëson këtë vend, është pak më ndryshe, bre. Nëse jemi në politikë, ndoshta e kuptojmë çka jam duke folur, ju e dini me çka përballet sot Kosova, me çfarë përpjekjesh, nuk të lë fare në tema. E bazuar në këtë, ideja e rritjes së pagave ju duket ndoshta krejt që u bë veç për hatër të pagës së kryeministrit. Mund ta mendoni kështu, ju kam thënë edhe më herët, a është ashtu a jo, por s'ka lidhje. Përgjigjja ime për kravatë kur e kam dhënë, e tash po ju them, me siguri nuk i keni besuar që është ashtu, as që s'kam menduar ashtu, por e kam thënë me qëllim atë.

Mos harroni, nuk ke pasur dhe nuk e ke një instrument sot, dikush po thotë ua rritim gjyqtarëve, e kështu e ashtu, prokurorëve. Rrenë është, instrument tjetër nuk ke njëherë, s'mund të mbërrish te ta menjëherë. Po të ishte ashtu, ua kishte rritur edhe para meje dikush shpejt e shpejt, por s'kanë mbërritur t'ua rrisin pagën, e mos e neglizhoni gjendjen që e kemi në gjyqësor. E dini si e kemi gjendjen, edhe kryetari i Qeverisë, edhe ministri, edhe kryeprokurori, edhe kryetari i

Këshillit Gjyqësor, kryetari i Gjykatës, gjykatësi, prokurori, nuk janë në rregull të trajtuar me nivelin e pagave. Ndryshe thënë, unë kur kam qenë deputet s'e kam dëgjuar kryeministrin duke u ankuar, se beso s'ia kisha lënë rrogën ashtu. S'ia kam vënë mendjen atij detaji, kurrë s'ia kisha lënë rrogën ashtu. E kisha thirrur, e i kisha thënë, zotëri s'mund të jesh kryeministër e i 70-i a i 80-i në listë të rrogës. Si t'i vlerësoni ju këto paga, si të doni vendosni, qe po i heqim të 30 njerëzve e po i zgjidhim problemet sociale me to, mundemi. Po ua marrim edhe deputetëve nga 100 euro, çka kemi zgjidhur, nuk kemi zgjidhur kurrëgjë, bre.

KRYESUESI: Faleminderit! Megjithatë, përjetësia e krejt këtyre që po i përmend për të pasur rroga dhe privilegje nuk është praktikë e asnjë vendi në rajon, e është praktikë e pak shteteve në botë, siç e kemi bërë ne.

Fjalën e ka Sali Zyba.

SALI ZYBA: Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Të nderuar të pranishëm,  
Kolegë deputetë,

Po flasim për rritje pagash, për Kabinetin qeveritar, për një rritje për 100%. Nga Kabineti qeveritar parafolësit, disa prej ministrave këtu përmendën edhe ligjin, i cili i mungon Kosovës, Ligji për pagat.

Në veçanti do të vë theksin te ministri Jagcillar, i cili tha se është ligji dhe në qershor shpreson të vendoset. I njëjti shumë herë më parë, shumë vjet me radhë në kabinetet e tjera qeveritare ka premtuar dhe është angazhuar për një ligj, po ligj që nuk është bërë asnjëherë. Po kaloj te ministri Hamza, se fjalimet janë kundërpërgjigje, se vendimi tashmë është i pezulluar, por është edhe i kundërligjshëm, i cilësuar edhe prej organeve të drejtësisë presim vendime të tjera. Ministri Hamza tha se “jemi përpjekur që ta zbusim diskrepancën”. Le të ma gjejë ministri një vend në botë ku brenda 100 ditësh Kabineti qeveritar rrit pagat për vete 100%. Tha “nuk ka prodhuar asnjë efekt financiar”, nuk ka prodhuar asnjë efekt financiar për faktin sepse është detyruar ta ndërpresë, ta pezullojë. Nëse është aq lehtë, pse është ndaluar në 100%, nëse s'paska ndikim financiar do të mund ta vendoste vetë, sa ka nevojë ai.

Ministri Reçica i përmendi shumë gjëra, meqenëse i takon skemës sociale, një prej skemave që e përmendi më së shumti dhe përshtypja ose arsytimi për rritje të pagave e krahasoi me gjendjen e përmirësuar ose me rritjen me vendimit të kësaj qeverie për një rritje prej 20%. Kjo rritje prej 20%, në fakt, prej kategorive të përfitimit të skemës sociale, rritje e cila nëse ka qenë 50 euro për një familje ose për një anëtar të një familjes në kuadër të kësaj skemës, është bërë 60 euro, ndërsa 100% i këtij Kabineti është rritje e madhe. Në skemën sociale, ministër, duke pasur për bazë gjendjen dhe varfërinë e kësaj skeme, e këtyre përfituesve të skemës, ju si ministri nuk jeni duke mundur ta realizoni ose të ushtroni ndikime të paktën të kontrollit të skemës në disa prej

komunave të veriut të vendit dhe kjo e dëmton edhe skemën, edhe buxhetin, edhe format e tjera të përkrahjes.

Ndërsa, kryeministri përveç që foli që e arsyetoi si nivelim të pagave, duke u bazuar në disa paga të tjera dhe tha se qeveritarët janë një pakicë e vogël, një pakicë e vogël janë të pranishëm këtu, ndërsa numri i tyre i madh, edhe në rritje, është numër i madh. E përmendi në një moment shifrën prej 30 personave, nuk janë 30 persona, vetëm zëvendësministra ose vendimi i tij për ngritje pagash i ka 23 kategori për ngritje të pagave, në kuadër të Kabinetit dhe disa kategorive që ka marrë vendime për rritje 100%. Këto 23 kategori, njëra prej kategorive, do të thotë e zëvendësministrave, janë mbi 75 persona, kjo nuk nënkupton 30 persona, edhe për më keq, aktualisht edhe sa përpqesha ta gjej në ueb faqe të Qeverisë, janë disa ministri që nuk figurojnë të dhënat e stafit dhe të Kabinetit qeveritar, që nënkupton nuk është transparente as numri i të punësuarve, ndërsa vendimi tashmë është i kontestuar.

Unë për kryeministrin kam një pyetje: meqenëse në listën e këshilltarëve ka këshilltarë politikë dhe ka kategori të tjera që kanë përfituar prej kësaj rritje, nëse është e mundur të di, ka qenë këshilltar ekonomik apo çfarë këshilltari ka qenë ky që ka propozuar këso rritje për Kabinetin 100% e kategoritë e tjera, qoftë ato sociale, qofshin skema të tjera, për përqindje, në veçanti për nëpunësit civilë, të cilët kanë përfituar vetëm 4%, qoftë duke u bazuar në rritjen ekonomike prej 4%, qoftë prej formave të tjera të avancimit të kësaj qeverie. Meqenëse po flasim për 100 ditë pune, 100% rritje të buxhetit të vet ose të Qeverisë së vet.

KRYESUESI: Zoti Haradinaj ka sqarim shtesë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Janë disa deputetë që flasin dy herë gjatë mandatit të tyre, ose deri në tri herë. Kur kam qenë unë deputet, ka pasur të tillë, por nuk është që s'i kanë ditur temat, por e kanë vlerësuar, janë konsumuar, i tha dikush dhe e kanë respektuar ashtu. Ti Salih Zyba më shumë je duke e harxhuar popullin me rrogën tënde të deputetit, se s'di çka je duke e ndihmuar, por pikërisht për këtë po e them se sa ata në Qeveri.

Pse po flas kështu, mos e harroni një gjë, edhe unë i shoh do njerëz që marrin rroga sa punojnë. I bëjnë bukur disa orë punë, vrapojnë, janë aktivë. Nuk është e vërtetë që zëvendësministrave u është rritur rroga, s'di ku e ke marrë. E, ti shpresoj që e arsyeton rrogën tënde gati 2 mijë euro që e merr këtu në Kuvend, edhe nëse i ke tepër, dërgoja pak edhe ti rasteve sociale, se bën, nuk është marre.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ka zoti Zyba.

SALI ZYBA: Është për keqardhje, kryeministër, nëse jeni bazuar në kontributin apo pagën time për referencë që ta rritni pagën tuaj apo të Kabinetit tuaj, ndërsa kontributi dhe angazhimi im nuk ka filluar sot, nuk do të përfundojë këtu dhe as nuk është i pari apo i fundit. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju lutem, mos ndërhyri prej vendit! Mos e merrni fjalën pa ju a dhënë! Zoti Ramush Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Shiko, nuk e vë në kontest ndonjë kontribut të vlerave të tjera, qoftë për liri, qoftë për çka do qoftë të askujt. Të gjithë kanë bërë diçka dhe ju lumtë. Jam duke folur për pagat që i marrin, për këto që i kemi të shkruara. Pra, unë e marr sot 1 mijë e 400-500, me rritje 2 900, ti e merr nja 2 000. Unë desha të them, burri i dheut, me çdo normë shumë më badihava je duke e marrë ti.

KRYESUESI: Zoti Driton Selmanaj e ka fjalën.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, unë fillimisht kam një shqetësim timin rreth asaj që interpelanca jonë është kërkuar para dy muajve dhe është vonuar diku për dy muaj, kam përshtypjen që kjo po bëhet me qëllim për ta devaluuar edhe tematikën. Më pas kjo po devalvohet edhe për shkak të vendimeve dhe kundërvendimeve që kjo qeveri po i merr, e ndërkohë unë po mendoj që duhet ta respektojmë afatin në Rregullore, që diku për 14 ditë secila kërkesë për interpelancë të vihet në agjendë.

Çështja me të cilën unë po dua të filloj debatin për këtë temë është që, besomëni, po ndihem keq se si mund të ndihen njerëzit që po na dëgjojnë neve sot, së paku në bazë të të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës që janë diku 32% të papunë, nja 18% që jetojnë në varfëri të skajshme dhe ne po flasim për paga 6 mijë euro në Kosovë, 2 mijë euro, 1 mijë e 900, 3 mijë, sikur të jemi duke folur për një shtet tjetër duke i fyer ata. Unë mendoj që jemi duke i fyer dhe me këtë po e kuptoj pse ata, në fakt, po na urrejnë kaq shumë si politikanë. Unë pasi jam bërë politikan kur dal në terren e shoh që po i the jam politikan, po ndihem keq, po ndihem keq, sepse është krijuar njëfarë urrejtje ndaj postit të politikanit dhe kam përshtypje kjo po vjen edhe si rezultat të veprimeve të papërgjegjshme të tilla, e cila është kjo që ne sot po e trajtojmë.

Tash edhe kryeministri, edhe ministri Hamza tha, po shikoni, kjo është në vazhden e praktikave që ka ndodhur në Kosovë dhe po pajtohen të gjithë që është praktikë e keqe. Dhe, çfarë po na thonë, praktikë e keqe që shumica e kryeministrave i kanë rritur pagat më herët, pa ligj, të pabazuara në dokumente legale dhe çfarë. Hajt po vazhdojmë edhe ne, meqenëse na erdhi rasti edhe neve, por tash jo me pak rritje, por 100%, diku 200%, more 300%, s' e kemi telashe. Unë po e them që zoti Hamza duhet ta dijë këtë që edhe pjesë e këtij çekuilibrimi të të ardhurave në Kosovë ka qenë pikërisht ai, sepse ka qenë ministër i Financave në kohën kur ekzekutonte vendime, të cilat tash po themi që ka qenë praktikë e keqe. Dhe, unë kam përshtypjen që edhe

vendimi i zotit Haradinaj, i fundit, nuk është që është tërhequr se zoti Haradinaj ka vendosur ashtu, por kam përshtypjen që kjo ka ndodhur për shkak të problemeve të brendshme, brenda koalicionit. Sepse, zoti Hamza sikur nuk donte të ekzekutonte një vendim të kundërligjshëm. Sepse, po të jeni të bindur ju që ky vendim është i ligjshëm dhe i bazuar në praktikën e mira, pse e tërhoqët?!

Gjykata Kushtetuese nuk ka kërkuar ose nuk ka vënë masë të përkohshme të pezullimit të vendimit, ka mundur të bëjë edhe këtë, nuk ka vendosur. Po ju e keni hequr vendimin, e keni pezulluar, sepse jeni të vetëdijshëm që ky vendim është i kundërligjshëm. Tash po provon këtu sikur të shitet që keni kujdes, sepse gjykatat, prokuroritë i kanë pagat e vogla dhe ju e dëmtuat këtë proces. Jo, jo, të jeni të sigurt që vendimi juaj për rritje të pagave ose pasojat që i ka pasur vendimi juaj ka qenë incident, se ju as që e keni ditur që vendimi juaj prek edhe prokurorët, edhe gjykatat. Sepse, po ta bëni këtë me vetëdije, unë mendoj që do të ishte shkelja tjetër, pse? Qeveria nuk i rrit pagat e pushtetit gjyqësor në Kosovë, Qeveria i propozon Kuvendit dhe Kuvendi e voton rritjen e pagave edhe për prokurorët, edhe për gjykatësit në Kosovë. Po të ishte ndryshe, kjo i bie cenim i pushteteve të ndara në Kosovë, cenim i pushtetit gjyqësor, në këtë rast, që i bie ju ua rritni pagën dhe më pas mund t'i kontrolloni ata, nuk është kjo kështu.

Cila është ideja? Ideja është që ne të ndërtojmë një sistem të pagave bazuar në ligje, nxirreni ligjin, kryeministër. Ashtu siç e morët me shpejtësi nismën legislative për ta rrëzuar Gjykatën Speciale, merreni, ngutuni, shumë shpejt, sepse po na duhet. Unë po pajtohem që rroga juaj nuk është e dinjitetshme, rroga juaj si kryeministër, por këtë nuk mund ta bëni ju duke abuzuar me ligjet që ka ky vend ose nëse nuk i ka ato, nxirreni ato, sepse mund ta bëni atë, edhe nëse s'e kanë bërë tjerët, bëni ju, si shembull.

Tash unë këtë logjikë të vendimeve absurde e kuptova vetëm me një thënie tuajën, cila ishte ajo? Që shteti po dhënka para edhe në të zezën. Unë s'di qysh shteti jep para në të zezën, qysh paguan në të zezën! Mund të mos jenë procedurat e prokurimit publike për shkak të tematikave të ndjeshme, por ato janë me ligje, nuk janë në të zezën, janë të rregulluara me norma, jo në të zezën. Nëse është kjo logjikë, ju lutem, ndërpritni, sepse në të zezën funksionon diçka tjetër, por jo shteti. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Haradinaj, pastaj zoti Mahir Jagxhillar i ka minutat e "6+".

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** Dy-tri elemente për ju, zoti Selmanaj, para se të merret vendimi që të rriten pagat, ka ndodhur një debat, është diskutuar, kanë treguar implikimet, njëri nga implikimet, nuk po them i vetmi, ka qenë edhe ky që do të ballafaqohem me ju, ka qenë se implikon rritjen e pagave të gjyqësorit. E kemi pasur këtë informatë, pra nuk qëndron ajo që po thoni ju. Tjetra është shteti në të zezën, ne mund të asociojmë të zezën me shumëçka, përnjëmend mundemi, bile edhe shqiponja në flamurin tonë është e zezë, por nuk është e zezë

ashtu qysh po mendoni ju. Tash varet ku të shkon mendja, se nuk është veç e zeza e zezë, ka veprime e projekte të caktuara të shteteve që mund t'i cilësosh ti si i vlerëson, po ndodhin në praktikat e shteteve. Ndoshta ke dëgjuar, ndoshta dëgjon ndonjëherë, më shumë nuk po flas. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Jagxhillar e ka fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Unë jam në mandatin e tretë si ministër i Administratës Publike, në mandatin e katërt legjislativ është propozuar Ligji për funksionarët publikë, për paga të funksionarëve publikë, por prej Parlamentit është kthyer. Në mandatin e kaluar vërtet përmes Qeverisë ka kaluar Ligji për pagat, por duke u bazuar në kërkesën e Komisionit Evropian që në kuadër të reformave të Administratës Publike të shkojnë të tri ligjet në pako: Ligji për organizimin e Administratës Publike, Ligji për shërbimin civil dhe Ligji për pagat, është shtyrë. Edhe atëherë ka pasur disa reagime tjera, ne punuam, jemi duke vazhduar punën, besojmë që javën tjetër do të aprovohet koncept-dokumenti, sepse së pari kërkohet të aprovohet koncept-dokumenti dhe pastaj menjëherë të vazhdojë me të njëjtën temp të punojmë si në Ligjin e shërbimit civil dhe organizimit të Administratës Publike, që në fund të muajit mars, faktikisht në muajin maj ose në muajin qershor të procedojmë në Parlament dhe së bashku pastaj të procedojmë. Sepse, janë disa hapa, të cilët ne nuk mund t'i tejkalojmë.

Është një ligj, i cili do të rregullojë çështjet përafërsisht të 80 mijë njerëzve, të cilët përfitojnë prej buxhetit të Republikës së Kosovës, ndërsa vendimet e deritanishme gjithmonë kanë shkuar përmes Qeverisë, disa vendime kanë qenë nën nivelin e Kryesisë së Kuvendit, disa vendime sa u përket pagave, sidomos të institucioneve të pavarura, vetë kanë marrë gjithashtu edhe institucionet e ndryshme kanë kërkuar pastaj shumicën e çështjeve të pagave të rregullojnë edhe me shtesat dhe kompensime të ndryshme. Kështu që në këtë aspekt, është duke u krijuar një situatë e cila nuk mundet të rregullohet, përveç nëse nuk aprovohet një ligj, i cili do të jetë bazë për Ligjin për caktimin e pagës bazë, pastaj të rregullohet nivelimi dhe raporti midis pozitave të ndryshme.

Kryeministri e ka përmendur, e ka pagën në vendin e 69-të si vlerë, po si pozitë është në vendin e 85-të, si pozitë. Faktikisht 84 pozita janë mbi pozitën e kryeministrit dhe sigurisht që nuk është në rregull, atëherë duhet ta bëjmë nivelimin e pagave dhe pastaj të bëjmë një disiplinë edhe në pjesën e shtesave dhe kompensimeve, ku ekzistojnë ndoshta afro 100 vendime të ndryshme. Pra, nivelit qeveritar, nivelit të Parlamentit, nivele të ndryshme të institucioneve në kuadër të

Administratës Publike. Në këtë aspekt, është edhe kërkesa edhe e Komisionit Evropian që në kuadër të reformave të Administratës Publike të bëhet një rend edhe sa u përket pagave.

Unë në bashkëpunim me ministrin e Financave do të vazhdojmë punën dhe me institucionet e tjera dhe procedurat qeveritare kur të përfundojnë, besoj që në muajin maj ose më së shumti në qershor do të procedohet Ligji për paga, për të gjithë përfituesit nga buxheti i Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë ka zoti Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, një kohë të gjatë në Kosovë ka ndodhur që edhe pas çdo vendimi abuzues ose sjelljes abuzuese t'u kthehem pak metaforave në kontekstin e elementeve nacionaliste që i kemi duke e mbrojt veten, qoftë me kohën e luftës, qoftë me simbolet kombëtare ose diçka tjetër. Por më s'pi ujë kjo, unë po ju them kështu, shkëlqimi i shqiponjës së zezë në flamur do t'i rritej shumë, besoj, nëse do të instalonim një kulturë tjetër qeverisëse në Kosovë, ku do të vendosim që çdo gjë që bëjmë, ta bëjmë në përputhje me ligjet, me Kushtetutën, me mirëqeverisjen, e kështu e ashtu, por jo të provojmë që me metafora të tilla, me shembuj të tillë të provojmë ta relativizojmë një dëm që e keni shkaktuar, sepse edhe vetë po e dini që keni bërë gabim.

Dje, pardje ndodhi që e tërhoqët edhe një vendim tjetër, atë për faljen e borxheve. Prandaj, mendoni para se t'i merrni këto, sepse më pas pasojat janë shumë më të mëdha se sa vetëm një sjellje juaj. Populli s'po na e fal, pastaj goxha gjatë këto farë punësh, të cilat po vijnë si rezultat i papërgjegjësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Millaku e ka fjalën.

DRITA MILLAKU: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo interpelancë është bërë shkak i ngritjes së pagave të Qeverisë, domethënë mendoj që këtu u arrit, u mbush kupa për ta thirrur këtë interpelancë, mirëpo nuk ka qenë arsye e vetme që të diskutohet sot kjo.

Konsiderojmë që gjatë debatit shumica e gjërave u tha, për të mos i përsëritur edhe unë, mirëpo do të isha ndalur vetëm te disa elemente, të cilët i konsideroj që janë shumë të rëndësishme, e ndër to një fjalë e cila më tingëlloi dhe më mbeti nga ministri i Financave, Bedri Hamza, kur tha që nuk është precedent, domethënë nuk është krijuar precedent rritja e pagave. Po, është e vërtetë që nuk është krijuar precedent, sepse prej 18 vjetëve që udhëhiqet nga kjo qeverisje ndodh e njëjta gjë, por sidomos në rritjen e pagave në sektorin publik këtë gjë e kanë shfrytëzuar

jashtëzakonisht mirë sidomos në kohën e fushatave. Tjetër gjë që duhet ta theksojmë dhe që është e rëndësishme, dua të diskutoj dhe të ndalem te ministri Jagxhillar, i cili tha dhe u deklarua, meqenëse edhe dimë që është hera e tretë që ky është ministër, i cili i drejton shërbimet, por çka është e rëndësishme zoti ministër, çdoherë keni theksuar dhe keni thënë se duhet të bëhet një ligj i veçantë për pagat, mirëpo a nuk ka qenë guximi juaj, kur e dimë se në shumicën e rasteve, prapa kamerave e ke theksuar se, “nuk kam guxim, apo nuk më lejohet prej kryeministrave të bëhet një gjë e tillë”. Ku qëndron arsyeja dhe pse nuk e keni marrë një vendim, kur ke pasur mundësi deri më tani, siç e theksuan edhe kolegët deputetë që Ligji për pagat e definon saktësisht që të mos krijohen manipulime të ndryshme sa u përket pagave, edhe në Qeveri, por edhe në sektorët publikë.

Ajo çka është më e rëndësishme te sektorët publikë, e theksova sepse jo rastësisht qeveritë e pasluftës, secila me radhë, e kanë përdorur këtë mekanizëm në sektorin publik që t’i ngrenë pagat në kohë të fushatave, mirëpo çka është më shqetësuese dhe çka është më e rëndësishme është rritja e pagave në sektorin privat. Ngritja e tyre sipas kategorive të moshës dhe sipas një ngritjeje minimale po e shkakton një pakënaqësi të madhe te të punësuarit në këtë sektor, e duke e krahasuar me sektorin publik kjo është një lëvizje taktike e Qeverisë, pasi të gjitha bizneset e mëdha në Kosovë janë të lidhura direkt me pushtetarët në nivelin qendror. Përveç pagave të ulëta, ata përballen edhe me shumë kushte të vështira të punës së tyre.

Ngritja e pagës sipas moshës i demotivon në përgjithësi të rinjtë që të konkurrojnë për një vend të punës, se duke pasur ngritjen e inflacionit apo kostos së jetesës, atëherë nuk kanë motiv për të punuar dhe shumica e tyre u drejtohen vendeve tjera për të aplikuar për një vend pune dhe dëshiroj të pyes se kjo Qeveri a ka informacione, se sa është numri i të rinjve të larguar nga vendi vetëm për këto pesë vjetët e fundit dhe e gjithë kjo si pasojë e qeverisjeve të dobëta për këto 18 vjetët e fundit.

Me rritjen e pagave në këtë sektor nuk ndikohet vetëm tek investitorët në asnjë aspekt negativ, përkundrazi rritet besimi i tyre për të investuar më shumë në vendin tonë. Duke mos dashur të marr më shumë kohë, atëherë fjalën ua kaloj kolegëve të mi.

KRYESUESI: Zonja Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të vendit,

Në fakt, pothuajse u konsumua tema, e në mënyrë që të mos i përsëris, po i them shkurt vetëm disa gjëra.



Derisa erdha në seancë, njëra nga punëtoret e pastrimit që punon në Kuvend më ndali dhe më tha që sot do të diskutoni për pagat. Ajo kryeministër më tha që pagën mujore e ka 120 euro. Një pastruese që i pastron lokalet e Kuvendit, ku ne dhe ju e sjellim pluhurin nga jashtë e ka pagën 120 euro.

Besoj që ju ndiheni kryeministër edhe i saj. Ajo është një nënë, një grua, është një zonjë familjare, një shtëpiake e dikujt. Arsyeya pse ne po e kundërshtojmë këtë vendim është që të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të gjithë të tjerët, përpos juve, nuk e kanë mundësinë t'ia ngrenë pagën vetes.

Në anën tjetër, një referent i Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës është përgjegjës për 13 mijë studentë dhe e ka pagën po të njëjtë me një referent të një fakulteti tjetër në kuadër të Universitetit të Prishtinës, që është përgjegjës për 60 apo 70 studentë.

Nëse flasim për përgjegjësinë, nëse flasim për anën ligjore të vendimit dhe legjitimitetin duhet t'i kemi parasysh këto. Unë nxora disa të dhëna dhe propozimi juaj për t'ia rritur pagën Kabinetit qeveritar dhe vetes është shumë i lartë, është 22 herë më e madhe se paga minimale në Kosovë, përderisa kryeministri i Shqipërisë e ka nëntë herë më të madhe se paga minimale, ai i Maqedonisë pesë herë më të madhe, në Serbi paga e kryeministrit është pesë herë më e madhe se paga minimale, në Mal të Zi është vetëm katër herë më e madhe, në Kroaci është njëmbëdhjetë herë më e madhe dhe në Slloveni është 6,5 herë më e madhe.

Keni propozuar që pagën vetes t'ia bëni 22 herë më të madhe sesa paga minimale në Kosovë dhe kjo na duket që nuk është e drejtë.

Tjetra? Gjatë prezantimeve tuaja sot, nuk e di ndoshta është mangësi imja, nuk kam mundur të ju kuptoj, por nuk e pata shumë të qartë nëse do t'i rritni pagat, nëse vendimi yt ka për qëllim për t'ua ngritur pagën Prokurorisë dhe Gjyqësisë apo jo, sepse në 25 pika të vendimit asnjëherë nuk i keni përmendur. E thanë edhe kolegët parafolës që duket sikur ju e keni marrë vesh pasi e keni marrë vendimin që ky implikon edhe rritjen e pagave të Gjyqësorit. Nëse nuk është kështu, atëherë na thoni, se i keni përmendur 22 kategori të ndryshme, duke përfshirë truprojen, asistentin e ministrit, shefin e protokollit, por asnjëherë nuk e keni përmendur që me këtë vendim, në fakt Qeveria, kryeministri, Kabineti qeveritar ia rrit pagat edhe Këshillit Gjyqësor.

Tani ne kur po diskutojmë këtu nuk është se po pretendojmë ta paragjykojmë vendimin e Gjykatës, e thanë edhe kolegët, ne e kemi bërë kërkesën për interpelancë para se lënda të shkojë në Gjykatë. Vendimi ndoshta edhe mund të jetë ligjor, por asnjëherë nuk është legjitim. Nuk është legjitim për shkak se ju jeni kryeministër, edhe i pastrueses së Kuvendit, edhe i referentit të Fakultetit Ekonomik, edhe i atyre që nuk janë fare në listat e pagave të Buxhetit të Kosovës. Dhe tjetra, kryeministër, duhet të punoni që ta stimuloni që të rritet sektori privat, se me të vërtetë

diskrepanca ndërmjet sektorit publik dhe privat është shumë e madhe dhe kjo po bën që rinia jonë të vetmen shpresë, tentim dhe qëllim për punësim ta ketë sektorin publik, e jo atë privat, e kjo po e dobëson dita-ditës sektorin privat, sepse ata nuk janë atraktivë për fuqinë punëtore kualitative. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti kryeministër Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Janë disa deputetë që ia kanë filluar, ishte rasti i Dritonit, vërtet duhet lënë një kohë për ta parë çfarë është kontributi i tij në politikë, çka do të ndryshojë ai.

Por janë disa, si zonja ministre Hykmete, a cila ka qenë disa mandate ministre e deputete, a të ka rënë ndërmend ty sa e ka rrogën ajo pastruesja më herët? Veç tash të ka rënë ndërmend, besoj, po e lidh me këtë rritjen. Kush të ka ndalur t'ia rritësh rrogën asaj e të tjerëve, e të tjerëve... Ato rroga i kam gjetur prej jush, ju ua keni lënë, në mundsha ua rris.

KRYESUESI: Zonja Hykmete Bajrami, replikë!

HYKMETE BAJRAMI: Kryeministër,

Më ka rënë ndërmend, e kam ditur, por nuk kam pasur mundësi t'ia rris. Por, ajo çka unë nuk kam bërë, për dallim prej jush, dhe çka nuk ka bërë kryeministri Mustafa është se nuk ia ka dyfishuar pagën vetes. Ne kemi qëndruar me ato paga dhe i kemi pasur po ato telashe që i keni ju sot, po ato punë, bile kemi punuar nën presionin e gazit lotsjellës që ju e keni gjuajtur këtu, nën presionin e molotovit, të protestave dhe të të gjitha atyre që ju sot nuk i keni asnjëherë.

Domethënë, ne nuk ia kemi rritur pagat vetes, sepse e kemi ditur. Ne ua kemi rritur pagat të gjithëve në sektorin publik me ligj 4%, atë që ju e keni zbatuar, sepse ne e kemi bërë pjesë të ligjit. Për sektorin privat kemi punuar shumë, e kanë treguar raportet ndërkombëtare, e kemi implementuar pakon fiskale 1 për t'i përmirësuar kushtet në sektorin privat që të rriten pagat, e ju duhet dhe jeni përgjegjës që ta implementoni sa më shpejt pakon fiskale 2. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: S'e di çka keni bërë, veç prej se kam ardhur prodhuesit s'po ma lëshojnë derën, duke kërkuar lehtësira, duke kërkuar... Nuk di ju çka keni aprovuar, por ata gjithë ditën te dera po rrinë, prodhuesit e Kosovës, ende s'kemi mbërri mjaftueshëm t'u dalim hakut. Ndryshe thënë, e thashë edhe më herët, sa herë... s'po di sa herë më të madhe e ke rrogën deputete tash, se ajo pastruesja. S'di sa herë i bie, a mundesh me... se ti je ministre dhe ndoshta e di.

KRESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajl Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Përshëndetje!

Mendoj se para se të bisedonim për rangimin e pagave të burokratëve që nuk janë duke hequr, do të duhej të diskutonim për problemin e papunësisë, për gjendjen e rëndë sociale të pensionistëve dhe të shumë familjeve tjera në Kosovë, për mosrespektimin e Ligjit të punës, sidomos ndërmarrjet private, e mosrespektim ka edhe brenda Kuvendit, por megjithatë edhe inicimi i kësaj interpelance konsideroj se është me vend, sepse të ardhurat personale të anëtarëve të Kabinetit qeverisës janë ngritur në shpërputhje me gjendjen ekonomike në vend dhe me procedura të parregullta, që janë bërë. Por, kur bëjmë fjalë për lartësinë e të ardhurave personale, nuk bën të mos përmendim edhe rroga tepër të larta në disa segmente për kushtet e Kosovës, ku rroga minimale është 170 euro, e ku pensionisti merr diku rreth 180 euro, ose ata që nuk janë kontributdhënës deri në 80 euro, derisa menaxherët në Fondin e Kursimeve Pensionale marrin nga 5 000 euro në muaj, menaxherët e Agjencisë Kosovare të Privatizimit 4 000 euro, e kështu me radhë.

Për t'i dhënë fund kësaj padrejtësie të madhe, kur dikush për një muaj merr sa merr një punëtor krahu për tre vjet, ne si Kuvend nuk e kryejmë obligimin tonë, duke u kufizuar vetëm te të ardhurat e Qeverisë, por duhet ta trajtojmë problemin në tërësi dhe të vendosim barriera ligjore që do t'u japin fund këtyre padrejtësive. Duhet që me ligj të pengohet mundësia e marrjes së dy a më shumë pagave, pavarësisht nëse merren në sektorin privat a publik. Kjo duhet të vlejë sidomos për zyrtarë të lartë, duhet të ndërpritet praktika e rritjes së pagave dhe përcaktimi i privilegjeve të zyrtarëve të lartë për vetvete gjatë mandatit aktual. Në çdo situatë për zgjedhje të suksesshme të këtij problemi iniciuesit duhet që zgjidhjen ta fillojnë nga vetvetja. Duhet të fillojnë me pagesa sipas rezultateve dhe angazhimeve në punë të secilit të punësuar, veç e veç. Ne si deputetë duhet ta shohim se sa është e drejtë, që ne për një pjesë të punës që e kryejmë të paguhemi në dy mënyra.

Për punën që bëjmë ne i kemi rrogat fikse mujore, këtu hyn edhe kompensimi për seanca dhe për mbledhjet nëpër komisione, por për të njëjtat punë, për pjesëmarrje nëpër seanca dhe mbledhje të komisioneve ne kompensohemi edhe me mëditje. Ky është kompensim i dyfishtë për të njëjtën punë dhe si i tillë është fitim i padrejtë, nga i cili ne si Kuvend duhet të heqim dorë, e pastaj të jemi këmbëngulës që t'ua pamundësojmë edhe të tjerëve që të mos i keqpërdorin pozitat e tyre për përfitime të padrejta personale, sidomos t'ua pamundësojmë zyrtarëve të lartë të institucioneve publike të agjencive të ndryshme publike dhe kompanive publike, të cilët vetvetes ia caktojnë të ardhurat. Për ta rregulluar këtë çështje konsideroj se është e domosdoshme që sa më parë në Kuvend të vijë Ligji për të ardhurat personale dhe kështu besoj se do t'i zgjidhim problemet ekzistuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Skënder, dëshiron? Ministri për Çështje Sociale, zoti Reçica.

MINISTRI SKËNDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Rritja prej 30% e asistencës sociale për kategoritë që përfitojnë nga kjo asistencë mendoj se është lajm i mirë për të gjithë ne dhe nuk duhet të na pengojë askujt prej nesh. Është lajm i mirë, sa për ato familje, për ata përfitues, po aq është edhe për ne.

U bënë këtu disa krahasime rreth pagës së zyrtarëve publikë dhe shumës që përfitojnë këta qytetarë nga asistenca sociale. Unë mendoj se kjo sa është jonjerëzore, është edhe emocionuese, prandaj nuk është mirë që t'i prekim në emocion kategoritë të cilat vërtet edhe ashtu janë të ndjeshme.

U fol këtu edhe për pagën minimale, u bënë edhe krahasime. Dua ta ndaj një fakt zyrtarisht edhe me ju. Këshilli Ekonomiko Social, në mbledhjen e fundit, vitin e kaluar, e ka nxjerrë një propozim për pagën minimale dhe atë propozim e ka bërë në bazë të analizave. Unë jam i lumtur që ne në bazë të analizave si Këshill Ekonomiko Social kemi dalë me atë rekomandim për pagën minimale.

U fol këtu për kategorizimin e rasteve sociale, u fol këtu për kategorizimin e shoqërisë në përgjithësi të atyre me nevoja të veçanta, me nevoja dhe asistencë speciale, e tjerë, e tjerë... Dua të ndaj me ju dy fjalë rreth asaj se çfarë kemi bërë për një kohë të shkurtër rreth dilemës së kategorisë më të shenjtë, veteranëve, familjeve të dëshmorëve, invalidëve civilë. Kemi bërë shumë. Për një kohë shumë të shkurtër u kemi dhënë rrugë dhe orientim shtetëror e shoqëror viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit. Dhe, jo vetëm kaq, jemi duke punuar shumë që nëna lehonë në Kosovë ta ketë vendin dhe dorën e shtetit aty ku duhet.

Të nderuar deputetë,

Po punojmë shumë që nataliteti të mos bëhet brengë e jona për mungesë të buxhetit dhe shumë shpejt këtë çështje do ta adresojmë aty ku duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Reçica! Fjalën e ka zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Jo rrallëherë tema e kategorizimit të pagave, e Ligjit të pagave, ka qenë pjesë e debateve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, qoftë në mënyrën e interpretimit individual apo të grupeve politike, pavarësisht raporteve pozitë dhe opozitë.

Grupet politike e kanë ngrehur një çështje të caktuar, që është rritja e pagave, e parë apo që edhe sot shihet në mënyrë të njëanshme, pa bazë ligjore, pa arsyeshmëri dhe kjo sigurisht se edhe sot nuk bën që vetëm ta anashkalojmë debatin, qoftë edhe për arsyeshmërinë e mungesës së ligjit,

por mbi të gjitha ajo çka nuk duhet të jetë temë, gjithmonë është tentimi për ta relativizuar, t'i quaj kushtimisht edhe funksionet edhe pozitat. Por, më së shumti, është mendim imi personal, është mungesa e përgjegjësisë para ligjit dhe para punës dhe detyrave që janë të parashtruara në të gjitha funksionet publike.

Ne kemi institucione si kategori kushtetuese që janë faktorë sigurie për ruajtjen dhe menaxhimin e financave publike dhe besoj se ato janë të thirrura dhe janë kompetente, qoftë Zyra e Auditorit Gjeneral, por edhe institucionet tjera të sigurisë, që e luftojnë krimin dhe korrupsionin në vend, t'i shohin lëvizjen e parasë publike në të gjitha institucionet e saj.

Insistimi ynë është përmirësimi i qeverisjes dhe krijimi i kushteve të mira edhe për jetë, edhe punë për gjithë qytetarët e vendit, por kjo ka treguar që jo gjithmonë është arritur vetëm me rritjen e pagave. Dhe tash, nëse ne nuk tentojmë, e mbi të gjitha nuk e synojmë një reformë tërësore dhe organizative, mbi të gjitha funksionale të ligjit, sidomos për kategorizimin e pagave dhe reformës në Administratën Publike dhe ky debat do të vazhdojë i tejzgjatur pa ndonjë konkludim të saktë, mbi të gjitha dhe shpeshherë edhe me arsye apo pa arsye, me inate politike dhe pa ndonjë arsyeshmëri të plotë.

Gjithmonë lind pyetja se me rritjen e pagave a është ulur korrupsioni dhe krimi i organizuar në vend? A është ulur apo është rritur informaliteti ekonomik? A është ulur apo është rritur numri i ministrave, i zëvendësministrave dhe i pozitave të dyfishuara në institucionet publike? Dhe, në plotësisht mund të konkludojmë se është nevoja që të kemi paga të dinjitetshme për institucionet qeverisëse, presidentin, kryeministrin, kryetarin e Kuvendit, deputetët... pa dashur t'i krahasojmë edhe nivelet, por brenda këtyre funksioneve ka funksione të cilat nuk mund të arsyetohen. Edhe sot e kësaj dite, për mua, është e pakuptimtë se cili është roli apo pozita e shefit të stafit të kryeministrit, cili është roli dhe pozita e zëvendës-shefit të stafit të kryeministrit dhe cili është roli dhe pozita e shefit të Kabinetit të kryeministrit të vendit? Domethënë, cila është arsyeshmëria që ata e bëjnë në punën dhe detyrat që i kryejnë edhe në të kaluarën, edhe në të tashmen, e nëse pretendohet edhe në të ardhmen, që të ekzistojnë funksione dhe pozita të tilla, pa dashur të hyj edhe në pozita të tjera, të cilat për mendimin tim janë vetëm ngarkesë për Buxhetin, nuk janë funksionale dhe nuk sjellin ndonjë rezultat konkret në luftimin, apo në qeverisjen e mirë.

Tendencat për të relativizuar, ta quaj edhe njëherë kështu, në mes pagës së Qeverisë dhe deputetëve dhe duke u thirrur gjithmonë në institucionet e Gjyqësorit dhe të Prokurorisë, nuk është e drejtë, nuk është parimore, është tendencë për t'i ikur përgjegjësisë, sepse paga e dinjitetshme, e thashë edhe paraprakisht, nuk e mbulon qeverisjen e keqe.

Për mua është normale që institucionet të kenë paga të dinjitetshme, por është jonormale që të kemi falje të borxheve, paarsyeshmëri të plotë, i kemi pagesat e obligimeve, siç ishte rasti i pesë milionëve për tenderit kriminal të pasaportave, shlyerja e borxheve në shumën 500 mijë euro e

obligimeve tatimore. Është e paarsyeshme tendenca tash dhe akoma nuk po gjen rrugë as përgjigje ai 64-milionëshi apo 14-milionëshi i “Bechtel-Enka”. Ky është shpenzimi i parasë publike në mënyrë të pakontrolluar dhe kjo është ajo që qytetarët i shohin si afera korruptive, e të cilat e lënë në hije rritjen e pagave, edhe pse kjo shpeshherë as nuk është arsyetuar, mbi të gjitha është banalizuar dhe pjesa tjetër tentohet që të ketë krahasime ndërmjet institucioneve të cilat punojnë, apo individëve që punojnë me dinjitet dhe jetojnë nga paga apo nga puna e ndershme, që marrin një pagë nga Buxheti i Republikës së Kosovës.

Andaj, besoj se kjo duhet të jetë një thirrje që sa më shpejt të vijë Ligji për pagat, sa më shpejt të ndodhë reforma në Administratën Publike dhe besoj se do të rritet përgjegjësia para ligjit. Nuk mund të ketë përgjegjësi para ligjit, kur në institucionet tona qeverisëse kemi njerëz me të kaluar kriminale dhe që kanë rënë ndesh me ligjin. Nuk është kjo arsyeshmëria e pagës, është arsyeshmëria e pastërtisë ndaj së kaluarës dhe detyrave që marrin, edhe institucionet e sigurisë, edhe të drejtësisë, edhe të Gjyqësisë. Ne kemi tentuar, ka pasur në të kaluarën kushte më të mira të Prokurorisë Speciale, por i gjithë angazhimi i tyre brenda një mandati të caktuar ka qenë ngritja e një aktakuze për armëmbajtje pa leje dhe paga ka qenë shumë e dinjitetshme, siguria ka qenë shumë e dinjitetshme. Andaj, kjo nuk e siguron rritjen e përgjegjësisë, rritjen e përgjegjësisë e sigurojnë njerëzit kredibilë, që janë të përgjegjshëm dhe që ia duan të mirën këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesues!

Po e filloj këtë diskutim duke u bazuar në fjalën e kryeministrit, i cili e tregoi rangimin e tij sa i përket pagës dhe pa e kontestuar këtë dua ta theksoj faktin se paradoksalisht në rangun më të lartë të pagesës janë personat që punojnë në Fondin e Kursimeve Pensionale, përderisa pensionistët e këtij vendi kanë pensione minimale, që nuk u mjaftojnë as për përmbushjen e nevojave elementare, përfshirë këtu edhe blerjen e ilaçeve.

Duhet ritheksuar prapë se vendimi i kryeministrit për rritje të pagave është i jashtëligjshëm, përveçse është jo etik dhe përderisa po u referohemi rasteve individuale si krahasuese, atëherë vlen të shtrohet pyetja: pse s’u konsiderua asnjëherë mundësia për zvogëlim të pagës së lartë, por anasjelltas gjithmonë duhet të rritet paga për ata që janë në qeverisje?

Ministri Hamza deklaroi sot këtu se rritja e pagave me vendim të Qeverisë nuk është rast i ri, se ka ndodhur edhe më herët. Pra, po vazhdohet me gabime e shkelje të njëjta, konkretisht me përfitime personale të grupeve të vogla dhe asnjëherë nuk u raportua për pagesat e kategorive të ndryshme. Është me interes të shihet me kujdes vendimi për rritjen e pagave për të punësuarit që marrin paga nga Buxheti i Republikës së Kosovës, ku përmendet se prej 4% mbi pagesën bazë,

duke u përfshirë mjetet financiare prej 30 eurove për punëtorët e shërbimit civil, si dhe 44 euro për punëtorët shëndetësorë.

Unë e kam një sqarim nga ministri i Financave, apo nga ata që kanë qenë në qeverisje më herët dhe kanë marrë këtë vendim, se si u vendos për këtë vlerë, cila është baza ligjore dhe pse është pikërisht kjo vlerë.

Një pyetje tjetër që kisha për ministrin është se çfarë e përbën pagën bazë, sepse ajo që ka ndodhur, po e marr vetëm një shembull, në muajin janar të këtij viti në sektorin e arsimit janë dërguar dy lista të pagave, ku lista e dytë ka përcaktuar një zvogëlim të shumës së pagesës bazë, gjegjësisht përvojës së punës në dëm të stafit arsimor dhe vendimi është marrë pa asnjë argument dhe në mënyrë krejtësisht arbitrare në dëm të mësimdhënësve.

Një çështje tjetër që dëshiroj ta adresoj është edhe dallimi shumë i madh në mes të pagave të zyrtarëve që punojnë në nivelin qendror, gjegjësisht në ministri dhe atyre që punojnë në nivelin lokal, edhe pse këta të fundit paguhen shumë më pak, ndonëse volumi i punëve të zyrtarëve komunalë është shumë më i madh.

Meqenëse pati diskutime këtu nga përfaqësues të subjekteve të ndryshme, vlen të përmendet se ka dallime të theksuara në paga në mes të shërbyesve civilë në komuna të ndryshme dhe në të gjitha rastet, ka paga më të mëdha në komuna që kanë qenë të udhëhequra nga të njëjtat parti me ato që kanë qenë në pushtet.

Kështu, për shembull, pagat e zyrtarëve të DKA-së në Prishtinë dhe atyre në Gjakovë janë më të vogla se në komunat e tjera.

Po e marr vetëm një shembull, koordinatorët për arsim në Prishtinë e kanë koeficientin 6, kurse në Prizren dhe në Gjilan e kanë 7.

Ose zyrtarët e financave dhe të arsimit në Prishtinë dhe Gjakovë kanë koeficientin më të vogël se ata në Klinë dhe Kamenicë, ku numri i nxënësve dhe rrjedhimisht volumi i punëve është shumë më i vogël, por e vërteta është se aty ka qeverisur PDK-ja.

Në lidhje me këta shembuj që sapo përmenda, Ligji për pagat e nëpunësve civilë, në nenin 3 e përcakton saktë të drejtën e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt dhe thotë se kjo është e garantuar dhe se institucionet e Administratës Publike të Republikës së Kosovës janë të detyruar të paguajnë pagë të njëjtë për punë me vlerë të njëjtë.

Kjo gjë është adresuar edhe nga Institucioni i Avokatit të Popullit që ka konstatuar në vitin e kaluar se ka trajtim të pabarabartë ndërmjet shërbyesve civilë të punësuar në drejtoritë komunale të arsimit në Kosovë, e kjo padrejtësi cenon një varg normash ligjore dhe etike.

Dua të përmend edhe grevën që këto ditë po organizohet nga SBASHK-u për shkak të mospërbushjes së premtimeve për Ligjin për mësimdhënësit të viteve të '90-ta, duke shkaktuar kështu çrregullim të procesit mësimor për shkak të papërgjegjësisë së Qeverisë.

Andaj, është momenti i fundit që të ndërrohet praktika e rritjes së pagave me vendime arbitrare, në mënyrë diskriminuese, pa vlerësim të performansës së punës dhe vetëm për qëllime elektorale.

Dhe, fare në fund, pas po ju referoheni këtu personave të caktuar, me emra individual, kryesisht nga Lëvizja “Vetëvendosje”, duhet bërë me dije për qytetarët se as në një rast të vetëm deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk kanë vendosur e as nuk kanë përkrahur me votë pro apo në asnjë mënyrë tjetër vendimet për rritje të pagave, përkundrazi në të gjitha rastet e kemi kundërshtuar dallimin e madh të pagave dhe vazhdojmë ta kundërshtojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Korab Sejdiu e ka fjalën.

KORAB SEJDIU: Të dashur qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Kryesues,

U fol sot shumë për diskrepancën që ka mes rrogave ose pagave në sistemin publik, pajtohem që kjo çështje duhet të adresohet në mënyrë urgjente.

Mirëpo, njëkohësisht u përmend edhe dinjitetshmëria e pagave të zyrtarëve të lartë që unë besoj, fer ndoshta nuk është që kryeministri ta ketë pagën e 69-të në shtetin e Republikës së Kosovës, po detyrimisht është e dinjitetshme edhe paga e kryeministrit, edhe e deputetëve, edhe e shumë zyrtarëve të tjerë, veçanërisht duke i pasur parasysh rrethanat e Kosovës.

Po çështja e dytë për të cilën desha sot të diskutoj buron nga diçka çka u tha më herët lidhur me vendimin e Qeverisë për rritjen e pagave, ku u tha që qëllimi ka qenë t'i ndihmohet gjyqësorit, edhe nëse unë dyshoj në këtë, po e marrim si të mirëqenë. Dhe, u tha që s'ka asnjë mënyrë tjetër për të arritur këtë rezultat.

Unë e kam një lajm shumë të mirë për kryeministrin. Projektligji për gjykatat aktualisht është në Kuvend, nuk ka mënyrë më të mirë për t'i adresuar pagat e gjyqtarëve se sa nëpërmes projektligjit për gjykatat që shpresoj do të bëhet ligj për gjykatat.



Në fakt, e kam pasur pak një brengë dhe drojën që amendamentin që e kam planifikuar ta paraqes për rritjen e pagave gjyqtarëve, nuk do të gjejë përkrahje të mjaftueshme, por besoj që mund ta bëjmë një precedent të mirë këtu, ku kryeministri angazhohet për t' i ndihmuar opozitës me një nismë të mirë dhe të na e sigurojë mbështetjen edhe nga shumica parlamentare këtu që të rriten rrogat e gjyqësorit, pra nëpërmes Ligjit për gjykatat.

Kështu që, kryeministër, nëse do, po e marr si mbështetje tënden atë që e the më herët që ka nevojë të rriten pagat e gjyqtarëve, po e marr si një mbështetje të kësaj nisme që synoj ta kem, edhe nëse nuk përton, qohemi bashkë e ua urojmë rrogat e reja të rritura edhe gjyqtarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besa Baftiu e ka fjalën.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

I nderuar kryeministër Haradinaj,

Në fushatën zgjedhore një ndër premtimet tuaja ka qenë edhe rritja e pagave për 30% në tërë sektorin publik.

Mirëpo, në realitet ndodhi ajo që me të marrë mandatin ju, si kryeministër, puna e parë apo vendimin e parë që e keni bërë është rritja e pagës suaj dhe Kabinetit qeveritar, gjegjësisht rritja e pagës për 4% edhe të sektorit publik.

Ju, kryeministër, fillimisht jeni arsyetuar para publikut apo para gazetarëve se ju duhen siç e thatë edhe sot për blerjen jo të rrobave, jo të kravatave, e sot u arsyetuat se jeni të ranguar në listë të pagave apo kategorizimin e pagave i 69-ti, e për atë edhe ne nuk pajtohemi.

Mirëpo, po ju bëj një pyetje, a e keni shikuar listën deri në fund, a e keni parë ku rangohen mjekët, të cilët për një punë 24-orëshe, kur kanë kujdestari, paguhen shumë pak, e paga bazë e një mjeku specialist që mesatarisht avancimi profesional prej mjeku deri sa të bëhet specialist është diku 11 vjet, kështu që i duhet të bëjë një punë shumë me përgjegjësi dhe paga e mjekut është 640 euro, tani me këtë rritjen që e keni bërë prej 4%.

Prandaj, kryeministër, unë besoj se ju do të keni parasysh atë që e keni thënë në fushatë, ju do të rritni pagat e mjekësve, arsimtarëve, siç u tha edhe nga kolegët tanë këtu deputetë, se ka punëtorë të cilët janë punëtorë edhe të këtij Kuvendi e marrin pagë diku prej 130 deri 150 euro.

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Konsideroj që debati ka përfunduar. Radha është e kryeministrit, nëse e dëshiron fjalën, pastaj i propozuesit të interpelancës.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Me fillimin e punës në Qeveri kam kërkuar të vendosim disa parime në punë. Një nga primet ka qenë të mos ankohe mi për gjendjen që e kemi gjetur, të mos i shajmë ata para nesh, të mos merremi me ta, po mundësisht të bëjmë diferencën.

Sa ia kemi arritur të bëjmë këtë diferencë, kur ndodhin punët, ndoshta ditët nuk shihen më së miri, por vjen një ditë që i merr vesh qytetari i vendit, vendi, a jemi duke punuar a jo.

Nuk pres prej opozitës t'i miratojë punët e veprimet e të përshtatet, e ku di unë, por e pres njëfarë korrektësie, po ashtu.

Çka është kjo korrektësi që e kisha pritur? E keni parë, për shembull, tani është e padrejtë t'ia përmend emrin, po një kryetar partie është në shërim diku, ka qenë ish-kryeministër, kujdesem në çdo aspekt që fare të mos e sjell në temë, i uroj shërim.

Ruhem të mos e kthej në baza personale për nivel të pagave njëri me tjetrin. Nuk mendoj që është qëllimi, as juaji e as imi në këtë temë, është krejt normale që një rritje e pagave e tillë shumë herë më e madhe, e minimale, se e këtij, se e atij nuk është në rregull. A duam t'ia nisim diku, a duam të ndërrojmë diçka, qysh dua të ndryshojmë këtë vend, me diçka, diku duhet nisur. Ku po prek, nuk po bie tamam.

Disa po thonë këtu që s'e kemi ditur për gjyqësorin, po more, qysh nuk e kemi ditur. Kanë ardhur, na kanë treguar shifrën sa e qysh, tek, sa milionë, çka bëhet.

Kemi një takim të rregullt, punën nuk e bëjmë me media, po me rend e ligj, e quajmë të nivelit të lartë, i kem thirrur amerikanë e evropianë, po bisedojmë, e kemi biseduar gjendjen me ta.

I kemi bërë disa ndërhyrje direkte, kemi shtuar numrin e personelit, kemi shtuar buxhet shpenzues.

Kemi bërë disa përpjekje t'i forcojmë institucionet e rendit dhe të ligjit. Kemi përkrahur AKI-në, Policinë, jo për ta shtypur opozitën, se nganjëherë krijohet ajo përshtypje, ose gjyqësorin, nuk e kemi për ata, po të forcojmë një argument për liberalizim të vizave, e dini që është e ndjeshme.

Fokusimi ynë, kujdesi ynë ndaj gjyqësorit do të çmohet, në një mënyrë a një tjetër. Nëse qenka me ligj, se u tha me ligj duhet t'u rriten pagat gjyqtarëve, prokurorëve, shlyqyr, ta bëjmë, se është mirë, druaj që s'e bëni, se po të kishte qenë ashtu, e kishim bërë deri më sot. U diskutua pse s'ka

ndodhur nëpërmjet ligjit, pse nuk ka ndodhur nivelimi i pagave ose arsye të tjera. Nuk është operacion i lehtë nivelimi i pagave ose Ligji për pagat.

Dikush po e thotë shumë lehtë këtu, janë dhjetëra-mijëra njerëz, janë kushedi sa përgjegjësi, nuk është bërë ndonjë studim i mirëfilltë, për këtë e kemi kaosin e trashëguar, mund ta bëjmë një ligj shpejt e shpejt, po do një kujdes në këtë ligj që, të paktën kur ta kem një herë, të mund ta përfshijmë mirë, t'i respektojmë drejt kategoritë pra që marrin paga nga buxheti. Nuk do të shkojë aq thjesht, nuk është vetëm çështja e kostos. Po të ishte aq thjesht, e kishin bërë më herët qeveritë.

Unë kam kërkuar të ecet me këtë ligj, që të mos frikësohemi prej kësaj teme, po besoni, kur t'jua sjellim juve këtu, do ta shihni që nuk është ligj i thjeshtë, atëherë do ta vërtetojmë së bashku pse u vonua kaq shumë ky ligj. S sa më shpejt që e kemi të gatshëm, ne do të vijmë me ligj te ju, po është përgjegjësi pastaj e të gjithë neve çka bëjmë, se më s'mundemi t'ia lëmë fajin dikujt pse ia kemi lënë mjekut kaq, ose atij aq.

Mua po m'i përmendni pagat e specialistëve, të mjekëve. Po që 6 muaj erdha unë, që 6 muaj, ato paga i kam gjetur ashtu, edhe të specialistëve, edhe të mësuesve, edhe të policëve. I kemi rritur 4% në fillim të mandatit, nuk kemi pritur në fund. 300% timen, po 300%, po e shoh çka e keni, po nuk e ndryshon gjendjen e atyre, mos harroni. Edhe ju tregova për atë moralin e rrejshëm, unë nuk jam prej atyre, unë e di që njerëzit e lënë rrogën e lirë, shesin mend, jemi këta, e dimë çka bëjmë mandej.

Unë e kam marrë një rrugë tjetër, po dua të jem direkt, po dua të shpjegoj çka besoj dhe çka bëj.

Sido që të jetë, ju jeni Parlamenti, sido që të vendosni, e respektojmë, jo vetëm kaq, po sido që të vendosë Gjykata Kushtetuese ne e respektojmë, a mendoj që është veprim i duhur. Unë mendoj që kushdo që mban përgjegjësi të ndjeshmërisë së lartë publike duhet të ketë pagë të dinjitetshme, ajo është parakusht që t'u bëjmë pagat të tjerëve. Nëse ata që i mbajnë përgjegjësitë kryesore në këtë vend nuk i trajtoni me dinjitet, edhe në aspektin e pagës, kurrë s'do t'i bëhet zgjidhje pastrues, as atyre atje më poshtë që presin prej tyre.

**KRYESUESI:** Faleminderit!

Fjala është e propozuesve të interpelancës, pesë minuta, tani kush do të flasë prej jush. Albulena, zonja Haxhiu e ka fjalën.

**ALBULENA HAXHIU:** Natyrisht kemi shumë çështje për të diskutuar, por sigurisht që pati këtu një tendencë të devijimit të kësaj interpelance nga zoti Haradinaj.

Ndër vendimet e para të tij ishte vendimi i kundërligjshëm për rritjen e pagave, së paku zoti Haradinaj është dashur që të prisni për performansën tuaj, sepse ashtu-kështu të gjitha vendimet që tash së fundi i keni marrë, kanë qenë vendime të Qeverisë së kaluar, pra është dashur që të pritni pak në këtë drejtim për ta parë nëse e meriton a s'e meriton, apo të tjera si këto.

U përmendën shumë pagat e Gjqësorit. Më duhet ta them sikur Qeveria Haradinaj të ishte e interesuar t'i rriste pagat në sistemin e drejtësisë, sigurisht që do ta bënte me Ligjin për Buxhetin për vitin 2018. Ne e kemi pasur Ligjin për buxhetin, në dhjetor është miratuar në Kuvendin e Republikës, askush nga Qeveria, as zoti Haradinaj nuk ka propozuar që ky buxhet për pagat e gjyqtarëve dhe të prokurorëve të rritet. Dhe, ata për të cilët kanë nevojë më së shumti që t'u rriten pagat janë stafit civil përbrenda institucioneve të drejtësisë. Ata kanë nevojë, zoti Haradinaj për rritjen e pagave. Pra, ne e mbështetim edhe rritjen e pagave për gjyqtarët dhe prokurorët, kurdo që kjo të propozohet.

U munduam këtu që 2/3 e kohës t'i kalojmë ose të diskutojmë për pagat e Qeverisë, por vetëm 1/3 e kohës për pagën minimale dhe kompleksitetin që ngërthen rritja dhe zbatimi i saj. Tjetra, paga sado e lartë nuk e shmang korrupsionin e zyrtarëve të lartë. Dëshmi për këtë është pjesa më e madhe e këtij Kuvendi, por po ashtu edhe e Qeverisë, për shkak se pasuria e deklaruar e zyrtarëve të lartë publikë pëson rritje çdo vit. Shtrohet pyetja, si e rritët pasurinë nëse pagat janë të pamjaftueshme? Si e rritët pasurinë nëse s'ju paskan dalë pagat? Askush s'po e thotë që ta dëshmojmë ndershmërinë me spektaklin e varfërisë, por që Buxhetin e Kosovës ta ndajmë, ose t'ia ndajmë shumicës, e jo pakicës qeveritare.

Po ashtu, është për keqardhje deklarata e kryeministrit Haradinaj kur tha që personi që merr pagë 300 euro s'ka përgjegjësi. Zoti Haradinaj, për ju s'paska përgjegjësi ushtari, sepse ushtarët marrin paga 360 deri në 380 euro, polici, mësuesi. Pra, nuk po flas për oficerët, po flas për ushtarët profesionalë, siç i emërton edhe ligji. Pra, ata s'paskan përgjegjësi, rrjedhimisht pagat i paskan ashtu dhe s'meritojnë më shumë. Kjo është deklaratë skandaloze, zoti kryeministër. Skandaloze! Ne kemi propozuar, ka edhe shumë çështje tjera, por s'kemi minuta në dispozicion, i kemi vetëm edhe 2 minuta, ne i kemi propozuar tri rekomandime, por po ashtu në këtë debat pati edhe rekomandime të tjera. Ne si "Vetëvendosje" jemi që këto të votohen, por nëse kërkojnë deputetët natyrisht që mund të kërkojnë pauzë dhe të shkojmë që t'i harmonizojmë.

E para, shfuqizimi i vendimit nr. 04/20, i datës 20 dhjetor 2017, për rritjen e pagave, heqja e kategorizimit sipas moshës për pagën minimale dhe përshtatja e saj të bëhet në baza vjetore, referuar të dhënave social-ekonomike dhe tregut të punës dhe, e treta, lartësia e pagesës së skemës sociale për çdo vit të përshtatet në varësi të lëvizjes së çmimeve dhe standardit të jetesës sipas të dhënave zyrtare të Republikës së Kosovës.

Edhe një herë, ne e mbështetim rekomandimin e LDK-së që është procedimi i Ligjit për pagat në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sa më parë, por në qoftë se kjo mund të votohet tani, ne jemi për ta votuar tani, nëse ka edhe ndonjë rekomandim tjetër mund ta plotësojmë tash. I ftoj deputetët e Kuvendit që ta përkrahin këtë rezolutë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj do ta shfaqë mendimin sa i përket kësaj rezolute.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Është e lejuar, nëse s'është.

KRYESUESI: Ke të drejtë, unë ta dhashë fjalën!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Shiko, Albulenë shkurt: 300 euro ushtari, s'po di a e keni parë, këtu po thotë Ministria e Forcave të Sigurisë së Kosovës, FSK gjenerallejtënant... a mund të flas, a po do të flasësh, hajde a ke qejf... Ani, por prit një sekondë, veç duro një sekondë! Gjenerali po thotë i FSK-së, jo nëse do hajde urdhëro, të lutem, veç gjenerali po thotë 1 600 euro. A e ke ditur këtë? Veç po të pyes, a e ke ditur që gjenerali e ka pagën 1 600? Ani dëgjo, a po e sheh që brenda tyre po dalluaka përgjegjësia, njëri e paska 1 600, tjetri 300.

A dëshiron ta gjej edhe të shefit të tij, s'e kanë njësoj?

KRYESUESI: Zoti Haradinaj...

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Ti ke qenë deputete, pse s'ke ndërhyrë pra t'ia rritur?

KRYESUESI: Zoti Haradinaj, komuniko me të gjithë deputetët, e jo me një deputet, më mirë. Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Projektligji për gjykatat është në Kuvendin e Kosovës. Unë e dëgjova deklarinimin e kryeministrit që iu referua disa herë. Pra, qëllimin e tij që nëpërmjet këtij vendimi, edhe pagat e gjyqtarëve të preken. Ne duhet ta marrim sot mbështetjen edhe të tij, edhe të partisë së tij, që amendamenti që do ta bëjmë si grup parlamentar në Projektligjin për gjykatat të përfshihet rritja e pagave për sistemin gjyqësor.

Përtej kësaj, unë sugjeroj që ne të ulemi bashkë, t'i harmonizojmë rekomandimet që do t'i nxjerrim në votim dhe pastaj, pas pauzës, ta nxjerrim në votim. Faleminderit!

KRYESUESI: A doni ta votoni tani, apo pas pauzës? Në rregull, atëherë votimin e bëjmë pas pauzës. Shkojmë në pauzë deri në orën 15:15 minuta.

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Edhe një herë para se të futemi në votim, ju lus t'i zini vendet tuaja. Zoti Lushtaku, ulu të votosh këtu, kemi votim.

Në sallë janë 71 deputetë. Tekstin e përpiluar nga të dyja grupet parlamentare e keni marrë, sa u përket rekomandimeve. Debat ka përfunduar.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

*(Debat në sallë)*

Ju lus, mund ta merrni fjalën. Dil, merre fjalën, mos fol prej vendit! Kërkoje fjalën! Çfarë po do?

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Ju i keni përpara katër rekomandime që i kemi harmonizuar me grupet parlamentare. Askush, as deputetë individualë, por as grupet parlamentare nuk na kanë dhënë me shkrim ndonjë propozim tjetër, andaj këto i kemi përpara.

Por, ajo çfarë unë desha ta ngre këtu është që para se të fillojë procedura e votimit, zoti kryeministër shkoi te zoti Zenun Pajaziti për të kërkuar që të mos marrë pjesë në votim. Kjo është mbyetje e republikës parlamentare. Kjo është mbyetje e republikës parlamentare, për shkak se Qeveria nuk ka të drejtë të ndërhyjë në punën e Kuvendit dhe në mandatin e lirë të deputetit.

KRYESUESI: Ju lutem, mjafton! Regjia, mbylle foltore! Mjafton, mjafton!

Shiko, në rregull! Kryeministri, sa i përket pozitës dhe opozitës mund të komunikojë në mënyrën e vet që dëshiron, t'u thotë edhe në foltore "mos e votoni". Nuk është shkelje, kjo s'është kurrfarë shkeljeje. Edhe në foltore mund të thotë mos e votoni, edhe abstenoni, problemi është i deputetit qysh vendos. Për atë është "lobimi". Po, s'ka dert bre tash, a duam ta mbytim, a?!

Edhe një herë e përsëris votimin. Edhe një herë, të nderuar deputetë. Zenuni nuk është fajtor, a? Edhe një herë, ju lus! Po e përsëris votimin. Votojmë tani!

Në sallë janë 75 deputetë. Kanë votuar vetëm 50, 44 janë për, 5 kundër, 1 abstenim.

Nuk ka kuorum. Kur të bëhet kuorumi për të votuar, e votojmë prapë.

## **10. Debat parlamentar, sipas kërkesës së nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala dhe gjashtë (6) deputetëve nënshkrues lidhur me raportin e 100 ditëve të punës të Qeverisë së Republikës të Kosovës**

Nënkryetari i Kuvendit, zoti Kujtim Shala dhe 6 deputetët nënshkrues kanë parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me raportin e 100 ditëve të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

E ftoj zotin Shala që para deputetëve ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati.

Atëherë, zoti Avdullah Hoti, në vend të Kujtimit.

AVDULLAH HOTI: Zoti kryesues i seancës,

Me votimin që e pamë u konkludua që këtu në seancë që nuk ka kuorum për vazhdim normal të seancës. Durim, ju lutem!

50 veta kanë votuar, seanca nuk mund të vazhdojë më tutje me pikat tjera të rendit të ditës, pa u votuar kjo pikë. Nëse ka sjellje të tilla nga pozita, ne e kuptojmë që nuk i përkrahin këto rekomandime, është çështje juaja, por nëse sillet kështu pozita me këto rekomandime që ne sapo i propozuam, d.m.th. nuk merr pjesë fare, unë ju garantoj prej këtij momenti ne nuk e votojmë asnjë ligj, as për, as kundër, as abstenim.

Por, po ju them një gjë, seanca nuk mund të vazhdojë, sepse u konstatua se nuk ka kuorum. Ose kthehemi dhe i votojmë rekomandimet që i propozuam, përndryshe nuk mund të vazhdojë.

KRYESUESI: Ky është standard që gabimisht është vendosur, ç'është e vërteta, sepse deputetët që janë në sallë të mos votojnë, kjo s'ka asnjë kuptim, sepse për atë punë janë. Në krejt botën kështu funksionon. Por, është vendosur si praktikë. Ne mund të hidhërohemi nga pak kështu, po ndoshta na kalon hidhërimi. Nëse doni, unë edhe një herë e hedh në votim, nuk e di nëse e votojnë, apo jo. Po, kuorumi ka qenë 75 veta në sallë.

Edhe një herë për korrektësi me grupin tuaj parlamentar e konstatoj dhe e rikthej atë çështjen që e diskutuam në pikën e mëparshme të rendit të ditës dhe për votim.

Ju lus, ma konfirmoni kuorumin edhe një herë, sa veta janë në sallë?

Në sallë janë 82 deputetë.

Avdullah, zoti Hoti, kur të më futni llugave, bile më dëgjoni kur dua të ju raportoj. 82 deputetë janë në sallë. A do ta ktheni votimin edhe një herë? Edhe një herë votojmë. I votojmë

rekomandimet e propozuara, katër rekomandimet e propozuara nga zoti Avdullah Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, të nënshkruar nga Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Votojmë tani!

Atëherë, deputetët nuk duan të votojnë.

Atëherë, e vazhdojmë nesër pra seancën. E lëmë vazhdimin e kësaj seance pas mbledhjes së Kryesisë.

Nesër e kemi seancën tjetër. Unë kaq mund të bëj, më shumë s’mund. Ja ku është kryetari, në qoftë se dëshiron të ndryshojë ndonjë gjë... Mirupafshim!

\* \* \*



*E martë, 13 mars 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 8, 9, 13 shkurt dhe 1 mars 2018*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI: Të nderuar deputetë,  
I nderuar kryeministër,  
Kabinet qeveritar,  
Aktualisht në sallë janë të pranishëm 63 deputetë.

Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 8 e 9 shkurt dhe 1 mars 2018.

Fillojmë me shqyrtimin e pikave të papërfunduara, si në vijim.

***9. Votimi i rekomandimeve të interpelancës lidhur me Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 04/20, datë 20. 12. 2017 për rritjen e pagave të anëtarëve të Kabinetit qeveritar, Vendimin nr. 05/24, datë 12. 1. 2018, për rritjen e pagave për të gjitha kategoritë e të punësuarve që marrin pagë nga Buxheti i Kosovës, si dhe Vendimin nr. 15/24, datë 12. 1. 2018 për lartësinë e pagesës mujore për familjet në Skemën e Ndihmave Sociale***

Të nderuar deputetë,  
Diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 1 mars 2018, por në mungesë të kuorumit nuk janë proceduar rekomandimet për votim.

Para se të procedojmë me votimin e rekomandimeve, në emër të propozuesve e ftoj deputeten Albulena Haxhiu që para deputetëve t'i paraqesë rekomandimet e harmonizuara ndërmjet grupeve parlamentare Lëvizja “Vetëvendosje” dhe LDK.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Ndonëse ne i kemi harmonizuar qëndrimet dhe rekomandimet sa i përket kësaj pike, pra deputetët të cilët kanë shprehur interesim për të dhënë propozime, ne i kemi shqyrtuar të gjitha këto propozime dhe kemi rënë në dakord që para deputetëve t'i propozojmë këto:

#### R e k o m a n d i m e:

1. Shfuqizimi i Vendimit numër 04/20 i datës 20 dhjetor 2017 për rritjen e pagave të zyrtarëve të lartë;
2. Procedimi i Projektligjit për pagat në Kuvendin e Republikës së Kosovës;

3. Heqja e kategorizimit sipas moshës për pagën minimale dhe përshtatja e saj të bëhet në baza vjetore, referuar të dhënave socio-ekonomike dhe tregut të punës dhe

4. Lartësia e pagesës së skemës sociale për çdo vit të përshtatet në varësi të lëvizjes së çmimeve dhe standardit të jetesës sipas të dhënave zyrtare të Republikës së Kosovës.

Pra, këto janë katër rekomandime të cilat kanë dalë pas debatit që e kemi pasur, apo pas interpelancës që e kemi zhvilluar, dhe unë në emër të propozuesve i thërras deputetët që t'i përkrahin këto rekomandime. Faleminderit!

KRYESUESI: Të nderuar kolegë deputetë,  
Jemi në procesin e votimit të këtyre rekomandimeve. Aktualisht janë 71 deputetë në sallë. Por, kartelat i kanë të vendosura vetëm 59 deputetë.

Tash me votim elektronik. A ka mundësi, 71, 63, 62, futini kartelat në qoftë se nuk përtoni! Të votojmë në mënyrë elektronike.

Atëherë jemi gati për votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Të nderuar kolegë deputetë,  
44 deputetë kanë votuar, 43 për, një abstenim kundër.

Por, në këtë formë nuk kemi vendimmarrje të Kuvendit.

A ka mundësi të votojmë edhe kundër?

Jo, jo! Që nuk doni të votoni, unë vetëm edhe një herë po ia bëjmë rendin. Nuk po votojnë kartelat!

Atëherë, regjia, a ka mundësi ta shikojmë teknikisht situatën?

Ne po votojmë edhe një herë. E shihni që nuk ka fare reaksion të opozitës kur po votojmë për të dytën herë, fare nuk ka reaksion.

Kolegë deputetë,  
Të përgatitemi për votim!  
Regjia po na lajmëron se punojnë, por këta po votojnë, ky grupi i deputetëve, nuk po votojnë të tjerët.

Nuk po votojnë, ta kemi parasysh. Është e drejtë e tyre, deputetët kanë të drejtë edhe të votojnë, edhe të mos votojnë, edhe të abstenojnë.

Ndërkohë e dëshiron fjalën Shkumbini. Urdhëro! Shkumbin Demaliaj e ka fjalën të lutem.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Kryetar!

I nderuar kryeministër, Kabinet,

Kolegë deputetë,

Meqenëse të njëjtën kërkesë propozuesi e ka drejtuar drejt Gjykatës Kushtetuese për ta vlerësuar këtë vendim, besoj se ne nuk duhet të biem në këto standarde të dyfishta. Të presim çka po interferon dhe interpreton lidhur me kërkesën Gjykata Kushtetuese, pastaj çfarëdo vendimesh që marrim, deputetët mund të votojnë.

Kështu që të mos merremi me standarde të dyfishta, të vendoset një standard, ta ndajmë pushtetin legjislativ për Gjyqësorit, meqenëse janë drejtuar drejt Gjykatës Kushtetuese, propozoj që kjo të hiqet nga rendi i ditës, të presim çka po propozon Gjykata Kushtetuese lidhur me këtë çështje dhe këto rekomandime të shuhen. Faleminderit!

KRYESUESI: Ne në seancë duhet ta futim edhe një herë në votim. Po e futim edhe një herë në votim, në qoftë se nuk kemi sikur herën e kaluar, mbetet më çështje e hapur, është vendimmarrje.

Edhe një herë e lus regjinë dhe kolegët deputetë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

46 deputetë kanë votuar, 45 për, një abstenim.

Në mungesë të votimit mbetet çështje e hapur, në pritje.

Avdullah Hoti dhe Milaim Zeka e kanë kërkuar fjalën. Shefi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, urdhëro!

AVDULLAH HOTI: Kryetar!

Ju bashkë me Sekretarinë e Kuvendit e konstatuat që në Kuvend ka më shumë se 60 deputetë, 60 e sa deputetë. Deputetët nuk po marrin pjesë në votim, e kjo tregon që shumica në fakt nuk i ka votat për ta ndalë asnjë vendim, ne duhet të procedojmë qysh sot me shpërbërjen e Kuvendit, sepse nuk ka kuptim të shkohet më tutje. Nuk mund të kalojmë në pikën tjetër pa u kryer kjo pikë.

Ju e dini që nesër është vazhdimi i seancës tjetër, e ku është një listë e gjatë e ligjeve që s'mund të kalohen nga pozita, sepse nuk i ka votat. Nëse vazhdoni me këtë praktikë si shumicë

parlamentare, ne nuk do të marrim pjesë në asnjë votim tjetër dhe sot debati parlamentar nuk mund të vazhdojë më tutje pa u kryer kjo pikë.

**KRYETARI:** Faleminderit, kryetar i grupit parlamentar!

Më lejo vetëm të sqaroj proceduralisht: Është çështja e vullnetit të deputetëve votojnë a s'votojnë. Është çështje e deputetëve. Këtë s'kemi mundur t'ua imponojmë, e keni edhe praktikën e herëve të kaluara. Vendimmarrja është politike sido që të jetë. A po e përfundojmë këtë? Milaim? Edhe ai flet në emër të grupit parlamentar, hajde ti pastaj e udhëheq, si të duash, po tash po shkoj në bazë të rendit kërkoj falje, edhe Glauku do të flasë, edhe Teuta Haxhiu do të flasë.

**MILAIM ZEKA:** Faleminderit, kryetar!

Desha një sqarim për opinion publik. Ne si "Nismë" kemi biseduar me opozitën lidhur me rekomandimet e tyre dhe për hir të informacionit të opinionit dëshiroj ta bëj një sqarim. Opozita na ka thënë tekstualisht, zoti Avdullah Hoti, që ne kemi kauzë dhe kauza jonë është rrëzimi i Qeverisë.

Domethënë, nuk ka ardhur kjo rezolutë, këto rekomandime as për ulje, as për ngrirje të pagave. Ne kemi qenë për një kompromis, kompromisi ka qenë i mundshëm në qoftë se opozita nuk do të hidhej mbi Gjykatën Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese është forumi më i lartë legjislativ i këtij vendi dhe përderisa këta e kanë dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese, po shihet që këto rekomandime janë thjesht për ta bllokuar Parlamentin dhe për ta rrëzuar Qeverinë.

Prandaj, mbi bazën e kësaj, ne nuk marrim pjesë në votim. Ky është sqarimi. Po të donin këta të dilnin me rekomandime tjera ne jemi për, por edhe ta dërgojnë çështjen në Gjykatën Kushtetuese, edhe të dalim ne mbi Gjykatën Kushtetuese, kjo është e pakuptimtë.

**KRYETARI:** Faleminderit! Kisha kërkuar vetëm nga një prej grupeve parlamentare. Glauk Konjufca e ka fjalën.

**GLAUK KONJUFCA:** E para, dua të flas për moskorrektësinë tuaj profesionale lidhur me atë se si e interpretoni Rregulloren e Kuvendit. Duhet t'ua jepni me rend fjalën grupeve parlamentare dhe kjo shkon sipas ulëseve në Kuvend, sipas madhësisë së grupeve parlamentare. Nuk është hera e parë që po e shkelni këtë rregull dhe nuk është mirë.

E dyta, sa i përket kësaj metodologjisë së pushtetit dhe të mazhorancës këtu, po vërehet qartë që po udhëhiqet prej një principi. Principi është ky: "Ju do të jeni të dëgjueshëm si opozitë për gjithçka që ne kërkojmë të na e votoni, por ne nuk do të votojmë asgjë që ju propozoni dhe jo

vetëm që votojmë kundër, por nuk votojmë fare, duke e pamundësuar vazhdimin e seancës”. Atëherë nuk kemi rrugëzgjidhje tjetër, përpos që t’ua kthejmë me monedhën e njëjtë, me metodën e njëjtë, ama veç mos e harroni një gjë: nëse Kuvendi hyn në këtë cikël, që ne t’ua kthejmë në të njëjtën mënyrë, mos harroni që ju asnjë ligj s’mund ta kaloni dhe pamundësohet funksionimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Atëherë, nëse po e kërkon këtu patjetër, ajo do të ndodhë.

**KRYETARI:** Edhe nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe PDK-ja. Ta keni parasysh, unë nuk jap fjalë pa u lajmëruar. Duhet të lajmërohen kolegët deputetë, pastaj u jepet fjala në bazë të lajmërimit. Kështu ka qenë edhe mënyra e lajmërimit tash. Zonja Teuta Haxhiu, në emër të AAK-së, dhe Hajdar Beqa, në emër të PDK-së.

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, kryetar!

Kjo që po shihet sot nga dy grupet, edhe nga Grupi i “Vetëvendosjes”, por edhe nga Grupi i LDK-së, sidomos Grupi i LDK-së, meqë shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së e ka futur Grupin e LDK-së në një rrugë qorre, dhe vërtet kjo është më tepër se sa zhgënjyese për vetë qytetarët e vendit.

Sot, në vend që të dy grupet opozitare të kërkojnë me ngulm që Qeveria ta sjellë Ligjin e viteve të ‘90-ta, që është me interes, sepse pesë vjet nga marrja e vendimeve këtu në Kuvend, Qeveria e Republikës së Kosovës është obliguar që ta sjellë sa më parë Ligjin për punëtorët e viteve të ‘90-ta, për punëtorët shqiptarë të viteve të ‘90-ta.

Prandaj, nëse vërtet pret një numër rreth 50 ligjesh për të kaluar në Kuvend dhe kjo që po ndodh është më shumë se zhgënjyese, është një opozitë që nuk e ka seriozitetin për të punuar për vendin, është një pozitë që opozitarizmin po bën thjesht shumë të rrejshëm dhe më shumë se sa kjo që po shihet sot, qytetarët po e shohin që përderisa ne me shumë sinqeritet po e presim një vendim të Gjykatës Kushtetuese për të vepruar dhe ajo çfarë po ndodh sot nuk është për herë të parë.

Në mandatin e kaluar, e dimë se sa ka pasur Qeveria numër të deputetëve, por vazhdimisht ka ndodhur ajo sikur që ndodhi edhe sot. Pra, pikërisht nga LDK-ja kanë qenë ata që nuk kanë votuar në mandatin e kaluar, por edhe grupet e tjera.

Prandaj, ndryshojeni Rregulloren, kryetarja e Komisionit për Legjislacion do të duhej të punonte në drejtim që sa më parë të ndryshohet Rregullorja dhe të vendosen rregullat që të mos ndodhë kjo që po ndodh, por në fakt nuk është që sot kemi zbuluar diçka. Andaj, sjelljet e tilla tregojnë që këta nuk janë seriozë, pos problemeve të brendshme që kanë të dyja grupet, kuptohet

mësuesin, respekt për secilin mësues, por mësuesi i Grupit Parlamentar të LDK-së do të duhej të merrte mësimin nga ish-shefi për t'u sjellë tamam siç duhet si shef.

KRYETARI: HajdarBeqa, fjala për ju, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Përsëritje për të gjithë të pranishmit, kryeministrin,

Kabinetin qeveritar,

Kolegët deputetë dhe qytetarët,

Realisht opozita nuk ishte e sinqertë në kërkesat e veta dhe rekomandimet ishin harmonizuar vetëm me opozitën, ndërmjet LDK-së dhe “Vetëvendosjes”. Ne duhet ta respektojmë ligjin. E njëjta çështje u tha edhe nga kolegët e pozitës, që adresuan Gjykatën Kushtetuese si organ më i lartë për interpretimin e vendimeve të në kuadër të Kushtetutës.

Konsideroj që nuk duhet të interferojmë në gjykatën, duhet ta presim vendimin e saj dhe unë them që ajo që vjen nga gjykata, u pohua edhe nga Qeveria, do të respektohet 100%. Sa i përket deklaratimit të zotit Konjufca që nuk po respektohet Rregullorja, Rregullorja po respektohet, se ky ishte një vazhdim i seancës, ishim një pikë të votimit dhe shefave të grupit nuk u jepet fjala kur jemi në votim. Nuk pati vota të mjaftueshme, nuk është hera e parë që kemi kesi rasti. Kemi shpesh raste që “Vetëvendosja” është sjellë njëjtë, apo LDK-ja, prandaj unë propozoj që të bëhet një pauzë dhe të kërkohet një konsultim ndërmjet shefave të grupeve dhe kryetarit për ta vazhduar seancën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi një situatë kur është shumë e qartë, është çështje politike, është legjitime, pavarësisht sa është korrekte, sa është morale, ajo është çështje tjetër. Kur opozita e vëren që s'janë 61 vota nga pozita, natyrisht e bllokon seancën në shumicën e rasteve. Janë rreth 15 projektligje, të cilat do t'i kemi edhe nesër në fakt, të cilat kanë mbetur vetëm në mungesë të votimit. Por, deputetët kanë të drejtë që të votojnë, ose të mos votojnë. Do të thotë, qoftë pozitë, qoftë opozitë.

Kryeministri e ka kërkuar fjalën. Fjala për kryeministrin.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

Të nderuar deputetë, në këtë rast të pozitës, më vjen keq që opozita s'është këtu që t'i dëgjojë këto fjalë,

Kolegë të Kabinetit qeveritar,

Është shumë me rëndësi ta themi kush e zbuloi këtë praktikë. Unë kam qenë në seancë, si kryetar i Qeverisë, me ligjet që janë direkt të drejtuara dhe që e ndihmojnë jetën e qytetarëve të vendit dhe e kam parë opozitën kur ka pritur ta shohë nëse i kemi 61 vota, që të mos na e bëjë kuorumin. Pra, këtë e kam vërtetuar, e kam përcjellë prej këtu, për tema krejt të zakonshme të

jetës të njerëzve të këtij vendi. Kanë pritur që të shohin a po bëhen 61 deputetë për të vlerësuar a të marrin apo jo pjesë në votim. Me këtë, kjo praktikë e nisur prej tyre sot nuk po u pëlqen.

Çka mund të ndodhë në të ardhmen me këtë? Nëse opozita ka tema që dëshiron t'i ndihmojë qytetarët e vendit, gjithnjë mund të llogarisë në përkrahjen e secilit, por nëse opozita e ka për qëllim vetëm pengimin e punës së Parlamentit me propozime çfarë po i shohim realisht, imagjinojeni tani kërkojnë debat për 100-ditëshin, u harrua ajo temë. Ç'është qëllimi i këtij debati? Nuk kërkojnë debat për ndonjë temë të menjëhershme që u dhemb qytetarëve të vendit! Njëfarë opozitarizmi pra krejtësisht i paargumentuar, i pashpjegueshëm, që po ndodh. Të ju them të drejtën, edhe koha është çmuar. Shiheni sot! Ministrat përkatës, shumica e tyre është mirë të jenë në tema, në punë, t'i kryejnë punët, detyrat që i presin këtë vend, përfshirë edhe mua.

Ne kemi provuar vazhdimisht të vijmë që ta respektojmë Parlamentin, mirëpo a besoni që ka raste të caktuara kur jemi këtu, me respekt për deputetët, por temat nuk janë adekuate, nuk janë të rëndësishme dhe po ia humbin kohën Ekzekutivit, deputetëve, pra Parlamentit dhe qytetarëve të vendit. Besoj që partitë politike opozitare duhet ta kuptojnë që edhe për të bërë opozitarizëm ekziston njëfarë standardi që duhet praktikuar në këtë rast, në rastin konkret pra si temat e sotme. Ne i kemi bërë shpjegimet e nevojshme, vetë e kanë dërguar në Gjykatën Kushtetuese, dhe është standardi më elementar që përderisa një lëndë është në Gjykatën Kushtetuese, si rasti konkret, ose në një gjykatë të caktuar, Legjislativi nuk merr vendime për këtë lëndë, ose për këtë temë.

Pra, shumica e këtyre, sikur të ishim ne në pozicionin e tyre, sot ku me ditë çfarë kishin diskutuar dhe çfarë kishin thënë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër! Ne në mungesë të kuorumit, po shihet qartë që nuk kemi, unë do t'i ftoj kryetarët e grupeve parlamentare për një konsultim. Do ta kemi një pauzë, e pastaj shohim për mundësinë e vazhdimin apo shtyrjes së kësaj seance të hapur.

Takohemi me kryetarët e grupeve parlamentare tash menjëherë, në zyrën time. Faleminderit!

\* \* \*

### *Pas konsultimit*

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,  
Në rrethanat në të cilat jemi, vazhdimi i seancës do të jetë nesër, me pikat e mbetura. Vazhdojmë nesër. Faleminderit!

*E mërkurë, 14 mars 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 8, 9, 13 shkurt dhe 1, 13 mars 2018*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Në sallë aktualisht janë të pranishëm 78 deputetë, ndërkohë janë duke ardhur edhe deputetë të tjerë.

Jemi në vazhdimin e punimeve të seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, filluar më 8, 9 shkurt dhe 1 e 13 mars 2018.

Jemi në pikën e rendit të ditës:

***9. Votimi i rekomandimeve të interpelancës lidhur me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, numër 04/20 të datës 20 dhjetor 2017 për rritjen e pagave të anëtarëve të Kabinetit qeveritar***

Jemi në procedurë të votimit.

Lus kolegët deputetë të përgatiten për votim, regjia, votojmë tash:

86 deputetë kanë votuar, 39 për, 45 kundër dhe 2 abstenime.

Kuvendi nuk i miratoi rekomandimet e propozuara nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Urdhëro, zoti Mikullovc, s’ke mundur të votosh, atëherë a mund ta deklarosh votën?

*(Ndërprerje e incizimit)*

A ka mundësi të ngritën duart, sa vetë. Vetëm pak, qetë, ju lutem. Jemi para qytetarëve, ne e dimë listën si ka votuar, kush s’ka votuar, le ta ngritë dorën edhe pastaj e verifikojmë, sa kanë votuar në mënyrë elektronike, sa po pretendojnë me dorë.

Fillimisht, a bën me ngritje duarsh, kush nuk ka votuar në mënyrë elektronike.

*(Reagime nga salla)*

Visar Ymeri, Fisnik Ismajli, Dukagjin Gorani...

*(Ndërprerje e incizimit)*



Po e bëni problem pa pasur nevojë. Më falni, vetëm pak, askush vullnetin e askujt nuk mund t'ia tjetërsojë, po improvizoni pa nevojë, në këtë formë nuk zhvillohet lufta politike, me dhunë s'mund ta ndërroni vullnetin.

A ka mundësi kryetarët e grupeve parlamentare një minutë, bashkë, këtu.

*(Konsultime)*

Atëherë e përfundoj pikën e parë. Kryetarët e grupeve parlamentare nuk po dëshirojnë, vazhdojmë me pikën e dytë.

A dëshironi të takohemi me kryetarët e grupeve parlamentare, po, jo. Unë nuk e përcaktoj, i kemi edhe mediat, kjo ishte në votim, tani është ora 10:20. Mos manipuloni, se nuk keni nevojë.

Po, s'mund ta përsëris unë çdo pesë minuta, derisa t'ju bëhet juve tamam.

*(Konsultime)*

Për hir të opinionit publik, po vërehet tendenca të manipulimit shumë të madh. Do të shkojmë edhe një herë në votim, ta qartësojmë, vetëm se në këtë formë po të ishte e kundërta, opozita kishte thënë: "Kemi votuar një herë".

Është koha të futen në seancë, ne nuk mund të presim deri t'i kryejnë punët e shtëpisë, tash edhe tre minuta i keni, të gjitha grupet parlamentare, pozitë e opozitë dhe rezultati del.

Jo, janë duke i pritur grupet parlamentare deputetët për përforcime. Dëshirovat të mbahet seanca në këtë formë, shihni garën, jo tre, tre, ja i kemi lënë tre edhe votoni.

A ka dikush pa kartelë, këta të cilët janë të pranishëm. Asnjë nuk është pa kartelë, 103 dhe i 104-ti e futi kartelën.

104 deputetë janë të pranishëm, edhe dy minuta vijnë përforcimet e të dy palëve dhe shkojmë në votim.

Në mënyrë publike, edhe dy minuta, kush vjen në sallë, më nuk presim askënd.

A ka nevojë të presim ende, a jeni përforcuar, s'ka më.

Atëherë mirë jemi të gjithë. A ka dikush pa kartelë? Nuk ka! Aktualisht janë 106 deputetë në sallë, 106 kartela janë vënë.

Regjia të përgatitet për votim, i votojmë rekomandimet e interpelancës lidhur me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 04/20 datës 20 dhjetor 2017 për rritjen e pagave të anëtarëve të Kabinetit qeveritar.

Votojmë tash!

107 deputetë kanë votuar. 49 për, 58 kundër. Ju lutem! Ju kisha lutur për hir të korrektësisë. Unë e bëra me qëllim edhe një herë të futemi në votim, vetëm këtë precedent do ta ndjekim çdo herë në momentin kur ka shqetësime, qoftë për pozitë, qoftë për opozitë, ta keni parasysh.

***10. Debat parlamentar sipas kërkesës së nënkryetarit të Kuvendit, zotit Kujtim Shala dhe gjashtë deputetëve nënshkrues lidhur me raportin e 100 ditëve të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës***

Nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala, dhe gjashtë deputetët nënshkrues kanë parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me raportin e 100 ditëve të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ftoj nënkryetarin e Kuvendit, zotin Kujtim Shala, në emër të deputetëve nënshkrues ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati.

Avdullah Hoti e ka kërkuar ndërkohë fjalën, kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, do ta paraqesë edhe kërkesën për debat parlamentar. Urdhëroni!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Raporti për 100 ditët e qeverisjes u dorëzua në Kuvend me pompozitet, ne kemi pritur që ky debat të kërkohej nga vetë kryeministri për të prezantuar dhe për të mbrojtur punën e tij. Kryeministri po i ik përballjes me deputetë dhe praktikën e zakonshme parlamentare po shihen që e kanë të pamundur të ballafaqojnë kryeministrin me deputetët. Kështu që e vetmja mënyrë për neve për të debatuar në Kuvend është përmes interpelancave dhe përmes debateve, të cilat po shtyhen nga pozita pa fund.

Prandaj, tash kërkesa jonë për debat për 100 ditë, në fakt është debat për 200 ditë, më saktë për 188 ditë të qeverisjes. Po nisem nga premtimet, vetë koalicioni është themeluar për punë të mëdha: themelimi i shpejtë i Forcave të Armatosura të Kosovës, zotimi se kufiri me Malin e Zi do të vendoset në Çakor e në Kullë, heqja e vizave për 90 ditë, rritja e pagave për 30%, rritja e pensioneve për 25%, ulja e importeve me Serbinë, rifunksionalizimi i Trepçës, gjetja e zgjidhjes për pensionistët minatorë brenda 90 ditëve, vendosja e Republikës së Kosovës për të gjitha çështjet, e jo nën ndikimin e Beogradit, rregullimi i problemit me energjinë, transparencë dhe llogaridhënie në Qeveri.

Të gjitha këto kanë mbetur vetëm fraza të thata të fushatës. Në vend të realizimi të punëve të mëdha, kryeministri është kujdesur që të emërojë pesë zëvendëskryeministra, 21 ministra dhe mbi 70 zëvendësministra në gjithë Qeverinë. E ka urdhëruar ministrin e Arsimit të shkarkojë Bordin e Agjencisë së Akreditimit dhe kemi debatuar pasojat e kësaj në këtë Kuvend. E ka dyfishuar pagën për vete dhe për vartësit e tij, por që u detyrua të pezullojë këtë vendim nga presioni i opozitës dhe nga vendimi i Agjencisë Antikorrupsion, vendosi të falë 58 milionë të hyra të parapara për buxhet, por prapë u detyrua të anulojë këtë vendim. U përfshi direkt kryeministri në shpronësimin në Hadë dhe në Shipitull, në janar të vitit 2018 importet nga Serbia u rritën për 50% krahasuar me janarin 2017, Bordi i Trepçës nuk u funksionalizua, më 5 qershor 2017, të nderuar deputetë, Haradinaj, Veseli dhe Rrahman Jashari nënshkruan memorandum, por premtimet nuk po i realizojnë dhe Sindikata e Arsimit po i shton masat sindikale. Të hënën gjysmë milioni nxënës dhe studentë kanë humbur orët mësimore, e kemi parë një vendim të madh në natën e 22 dhjetorit 2017, ku miqtë tanë ndërkombëtar e bënë të qartë që do ta izolonin Kosovën në rast se do të ndërmerrej aventura për shfuqizimin e Ligjit për Dhomat e Specializuara.

Vendim tjetër i madh i kësaj shumice parlamentare është Ligji për amnistinë që shpejtë do të vijë këtu në Kuvend, shkarkimi joligjor i bordeve që janë nën kompetencë të Kuvendit të Kosovës, zbrazja e rezervës shtetërore, në 188 ditë të qeverisjes janë ndarë 5.6 milionë me vendimin e Qeverisë nga rezerva shtetërore që është pesëfish më shumë se sa 200 ditët e para të qeverisjes së kaluar.

Të nderuar deputetë,

Këto dhe vendime të tjera dhe i gjithë raporti 100-ditor reflektojnë mungesën e kompetencës për të qeverisur, reflektojnë mashtrimet elektorale. Tanimë është e qartë për secilin qytetar, edhe për vetë partnerët e koalicionit, se nuk janë për punë të mëdha: ushtria mbetet e kushtëzuar nga njëri partner i koalicionit, demarkacioni doli që ka qenë kauzë e rrejshme, duke i lënë qytetarët e izoluar për tre vjet dhe tash po kthehemi te marrëveshja fillestare. Dialogu me Serbinë po zhvillohet pa platformë dhe me transparencë zero, kryeministri kishte deklaruar gjatë fushatës se askush s'do ta mund Kosovën asnjëherë, as korrupsioni. Kosova po na thërret që ta mundim korrupsionin, krimin dhe terrorizmin, kishte thënë ai, por liberalizimi i vizave edhe tash nga Komisioni Evropian është kthyer kriteri i luftës kundër korrupsionit.

Të nderuar deputetë,

Në raport ka tendenca për mashtrim të opinionit, 90% e të hyrave janë të qeverisë së kaluar, siç është rasti te kontrata për "Kosovën C", marrëveshja me korporatën e sfidave të mijëvjeçarit, të bërit biznes dhe renditja e Kosovës në vendin e dhjetë në botë, që është për shkak të reformave të Qeverisë Mustafa, sjellja në Kuvend e krejt projektligjeve të përgatitura në qeverinë e kaluar, pakvoja fiskale që është lënë e gatshme, gjithashtu. Në raport ka edhe plot anomali, në fakt, si është e arritur e 100-ditëshit ndarja e mjeteve për 2018 për trajtimin e qenve endacakë, kur kjo

çështje është kryer në qeverinë e kaluar, ose në faqe gjashtë e arritur konsiderohet ndarja e 25 mijë euro për festat e fund vitit për fëmijët e komunës së Leposaviqit.

Ose, ta zëmë, e arritur e Ministrisë së Drejtësisë është kryerja e 87 autopsive, e arritur e Qeverisë është edhe nxjerrja e akteve ligjore nga komuna, raporti e tregon mungesën e çfarëdo plani për reforma ekonomike, është vërtetuar tanimë që rritja ekonomike e propaganduar prej 7% ka qenë vetëm për qëllime elektorale. Në raport nuk jepen informata për humbjet buxhetore nga kontrata për pasaportat, nga humbjet që mund të vijnë tash nga “Axos Capital” pasi është kryer seanca përfundimtare, nga rasti i PTK-së me Z-Mobile dhe plot kontrata të tjera të dëmshme.

Të nderuar deputetë,

Këto janë arsye të mjaftueshme se kjo qeveri nuk di të udhëheqë, kjo qeveri nuk duhet të udhëheqë, kjo qeveri nuk i përmbush pritjet për integritet euro-atlantike që kanë qytetarët e Kosovës. Nuk mund t’i përmbushë pritjet e kosovarëve për jetë më të mirë. Asnjëherë nga mbarimi i luftës nuk ka pasur më shumë mllef në shoqërinë kosovare. Situata ekonomike dhe sociale mund të ketë qenë më e keqe, por gjithmonë ka pasur shpresë për një të ardhme më të mirë. Prandaj, unë sot ftoj që të bëhemi të gjithë bashkë, të marrim disa vendime të mëdha, siç është ratifikimi i demarkacionit dhe të organizojmë sa më parë zgjedhje të lira. Të mos lejojmë thellimin e krizës dhe humbjen e shpresës në shoqërinë tonë, të bëhemi bashkë që ta ruajmë këtë vend nga kjo qeveri, të bëhemi bashkë që të kthejmë normalitetin në institucionet e vendit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj, e ka kërkuar fjalën. Faleminderit, zoti Hoti!

**KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ:** I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Kadri Veseli!

Nënkryetarë të nderuar,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Media,

Qytetarë,

I nderuar zoti Hoti, e kam harruar përmbajtjen e raportit 100-ditor, se e kam dorëzuar që një 100 ditë në qeveri.

Nëse është 188, po mundohem t’i mbaj në mend këto 88 ditë çka ka të re, diçka që ka ndodhur e është me rëndësi. E vërteta është se janë disa tema që e rëndojnë Kosovën, e kanë rënduar. Ju e cekët dialogun, është temë që vazhdon, që e rëndon Kosovën dhe besoj që është mirë që në Parlament kemi diskutim për dialogun, pra të diskutojmë një herë grupet parlamentare, të gjithë, dhe ndoshta të vendosim si do të përfaqësohemi dialogët, që LDK-ja të ketë njerëzit e vet në dialog, edhe “Vetëvendosja” që të mos jetë dialogu i njërit prej neve, por i të gjithë neve, mendoj

se do të ishte në dobi për vendin kjo, kështu do të sigurohej edhe transparenca, por edhe do të kishim garanci se çka do që vendoset, është e Kosovës, e jo e dikujt prej nesh

T'ju them të drejtën, do ta përkrah këtë qasje të tillë dhe e di që një qasje e këtillë ekziston te partnerët e koalicionit qeverisës. Pra, ju lutem, kur të ekzistojë mundësia, të kalojmë në këtë temë. Edhe demarkacioni me Malin e Zi e ka rënduar Kosovën, e rëndon edhe sot, vërtet që Qeveria aq sa ka mbërritur dhe sa ka pasur mundësi edhe hapësirë vepruese, ka ndihmuar që kjo temë të marrë epilogun e duhur. Një komision i ri, një raport me marrëveshje mes dy presidentëve, një materie e respektueshme para jush. Mendoj që Qeveria këta ka mundur ta bëjë, e ka bërë, e ka sjellë këtu, e vërteta është që ne në koalicion qeverisës nuk kemi pasur një marrëveshje paraprake me njërin nga partnerët e koalicionit qeverisës, me Listën serbe, për një temë të këtillë, sepse edhe një pjesë jona s'kemi qenë për këtë temë, ende s'e kemi një dakordim të tillë, jemi në pritje të ndonjë opsioni votues, por që është kredibil dhe që është në dobi të vendit. Nuk po e thelloj më shumë përpos që e di që kjo temë është ngarkesë për Kosovën, jam i interesuar që ta zgjidh.

Sa i përket ushtrisë, po më vjen keq që më duhet ta them e ta përsëris, por është LDK-ja ajo që e ka lënë Kosovën pa ushtri. Kam qenë në takime në Ambasadën Amerikane, na kanë thirrur në atë kohë mua, presidentin Thaçi, kryeministrin Mustafa, Behxhet Pacolli është dëshmitar, Ambasada Amerikane, i kanë edhe transkriptet e takimeve, mund të pyetni a është kështu dhe do t'ju tregojnë a është kështu a s'është. Na e kanë ofruar ushtrinë më 2014, kemi pasur vetëm një mandat, pra për katër vjet për t'ua dhënë ulëset e rezervuara serbëve.

*(Ndërrhyrje)*

Me leje, a po doni të dilni tash, flisni, e pastaj unë po ju pres, në rregull. Si ta kryej, merreni fjalën.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Ju lutem, mos e pengoni!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: LDK-ja ka dashur të bëhet patriote atëherë, kanë dashur të marrin 1% votë më shumë, na kanë quajtur "tradhtarë" që po ua jepim një mandat për katër vjet, na keni lënë pa ushtri, pyetni amerikanët, në mos më besofshi mua, shkoni në Ambasadën Amerikane, i gjeni transkriptet, e di që disa prej jush keni komunikim vetëm ashtu, e keni lënë Kosovën pa ushtri që dhjetë vjet, keni shitur patriotizëm atëherë, e di qysh.

Më mirë ka qenë të kishim ushtrinë, ishte kryer ai mandati, katër vjet. O zotni, me tekst i shkruar, një mandat, me amerikanët, për të cilët po besojmë se janë garanti kryesor për gjithçka, ata i ke

pas garant. Po jeni ulur atje e keni thënë qysh e fitojmë 1% më shumë votë, duke u shitur patriotë e duke i quajtur ‘tradhtarë’ të tjerët, e keni bërë e ja ku jemi sot. Por duhet ta riparojmë atë dëm që e ka bërë LDK-ja, nuk jua kisha thënë sikur të ishit sjellë pak më kujdesshëm, por kur po i hapni temat, t’i hapim deri në fund. Ka transkripte për këtë, ka njerëz të gjallë, ka dëshmitarë.

E vërtetë është, besoni, nuk e them as për votë, as kundër votave, as për kurrgjë, por kjo është e vërteta dhe tash jemi në proces, kësaj teme t’i japim epilog. Ani, ani, disa prej jush ndoshta nuk e dini që ka qenë kështu, por ka me siguri edhe në këtë tavolinë që e dinë.

Arben Gashi, nëse ke qenë atje, je duke rrejtur sot. Jo, s’është ashtu! Shkoni në Ambasadën Amerikane, merrni letrat. Je duke rrejtur sot prapë...

Rrej e rrej sa të duash... sa të kesh qejf, por janë shumë që e dinë që është kështu. Janë shumë që e dinë se është kështu. E ke në partinë tënde që e di, do të të demantojnë ndonjëherë.

KRYESUESI: Arben, të lutem, e merr fjalën... Të lutem, zoti kryeministër! Arben, ulu dhe mos ofendo prej vendit!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Je kah rren, o vëlla! Je kah rren pastër, pastër je kah rren. Hiç, s’është ashtu!

KRYESUESI: Arben, po përdor fjalor dhe po sillesh keq. Të lutem! Të lutem, le ta kryejë ky, pastaj fol ti, i ke dhjetë minuta. Edhe armeni mund të flasë 10 minuta. Ky e ka ekspozenë e vet dhe mos e pengoni njeriun. Detyra e tij është të raportojë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Dëgjoni, nëse është me Rregullore që të bëhet interaksion kështu, pa e kryer njëri, jam në faj unë çfarë po të them. Nëse është në Rregullore ta kryejë njëri fjalën e ti të kyçesh, atëherë ti ke faj vëllai im. Ani, pritni pra sa ta kryej. A po doni të flisni? Hajde një herë, thuaje dhe dalim. Kryetar, a bën t’ua japë fjalën dhe e marr prapë, se s’po mund të durojnë. A po doni ta merrni tash, nëse doni urdhëroni. Jo, s’ka problem, nëse është rregull.

Shikoni... jo, nuk është problem, nëse s’po ju durohet të prisni derisa ta kryej, njëmend po e lë të flas, po unë s’po mund edhe të ju dëgjoj, edhe të flas.

KRYESUESI: Zoti kryeministër, mos komunikoni me ta. Lexoje ekspozenë tënde, ata këtë punë e kanë që të detyrojnë ty të nxelesh dhe të flasësh me ta, e jo ta bësh ekspozenë që e ke.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I dashur Avdullah,  
Para disa ditësh e kemi nënshkruar një projekt, të cilin edhe ju keni meritë, LDK-ja. Ai projekt është Parku Inovativ Trajnues në Prizren. Është nisur në qeveritë e mëhershme, i ka ardhur puna,

e kemi kryer. Është bukur lajm i mirë për Kosovën, flamuri i gjermanëve ushtarakë vazhdon të valojë në Prizren, por tash ekonomik. Ndoshta e keni shënuar këtë ngjarje, prita që po e përmend dikush, e ta thotë bile një gjë të mirë, apo ndoshta s'keni pasur mundësi. OK!

Qeveria e vendit është boll në telashe. Arsimi s'është mirë. Po punojmë, nuk po themi se çdo veprim është perfekt. Në shëndetësi kemi vështirësi, se gjendja është e rëndë, e kemi gjetur qysh e kemi gjetur. Në të gjitha jemi duke punuar. Nëse jeni të interesuar të debatoni për tema konkrete të qeverisjes, beso s'përtojmë.

Për këtë 100-ditëshin përnjëmend e kam harruar raportin. Për këto 88 ditë do të mundohem të shpjegoj çka është tash. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kush dëshiron replikë? Po, ta ka përmendur emrin, replikë zoti Gashi. Jo, jo, prisni! E keni fjalën me rend, tash një replikë e ka. Ju të gjithë s'mund të replikoni pse ka folur kryeministri. Zoti Gashi e ka fjalën, tre minuta.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Zoti Haradinaj,

Ne të njohim për burrë të fortë dhe trim, por mos mendo as ne nuk jemi të ligj, e para.

Po flas dukagjinçe për t'u marrë vesh më mirë, meqë retorikën e ke dukagjinçe. Për të tjerat, kam qenë dëshmitar, kur është diskutuar çështja e formimit të ushtrisë, kam qenë pjesëmarrës, ti nuk ke qenë i pranishëm. Në emri tënd kanë qenë të pranishëm Ardian Gjini dhe Blerim Shala. Ajo që po thua këtu është e pasaktë dhe jam i gatshëm të ta dëshmoj personalisht dhe publikisht, kur të duash.

Ofendimet "rrenë" e fjalë të tjera nuk janë në gjuhën parlamentare dhe të këshilloj, në daç dukagjinçe, në daç kosovarçe, në dash shqiptarçe, mos i përdor, sepse nuk janë në të mirë as të Kuvendit, as në tënden. Faleminderit!

KRYESUESI: Ke të drejtë kundër-replikë dhe e mbyllim. Zoti Haradinaj, kundër-replikë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Arben, faleminderit për korrigjimin në shprehje. Ke të drejtë, e tërheq, më vjen keq që e përdora atë fjalë, sigurisht po ta them kështu. Edhe pjesa tjetër është kjo, materia për të cilën fola.

Unë po e vlerësoj që ti e ke një pikëpamje të caktuar dhe po e mbron, edhe bindje, edhe pikëpamje, e ndoshta edhe kujtesë nga ajo ngjarje, por me krejt çka di, edhe krejt çka ekziston sot, me dokumente, po të siguroj që ke në këtë sallë plot njerëz, këtu në këtë sallë, qoftë të

komiteteve, qoftë tanët, që kanë qenë në takim, që na është ofruar dhe e kemi pasur dakordimin e serbëve për ta votuar ushtrinë në atë kohë. Këta janë tjerë, këta janë tjerë, o ti Kujtim. Ah...

*(Debat në sallë)*

OK, OK!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj, uluni, lëri këto. Fjalën e kanë kryetarët e grupeve parlamentare. Zoti Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”. Rregullat janë rregulla. Të gjithë e keni fjalën tuaj.

GLAUK KONJUFCA: Kur të dalim në këtë foltore, tash meqenëse është tema për qeverisjen, duhet ta bëjmë pyetjen kryesore: Çka dallon kjo qeverisje prej qeverisjes së kaluar? Dhe, mua po më duket se i vetmi dallim është që kryeministri vrapon më shpejt. Kurrfarë dallimi tjetër nuk po shoh prej Qeverisë së kaluar.

Kjo Qeveri filloi me një premtim, që ishte premtimi për reformimin e saj, sidomos lidhur me madhësinë. Por, si po shkon puna, kësaj Qeverie do t’i nevojitet edhe një ministri shtesë, e kjo do të jetë “Ministria e Zëvendësministrave!”. Aq shumë zëvendësministra ka, sa që na duhet një ministri për t’i menaxhuar zëvendësministrat. Ata nuk e dinë çka bëjnë, nuk e dinë sa janë, nuk e dinë ku janë, kështu që kjo tregon se Qeveria nuk e ka fare hall Kosovën dhe problemet e qytetarëve dhe bile as nuk ka kohë të merret me problemet e qytetarëve. Shumica e kohës kësaj Qeverie do t’i shkojë duke u marrë me vetveten, me menaxhimin e vetvetes.

Dhe, kjo ndodh për shkak të mënyrës se si është krijuar kjo Qeveri. Duhet t’i shkojmë problemit në origjinë. Për ta krijuar këtë mazhorancë kaq të brishtë parlamentare këtu në Kuvend, Qeverisë i është dashur që një partie me 3 deputetë t’ia japë 3 ministri, Listës serbe t’ia shtojë një ministri më shumë sesa e ka pasur gjithmonë dhe një subjekti politik, i cili as që ka garuar në zgjedhje, por ka arritur ta fitojë një deputet, i është dashur t’ia japë një ministri. Ky është problemi i kësaj Qeverie.

Pra, kjo është Qeveri e pazareve dhe këtu ka qenë fokusi te pushteti si i tillë, te pushteti si qëllim. Kjo është pikërisht arsyeja pse nuk kemi pasur kurrë ligj për Qeverinë deri tash. Sa qeveri janë ndërruar në Kosovë? Qe 17 vjet ne kemi qeveri, e asnjëra prej tyre nuk e ka sjellë në Kuvend Ligjin për Qeverinë. Shtrohet pyetja, pse? Sepse, secila qeveri që vjen për hir të pushtetit bën çka t’ia dojë qejfi me strukturën e Qeverisë, me numrin e ministrive, me numrin e zëvendësministrave, e besa edhe me numrin e zëvendëskryeministrave. Pra, ajo fjala e famshme e Ramiz Lladrovci që “ligji është si llastiku”, vlen sidomos për Qeverinë. Qeveria është si llastiku, për arsye se këtyre qysh t’u konvenojë e modifikojnë dhe e modelojnë Qeverinë, e qëllim është pushteti. Ky është problemi i parë.



Problemi i dytë është që e kemi një vartësi të frikshme të kësaj Qeverie nga Lista serbe dhe drejtpërdrejt nga këshillat që jep Beogradi për të. Të mos harrojmë që vizita e parë e këtij subjekti politik ishte në Rusi, ku u takuan me partinë e Vladimir Putinit. Pse nuk pati asnjë reagim të Qeverisë për këtë vizitë?

Nëse Lista serbe është pjesë e Qeverisë dhe pjesë e koalicionit dhe Lista serbe e ka vizituar Rusinë, a i bie që një pjesë e Qeverisë së Kosovës e ka bërë këtë takim? Më e pakta që do të duhej të ishte është përjashtimi i këtij subjekti politik prej qeverisjes, nëse është në kundërshtim me interesat e Kosovës. Por, jo vetëm që nuk ka ndodhur kjo, por nuk ka pasur asnjë reagim. Të dalë kryeministri e të na tregojë se çka mendon për këtë vizitë në Rusi. Nuk ka ndodhur kurrë kjo.

Tjetra? Këtu po dëgjojmë se po zihet kryeministri me LDK-në se kush e pamundësoi krijimin e ushtrisë. Kjo tash bëhet për ta devijuar temën nga thelbi i vet, për shkak se ne ushtrinë e kemi dhe vendimin për ushtrinë e kemi përpara. Kot ne grindemi këtu kush e parandaloi e kush e pamundësoi, ajo që është me rëndësi është që të na tregojë kryeministri se për cilin version është përcaktuar. Në tavolinë janë krejt dy opsione. Ky duhet të na tregojë tash cila është rruga përpara e kryeministrit. Nuk mjafton të akuzohen të tjerët. Qeveria nuk është për t'i akuzuar të tjerët ku kemi ngecur, Qeveria është për të na treguar se për cilin version do të përcaktohet në dy-tre muajt e ardhshëm dhe në tavolinë janë vetëm dy opsione, siç e di edhe vetë kryeministri.

Ushtria mund të bëhet vetëm në dy mënyra. A do ta bëni vetëm me Kushtetutë, apo do ta bëni me ligj? Dhe, shtrohet pyetja këtu, pse nuk po koncentrohemi në temat ku mund ta keni edhe votën e Lëvizjes “Vetëvendosje”? Pse po koncentrohemi në demarkacion, i cili po shkakton përçarje. Mund të koncentrohemi te ushtria, për ta themeluar ushtrinë. Këtu, nga krejt ky spektër i skenës politike që është ulur këtu në Kuvend, në të gjitha anët e Kuvendit, e keni votën pro. Atëherë, pse nuk po e merrni këtë vendim? Pse po insistoni në vendime që po e ndajnë skenën politike në Kosovë? Shumë më mirë do të ishte të koncentrohemi në gjëra të interesit nacional, në të cilat e keni votën e “Vetëvendosjes”, votën e LDK-së, votën e PDK-së, votën tuaj, votën e “Nismës”. Ka një konsensus këtu sa i përket krijimit të ushtrisë, të gjithë jemi të gatshëm, po më duket, përveç Qeverisë, e cila nuk po ka tjetër opsion, përveçse të akuzojë.

S’duhet ta harrojmë një gjë, që kjo Qeveri erdhi me probleme të mëdha. Mos harroni që një javë pasi erdhi kjo Qeveri në pushtet, tre pacientë në Qendrën Klinike Universitare e gjetën vdekjen. Unë dua ta ngre edhe një herë këtë çështje, sepse u harrua shumë shpejt. Mos harroni, në vendet e Perëndimit kur vdesin tre qytetarë për shkak të pakujdesisë së stafit, aty më së paku ministri jep dorëheqje, por edhe qeveria mund të bjerë krejt. Kjo çështje u hesht dhe drejtësia nuk është duke u marrë me këtë çështje. U përhumbar. Kush ua kthen atyre familjeve këta njerëz, që i humbën më të dashurit e tyre?

Tjetra? Vendimi i kryeministrit për kompensimin në Hade. Këtë duhet ta hetojë Prokuroria. Pse? Aty ka edhe krim të organizuar. Krejt fokusi ishte që tash u bë një zgjidhje dhe do të kemi thëngjill. Shumë mirë që do të kemi thëngjill. Kemi pasur nevojë, mirëpo arsyetimi që do të kemi thëngjill e fsheh prapa edhe një makinacion të manipulimeve me pronat atje, me ndërtime pa leje, për ç'gjë kemi pasur një kompensim marramendës dhe ky ka qenë një krim i organizuar.

Qeveria e ka kollaj, sepse paratë e Buxhetit të Kosovës, paratë e xhepit të qytetarëve të Kosovës vetëm i dislokon me miliona dhe kemi faktikisht kompensim të pronarëve. Mirëpo, çka ka ndodhur atje është një krim shumë i madh dhe vendimi i Qeverisë vetëm sa e ka mbuluar këtë krim, nuk e ka zgjidhur fare. Përkundrazi, hetimi i drejtësisë do të duhej t'i kishte paraprirë këtij vendimit për Hade. Njëherë t'i kapë kriminelët që kanë ndërtuar atje shtëpi, kanë blerë prona, kanë blerë e kanë stërshitur, të vihet në sistem Prokuroria e Shtetit, e pastaj kryeministri pas një vlerësimi të drejtësisë, është dashur të marrë këtë vendim.

Tjetra, sa i përket drejtësisë. Shumë është folur për korrupsionin, për antikorrupsion nga kjo Qeveri.

Rasti i prishjes të asaj që quhet në drejtësi dhe në gjykata rasti "Toka" dhe lirimi i Azem Sylës, si dhe lirimi i njeriut kryesor në "Rastin Veliaj", falsifikimi i pasaportave, e po ashtu edhe vendosja në krye të prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës të Nexhat Krasniqit, këta janë tri hapa të mëdhenj prapa në luftën kundër korrupsionit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj e ka fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar zoti Konjufca, Kolegë deputetë të "Vetëvendosjes", Vrapoj më shpejt, mirë që po e shihni, po ju duket interesant, s'ka dert. Nëse është shumë me rëndësi për ndonjë analogji me të kaluarën, ndoshta keni të drejtë.

Sa u përket zëvendësministrave, shumë, s'dimë ku janë, s'dimë pse janë. Po e lëmë ashtu, një raport do t'ia prezantojmë Parlamentit në kohë të shohim çka po bëjnë këta zëvendësministra.

Më kanë thënë të mos komunikoj sa jam duke folur, po duroj, nëse mundem.

Për problemet e qytetarëve nuk po interesohem, se duhet të merrem me Qeverinë, Qeveria është e ndërtuar, është në funksion, po merret me tema, nuk di sa i hetoni, nuk di a je duke e bërë edhe ti, Glauk, jetën e qytetarit tamam që ta hetosh a ka ndonjë ndryshim. Po sido që të jetë, jemi duke u marrë me tema të qytetarëve.

Erdhi puna te ushtria, ju e cekët me të drejtë, cilin opsion qëndroni, e favorizojmë opsionin e ndryshimit kushtetues, nuk përjashtohet opsioni tjetër, po nuk po flasim për atë të dytin para se të përfshihet, u konsumua i pari, është e vërtetë që ka votë unike shqiptare për ushtrinë sot, po ajo që thashë më herët qëndron, pse e kem humbur një hap, fatkeqësisht, shpresojmë që nuk do të bëjmë gabime të njëjta asnjë grup politik.

Po për demarkacionin dua t'ia bëj një pyetje "Vetëvendosjes" sa më sinqertë, përfshirë edhe Albinin, ia përmendi emrin, ma ka dërgua një letër. Më ka bërë përshtypje LDK-ja në këtë Parlament kërkonte të relativizohet raporti i Bulliqit. Unë e di që ju jeni kundër marrëveshjes, se është neni 3, pika 1.1 është marrëveshja e famshme e keqe, po pika 1.2 është raporti i Bulliqit, më ka bërë përshtypje pse dikush i "Vetëvendosjes" nuk u tha kolegëve të vet të LDK-së: mos, se nuk keni nevojë ta relativizoni, se nuk bën sherr ai raport. Qysh dikujt s'i doli një fjalë prej goje, të thonë mos, s'keni pse, leni ashtu. Jemi kundër krejt, ama mos e goditni raportin. Jam habitur pse s'ka ndodhur kjo, nuk e di pse, ka mundur të thonë. Shiko, ndoshta kanë të drejtë këta çfarë kanë kërkuar, po ju keni pasur po ashtu të drejtë ta thoni mendimin tuaj pak më ndryshe, edhe pse jeni opozitë, nuk ka dert.

U fol për shëndetësinë. Glauk, ka diçka që qëndron në atë që po thua. Nëse ministri e ka marrë detyrën sot, menjëherë ta bëjmë përgjegjës për shëndetësinë në krejt vendin a? S'ka mundësi që ai ministër që e ka marrë detyrën sot ta incizojë, ta skanojë e të dijë çka është duke ndodhur në shëndetësinë e këtij vendi. I duhet njëfarë kohe e të marrë vesh çka është duke ndodhur aty.

Është një farë rregulli, sot po të bëjmë ty ministër a dikë tjetër, s'mund t'i marrësh krejt përgjegjësitë menjëherë. Është një farë kohe prej pranimit të detyrës, e marrjes vesh ku je, çka je, çka është duke ndodhur. Megjithatë, e kemi parë një dinamikë të interesimit të gjendjes në shëndetësi. Nuk po them që është përmirësuar gjendje dhe çdo gjë është në rregull, ende ka probleme me disa procedura të kaluara dhe telashe të caktuara, por po shihet një vëmendje, është një kujdes.

Nuk po them as ai që ka faj përpara, por po dua të tregoj se në dy ditët e para po i japim dikujt një ministri, e shihni se ka zor, ai ndoshta e ka përcjellë edhe përpara ministrinë, po prapë e ka problem t'i japë të gjitha përgjigjet në sekondë. Ka shkuar ministri, kemi shkuar të gjithë, kanë ndodhur hetimet, ka ndodhur ajo që është e paraparë si procedurë në këto raste.

Te Hadja, po thoni është krim, krim që janë paguar ata që kanë ndërtuar. Shumë mirë. Unë s'mund t'i bëj 70 dosje, nuk jam i asaj natyre, kurrë s'bëj dosje. Unë e kam marrë në qeverisje, ata i kanë pasur të ndërtuara ato shtëpi, se s'kanë mundur t'i ndërtojnë për një javë sa kam ardhur unë, unë e kam gjetur problemin ashtu. Shtëpitë e ndërtuara, qymyr nuk ka pasur, ne blinim rrymë. I kam përdorur instrumentet ligjore për të kryer punë. Nëse keni problem me këtë, çka të bëjmë, s'kam ku shkoj më andej. Unë mendoj që i kam bërë një shërbim vendit, atdheut,

qytetarëve, sot konsumojnë qytetarët e Kosovës ose harxhojnë rrymën e Kosovës, prodhohet në Kosovë, punojnë punëtorët, po ju rritet rroga edhe 100 euro punëtorëve të KEK-ut, ua kemi pas premtuar, më kujtohet.

Pse duhet, Glauk, rastin “Toka” ta ktheni si shenjë që nuk po luftohet korrupsioni, po e mbytën Azem Sylën, nja 5 vjet i ka bërë nëpër procese gjyqësore. Më me faj është gjyqësori, se ai njeri, edhe dikush tjetër, kushdo qoftë. Ke deputetë që shkojnë pa kufij nëpër procese gjyqësore. Hajde të këqyrim, pse është kështu? Pse duhet të zgjasin kaq shumë, pse s’mund të jepet një epilog, se po i mbajnë njerëzit me vite e me vite.

Unë mendoj që korrupsioni e tona të këqijat e këtij vendit luftohen duke bërë një gjyqësor efikas që kryen punë, ja po, ja jo, je i fajshëm, je i pafajshëm, është një afat kohor, ta japë një përgjigje, po nuk mbahen njerëzit pa kufij nëpër procese duke bërë... Ndoshta edhe janë, ama jepi përgjigjen dikur, mos e le në pakufi.

Mua më kujtohet kur ka filluar rasti i Azem Sylës, nuk e kam për atë kush ka qenë ai a kush është, në aspekte të tjera të kontributeve të tij për liri, po vërtet një rast nuk mund të shkojë në pakufi.

Në botë i ke 3 muaj, 6 muaj, 9 muaj, e merr faturën: nëse je i fajshëm je kaq, për këtë, ja s’je, lëshohet në shtëpi. Këtu te ne ka njerëz që janë persekutuar, e dimë rastin edhe të zotit Limaj, edhe raste të tjera, kurrë nuk janë ndalur proceset, duhet të kalojmë në një logjikë të re të gjyqësorit, se është e dhimbshme.

Te rastet e tjera që i cekët ju, individuale. Ligji po i kthen disa njerëz në punë, po i kthen, janë procese ligjore. Kah t’ia mbajë ai tjetri, rrogat i merr, në dash merre brenda, në dash le. Janë disa situata kështu.

E kundërta që desha t’ju them, të bashkohemi në ato tema që na bashkojnë, si rasti i ushtrisë. Shumë me qejf ishim bashkuar sot. Kemi një klauzolë që thotë ‘votë e kualifikuar’, 2/3 e kualifikuara, nuk e kemi atë, kur konsumohet kjo mundësi, me siguri do të kalojmë edhe në atë etapën tjetër dhe besoj që do të na mirëkuptojnë edhe partnerët, edhe të gjithë. Faleminderit!

Do të lirohem pak, jo që nuk po dua t’i dëgjoj reagimet tuaja, do të gjej mënyrë t’i dëgjoj. Megjithatë ne kemi sjellë në Parlament shumë ligje, Qeveria e Kosovës, shumë vendime që kërkojnë votën tuaj, si borde, e vendime të tjera. Mua po më dhimbset pak a shumë Kosova që edhe kjo ditë e sotme është duke shkuar për një diskutim që u mbytëm. Ne këtë kemi mundur ta bëjmë edhe nëpër media. E nuk jeni duke i diskutuar ligjet që i kemi pruar këtu, nuk jeni duke i marrë ato vendime që janë me rëndësi për jetën e njerëzve.

E kisha lutur Parlamentin, ju po e shihni, opozita sidomos, se debati, të mos gaboj, një herë i kam thënë interpelancë, e kishte qenë debat, e s' e kam ditur, e tash a është debat, sot, a interpelancë?

Debati i sotëm e di që ka dobi opozitare, po më mirë të bëjmë ndonjë ligj. Po shikoni, u pa sot edhe vota, raporti i votës, e provojmë kohë pas kohe, prapë ju tregojmë që i kemi, me siguri që do t'i bëjmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismajli ka sqarim sa i përket çështjes së shtruar për shëndetësinë. Replikë ka edhe Glauku, pastaj.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit!

Desha pak të flas rreth asaj që deputeti e ngriti për çështjen e vdekjes së tre personave.

Konsideroj që rasti është aq i rëndë që nuk kem nevojë për shtrembërim të fakteve, kemi nevojë që të kemi një kohezion sa i përket dëshirës për ta zgjidhur.

Çfarëdo lloj shtrembërimi të fakteve na bënë të polarizohemi. Domethënë, nuk i kontribuojmë zgjidhjes reale, po i kontribuojmë 2-3 poenëve politikë.

E para, rasti ka ndodhur tri ditë para se të jem unë ministër. Ditën kur e kam marrë ministër është bërë mediatike dhe në asnjë moment të këtij procesi nuk kam heshtur. Pra, e kam ngritur në nivel të kryeinspektorëve, kam dalë në secilën media televizive që ka qenë nacionale, kam diskutuar, kam thënë që e kam gjetur një gjendje shumë të rëndë, të cilën jo veç një ministër mund ta zgjidhë, por çka mund të bëjë një ministër është ta ngre si çështje e të mos e lërë të heshtet. Domethënë është e kundërta e asaj që ju e thatë që rasti po heshtet.

Rasti është ngritur te të gjitha institucionet përgjegjëse, janë dorëzuar të gjitha raportet që i ka marrë ministria për t'u dhënë material sa më të fuqishëm dhe të kompletuar të gjitha institucioneve përkatëse.

Unë e di, besoj që nuk ka njeri në këtë sallë që nuk i janë dhimbsur tre pacientë që kanë hyrë brenda dhe nuk kanë dalë për shkak të një faktori tjetër, në këtë rast, të një gazi ose diçka tjetër.

Mirëpo, mënyrën se si e konceptojmë për të ardhur te zgjidhja, është shumë e rëndësishme.

Dorëheqja fare nuk është me rëndësi, dhe të ngritët si çështje.

Unë ditën kur e kam marrë, më kanë thënë ministër, mos fol se nuk është bërë në mandat tëndin, ka ndodhur më herët. Po dy ditë në jam ministër, tri ditë, do të mundohem të veprojmë me përgjegjësi të plotë për qytetarin tonë, pa dallim politik, pa dallim etnie, t'i japim një shërbim që

e meriton. Është gjetur një gropë e madhe në shëndetësi, pak digresion, kemi disa tema unifikuese. Konsideroj shëndetësia duhet të jetë temë unifikuese, sepse ne sot jetojmë 10 vjet më pak se qytetarët e tjerë në Evropë. Sepse ne sot paguajmë më shumë se secili qytetar në rajon për shërbime shëndetësore dhe nuk mund ta ngremë shëndetësinë veç kur na duhet të godasim dikë. Ngrite shëndetësinë për përmirësim të shërbimit, mos e ngrini shëndetësinë veç atëherë kur mendoni që ka mundësi të goditet një ish-ministër ose një ministër, sepse nuk krijoni konsensusin që po e duam. Nuk mund të flasësh me shtrembërim të fakteve për dëshirë të konsensusit.

Prandaj, jo unë, secili prej jush që dëshiron ta ngrejë sa më shumë, unë e kam ngritur aq sa kam ditur.

Kam folur në televizor, i kam thirrur kryeinspektorët, i kemi bërë raportet, i kemi dorëzuar në prokurori.

Në qoftë se keni ide që mund ta ngremë ndryshe, sot e 100 vjet do të jem me juve.

Por, t'i japim energji për t'u zgjidhur rasti, në çfarëdo lloj forme që e shihni të mundur. Faleminderit!

Në qoftë se keni ndonjë pyetje shtesë, jam këtu.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Për replikë është lajmëruar zoti Glauk Konjufca.

**GLAUK KONJUFCA:** Tash s'e paskemi kryeministrin këtu, është mirë kryeministri të përgatitet pak nga mendja dhe nervat për t'u përballur më suksesshëm me opozitën, sepse po e lëshojnë shumë shpejt, edhe kondicioni, edhe përgatitja dhe nuk po mund të qëndrojë më shumë se 20 deri gjysmë ore në seancë.

Sa i përket ministrit të Shëndetësisë, për këtë vlen ajo shprehja popullore: "Ka hi në mal pa sakicë", nuk e ka përgatitjen e duhur për t'u marrë me shëndetësinë. I ka qëlluar Kadri Veseli shok dhe e ka bërë ministër, kaq është puna e tij. Nuk zgjidhet shëndetësia kështu. Duhet pasur koncept, duhet pasur plan qysh duhet zgjidhur.

Tash po bëhen gati 200 ditë prej kur ka ardhur ministër dhe ka ende në QKUK aparate, të cilat as s'e di qysh funksionojnë, as s'e dinë pacientët së pari që është ai aparat për ta shfrytëzuar.

Lajmet nëpër media për skandalet në QKUK janë të përditshme, e ministri nuk po ka zgjidhje për ato.

Sa i përket vdekjes së tre pacientëve, nuk mund të thuash tash ndodhi pak para se unë të bëhesha ministër. Po ti tash je ministër, qysh je duke e trajtuar ti atë rast, kjo na intereson neve. Ne nuk po të akuzojmë për vdekjen e tyre, por po të akuzojmë për trajtimin e rastit.

Sapo the ekziston një faktor objektiv pse ata kanë vdekur, gazi. Pse e thoni këtë? Për ta amnistuar çfarëdo përpjekje njerëzore apo involvimi të veprimeve njerëzore në atë rast. E unë mendoj që veprimet njerëzore kanë shkaktuar vdekjen e atyre njerëzve. Nuk është gazi, po kush e ka blerë gazin, kush e ka bërë tenderin për gaz fals, kush e ka përdorur atë gaz.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë ka ministri.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit!

Domethënë, shumë shpejt është shpërfaqur prej një fjalimi që të jemi konsensual, të jem mirë, e menjëherë shpërfaqet inati i shpejtë politik.

Shpërfaqet, sepse nuk e shikon një shërbim që është sot 24 orë, e nuk ka ekzistuar kurrë. Të kishte ndodhur ty në familje, s'ke pasur ku ta çosh dikë me sulm në zemër pas orës 19:00, sot e çon në QKUK dhe nuk i paguan 10 mijë euro. Këtë nuk e këqyr, po shprehet me fjalë popullore e mendon që unë duhet të di çfarë aparati ka, çfarë voltazhi ka, çfarë amperi ka, edhe të di unë qysh punon aparati.

Për dallim prej teje, domethënë që nuk fole asgjë hiq, veç u mundove me zonë kohë, unë po tregoj që përpos shërbimeve 24 orë në Kardiologji invazive, në Onkologji te pacientët me kancer që përpara është dashur t'i dërgoni...

KRYESUESI: Faleminderit! T'i respektojmë rregullat të gjithë. Zoti Ismet Beqiri e ka fjalën për një sqarim.

ISMET BEQIRI: Faleminderit!

Zoti nënkryetar, unë ju kërkoj falje, po tash pasi hymë në rend të ditës, duke i ditur procedurat.

Më lejoni vetëm një sqarim të bëj, meqenëse më herët u fol për ushtrinë, më vjen keq që nuk është kryeministri Haradinaj, me gjithë konsideratat që i kam për funksionin që e ka, më duhet të them që në takimin në të cilin thirret zoti Haradinaj duhet sqaruar, sepse ne jemi subjekt serioz dhe është përgjegjësi e madhe nëse akuzohet një subjekt politik që gjoja na u paska afrua diçka e tillë në këmbim të formimit të ushtrisë. Kjo nuk qëndron.

Në takimin e tillë me zonjën Jacobson, ambasadoren amerikane, kanë qenë zoti Thaçi, zoti Haradinaj, zoti Jakup Krasniqi, zoti Pacolli, zoti Isa Mustafa, si kryetar i LDK-së dhe kam qenë unë si sekretar i përgjithshëm dhe kryetar i grupit.

Po ju them me përgjegjësi të plotë, nëse ekziston një dokument i tillë, ne e bartim përgjegjësi dhe ajo duhet të publikohet. Nuk qëndron, asnjëherë, asnjë ofertë nuk na është bërë që po të vazhdohen mandatet e rezervuara do ta kemi ushtrinë, është e paqëndrueshme, nuk është e saktë, nuk është e vërtetë.

E keni zotin Jakup Krasniqin në mesin e atyre që e ka kundërshtuar, si kryetar i Kuvendit ka qenë në takim. Dhe, përpos Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe zotit Krasniqi, është e vërtetë, të tjerët kanë pasur gatishmëri t'ua vazhdojnë mandatin e vendeve të rezervuara.

Ju lutem, para opinionit publik të thoni diçka për një organizatë të madhe, një parti politike siç është LDK-ja, të ngarkohet për atë që nuk qëndron, ky është një obligim imi të sqaroj, sepse kam qenë i pranishëm në takim dhe mund të konfirmohet kjo.

Nëse del e kundërta nga një takim i tillë, ne po flasim që ka pasur tekst të shkruar, ka pasur ofertë. Shikoni, po flasim në emër të Ambasadës Amerikane, gabim i madh është ky, të kishte diçka të tillë, do të na e thoshin publikisht. Nuk ka pasur asnjëherë ofertë për këmbim të vendeve të rezervuara me formimin e ushtrisë së Kosovës.

Prandaj, po e them me përgjegjësinë edhe qytetare, edhe si zyrtar politik, edhe si deputet, që kjo nuk qëndron dhe asnjëherë Lidhja Demokratike e Kosovës jo që nuk e ka penguar, po as nuk do ta pengojë, po përkundrazi do të kontribuojë për formim të ushtrisë. Ne nuk na vyejnë votat kalimtare, t'i përfitojnë asnjëri prej nesh në emër të diçkaje që nuk qëndron.

Ka pasur gatishmëri të njerëzve edhe me dy mandate t'u vazhdohet, ju e shihni çfarë telashesh po na bëjnë këta 10 që janë aktualisht për çështje të caktuar, mund ta merrni me mend të kishin edhe vende të rezervuara ende se në çfarë situatë kishim ardhur si Kosovë, çfarë bllokade do të kishim pasur.

Zoti nënkryetar,

Unë ju falënderoj shumë për mundësinë që ta sqaroj edhe një herë dhe marr përgjegjësi publike për këtë që e them, si Ismet Beqiri, si zyrtar, asnjëherë nuk ka pasur ofertë të tillë të këmbimit të vendeve të rezervuara me formim të ushtrisë. Kjo është e saktë, sepse takimi ka qenë i nivelit më të lartë, në të cilën kam marrë pjesë.

Prandaj, po ju lus, nuk na bënë nder asnjërit të thuhet diçka që nuk është dhe ta etiketojmë njëri-tjetrin.

Mos harroni një gjë, LDK-ja po sillet si parti serioze, edhe tash që jemi opozitë, ne mund t'ju themi: "Bëni çka të doni me demarkacion", po s'po e bëjmë këtë, sepse është interes i vendit dhe kur keni nevojë për vota të LDK-së, edhe si koalicion, së paku respektojeni, sepse pa LDK-në,



po e them me përgjegjësi, as nuk mund të kalojnë vendimet, po as nuk ka shtet të mirëfilltë të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: I nderuar nënkryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar, Të nderuar kolegë deputetë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me kujdes raportin 100-ditor të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe ka vlerësuar punën dhe dinamikën e bërë nga Qeveria brenda kësaj periudhe kohore.

Nga raporti 100-ditor i Qeverisë së Kosovës, vërejmë se Qeveria ka vazhduar punën bazuar në programin qeverisës 2017-2021.

Nëse diskutojmë me vëmendje dhe pa paragjykime planin e punës së Qeverisë dhe të arriturat, të cilat janë bërë brenda kësaj periudhe, shohim se kanë filluar reformat në shumë segmente, siç janë shëndetësia, në avancimin e kuadrit ligjor për sundimin e ligjit, kur është hartuar e aprovuar planin zhvillimor strategjik 2018-2021 që përcakton drejtimin e zhvillimit të sistemit të drejtësisë.

Në sigurimin e stabilitetit financiar, duke përmirësuar ndjeshëm politikat financiare, ne vlerësojmë punën e bërë në drejtim të integritetit evropian në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, po ashtu vlerësojmë edhe konsolidimin e Ministrisë së Ndërmarrësisë dhe Inovacionit që do të ketë një impakt pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit.

Nga raporti vërejmë se Qeveria ka aprovuar gjatë këtyre 100 ditëve të punës së saj 48 projektligje që janë të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve dhe në funksion të avancimit të shtetit të Kosovës, disa prej të cilave kanë kaluar, janë votuar edhe në këtë Kuvend.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e vlerëson punën e Qeverisë, e veçanërisht punën që është bërë në Ministrinë e Drejtësisë nga ministri Abelard Tahiri.

Për arsye se sundimi i ligjit, si objekt kryesor i kësaj Qeverie, është duke u trajtuar me prioritet krahas obligimeve që dalin si në rrafshin e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm në lidhje me rrugëtimin tonë euro-atlantik.

Sundimi i ligjit nuk nënkupton vetëm sigurinë duke luftuar krimin dhe korrupsionin, por edhe është bazë për zhvillimin ekonomik dhe integritetin e Kosovës drejt Bashkimit Evropian, ky është dhe duhet të jetë një nga synimet kryesore të Qeverisë, por edhe të të gjitha institucioneve.

Ne do të angazhohemi edhe në Kuvend që përmes miratimit të ligjeve dhe materialeve të tjera të rëndësishme të jemi në shërbim të sundimit të ligjit dhe në shërbim të shtetit tonë, Republikës së Kosovës.

Qeveria ka bërë hapa pozitivë edhe në drejtim të mbështetjes së plotë dhe ne do të japim mbështetje të plotë punës së qeverisë në krijimin e Byrosë nacionale të hetimeve, ku do të ndërtohet procesi i verifikimit të sigurisë, pra i vetingut.

Forcimi i gjyqësorit përmes pakove të ligjeve është punë që duhet vlerësuar në Ministrinë e Drejtësisë, si Ligji për Këshillin Prokurorial, gjyqësor dhe Ligjin për gjykata.

Nga raporti vërejmë se është bërë punë e mirë edhe në përmbushjen e obligimeve që dalin nga agjenda evropiane, ku janë hartuar projekt-kode dhe koncept-dokumente në luftën kundër korrupsionit, si koncept-dokumenti për fushën e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë, rishikimin e Ligjit për mbrojtjen e informatorëve dhe Projektligjin për përgjegjësinë disiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët.

Vlerësojmë hartimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurorin e shtetit, Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit dhe koncept-dokumentin për suspendimin, përkatësisht largimin nga puna e zyrtarëve publikë. Në Ministrinë e Drejtësisë, në këto 100 ditë është punuar edhe në përmirësimin e kushteve të të burgosurve që hynë në domenin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përmes ndërtimit dhe përmirësimit të infrastrukturës së burgjeve.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës vlerëson punën e Qeverisë dhe të ministrit të Financave, zotit Bedri Hamza, në hartimin e buxhetit të qëndrueshëm, i cili siguron zhvillim ekonomik dhe reflekton prioritete të Qeverisë, duke rritur buxhetin në sektorët që qeveria i ka si prioritet, si në drejtësi, shëndetësi, arsim, në rritjen e pagave për të gjithë të punësuarit në Shërbimin civil, në rritjen e asistencën sociale për 20%, fillimin e financimit të skemave të përkrahjes së qytetarëve të paaftësuar në vend të punës, mbështetjen e qytetarëve paraplegjikë dhe kujdestarët e tyre dhe ndarjen e mjeteve për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, e krahas kësaj ka ruajtur edhe nivelin e lartë të investimeve kapitale, i cili reflekton direkt në jetën e qytetarëve të Kosovës.

Qeveria është e përkushtuar për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik që nënkupton mirëqenien e qytetarëve dhe uljen e papunësisë, prandaj këtë duhet ta vlerësojmë. Në kontekst të kësaj shihet që Ministria e Financave ka ndërmarrë një numër vendimesh, të cilat ndikojnë në zhvillimin e sektorit privat, duke bërë hapa konkretë në fushën e politikave fiskale dhe në përmirësimin e mjedisit afarist. Nga raporti vërejmë se është marrë vendimi për lirimi nga tatimi doganor për prodhuesit, për lëndën e parë, gjysmë produktet, lirimi nga tatimi doganor për vijat e prodhimit

dhe pajisjeve teknologjike informative, të gjitha këto janë parakusht për zhvillimin ekonomik dhe uljen e papunësisë. Andaj, edhe presim synimet e qeverisë dhe ministrit Hamza për rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës.

Ne vlerësojmë punën që ka bërë Qeveria, në veçanti ministri i Financave në bashkëpunimin me institucionet financiare ndërkombëtare, si aprovimin e dy konventave ndërkombëtare për doganën, marrëveshjes financiare për bujqësi dhe zhvillimin rural dhe konkurrueshmëri, si dhe marrëveshjeve të tjera me Bankën Gjermane dhe institucionet e tjera financiare. Ne inkurajojmë qeverinë që të punojë edhe më tutje në drejtim të rritjes dhe zhvillimit ekonomik, të punojë edhe më tutje në drejtim të rritjes ekonomike, për arsye se kjo do të reflektonte në zhvillimin ekonomik dhe uljen e papunësisë. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka vlerësuar nënshkrimin e kontratës për ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re” ndërmjet Qeverisë dhe nënshkrimin e kësaj kontrate me kompaninë “Contour Global”, i cili projekt ka filluar qysh në kohën e qeverisjes së Partisë Demokratike të Kosovës që kishte për synim arritjet në fushën e energjisë, e cila po kurorëzohet me bashkëqeverisjen e PDK-së në këtë dhjetëvjeçar të pavarësisë së Republikës së Kosovës. Marrëveshja “Three scholt” që është nënshkruar, po ashtu duhet vlerësuar, sepse mundëson një investim prej 49 milionë dollarësh në ekonominë kosovare, mjete këto, të cilat janë të orientuara në energji, eficiencë dhe në ekonominë familjare.

Për herë të parë Partia Demokratike e Kosovës e udhëheq sektorin e shëndetësisë dhe vërejmë se ka lëvizje pozitive që s’i kemi vërejtur në të kaluarën dhe janë evidente pikërisht në këtë qeverisje. Edhe në këtu, por edhe qytetarët anëmbanë Kosovës e kanë vërejtur punën e mirë të ministrit të Shëndetësisë, zotit Ismajli dhe përkushtimin që ka bërë ai për ta bërë ndryshimin e madh në shëndetësinë e Kosovës. Me Buxhetin e Republikës së Kosovës është rritur buxheti për 18 milionë në këtë sektor. Është për t’u vlerësuar puna me përkushtim në shëndetësi, në arritjen e objektivave për të siguruar kushte të përshtatshme për shërim të qytetarëve brenda Kosovës, pra në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Krijimi i mundësive për të dhënë shërbime 24 orë në shtatë ditë, në Kardiologjinë Invazive dhe në Onkologji, është një hap i madh i bërë nga ministri i Shëndetësisë, sepse kjo ka bërë të mundur kursimin e miliona euro nga buxheti i shtetit dhe është shërbim efikas dhe i lirë për qytetarët e Kosovës. Ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjilan, Gjakovë, spitalet e Podujevës, është tregues i qartë për shërbimet gjithëpërfshirëse, pavarësisht rajoneve dhe ndikimeve politike, e kjo në fakt ka qenë gjithëherë logjika e punës dhe e qeverisjes së Partisë Demokratike të Kosovës. Një objektiv tjetër me rëndësi sa i përket shëndetësisë, e cila kërkon vëmendje dhe nga ne, është rritja e stafit shëndetësor për 300 pozita, ngritja e buxhetit për barna dhe investimeve kapitale.

Ne mbështetim angazhimin e Qeverisë karshi obligimeve që dalin dhe programin kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, po ashtu edhe objektivat për zbatimin e mbi

500 reformave strategjike që ndikojnë në përmbushjen e kësaj marrëveshjeje. Është arritur përmbyllja dhe ratifikimi i IPA-s 2016, prej 45 milionë euro për arsim, punësim, politika sociale, konkurrueshmëri, të drejtat e njeriut. Ne presim nga Qeveria që të nënshkruajë marrëveshje të tjera me IPA-n, të cilat do të jenë të favorshme për zhvillimin dhe mirëqenien në Republikën e Kosovës.

*(Ndërprerje nga regjia)*

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Mufera Shinik.)*

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Lumir Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Fatkeqësisht kryeministri s'është këtu, por është i paqartë obsesioni i tij me LDK-në edhe me të pavërteta që në vazhdimësi që i thotë ndaj LDK-së, sa herë që del këtu. Është e pavërtetë e madhe se LDK-ja ka bllokuar formimin e ushtrisë, por kam përshtypjen se konsekuencat kushtetuese të kohës kryeministri nuk arrin t'i kuptojë. Për të pasur të qartë, besoj se duhet dëgjuar rrëfimi i atyre që kanë qenë të pranishëm nëpër takime, edhe përfaqësuesve të minoriteteve për të kuptuar se a ka qenë në tavolinë një propozim i tillë.

Por, gjithsesi është i trishtueshëm ofendimi i vazhdueshëm që kryeministri i Kosovës i bën ndaj LDK-së, tash ne fatkeqësisht s'mund ta edukojmë kryeministrin, e as ta ndryshojmë qasjen që ka zgjedhur ndaj LDK-së, por që ta ketë kryeministri të qartë, ai edhe të gjithë të tjerët që dalin këtu dhe ofendojnë LDK-në, ne, kjo anë këtu nuk ofendohet prej një gjuhe që mund ta thotë secili. A e dini kur ofendohemi ne, kur na mundni me argumente, kur jepni ide më të mira se ne, kur bëni punë më të mirë se ne, e kur keni punë më të mëdha se sa ne. Ne nuk ofendohemi prej një gjuhe që mund ta thotë secili, ju s'mund ta ofendoni LDK-në, por gjithsesi një gjuhë e tillë është ofendim për Kosovën. Mbi të gjitha, një gjuhë e tillë është zëvendësues i mungesave të suksesit, është simptomë dhe, thënë të drejtën, për këto 200 ditë ne nuk është se kemi pritur shumë, dhe s'do të presim as për secilën ditë tjetër që kjo qeveri e kalon.

E kemi thënë fillimisht, e themi edhe tani, se një qeveri e bërë bashkë mbi interesa të pazareve, mbi poste, jo mbi ide, s'mund të prodhojë përparim, e kemi kuptuar këtë kur në vend të një programi për qeverisje, na është ofruar një dokument trefaqësh mbi pozitën se kush e sa merr. Ishte qartë që në fillim se qëllimi i këtij pushteti s'ishte rruga e Kosovës, por karriget e saj. Por, duhet pranuar megjithatë se edhe ne skeptikët më të mëdhenj të kësaj qeverisje nuk kemi pritur kaq shumë regres për vetëm 200 ditë, s'kemi pritur kaq shumë tension qeverisës, kaq shumë pamaturitë politike e kaq shumë papërgjegjshmëri shtetërore, pra s'kemi pritur kaq shumë kaos. S'e kishim menduar se në 200 ditë, në dhjetëvjetorin e saj, Kosova mund të kthehej në një shtet

të para thyerjes, në një shtet me perspektivë të rënduar evropiane, me përplasje skandaloze me Perëndimin, në një shtet që drafton politikën e saj në mënyrë krejt të rastësishme aksidentale, në një shtet që fal borxhe sipas tekeve, rrit paga për vete, shpërndan para pa dhembje dhe në fund pyet: ku po ju dhemb? Për t'i thënë gjërat siç janë, kjo qeveri ka kaluar ditët e para të saj nga një skandal në skandalin tjetër.

Përgjatë gjithë ecjes së saj nëpër skandale të njëjta ka treguar brishtësi të pashoqe, ka treguar se s'arrin të kalojë as edhe një ligj të thjeshtë pa mbështetjen e opozitës. Por, konstruktiviteti i opozitës sot duket i pamjaftueshëm përballë sfidës më të rëndësishme kosovare, atë të demarkacionit dhe liberalizimit të vizave. Sjellja jonë konstruktive, përkundër arrogancës e ofendimit dhe papërgjegjshmërisë së pushtetit, përkundër sjelljes kaotike të njëjtëve sa ishin në opozitë, por edhe tani sa janë në pozitë, del sërish të jetë e pamjaftueshme, sepse koalicioni i 22 partive vazhdon të mos i ketë 61 vota për të bërë gjënë më të thjeshtë të mundshme, dhënien e lëvizjes të lirë për qytetarët tanë.

E, skandali më i madh i këtyre 200 ditëve nuk është demarkacioni, është nata e 22 dhjetorit. Në një lëvizje krejt të papritur politike liderët e pushtetit provuan shfuqizimin e një marrëveshje ndërkombëtare. Shfuqizimi prodhoi relacionin politik më të rëndë për Kosovën që nga përfundimi i luftës e këndej. Vendet aleate tona e quajtën “thikë pas shpine” përpjekjen e tillë. Një papërgjegjshmëri e tillë e bëri Kosovën të duket shtet joserioz në arenën ndërkombëtare, në natën e 22 dhjetorit, zonja dhe zotërinj, Kosova e arriti pikën e saj më të ulët historike përballë aleancës me Perëndimin. Në kthim, liderët tanë morën izolim, u desh refuzimi i vizave për ta, për t'i qetësuar për një kohë dhe kthyer vendimin në fillim. Në këtë relacion të dhënies së vizave ose jo, zhvillohet sot diplomacia kosovare.

Gjestet kaotike si këto kanë shtuar zërat kundër Kosovës edhe në mes të shteteve që kanë njohur dhe sponsorizuar vendin tonë për shumë kohë, dhe shturja diplomatike e Kosovës nuk përfundon me kaq. Ju kujtoj vetëm dy të fundit, të dy zëvendëskryeministrave tanë, njëri shqiptar, ministër i Punëve të Jashtme, i cili deklaroi se Serbia nuk duhet ta njohë Kosovën dhe kështu për herë të parë pas dhjetë vjetëve të shpalljes së pavarësisë kemi një pozicion zyrtar të ndryshëm prej atyre të bëra publike. Në anën tjetër, meqenëse tema është e ushtrisë, një zëvendëskryeministër nga radhët serbe, vartës i kryeministrit tonë, lobon në Pentagon kundër formimit të ushtrisë së Kosovës. Sërish për herë të parë një pozicion zyrtar i Kosovës mban qëndrime kundër orientimit kushtetues e nacional të Kosovës. Deklarata si këto s'morën asnjëherë qëndrime politike, as kërkesë qartësuese, ato u kaluan krejt në heshtje, siç kalon secili skandal tjetër qeverisës në vend. Kalojnë në heshtje, sepse kjo qeveri varet prej individëve dhe përderisa varet prej individëve, detyrohet t'i tolerojë jo vetëm gabimet e tyre, por edhe tendencat antirepublikane, siç janë këto kundër formimit të ushtrisë.

E, përderisa në relacionet ndërkombëtare ne e kemi sjellë Kosovën në pikën historike më të ulët të saj, në punët brenda ne kemi prodhuar një mori anomalish politike. Në ditët e para të qeverisjes kjo qeveri theu dy rekorde: atë të numrit të ministrive dhe të numrit të zëvendësministrave, plot 71 sosh. Një armatë e tërë badihavxhinjsh vazhdon të marrë miliona euro të buxhetit të Kosovës. Përtej kostos financiare, një veprim i tillë është edhe deklaratë politike mbi stilin udhëheqës në vend. Publikisht, kjo qeveri në disa raste ka pranuar se numri i madh i zëvendësministrave është bërë për shkak të numrit të partnerëve në koalicion, pra ka pranuar se është çështje pazari dhe ky pazar filloi të na kushtojë shtrenjtë kur kryeministri vendosi në formë krejtësisht arbitrare të rrisë pagat për vete, stafin e vet dhe ministrat e tij. Arsyetimi, po e citoj kryeministrin, “sepse më duhen kravatat”.

Siç u kuptua më vonë, kryeministri s’kishte edhe shumë nevojë për kravata, u desh interpretimi i Agjencisë Kundër Korrupsion që kjo çështje të kthehet në fillim. Kjo Qeveri ua fali në formë të paprecedentë plus 58 milionë euro prodhuesve të ujit, të cilët veçse kishin mbledhur këtë taksë te qytetarët tanë. Arsyetimi i dhënë, po e citoj sërish kryeministrin, “sepse mu ka tek” dhe gjërat s’bëhen me teke në një shtet serioz, ato s’bëhen as me vendime të atypëratyshme, ka një rregull në secilin shtet dhe në shtetin tonë ka rregulla të tilla, ka procedura, ka ligje, ka norma që obligojnë secilin të sillet me dinjitet. Meqenëse vendosin t’i ndjekin procedurat kushtetuese, qeveria vendosi të bënte atë që bën më së miri këto 200 ditë, kthimin prapa dhe rënies pishman. Edhe ky vendim u kthye prapa.

Por, milionat e faturuara në ujë s’janë të vetme dhe ditëve të fundit kjo qeveri ka nisur fushatën e faljes së 63 milionë eurove shtesë për “Bechtel&Enka”. Në paraqitjet e deritanishme ata i kanë paraqitur pretendimet e kompanisë si pretendime thujse shtetërore, madje as edhe një herë s’e kemi parë “Bechtel&Enka” të dalë publikisht të mbrojnë qëndrimin e saj. Në menaxhimin e parasë publike Qeveria shpërndan para pa ndonjë hesap, pa ndonjë kriter, pa ndonjë prioritet. Jep miliona për libra presidentësh, shënime ditësh, rehatime, ndonëse spitalet i mban ende pa barna e pa penj, rezerva e shtetit për vitin 2018 është shterur në dy muajt e parë. Skandalet e tjera qeverisëse sikur ai i një ministri që doli të jetë torturues i shqiptarëve gjatë viteve të ‘90-ta apo një zëvendëskryeministri që shtinte me armë zjarri në ambient të hapur, u mbulua nga pushteti dhe shumica parlamentare në vend. Shtënia me armë zjarri e thyerja e ligjit u trajtuan si kulturë e zakonshme, u tha “punë e madhe që shkelet ligji”, e torturat e pretenduara u trajtuan si mashtrime të viktimave shqiptare. Dhe për t’i dhënë kapak ditëve të para të kësaj qeverie, këtë muaj Kosova mori lajmin më të hidhur në fushën e arsimit, suspendimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga Regjistri evropian. Suspendimi, siç u njoftuam publikisht, ndodhi për shkak të ndikimeve politike në Agjenci dhe në vend të korrigjimit të gabimit, arsyetimi i dhënë në këtë foltore nga kryeministri ishte të mos bëjmë zhurmë, sepse “nuk është bërë kiameti”.

Pra, me pak fjalë, puna e kësaj qeverie për 200 ditë rumbullakohet. Kur s’na njihen diplomat ndërkombëtare, themi “s’është bërë kiameti”, kur falim 53 milionë borxhe, themi “se mu ka tek”,

kur ia dyfishojmë pagat vetit themi se “më duhen para për kravata”, kur shtimë me armë në publik themi “se punë e madhe që shkelet ligji, është zakon”, kur përplasemi me Perëndimin themi “nuk ndiejmë për ambasadorë”, e kur habitemi për gjithë këto themi “ku po ju dhemb”.

Kjo gjuhë, ky stil, kjo mendësi e treguar edhe sot në këtë foltore nuk i përkon mendësisë normale të një shteti normal, është fakt, mendësi pa stil dhe pa shumë kokëçarje, është mendësi e krizës dhe kaosit, subvencionuese e sukseseve minimale. E në mungesë të sukseseve minimale, në mungesë të punëve të mëdha, Qeveria ka nisur të flas për pallate të mëdha, flet për zyrat e veta, mendojnë e diskutojnë për pallate rezidenciale kur shkollat, spitalet, gjykatat i kanë të dërmuara nga investimet dydekadëshe në to.

Ide e madhe s’është një pallat i madh, ide e madhe është kthimi i Kosovës në rrugën perëndimore, është hapja e dyerve të Fuqitë e Mëdha, është liberalizimi i vizave për qytetarët tanë dhe harresa e kauzave fiktive primitive, është ndërtimi i spitaleve, shkollave, sistemeve gjyqësore, ide e madhe është nisja e një dhjetëvjeçari ndryshe nga ai që kemi pasur deri më tani.

Dhe, në këto 200 ditë fatkeqësisht është dëshmuar se një gjë e tillë s’mund të bëhet nga ky Kabinet qeveritar, dhe po e them atë që e kemi thënë edhe në fillim, se ndërprerja e ditëve të kësaj qeverie është akt patriotik për Kosovën. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ahmet Isufi e ka fjalën në emër të AAK-së.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky debat po shihet që është ftuar vetëm për të bërë zhurmë, por jo që të bëjë analizën e 100-ditëshit të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Edhe ashtu kur u bënë 100 ditë të qeverisjes së Kosovës thirrej të bisedohej ose të debatohej për programin e Qeverisë, që i kishte kaluar afati, ose koha, po ashtu tani po bëhen 200 ditë, thirret për 100-ditëshin, unë kam kërkuar edhe në mbledhjen e Kryesisë nga shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së që ta tërheqin këtë debat, meqë kemi të bëjmë me një tejkalim të kohës edhe nuk është mirë të humbim kohë, meqë kemi shumë ligje, shumë vendime, të cilat duhet t’i marrim në këtë Parlament për t’u treguar edhe deputetë seriozë para qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Nuk u gjet së paku edhe një fjalë për një vendim ose për një veprim të mirë të kësaj qeverie, unë e kuptoj opozitën kur e luan rolin e vet për ta korrigjuar Qeverinë, për ta kundërshtuar, edhe pretendimet për ta rrëzuar, pse jo, sepse në krejt botën bëhet kështu, po nuk e kuptoj së paku me u gjet një fjalë me thënë këtë e kemi nis, e së paku kjo Qeveri po e realizon. E dini projektin më

të madh të Kosovës që po ndodh për këto 18-19 vjet që është Termocentrali “Kosova e Re”, deri tani sa milionë janë paguar për konsulencë e kurrë s’është bërë deri sa ka ardhur kjo qeveri. E dini për Ligjin për Prishtinën, po ashtu, sa zhurma është bërë në këtë Parlament që nga fillimi i pasluftës, e s’është bërë deri në ardhjen e kësaj Qeverie. I dini edhe disa vendime që u folën edhe për shpronësimet, që e vetmja Qeveri bëri hapat e duhur, po ashtu edhe për autostradat që po ndërtohen, kthjelluni pak dhe shikoni me realitet, qoftë edhe nëse s’ju pëlqen dhe ajo çka më çudit më së shumti është kur Lidhja Demokratike e Kosovës që ka qenë këtë Parlament prej fillimit, ka pasur së paku një durim për ta dëgjuar tjetrin, qoftë edhe nëse nuk është pajtuar, qoftë edhe nëse tjetri ka qenë krejt ndryshe opinionit të tyre.

Por tash, kryeministrin e vendit nuk e lënë as ta përfundojë fjalën që nuk është mirë, nuk është kulturë që e ka pasur dikur Lidhja Demokratike e Kosovës në këtë Parlament dhe po ju them që, si duket, turistët që shëtisin nëpër parti, nëpër institute, nëpër opinione të ndryshme tregojnë që vërtet ia kanë humbur edhe rrugën, por është mirë të gjendet rruga, të jenë të kujdesshëm, të kulturoar, ashtu si gjithmonë e kanë pasur durimin, atë mënyrën e sjelljes, qoftë edhe atëherë kur kemi qenë më së ngushti, edhe nga okupatori, prandaj ju lutem, keni durim, dëgjojeni tjetrin, respektojeni, kur ta përfundojë fjalën, mund ta merrni secili veç e veç, nuk ka asnjë problem.

Tjetra që po dua ta them me këtë rast, janë edhe angazhimet e kësaj qeverie në të gjithë sektorët, nuk mund ta mohoni se nuk ka një disiplinë më të shtuar në punë, kjo ekziston në administratë, kudo, te ministrat, te zëvendësministrat që po thuhet janë shumë. Për mendimin tim janë shumë se janë 72 a 73, por që nuk ka pasur më pak konsideruar si qeveri, as qeveria e kaluar, domethënë e kanë përcjellë njëra-tjetrën dhe më shumë duhet të lidhemi për programin, për veprimet dhe për atë çka mund të korrigjojë opozita në drejtim të pushtetit, se është obligim. Dhe, e kemi parë edhe dje seancën, i kemi parë edhe veprimet më herët. Është një paradoks në këtë vend që deputetët deponojnë në Gjykatën Kushtetuese një lëndë dhe nuk e presin Gjykatën Kushtetuese të marrë vendimin, por duan vendim para Gjykatës Kushtetuese, e nëse Gjykata Kushtetuese do të kishte marrë një vendim tjetër, qysh do të kishte mbetur ajo rezolutë ose ai dokument që duhej të prodhohej këtu. Vërtet është fatkeqësi kur opozita më shumë do të bëjë zhurmë, të bëjë pengesa se sa veprime konkrete, të cilat e çojnë vendin në drejtim të zhvillimit.

Edhe një gjë po dua ta them, kemi pasur kryeministra në këtë vend që kanë ditur të maskohen, kanë ditur të kenë pikëpamje në kundërshtim, ndoshta edhe me interesat e qytetarëve, kanë ditur edhe të mashtrojnë, por një kryeministër që flet drejtpërdrejt, që është i vërtetë, që është i sinqertë, edhe atëherë kur gabon, nuk e keni pasur dhe tash e keni rastin që ta shihni e ta dëgjoni se çka flet dhe, në të njëjtën kohë, veç pse është i tillë, i vërtetë, dikush do ta cenojë vërtetësinë e tij. Nuk mundet, sepse me shpifje nuk bëhen ato veprime të cilat mund ta cenojnë tjetrin. Edhe, ju kisha thënë që kjo mënyrë e sjelljes dhe ky debat, për mendimin tim i tejkaluar, vetëm do të prodhojë kundërthënie mes nesh, e në të vërtetë nuk kemi pasur nevojë, është dashur të bëhet në



kohën që duhet, nëse s'është bërë atëherë, atëherë pse ta presim 200-ditëshin që të flasim për 100 ditë.

Vazhdimisht po vonohet Kuvendi me këto veprime, a ka nevojë që të jetë Kuvend kur po presin ligjet që e kemi seancën edhe nesër, e në të cilën duhet t'i votojmë ligjet, të cilat janë të nevojshme shumë për qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të "Nismës", zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Në radhë të parë, po e shoh një tendencë që shumica e deputetëve më të zhurmshëm të këtij Kuvendi vijnë i mbajnë fjalimet e tyre dhe dalin jashtë sallës. Unë, kryesues, do të propozoja që seancat e ardhshme të mbahen pa transmetim televiziv dhe pa praninë e gazetarëve, pastaj do të shikonit se kush çka do të flasë këtu. Ne gjatë gjithë kohës si deputetë të Parlamentit të Kosovës, në vend që të koncentrohemi te temat reale, flasim sikur në fushata zgjedhore dhe paragjykojmë njëri-tjetrin, çdo kritikë, e cila e ka pikënisje rrëzimin e Qeverisë aktuale, është kritikë vetëm sa për të bërë zhurmë.

Ne si deputetë nuk jemi për ta lavdëruar Qeverinë e Kosovës, por jemi ata të cilët duhet ta kritikojmë, ta kontrollojmë dhe të dimë se cilat janë gabimet e kësaj qeverie gjatë këtyre 200 ditëve të qeverisjes së saj. Ama, në një moment kur unë e pata pyet një herë Edi Ramën, i thashë, a mundesh në një intervistë, bre burrë i dheut, të thuash një llaf të mirë për Sali Berishën? Tha, valla, veç një i çmendur si ai e ka bërë Rrugën e Kombit.

Domethënë, si ka mundësi që këtu të mos përmenden një, ose dy të mira të kësaj Qeverie? Po e marrim, po fillojmë me Termocentralin. Ne e dimë se ky termocentral aktual është kancerogjen. Ky ua sjell kancerin qytetarëve të Kosovës. Por, a më i keq do të jetë termocentrali i ri që do të ndërtohet, apo do të jetë më i mirë?

Ne nuk kemi kapacitete për ta ndërtuar ndonjë termoelektranë, që do të prodhonte energji atomike në Kosovë, prandaj në mungesë të kësaj mundësie, normalisht që kjo Qeveri e ka bërë një marrëveshje të jashtëzakonshme për qytetarët e Kosovës. Nuk u përmend fare këtu, për shembull, shqetësimi i çdo qytetari të Kosovës për hyrjen e mishit të prishur belg, që do të duhej të ishte shqetësimi më i madh, ose për hyrjen e tonelatave të barnave të skaduara nëpër vendet e ndryshme, që sillen këtu prej matrapazëve, pastaj derivatet e naftës, e tjera, e tjera...

Sa i përket Ushtrisë së Kosovës, që u fol këtu, është e vërtetë që Jakup Krasniqi e ka kundërshtuar në çdo takim me ndërkombëtarët shtimin e mandateve për Listën serbe. Është e vërtetë, është shumë e vërtetë e madhe që Lista serbe në këtë vend po bën harakiri më të madh kundër vetes së vet, sepse nuk po e trajton Kosovën si vendin e vet, po vazhdon ta trajtojë

Kosovën si vend armiqësor, bile-bile nuk po e trajton Kosovën as si zemra e Serbisë, se po ta trajtojë në atë formë njeriu nuk çohet e t'i bëjë 100 sabotime kundër zemrës së vet. Këta njerëz duhet të kthjellen, Lista serbe duhet të merret me ata matrapazë që kanë keqpërdorur miliona euro që janë dhënë nga Qeveria e Kosovës për t'i ndërtuar shtëpitë e serbëve për t'u kthyer në Kosovë. Këta të Listës serbe janë armiq të më të mëdhenj të komunitetit serb në Kosovë dhe në qoftë se sillen në këtë mënyrë, do të vijë një ditë kur këta do të flasin vetë me vete, do të mbeten herë duke vrapuar në Beograd te Vuçiqi, herë duke vrapuar nëpër ambasadat e huaja, duke thënë, "Aman, çka të bëjmë ne?".

Prandaj, kjo sjellje duhet të përfundojë, por duhet të përfundojë edhe sjellja e opozitës për të mos ia krijuar vakumin Listës serbe për të bërë hajgare me interesat e popullit të Kosovës. Unë do të dëshiroja që kryetari i opozitës, zoti Albin Kurti, së bashku me Avdullah Hotin, të jenë udhëheqës të bisedimeve në dialogun me Serbinë. Ne duhet të afrohem në këtë pikë, sepse është një pikë e përbashkët dhe duhet të ulemi, të merremi vesh për këtë punë dhe të mos ia krijojmë komoditetin Listës serbe që kur i teket të votojë, kur i teket të hyjë në sallë, së bashku me disa deputetë, po ashtu nga ana jonë, dhe kur i teket të dalë jashtë edhe të bëjë hajgare me ne.

Sa i përket Qeverisë së madhe, kjo Qeveri, jo që është e madhe, po qysh s'u vjen marre disa zëvendëskryeministrave, prej Dardan Gashit, edhe Behgjet Pacollit, edhe zëvendëskryeministër, edhe ministër. Po të ishte kryetari im Fatmir Limaj edhe zëvendëskryeministër, edhe ministër, unë të njëjtën gjë do t'ia thoja Famir Limajt, "pashë zotin kryetar, qysh s'të vjen marre?".

Tjetra, qysh nuk u vjen marre këtyre zëvendësministrave të shëtisin me paratë e taksapaguesve e t'u telefonojnë shoqatave kulturore nëpër Evropë, e veç t'u thonë "çoma një ftesë", e të ikin pa asnjë ftesë zyrtare e ta harxhojnë buxhetin e taksapaguesve të Kosovës? Gjithë ditën, shikoni nëpër Facebook, i shihni, herë në Itali, herë në Suedi, herë në Londër, herë në Gjermani. Për këto, kryeministri i Kosovës duhet të kërkojë raport dhe të thotë: "Kush të ka ftuar ty në Gjermani? Cili institucion të ka ftuar? Me para të kujt po udhëton atje?".

Prandaj, ky është shqetësimi im si deputet i Republikës së Kosovës. Çështja e Valës, Postë-Telekomit të Kosovës, nuk e diskuton askush këtu që 2 500 punëtorë rrezikojnë të mos i marrin rrogat e veta. Pse? Sepse, drejtori aktual, që kundër ligjit po tentohet t'i vazhdohet edhe për tre muaj mandati, e që vetëm ministri Bajram Hasani e ka kundërshtuar një gjë të tillë, para dhjetë ditëve i ka ndarë 2,5 milionë euro sponsorizime për jaranët e vet, për portalet e Ruisisë e të Serbisë në Kosovë, që ata për çka të flasim ne pastaj të na japin nga një rafal edhe të na shajnë. Domethënë, profesor Avdullah Hoti, Agron Mustafa i ka goditur me dy milionë e gjysmë edhe portalet, edhe mediet edhe për nja një vit, që në qoftë se ne shkojmë në zgjedhje të jashtëzakonshme, ato edhe një vit, i kanë marrë paratë, dhe do të shajnë neve në favor të qarqeve të ndryshme kriminele, që e kanë shkatërruar Postë-Telekomin e Kosovës.

Çështja e 60 milionëve të “Bechtel&Enka” po ashtu fare nuk u diskutua. Me 60 milionë do ta kishim bërë një spital më modern në rajon dhe po e përfundoj fjalimin tim me një shqetësim shumë të madh dhe me një thirrje për kryeministrin e Kosovës: Paratë që u dhanë për pavarësi të Kosovës dhe paratë që u ndanë nga rezervat e shtetit për përvjetorin e Skënderbeut, i bëj ftesë kryeministrit që të publikohen për çdo cent në ueb-faqen e Qeverisë. Urdhëro! Për epopenë e për të gjitha, për pavarësi, aty vidhet më së shumti: në epope vidhet, në pavarësi vidhet, tash do të vidhen për Skënderbeun. Këtu vidhen paratë! Krejt në emër të patriotizmit ne vjedhim. Qysh të vjedhim na? Ne s’mund edhe të vjedhim edhe të dalim të themi “jemi hajna”. Po, le të publikohet cent më cent çdo kompani, me çfarë destinacioni, kush po i shfrytëzon këto para, dhe të jemi transparentë.

Tani, i dashur profesor Hoti, edhe unë pajtohem me ty, ta votojmë demarkacionin, t’ia heqim lakun këtij populli të shkretë, që ia kemi gërditur jetën për të ndenjtur në këtë vend, le të dalin të rinjtë tanë nëpër Evropë, pastaj hajde bëhemi bashkë, e rrëzojmë Qeverinë, nuk është kurrfarë problemi. Por, gjërat që na bashkojnë, si demarkacioni, çështja e ushtrisë, çështja e asociacionit dhe temat e rënda, çështja e dialogut me Serbinë, për këto gjëra duhet të ulemi, pozitivë dhe opozitë, dhe të merremi vesh bashkërisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kinolli e ka fjalën në emër të “6+”-it.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Kjo Qeveri e kryeministrit Haradinaj, së bashku me partnerët e koalicionit, me gjithë sfidat që është duke u ballafaquar, me tema të mëdha e jetike për vendin, për shtetin e Kosovës, gjithsesi e ka treguar edhe përkushtimin dhe guximin e saj për t’u përballur me tema nacionale, si dhe me temat që prekin interesin e popullit të Kosovës.

Kjo qeverisje së bashku me partnerët e saj të koalicionit është duke i dhënë një dinamikë tjetër jetës në Kosovë. Kjo qeverisje ka marrë edhe vendime, me të cilat është munduar të gjejë zgjidhje për çështjen e qytetarëve të Kosovës me rëndësi jetike. Është më se normale që disa nga vendimet e Qeverisë Haradinaj mund të mos i kënaqin interesat e një pjese të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Është më se normale që të kemi zëra kundër vendimeve të marra, apo edhe shprehje të pakënaqësisë për vendimet e marra, por jetojmë në një shtet demokratik ku secili mund ta shprehë atë që mendon, përderisa Qeveria është duke u munduar të bëjë zgjidhjen më të mirë të mundshme për qytetarët e saj.

Ne si Grup Parlamentar “6+”, i përbërë prej komuniteteve pakicë, mund të themi se kemi relacione jashtëzakonisht të mira dhe të sqjerta me qeverisjen aktuale. Kjo Qeveri, qoftë nëpërmjet kryeministrit, apo nëpërmjet ministrave relevantë, është munduar që së paku t’i

dëgjojë brengat, nevojat, sfidat dhe prioritetet tona si komunitet pakicë. Mund të them me përgjegjësi të plotë se deri më tani përkrahja e Qeverisë dhe e kryeministrit Haradinaj asnjëherë nuk ka munguar në këtë drejtim. Por, edhe ne si Grup Parlamentar në mënyrë konstante, prej se ka ardhur në pushtet kjo Qeveri, jemi munduar dhe do të mundohemi ta luajmë një rol aktiv në përkrahje të proceseve, nëpër të cilat po kalon shteti ynë, por edhe të kërkojmë llogari e transparencë për vendimet e marra.

Jemi të vetëdijshëm që shteti i Kosovës gjendet para plot sfidave, problemeve, peripecive e temave nacionale, duke mos i harruar asnjëherë çështjet apo temat që prekin interesin, mirëqenien e popullit të Kosovës, por me guximin për t'u ballafaquar me tema të mëdha që e kanë preokupuar Kosovën, me përkushtimin e saj, me gatishmërinë për të bashkëpunuar me aktorët jashtë Qeverisë lidhur me temat nacionale. Besoj se kjo Qeveri e kryeministrit Haradinaj ka treguar shenja të mira që është duke punuar për të mirën e Kosovës dhe popullit të saj.

Prandaj, ne si Grup Parlamentar "6+", ashtu siç e kemi bërë me qeveritë e kaluara, gjithashtu edhe me këtë Qeveri jemi të gatshëm ta japim kontributin tonë të padiskutueshëm për çështjet që kanë të bëjnë me interesat e Kosovës, për qytetarët e saj, për tema nacionale, për të vetmin qëllim - përmirësimin e mirëqenies së popullit dhe integrimin e shtetit të Kosovës në institucionet ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Arbër Rexhaj.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Republika e Kosovës gjatë krijimit të institucioneve për çdo mandat po thyen rekorde skandaloze të numrit të ministrave dhe zëvendësministrave. Qeveria aktuale po nxiton t'ia kalojë asaj paraprake me numrin e zëvendësministrave. Sa më shumë të bashkohen në koalicione, aq më shumë po e zhvatin mizorisht Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Numri i shtuar i ministrave, i ministrive, numri i arritur në 100 i zëvendësministrave tregon për natyrën dhe karakterin e kësaj Qeverie. Sa më shumë pjesë të Buxhetit për vete, e sa më pak për shtresat tjera shoqërore. Një konglomerat interesash, ku kryeministri nuk mbërrin ta njohë as Kabinetin e tij. Sigurisht se është e pamundur ta bëjë këtë, duke pasur parasysh që çdo ditë kemi nga një emërim të ri të një zëvendësministri. Kjo Qeveri në planin qeverisës flet për zhvillim ekonomik të Kosovës, ndërsa zhvillimi ekonomik i supozuar nuk ka si t'i shpëtojë mendësisë së këtij konglomerati interesash. Aq private është qasja e këtyre, sa edhe rritjen e pagave ua bëjnë vetvetes.

Këto janë veçse disa nga shenjat që pasqyrojnë qëllimin e vërtetë kësaj Qeverie. Këta dinë të bëjnë vetëm zhvillimin e interesave të tyre individuale. Këtë dinë ta bëjnë shumë mirë. Për 100 ditë, kjo Qeveri tha se ka marrë 180 vendime. Në fakt, debati po zhvillohet në këtë temë dhe unë

do t'i përmbahem kësaj, por po t'i lexosh ato e dallon që, në mos qofshin diletanteske, janë vërtet të vobekta. Aty më së shumti ka aktivitete, përkundër punëve apo iniciativave. Në sektorët më vendimtarë, kjo Qeveri, për shkak të burimeve njerëzore që ka angazhuar, lehtësisht mund të quhet e padijshme, por kushton më shtrenjtë se çdo qeveri në vendet e BE-së në raport me Buxhetin dhe bruto-produktin vendor.

Premtimi i parë i kësaj Qeverie ishte liberalizimi i vizave, madje u tha brenda disa muajve, edhe pse asnjë masë nuk u ndërmor kundër krimit të organizuar prej Inspektoratit Policor, e deri te korrupsioni në klanet brenda shëndetësisë dhe arsimit të lartë. Në planin qeverisës, kjo Qeveri thotë se do ta ketë prioritet zhvillimin ekonomik të vendit, duke mos prioritizuar çka. Për shembull, në sektorin e bujqësisë thotë se prioritet do ta ketë bujqësinë, blegtorinë, vreshtarinë, bletarinë, pemëtarinë... dhe kjo vazhdon ende, duke mos prioritizuar në mënyrë konkrete se çfarë do të bëjë.

Po ashtu, ministër, në këtë sektor kaq jetik e kanë vënë Rikalon famëkeq, i cili akuzohet nga banorët e Lagjes "Dardania" në Prishtinë se ka keqtrajtuar shqiptarë e ka qenë i mobilizuar në makinerinë e Milosheviqit. Si mund një person e personazh i tillë të punojë për të mirën e bujqve, fermerëve e sipërmarrësve në Kosovë? Si mund që sindikatat e bujqve të kenë komunikim e bashkëpunim me të, kur ai as emrin nuk do t'ia dëgjojë. Nënshkruhet kontrata me "Contral-Global" 1,18 miliard për 500MW, s'ka as studim, s'ka as planifikim, as arsytim sesa energji nevojitet të gjenerohet në të ardhmen e Kosovës. Në vend që të hartohet plani i rindërtimit të Kosovës A, të fillojë përgatitja dhe plani i remontit për Kosova B, e mandej të planifikohet buxhetimi me fondet publike i Termocentralit të Ri, të bazuar në studimin e mirëfilltë të nevojave për energji elektrike dhe ngrohje, këta nxitojnë ta nënshkruajnë një kontratë kapitulluese. Pra, nëse do ta kishim një Qeveri serioze e të përgjegjshme si e Lëvizjes "Vetëvendosje", për shembull, ky plan i përshkruar më lart do të na lejonte që ne të projektonim e të vendosnim, jo në kushte të urgjencës për ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike.

Modelin financiar, volumin e kapacitetin, vendndodhjen, sigurimin e mjeteve për zhvendosjet eventuale në popullatë, studimin e mirëfilltë ambiental, si dhe disa shqyrtime të rëndësishme sa u takon sektorëve të tjerë të industrisë, që lidhen direkt me kërkesën për energji elektrike, siç janë: modeli i zhvillimit dhe prodhimit në "Trepçë", industri të reja të prodhimit vendës, rrjeti dhe kapacitetet e reja të furnizimit me ujë. Po ashtu, në këtë matricë të përgjithshme ne do të duhej t'i llogaritnim me detaje edhe për fitimet e interkonjeksionit me Shqipërinë dhe zhbllokimin e situatës nga Serbia për anëtarësimin në ENCO, pa i lënë anash të gjitha përpjekjet për t'i reduktuar në përgjithësi shpërdorimet e energjisë nëpërmjet programeve të eficiencës.

Në kushtet që jemi, nën kërcënimin e defekteve serioze në Kosova A, nën presionin e importit të energjisë, nën presionin e favorizimeve pa asnjë arsytim serioz për kompani private, as nuk do të kemi zgjidhje serioze, as të favorshme. Falja e borxheve për 58 milionë euro për kompani të

caktuara është bërë në mënyrë të paligjshme e, mbi të gjitha, pa ia sjellë Kuvendit, pa asnjë diskutim publik, gjë që pra edhe Qeveria pastaj u tërhoq. Kjo Qeveri as duhet të kishte ardhur, e lëre më të vazhdojë më tej. Nuk shpresojmë se këta do ta kthejnë kursin, aq më tepër që brenda saj pjesën kryesore e zënë të njëjtat personazhe që vijnë nga “Klani Pronto”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selmanaj e ka fjalën.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Të nderuar njerëz të mirë të këtij vendi,

Në fakt, sot po diskutojmë për një tematikë që kemi pritur gjatë ta diskutojmë, por, si zakonisht, koalicioni qeverisës nuk e di se si po organizohet kaq mirë për t’i devaluuar ose degraduar temat dhe po i shtyn shumë gjatë dhe më pas, besomëni pesë herë e kam ndërruar fjalimin tim, sepse shtyhej jo sot, jo nesër, jo pasnesër.

Megjithatë, dua të them kështu, në fillim kur zoti Haradinaj u zgjodh kryeministër, një numër i madh sidomos i njerëzve të tij dhe partnerëve tjerë të koalicionit, thoshin kështu: “Është njeri i zoti, i dijshtëm, punon, vullnetmirë dhe i kryen punët...”. E sot, a dini çfarë po thonë, i ka mbetur vetëm një element: “Po, i sinqertë bre është, edhe kur gabon po heq dorë, i shkreti”. Merreni me mend në çfarë shtate kemi ardhur. Po flasim për kryeministrin e vendit, krejt atributet tjera të cilat i kemi thirrur për ta bërë kryeministër, sot po themi: “Po, i sinqertë bre është...”. Po të sinqertë mund të jenë këtu një milion njerëz të këtij vendi, por s’mund të jenë burrështetas për t’i kryer obligimet e mëdha, të cilat i dalin për interesat e njerëzve dhe për interesat e shtetit.

Por, megjithatë, jemi ku jemi dhe tash po ballafaqohemi me këtë kryeministër. Unë mendoj kështu, që Qeveria aktuale është më e dëmshme dhe më e paparashikueshme që nga lufta që kemi pasur, sepse gjithçka mund të pritët. Rasti i 22 dhjetorit, kur na erdhi këtu ideja për rrëzimin e Gjykatës Speciale, na e dëshmoi se nga ky koalicion, nga këta njerëz, qoftë ditën, qoftë natën, mund të na vijë gjithçka në Kuvend të Kosovës dhe mund ta vëmë në pikëpyetje secilën të arritur që ne e kemi pasur për këto shtatëmbëdhjetë vjet në Kosovë. E tash, më vjen keq, por duhet të përsëris, për shumë tematika të cilat edhe të tjerët i thanë, sepse vendimeve të kundërligjshme dhe kundërkushtetuese asnjë qeveri s’ka mundur, edhe po të dëshironte, t’i marrë për kohë... Fali borxhe - u tërhoq, rriti paga - u tërhoq, e solli Gjykatën Speciale këtu - u tërhoq... E kam përshtypjen që dikush-dikush i është kthyer një zanati të vjetër, një shprehje e njohur që ka qenë në Kosovë, tërheqje taktike, bënin diçka dhe më pas strukeshin. Po nuk duhet të jetë kjo metoda, nuk duhet të jetë kjo forma. Edhe nëse vendimi është i keq, edhe nëse sjellja është e keqe, provoni ndryshe, sepse nuk është sjellje e institucioneve dhe njerëzve që bartin përgjegjësi të mëdha për këtë vend.

Nuk kam qare pa folur pak për çështjen që u lidh për ushtrinë, “LDK-ja kundër ushtrisë”, e kështu me radhë. Po dua të flas për çështjen e vendeve të rezervuara, për ta përkthyer shumë qartë: Vendet e rezervuara janë kështu, dhjetë deputetë gjithsesi do t’i kishin pasur serbët dhe çdo votë tjetër do të ishte përkthyer në mandat të ri, që i bie më së paku 15 deputetë serbë do t’i kishit pasur në Kosovë. Dhe, tash, unë nuk jam kundër kësaj kategorie etnike në Kosovë, për çdo respekt që mund t’i kenë ato, por mënyra sesi këta po sillen kundër interesave të shtetit të Kosovës, për mua, të më thonë edhe sot a e bëjmë ushtrinë sot, e ia vazhdojmë Listës serbe vendet e rezervuara, përsëri do të them “jo, jo, po rrimë edhe dhjetë vjet pa ushtri, sepse për sigurinë tonë po na ndihmojnë edhe miqtë tanë”, se sa ta vëmë në pikëpyetje secilin akt vendimmarrës në këtë Kuvend. Për secilin ndryshim kushtetues që ne dëshirojmë po duhet t’i lutim ata. Shiheni për demarkacionin. Nuk po e dimë kush. Kur shkoi Radojçiqi në vilën e Pacollit, dikush na tha që shkoi në vizitë, mendova që u krye kjo, sepse kjo është forma se si është arritur ky koalicion, “sa po jep, kush po jep” dhe më pas e kryejnë punën. As kjo s’po ndez më.

Dhe, tash, duke parë që as me para s’po mund t’i blini ata, merreni me mend perspektivën tonë po të varehim nga 15 apo 20 deputetë që nesër kishin mundur t’i kenë këta. Prandaj, vendimi i LDK-së në atë kohë, po jo vetëm i LDK-së, sepse unë po e shoh një urrejtje ndaj LDK-së, duke thënë që “LDK-ja e ka ndalur këtë”. Edhe po të dëshironit ta dëmtoni vendin kaq shumë me vendet e rezervuara, pa LDK-në i keni pasur 92 vota. Pse s’e keni bërë? Merrni vendime të rënda, shkatërrojeni këtë vend pa LDK-në, po s’mund ta bëni këtë, sepse i keni pasur, 28 deputetë i ka pasur LDK-ja atëherë, e 92 kanë qenë me ju. Nuk është fajtores LDK-ja. LDK-ja po, është fajtores që ka mbi barrën e vet, mbi supet e saj, perspektivën, të tashmen dhe të ardhmen e këtij vendi, sepse kështu po del. Nëse ju e përktheni, nëse kryeministri na thotë “turp çka keni bërë”, unë po ju them “turp çfarë po mendon edhe sot, pas gjithë kësaj kohe”.

Tash, të flasim edhe për një element tjetër. Po flasim për rezerva shtetërore. Në tremujorin e parë, ne po e vëmë në rrezik këtë çështje. Kjo i bie që dikush, jo që s’është kah di, por është kah do qëllimshëm ta shkatërrojë. Po, zoti ministër, unë juve ju kam dëgjuar në Kabinet qeveritar duke thënë, dëgjuar në takimin e juaj, kur keni thënë, “Hej, kujdesuni, planifikoni mirë, se çka jemi duke bërë me këtë tematikë...”. Të mos flas që u mor edhe një iniciativë këtu për t’i amnistuar disa akte të pakuptimta në Kuvendin e Kosovës, por, për fat, po më duket edhe këtu do të tërhiqen, sepse e dëgjova ministrin që tha “s’mund të ndodhë kjo”, e përshëndes që e ka bërë një veprim të tillë. Por, po them, kjo Qeveri do të mbahet mend si “Qeveri e tërheqjeve taktike”.

Tash, izolimi i udhëheqësve. Çfarë na ndodhi këto ditë? Filluam të gëzohemi si popull e si shoqëri, a po i jep vizë dikush kryeministrit tonë, apo jo. Lajm e kryelajm u bë më vonë në Kosovë, “hej sa mirë që kryeministri ynë ka vizë”. Merreni me mend, ku kemi ardhur. Asnjë vizitë bilaterale të këtij kryeministri nuk e kemi me asnjë shtet tjetër, përpos me Shqipërinë. Presidenti, jo se jo. Në takimet që ndodhin në skaje të takimeve rajonale, kjo është temë tjetër, po

flas për takime bilaterale, asnjë vizitë shtetërore nuk e kemi të kryeministrit të vendit për tematika të mëdha, demarkacioni, asociacioni, anëtarësimi i Kosovës në organizma ndërkombëtarë, reforma kushtetuese, as që po fliten këto, s'mund as të diskutoni.

Unë në fund si konkludim për këtë Qeveri kisha thënë kështu. Në planin e brendshëm, qeverisje e demoluar, pa koncept zhvillimor, pa ide të qarta për të ardhmen, pa plan për konsolidimin e mëtutjeshëm të shtetit të së drejtës, pa plan në arsim, shëndetësi, kulturë e sport, me një fjalë, Kosova e ka një Qeveri stihike, improvizuese, jokompetente, në shumë situata eksperimentuese dhe, në fund, impotencia vendimmarrës përfundon si zakonisht me tërheqje taktike.

Në planin e jashtëm, dështime në imazhin ndërkombëtar të Kosovës, me rrezik të diskursit për vendosjen e sanksioneve ndaj Kosovës. Ende nuk kemi strategji për aplikim dhe anëtarësim në organizma të rëndësishëm ndërkombëtarë, as në OKB, UNESK-o, në Këshillin e Evropës, Interpol, e të tjera. Po ballafaqohemi me tërheqjen e njohjes nga disa vende afrikane dhe shihni paradoksin.

Dy zëvendësministra të jashtëm, kur u tërhoq njohja nga shteti i Borundit, e dini çka thanë: shtet i vogël, i parëndësishëm. Shihe, hej, zëvendësministrat e jashtëm, në vend që të shqetësohen, sepse në kontekstin e të drejtës ndërkombëtare nuk ka peshë fort, ne po na duhen numra për t'u bërë pjesë e OKB-së, këta thonë, i parëndësishëm është, edhe nëse tërhiqet.

Ka filluar të vendoset diskurs për tërheqjen e njohjes në Austri, në Çeki, opozita atje e diskuton edhe këtë, edhe pse kemi ardhur kështu? Sepse e kemi demoluar kontestin e brendshëm të Kosovës.

Nëse ju ka mbetur pa rezon për ta mbrojtur këtë shtet, po ju lus, për të mirën e vendit, ta ndërpritni këtë koalicion dhe vendit t'i jepni mundësi për një strukturë dhe kulturë tjetër qeverisëse. Përndryshe, zgjatja e këtij koalicioni do ta dëmtojë shumë rëndë, ama shumë rëndë, të tashmen dhe të ardhmen e këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Hamza e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar zoti nënkryetar,

Kabinet qeveritar,

Shumë të respektuar deputetë,

Sa i përket punës dhe të arriturave të Ministrisë së Financave gjatë periudhës 100-ditore të Qeverisë, në vijim po ju prezantoj reformat dhe të arriturat kryesore.



Më lejoni t'ju them se 100-ditëshi për Ministrinë e Financave ka qenë periudhë shumë aktive dhe me rezultate konkrete, duke përfshirë edhe vendime të shumta.

Në fillim të mandatit të Qeverisë, si asnjëherë më parë, janë filluar dhe kompletuar dy procese shumë të rëndësishme: është fjala për rishikimin e buxhetit 2017 dhe buxhetin e vitit 2018.

Për sa i përket rishikimit të buxhetit 2017, Ministria e Financave, pas konsultimeve të gjera me organizatat buxhetore, ka propozuar rishikimin e buxhetit për të adresuar një numër të çështjeve mjaft të rëndësishme në kontekstin e buxhetit.

Këtu bëhet fjalë për çështjen e veteranëve, fushën e shëndetësisë, skemave sociale, sigurisë dhe natyrisht për një numër të projekteve kapitale, të cilat kanë pasur obligime kontraktuale.

Ndërsa sa i përket buxhetit të vitit 2018, i aprovuar në Qeveri, e më pas në Kuvend, në tërësi e reflekton prioritetet e Qeverisë, duke rritur buxhetin për sektorin e drejtësisë, shëndetësinë, arsimin, skemat sociale, rritjen e pagave për të gjithë punonjësit publik, mjete shtesë për projekt kapitale, rritjen e asistencës sociale për 20%, fillimin e financimit të skemave të përkrahjes për qytetarët e paaftësuar në vend të punës, për pagesën e mbështetjes financiare për qytetarët paraplegjikë dhe kujdestarët e tyre si dhe për mbështetjen e viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës.

Buxheti i vitit 2018 është ndërtuar në bazë të fortë, që siguron zhvillim ekonomik.

Krahas këtyre dy proceseve, Ministria e Financave është angazhuar shumë në përmbylljen e suksesshme të vitit fiskal 2017.

Në këtë kontekst, të hyrat buxhetore kanë qenë në linjë me planifikimin buxhetor, shpenzimet po ashtu dhe, rrjedhimisht, fundi i vitit 2017 që nuk mbulon vetëm 100-ditëshin, por që është derivat i punës gjatë kësaj periudhe, ka rezultuar të jetë shumë i suksesshëm, me një deficit më të vogël se sa rregulla fiskale me bilanc bankar adekuat dhe strukturë të favorshme të shpenzimeve.

Gjatë kësaj periudhe Ministria e Financave ka ndërmarrë hapa konkretë në fushën e politikave fiskale dhe përmirësimin e mjedisit afarist për lehtësuar edhe më shumë aktivitetin e zhvillimit të sektorit privat.

Është aprovuar vendimi për lirim nga tatimi doganor për të gjithë prodhuesit për lëndën e parë, gjysmëproduktet, lirimi nga tatimi doganor për vijat e prodhimit dhe pajisje teknologjike informative.

Po ashtu është provuar vendimi për lirim nga tatimi i akcizës për lëndën ndihmëse, e cila merr pjesë në procesin e prodhimit.

Është vazhduar me avancimin e shërbimeve elektronike për tatimpaguesit dhe kjo ka ndikuar direkt në kursimin e kohës për biznese dhe qytetarët.

Janë bërë avancime shtesë për procedimin më të shpejtë dhe efikas të kërkesave të bizneseve për rimbursimin e TVSH-së, duke përfshirë edhe mundësinë që një periudhë shumë të shkurtë tatimpaguesit të kenë qasje direkte në kërkesat e tyre për të monitoruar progresin në çdo fazë.

Hyrja në fuqi e këtyre vendimeve ka filluar direkt në dinamizmin e sektorit privat, e rrjedhimisht në rritjen ekonomike dhe në punësim.

Në kontekstin e bashkëpunimit me institucionet financiare ndërkombëtare janë përmbushur të gjitha kushtet për aderim të Kosovës në Kapitullin VIII të shteteve të zhvilluara nga Kapitulli XIV të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Janë aprovuar dy konventa ndërkombëtare për doganën për thjeshtësim të procedurave dhe përshkrim të mallit dhe është nënshkruar marrëveshja për eliminim të tatimit të dyfishtë me Qeverinë e Luksemburgut.

Janë ratifikuar dy marrëveshje financiare ndërkombëtare për kredinë në shumë prej 35 milionëve, që janë financim për projektet në bujqësi dhe zhvillim rural dhe konkurrueshmëri.

Është nënshkruar marrëveshja për kontribut me KFV-në për kapitalin e Fondit Kosovar të garantimit të kredive në shumë prej mbi 7 milionë euro, duke mundësuar garantimin e një portofolio kreditor në shumë prej rreth 26 milionë euro që nga fillimi i operimit të tij.

Është finalizuar programi kombëtar për reformat në ekonomi.

Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe i ka kushtuar një rëndësi të veçantë dhe agjendës legislative për të siguruar se të gjitha ligjet të aprovohen sipas planit të Qeverisë.

Gjatë kësaj periudhe janë aprovuar një numër i konsiderueshëm i ligjeve, duke përfshirë: Ligjin për plotësimin dhe ndryshimin e buxhetit të vitit 2017, Projektligjin për buxhetin e vitit 2018, Projektligjin për kontabilitet, auditim dhe raportim financiar, Projektligjin për tatim në pronë e paluajtshme, Projektligjin për masat doganore për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë intelektuale, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Projektligji për kontroll të brendshëm të financave publike dhe gjitha këto punë dhe këto merita i

referohen më së shumti stafit të Ministrisë së Financave, e sigurisht se është një pjesë e punës trashëguar edhe nga e kaluara.

Dhe krejt në fund, çështja e rezervës, është detyrë, është obligim i secilit ministër të Financave gjithmonë për të ngritur çështje që kanë të bëjnë me ruajtjen e disiplinës makro-fiskale dhe stabilitetit financiar të vendit.

Nëse i referohem historikut të shpenzimit të rezervave nga Qeveria në vitin 2016 janë shpenzuar mbi 8 milionë euro.

Në vitin 2017 janë shpenzuar 7 milionë, më pak një milion se sa në vitin 2016 dhe jam i sigurt që edhe në vitin aktual niveli i shpenzimit nga rezerva do të jetë i përafërt apo më i ulët se sa vitet paraprake.

Edhe një informatë, ministri i Financave gjithmonë ka obligim që të kërkojë disiplinë, që është përgjegjës për transparencë dhe llogaridhënie, mirëpo nuk është pozicioni i rezervës së ministrit pozicion që e rrezikon stabilitetin makro-fiskal të vendit.

Më tepër është qëllimi që të gjitha zhvillimet, ngjarjet të ndodhin në procedurë të planifikuara dhe në përputhje me parashikime.

Prandaj, te çështja e rezervës e kam thënë si ministër, po e përsërisë edhe këtu në Kuvend para juve, deputetë të nderuar, se disiplina për ruajtjen e stabilitetit makro-fiskal është top prioritet i këtij vendi.

Në rast se rrezikohet stabiliteti makro-fiskal, atëherë nuk mund të flasim as për prioritete të tjera.

Po të dhënat historike tregojnë që vitet paraprake ka pasur shpenzim të rezervës më të madhe se sa në vitin 2017 për një milion euro dhe në vitin 2018 do të jemi shumë të kujdesshëm me nivelin e shpenzimit të kësaj rezerve. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit!

Zoti Kuçi e ka fjalën.

**BLERIM KUÇI:** Faleminderit!

Së pari, dua ta falënderoj kryeministrin, edhe pse sot askush nuk e falënderoi për raportin 100-ditor të punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kryeministër, ju faleminderit!

Kjo ndodh për herë të parë kur një kryeministër i vendit i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës për punën e vet 100-ditësh të qeverisjes.

Ky raport përmban në brendësi material të mjaftueshëm, ku ne si deputetë ta kemi më lehtë të vlerësojmë, si për punën e kryeministrit, edhe për ministrat veç e veç në fushat përkatëse.

Duke u bazuar në këtë raport, jo jashtë rendit të ditës, po mundohem në formë të shkoqitur t'i theksoj disa elemente që mendoj se janë vetëm shembuj për të ilustruar punën e mirë dhe shumë dinamike të 100-ditëshit të parë të Qeverisë Haradinaj.

Për 100 ditë Qeveria Haradinaj ka përgatitur dhe ka dërguar për Kuvend mbi 44 projektligje, që i bie çdo të dytën ditë nga një ligj e ka sjellë në Kuvend. Kjo as që ka ndodhur ndonjëherë dhe vështirë që mund të ndodhë që një Qeveri të bie çdo të dytën ditë një ligj në Kuvend.

Të vetëdijshëm që në mesin e këtyre ligjeve ka pasur edhe ligje të rëndësisë së veçantë, që kanë qëndruar nëpër sirtarë të Qeverisë me vite të tëra, si për shembull, Projektligji për kryeqytetin e Republikës së Kosovës.

Kjo është bërë me modestinë dhe korrektësinë politike që posedon kryeministri Haradinaj, ky është vetëm një shembull.

Po ashtu, këtë raport, përveç 44 projektligjeve, e veçojnë edhe 224 vendime të rëndësisë së veçantë, si për shembull: Vendimi për rishikimin e matricës për metodën e llogaritjes së vlerës së kompensimit të objekteve të banimit në zonën kadastrale Shipitullë.

Ku me këtë vendim ka zgjedhur çështjen e zhvendosjes së fshatit Hade dhe më e rëndësishmja, e ka futur në prodhim Termocentralin dhe ka ndaluar importin e pakuptimit të energjisë dhe ka kursyer buxhetin për disa dhjetëra miliona euro. Problem ky i kamotshëm. Edhe kjo është bërë me guxim dhe përkushtimin e një kryeministri të vërtetë.

Ose vendimin e natyrës tjetër, vendim për të cilën miratohet kompensimi financiar i njëhershëm për deputetët e Kuvendit, të cilët kanë shpallur dhe miratuar Kushtetutën e Kaçanikut.

Përveç tjerave, një vendim për t'i nderuar të gjithë ata që kanë kontribuar për Republikën që kemi sot.

Pastaj, vendime të shumta që kanë të bëjnë me ish të burgosurit politikë dhe shoqatat e dala nga lufta.

Po ashtu, urdhëresa dhe implementimi, urdhëresa që gjatë fushatës së zgjedhjeve lokale 2017 të mos përdoren automjetet dhe logjistika e Qeverisë, kësaj i shtohet edhe mosaktiviteti i kryeministrit në fushatë gjatë orarit të punës. Kjo ka ndodhur për herë të parë, shpresojmë ta vazhdojnë edhe kryeministrat e ardhshëm.

Pastaj, masat për lehtësi për prodhuesit e vendit. Unë pashë që ministri i Financave e dha rezymenë e vet, po më duhet disa elemente t'i përsëris dhe t'i them ato edhe që tha ministri i Financave.

Masa kryesisht të bazuar në programin e tij qeverisë, pra në programin e kryeministrit Haradinaj për përkrahje të prodhuesve vendorë, vendime krejtësisht konkrete, si: Vendimin për lirim nga tatimi doganor për lëndë të parë për të gjithë prodhuesit, po them, për të gjithë prodhuesit.

Vendimi për heqje të akcizës për lëndë djegëse që marrin pjesë në procesin e prodhimit.

Vendimet të cilat jo vetëm që kanë krijuar e lehtësuar edhe lehtësua prodhuesit, por kanë mundësuar krijimin e vendeve të reja të punës dhe kanë bërë uljen e çmimit të blerjes për qytetarë.

Përkundrejt Qeverisë paraprahe që ka rritur TVSH-në për 12.5% dhe normalisht qytetarët kanë blerë shumicën e produkteve më shtrenjtë për masën e rritjes së TVSH-së.

Është interesant, edhe pse Qeveria Haradinaj ka liruar prodhuesit nga dogana dhe akciza, të hyrat në dogana për janar 2018 kanë qenë më të mëdha si asnjëherë më parë.

Kjo është politika fiskale e kryeministrit Haradinaj: të ulen taksat, të rriten të hyrat.

Normalisht, kur jemi te politikat fiskale dhe sistemi i grumbullimit të të hyrave, patjetër duhet theksuar, edhe pse nuk është në raportin 100-ditësh, vendimin e ministrit të Financave, edhe pse është në nisje, për mosinkasimin e TVSH-së në dogana.

Do të jetë një proces jo i lehtë, por kjo Qeveri nuk është për vendime të lehta, po them edhe një herë, kjo Qeveri nuk është për vendime të lehta, do të jetë përkrahja më e madhe që u është bërë ndonjëherë bizneseve, normalisht do të ndikojë pozitivisht në krijimin e vendeve të reja të punës dhe uljen e çmimeve të shumë produkteve.

Unë uroj që ky vendim të hyjë në fuqi nga janar i vitit 2019, si diçka shumë e kërkuar nga të gjitha bizneset. Ky është vendimi më i madh që ka marrë ndonjëherë Qeveria në fushën fiskale.

Në fushën e investimeve pa tjetër që duhet theksua kontratën që ka nënshkruar Qeveria e Republikës së Kosovës për ndërtimin e termocentralit prej 500 megavatësh.

Në raport thuhet se është investimi më i madh në Kosovën e pasluftës. Unë them se është investimi më i madh që është bërë ndonjëherë në Kosovë.

Ky investim përveç se do të sigurojë pavarësinë energjetike në Kosovë, do të sigurojë vende të reja të punës, sidomos në fazën e ndërtimit.

E besa, edhe e zgjidh një problem që kemi debatuar në seancën e jashtëzakonshme në këtë seancë, pra ndotjen e ambientit.

Pasardhësi i Shpend Ahmetit do ta ketë ajrin më të pastër në Prishtinë. E përmenda pasardhësin e Shpendit, sepse Shpendi nuk iu ka falënderuar Qeverisë Haradinaj për këtë çështje.

Çudi, edhe mediat nuk janë marrë me këtë temë.

Kontrata më e madhe investive e nënshkruar ndonjëherë është përmendur vetëm dy ditë, vetëm dy ditë. Kjo është Qeveria Haradinaj dhe marketingu i kësaj Qeverie.

Do ta bëj një krahasim në këtë kontekst. Sa i përket marketingut, Shpend Ahmeti me kredi bleu 20 autobusë, dy vjet nuk u ndal debati.

Kontrata më e madhe e historisë së Kosovës prej 1.3 miliardë eurosh debatohet vetëm dy ditë.

Kryeministër, edhe pse nuk je këtu, sigurisht do të dëgjosh, kryeministër, rregulloje çështjen e marketingut dhe promovimin e punës së Qeverisë.

Çuditërisht as TV Klani nuk u mor me këtë çështje, si duket ka qenë e zënë me donacionin e familjarëve të rastit Kumanova.

Kryeministër, e di që është çuar shumë pluhur për punën tuaj, edhe sot po ashtu, karvani le të shkojë përpara, e pluhuri le të mbetet mbrapa.

Po e shoh që e kam edhe një minutë, dua ta shfrytëzoj sot maksimumin.

E filloi një koleg imi me një përshëndetje të veçantë. Tha, ju përshëndes, njerëz të mirë të vendit! Dikur ka qenë njerëz modernë dhe jomodernë, ndoshta edhe të ndershëm e jo të ndershëm, “poshteni, neposhteni”, tani kemi nisur me këto ndarje.

Të mos harroj, sepse atë atë që e përmenda, e kam edhe në një formë edhe bashkëvendës, thuhet: “S’ka më rrezik se të jesh tepër modern, sepse së shpejti do të jesh jashtë mode”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Evgjëni Thaçi-Drăgusha.

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Qytetarë të Kosovës,

Meqenëse tema për të cilën debatohet sot është mjaft e gjerë, unë do të fokusohem në veprimet e Qeverisë së Kosovës lidhur me integrimet evropiane dhe anëtarësimin e vendit tonë në mekanizma ndërkombëtarë, si çështje me rëndësi vitale për vendin tonë.

Si vend që synojmë integrimin në familje e madhe të Bashkimit Evropian, zbatimi i obligimeve që dalin nga Marrëveshja e stabilizim asociimit janë prioritet.

Sipas raporteve të fundit, hapa konkretë janë marrë lidhur me këtë çështje.

Në kuadër të dialogut Kosovë-BE, Qeveria ka përmyllur me sukses rundin e parë të mbledhjeve të përbashkëta me BE-në për mbikëqyrjen e zbatimit të MSA-së.

Mbi 500 faqe me përgjigje në pyetjet rreth zhvillimeve kryesore në zbatimin e reformave për aderim në BE i janë dorëzuar shëfës së Zyrës së BE-së në Kosovë.

Hap i rëndësishëm në këtë drejtim është rishikimi, finalizimi dhe miratimi nga Qeveria i programit kombëtar për zbatimin e MSA-s, i cili së shpejti pritet të aprovohet edhe nga Kuvendi.

Ky program është dokumenti kryesor strategjik kombëtar për zbatimin e agjendës evropiane që mbulon periudhën 2017-2021 dhe përfshin të gjithë kapitujt e ‘acquis communautaire’.

Është punuar edhe në përmbushjen e prioriteteve të agjendës për reformën evropiane.

Në kuadër të reformave në administratë publike është përgatitur pakoja e ligjeve kornizë, e cila synon krijimin e një administrate publike efektive dhe në shërbim të qytetarëve.

Janë hartuar dhe presim miratimin nga Kuvendi të një serë projektligjesh, të cilët janë në funksion të reformës në fushën e sundimit të ligjit.

Ndërsa reformat për zhvillim ekonomik kanë vazhduar duke sjellë edhe rezultate.

Në këtë aspekt Banka Botërore në raportin e saj të të bërit biznes e ka ranguar Kosovën në mesin e vendeve më reformatore në botë.

Duhet theksuar se me sukses u procedua Marrëveshja IPA 2016, e cila kishte dështuar të procedohet nga Qeveria e mëparshme.

Këto janë vetëm disa nga obligimet, të cilat janë realizuar ose janë në proces të realizimit, ndërsa mbesin edhe shumë të tjera, të cilat duhet të përmbushen shpejt dhe korrekt.

Kosova bëhet gati që këtë fundvit të aplikojë për marrjen e statusit të vendit kandidat.

Skenës politike në këto momente i nevojitet përkushtim, qëndrim dhe guxim.

Prandaj, përgatitjeve për këtë proces duhet t'u jepet mbështetje dhe vëmendje e veçantë nga të gjithë, pa përjashtim.

Sfidë dhe përgjegjësi e njëjtë mbeten edhe kriteret për liberalizimin e vizave. Kriteret të cilat i kemi këtu që nga udhërrëfyesi i vitit 2012, për përmbushjen e të cilave kemi pasur kërkesa nga zyrtarët më të lartë evropianë dhe amerikanë. I fundit ishte ndihmëssekretari i Shtetit për Çështje Evropiane dhe Euro-aziatike, Wess Mitchell, dy ditë më parë.

Në këtë aspekt, luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe ratifikimi i marrëveshjes për shënimin e kufirit mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi janë dy drejtime, për të cilat të gjithë së bashku duhet të punojmë, në mënyrë që të forcojmë sovranitetin e vendit tonë dhe të dalim nga izolimi.

Njërin kusht e kemi në dorë ne si deputetë të këtij Kuvendi, ndërsa për kushtin tjetër, sipas raporteve që kemi, Qeveria ka ndërmarrë hapa konkretë dhe vazhdon të punojë në forcimin e rendit dhe ligjit. Këtë e dëshmon edhe raporti i fundit i "Transparent International", ku Kosova ka bërë përparime të dukshme dhe renditet disa vende më lart në luftimin e korrupsionit.

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Kosovës po bën përgatitje të aplikojë për anëtarësim edhe në Këshillin e Evropës, Interpol, UNESCO dhe mekanizma të tjerë ndërkombëtarë.

Vitet 2018-2019 janë mjaft të rëndësishëm për integrimin e vendit, prandaj, edhe një herë e theksoj, se nevojitet përkushtim dhe mbështetje nga të gjithë si dhe koordinim i resorëve të Qeverisë mes veti dhe institucioneve për interesa të përbashkëta.

I nderuar Kabinet qeveritar,

Si deputete e këtij Kuvendi unë kërkoj nga kjo Qeveri që të respektohen ligjet dhe institucionet në çdo vendim dhe veprim të saj.

Puna e Qeverisë të udhëhiqet nga synimi që të sigurohet një jetë më e mirë për të gjithë qytetarët.

Të hartojë strategji dhe plane afatgjata për zhvillimin e shtetit.



Të rrisë transparencën në çdo aspekt, në mënyrë që të sigurohet llogaridhënia, si një ndër parimet e qeverisjes së mirë.

Të respektohen dhe të përmbushen të gjitha detyrimet kontraktuale, në të cilat hyn Qeveria për të siguruar fuqizimin, pavarësinë, meritokracinë dhe profesionalizmin në procesin e rekrutimit të pozitive të larta drejtuese në Shërbimin civil dhe të bordeve të ndërmarrjeve publike.

Ajo që dua të theksoj fuqishëm e që është qenësore është të ruhen dhe të forcohen edhe më shumë marrëdhëniet me shtetet mike, sidomos me ato të BE-së dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në funksion të vlerave dhe interesave të përbashkëta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Albin Kurti e ka fjalën.

ALBIN KURTI: Të nderuar qytetarë të Republikës!

Deputetë të Kuvendit,

Ministra të Qeverisë,

Qeveria aktuale është një qeveri e madhe, e cila e ka pasur një vendim me peshë të madhe, aq të madhe sa që është më i rëndë se sa të gjitha vendimet e tjera marrë së bashku. Është kjo kontratë e nënshkruar për ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re”, kontratë me fondin investiv “Contour Global”. Me këtë rast, kjo Qeveri i garanton “Contour Global” shitjen e energjisë nëpërmjet një ndërmarrje të posaçme publike, që do të themelohet.

Sipas kontratës, “Contour Global” do t’i paguhen të gjitha kostot, këstet e kredisë, kamata e tyre, fitimi edhe tatimi, sepse “Contour Global” e do fitimin e garantuar, duke mos e marrë fare përsipër rrezikun. Për të qenë më keq se kaq, “Contour Global” e do edhe normën tejet të lartë të kthimit të brendshëm në kapital prej 18,5%, që ia ka nënshkruar Qeveria aktuale. Shtrohet pyetja: Pse një normë kaq e lartë e kthimit të brendshëm në kapital? Pse duan kaq shumë e kaq shpejt? Bëhet fjalë për “Hedge Funds”, apo për çka? Dhe, unë besoj që është e domosdoshme që paraprakisht të dihet prejardhja, pronari dhe struktura e kapitalit të “Contour Global”.

Në vitin 2008, në Gjermani është aprovuar “risk limitation act”, i cili i detyron investitorët që ta zbulojnë edhe origjinën e fondeve të tyre, edhe qëllimet e tyre, sepse investitorët financiarë që synojnë përfitime të mëdha e të shpejta i zhveshin kompanitë nga asetet e tyre edhe duke ua hapur apo shkyçur rezervat dhe i lënë pastaj të dobësuar shumë.

Prandaj, një “risk limitation act” sikur në Gjermani në vitin 2008, unë besoj që duhet të miratohet edhe në Republikën tonë të Kosovës. Duhet të dihet prejardhja, struktura dhe pronari apo aksionarët e këtij “investment fund”, fondi investiv. Çmimi final, i cili dikur propagandohej që pas nënshkrimit me “Contour Global” nuk do të jetë kurrsesi mbi 80 euro për megavat, në

kontratë është e qartë se ia kanë vendosur edhe një bonus prej 20%, në qoftë se prodhohet madje edhe vetëm 1 megavat orë më shumë.

Si zakonisht, shteti i Kosovës, qytetarët si tatimpagues nëpërmjet kësaj qeverie që bëri këtë kontratë të dëmshme do ta mbulojnë gjithë riskun, do ta paguajnë atë, do ta japin falas tokën, burimet të shiten me çmim më të ulët sesa prodhimi, të zhvendosët banorët, ne me buxhet t'i mbulojmë kostot, ta sigurojmë ujin, ta japim infrastrukturën e ujit dhe të negociojmë për çmimin e ujit jashtë rregullave dhe ta marrim përsipër atë si shtet, me ç'rast edhe mos shitjen aty për aty të energjisë së prodhuar ne e paguajmë me këtë bonusin prej 20% të çmimit, kur sistemi nuk ka nevojë më për të.

Madje, Qeveria me kontratën për bartjen e tokës ka vendosur që t'ia shesë tokën e KEK-ut "Contour Global", aty ku do të ndërtohet termocentrali i ri me çmim prej 10 euro, gjithsej për plot 15 hektarë tokë në shpërputhje me çmimin e shpronësimit në Shipitullë. Kështu, edhe Ligji për ndërmarrjet publike, edhe Ligji për ZRRE-në, edhe Ligji për prokurimin publik gjithsesi janë shkelur me këtë kontratën, e cila është bërë me "Contour Global".

U fol edhe për të ashtuquajturat zona industriale apo parqe ekonomike, të cilat janë bërë nga këto qeveri, jo vetëm nga kjo, dhe mua më duhet të theksoj që edhe raportet e progresit të Komisionit Evropian vit pas viti kanë theksuar që autoritetet kanë vazhduar në themelimin e zonave ekonomike dhe të parqeve industriale, por, megjithatë, kjo është bërë pa një plan nacional. Pra, raportet e progresit të Komisionit Evropian janë ankuar që këto zona ekonomike bëhen pa një plan zhvillimor nacional.

Duhet ta kemi parasysh tërësinë, e pastaj pjesën. Nëse fillon me copëza aty-këtu, atëherë kjo shkon në dëm të tërësisë. E Republika është e përgjithshme. Nëse jemi republikë, që do të thotë se s'kemi mbret, nëse republika jonë është republikë parlamentare, nuk kanë kuptim këso zonash ekonomike pa njëfarë plani zhvillimor nacional, sepse edhe vetë Raporti i Progresit të Komisionit Evropian na e kërkon neve një gjë të tillë, besoj me shumë të drejtë. Merreni me mend, Qeveria i është drejtuar një fondi investiv privat që ta ndërtojë Termocentralin "Kosova C", ose "Kosova e Re", sido që do të quhet ajo në fund, ndërkohë që ne nuk i mobilizojmë mjetet, të cilat i kemi si shtet.

Ju e dini që Fondi i Kursimeve Pensionale është tash 1,6 miliard euro i trashë, e vetëm 3% investohen në Kosovë. Nuk ka kurrfarë kuptimi që ministrat e kryeministrat të kërkojnë investime prej jashtë, kur ne nuk i mbajmë paratë tona brenda vendit, por i nxjerrim ato jashtë.

Çfarë investimesh prej jashtë kërkojmë ne, kur ne paratë tona, në emër të pasigurisë këtu, apo kush e di pse, i nxjerrim jashtë vendit? Në vend se të kemi një fond investiv privat, që vjen këtu të na ndërtojë neve termocentralin, është shumë më mirë që ne ta krijojmë një fond sovran

investiv dhe për këtë arsye Lëvizja “Vetëvendosje” insiston që ta shpërbëjmë Agjencinë e Privatizimit dhe ta themelojmë fondin sovran të Republikës së Kosovës me mandat të investimit, përmirësimit, ristrukturimit dhe rritjes të probabilitetit të aseteve me rëndësi strategjike industriale të vendit tonë.

Fondi sovran do të bëhej aksionari kryesor i të gjitha ndërmarrjeve të mëdha publike në Kosovë, KEK, PTK, “Trepçë”, me mundësi zgjerimi edhe në industri tjera. Atë do ta themelonim ne si Kuvend i Republikës, neve do të na përgjigjej ai fond sovran dhe me bord mbikëqyrës të emëruar pikërisht nga Kuvendi, me Kryeministrinë e Presidencën, edhe me nga një përfaqësues nga shoqatat e biznesit e të BSPK-së. Bordi drejtues në këtë fond sovran do ta zgjidhte një drejtor ekzekutiv të tij, që do të ishte një figurë apartiake, me përvojë globale ekzekutive në biznes dhe i cili do ta drejtonte fondin sovran në baza korporative, pra në formën e një fondi investues.

Në vend se të kemi fonde investive private që vijnë këtu dhe ne dorëzohemi si shtet para tyre, do të duhej që ne ta krijojmë një fond sovran investiv.

Fondi ka funksion të veprimit si aksionar kryesor në industrinë e mëdha strategjike të Kosovës, ndërmarrjet aktuale publike dhe ndërmarrjet e caktuara në menaxhimin e AKP-së do të transformoheshin në shoqëri aksionare me fondin si aksionarë mazhoritar. Vlera e fondit do të përcaktohej nga vlera e këtyre korporatave që i ka ky fond. Shembull është Ministria e Thesarit e Polonisë, e ndryshme nga Ministria e Financave, e cila është aksionare në shumë industri polake. Ndarja e fondit si entitet kuazi-publik e bën atë sa më të izoluar nga mundësia e kapjes politike, krijon mundësi për udhëheqje profesionale jopartiake, jopolitike dhe me performansë që në fund matet sipas parametrave financiare kthimin në investim.

Për shtetin, fondi është instrument i politikës industriale. Fondi mund të vendosë edhe të shesë aksionet që i kontrollon në industrinë e Kosovës, duke i mundësuar investime në industri Fondit Pensional 1,6 miliard, merreni me mend, bankave edhe investitorëve privatë vendorë e të jashtëm, sigurisht edhe mërgatës sonë, në mënyrë që remitencat e saj të mos jenë vetëm për mbijetesë sociale, duke konsumuar ne këtu mallra të importit, e duke nxjerrë paratë e mërgatës me shpejtësi jashtë vendit.

Kjo do të ishte alternativë ndaj shitjes së aseteve fizike të ndërmarrjes sipas modelit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Si rregull, fondi do të ishte aksionar mazhoritar në një numër firmash strategjike, energjetika, telekomi, minierat. Si i tillë, fondi mund të shërbejë si bazë për organizimin e një tregu të kapitalit, apo bursës. Pra, kjo në vend të fondit investiv privat që s’i dihet prejardhja e kapitalit, as aksionarët, e as struktura.

Dhe, krejt në fund, besoj që Posta dhe Telekom i Kosovës është në krizë. Krizën nuk e zgjidhin shkaktarët, prandaj është e domosdoshme ndërhyrja e Kuvendit të Kosovës me një debat dhe rezolutë.

Sa i përket ushtrisë, neni 10.2 në Ligjin për FSK-në thotë: “FSK-ja është e armatosur lehtë dhe nuk do të ketë armë të rënda, siç janë tanket, artileria e rëndë, apo kapacitetet sulmuese ajrore”.

Pra, është e mundshme që FSK-ja të ketë helikopterë, për shembull, por nuk kanë qenë të interesuar për një gjë të tillë. Thuhet që FSK-ja duhet të ketë armatim të lehtë. A e dini çka është armatimi i lehtë? Çdo armatim i cili nuk ka nevojë për tërheqje të motorizuar, quhet armatim i lehtë. Ne nuk i kemi shfrytëzuar as mundësitë që i ofron Kushtetuta dhe Ligji për FSK-në. Njerëzit që nuk e kanë shfrytëzuar, qeveritë që nuk i kanë shfrytëzuar mundësitë aktuale nuk janë këtu për të na i rritur ato. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kusari-Lila e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot, në vend të 100-ditëshit, është mirë të bëjmë përmbledhje të 188-ditëshit të Qeverisë Haradinaj, qeveri kjo e cila të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës na tregoi se si nuk duhet qeverisur. Për të gjithë ne në opozitë, është shumë e lehtë të përgatitemi për atë se çfarë do të pasojë në Kosovë në vitin 2018, me programet zgjedhore, se krejt çfarë kjo Qeveri ka bërë, duhet ne të mos e përfshijmë, ose ta bëjmë të kundërtën e tyre.

Sa beson kryeministri personalisht vetë në punën e vet dhe të Qeverisë së vet, në mënyrën më simbolike e ka treguar akti i marrjes së pasaportës së Republikës së Shqipërisë. Në kohën kur Kosova po mbahet e izoluar, kryeministri me familje pajiset me pasaportë, e cila i ofron mundësinë e lirisë së lëvizjes. Kjo Qeveri e ka prezantuar një standard të ri në mbrojtjen dhe shtyrjen përpara të privilegjeve të veta personale para të gjithë të tjerëve. Asgjë të guximshme dhe parimore nuk kemi parë nga kjo Qeveri. Ky është slogani ose kjo është forma dhe mënyra me të cilën kanë ardhur, se “ne jemi për vendime të guximshme”. Guximi i vetëm që është lidh me këtë Qeveri është që vetes t’ia akomodojnë së pari militantët politikë me numrin më të madh të mundshëm të ministrive të deritashme në Republikën e Kosovës, me 22 ministri, afërsisht i jeni afruar Kinës, ajo po dihet, me 72 ose 74 zëvendësministra. U përmend më herët disiplina në punë, nuk e di kush po e përcjell disiplinën në punë, se numri është aq i madh i zëvendësministrave, i ministrave, i shërbyesve civilë sa me të vërtetë duhet angazhuar dikë në veçanti për ta përcjellë numrin e tyre se kur po dalin, ose kur po e lëshojnë punën.

Gjithashtu, e kemi parë kushtëzimin e kryeministrit me vendimmarrje, ose me përcjellje, ose me tërheqje të shfuqizimit të Gjykatës Speciale, me lëshimin e vizave. Kjo besoj se e tregon më së miri dorëzimin e shpejtë dhe mungesën e guximit të një kryeministri për një çështje që e konsideron qoftë patriotike, qoftë parimore.

Shtyrja e dhënies së vizës nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, shtyrja e dhënies së vizës nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, tërheqja e Ligjit për shfuqizimin e Gjykatës Speciale, nuk e di çka tregojnë. Vetëm tregojnë për mungesë të guximit, tregojnë për mungesë të shtyrjes së një kauze me të cilën është prezantuar përpara opinionit publik. Qeveria e Kosovës, jo që ka dështuar në sjelljen në binarë normalë të funksionimit të ndërmarrjeve publike të Kosovës, por përderisa ne po e trajtojmë punën e kësaj Qeverie, ne e shohim se e kemi një krizë fundamentale, ndoshta të ekzistimit apo të mosekzistimit të ndërmarrjes publike “Trepça”, ndërmarrje strategjike, kemi paralajmërimin se muajin e ardhshëm Posta e Kosovës nuk ka mundësi që të paguajë më paga për punëtorët në numër masivisht të rritur gjithmonë me ndërrimin e qeverive dhe me dërgimin e listave të niveleve më të larta qeveritare për ata që duhet punësuar, patën apo nuk patën zyra, patën apo nuk patën vendpërshkrim për punën e tyre, patën apo nuk patën performansë të mirëfilltë të biznesit.

Të njëjtën e ka paralajmëruar edhe Telekom i Kosovës. Në të gjitha asetet strategjike në Kosovën e pasluftës, ne kemi dështuar si shtet, dhe kjo është bërë strumbullari ose kulmi i saj në Qeverinë Haradinaj. Kjo Qeveri në afat rekord ka arritur që të mos e përtërijë planin, ose të dalë nga programi i Fondit Monetar Ndërkombëtar, dhe kjo si rrjedhojë e mosmenaxhimit si duhet me listën e veteranëve, që gjithashtu të kemi nxjerrjen e Kosovës nga EQAR-i, apo Regjistri Evropian i Cilësisë për Arsimin e Lartë, për arsye ende të panjohura.

Ne kemi pasur interpelancë në këtë Kuvend edhe ende sot saktë nuk e dimë se cilat janë arsyet e shkarkimit të drejtorit dhe bordit për shkak se forma më e mirë me të cilin kryeministri Haradinaj debaton me deputetët është ofendimi, është gjuajtja e ulët në personale, ose bërtima e tij “çka keni o burra”, e t’ia kujtojmë kryeministrit që këtu ka edhe gra, edhe goxha të forta, por për të është me rëndësi të flasë me gjuhën “çka keni o burra”, por ende krejt çka na mungon neve prej tij, ose prej Kabinetit të tij, janë argumentet. Nëse keni argumente t’i prezantojmë ato, se pse me të vërtetë, më 17 prill ishte në agjendë përjashtimi i Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga EQAR-i. Agjenda është e publikuar, të gjitha janë zyrtare, njëjtë sikur ka qenë edhe komunikimi deri në atë pikë.

Kjo Qeveri gjithashtu në formën më të mirë të mundshme edhe më transparente të mundshme e ka bërë politizimin e pozitive më të larta të shërbyesve civilë. Nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar edhe zyrtarisht ka në disa raste tërheqje nga panelet zgjedhore për sekretarë të përgjithshëm të ministrive. Për të gjithë ata që nuk e dinë, kjo është pozita më e lartë e

shërbyesve civilë, të cilët zgjidhen jashtë çdo standardi. Nëse ka pasur të paktën modifikim politik, të kualifikimeve të tyre, atëherë sot as ajo më nuk ekziston.

Kjo Qeveri i ka sjellë deri në atë derexhe sa vetë ministrat brenda Kabinetit qeveritar më nuk pranojnë që vendimeve të kryeministrit t'ua bëjnë aminin. E kemi pas rastin me rritjen e rrogave nga ministri i Financave, e kemi pasur rastin me emërimin e sekretarit të përhershëm të Ministrisë së Tregtisë nga ministri i Administratës, që të dy i kanë thënë “jo”. I pari thotë “nuk ka bazë ligjore”, i dyti i thotë që “asnjëri nga kandidatët nuk është i kualifikuar për t'u zgjedhur”, e për këtë arsye Ministria e Administratës nuk e rekomandon asnjërin.

Domethënë, përkundër të gjitha këtyre, kjo Qeveri prapë vazhdon me këmbëngulje dhe guximin e vetëm që e ka për shkelje të ligjit, dhe kjo është forma e cila sot po përdoret për vendimmarrje. “Unë kam guxim, unë e kam forcën, qoftë edhe atë fizike dhe e shkel ligjin!”. Kjo Qeveri e ka sjellë skandalin në përditshmëri dhe gjithashtu e ka prezantuar brutalitetin si formë të re të komunikimit.

Sot, kryeministri duhet ta shfrytëzonte, nëse do të kishte pak logjikë institucionale, ose nëse do të kishte pak vullnet për ndërtimin e një konsensusi politik, të na tregonte se cilat janë mësimet që i kanë nxjerrë prej 100-ditëshit të parë, se deri më tash në karrierën e tij e ka pasur një 100-ditësh famoz që është përmendur “se sa mirë do të jetë kur të vjen për herën e dytë, se e ka pasur një 100-ditësh shumë të suksesshëm”, të na tregojë pse është 100-ditëshi i mandatit të dytë si kryeministër kaq skandaloz dhe çka ka në plan ai të bëjë që ta përmirësojë performansën e tij.

Sot ai duhet të vinte dhe gjithashtu të na tregonte se cilat janë planet për të gjitha këto dështime, për çfarë po ndodh në sektorin e arsimit, pse fëmijët tanë dy javë më herët tri ditë janë jashtë procesit mësimor, edhe pse përmirësohen kushtet atmosferike? Pse një ditë tjetër fëmijët janë jashtë mësimit për arsye se nuk arrihet marrëveshja me SBASHK-un? Gjithashtu, kryeministri duhet të na tregonte se çfarë plani ka ndërmarrë urgjent që ta nxjerrë “Trepçën” nga kriza, gjithashtu se çfarë do të bëjë me Postën dhe Telekomin, në mënyrë që ta ndërtonte një konsensus që ne të jemi në gjendje të besojmë se kjo Qeveri me të vërtetë e paska seriozisht dhe me të vërtetë kjo Qeveri e ka një marrëveshje ndërmjet saj, në mënyrë që ne ta kemi të qartë rrugën e Kosovës.

Ne e kemi një Qeveri në të cilën të gjithë krerët politikë të saj, ose partiakë, ata që kanë nënshkruar marrëveshjen e koalicionit, nuk arrijnë ta japin një deklaratë të njëjtë, ose të përbashkët për një temë të rëndësishme.

Kur e kemi pasur çështjen e demarkacionit, të gjithë kanë deklaruar sipas qejfeve të tyre. E kemi pas fillimisht kryeministrin që e ka kundërshtuar, kryetarin e Kuvendit që ka thënë se duhet të miratohet, e kemi pasur zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme gjithashtu që

ka thënë se duhet të miratohet, Listën serbe që e ka demantuar, ose që nuk e ka miratuar, asnjëherë nuk ka pasur trajtim njëzëri të çështjeve të rëndësishme nga partnerët e koalicionit.

Në këtë Qeveri, opozita nuk është problem. Në këtë qeveri pozita dhe partitë politike brenda saj janë problemi kryesor.

Kthimin e zonës ushtarake në Prizren në Qendër Inovacioni, kryeministri ia atribuoi suksesit të vet. Tash pasi këtu u fol për kohët kur dikush ka qenë dëshmitar, unë po ia tregoj kryeministrit një ngjarje të mirëfilltë ku kam qenë vetë dëshmitare. Ish-ambasadorja gjermane, Angelika Viets, në zyrën time si kryetare e Gjakovës, kërkonte informata për planin e fizibilitetit për zonën industriale që e kishin bërë në Gjakovë, duke deklaruar se të njëjtin plan e kanë për Prizren. Megjithatë, arsyeja se pse nuk kanë shkuar në Prizren se kryetari i atëhershëm i Prizrenit ishte me aktakuzë dhe proces gjyqësor të hapur dhe deri në mbajtjen e zgjedhjeve në Prizren, Qeveria Gjermane e ka kufizuar veten që të bashkëpunojë me Prizrenin. Prandaj, ndryshimi dhe sukcesi në Prizren duhet t'u atribuohet sot qytetarëve të Prizrenit dhe jo Qeverisë së Republikës së Kosovës, se për Qeverinë e Republikës së Kosovës prapë sot Prizreni nuk e kishte, ose nuk do ta kishte të valuar flamurin gjerman për Qendrën e Inovacionit.

Qeveria është dashur të na tregojë sot, ose kryeministri, kur do ta sjellë Ligjin për paga? Kur do ta sjellë Ligjin për Qeverinë me ministri të reduktuara? Guxim do të ishte sikur nga 22 ministri t'i kthente në 15, me afat që duhet të bëhen 13 ministri. Reformën e mirëfilltë të Administratës Publike dhe jo politizimin e mëtutjeshëm të saj. Të trajtohet si duhet çështja mjedisore. Ne e patëm bllokimin e Prishtinës për dy ditë, por asnjë gjë konkrete pas asaj nuk ka ndodhur në mënyrën e mirëfilltë. Planin se si të nxirren nga kriza ndërmarrjet publike. Cili është afati kohor dhe çfarë duhet të bëjmë me to? Diskutimin për projektet e BERZH-it. Tha 600 milionë i keni prezantuar, askush ose në asnjë mënyrë nuk e ka thënë në mënyrë të mirëfilltë cilat janë ato projekte.

Kjo Qeveri ka nevojë që të ketë një ide të qartë për qeverisjen. Jo që të fillojë luftën me opozitën. Mandatin e ka marrë për të qeverisur, le të qeverisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, zoti Reçica.

MINISTRI SKENDER REQICA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Më lejoni që shkurtimisht të paraqes para jush disa nga të arriturat e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale brenda 100-ditëshit të parë të qeverisjes.

Po e filloj këtë raport në fushën e politikave dhe planifikimit strategjik.

Në kuadër të planit të Qeverisë dhe agjendës evropiane, brenda 100-ditëshit janë finalizuar Strategjia Sektoriale 2018-2022 dhe plani për punësimin e të rinjve, 2018-2020. Gjatë periudhës 100-ditore, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nëpërmjet Agjencisë së Punësimit ka ndërmjetësuar në punësimin e 2 248 personave në punësimin e rregullt, prej tyre 1 134, ndërsa në kuadër të masave aktive në tregun e punës janë trajtuar 1 114 punë kërkues. Po ashtu, nëpërmjet qendrave të aftësimin profesional janë trajtuar 1 176 punëkërkues dhe janë certifikuar 725 prej tyre.

Sa i përket praktikës në punë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, së bashku me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe me UNDP-në, ka nënshkruar 200 kontrata për praktikë në punë për të sapodiplomuarit në universitetet e ndryshme të Kosovës. Me qëllim të përmirësimit të punës dhe punësimit, aftësimin profesional, orientimit në karrierë, si dhe riintegrimin e të rikthyerve, Ministria e Punës ka nënshkruar marrëveshje kooperimi me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe GIZ-in gjerman. Gjithashtu, është nënshkruar marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe UNDP-në për të mbështetur të rikthyerit nga vendet e huaja. Në kuadër të aftësimin profesional është lansuar shpallja e dytë për 25 të rinj për t'u aftësuar tre vjet në Landin e Bavarisë në Gjermani, në fushën e ndërtimtarisë.

Sa i përket mirëqenies sociale, në kuadër të angazhimeve për mirëqenie sociale të qytetarëve është mbajtur Komiteti i Kosovës për parandalimin dhe eliminimin e punëve të rënda për fëmijët.

Me qëllim të realizimit të testit të varfërisë për qytetarët, të cilët nuk janë në gjendje t'i paguajnë premiumet dhe bashkëpagesat për sigurime shëndetësore është dërguar për miratim në Qeveri propozim-vendimi për caktimin e institucionit përgjegjës për realizimin e këtij testi. Tashmë ky propozim është miratuar në Qeveri.

Ka vazhduar ofrimi i shërbimeve përreth 65 rezidentë të moshuar dhe pa përkujdesje familjare, të vendosur në Shtëpinë e Pleqve në Prishtinë, si dhe ofrimi i shërbimeve për mbi 60 rezidentë të vendosur në Institutin Special në Shtime.

Sa u përket tensioneve dhe beneficioneve, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale konform rregullativës ligjore në fuqi gjatë periudhës 100-ditore e ka vazhduar suksesshëm implementimin e skemave ekzistuese pensionale dhe i ka bërë përgatitjet për skemat e pensioneve familjare, pensionet invalidore të punës, si dhe zbatimin e skemës për kompensimin e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Në këtë 100-ditësh janë finalizuar dhe përfunduar të gjitha procedurat për marrëveshjen për sigurimet sociale me shtetin e Belgjikës dhe atë të Zvicrës. E para është nënshkruar dhe e dyta pritet së shpejti të nënshkruhet.



Për informimin tuaj, janë iniciuar marrëveshjet me Austrinë, Kroacinë, Slloveninë dhe është në proces iniciimi me Turqinë, që kanë të bëjnë me sigurimet sociale. Në këtë periudhë është nënshkruar marrëveshja për vërtetimin e periudhave të sigurimit për realizimin e të drejtës për pension ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Me qëllim të zbatimit të Ligjit 04/L-054 është miratuar vendimi për themelimin e Komisionit Mjekësor për vlerësimin e shkallës së invaliditetit të invalidëve të luftës, duke shfuqizuar shkresat nr. 171 të datës 9 qershor 2011 dhe vendimin nr. 98 të datës 14. 3. 2014. Me këtë rast invalidët e luftës kanë filluar të aplikojnë për realizimin e të drejtës në pensione dhe benificione. Gjithashtu, është miratuar vendimi nr. 05/14 për caktimin e shumës së pensionit për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Sa u përket inspektimeve, punës, sigurisë dhe shëndetit në punë Inspektorati i Punës gjatë periudhës 100-ditore ka realizuar gjithsej 2310 inspektime. Nga këto inspektime janë inspektuar gjithsej 12 978 të punësuar. Si efekt i punës së Inspektoratit janë obliguar që të legalizohen marrëdhëniet e punës e 323 të punësuarve të cilët kanë punuar në mënyrë informale. Për shkak të shkeljeve të konstatuara janë shqiptuar 413 vërejtje me shkrim 64 gjoba.

Në fushën e marrëdhënies së punës gjatë kësaj periudhe kemi arritur të konsolidojmë kapitujt e Projektligjit të punës, në bazë të të cilit janë transponuar 15 direktiva të BE-së në fushën e kushteve të punës. Në fushën e dialogut social Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka rikonstituuar Këshillin Ekonomik Social dhe trupat e tij. Në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë në 100 ditët e para kemi finalizuar dhjetë projekt-rregullore në të cilat janë transponuar dhjetë direktiva përkatëse të Bashkimit Evropian nga kjo fushë.

E arritur tjetër në këtë fushë është krijimi i kuadrove apo 15 trajnerëve nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë. Sa i përket legjislacionit në periudhën 100 ditore janë finalizuar dy projektligje, Projektligji për ndërmarrjet sociale, i cili ka kaluar në leximin e parë në Kuvend dhe Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, i cili gjendet në Qeveri për miratim. Sa u përket akteve nënligjore brenda kësaj periudhe kemi miratuar 5 rregullore dhe 5 të tjera janë në procedurë në Qeveri.

Të nderuar deputetë këto ishin vetëm disa nga të arriturat për këtë 100 ditësh. Natyrisht, që si ministri kemi bërë edhe punë tjera për të cilat nuk desha të ju lodhë e të ju marr kohë më gjatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Gutaj-Veselaj.

LULJETA GUTAJ-VESELAJ: Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ka shumë për t'u thënë e për t'u debatuar për 100 ditët e punës së Qeverisë në shumë fusha, por me vullnet dhe përkushtim të secilit, edhe të deputetëve, edhe të ministrave, edhe të kryeministrit, gjërat mund të ndryshohen për të mirë.

Për sa i përket punës dhe të arriturave të Ministrisë së Financave gjatë periudhës 100 ditore të Qeverisë janë për t'u përgëzuar aktivitetet dhe rezultatet konkrete me vendime të mëdha, siç ishte çështja e veteranëve, shëndetësia, skema sociale, siguria dhe natyrisht një numër i konsiderueshëm i projekteve kapitale, në të cilat janë alokuar mjete shtesë për vitin 2017.

Në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përkushtimi dhe përkrahja e veprimtarisë kulturore në vend, mbështetja e aktiviteteve për ndërkombëtarizimin e kulturës përmes pjesëmarrjes në evenimente ndërkombëtare të librit, të filmit dhe arteve pamore e muzikës tregojnë përkushtimin e ministrit Gashi për ndryshime pozitive në këtë ministri. Mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore nëpërmjet zbatimit të projekteve kapitale për mbrojtjen dhe ruajtjen në fushën e trashëgimisë kulturore janë të arritura, siç janë edhe projektet e restaurimit dhe ato të rehabilitimit të aseteve të trashëgimisë kulturore.

Po ashtu, themelimi i Inspektoratit të trashëgimisë kulturore dhe funksionalizimi i tij është një hap shumë i rëndësishëm dhe shpresëdhënës për implementimin e Ligjit të trashëgimisë kulturore në vend. Hartimi i planit për menaxhimin e Qendrës Historike të Prizrenit, planit të menaxhimit për Parkun Arkeologjik Ulpiana dhe për Kalanë e Prizrenit si objektiva të rëndësishme të kësaj ministrie, mendoj se duhet të përfshihen sa më parë në planet zhvillimore të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, po ashtu hartimi i projektit për Muzeun e historisë dhe natyrës dhe programi për trashëgimi shpirtërore. Mbështetja e të rinjve me një mori projektesh për ngritjen e kapaciteteve të organizatave rinore dhe mbështetja e mekanizmave rinore për të zhvilluar programe dhe shërbime kualitative për të rinjtë, si dhe ngritja e shkathësive jetësore për të rinjtë janë të arritura të kësaj ministrie.

Inaugurimi i Zyrës rajonale për bashkëpunim të të rinjve në Prishtinë, po ashtu zyra e themeluar nga gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor, nga Shqipëria, Kosova, Bosnjë-Hercegovina dhe Mali i Zi, Maqedonia e Serbia. Vendimi i Qeverisë së Kosovës për ndërtimin e stadiumit kombëtar të Kosovës në komunën e Drenasit edhe kjo është një nga të arriturat më të mëdha në Ministrinë e Rinisë, Sportit dhe Kulturës.

Si deputete vlerësoj po ashtu, punën e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Planifikimit Hapësinor, ku gjatë punës 100-ditore në këtë ministri zonja Reshitaj ka treguar gatishmëri për të punuar me autoritetet përgjegjëse në zbatueshmërinë e ligjeve të aplikueshme të Kosovës me të cilat funksionon Ministria e Mbrojtjes dhe Planifikimit Hapësinor.

Hap i rëndësishëm në këtë ministri është miratimi i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje, që ka për qëllim ndërtimin e legalizimeve pa leje, të cilat plotësojnë kushtet teknike dhe regjistrin e tyre në kadastër. Ndarja e buxhetit për sanimin, pastrimin dhe zgjerimin e shtretërve të lumenjve në Kosovë, aty ku kanoset rreziku nga veprime të dëmshme të ujërave, po ashtu ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza në Prizren është një nga projektet që do të përmirësojë gjendjen e ujërave në Komunën e Prizrenit dhe që është për t'u vlerësuar nga ana e ministrisë dhe mbështetje e fuqishme e ministres Reshitaj.

Mbrojtja efikase e mjedisit është në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm e me këtë nënkupton edhe zhvillimin ekonomik, mirëqenien sociale dhe asnjëherë si barrierë për zhvillim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rasim Selmanaj e ka fjalën.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ky debat gjithsesi se është i vonuar në kohë, por megjithatë po ndodh. Kritikrat e opozitës janë normale edhe kur ato qëndrojnë edhe kur ato nuk qëndrojnë, kështu e ka demokracia. Por, ky debat ka logjikë dhe kulturë parlamentare, kur Qeveria i pranon kritikrat dhe kur opozita i pranon rezultatet.

Mirëpo, kjo sot nuk po ndodh. E vërteta është se Kosova ka shumë sfida përpara dhe as kjo Qeveri e as cilado qeveri tjetër nuk mund të bëjë për një kohë shumë të shkurtër mrekulli në këtë vend. Megjithatë, ka një ndryshim, ka vullnet dhe gatishmëri për t'u përballur me tema. Kjo qeveri, deshëm apo s'deshëm ta pranojmë, e ka ndërruar dinamikën qeverisëse. Ky material që është prezantuar nga ana e Qeverisë mendoj se edhe deputetët e pozitës dhe ata të opozitës, besoj që e kanë lexuar, prandaj nuk e shoh normale që të kemi një injorancë kaq të skajshme të rezultateve të cilat janë prezantuar në 100 ditshin e punës së Qeverisë.

Lëvizjen "Vetëvendosje" e kuptoj deri diku, sepse e bën çështjen e opozitës dhe realisht s'ka qenë kurrë në Qeveri, por kolegët e nderuar të LDK-së prej paslufte në shumicën e kohës kanë qenë në Qeveri. Domethënë, krejt këto çështje që po i ngrenë Qeveria e zotit Mustafa dhe ministrat kolegë të nderuar, e kanë pasur mundësinë t'i zgjidhin këto probleme. Mirëpo, qytetarët e kanë parë punën e secilës qeveri e po e shohin edhe punën e Qeverisë së zotit Haradinaj.

Unë dua t'i përmend katër argumente për t'u ndalur te argumenti i fundit. E para, që është përmendur sot e u përsërit, kontrata për ndërtimin e Termocentralit Kosova e Re është një ngjarje e mirë për Kosovën, pastaj Projektligji për Prishtinën, rregullimi statusit të kryeqytetit të Republikës së Kosovës duke i dhënë kompetenca shtesë, në shëndetësi, në polici dhe në shërbime publike. Pse nuk ka ndodhur Ligji për kryeqytetin deri sot. Krejt qeveritë dhe

legjislativat e mëhershme e kanë pasur mundësinë, por nuk ka ndodhur sepse s'ka pasur vullnet, sepse krejt qeveritë e kanë parë se kush po udhëheq Prishtinën, Lëvizja “Vetëvendosje”, LDK apo ndonjë parti tjetër. Ja që tash e kemi këtë ligj, e kemi kaluar në shqyrtimin e parë dhe në një prej seancave të ardhshme do të kalojë.

Vendimi për Shpitullën, për shpronësime, krijon stabilitet energjetik dhe është ngjarje që duhet të përshëndetet edhe sigurimi i thëngjillit për prodhimin e energjisë elektrike. Dhe krejt në fund dua të ndalem te pika e katërt, që është tema e demarkacionit. Qeveria e kaluar e udhëhequr nga zoti Mustafa nuk ka arritur ta sjellë në Kuvend, qoftë për ta kaluar, qoftë për ta rrëzuar demarkacionin. Dhe tashti kryeministri Haradinaj dhe kjo qeveri e ka krijuar një momentum të ri sa i përket demarkacionit. Ka formuar komisionin e ri shtetëror. Ky komision i drejtuar nga zoti Bulliqi i ka sjellë të gjeturat, krejt i kemi këto materiale, të gjithë deputetët.

Dhe, të nderuar deputetë, ju e mbani mend kur thoshte Mali i Zi se për ne kjo temë është e kryer. Ja që po del se Mali i Zi megjithatë është ofruar dhe është i gatshëm për të bashkëpunuar dhe për të ardhur deri te një zgjidhje për t'i përmirësuar gabimet që kanë ndodhur te komisioni i zotit Meha. Erdh kryeministri i Malit të Zi në Kosovë, ndodhi një deklaratë e re në mes dy presidentëve, atij të Malit të Zi dhe të Republikës së Kosovës dhe kemi një variant të ri të ligjit, do të thosha, për ta zgjidhur çështjen e demarkacionit me tri pika. Brenda këtij ligji është marrëveshja e vitit 2015, janë të gjeturat e zotit Bulliqi të Komisionit shtetëror e po ashtu, e kemi edhe deklaratën.

Prandaj, unë mendoj se është krijuar një bazë e mirë që të gjitha gabimet që kanë ndodhur në shënimin e vijës kufitare të përmirësohen, por është në dorën e deputetëve me e votua edhe hapë rrugë për liberalizim të vizave apo edhe me e rrëzua. Por, pse e përmenda pikën e katërt? Për të treguar se Ramush Haradinaj është lidërship, e ka guximin, e ka sjellë këtë situatë, këtë momentum të ri, është në dorën e Kuvendit për të vendosur me e kalua demarkacionin me këto tri pika që garantojnë, domethënë me e korrigjua dhe me e korrektua në drejtim të Çakorrit dhe të Kullës kufirin, ose me e rrëzua.

Unë kisha pasur një këshillë për kryeministrin. Kritikat është mirë me i dëgjua kur ato nuk qëndrojnë i vlerëson edhe ndonjë kritikë kur qëndron po ashtu, është mirë me qëndrua dhe me e marrë si të shëndetshme, por megjithatë në demokraci opozita bën punën e vet Qeveria bën punën e vet.

Kështu që, mendoj se ka pasur rezultate të prekshme. Ka edhe ndryshim të dinamikave qeverisëse dhe e inkurajoj Qeverinë që të vazhdojë të punojë në të mirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: I nderuari kryesues,

Të nderuar deputetë,

Në fakt, sot po dua të flas për llojin e politikëbërjes që e kemi parë këto 188 ditë. Faleminderit, Avdullah, për ditët, se i pari i përmende.

Pak a shumë, vendimet kualitative janë çelësi për reforma strukturore dhe rrjedhimisht edhe i suksesit politik të një qeverisjeje. Thjesht, janë disa parime pa të cilat nuk mund të bëhen politikat e duhura për të nxjerrë këtë vend nga humnera ekonomike, sociale e të mirëqenies së gjithëmbarshme shoqërore dhe parimi themelor është analiza e situatës, e cila i paraprinë një qasjeje mbi politikat që duhet ndërmarrë në sektor dhe për secilin sektor.

Raporti 100 ditor të cilin ju e keni paraqitur është veçse informacion telegrafik mbi vendimet që keni marrë, por këto vendime për të pasur kuptim duhet të jenë në raport e në përputhje me ndonjë lloj orientimi politik të caktuar për sektorët përkatës, pra një orientimi politik të Qeverisë. Me sjellë raport 100 ditësh duke raportuar në mënyrë telegrafike për secilin dikaster dhe pa na treguar se në përputhje me çka janë këto vendime, çfarë orientimi kanë këta sektorë, çfarë lloj politikash po duan t'i shtyjnë përpara, për mua nuk ka asnjë lloj kuptimi, përveçse të konkludohet se është vazhdim i qeverisjes së njëjtë me fytyra tjera.

Normalisht, në këto situata pa asnjë lloj analize vendimet do të jenë “ad hoc” dhe me pasoja. Disa vendime sikurse shkarkimi i Bordit të Agjencisë së Akreditimit, na kanë sjellë pasoja të cilat edhe jemi munduar t'i adresojmë në Kuvend, por jo me shumë sukses, normalisht. Nuk mjafton e as nuk duhet të merren vendime pa plan koheziv e të qartë për vendin, për secilin sektor veç e veç, por edhe për orientimet që një qeveri i ka në përgjithësi karshi shoqërisë të cilën e menaxhon apo shtetit në të cilin qeveris. Pra, ky diskutim sot në ditën e 188-të do të kishte kuptim, nëse kemi krahasim në mes të vendimeve të paraqitura në raport karshi një plani për reformat strukturore të domosdoshme për secilin sektor. Fatkeqësisht, ky plan mungon e në mungesë të këtij plani shohim shpërthime gjithandej në shoqëri, në secilin sektor dhe normalisht Qeveria shndërrohet në zjarrfikës apo në dikë që tenton të fikë zjarrin në secilin sektor. E kjo është qasje komplet e gabuar.

Për ilustrim, ndërmarrje publike raportuan në Komisionin për Zhvillim Ekonomik, përkatësisht zëvendësministri apo dikush i deleguar nga zëvendësministri dhe ndërmarrjet publike ishin në humbje prej 29 milionë eurosh. Humbja kryesore vinte nga një ndërmarrje publike, humbje prej 31 milionë eurove nga Posta dhe Telekom i Kosovës apo Telekom dhe propozimin mbi politikat, si duket, dhe për rimëkëmbjen e këtyre ndërmarrjeve publike i kemi të reduktuara vetëm se në privatizimin apo në shitjen e këtyre asetëve e assesi në rimëkëmbjen e tyre. Bilebile, po më duket që edhe ato pak ndërmarrje që ishin, njëra prej tyre KEK-u, kishte fitim prej dhjetë milionë eurosh dhe nuk e kuptova asnjëherë nëse Qeveria ka folur me KEK-un nëse për ato dhjetë milionë euro dhe për punën që bën, ka potencial të ndërtojë kapacitete të reja

energjetike, pra një gjenerator të ri të jetë në pronësi të KEK-ut. Nuk e di a është diskutuar kjo çështje me ta dhe nuk e di a është sjellë ndonjëherë në Kuvend mënyra se si do të mund të rrisim kapacitetet e KEK-ut dhe potencialin energjetik të kësaj Republike, por menjëherë është vendosur, gjithsesi si një paradigmë për të cilën nuk guxon të flitet, privatizimi, shitja apo ndërtimi i një kapaciteti energjetik të ri në duart e sektorit privat, bile tash po shkojmë edhe më larg. Tash po themi Mihja, e cila do të duhej të përdoret për thëngjillin për gjeneratorin e ri, gjithashtu duhet të jetë në duart të privatit, në një formë apo tjetër. T'i bëjmë një aranzhuan ligjor, qoftë me anë të partneritetit publiko-privat, qoftë të një elementi privat me një kontratë të re dhe kështu të sigurohemi se gjithë zinxhiri energjetik, përjashto KOST-in, të jetë në duart të sektorit privat.

Pra, kemi raport telegrafik, i cili nuk ka plan dhe ka vendime të cilat janë “ad hoc” dhe assesi që trajtojnë çështje kruciale për zhvillimin e gjithëmbarshtëm shoqëror.

Edhe një rast tjetër, Telekom, pra Telekom Kosovës, Vala, i ka 60% të tregut të telefonisë mobile dhe operon me humbje, përderisa operatori privat ka 38% të tregut dhe operon me fitim. Të hyrat vjetore të operatorit publik janë 78 milionë euro për vitin 2015, sepse në vitin 2016 ende s'e kemi parë, s'janë raportet e audituara sepse nuk ka Bord, por i zgjatet mandati drejtorit edhe për tre muaj, përderisa të hyrat e një operatori që i ka 38% të tregut, pra më pak se operatori publik, janë identike me operatorin publik, 70 milionë euro. Dhe, kjo ka të bëjë me vendimet që duhet të marrë një qeveri dhe këto vendime përcillen edhe në ndërmarrje publike, edhe në vendimet që shpijnë drejt zhvillimit.

Pra, vendimet kualitative, të nderuar deputetë, janë çelësi për sukses e vendime të tilla, kolegë të nderuar, janë të mundshme vetëm pas një analize të mirëfilltë të situatës karshi qëllimit dhe mendësisë për llojin e shoqërisë, që një qeverisje pretendon ta organizojë kur e merr pushtetin. Normalisht, për këso vendime duhen njerëz. E kjo qeveri, nëse asgjë tjetër, ka shumë njerëz. E meqë ka shumë njerëz, së paku le të na sjell dokumente që kanë përmbajtje apo edhe kuptim. Dhe, meqë janë së paku 70 zëvendësministra e 21 ministra, atëherë një alokim i thjeshtë i detyrave dhe temave që duhen analizuar është i mundshëm dhe i bëshëm. Pra, 100 njerëz janë të angazhuar në Qeveri, nuk po flas për Zyrën e Kryeministrit, sepse në Zyrën e Kryeministrit janë edhe 100 sosh. 100 persona, ministra dhe zëvendësministra i ka kjo Qeveri dhe nëse secilit do ia ndanin nga një detyre, për 20 ministri pesë persona jeni aty, 3 zëvendësministra në mesatare, 4 po më thotë një ministër, pra secila ministri i ka 4 zëvendësministra dhe një ministër, 5 persona. Dhe nëse këta 20 dikastere do të shpërndanin pesë çështjet kryesore te një zëvendësministër dhe një ministër, ne sot, të nderuar kolegë, do t'i kishim në këtë raport për 100 ditë 100 tema të analizuara mirë nga 20 ministra, secili prej tyre me 4 zëvendësministra dhe do të trajtonim në raportin 100-ditor 100 problemet kryesore të kësaj qeverie dhe këtij vendi, nga 100 persona që paguhen jashtëzakonisht mirë dhe do të shtjellonim orientimin për rrugën përpara. Por, sot ja ne po trajtojmë një raport 100-ditor të punës, i cili nuk na tregon asgjë përveç vendimeve që i keni

marrë e këto vendime, të nderuar ministra, mund të krahasohen vetëm karshi orientimit qeverisës, një programi qeverisës që ju e keni.

Si mund të analizojë një njeri vendimin, pa e ditur se ku po doni të shkoni, pa e ditur se cili është orientimi në këtë vend, si mund të analizojmë mbi situatën në shëndetësi, kur ministri i Shëndetësisë duhet gjithmonë të bëjë fikje të zjarrit e asnjëherë të prezantojë e propozojë politika për rregullimin e sistemit shëndetësor. Pra, për 100 ditë, në ditën e 188-të, këta 100 ministra e zëvendësministra na kanë sjellë po të njëjtat 100 probleme që i kemi që 17 vjet e asnjë solucion për rrugën përpara, veçse vazhdimësi të të njëjtës mendësi qeverisëse.

Dhe në shkencë, do të mund të doktoronim tri herë, tri herë, duke dëshmuar tezën që kjo lloj mendësie qeverisëse nuk funksionon. Një raport 100-ditor vjen me analizë dhe vjen me propozim për politika përpara e jo me vendime ad-hoc që sjellin pasoja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Enver Hoxhaj e ka fjalën.

ENVER HOXHAI: I nderuar zoti kryesues, nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zonja e zotërinj,

Të nderuar kolegë nga Kabineti qeveritar,

Unë nuk e pata ndërmend të flas, por dëgjova një konkurrencë në mes punës së këtij kryeministri me atë kryeministër edhe një kolegë para dite e pati një metaforë shumë të mirë, se kush e ka hapin më të madh e më të shpejtë, për ta matur punën e kësaj Qeverie.

Unë nuk kam qenë në 100-ditshin e parë të Qeverisë. Kam kolegë shumë të çmuar që i vlerësoj nga ish-Qeveria, sikurse kam shumë kolegë që i çmoj në këtë Qeveri. Jam në këtë 100-ditëshin e parë, por kam qenë pjesë e kësaj Qeverie dhe kam qenë pjesë e ish-Qeverisë. Më lejoni t'i them disa gjëra pak më shtruar.

Shpejtësia e këtij vendi, se para dite e nisëm seancën me shpejtësi të këtij vendi, mund të varet prej tri-katër temash të mëdha. Natyrisht, se varet edhe prej shumë problemeve që u përmendën edhe më herët. Ato mund të jenë edhe dhjetë tema, mund të jenë edhe njëqind tema, por 100-ditëshi i kësaj Qeverie, apo 200-ditëshi i kësaj Qeverie, nuk mund të dallojë as prej 100-ditëshi, 200-ditëshi të Qeverisë së ardhshme, sikurse nuk dallon as prej së kaluarës, nëse ne nuk u japim përgjigje nja tri-katër temave të mëdha që mund t'u japim përgjigje, ndoshta mund të jetë brenda 24 orësh, ndoshta mund të jetë brenda 48 orësh, ndoshta brenda një jave dhe ajo ka të bëjë me shënimin e vijës kufitare me Malin e Zi.

Ajo çka e ka karakterizuar këtë Kuvend dhe raportin e Kuvendit me Qeverinë dhe të opozitës me pushtetin në këto tre vjetët e fundit, ka qenë fakti që partitë të cilat kanë qenë në opozitë kanë

ndjekur vërtet politikë opozitare edhe për tema nacionale dhe unë i çmoj kolegët nga Lidhja Demokratike e Kosovës, por Ismeti nuk qenka këtu, po Ismeti e di dhe ju e dini, sikurse edhe kolegët nga VV-ja, që në vitin 2013 ne e kemi humbur shansin ta votonim një proces kushtetues që do t'ia siguronte në atë kohë Slobodan Petroviqit dhe Partinë Liberale serbe edhe një mandat të vendeve të rezervuara dhe neve do të na siguronte çështjen e ushtrisë.

Ma merr mendja që ky është fakt, ma merr mendja që nuk është perceptim dhe përtej asaj që ky Kuvend nganjëherë është shndërruar në një makinë të përbaltjes së njëri-tjetrit, ky është fakt. Nuk mund t'i ikni këtij fakti, sikur sot PDK-ja nuk mund t'u ikë shumë fakteve të saja, por edhe LDK-ja, edhe "Vetëvendosja" nuk kanë qenë të gatshme ta përmbyllin një proces të formimit të ushtrisë me vende të rezervuara, të cilat në vitin 2018, kur ne po bisedojmë sot, kishin qenë histori, është fakt, Kujtim, është fakt, është fakt. Ne mund të debatojmë, po ka të dhëna publike.

Po, nuk ka ndodhur veç një takim në ambasadë, qysh e bëtë veten sot aktorë kështu të skenës ndërkombëtare, po ka deklarata publike. Mirë, ta tejkaloj.

Edhe a e dini pse po e përmend këtë çështjen e 2013-tës, po dua të dal te dita e nesërme, e pasnesërme...

Neve na duhet mbështetja e krejt deputetëve ta përmbyllim çështjen e ratifikimit të marrëveshjes me Malin e Zi. I ftoj kolegët nga "Vetëvendosja" që ta votojnë, po dua t'ju them edhe hapur, nëse nuk janë të gatshëm ta votojnë, ne do të kërkojmë mbështetjen e Listës serbe. Dhe nëse Lista serbe voton pro ratifikimit për ta shënuar një kufij ndërkombëtar me Malin e Zi, është krejt në rregull, për PDK-në është shumë në rregull kjo punë. Po nëse ju doni ta shkurtoni mundin tuaj e tonin, po veçanërisht mundin e qytetarëve, ju ftoj sot që atë ditë, atë seancë ta shndërrojmë në një seancë festive, ta përmbyllim çështjen e kufirit me Malin e Zi.

Dhe, kur po e shoh zotin Lajçi, e di se si ia ka nisur kjo temë, Zoti Lajçi ka ardhur tek unë në Ministrinë të Jashtme me një atlas pedologjik dhe në atë atlas pedologjik, i cili merret me përbërje të tokës, jo të sipërfaqes, ka ardhur me njëfarë "pedoloshki atlas" ka pretenduar që kufiri nuk është në rregull dhe ne i kemi humbur tre vjet që ta përmbyllim çështjen e kufirit me Malin e Zi, ky është fakt, ky është fakt, nuk është perceptim.

Po dua t'ju them qartë, nëse nuk votojnë deputetët shqiptarë, ne do të kërkojmë mbështetjen e Listës serbe dhe do të kërkojmë shumë seriozisht, krejt në rregull, nuk po them për LDK-në, më duket, jeni prononcuar, po ne do të kërkojmë.

Po dua të dal te një temë e tretë, ma merr mendja që shihemi pas një 2-3 vjetësh edhe mund të flasim njëjtë, nuk ka me rëndësi unë a ulem në rreshtin e parë, në të dytin a të fundit, këtë anë të



Kuvendit apo ku jam i ulur këtu, krejt në rregull është. Edhe a e dini pse po e them, se u fol për shpejtësinë.

Ka një shpejtësi të re të dialogut me Serbinë, ju lus për vëmendje, të gjithëve. Ka një shpejtësi, është temë, është pjesë e programit të Qeverisë, dialogu me Serbinë është pjesë e programit të Qeverisë, ne nuk jemi njerëz që merremi me tema teknike këtu, nuk jemi menaxherë të korporatave.

Ka një shpejtësi të re, e cila merret me çështjen e dialogut me Serbinë, procesi do të jetë i vështirë, goxha i rëndë, jemi në proces, duhet të ketë një debat në këtë Kuvend me një platformë të qartë, ku po hyjmë, po përsëri i kisha lutur të gjitha partitë, ato që janë në opozitë dhe ato në pushtet, të bashkohen rreth temës së dialogut. Nëse ka një temë, e cila e ka ndarë Kosovën, ka qenë puna e dialogut.

Unë e di që kur dikush është në opozitë mund t'i thotë Asociacionit "Zajednicë" dhe kur është në pushtet mund t'i thotë asociacion, po edhe këtu ju ftoj për një politikë shtetërore, për një politikë shtetërore, e cila i duhet këtij vendi.

Unë nuk dola të polemizoj me askënd, jam i gatshëm të polemizoj, por po ju them një gjë. Për 2-3 ditët e ardhshme, nëse vijmë në Kuvend me temën e ratifikimit të marrëveshjes, ju ftoj të gjithëve ta votojmë, ta mbyllim. Nëse dikush e ka shpallur kufirin në sheshin "Nëna Terezë" se ku është, po tash është me një deklaratë të nënshkruar mes dy presidentëve që mund të shihet, korrigjohet, rishikohet dhe është punë e trupave profesioniste, është mirë që t'u lihet trupave profesioniste dhe nuk është mirë që t'i lihet prapë sheshin "Nënë Terezë" se si ta vendosë ku është kufiri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Këtu u fol disa herë sot për konsensus nacional.

Mendoj që qytetarët e Kosovës që i përcjellin fjalimet e deputetëve dhe në veçanti të Qeverisë me vëmendje, shumë lehtë mund ta gjejnë përgjigjen pse nuk është arritur konsensus për tema të ndryshme.

Kjo është për shkak se Qeveria dhe disa parti aktuale në të, në vend se të kërkojnë konsensus të sinqertë, e bëjnë këtë qoftë nëpërmjet gjuhës shantazhuese, qoftë nëpërmjet gjuhës shpifëse, e nganjëherë edhe me gjuhë ofenduese, siç ishte ajo e hershme e kryeministrit.

Po përgjigjem tani në ato që i tha zëvendëskryeministri Hoxhaj lidhur me rolin e LDK-së në vitin 2013 sa i përket krijimit të ushtrisë, meqenëse edhe vetë kam qenë e pranishme në ato takime, siç e di zoti Hoxha, jo për shkak se dikush ka qenë aty aktor më i rëndësishëm se tjetri, por kemi qëlluar sepse dikush e ka njohur atë fushë më shumë se dikush tjetër dhe kemi qenë prezentë bashkë në së paku tri takime ku është diskutuar kjo temë.

Në asnjë moment nuk ka pasur garanci nga askush dhe në veçanti jo nga pakica serbe, sepse ju flisni në emër të tyre, nuk i leni ata të flasin, se në qoftë se vazhdoen vendet e rezervuara, ata do ta votonin ushtrinë. Përkundrazi, ky ka qenë një kurth i ndytë, një kurth në të cilin keni dashur të na futni neve që të votohen edhe shumë më shumë vende për pakicat se sa që i kanë tani dhe a e dini cili ka qenë rezultati i mundshëm me atë dalje në përqindje të serbëve që e kishim në atë kohë. Sot do t'i kishim ata grupin më të madh parlamentar, pakicat, tash ju 23 i keni PDK-ja, ju mendonit që gjithmonë do t'i keni 40, sot i keni 23.

Me atë logjikë keni menduar atëherë, e jo që do t'i sillnit grupet e pakicave në një grup më të madh se sa çdo grup shqiptar tjetër.

Ne si LDK mburremi, mburremi, po e përsëris që e kemi thënë që nuk pranojmë një kurth e një skenar të tillë, e para.

E dyta, asnjëherë pakica serbe nuk ka thënë se do ta votojë ushtrinë, as atëherë e as tash, mund të ketë pasur vetëm deputetë individualë. Dhe a e dini ju se me çfarë shumice ndryshohet Kushtetuta, si duket më herët kryeministri nuk e dinte 2/3 shumica e dyfishtë, do të thotë janë kërkuar edhe 2/3 e pakicave, të cilat as atëherë nuk kanë qenë, pavarësisht a do t'ua vazhdonim ne atyre vendet e rezervuara apo jo.

E treta, ta zëmë që vërtet paska qenë ashtu si po thoni ju dhe LDK-në me 28 deputetë s'e keni pasur me veti, po 92 të tjerë ku i latë? Sa janë 2/3 në këtë, po mirë de, pse s'keni punuar me "Vetëvendosjen" sikur tash që po u bëni thirrje, zoti Hoxhaj. Pse s'i keni marrë, vetëm tre ju kanë dashur, 13 kanë qenë "Vetëvendosje", 28 ne. Pse nuk keni punuar me të tjerët, 92 deputetë i keni pasur pa LDK-në, në qoftë se paska qenë e vërtetë që një garanci e tillë nuk ka ekzistuar. Na sillni dokumentin, zoti Hoxhaj, sepse për momentin fjala juaj është kundër fjalës sime, nuk ka një dokument të tillë dhe qytetarët e Kosovës, sidomos në këto zgjedhjet e fundit, e kanë treguar kujt i besojnë më shumë, për ata ju sot i keni 23 deputetë e ne i kemi 27, sepse kanë treguar kujt i besojnë më shumë në tema siç është ushtria e Kosovës.

Lista serbe është krijesë juaja, është krijesë e Marrëveshjes së vitit 2013 të nënshkruar nga Hashim Thaçi, dhe ju sot po ankoheni pse partia e Slobodan Petroviqit dhe e Nenat Rashiqit s'po marrin vota. Kur e ngritët ju zërin për gjithë atë dhunë, ato kërcënime që u janë bërë partive të

tjera nga anëtarët e Listës serbe, për të cilat ka reaguar edhe QUINT-i në zgjedhjet e fundit, procese të dhunshme, të cilat e kanë degraduar edhe procesin e fundit zgjedhor në Kosovë.

E fundit, lidhur me këtë temë. Gënjeshttrat nuk mund ta çojnë asnjë proces përpara. Deri tash është dëshmuar që vetëm LDK-ja e ka me seriozitet krijimin e ushtrisë së Kosovës. Vetëm LDK-ja, po, po, sepse shihni se çfarë bëri Hashim Thaçi, bërtitni sa të doni, shihni çfarë bëri Hashim Thaçi, në fund të mandatit të kaluar. Ju jeni në gjendje të rrezikoni miqësi e partneritete, të cilat nuk i kemi veç për qejf, i kemi esenciale, i kemi ekzistenciale, jeni në gjendje t'i rrezikoni ato miqësi ekzistenciale për shtetin e Kosovës që i kemi ndërtuar për 20 vjet vetëm për ta shpëtuar lëkurën tuaj. Deri këtu jeni në gjendje të shkoni dhe tani vini dhe na shisni moral për kulturë politike e leksione, për kulturë politike i shitni, kujt? LDK-së! Po cila është kultura politike që opozita e tregoi në kohën kur LDK-ja ishte në Qeveri, ishte kulturë e “filikaqave”, ishte kulturë e sulmeve ndaj Policisë së Kosovës, ishte kulturë e gazit lotsjellës.

E sot kryeministri vjen dhe ankohet që nuk po e respektojmë sa duhet, kënd nuk po e respektojmë? Dikë që u thotë deputetëve “mos rreni”, dikë që nuk e respekton institucionin e Kuvendit dhe as nuk rri këtu, sepse i duket humbje kohe. Çdo herë kur vjen kryeministri në Kuvend thotë: “Unë s’kam çka rri këtu, se është humbje kohe kjo temë e ajo temë”. Kaq e respekton rolin e vet kushtetues.

Me këto urrejtje ndaj LDK-së ne jemi mësuar në fakt qysh prej viteve '90-ta, e keni pasur edhe gjatë luftës ndaj formacioneve ushtarake që i kanë respektuar institucionet e udhëhequra nga Presidenti Rugova, e keni urrejtje edhe sot ndaj përpjekjeve tona serioze për të krijuar ushtrinë.

U përmend edhe dialogu, që ka qenë tema themelore për të cilën sot kam dashur të flas, por meqenëse u desh të përgjigjem në tema që u ngritën, ato morën pak kohë.

U kërkua një bashkim rreth temës së dialogut. Po ju as vetë që jeni në Qeveri nuk jeni duke e ditur çka po flet presidenti Thaçi me presidentin Vuçiq. A jeni duke e ditur çka është duke folur?

Kush sot prej kryeministrit mund të garantojë që nuk po hapet as tema e autonomisë së serbëve, as të drejta speciale për pakicën serbe, as shkëmbimi i territoreve, as ndarja? Qeveria nuk ka përgjigje, paramendojeni, ose së paku, thënë më butë, ka çakordim total institucional.

Kemi deklarata se Serbia nuk ka nevojë ta njohë Kosovën, pak më vonë zëvendëskryeministri tjetër thotë se duhet pa tjetër ta njohë Kosovën.

Kemi deklarata se Serbia mund të vijë në veri dhe të vendosë bashkë me Kosovën për një zonë të lirë ekonomike. Çakordim total në fushën e politikës së jashtme dhe çka bën Qeveria? Në vend se të respektojë rezolutat e vitit 2011 dhe 2012 që kërkon që ajo ta udhëheqë procesin e dialogut

dhe të mbikëqyret nga Kuvendi, frikësohet, frikësohet të marrë përgjegjësi! Çfarë trimërie është të dalësh këtu e t'i bërtasësh opozitës "ti po rren", kur e heq nga barra përgjegjësinë e mbrojtjes së interesave shtetërore në tavolinë me Serbinë, ajo është trimëri.

Pse Qeveria po i ik kësaj përgjegjësie dhe e lejon Hashim Thaçin të takohet herë publikisht e herë fshehtas me Aleksandar Vuçiqin dhe askush në Kosovë nuk e di cilat janë temat, cilat janë koncesionet dhe cilat janë marrëveshjet. Me shpejtësi, kjo qenka shpejtësia e dialogut, shpejtësia e marrëveshjeve të fshehta, shpejtësia e territ informativ? Kjo nuk është shpejtësia e cila i duhet Kosovës. Shpejtësia e shkeljes së ligjeve nuk është shpejtësi që i duhet Kosovës. Ky nuk është shembulli i Qeverisë që i duhet Kosovës.

Qeverisja Haradinaj në këto 180 e sa ditë ka dëshmuar, siç e kam thënë edhe më herët, se është Qeveri e izolimit dhe e izoluar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoxhaj e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI ENVER HOXHAI: Unë nuk u ngrita, kolegë të nderuar, sidomos një pjesë e madhe juaja që jeni gjatë në Kuvend, të mbaj ligjëratë se si ka qenë dhe se si do të duhej të ishte, po pata një mesazh shumë të thjeshtë se si pas dy ditësh, nëse e sjellim marrëveshjen e 2015-së ta ratifikojmë në këtë Kuvend, e cila është marrëveshje, ku nuk ka nevojë për shumicë të dyfishtë, ku nuk ka nevojë për votën e komunitetit serb, ku varet prej votës së thjeshtë, ta votojmë dhe ta mbyllim këtë temë. Ky ishte qëllimi im kryesor bazik.

Por me qëllim që të jem i kuptueshëm, u desh të rikthehem në situata mbrapa dhe tash kur rikthehen situatat mbrapa, dikujt i pëlqen, dikujt s'i pëlqen, nganjëherë s'i pëlqen as PDK-së, as LDK-së, as "Vetëvendosjes", por sa herë dal në këtë foltore do të bëj përpjekje të flas me fakte dhe jo me perceptime.

Dhe fakt është që në 2013-ën nuk ka pasur Listë serbe, po ka pasur Parti Liberale serbe e Slobodan Petroviqit dhe krejt keni qasje në internet, hyni, këqyrni në Google çka ka thënë në vitin 2013 zoti Petroviq, unë nuk jam zëdhënës i tij, sa u takon vendeve të rezervuara dhe përmbylljes së procesit të ushtrisë dhe çka keni thënë ju. Hyni, këqyrni, është e matshme, tash këqyreni edhe dilni e sqaroni këtë temë.

Por dola t'ju jap njëfarë ideje të urgjencës që ne e kemi si Qeveri për ta krijuar një konsensus dhe për ta ratifikuar marrëveshjen e demarkacionit. Nuk ka të bëjë me urgjencën tonë, pa keqkuptim, ka të bëjë me një urgjencë tjetër, javën e ardhshme në kohën e njëjtë. Më 22-23 mbledhet Këshilli Evropian, është Samiti i pranverës, mandej takohen vetëm në verë dhe në vjeshtë. Nëse ne duam ta zëmë afatin e tyre kohor, jo afatet tona partiake, parlamentare, të deputetëve, duhet ta votojmë brenda 48 orësh marrëveshjen dhe të ecim përpara. Ndoshta e marrim një rekomandim të prerë

prej tyre dhe kur po flas, ndoshta e marrim, i referohem telefonatës që e kam pasur dje dhe pardje.

Te dialogu, nuk po flas për shpejtësinë tonë të dialogut, nuk po flas as çka thotë presidenti, as çka thotë kryeministri, as çka thotë Qeveria. Po flas për një vullnet të ri ndërkombëtar që më 2018 të ketë agjendë të re, më shumë s'mund të them.

Dhe, nëse ne më 2018 duam të kemi agjendë të re të dialogut dhe në Beograd veç 3 javët e fundit i keni 15 skenarë, 15 skenarë, unë i kam 15 skenarë, veç tri javët e fundit që kanë dalë në media, modele të shumta dhe të ndryshme, për të cilat shumë pak po reagojmë.

Duhet ta kemi parasysh edhe një kontekst: konteksti 2018 është më pak i favorshëm për Kosovën se sa ka qenë 2008, kur e kemi shpallur pavarësinë. Konteksti ndërkombëtar është më pak i favorshëm tash, pas 10 vjet shtetësi, se sa më 2008 kur e kemi shpallur shtetësinë. Më agresive është Spanja dhe më e dëmshme brenda përbrenda BE-së, po më vjen keq që duhet ta them, po s'e kam tash pozitën që e ka kolegu ynë Pacolli, se sa Rusia. Jo me neve, ka të bëjë me tema të brendshme, ka të bëjë me politikë të jashtme, e dini, ma merr mendja.

Po në të njëjtën kohë e kemi një kontekst goxha të ri rajonal. Maqedonia po bën përpjekje me Greqinë ta zgjidhë çështjen e emrit, ka shpejtësi të re në Maqedoni, u fol paradite për shpejtësi dhe unë pajtohem të flasim për shpejtësi. A e di pse pajtohem të flasim për shpejtësi? Se për mua shteti i Kosovës nuk është veç entitet as territorial, as institucional, është entitet kohor. Shteti është edhe kohë, a të ndihmon të lëvizësh përpara a s'të ndihmon.

Shqipëria po i mbyll problemet e saja me Greqinë. Serbia çdo ditë po e rrenë bashkësinë ndërkombëtare me 15 skenarë se si do ta adresojë temën e Kosovës. Dhe ne, nëse jo në fundin e marsit, javën e parë e prillit do të flasim po ashtu për temën e dialogut në këtë Kuvend.

Po nëse një temë teknike, qysh është demarkimi, gjatë e kam përcjellë, jo politike. Ne e kemi shndërruar në një kauzë të madhe politike, nëse i kemi votat që ta mbyllim këtë temë pas dy ditësh, duhet ta lusim Listën serbe dhe unë do ta lus, po më vjen keq t'ju them, atëherë shtrohet pyetja qysh do të përmbylim shtetndërtimin. Për këtë dola, për atë dola, e pse u riktheva në kohë, u riktheva se i takon edhe Parlamentit.

KRYESUESI: Faleminderit! A shkojmë në pauzë, apo vazhdojmë. Atëherë zoti Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!  
I nderuar Kabinet qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Mund të them lirisht që këtë debat për 100-ditëshin ndoshta edhe do të ishte mirë që ta orientonim si debat për gjashtëmujorin e punës së Qeverisë, sepse janë gjashtë muaj të punës së kësaj Qeverisë dhe si deputetë dhe Parlament të merremi edhe me monitorimin e asaj pune që është bërë, duke vlerësuar sinqerisht dhe drejt të arriturat, por edhe të japim sugjerime dhe mendimet tona sa u përket atyre që nuk janë bërë brenda kësaj periudhe kohore.

Ka dikastere qeveritare, të cilat marrin notë pozitive brenda kësaj periudhe kohore, por ka edhe dikastere qeveritare, të cilat duhet të jenë më aktive, më proaktive dhe të punohet me një program të mirëfilltë qeveritar. Ndoshta në disa dikastere edhe me një konsensus të të gjitha subjekteve politike, sepse është më se e nevojshme që disa çështje të cilat janë me rëndësi për interesin e vendit të kemi një konsensus ashtu siç unë e konsideroj që e kemi arritur një konsensus në Komisionin për Shëndetësi sa u përket prioriteteve, të cilat duhet të trajtohen, por që i njëjti konsensus ose e njëjta frymë e bashkëpunimit ose shtytja përpara e zgjidhjes së këtyre problemeve të mëdha në shëndetësi nuk përcillen nga Ministria e Shëndetësisë.

Është më se evidente që brenda gjashtë muajsh Qendra Klinike Universitare, apo tani e njohur si SHSUK, ka bërë dy hapa shumë të rëndësishëm sa i përket ofrimit të dy shërbimeve, të kardiologjisë invazive 24 orë dhe onkologjisë 24 orë. Por që për fat të keq, kjo nuk është përcjellë me një dinamik dhe profesionalizëm nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, sepse mungesa e barnave, mungesa e citostatikëve, do të thotë përkundër që është afruar një shërbim 24-orësh në onkologji, ka bërë që pacientët të blejnë barnat nga buxheti i tyre dhe jo me mbështetjen nga Ministria e Shëndetësisë, sepse planifikimet e duhura kanë ngecur për blerjen e barnave, menaxhimi i kontratave shumë problematike ose jo i duhur, me përgjegjësi të caktuara nga individë, të cilët kanë qenë përgjegjës, te kalimi i kuotave të blerjes dhe manipulimit të caktuara janë evidente.

Unë pajtohem që një pjesë e ministrave kanë marrë detyra, përgjegjësi të udhëheqin këto dikastere, edhe pse nuk janë të profesioneve ose nuk kanë marrë më herët, por kjo mund them që vjen si shkak ose si pasojë e mosfunksionimit të mirëfilltë të demokracisë në shumë subjekte politike parlamentare, ku nuk respektohen programet politike të vetë subjekteve.

Nuk kemi një agjendë, e cila ndiqet nga subjektet politike që pastaj ministrat ta ndjekin po të njëjtën agjendë, për të cilën ka dakordim si partner koalicioni për të ndjekur programe qoftë në shëndetësi, qoftë në arsim, qoftë në drejtësi, qoftë në sferën e sigurisë, ku ditëve të fundit jemi përballur me shumë probleme, të cilat janë evidente dhe me humbjen e jetës së qytetarëve, siç është rasti i fundit në Malishevë, ku institucionet e sigurisë nuk arrijnë ta bëjnë punën e vet, prandaj qytetarët duhet vetvetiu të mbrojnë pronën e tyre dhe për këtë pastaj edhe të kenë pasoja me jetën e tyre.

Por mund të them se brenda kësaj periudhe kohore, brenda këtij gjashtëmujori, është ruajtur bilanci financiar si pasojë e punës së mirë të Ministrisë së Financave.

Kemi një vlerësim të punës së Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale sa i përket zgjidhjes së problemeve të kategorive të dala nga lufta dhe një mbështetje edhe për pensionistët.

Por gjithashtu, mund të themi që kemi pasur avancime edhe punë të mirë edhe në Ministrinë e Ambientit dhe gjithashtu një punë gjithashtu të mirë edhe në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe një përpjekje edhe nga Ministria e FSK-së sa i përket çështjes së ushtrisë. për t'i arritur të gjitha standardet e kërkuara që pastaj politikës t'i jetë vendimi definitiv sa i përket formimit të ushtrisë.

Pasi që ky është mandati im i tretë, mbes me borxh kur jemi te puna e ushtrisë dhe të mos e them atë që të gjithë këtu që kemi qenë mandatin e kaluar, që kemi qenë tri mandate rresh e më shumë, sepse ka qenë evidente që vetëm për shkak të një inati që disa ende vazhdojnë ta shpërfaqin ndaj Hashim Thaçit, atëherë kryeministër i Kosovës, tani president i vendit, në parakalimin e FSK-së ka deklaruar se kjo do të jetë hera e fundit që FSK parakalon si e tillë dhe vitin tjetër do të jetë ushtri dhe për shkak të kësaj, edhe atëherë LDK-ja dhe "Vetëvendosja" nuk kanë dashur ta votojnë ushtrinë e Kosovës. Kam qenë këtu, kemi debatuar bashkë, kemi diskutuar, Lista serbe i ka pasur kërkesat e veta, AAK-ja ka qenë në opozitë, por e ka pranuar si fakt për ta bërë ushtrinë për një mandat për vendet e rezervuara, ka humbur ai shans, mund të kthehemi prapë mbrapa, mund t'i tregojmë njërit-tjetrit histori edhe të '98-tës, edhe të '92-tës, edhe LDK-në, edhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës e ka themeluar populli, nuk është meritë e asnjërit prej deputetëve dhe unë mendoj që këtu ne duhet të kemi një konsensus për atë ku do të shkojmë tutje, sepse të kaluarën e dimë të gjithë dhe s'kemi nevojë t'i mbajmë ligjëratat ose duke përmendur emra të përveçëm këtu, të arrijmë të jemi fokus ose të mbledhim një votë më shumë tek elektorati, sepse edhe punën e 100-ditëshit të Qeverisë së kaluar, edhe të kësaj qeverie e vlerësojnë qytetarët, dihet me të cilat probleme është përballur Qeveria e kaluar, cilat kanë qenë rezultatet e saj, cila ka qenë një pjesë e qëndrimeve për ato problemeve të disa deputetëve që tani janë opozitarë, atëherë kanë qenë pjesë e mazhorancës, dhe pse nuk kemi ecur tutje, por i kemi humbur tre vjet për një temë, e cila tani po kërkohet të ketë zgjidhje, sepse është shumë me rëndësi jetike për interesin e qytetarëve të vendit.

Pra, ne duhet të kemi konsensus për këto çështje, por gjithsesi ne nuk mund t'i anashkalojmë problemet e përditshme, që e rëndojnë jetën e qytetarëve, sepse një qytetar yni, i cili kërkon një trajtim jashtë vendit, përveç anës financiare, ka problemin tjetër të sigurimit edhe të vizave për trajtim jashtë vendit.

Unë kam thanë edhe në një diskutim tjetër këtu, sepse përafërsisht 80% e deputetëve të Parlamentit të Kosovës kanë më shumë se një pasaportë, do të thotë përveç të Kosovës, kanë

pasaportë edhe të vendeve fqinje, edhe të vendeve të Bashkimit Evropian dhe nuk e kanë fort për hatër ose për zemër çështjen ose interes çështjen e liberalizimit të vizave, edhe pse është interes i qytetarëve të Kosovës, kushtimisht kjo do të duhej të shikohet edhe në këtë prizëm, sepse disa janë të akomoduar, nuk kanë probleme për të lëvizur në asnjë vend të botës.

Gjithashtu do të kërkoja që për këto tema, në veçanti për ato të cilat janë të interesit të përditshëm të qytetarëve, të diskutojmë me ekspertë të fushës, qoftë për ato tema të arsimit vërtet, sepse këtu kemi diskutuar para disa ditësh për çështjen e arsimit dhe përjashtimit të Kosovës nga EQAR dhe me një marrëveshje të përbashkët të të gjitha grupeve parlamentare kemi ardhur me rekomandime, pastaj të cilat i kemi mbështetur të gjithë.

Pra ne mund të gjejmë konsensus për tema, të cilat janë me rëndësi për vendin, por gjithsesi edhe për temën, e cila është kryesore për vendin, e cila i hap perspektivë këtij vendi, ne duhet të gjejmë një konsensus dhe mendoj që është më se i domosdoshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë po mendoj që është mirë të shkojmë në pauzë, në orën 15:00 fillojmë.

\* \* \*



*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës.*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, po vazhdojmë. Atëherë, fjalën e ka Ali Lajçi.

ALI LAJÇI: Të nderuar deputetë,

Është një temë mjaft e hapur dhe e vështirë, po aq sa me përgjegjësi, po njëkohësisht sa është menaxhuese, madje sa është edhe cilësuese, kualifikuese e të tjera, çështja e punës e një qeverie 100-ditëshe tash duket që ka skaduar trajtimi i saj, por nuk është keq çdoherë të bisedohet, sepse ka çka të bisedohet. Por, të flitet vetëm për këtë qeveri, sigurisht se është një kapitull i shkurtër ndoshta, por që është e mbushur me të bëra e të pabëra. Po aty mund të flasim për të bërat e pamira dhe që mund të nisët prej qeverive të pasluftës e këtej që lidhen me çështjen e rregullimit, konstitutimit, kontrollimit dhe rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.

Prandaj, ne po shohim këtu se kemi ardhur bile që disa vjet në një rreth vicioz të proceseve, qofshin ato integruese ndërkombëtare, njëkohësisht edhe këto të brendshme si shoqëri. Edhe pse kemi ardhur këtu është shumë e qartë, por shpesh nuk kemi dëshirë fort të prekim atë “shtimungun”, thelbin e këtyre, për arsye se gjatë administrimit janë bërë nga qeveritë, të gjitha atyre pasluftës, ama pa dallim. Kosova nuk ka arritur të administrohet në kufijtë e saj të shpallur si shtet sovran dhe i pavarur për shkaqe të ditura. Kosova e ka ‘hiletin’ brenda për shkak të konceptit të bërjes së shtetit, pra të shtetit me komuna në baza njënacionale, me një decentralizim që dihet se çfarë ka qenë dhe nuk kemi dashur të bëjmë një decentralizim për qytetarët, por kemi dashur të bëjmë një decentralizim, i cili e gërryen brenda Republikën e Kosovës dhe jemi shumë dëshmitarë që është duke e gërryer dhe kush i ka bërë këto, dihet. Të shkojmë në procese të tjera.

Sot Qeveria jonë, që të ecë, t’i zhblllojë proceset duhet të bëjë ndryshime kushtetuese, duhet të trajtohet objektivisht ndryshimi i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila tash e mbas veç sa i frenon zhvillimet qoftë të brendshme apo integruese të Republikës së Kosovës. Ju keni parë përse po bëhet shumë fjalamani rreth krijimit të ushtrisë. Po bëhet dhe përdoret në mënyrë shumë të ulët, propagandistike një çështje të cilën është produkt i qeverive dhe ardhjes së një Kushtetute, e cila ndoshta s’ka pasur të tjera alternativa, por është bërë keq dhe për çdo ditë krijojmë ushtri me fjalë. Shikoni sa e çuditshme, çdo ditë, çdo javë, çdo muaj, por dijani, mos e përmendni ushtrinë, kapni çështjet serioze dhe sillni në Kuvendin e Republikës së Kosovës, konsensusi është i ditur. Nuk ka nevojë që ta përmendim ushtrinë se e bëjmë sot, nesër, ka nevojë të procedohet, të sillët në Kuvend, ta aprovohen ndryshimet kushtetuese ose Kushtetutën jo vetëm për këtë kapitull, por edhe shumë kapituj të tjerë e të ec përpara Kosova, por nuk doni, doni veç të bëni fjalamani, se e keni aprovuar një Kushtetutë me hendikepe, cilat? Kur kemi dhënë atje përfaqësimin e pakicave, i kemi kaluar normat e të drejtës ndërkombëtare për pakicat, duke u mashtruar se gjoja do ta njohin pavarësinë dhe i kemi dhënë atribut gati të vetos një

komuniteti që këtu në Qeveri herë bashkë e herë ndaras dhe i ka dhënë fuqi juridike e politike, e sot e sjell Kosovën rreth e rrotull.

Dhe sot, as nuk mund të bëni ushtri, as nuk mund t'i tejkalojmë disa procese të tjera, as nuk mund të bëjmë, ta zëmë, edhe një Ligj për shkollim të lartë, për shembull, aty ku preket mundësia për t'u sovranizuar edhe më tej Republika e Kosovës, aty e kemi të ndalur, për shkak se kemi prodhuar procese, të cilat janë frenuese dhe kur vijmë këtu, edhe Kosovës i mungon, që duhej ta kishte në prioritet Qeveria, Ligji i vetingut, të cilin nuk e ka bërë e do të duhej të ishte me nguti të bëhej kjo. Sistemi zgjedhor dhe reforma e tij, të cilën nuk e kanë bërë as qeveritë e para, e kjo Qeveri ka nisur disa procese t'i grithë aty-këtu, por ngase thasët janë aq të mbushur, është rrezik se si do të mund të menaxhohen. Ligji për sistemet lokale, ta zëmë, reforma në sistemin zgjedhor, edhe tash është harruar ajo, që disa po bëjnë turr e vrap të shkojnë në zgjedhje, por nuk janë të përgatitur as si parti, as si sistem zgjedhor dhe faktikisht duan të përsëriten proceset, të cilat nuk çojnë askund.

Kurse, u zu këtu në gojë, s'qenka ky ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, i cili hyri në procesin e demarkimit, për të cilin unë e kam përcjellë që në fillim sa isha në atë komisionin dhe u pata bërë vërejtje Thaçi dhe vetë ministrit Hoxha që metodologjia e komisionit të tyre për shënimin e vijës kufitare, ata që e kishin bërë, e nuk duhej, sepse kishte një mandat tjetër ai përkufizim, por duhet bërë shënim i pikave kufitare, i vijës kufitar. Nuk e morën parasysh dhe ishin aq injorantë, aq njerëz të pakapshëm në kuptim të arsyes sa edhe shkaktuan protesta, demonstrata, peticion, gaz në Kuvend, sepse ishte shprehje e një revolte, e cila herë shprehej mirë e herë keq, herë me mjete të duhura, e herë të paduhura, por arsyeja e madhe ishte se faktikisht ndodhi një projekt, i cili e prekte rëndë pavarësinë dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës. Dhe, tash çka keni bërë? OK, edhe "Nisma" u fut në koalicion me PDK-në, që është qasje e tyre dhe e drejtë e jo e drejtë, por u fut në një koalicion, i cili faktikisht nxjerr veç komplikime. Nuk ka krijuar një administrim dhe një qeverisje të dëshirueshme, sepse nga ana tjetër, e kemi pasur tendencën, synimin e PDK-së që me çdo kusht të ratifikohet marrëveshja e 2015-ës, kurse AAK-ja e ka pasur kundër, bashkë me ne, kurse LDK-ja, edhe përkundër synimeve eventuale kozmetike, që ka synuar Ramushi, e që nuk janë ndryshime, kjo do ta mbajë sidomos marrëveshjen 2015 pastër. Më vonë e shohim se këta bile as nuk duan të tentojnë për ta ndryshuar. Këta duan ta votojnë një marrëveshje, e cila humb territor qartë edhe me vetëdije. Këto janë dy dallime. Kurse unë po ju them, është nisur kjo punë gabim dhe përfundon gabim, është nisur kjo punë shkaras dhe në mënyrën më diletante të mundshme, me pretendime të caktuara që përpara dhe kanë ndodhur keq. Prandaj, edhe është keq, prandaj edhe është menaxhuar keq, prandaj edhe nuk ecën. Shikoni, është lidhur ky projekt me çështje të vizave, se është historik tashmë e ditur, e që vizat janë një kapitull tjetër i rëndësishëm për qarkullimin e lirë të njerëzve, ky kapitull nuk mund të kushtëzohet kurrsesi me territor, çfarë edhe ka ndodhur, e që është shumë e vërtetë dhe që është kusht i panevojshëm e i dëmshëm, e që e kanë aprovuar qeveritë e mëparshme.

Prandaj, këtu kur jemi, për çështje të shpjegimit të territorit, çështja e kufijve e këto është një temë që zgjat nga 2-3 orë a 5 orë këtu, por do të themi për objektiva tash. Unë pashë se ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, i thirri për ta votuar një projekt, i cili është i njëjti, sipas neve gjithnjë, sepse aprovohet në bazë, ratifikohet marrëveshja 2015, e cila në bazë është, në paragraf është numër 1 Marrëveshja 2015, a është ashtu? Duhet të votohet kjo sipas radhitjes, kurse mos harroni, ju i dini edhe të drejtën ndërkombëtare e tjera, dy marrëveshje shtetërore nuk kanë kushte kur të vijë..

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Bajrami.

*(Ndërhyrje)*

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar,

Përfaqësues të Kabinetit qeveritar, qenka vetëm një ministër tanimë,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot është e vërtetë që me shumë vonesë po e trajtojmë raportin e 100 ditëve të punës së Qeverisë Haradinaj, me 88 ditë vonesë, e dinë të gjithë disa herë e kemi shtyrë seancën për shkak të mungesës së kryeministrit Haradinaj. Siç po e shohim, edhe sot ai ishte në pjesën e parë, ku zbrazti një breshëri ofendimesh dhe iku. Po mendoj që rezultati i qeverisjes së tij më së miri tregohet nga mosprezenca e tij, sepse sikur të ishte në gjendje të mbronte vendimet, të cilat ne i kemi para vetes, atëherë do të ishte këtu.

Të nderuar kolegë deputetë, ne kemi një listë të vendimeve, të kontratave, të cilat janë nënshkruar e që, në fakt, kanë qenë pothuajse të gatshme. Po përmend të gjitha me radhë: kontrata për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”, për të cilën Qeveria Mustafa ka negociuar tre vjet. Qeveria e re sigurisht që është meritore për koncesionet e shpejta që i ka bërë pothuajse për më pak se një muaj dhe e ka nënshkruar, e të cilat ende sot e kësaj dite nuk janë publike. Fitimi i 49 milionë eurove me korporatën e Sfidave të Mileniumit, të mos harrojmë se edhe kjo është rezultat i qeverisjes së kaluar. Zgjedhja dhe ndarja e buxhetit për kategoritë e dala nga lufta ka qenë çështje e rishikimit dhe ne e dimë që rishikimi i buxhetit nuk ka mundur të ndodhë për shkak se nuk kemi pasur rishikim, se kemi shkuar në zgjedhje. Një e arritur tjetër, e cila nuk është aspak e vërtetë dhe është raportuar në raport është renditja e Kosovës në dhjetëshen e parë top reformatore për përmirësimin e ambientit të biznesit. E kemi thënë disa herë që Banka Botërore ka matur ambientin e biznesit në Kosovë nga 1 qershori 2016 deri më 31 maj 2017, kështu që si e tillë as nuk është dashur të figurojë si rezultat i Qeverisë Haradinaj, për shkak se nuk ka asnjë meritë.

Në fakt, e vetmja meritë që ka për atë periudhë është hedhja e gazit lotsjellës, thyerja e veturave të ministrisë, të organizuara dhe të frymëzuar nga persona në protestat atë kohë të “Vetëvendosjes” edhe AAK-së që ishin në një lloj koalicioni të opozitës. Dikush nga deputetët e AAK-së e tha që Qeveria ka sjellë pothuajse çdo ditë nga një ligj, është e vërtetë që ka sjellë ligje, por janë mbi 60 ligje, të cilat kanë qenë të gatshme, rreth 40 prej tyre kanë qenë në Kuvend dhe i janë kthyer si pako Qeverisë. Kryeministri në raportin 100-ditësh e ka shënuar si rezultat shkarkimin e Bordit të Agjencisë së Akreditimit, nuk e di nëse e konsideron si rezultat edhe përjashtimin e Agjencisë së Akreditimit nga rrjeti i agjencive evropiane, domethënë nga EQAR-i, dhe për këtë nuk kemi marrë përgjigje.

Vendim tjetër që thuhet që është i pari në historinë e qeverive që nuk është e vërtetë, është ndalimi i përdorimit të veturave zyrtare në fushatën lokale. Unë dua t’ua bëj me dije edhe përfaqësuesve të Qeverisë, kryeministrit Haradinaj që ka qenë kryeministri Mustafa, i cili për herë të parë ka marrë një vendim të tillë edhe gjatë fushatës së zgjedhjeve nacionale asnjë veturë zyrtare nuk është përdorur. Po ajo çka është dashur të raportojë kryeministri Haradinaj është se si përdoren 75 veturat e zëvendësministrave dhe ku parkohen ato, sepse kemi parë plot skandale.

Ndarja e 5.7 milionë eurove nga rezerva shtetërore, për vetëm gjashtë muaj qeverisje, e cila ka tejkaluar disa herë rezervat që i kemi ndarë ne për një vit, është komplet e pajustificueshme, të natyrave deri për festimin e festave të fund vitit për fëmijët e Leposaviqit, deri tek ato për ndarje të familjarëve, të pjesëmarrësve në konfliktin e Kumanovës, për të cilin fakt ne nuk kemi asnjë përgjigje dhe ajo ngjarje është sot e kësaj dite enigmë, gjithsesi nuk është diçka me të cilën qytetarët e Republikës së Kosovës krenohen me të. Procedurat për ndërtimin e stadiumit kombëtar janë shënuar si rezultat në raport, unë ju bëj me dije se këto procedura kanë filluar në qeverisjen e kaluar, në kohën e ministrit Shala, bile në kohën e ministrit Shala dhe të qeverisjes Mustafa, Kosova është pranuar në FIFA dhe në UEFA, krejt çka është bërë gjatë kësaj qeverisje, është ndërruar lokacioni, domethënë nga Bërnica në Drenas dhe historia, e ardhmja do të na e vërtetojë që ky është një nga gabimet më trashanike që ka bërë kjo qeveri për shkak të kostos së madhe të mirëmbajtjes, e në një lokacion siç është Drenasi, assesi nuk ka interes nga operatorët privatë që ta marrin për ta shfrytëzuar dhe mirëmbajtur.

Energjia e strategjisë ka qenë e gatshme, është ministri këtu, për shpronësimin në Hadë tanimë u fol, ne do të thërrasim edhe një interpelancë sigurisht për të raportuar kryeministri se në çfarë niveli dhe në çfarë cilësie ai drejtpërdrejt ka ndërhyrë te shpronësimi. Kostoja e shpronësimit në Hade fillimisht ka qenë 4.5 milionë dhe flitet që kostoja e shpronësimeve nga kjo qeveri ka arritur mbi 22 milionë. Në fakt, banorët e Hadës triumfuan duke shkelur ligjin, e këtë e kurorëzoi me vendim kryeministri Haradinaj që në fund shkeli ligjin vetë. Kryeministri në një intervistë për punën 100-ditore e tha që është lajm i mirë që askush në Kosovë nuk do të paguajë për energjinë elektrike që e shpenzojnë të tjerët dhe ne duam t’ia përkujtojmë kryeministrit tash pas 88 ditësh që ai vetëm para një jave mori një vendim për ndarjen e 1 milion eurove pikërisht për të

kompensuar energjinë elektrike që shpenzojnë qytetarët në tri komunat veriore. Ku mbeti premtimi, pse tash ne po u dashka prapë të paguajmë? Sepse është njëjtë sikur ajo kosto të ishte e inkorporuar në fatura, siç ka qenë përpara, sikur tash që paguhet nga taksat e qytetarëve të Republikës.

Kryeministri ka marrë disa vendime për të shkarkuar borde të ndryshme, shpeshherë jo në kompetencë të tij, kanë qenë në kompetencë të Kuvendit, por edhe kur ka marrë vendime për të shkarkuar borde, këto i ka bërë në mënyrë shumë selektive. Ka borde, në të cilat ka pjesëtarë të partisë së tij dhe ato nuk i ka prekur fare. Në raportin 100-ditor gjithashtu thuhet që Qeveria ka miratuar prioritetet e Agjendës Evropiane të reformave, me theks të veçantë në qeverisje të mirë. Unë i bëj pyetje atij, për cilën qeverisje të mirë e ka fjalën, për atë që po shpërndan buxhetin sikur të ishte i tij apo për atë që i ka emëruar 75 zëvendësministra. Prioritet tjetër thotë që është sundimi i ligjit dhe prapë e pyes, se për cilin sundim të ligjit e ka fjalën. Për atë që Gjykatës Speciale, i cili desh e kthej vendin në vitin 1999 për një mbrëmje, apo për qeverisjen e cila po flet për sundim të ligjit dhe po kthen zyrtarët e korruptuar në pozita të prokurimit.

Prioritet tjetër tha që është konkurrueshmëria. Për cilën konkurrueshmëri e ka fjalën? Për vendimin i cili u fali 53 milionë vetëm disa kompanive dhe pasi u bind nga opozita që ka bërë shkelje ligjore, e ktheu atë vendim mbrapa apo për cilat vendime të tjera? Sepse këto vendime janë selektive, e dëmtojnë konkurrencën e drejtë dhe assesi nuk janë në funksion të përmirësimit të ambientit të biznesit. Ka folur edhe për klimën e investimeve, ne i themi atij që asnjë hap konkret nuk është bërë që të përmirësohet tutje klima e investimeve. Në raportet ku flitet për ministrinë janë disa ministri që i raportojnë Komisionit tonë FunkSIONAL për Tregti, Industri, Zhvillim Ekonomik dhe Zhvillim Rajonal, po ju them me kompetencë të plotë që ministrinë e reja janë fokusuar drejt rekrutimit, nuk kemi asnjë aksion nga ana e tyre, ndërkohë që ministrinë ekzistuese edhe sot e kësaj dite raportojnë në rezultatet e qeverisjes së kaluar. Po më vjen keq që ministri i Tregtisë dhe Industrisë nuk është këtu, por i them publikisht se nga dhjetë rezultate, të cilat ai i ka raportuar në raportin 100-ditor, janë rezultate të qeverisjes së kaluar, si renditja në raportin e Bankës Botërore “Top reformator”, krijimi i zonave ekonomike, inkubatori i parkut të teknologjisë informatike në Bërnice, vizitat e ndërmarrjeve, organizimi i panairëve, të gjitha këto janë vendime, janë projekte, të cilat kanë qenë në implementim e sipër dhe asnjë hap tjetër nuk është bërë.

I vetmi rezultat që mundet të shënohet është vendosja e taksës për 4 cent për miellin që importohet nga Serbia, dhe ju them prapë që për një vendim të tillë duhet të bëhet hetim, sepse kjo nuk ka ndihmuar prodhuesit vendës, kjo ndihmon një numër të kompanive të vogla dhe...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Izma. Replikë, zoti Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit! Unë e kuptoj edhe parafolësen time që e përmendi çështjen e ligjeve që shumë ligje janë sjellë në Kuvend, edhe që ato ligje kanë qenë nëpër sirtarë. Është e vërtetë, ndoshta nuk është meritë e punës me këto ligje të kësaj qeverie, po është meritë e guximit për t'i prurë në Kuvend këto ligje. Po ashtu, meritë e kësaj qeverie ose mund ta them atëherë, edhe me fat, sepse 100 milionë euro brenda 100 ditësh janë sjellë grante pa kthim, meritë e kësaj qeverie po ashtu është që 1.3 miliardë euro po bën kontratë. Po ashtu, 280 milionë euro po kthehen prej AKP-së te qytetarët e Republikës së Kosovës, ose mund të themi që është meritë, ose fat.

Do të kisha pranuar çështjen me fat se kur ta kishim pranuar që Qeveria e mëparshme ka qenë qeveri pa fat. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zonja Bajrami!

HYKMETE BAJRAMI: Për çfarë guximi, zoti Kuçi, e keni fjalën, që jeni tërhequr nga kauza e demarkacionit, që sa keni qenë në opozitë keni dashur ta kallni Kosovën, keni dashur ta kallni Kuvendin dhe sot bëni thirrje për të votuar të njëjtën marrëveshje, këtë e quani guxim? Përndryshe, ligjet kanë qenë të gatshme nga qeveria e kaluar, ka qenë Kuvendi ai që nuk ka funksionuar për shkak se ju gati e keni kallur Kosovën për demarkacionin dhe sot, për të qëndruar në pushtet, për të vazhduar të ndani mjete të buxhetit e Kosovës me arsye dhe pa arsye, ju e keni harruar edhe kauzën e demarkacionit dhe i keni harruar të gjitha.

Këtë e quani guxim? Unë nuk e besoj që ky është guxim, kjo është tradhti e votuesve tuaj që ua bëni.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Xhevahire Izmaqu e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

Po shpresoj ta kthej debatin në temën për të cilën jemi thirrur.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Dhënia e mundësisë të diskutoj në këtë fazë ku debati është kah fundi i ka dy mundësi pozitive, në një e shpenzon mllëfin e deritashëm nga ana opozitare, herë të arsyeshëm, herë të paarsyeshëm dhe, nën dy, ka mundësi që të marr përshkrimet edhe mënyrën se si është parë puna e qeverisë deri në këtë fazë, duke u thirrur në emër të qytetarëve, po shpresoj që qytetarët më së shumti sot kishin pasur dëshirë të na shohin duke votuar dhe duke diskutuar për demarkacion, që të jetë fjalimi ndoshta i fundit imi para se të votojmë atë temë shumë të rëndësishme për vendin.

Kërkesa për debat e lidhur me punën e 100-ditëshit, bashkë me kolegët e mi të tjerë dhe mua personalisht më ka dhënë motiv që t'i shikoj me interesim dhe me iniciativë të opozitës, pra çdo detaj të punës së qeverisë, duke i analizuar edhe mangësitë. Në të gjithë sektorët qeveritarë në një periudhë që mendoj që nuk na lejon edhe shumë komoditet për të pasur një pasqyrë të saktë edhe objektive, sepse kemi edhe punë, të cilat janë duke u kryer dhe kërkojnë një afat më të gjatë deri në finalizim. Fillimisht, dëshiroj t'i falënderoj të gjithë ministrat, veçanërisht nga partia ime që kanë shprehur vullnet të madh deri në këtë moment, kanë biseduar me neve dhe kanë raportuar për çdo dilemë qoftë brenda grupit, qoftë edhe jashtë grupit. Por, sigurisht edhe ministrat e tjerë, të cilët kanë qenë bashkëpunues, qoftë e kemi parë punën e tyre, domethënë që është zhvilluar me transparencë, por edhe pyetjet që i kemi shtruar kanë qenë në gjendje të përgjigjen, qoftë edhe për punët që nuk i kanë kryer.

Kam përcjellë veçanërisht me vëmendje sektorët, për të cilët vërejtjet dhe ambiciet tona në vazhdimësi kanë qenë të munguara, e këtë mandat shpresoj dhe duket që do të kemi vend për një vlerësim më kualitativ, siç janë: Ministria e Drejtësisë, udhëhequr mendoj guximshëm nga një ministër i ri, siç është ministri Tahiri. Ministria e Shëndetësisë, e Financave, Infrastrukturë, Integritet, Ambient, Kulturë e tjerë. Duke qenë se jemi përfolur shumë në shumë raporte ndërkombëtare mbi mungesën e përkushtimit dhe reformave në sektorin e drejtësisë, unë përgëzoj iniciativat e shpejta, po them edhe të guximshme në këtë drejtim për angazhimet pra në reformën legislative për drejtësi.

Në kuadër të Agjendës për Integritet Evropiane, konsiderojmë që janë ndërmarrë të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me zbatimin e obligimeve të dala nga plani kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, por edhe pakos të procesit "Era" dhe dialogut nën Komitetin për drejtësi, siguri dhe liri. Me vendim të Qeverisë është miratuar rishikimi funksional i sektorit të sundimit të ligjit, me qëllim të ngritjes të efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë. Si deputete, por edhe si qytetare dhe qytetarë kemi pasur mundësinë që për këto ditë të përcjellim me shumë transparencë të gjitha këto zhvillime përmes mediave, ku ministri Tahiri pra pa hezitim i ka ofruar opinionit këto informacione në mënyrë të qartë.

100-ditëshi për Ministrinë e Financave konsideroj që ka qenë një periudhë shumë aktive dhe me rezultate konkrete, duke përfshirë edhe vendime shumë të mëdha. Në fillim të mandatit të Qeverisë, si asnjëherë më parë, janë filluar dhe kompletuar dy procese shumë të rëndësishme. Është fjala për rishikimin e buxhetit 2017, meqenëse ishte një kohë shumë e shkurtër dhe përgatitja për buxhetin e vitit 2018. Gjatë rishikimit të buxhetit Ministria e Financave, pas konsultimeve, komunikimeve me të gjitha organizatat buxhetore, ka zgjidhur problemin e çështjeve të veteranëve, fushën e shëndetësisë, skemave sociale, sigurisë dhe natyrisht për një numër të projekteve kapitale që është dashur të alokohen mjete shtesë për projektet që kanë mbetur nga qeveria e kaluar, nga viti 2017. Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe i ka

kushtuar një rëndësi të veçantë edhe agjendës legislative për t'u siguruar se të gjitha ligjet aprovohen sipas planit të paraparë të Qeverisë.

Ministria e Integritimit bashkë me strukturat koordinuese kombëtare për integrim evropian e ka bërë një punë intensive gjatë këtij viti me fokus në zbatimin e reformave që kërkon MSA-ja dhe monitorimin e zbatimit të tyre. E ka përcjellë hartimin dhe miratimin e gjithë legjislacionit për planifikim dhe zbatim të këtyre dokumenteve nacionale, pra në zbatim të MSA-së.

Ministria e Integritimit e ka përfaqësuar vendin në konferenca dhe organizata ndërkombëtare, për mendimin tim, me një performansë të shkëlqyer në periudhën e derisotme.

Më lejoni të shpreh një mendim pozitiv për angazhimin e madh të ministrit të Shëndetësisë në një periudhë të shkurtër, në një sektor ku janë mbledhur shumë probleme. Duke u inkurajuar nga fillimi i trajnimeve 24-orëshe në klinikat e QKUK-së për trajtimin e infarktit dhe kancerit, si një lajm të mirë për shëndetësinë kosovare dhe për qytetarët tanë me nevoja për trajtim. Aktivitetet e shumta të ministrit kanë treguar përpjekjet e Qeverisë që shëndetësia të bëhet prioritet kombëtar pas një kohe të gjatë. Sigurisht se ka shumë për t'u bërë në krijimin e kushteve për stafin mjekësor, sepse shpesh ndodh që i fajësojmë edhe për punët, për të cilat ata s'janë fajtorë. Kemi shumë pritje në furnizimin e spitaleve me barnat esenciale.

Sa i përket Ministrisë së Inovacionit, themelimi i saj kishte për synim stimulimin e aktiviteteve inovative në Republikën e Kosovës të lidhura ngushtë me ndërmarrësinë dhe fushat tjera të ekonomisë, fuqizimin kryesisht të sektorit privat. Në këtë drejtim janë bërë hapa të nevojshëm dhe presim zhvillime pozitive në ditët e ardhshme, sepse e kemi një ministër me përvojë në menaxhim dhe një profesor të suksesshëm.

Ministria e Kulturës në këtë periudhë të shkurtër ka përgatitur rregullativë ligjore në sektorët e munguar dhe ka mbështetur aktivitete me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar. Po ashtu, ka nënshkruar marrëveshje që konsideroj se në një periudhë të shpejtë do të sjellin produkte pozitive.

Ministria e Infrastrukturës - Mendoj se me një aktivitet të shtuar, ministri e ka bërë një përfaqësim shumë të mirë rajonal, pra nuk është fokusuar veç në një pjesë për të cilat kemi pasur përshtypje se do të koncentrohet, mirëpo mendoj se është duke e bërë një punë shumë të mirë, dinamike dhe me transparencë. Kemi mundësi që t'i shohim punët edhe nëpërmjet medieve, pra e përdor si parim edhe transparencën.

Konsideroj se ka pasur një përgjegjësi të mirë nga ministri Jaghillar për punët në reformën e Administratës Publike. Veçanërisht është një ndër ministrat i cili raporton pa kurrfarë ngurrimi



në komision dhe ky është detyrim, sigurisht kushtetues, mirëpo kemi që ka pasur edhe njëloj dembelie në këtë drejtim nga ministrat tjerë.

Si deputete e vlerësoj përkushtimin e ministres së Ambientit për një aktivitet me shumë transparencë nga dita e parë e punës, duke e njohur faktin që në këtë drejtim kemi shumë për të bërë, veçanërisht sfidat me të cilat u përballëm në periudhën e fundit, me cilësinë e ajrit. Pra, konsideroj që presim dhe duhet të kemi ambicie pozitive për pritje në vazhdimësi.

Unë pres që në ditët e ardhshme Qeveria do të fokusohet në prioritetet, veçanërisht në sektorin e arsimit. Sigurisht, duke e ndihmuar ministrin, t'i përmirësojë për sa është e mundur vendimet që na sollën pasoja të këqija në këtë drejtim, në aspekt të pranisë sonë ndërkombëtare në këto organizata. Pra, shpresoj të ndihmojë dhe jo të ndikojë në vendime për të cilat mund të kemi pasoja.

Pres që edhe opozita, kolegë e mi opozitar, përveç kritikave, ta marrin edhe rolin e vet në këto procese që kanë synim forcimin e shtetit, sepse konsideroj që duhet të krijohet një kulturë që jo çdoherë opozita ta shohë vetëm një qeveri vetëm zi dhe, po ashtu, mendoj se ka hapësirë që edhe ne deputetët e mazhorancës të shohim edhe elementet negative kur janë dhe këto t'i përmirësojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Thirrja e një debati nga opozita për të debatuar rreth 100-ditëshit të Qeverisë Haradinaj, ashtu siç janë gjithmonë të vonuar ata që e thirrën debatin, sot e pranuan që po diskutojnë për më shumë se 100 ditë dhe thjesht kërkesa e tyre drejtuar Kryesisë së Kuvendit ka qenë për 100-ditëshin. Atëherë ishte dashur t'i ndjekin edhe procedurat sipas rregullave, duke ditur se ka edhe interpretues të Rregullores së Kuvendit brenda grupit të LDK-së, që të thirret një debat për 200 ditë.

Megjithatë, secili deputet e ka marrë materialin me kohë, të kompletuar si raport për atë çfarë ka ndodhur për 100 ditë dhe është në vullnetin e secilit për të ditur, jo vetëm për ta lexuar, por edhe për ta kuptuar se çka në thelb paraqet ai raport.

Unë nuk dua t'i lexoj vendimet që janë marrë nga Qeveria, sepse janë transparente për secilin qytetar, e lëre më për deputetët. Deputetët e kanë materialin dhe e kanë pasur me kohë, por më duhet të them që në këtë Qeveri janë marrë shumë vendime, të cilat në radhë të parë e prekin mirëqenien e qytetarëve, por gjithherë është në interes të opozitës, që të kritikojë, sepse mbi të gjitha është demokratike edhe thirrja e debateve, e interpelancave, dhe, mbi të gjitha, ajo është

çfarë është edhe vetë Republika e Kosovës, pra si Republikë Parlamentare, që ta monitorojë Qeverinë.

Për shkak të numrit të madh të deputetëve të pozitës, unë kisha dashur që vërtet të thirren debate e interpelanca, por në kohën kur ne si Kuvend e heqim nga rendi i ditës radhën e ligjeve, që janë mbi 50 sosh, që janë në kutitë e deputetëve, në Kuvendin e Republikës së Kosovës që po presin për t'i shqyrtuar dhe për t'i miratuar, e kjo është një punë që ka sjellë Qeveria e Republikës së Kosovës, por po mbetet në duart e Kuvendit dhe tani thirrja e debateve, e interpelancave, pasi të kryhen ligjet, është shumë me interes, është shumë me vend. Unë kisha thënë që asnjë ditë të vetme të mos mbetet Kuvendi pa qenë në agjendë, pa punuar. Por, të mos i lëmë ligjet të presin.

Me një fjalë, është praktikë për të gjithë deputetët, sepse besoj që e dinë që secila qeveri, qoftë edhe një ligj, që sinqerisht Ligji për mbrojtjen e fëmijëve, fatkeqësisht, në Qeverinë e kaluar nuk arriti të përfundojë e të votohet për t'u implementuar ai ligj, edhe pse ishte në përfundim, sepse ishte pikërisht faji i Kuvendit. Në atë kohë Qeveria i kishte mbi 80 deputetë. Megjithatë, edhe sot po them që vendimet që ka ditur t'i marrë edhe Qeveria Mustafa, edhe Qeveria Haradinaj, janë vendime që sot secili i kemi para vetes dhe mund t'i gjejmë kudo.

Unë patjetër se më duhet ta përmend sot, të paktën disa prej atyre që Qeveria i ka marrë, nuk po ndalemi përsëri te ato që i thanë edhe kolegët e mi. Ligji për Prishtinën, normalisht se është Qeveria Haradinaj që e solli një ligj për Prishtinën, e që nuk patën guxim qeveritë tjera për ta sjellë. Ishte Qeveria Haradinaj që nuk e pa interesin e subjektit politik të Aleancës, por e pa interesin e kryeqytetit, e pa interesin e gjithë qytetarëve. Është Qeveria Haradinaj e cila ndau mjete mbi 200 mijë euro për procesin e njohjes dhe verifikimin e statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare, gjë që nuk e bëri Qeveria Mustafa. Është Qeveria Haradinaj, e cila bëri kompensimin, po i përmend këto për shkak se këto është dashur të ndodhin në Qeverinë e kaluar, me qëllim po i përmend, pra është Qeveria Haradinaj e cila bëri kompensimin e fermerëve për ngordhjen e kafshëve në vitin 2016 nga një sëmundje gungore, e secili prej nesh e dimë dhe janë ndarë pra 1 362 332,82 euro. Janë këto që kanë ndodhur, që është dashur të kompensohen fermerët qysh në vitin 2016, por nuk ka pasur as objektiv të qartë dhe as strategji Qeveria Mustafa.

Por, Qeveria Mustafa ka marrë disa vendime, ka marrë disa vendime, ka marrë edhe një vendim për faljen e borxheve, i kujtohet secilit prej nesh këtu që kemi qenë në legjislaturën e kaluar dhe sinqerisht po ju them që është mirë nëse me atë vendim... Ligj, ligj, me ligj, faleminderit kolege, faleminderit juve të LDK-së, me ligj po ju them që duke qenë në krye të Qeverisë zoti Mustafa, dhe duke qenë ministër i Financave, pra shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Hoti, atëherë ministër i Financave, në mesin e përfituesve të faljes së borxheve përfitoi vetë zoti Hoti. Janë fakte të cilat iu falën, iu shlyen pikërisht familjes së zotit Hoti si ministër i Financave, ai u kujdes për t'ia falë vetvetes pra një shumë të madhe, që është në kompaninë "Radoniqi", pra për të qenë

shumë transparente janë faktet të cilat unë i kam para vetes. Dhe, pos që janë falur disa borxhe në vlerë shumë të madhe për qytetarët e vendit, pikërisht zotit Hoti, i cili edhe sot i ka borxh kompanisë, por po pret ndoshta të bëhet edhe ndonjë ligj tjetër, a? Edhe ndonjë ligj tjetër ndoshta po pretendoni për t'ia falur edhe borxhet tjera.

Domethënë, kjo është një lojë me dy tehe. Unë nuk e di se si mund, duke qenë ministër i Financave po them, sepse njerëz jemi, mund edhe ne të atakohemi, por të jesh ministër i Financave dhe të jesh në listën e atyre që ke përfituar nga një vendim i tillë, për mua është diçka që nuk do të ishte një shembull i mirë, sepse jam shumë e sigurt se pensionistët dhe ata që kanë qenë në skemat sociale gjithëherë kanë ditur të ndajnë buxhet që të mos i mbeten borxh shtetit, të mos u mbeten borxh as kompanive, as ujësjellësit, as kompanive të mbeturinave, e të mos flas për energjetikë, e të tjera, sepse ata planifikojnë drejt dhe i ndajnë edhe mjetet tjera. Pra, unë disponoj me të dhëna faktike për këtë që po e them.

Megjithatë, u përmend qysh në fillim, pikërisht nga zoti Hoti, që kjo Qeveri nuk po e zbaton një kontratë të nënshkruar ndërmjet Qeverisë dhe SBASHK-ut. Po! Ju them me dhjetëra herë, për tri mandate rresht, prej momentit kur është shtruar debat parlamentar në atë kohë, më 2013, i iniciuar nga LDK-ja, dhe rekomandimet edhe të Komisionit për Arsim, dhe rekomandimet që kanë dalë nga ai debat, për tre muaj, obligohet Qeveria që ta sjellë Ligjin për punëtorët e viteve të '90-a. Prej 2013-ës, sot jemi më 2018, të nderuar, dhe nuk e keni bërë as edhe një hap. Sot, në vazhdimësi po ju them, jam dhe e ftoj Qeverinë e Republikës së Kosovës që sa më par ta sjellë këtë ligj dhe të zbatojë në plotëni Kontratën Kolektive, por e kam para vetes një letër publike, që në atë kohë, pra më 2016 ia ka drejtuar pikërisht kryeministri Mustafa kryetari i SBASHK-ut, zoti Rrahman Jashari. Është letër publike. Po flas, disa herë i thotë, që të mos i mashtrojë ata, sepse i ka mashtruar.

Unë këtu edhe një herë them që Qeveria Haradinaj të mos e bëjë mashttrimin e njëjtë me Qeverinë që e ka bërë, pra mashttrimin që e ka bërë Qeveria Mustafa.

Tani, zonja Kusari-Lila, nuk është këtu, por i them që edhe një herë për hir të transparencës, sepse në qoftë se ti flet se ku kemi korrupsion, në qoftë se flasim për konflikt interesi, në qoftë se flasim për diçka si model të mirë, po çfarë të mire i solle Gjakovës për katër vjet, zonja Kusari-Lila? Po, cilat janë ato projekte me të cilat mund të krenohesh sot që ua ke lënë qytetarëve të Gjakovës? Nuk e ke dhënë përgjigjen herën e fundit, edhe një herë, edhe dhjetë herë, do t'ia bëj pyetjen, a je anëtare e Këshillit Drejtues të Universitetit "Fehmi Agani", në Gjakovë? Po, është! Dhe, pos asaj që është konflikt interesi, sepse është udhëheqëse e një subjekti politik, e cila vazhdim...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Tash, zonja deputete, unë vërtet po mundohem ta ruaj gjuhën, por po m'i nxjerr fjalët kështu. Tash, të them se po thua të pavërteta, është pak. Të them se po thua shpifje, edhe kjo është pak. Unë po ta them qartë, se ti po rren dhe po e mashtron opinionin publik.

Unë ndihem mirë që sa kam qenë ministër, me sa di edhe ti e ke votuar Ligjin për falje të borxheve, me të cilin qytetarëve të Kosovës ua kemi falë 600 milionë euro. Ju keni tentuar t'i falni afro 60 milionë, gjysmën t'i merrni për vete, në mesin e atyre 600 milionëve janë të evidentuar krejt kush ka përfitur. Në mesin e tyre kanë përfitur edhe qindra-mijëra bujq të Rrafshit të Dukagjinit, përfshirë edhe gjysmën e fshatit tim, që janë kushërinj të afërt të mi, por Avdullah Hoti s'i ka borxh shtetit të Kosovës asnjë cent të vetëm.

Në bazë të ligjit ka përfitur edhe familja jote, edhe bujqit e krejt Rrafshit të Dukagjinit dhe kudo nëpër Kosovë për borxhin që mund ta kenë pasur ndaj ndërmarrjeve publike. Por, ne e kemi bërë me ligj atë dhe krejt janë transparente. Ju keni dashur ta bëni me vendim, t'i keqpërdorni 60 milionë euro taksa të qytetarëve të Kosovës. Kjo është diferenca.

Unë e kuptoj frustrimin tënd dhe të kryeministrit tënd dhe të partisë tënde, sepse tash jeni në bisht, jeni partia e pestë në Kuvend, s'mund të vendosni për asnjë proces. Krejt çka mund të bëni është që të shpifni, të fyeri dhe të rreni. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë, zonja Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit shumë për fjalorin, i nderuar profesor i Universitetit të Prishtinës. "Me rrej" dhe "në bisht" nuk do të duhej të ishte në gjuhën e një profesori, por, megjithatë, kam fakte i nderuar ish-ministër, i nderuar profesor dhe shef i grupit parlamentar, të kam thënë, merr mësim prej Ismet Beqirit. Nuk po merr!

Kam fakte, ia ke falur vetvetes dhe kjo është fjalë publike, i ftoj mediet, ftoj secilin prej jush, që në kompaninë rajonale "Radoniqi" i gjeni të dhënat, i keni edhe sot, por deri më 2009 është shifra që është shumë e madhe, që ju ia keni falur vetvetes me atë ligj, është ligj, por i keni falur vetes. Unë nuk po rrej! Unë nuk po rrej, po unë po flas me fakte i nderuar dhe këtu të kisha ftuar të kërkosh falje për këtë gjuhë tënden që po e qet për dallim nga ajo...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën, nga "Nisma".

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër i Kabinetit qeveritar,

Sot patëm rastin të debatojmë për punën e Qeverisë, edhe pse debati është thirrur për 100-ditëshin, 100-ditëshi ka kaluar, tani jemi në përmbushje të 200 ditëve të kësaj Qeverie.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Mendoj se Qeveria aktuale ka marrë vendime të cilat janë në interes të vendit dhe të qytetarëve të vendit. Ka mjaft tregues të cilët e dëshmojnë se Qeveria është në rrugë dhe në përpjekje maksimale për ta pastruar tavolinën e punës nga tema dhe nga mosvendime e situata të cilat janë krijuar në vazhdimësi në qeveritë e kaluara, apo nga qeveritë e kaluara.

Mendoj se duke filluar nga mbrojtja e prodhuesve vendorë, mbrojtja e konsumatorëve, pakoja për punësim, masat dhe transparenca që ka ofruar Ministria e Transportit, duke e pastruar tavolinën nga ato kontrata të cilat kishin dilema se si janë thurur më herët, mendoj se ka tregues të cilët mjaftueshëm tregojnë se Qeveria e ka një dimension pozitiv, megjithëse mund të themi se ka edhe ngecje dhe ka vështirësi për ta realizuar programin e saj qeverisës.

Të nderuar deputetë,

Nuk është mirë që ky debat të kthehet në një luftë ndërmjet subjekteve politike apo grupeve parlamentare për ta shfaqur konkurrencën politike në këtë kohë, sepse është herët. Mendoj se këtu duhet të bëhet një debat konstruktiv, i cili do t'i ndihmonte Qeverisë dhe qytetarëve për të krijuar standarde dhe jetë më të mirë, e sidomos në temat në të cilat mendoj se janë tepër të rëndësishme, siç është ushtria. Mendoj se kësaj teme duhet t'i përvishemi me seriozitet, e jo duke tentuar se kush ka faj për vonesat e moskrijimit të ushtrisë, apo për të marrë lëvdata. Po ashtu, duhet të them se nga ajo që dëgjuam nga eksponentë të Qeverisë, që bisedimet e kanë ndarë faktorin politik në Kosovë, ne duhet të shqetësohemi më tepër për dëmet që i kanë sjellë bisedimet Kosovës dhe qytetarëve të Kosovës, prandaj edhe kjo është një temë që me të vërtetë pajtohemi me atë pjesën e zëvendëskryeministrit që bëri thirrje për unitet rreth bisedimeve me Serbinë, por paraprakisht duhet t'i shohim edhe dëmet dhe pasojat që janë sjellë si rezultat i bisedimeve të papërgatitura dhe me një qasje të tillë, çfarë ka shkuar deri më tani.

Ne e vlerësojmë angazhimin e Kabinetit qeveritar të kryeministrit, por sigurisht bëjmë thirrje që të ketë më tepër potencial, të ketë më tepër angazhim dhe të ketë më tepër suksese, sepse qytetarët presin më shumë dhe presin që kjo Qeveri të ofrojë një jetë më të mirë, më stabile dhe më të sigurt për qytetarët e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë ju kisha lutur, nëse doni e ndërpresim, ose uluni, ose po e ndërpresim seancën. Fjalën e ka Drita Millaku.

DRITA MILLAKU: Faleminderit!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Që nga ora 10:00 sot e kemi filluar një debat, në të cilin më shumë jemi duke diskutuar ndërmjet mazhorancës dhe LDK-së, mirëpo asgjë konkrete deri më tash nuk u tha.

Ajo që u tha prej mazhorancës është se janë krenuar për vendimet që janë marrë deri tash, e nga LDK-ja të gjitha këto vendime thuajse janë servuar prej tyre. Mirëpo, në Prizren një fjalë e urtë popullore thotë, “Shkoi Jonuzi, erdh domuzi”.

Kjo qeverisje do të mbahet mend si një qeverisje që e ka bërë një hap para e katër prapa. Do t’i them vetëm disa prej vendimeve që i ka marrë dhe ende pa i marrë mirë vendimet, i ka tërhequr. E para është shfuqizimi që e mori për Gjykatën Speciale, vendimi për pagat, vendimi për faljen e borxheve dhe, së fundmi, vendimi për demarkacionin.

100-ditëshi i parë i kësaj qeverisjeje ka pasur vendime të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në varfërinë dhe në moszhvillimin ekonomik të vendit. Janë arsyetuar se Buxheti 2018 është mbi 2 miliardë euro, kinse garanton vende të reja të punës, por përveç zëvendësministrave dhe ministrave kjo qeverisje nuk ka pasur vende të reja të punës. Ka pasur veç mbi 72 zëvendësministra, 72 zyra, 72 shoferë, 72 truproja, pra vende tjera janë vetëm këto, këtu përfundon krejt punësimi i kësaj qeverisjeje. Janë krenuar se kanë siguruar dhe kanë ndarë fonde shtesë për kategoritë e dala të luftës, por ende nuk kanë bërë asnjë hap që të pastrohen këto lista dhe as që do t’i pastrojnë asnjëherë, sepse duhet kthyer këtyre personave nga 5 mijë euro që ua kanë marrë për t’i futur në lista.

Janë mburrur dhe po mburren që e kanë rritur buxhetin e Shëndetësisë mbi 18 milionë euro, por keni harruar që keni premtuar që nga data 1 janar e këtij viti keni për të filluar me sigurimet shëndetësore. Pra, avazi i njëjtë i qeverisjes së kaluar. Jeni krenuar se keni mbajtur mbi 20 mbledhje të Qeverisë dhe keni marrë mbi 244 vendime, por ama shumica e këtyre vendimeve kanë qenë vendime të mbrapshta.

Keni falë mbi 60 milionë euro tatim të firmave, vendim pra shumë i madh i guximshëm, mirëpo ky vendim u tërhoq menjëherë dhe tani do ta kisha pyetur zotin kryeministër, por nuk është këtu. Pse e ka tërhequr këtë vendim? Apo, dëshirojmë të dimë nëse nuk i kanë premtuar se do t’i ndajnë ato para me ta bashkë, apo ku qëndron arsyeja?

Kanë ndarë mbi 200 mijë euro për Sekretariatit për Hetimin e Personave të Dhunuar të luftës së fundit. Edhe këtu do t’i kisha pyetur, a do ta keqpërdorni edhe këtë kategori të ndjeshme për përfitime personale, si kategoritë e veteranëve?

Keni thënë se e keni marrë një vendim për ta ndërprerë përdorimin e automjeteve zyrtare për fushatë zgjedhore. Edhe kjo është një gënjeshtër e kulluar, sepse unë vij nga qyteti i Prizrenit dhe gjatë gjithë fushatës kam hasur nëpër automjetet e targave zyrtare nëpër fushatë. Jeni mburrur sigurisht se keni për të siguruar njohje me një shtet, faktikisht keni harruar se më shumë jeni marrë se cilat nga shtetet i kanë tërhequr njohjet.

Dua ta cek edhe një Ligj për kontrollin e interesave që e keni përmendur shumë në suksesin tuaj si Qeveri. E keni harruar se keni qeveritarë që i mbajnë më shumë se 2-3 poste, ka edhe më shumë që mbajnë deri në 5 vende të punës. I keni edhe ministrat që, përpos postit që e mbajnë si ministër, janë edhe asamblistë. Pra, Qeveri supermenësh i thuhet kësaj.

E, në anën tjetër, shërbyesve civilë u ndalohet me ligj që t'i mbajnë dy vende, apo dy pozita.

Është përmendur që brenda 100 ditësh, Ministria e Kulturës do të bartet në Prizren, po kaluan sa muaj dhe ky premtim mbeti si shumë premtime tjera pa u realizuar.

Pastaj Ligjin për pensionimin e policëve nuk po e sillni në Kuvend dhe meqenëse po thoni se e keni gati, ende nuk e keni sjellë dhe është shumë shqetësuese se mosha mesatare e policëve është 45-vjeçare. Kryeministër, pra kemi policë pleq që e mbajnë dhe kujdesen për rendin dhe ligjin.

Ushtria po vazhdon të mbetet ende e kushtëzuar nga Lista serbe. Për t'ia vënë kapakun krejt kësaj qeverisje, domethënë keni marrë një vendim më të keq - rritjen 100% të rrogave edhe të kryeministrit, por edhe të qeveritarëve, por edhe këtë vendim menjëherë e tërhoqi. Pra, ky është vendimi ku më së keqi ka "shllajfitur" kryeministri. Përnjëmend shumë i guximshëm, ama guximin për vendime shumë të mbrapshta. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Mufëra Shinik.)*

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Sot jemi duke e diskutuar një temë e cila ka disa muaj që e ka humbur aktualitetin, sepse kjo kërkesë e Lidhjes Demokratike të Kosovës për ta pasur një debat me kryeministrin e Kosovës lidhur me punën e tij 100-ditëshe, është bërë para 100 ditësh. Pra, tash jemi 200 ditë pasi që është formuar Qeveria dhe aktualiteti i kësaj teme ka humbur.

Gjithsesi, kryeministri i Kosovës për ta krijuar një situatë në të cilën mendon se mund ta krijojë një situatë të re nëpërmjet sjelljes obstruktive në Kuvend arriti sot që me akuza të pabaza dhe të paarsyeshme ta hapë debatin për një temë shumë të ndjeshme, siç është tema e krijimit të Ushtrisë së Kosovës.

Unë, në fjalimin tim, meqenëse e kisha paradite një debat me kryeministrin dhe një replikë, dua t'ia sqaroj kryeministrin, më vjen keq që nuk është këtu dhe t'i diskutojmë bashkërisht këto tema, tashmë ndoshta me qetësi, se si janë zhvilluar ngjarjet dhe në çfarë rrethanash politike është marrë vendimi i Grupit Parlamentar të LDK-së dhe i Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës, dhe kryetarit Mustafa në atë kohë që ne të mos e përkrahim vazhdimin e vendeve të rezervuara edhe për një mandat.

Në vitin 2011 unë kam qenë pjesë e Komisionit për draftimin e Kushtetutës dhe heqjen e provizioneve për pavarësinë e mbikëqyrur. Me ato punë që kemi bërë është hequr edhe provizioni për vendet e rezervuara dhe kemi mbërrirë në vitin 2011, por ashtu një moment kritik, kur me urdhër të kryeministrin të kohës, Hashim Thaçi, Policia e Kosovës nisat drejt pikave kufitare në veri të Mitrovicës dhe me dështimin e këtij urdhri mbetet një polic i vrarë dhe disa të tjerë të plagosur. Pas kësaj, çështja e Veriut të Kosovës bëhet çështje e diskutimeve ndërkombëtare, të ndërmjetësuara në Bruksel. Dhe, këtu vijmë në një situatë tjetër kur i kemi zgjedhjet e vitit 2013, zgjedhjet lokale, dhe si rezultat i bisedimeve dhe i Marrëveshjes së prillit të vitit 2013, marrëveshjes së njohur si Marrëveshja e Parimeve, vendimi për formimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe dhe një varg kompetencash për këto komuna.

Në këtë situatë, në vitin 2013 fillojnë debatet dhe kërkesat e grupeve politike dhe sidomos partive politike të grupeve etnike joshqiptare për vazhdimin e vendeve të rezervuara edhe për një kohë tjetër.

Në këto debate, duke e marrë parasysh situatën, Lidhja Demokratike e Kosovës në analizën e vet ka marrë në konsideratë këto elemente:

Elementi i parë, Marrëveshja e parimeve të vitit 2013,  
Elementi i dytë, dështimi i operacionit policor të 25 korrikut 2011,  
Elementi i tretë, në zgjedhjet lokale e vitit 2013 për të marrë pjesë në këto zgjedhje kanë aplikuar nga Republika e Serbisë 38 228 shtetas të Kosovës, të cilët jetojnë në Serbi. 1 074 kanë aplikuar nga Republika e Malit të Zi.

Nëse e marrim dhe e analizojmë, rreth 40 000 pjesëmarrës të rregullt në zgjedhjet e Kosovës dhe 40 000 të tjerë si aplikues prej Serbisë, i bie që kemi rreth 80 000 votues serbë që do të marrin pjesë në zgjedhjet e vitit 2014.

Nëse marrim dhe e shohim që për një deputet në Kuvendin e Kosovës mesatarisht votojnë 6 600 votues, i bie që përveç vendeve të rezervuara prej 10 deputetëve që do t'i kishte minoriteti serb në Kuvendin e Kosovës, do t'i kishte edhe 12 deputetë tjerë me këtë numër të aplikacioneve që e kanë pasur në vitin 2013. Po flas për të dhëna statistikore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që janë lehtësisht të verifikueshme.



Në këtë rast, dua ta falënderoj Komisionin Qendrorë të Zgjedhjeve, sepse në zgjedhjet e vitit 2013 ka gjetur falsifikime që janë bërë në Republikën e Serbisë dhe ka autorizuar vetëm rreth 11 000 persona që mund të marrin pjesë në këto zgjedhje.

Në këto rrethana është marrë vendimi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës që të mos përkrahet vazhdimi i vendeve të rezervuara.

Unë po flas për tri takimet, në të cilat unë kam qenë i pranishëm. Takimi i parë është mbajtur në rezidencën e ambasadorit Britanik në Kosovë. Ka qenë i pranishëm kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, unë dhe Vjosa Osmani, si dhe një përfaqësues teknik i LDK-së.

Në këtë takim është kërkuar nga ambasadorët e vendeve të QUINT-it që për hir të akomodimit të interesave serbe, sepse po tregohen konstruktivë në bisedimet e Vjenës dhe për pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet lokale, të krijohet mundësia e vazhdimit për një kohë të caktuar e vendeve të rezervuara.

Qëndrimi zyrtar i LDK-së ka qenë se do të diskutojmë me grupet parlamentare dhe me strukturat e partisë dhe pastaj do të kthehemi për të dhënë përgjigje.

Në takimin e dytë, Lidhja Demokratike e Kosovës ka diskutuar në Grupin Parlamentar dhe në Kryesinë e partisë dhe ka marrë vendim që të mos përkrahen vendet e rezervuara.

Në takimin e tretë, të pranishëm kanë qenë përfaqësuesit e LDK-së, përfaqësuesit e AAK-së, në atë kohë në pozitë, zoti Ardian Gjini dhe zoti Blerim Shala, kryeministri i Kosovës i shoqëruar nga Enver Hoxhaj, zoti Pacolli si zëvendëskryeministër në atë kohë dhe përfaqësues i pushtetit dhe të gjitha partitë politike nga radhët e komuniteteve joshumicë në Kosovë,

Takimi ka qenë i tensionuar dhe qëndrimi zyrtar i LDK-së ka qenë se ne nuk e përkrah vazhdimin e vendeve të rezervuara dhe takimi është prishur.

Në këto takime, të cilat ne i kemi mbajtur, asnjëherë nuk është diskutuar çështja e ushtrisë. Edhe sikur të ishte diskutuar, unë personalisht nuk do ta kisha përkrahur në këto rrethana politike futjen në Kushtetutën e Kosovës ndarjen e vendeve të rezervuara për komunitetet joshumicë në Kosovë, sepse e dëmton përfaqësimin politik në Kosovë dhe sot e kemi një Kuvend jofunksional, sepse kemi përfaqësim të pamerituar politik.

Mirëpo, e kemi këtë situatë dhe në këto rrethana unë ju them, edhe kryeministrit i cili nuk është i pranishëm, edhe përfaqësuesve të Kuvendin e Kosovës, se jam në gjendje ta diskutoj me detaje gjithsecilin diskutim që e ka pasur, duke filluar prej zotit Thaçi, i cili ka kërkuar në emër të

grupeve etnike joshqiptare që të vazhdohen vendet e rezervuara dhe të gjithë tjerëve dhe të shohim se kush çka ka bërë.

Pra, ne nuk kemi nevojë që ta destabilizojmë sigurinë e brendshme të Kosovës, duke pretenduar që ta formojmë ushtrinë, e cila realisht nuk ka mund të formohet as atëherë, sepse ju e dini që Kushtetuta e Kosovës duhet të ndryshohet me 2/3-tat e dyfishta, e 2/3-tat e dyfishta nënkupton 2/3-tën e të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës dhe 2/3-tat e deputetëve nga radhët e komuniteteve joshumicë në Kosovë.

Pra, kjo ka qenë situata politike, këto kanë qenë kërkesat të cilat janë bërë dhe ky ka qenë refuzimi që e ka bërë Lidhja Demokratike e Kosovës, me të cilin unë sot vazhdoj të jem krenar. Është puna më e mirë që Kuvendi i Kosovës e ka bërë në atë kohë, i udhëhequr nga LDK-ja, pjesa opozitare, e ka marrë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Në atë kohë në opozitë kanë qenë edhe “Vetëvendosja” dhe AAK-ja, mirëpo AAK-ja ka qenë përkrahëse e vazhdimit të vendeve të rezervuara, ndërsa Lëvizja “Vetëvendosje” si rezultat i sjelljeve të veta në një kohë të caktuar nuk ka pasur komunikim me bashkësinë ndërkombëtare. Pra, i gjithë presioni ka qenë mbi Lidhjen Demokratike të Kosovës, por ne nuk kemi pranuar dhe nuk pranojmë asnjëherë që të destabilizohet përfaqësimi i brendshëm politik dhe ta rrezikojmë stabilitetin dhe përfaqësimin në këtë Kuvend.

Pra, mendoj se është vendimi më i mirë që është marrë dhe mendoj se duhet të jemi krenarë për punën që e kemi bërë dhe të ecim tutje e të shohim se si mund të bëhet Ushtria e Kosovës.

Pra, edhe një herë si konkluzion, zoti kryeministër, sjellja obstruktive në Kuvend, fyerjet dhe gjuha jo e dinjitetshme për një kryeministër nuk është e mirë të përdoret këtu dhe ju këshilloj, meqenëse nuk jeni këtu, me siguri na shihni në televizor, që mos e përsëritni më, sepse ne jemi deputetë që kemi forcën tonë relative prej 27 deputetëve në Kuvendin e Kosovës dhe mendoj se duhet që projektet në interes të Kosovës t’i çojmë bashkë përpara dhe betejat tona politike t’i bëjmë mbi rrafshin e një konstruktiviteti politik, e jo të një sjelljeje agresive të paarsyeshme dhe të pakulturuar. Faleminderit!

**KRYESUESJA:** Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi, si përfaqësuese e komunitetit joshumicë.

**EMILIJIA REDŽEPI:** Zahvaljujem se predsedavajuća!

Molim poslanike iz redova LDK-a da danas ne polemishu u vezi rezervisanih mesta. Ako polemishete molim vas ograničite se između predstavnika Liste srpske, ili Srpske zajednice i ostalih poslanika unutar Parlamenta.

Mi ovde danas smo prisutni poslanici koji smo bili i u prošlom i u prethodnom sazivu i svih manjinskih zajednica, predstavnici Bošnjaka, Turaka, Aškalija, Egipćana, Goranaca.

Pa vas molim da u buduću kada govorite o rezervisanim mestima u Parlamentu u prošlom sazivu, kada smo razgovarali sa svim političkim liderima Albanskih partija naišli smo razumevanje samo na predstavnike AAK, i na predstavnike PDK. Kod vas nismo naišli na razumevanje, ali niste i negodovali, mi smo razgovarali sa gospodinom Ismetom Beqirijem, koji je u to vreme bio šef vašeg kluba, i razgovarali smo sa gospodinom Albinom Kurtijem, koji je i tad bio neutralan.

Ja vam ponavljam sada i tvrdim tada nije bila Lista srpska, tada su bili predstavnici Srpske zajednice, koji su bili voljni da glasaju za našu vojsku. I to mogu da vam argumentujem zato što smo podnosili zahteve napismeno i arhivirali.

Naša inicijativa je bila samo da u još jednom mandatu budu rezervisana mesta, a kada govorite o predstavnicima Srba, i ono što ste iznosili statističke podatke od strane Centralne izborne Komisije, neka oni brane svoj stav, a mi predstavnici Bošnjaka, Turaka, i svih koji smo ovde jako dobro znamo da sve procese kosovskog društva onda kada i neko od vas nije i glasao, kada se tiče nacionalnog interesa, od nezavisnosti pa sve ostalo, mi smo tu. I ne želimo da nas degradirate u ovom Parlamentu i nećemo to dozvoliti.

KRYESUESJA: Hvala Emilija! Kundër-replikë, një minutë e ke Arben!

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Edhe më shpejt se një minutë e kryej.

Emilija pasi po ke qejf t'i marrësh përsipër gjërat që nuk të takojnë, edhe ju e keni përkrahur shantazhin që është bërë për t'i futur vendet e rezervuara edhe disa mandate. Po ta them haptas dhe mbaje mirë kështu në mend, e para.

E dyta, në zgjedhjet e vitit 2013 në zgjedhjet lokale ka qenë pjesëmarrës Lista serbe dhe i ka fituar të gjitha komunat si rezultat i këtyre numrave që po i them unë.

Dhe, e treta, që është po ashtu e rëndësime në këtë debat, mendoj se është me rëndësi që ne të përfaqësohemi në bazë të forcës proporcionale që përfaqësojmë popullsi etnike. Meqë ju e përfaqësoni një popullsi etnike, atëherë të shkojmë në një momentum të përfaqësimit të barabartë dhe jo me vende të rezervuara, e me këto metoda të dyfishta, të cilat janë të paarsyeshme dhe të palogjikshme.

Ka qenë një fazë në të cilën është dashtë të ju marrim me të mirë edhe të ju avancojmë, sepse jeni ndier të kërcënuar edhe jeni paraqitur si të tillë, por sot jetojmë në një shtet të lirë dhe demokratik...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu, dy minuta!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryesuese!

Shkurt! Ajo krejt çka e tha zoti Gashi gjatë fjalimit të tij ishte një arsytim. Mbi 70% e fjalimit të tij ishte arsytim pse kanë qenë kundër vendeve të rezervuara, që do të thotë nuk e kanë përkrahur votën për ushtrinë atëherë.

Ky ishte në rumbullakim i gjithë asaj që e filloi kryeministri Haradinaj, e vazhdoi zëvendëskryeministri Hoxhaj dhe Arben Gashi vetëm se u mundua me argumentet e tij, por që nuk kanë qëndruar as atëherë as sot, sepse dispozitë kalimtare ka qenë kërkesa e komuniteteve që të jenë pesë vende të rezervuara dhe atë nuk kanë kërkuar pastaj në fund 10 vende por 5 vende të rezervuara për një mandat në dispozitë kalimtare, nëpërmjet së cilës do të bëhej Ushtria e Kosovës dhe ne i kaluam edhe dy mandate tjera dhe ushtrinë nuk po mund ta bëjmë për shkak të asaj që ju keni konsideruar që është e drejtë, por jua thashë edhe më herët, dhe po them - Ushtrinë e Kosovës nuk e keni votuar vetëm pse ka qenë premtim i kryeministrit të atëhershëm Hashim Thaçi dhe vetëm për shkak të asaj e keni refuzuar. Aleanca ka pasur qëndrim konstruktiv, qëndrimi juaj dhe i “Vetëvendosjes” dihet çfarë ka qenë, që i bie destruktiv. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Po ke të drejtë kundër-replikë, një minutë e ke!

ARBEN GASHI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Zoti Haxhiu,

Nuk di çka the, diçka të veçantë nuk the, megjithatë po të përgjigjem.

Mendoj se është veprimi më patriotik që është marrë që nga dita e shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Jam krenar që e kemi marrë këtë vendim si LDK dhe i kemi dhënë mundësi Kosovës që të mos bëhet destabilizimi politik brenda Kuvendit dhe mendoj se Ushtria e Kosovës do të formohet dhe do ta formojmë bashkërisht në një moment të duhur dhe këto veprime, digresione që ju i bëni dhe këto sjellje obstruktive, hiç nuk na lënë shenjë, sepse jemi të bindur që e kemi bërë veprimin më të mirë të mundshëm në interes të vendit. Faleminderit!

KRYESUESJA : Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Nezir Çoçaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, e nderuar nënkryetare e Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dashur të kyçem në debatin që ishte për këto, ne jemi shumë të vetëdijshëm edhe për atë çka është punuar në historikun e Kosovës prej shumë viteve përpara, para 20 viteve - '97, '98, '99, edhe për FARK-un, edhe për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, po pastaj edhe për qeveritë në vazhdimësi i dimë se cila kush çka ka punuar, po ashtu edhe për legjislaturat.

Ne të gjithë e dimë, nuk po dua ta përsëris, e mbështes në fakt fjalën që e tha deputeti Bekim Haxhiu për atë se çka është bërë.

Ne e dimë edhe për memorandumun e bashkëpunimit kush ka qenë kundër ndërmjet Ministrisë së FSK-së të asaj kohe dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Dihen arsyet edhe pse i kanë bërë këto. Por, si do që të jetë, ne si legjislaturë, si Kuvend asnjëherë nuk po përipiqemi të flasim për pikën për çfarë është thirrur seanca, apo për pikat e seancës që po kalojnë në Kryesinë e Kuvendit, por më shumë po e përdorim seancën, e sidomos transmetimin në televizor si propagandë politike ndoshta edhe për shkak se kanë filluar edhe zgjedhjet nëpër parti politike dhe secili grup po dëshiron ta ketë atë idenë që ne jemi më të fortë dhe e mbështetim bërthamën e partisë përkatëse.

Të nderuar kolegë deputetë,

Po dua të ndalem, pasi Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit raporton në komisionin ku unë jam pjesë, dua të flas për këtë pikë të rendit të ditës dhe dua të flas pikërisht për Ministrinë e Kulturës, përkatësisht për angazhimin në punë të aktiviteteve që i ka bërë kjo ministri.

Ministria e Kulturës e ka përkrahur krijimtarinë kulturore në vend, duke përfshirë aktivitetet e institucioneve publike e kulturore, si të Teatrit Kombëtar, Filarmonisë, Operës, Baletit, Ansambllit Shota, Galerisë Kombëtare të Kosovës, Qendrës Kinematografike, Kosova Filmit dhe Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, si dhe aktivitetit kulturore të pavarur, përfshirë ato të asocioneve dhe organizatave temporale, kulturore, artistëve e të tjerë.

Gjatë kësaj periudhe është bërë edhe shpërndarja e librave dhe revistave letrare në më se 36 biblioteka komunale apo ndërkomunale.

Po ashtu, në fushën e ndërkombëtarizimit të kulturës, ministria përkatëse ka qenë jashtëzakonisht aktive, duke bërë apo nënshkruar marrëveshje me Republikën e Turqisë, Shqipërisë, Austrisë e të tjerë.

Po ashtu, është finalizuar marrëveshja për nënshkrimin ndërmjet Ministrisë dhe Komisionit Evropian për “Evropën Kreative”, ku Kosova do ta fitojë një fond për mbështetjen e aktiviteteve kulturore. Po ashtu, e kemi themeluar edhe “Deskun Evropian Kreativ” të Kosovës.

Edhe pse disa kolegë i theksuan, unë po dua t'i përmend edhe në aspektin e trashëgimisë kulturore aktivitetet që i ka zhvilluar Ministria e Kulturës, përkatësisht ministri i saj, të cilin e falënderoj për një punë jashtëzakonisht të madhe që e ka bërë deri më sot.

Unë shpresoj që edhe në të ardhmen do të vazhdojë në këtë mënyrë për të pasur sukses dhe që qytetarët të jenë sa më afër atyre të arriturave që janë bërë.

Sa i përket trashëgimisë kulturore, unë veç dua t'i përmend në mënyrë telegrafike projektet e konservimit dhe restaurimit, apo të rehabilitimit të aseteve të trashëgimisë kulturore.

Njëra nga të arritjet kryesore të fushës të trashëgimisë kulturore është themelimi i Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore, si një ndër organizmat më të rëndësishëm për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore në vend.

Kjo trup tashmë është funksionalizuar në kuadër të Ministrisë së Kulturës dhe e ka filluar punën në terren.

Funksionalizimi i Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore është një hap i rëndësishëm dhe shumë shpresëdhënës për implementimin në tërësi të Ligjit për trashëgimi kulturore, e të tjerë.

Gjatë kësaj periudhe 100-ditore, edhe pas tash jemi pothuajse afër 200-ditëshit, është miratuar lista e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme të aseteve të trashëgimisë kulturore të viteve, 2017-2018.

Në njërin nga objektivat e rëndësishme të MKRS-së për trashëgimi kulturore është përfshirja e trashëgimisë kulturore në plane zhvillimore, është punuar në hartimin e planit të menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit, planit të menaxhimit për Parkun Arkeologjik Ulpiana dhe për Kalanë e Prizrenit.

Po ashtu, në lidhje me politikat e promovimit të trashëgimisë kulturore është bërë promovimin i trashëgimisë kulturore nëpërmjet botimeve, hulumtimeve, si dhe konferencave dhe aktivitete të tjera, të cilat janë pjesë e kalendarit, si: Dita Botërore e Trashëgimisë Kulturore, Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Lokaliteteve, Ditët e Trashëgimisë Kulturore Evropiane dhe të tjera.

Sa i përket politikës së edukimit, aftësimin dhe pjesëmarrjes aktive në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, Ministria, bazuar në marrëveshjen e nënshkruar me Këshillin Britanik, ka afruar pesë bursa për studimin në fushën e arkeologjisë, tre prej tyre janë përfitues dhe, bazuar në marrëveshjen e Shkollës Normale Superiore me Ambasadën e Francës të Universitetit të Prishtinës, janë mbështetur dy studentë.

Gjatë kësaj periudhe është hartuar edhe projekti kryesor për Muzeun e Historisë së Natyrës dhe Programit të Trashëgimisë Shpirtërore.

Sa i përket rinisë, Ministria përkatëse e ka afruar një mbështetje dhe janë mbështetur një mori projektesh për ngritjen e kapaciteteve të organizatave rinore, për mbështetjen e mekanizmave rinorë dhe për të zhvilluar programe dhe shërbime kualitative për të rinj dhe ngritjen e shkathtësive jetësore për të rinjtë.

Po ashtu, janë përkrahur projektet e organizatave rinore që kanë pasur në fokus ngritjen e kapaciteteve për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm.

Janë mbështetur projekte për zhvillimin e programeve në trajnime dhe ndërmarrësi, grante dhe pajisje për Start Up, si dhe trajnime profesionale për rikualifikim, si dhe sigurim të lidershipit, pra praktikë në punë. Rreth 200 të rinj janë certifikuar për trajnime profesionale.

Gjatë kësaj periudhe, Ministria ka inauguruar edhe 7 zyra rajonale në bashkëpunim me të rinjtë në Prishtinë.

Kjo zyre është themeluar nga gjashtë shtete të Ballkanit Perëndimor.

Lidhur me planifikimet strategjike, Ministria e ka hartuar strategjinë për rini 2018-2022, e cila do të pritët së shpejti të miratohet.

Në bashkëpunim me donatorët, në bashkëpunim me OSBE-në, Ministria e ka realizuar programin tremujor për intership të praktikantëve në institucionet publike të Kosovës, ku rreth 20 të rinj ka përfituar me “Helvetas Swiss Intercooperation” nga Zvicra për projektin për aftësim dhe punësim rural. Është realizuar programi në 12 komuna, në pjesën lindore të Kosovës, komuna lindore rurale pra.

Është realizuar projekti “Trajnimi në punë”, e përfitues janë 120 të rinj, që përfshijnë regjionin e Mitrovicës dhe të Prishtinës.

Është realizuar edhe projekti “Sallonet”, e përfitues janë 500 të rinj në 10 komuna të Republikës së Kosovës, implementues janë qendrat rinore, Ministria, Friedrich Ebert Foundation dhe OJQ2W2.

Sa i përket sportit, është realizuar përkrahja financiare për Komitetin Olimpik të Kosovës dhe federatat sportive sipas memorandumeve përkatëse të bashkëpunimit, edhe pse akoma mbetet sfiduese çështja e borxheve të trashëguara dhe federatave.

Janë mbështetur financiarisht edhe reprezentacionet në garat kualifikuese për kampionate evropiane dhe botërore në futboll, hendboll, basketboll e tjerë e tjerë.

Ka shumë aktivitete, të cilat edhe unë nuk po arrij për shkak të kohës për t'i lexuar. Nuk dua të flas për stadione, për këto se i kanë thënë më herët edhe kolegët, po edhe nga Qeveria janë thënë.

Sa u përket të drejtave të autorit, në politikën e promovimit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta janë organizuar fushata vetëdijesuese dhe promovuese nëpërmjet aktiviteteve promovuese dhe edukuese të mbajtura nëpër shkolla të mesme dhe dërgimit të revistës së autorit tek institucionet e zbatimit të ligjit dhe organet tjera kompetente.

Gjatë muajit tetor, Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta ka mbajtur ligjërata në disa shkolla, me ç'rast nxënësit janë informuar lidhur me rëndësinë e të drejtës së autorit dhe arsyet e ekzistimit të saj.

Po ashtu, gjatë muajit nëntor është organizuar trajnimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve, në të cilin kanë marrë pjesë gjyqtarë nga Departamenti i Çështjeve Ekonomike të Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe gjyqtarë e prokurorë të tjerë.

Janë organizuar trajnime edhe për menaxhim kolektiv të të drejtave të autorit për stafin e shoqatave kolektive, stafin e Zyrës për të Drejtat e Autorit, e tjerë, e tjerë.

Është mbajtur trajnim për mbikëqyrjen e zbatimit të të drejtave të autorit, luftimin e piraterisë, e shumë çështje të tjera që nuk po mund t'i mbërrij.

Po ashtu, dua të theksoj që Zyra për të Drejtat e Autorit e ka vazhduar koordinimin e luftës kundër piraterisë, pra e kemi Inspektoratin e Tregut, që ka zhvilluar veprime të rregullta për observimin e zbatimin të Ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta në Prishtinë.

Sa i përket legjislacionit, së paku ne si Kuvend e dimë, edhe pse qytetarët në përgjithësi e përcjellin punën dhe kanë mundësi ta përcjellin punën edhe nëpërmjet ueb-faqes, edhe nëpërmjet mundësive tjera individuale të ministrave dhe të personave që punojnë me ministrin.

Por, ajo që dua të them është se pos Ministrisë së Kulturës, ne e kemi edhe një ministri që për mendimin tim është jashtëzakonisht e rëndësishme, themelimi i kësaj ministrie, dhe shpresoj shumë që edhe ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë po e bën një hap shumë të rëndësishëm, dhe unë shpresoj shumë që edhe Qeveria, siç është shumë praktike në shumë qeveri të tjera, kësaj ministrie duhet t'i jepet një rëndësi jashtëzakonisht e veçantë.



Unë e di që kjo ministri vendos për shumë çështje brenda Qeverisë.

Unë shpresoj shumë që edhe ministri përkatës i kësaj ministrie, meqenëse e ka një përvojë edhe në themelimin e ministrive të tjera, e kemi pasur rastin gjatë mandatit të kaluar, po ashtu do t'ia dalë që ajo ministri, konform asaj që parashihet me ligje dhe me detyrat e saj, do ta arrijë një sukses jashtëzakonisht të madh. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Arbërie Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Është e vërtetë se ky debat i ftuar për 100-ditëshin e punës së Qeverisë po realizohet me shumë vonesë dhe kjo fatkeqësisht sepse po mungon vullneti që të diskutohet për problemet e vërteta të qytetarëve, për brengat e tyre, për sistemin e arsimit, të shëndetësisë, për drejtësinë e kapur, për papunësinë dhe shumë tema të tjera në interes për qytetarët.

E kjo po ndodh për dy arsye, për shkak të paaftësisë së kësaj Qeverie për të gjetur zgjedhje të duhura, apo edhe dëshirës për t'i vazhduar keqpërdorimet dhe keqmenaxhimi nga grupet e ngushta të interesit, në fakt vetëm duke i ndërruar rolet dhe përfituesit.

Dhe, e dyta, për shkak të mungesës së vullnetit të atyre që e sollën në këtë gjendje, pra për dy arsye, për të refuzuar marrjen e përgjegjësisë dhe për të shikuar mundësinë për rimarrje të pushtetit për të njëjtat motive.

Unë jam e bindur se sistemi i arsimit ka qenë sektori më i rëndësishëm për ta shtrirë ndikimin nga këta individë që po na rrezikojnë të ardhmen, për t'i arritur qëllimet e tyre të ulëta dhe fatkeqësisht ia kanë dalë.

Ka kohë që politizimi i skajshëm i arsimit dhe ndikimi i tij, qoftë nga grupet e ngushta të interesit, qoftë nga vendimet e marra në mënyrë të ngutshme e arbitrare, pa hulumtime dhe analizë të mirëfilltë, ka bërë që cilësia në arsim të bjerë dukshëm, që rezultatet e synuara në dokumentet strategjike të mos arrihen as për së afërmi dhe që e ardhmja e fëmijëve tanë dhe e vendit në përgjithësi pikërisht për shkak të arsimit jocalësor të mos jetë ajo që ne e dëshirojmë. E këtë praktikë po e vazhdon edhe kjo qeverisje.

Me një sistem të mirëfilltë të arsimit, me një cilësi të lartë dhe me një kultivim të mendimit kritik, edhe gjendja e përgjithshme e shoqërisë do të ishte më e mirë.

Në një rën anë janë hartuar dhe janë bërë përpjekje për të zbatuar politika të shumta arsimore, të cilat janë shumë mirë të shkruara në letër, por nuk janë të përshtatshme me sistemin arsimor që kemi, andaj edhe nuk kanë dhënë rezultatet e pritura. Në anën tjetër, procesi i politikave arsimore ka ngecur te cikli i implementimit për shumë arsye, për shkak të partizimit të skajshëm të arsimit, të emërimeve të personave joadekuatë, jokompetentë e jokredibilë në pozitat kyçe vendimmarrëse, apo në institucionet e arsimit të lartë dhe për shkak të kërkesave të shumta që u janë dhënë mësimit dhe stafit tjetër në shkolla, pa krijuar kushtet për punë dhe as parakushtet për implementim të suksesshëm të reformave dhe të politikave të shumta arsimore.

Në raportin 100-ditor të punës së Qeverisë së Kosovës, ndër vendimet e marra si rezultate që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e qytetarëve të Kosovës, nga Zyra e Kryeministrit është thënë: “Gjatë këtyre 100 ditëve Qeveria ka mbajtur 20 mbledhje dhe janë marrë 240 vendime”. Për një numër të konsiderueshëm të vendimeve tashmë është dëshmuar se janë të kundërligjshme, përveç që shpeshherë janë edhe të dëmshme. Ndoshta është në interes për qytetarët të dinë se si rezultatet e punës janë numëruar edhe të dhëna të tilla, si citoj: “Kryeministri i Republikës së Kosovës, më 27 shtator 2017 ka vizituar Republikën e Shqipërisë dhe gjatë vizitës ka zhvilluar takime me drejtuesit e shtetit shqiptar”. Ose: “Kryeministri Haradinaj e ka vizituar Brukselin më 17 nëntor 2017”. A janë vërtet këto rezultate që kjo qeveri i ka synuar? A janë vizitat, pa ndonjë të arritur konkrete, sukses, me të cilin kjo Qeveri duhet të krenohet? Nëse po, atëherë është dashur të përmenden të gjitha vizitat e shumta edhe të ministrave e të zëvendësministrave, kur kemi parasysh numrin e madh të tyre, ndoshta edhe do të dukej se ka rezultate, sepse në këtë drejtim, pra në emërim të këshilltarëve, të ministrave dhe zëvendësministrave duket se kryeministri Haradinaj ka marrë model kryetarit legjendar të Partisë së Fortë, i cili e kishte emëruar veten kryetar dhe të gjithë të tjerët nënkryetarë.

Në raportin 100-ditor të punës në fushën e arsimit përmenden, citoj: “Me qëllim të rritjes së cilësisë së arsimit të lartë është shkarkuar Bordi i Agjencisë së Akreditimit dhe cilësisë në arsim, si dhe është propozuar Bordi i ri me përbërje të re”. E konsideroj të rëndësishme të përmend që këtë çështje ne e kemi ngritur që më 4 tetor të vitit të kaluar, për ta ripërsëritur së paku edhe 3 herë të tjera dhe sikur të kishte marrë vëmendjen e duhur të të gjithë juve, e në radhë të parë të vetë Qeverisë Haradinaj dhe të ishte trajtuar ashtu si duhej, ndoshta edhe do të kishim arritur të parandalonim përjashtimin e Agjencisë Kosovare të Akreditimit nga EQAR-i dhe do të evitonim kështu sfidat me të cilat do të ballafaqohen studentët dhe të rinjtë tanë. Për më shumë, derisa jemi te kjo pikë, dua që tani të kem vëmendjen tuaj për një çështje tjetër, po aq të rëndësishme, që ne e kemi përmendur, rrezikun për përjashtim të Agjencisë Kosovare të Akreditimit edhe nga Rrjeti i agjencive për sigurimin e cilësisë, i cili është edhe themelues i Regjistratit. Kur e adresuam për herë të parë këtë çështje, na akuzuat se po flasim kot dhe se këtë po e kemi dëshirë. Ju lus sot edhe një herë nga kjo foltore që të keni kujdes dhe të ndërmerri sa më parë të gjitha veprimet e nevojshme, në mënyrë që të parandalohet një vendim i tillë, i cili po ashtu do të shkaktonte shumë pasoja për të rinjtë tanë dhe për arsimin e lartë në përgjithësi.

Në raport më tutje, tek të dhënat e detajuara të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë renditen disa rezultate që janë shumë sipërfaqësore dhe, në fakt, paraqesin vetëm rutinën ditore të punës. Për shembull, aty shënohet si rezultat se ka vazhduar pajisja e klasave për parafillorë me pajisje moderne në komunën e Gjakovës. Përderisa në të vërtetë gjendja e infrastrukturës në shkollat e Gjakovës vazhdon të mbetet e pakënaqshme, mungojnë edhe gjërat elementare, do të përmend këtu vetëm Shkollën e Mesme të Lartë Ekonomike, ku ka vite që s'ka pasur asnjë investime, madje as në pajisjet më bazike me kompjuterë e projektorë, të vetmit që i përdorin një numër shumë i madh i nxënësve aty janë një donacion nga "Rotary Club" në vitin 2012, pra pajisjet që janë nxjerrë nga përdorimi nga vendet e BE-së. Dhe, gjendja si në këtë shkollë është në shumicën e shkollave e tjera.

Po ashtu, përmendet në këtë raport se janë organizuar trajnime për zbatimin e kornizës kurrikulare në gjashtë komuna dhe trajnime gjithëpërfshirëse për shtatë grupe. Të dhënat nga terreni në fakt tregojnë se mësimdhënësit po ballafaqohen me vështirësi të shumta, duke filluar nga mungesa e teksteve adekuate, përkrahjes së domosdoshme për implementimin e suksesshëm të kurrikulës, ngarkesën për nxënësit, problemet serioze në lidhje me vlerësimin dhe një varg sfidash të tjera. Po ashtu, në raport përmendet si rezultat dhe sukses i ministrisë edhe dhënia e licencave të karrierës për 1 mijë e 100 mësimdhënës dhe dua këtu të përmend, e në radhë të parë e shpreh keqardhjen time për ministrin, për të cilin mendoj se është vënë në lajthitje nga mungesa e përvojës së tij për t'i paraqitur këto të dhëna si suksese. Dua të sjell në vëmendje të qytetarëve që në mbledhjen e datës 29.8.2008 ishte marrë vendim që nga 1 shtatori i vitit 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët dhe stafi tjetër në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë një rritje të pagave në bazë të kriterëve të licencimit.

Ky vendim i nënshkruar nga zoti Hashim Thaçi, atë kohë kryeministër i Kosovës, nuk u zbatua asnjëherë. Ashtu sikurse tashmë në shkollat dhe universitet e Republikës së Kosovës ka greva dhe rrjedhimisht humbjet e orëve mësimore e ligjëratave. Duhet sjellë në vëmendje se Ligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e '90-ta ende ka mbetur në qeveri dhe nuk po shkon tutje, ngase paraqiten pengesa të paarsyeshme për të. Po ju rikujtoj po ashtu, se edhe Kontrata kolektive e nënshkruar më 18 prill 2017 ka pengesa në implementimin e saj, përkundër se është nënshkruar. Pra, edhe kjo qeveri po vazhdon me praktikën e papërgjegjësive së plotë, me marrjen përsipër të obligimeve e bërjen e premtimeve për mësimdhënësit në kohë fushate dhe me neglizhim të plotë të tyre gjatë kohës së qeverisjes.

Askush s'po merret me cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, e pasojat e betejës në mes të kërkesave të drejta të mësimdhënësve dhe premtimeve të pambajtura të Qeverisë po i bartin nxënësit dhe të gjithë ne, sepse nuk mund të presim as për së afërmi rezultate më të mira me këtë mendësi, e me këtë mënyrë të qeverisjes. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Kërkoj falje për një ndryshim të vogël, fjalën e ka Time Kadrijaj.

Daut Haradinaj, a e keni kërkuar fjalën?

DAUT HARADINAJ: Veç pata dëshirë t'ia uroj Donika Kadës rikthimin në AAK.

KRYESUESJA: Faleminderit! Time, urdhëro!

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesuese!

Sot po debatojmë 100-ditëshin e Qeverisë, edhe pse ka kaluar shumë kohë dhe Qeveria Haradinaj me kohë, tamam me 100 ditësh e ka sjellë raportin e 100 ditëve të punës së Qeverisë Haradinaj. Nëse jemi vonuar në debatin e këtij 100-ditëshit, jemi vonuar sepse Kuvendi e ka zvarritur këtë procedurë të trajtimit dhe në fakt ne sot nga ajo që dëgjuam nga deputetët, më së paku u debatua për punën e Qeverisë, për raportin e 100 ditëve të Qeverisë, por të gjithë bëmë nga pak politikë dhe kemi dal në tema që vërtet sot nuk është debati dhe nuk është tema e debatit të sotëm.

Logjikë e kësaj qeverie është përballja me problemet, marrja e vendimeve dhe zbatimi i tyre. Dinamika qeverisëse është bazuar në qeverisje të mirë, sundim të ligjit, zhvillim ekonomik dhe në përmirësimin e gjendjes sociale. Uniteti shoqëror është rritur përmes komunikimit të hapur, ky unitet përfshin komunitetet, grupet e tjera të interesit, komunitetin serb dhe komunitetet e tjera, me të cilat komunikojmë drejtpërdrejt. Për 100 ditë janë takuar shumë grupe të interesit dhe të gjitha ato vendime që janë marrë kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e vendimmarrjes. Është nënshkruar marrëveshja për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re” dhe kjo është një e arritur, edhe pse opozita s’po do ta pranojë. Për 72 orë është arritur marrëveshja me banorët e Hades dhe Shipitullës që të mundësohet prodhimi i qëndrueshëm i energjisë, duke i ruajtur rezervat shtetërore dhe nëse dikush e di që nga mandati i kaluar, kush ka qenë në Komisionin për Bujqësi, me çështjen e Hades dhe të Shipitullës janë mbajtur shumë takime të komisionit, me ditë të tëra, me orë të tëra dhe nuk është bërë një zgjedhje e duhur. Ndërsa, kryeministri Haradinaj për 72 orë e ka zgjidhur këtë problem.

Është ndërtuar mekanizmi ndërinstytucional për fuqizimin e sundimit të ligjit, ku të gjithë aktorët vendorë dhe ndërkombëtarë bashkërendojnë veprimet mekanizmat e sigurisë dhe të rendit dhe ligjit. Është hapur rruga për anëtarësimin në UNESCO, me miratimin e Ligjit për liritë fetare, i cili rregullon veprimtarinë e bashkësive fetare në Kosovë dhe siguron mbështetjen e plotë të aleatëve strategjikë të Kosovës. Në 100 ditë janë nxjerrë 187 vendime të Qeverisë që kanë prekur drejtpërdrejt qytetarin. Në Kuvend janë proceduar 44 projektligje, përfshirë dhe ato që shumë vjet janë zvarritur në mungesë të vullnetit politik për të marrë vendim. Nëse sot kemi një numër

të vogël të projektligjeve, të cilat janë amendamentuar, nuk është problemi i Qeverisë, por është problemi i Kuvendit dhe problemi që po zvarriten qëllimisht këto projektligje.

Është bërë Ligji për kryeqytetin, duke e përmbushur obligimin kushtetues dhe duke e barazuar Prishtinën me kryeqendrat evropiane. Janë marrë hapa konkretë në miratimin e katër ligjeve themelore në fushën e sundimit të ligjit, janë zbatuar legjislacione që lidhet me luftën kundër korrupsionit dhe pjesë të reformave të agjendës evropiane. Janë të pakta këto veprime që po i cek, sepse e kemi edhe Ligjin për veteranët e luftës, ku për herë të parë janë në vijë buxhetore dhe më nuk do të ketë problem, po ashtu e kemi edhe për personat e dhunuara që për herë të parë po ndahet buxhet që kjo kategori të kompensohet materialisht. Dëgjuam shumë gjëra këtu dhe pamë që dikush është bërë edhe mjek dhe po merret me përcaktimin e diagnozave, sidomos nga “Vetëvendosja”, unë kisha dashur të them nëse janë bërë doktorë apo psikologë, le të merren me diagnoza për grupin e vet parlamentar dhe të mos merren me diagnoza për dikë tjetër.

Ndërsa, kishim edhe deputetë këtu, të cilët po flasin atë se çka po thonë qytetarët për kryeministrin, por ai nuk e dinë se çka po thonë qytetarët për deputetin në fjalë, kontributi i vetëm që e ka dhënë për shtetin e Kosovës është se s’ka bërë kurrigjë, s’ka qenë në gjendje as “macen prej përsheshi ta tutë” dhe sot po e dezinformon opinionin me deklarata të ndryshme, të cilat vërtet po më vjen marre që t’i them e t’i dëgjoj, edhe pse nuk e ka asnjë fije kontribut për shtetin e Kosovës.

Qeveria po punon, po merret me të gjitha temat, po merret me të gjithë sektorët, qoftë me arsim, qoftë me shëndetësi, do të vazhdojë të punojë edhe në këto 100 ditë, do të vazhdojë të punojë edhe në gjashtëmujor dhe një vit me dinamikë të shtuar që asnjëherë asnjë qeveri s’e ka pasur. Kosova ka probleme, duhet të përballemi me probleme dhe kjo qeveri vërtet po përballlet me probleme. Andaj, ne sot po diskutojmë, po debatojmë, po bëjmë opozitarizëm të rrejshëm, po qeveria po ecën me punët e mira që po bëhen për Kosovën. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka deputeti Milaim Zeka, pas tij Haxhi Avdyli.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesuese!

Së pari, kërkoj falje se edhe herën e parë kur kam folur kështu, Bilalli ka qenë jashtë e unë kam folur në vend të tij tinëzisht. Kështu më shumë kanë qenë qëndrime të mia personale, gjysma e të “Nismës”, gjysma veç të miat.

Në radhë të parë, edhe unë i uroj Donikës kalimin në AAK-së dhe Grupit të ri parlamentar të “Vetëvendosjes” i uroj sukses dhe bashkëpunim me pozitë dhe me opozitë. Dua të filloj pak me lojën e disa deputetëve për bisedat në ambasadat e huaja. Disa deputetë të rinj këtu që janë e të padjallëzuar nuk e kanë mbërritur atë kohën tonë të viteve ‘80 e këtej kur janë bërë diferencimet e mëdha, kur donte dikush të paraqitet i mençur, thoshte “ja sam bio juće u Beograd” e shqiptarët

e thoshin “ky qenka patriot i madh se koka kanë në Beograd, ka fol atje me Milosheviqin e me këta”, ose thoshin “filani është burrë i mirë, e ka revolen me leje”, pra të bënin të kuptosh që ruaju nga ai, se punon në UDB. Tash, ka kaluar Beogradi, i ka vdekur nëna ëndrrave të Beogradit, tash ia kanë nisur të thonë “jo folëm në ambasadë, jo s’folëm në ambasadë, jo na thanë amerikanët, jo anglezët”, jo këta.

Ata të shkretit s’kanë qare pa na thënë diçka, sepse kur shkojmë ne atje, duke e sharë shoqi-shoqin, me fol kundër njëri-tjetrit, ata s’mund të dëgjojnë dy orë, duhet diçka të na thonë. E vërteta, i dashur Arben, rreth ushtrisë së Kosovës është kështu, sipas meje gjithmonë, që mund ta kem krejt gabim. Meritë absolute për krijimin e Gjykatës Speciale çmimin Nobel do ta marrë Hashim Thaçi, pa Hashim Thaçin kurrë Gjykata Speciale s’ishte bërë, këta hiq s’e kishin votuar, po ai i ka detyruar me zor, e këta e votuan. Meritë kryesore për mosformimin e ushtrisë Çmimin Nobel e merr Isa Mustafa, sepse më 28 prill të vitit 2014, unë nuk po flas çka kanë folur në bodrume, në ambasada, po çka ka thënë në Radion Evropa e Lirë.

Isa Mustafa në atë intervistë thotë: “Unë jam për formimin e ushtrisë, por unë nuk jam për të bërë kompromise të dhimbshme që duke u ofruar deputetëve serbë ulëse të bëhet një gjë e atillë” dhe këtë u mundua ta artikulojë kryeministri, e ai po del prej taktit nganjëherë, po bëhet nervoz, megjithatë ajo që më ka fascinuar sot te kryeministri i Kosovës është një diçka. Unë i çmoj anët njerëzore edhe të kundërshtarëve të mi më të mëdhenj politikë. Foli për një kundërshtar të tij pa kompromis, gjithmonë e ka pasur kundërshtar Azem Sylën, por tha që gjykatat e Kosovës kanë vepruar padrejtësisht ndaj Azem Sylës dhe këtë rregull duhet ta ndjekin sidomos deputetët e “Vetëvendosjes”, që kur i prek prokurori dhe gjykatësi, këta çohen hop në hava e thotë: “E keni kap shtetin”. Si t’i lirojë këta prej burgut thonë: “E keni çkap shtetin”. Pse asnjë deputet i “Vetëvendosjes”, ose edhe nga ana jonë, edhe nga LDK-ja, nuk e ngriti problemin si ka mundësi që t’i mbyllën hetimet Aleksandër Lumezit, kryeprokurorit të Kosovës, për dy javë, ndërsa deputetëve ose fytyrave publike, ose kujtdo qoftë u vonohen hetimet me vite të tëra. Ju garantoj, me aq sa unë e njoh Qeverinë, po flas për kryeministrin Haradinaj, po të kishte ai interferim në gjykata, në prokurori dhe polici të hetuesisë, bash 80% i kishte ndërruar, por ngadalë se nuk është lehtë të bëhet qeveria, as për juve s’ka qenë lehtë kur e keni bërë, LDK-ja, as tash që ne e kemi bërë. Ju i dëgjuat, për shembull, disa deputetë të PDK-së sot folën veç për ministrat e PDK-së, qeveria aktuale është e ndarë si puna e picës, preje këndeje, preje andej.

A dëgjuat, një deputete tha dhe u krenua me Ministrinë e Inovacionit, po të isha pyetur unë, kurrë Ministri të Inovacionit s’kisha bërë. Ministrinë qeveri janë bërë, krejt qeveri, çdo ministri këtu qeveri është, hiq mos u mërzitni. E, domethënë, po të më kishin pyetur mua, unë kisha bërë ndonjë ministri të lezetit, s’kisha bërë hiq Ministri të Inovacionit, absolutisht, se kemi ne edhe tema të tjera më të rënda që ende janë tabu për Kosovën, a e dimë krejt çka po ndodh në asfalt nëpër këto motelet me pushimet ditore 10 euro. Tani te Ligji i vetingut, te zoti Lajçi, është guxim qytetar i deputetit që e ka ngritur vazhdimisht, e kam ngritur edhe unë që ky popull nuk mund të

qetësohet pa u bërë vetingu. Ata njerëz që na kanë dënuar në vitet e '80-ta, ata që kanë qenë legeni kryesor i Milosheviqit, sot i ke në prokurori, sot i ke në gjykata, sot i ke bosë të mediave. Ne e lexuam dje një raport në Shqipëri që bosët kryesorë të mediave në Shqipëri janë njerëzit kryesorë të politikës, e njëjta gjë është edhe në Kosovë. Njerëzit kryesorë, legeni kryesor i Rusisë e i Serbisë në Kosovë janë bosët e televizioneve, bosët e portaleve që degradojnë e fyejnë këtë vend. Për shembull, portalet thonë: “Lista serbe po kërkon tre anëtarë të Bordit të ‘Trepçës’ për të votuar demarkacionin”, që nuk është fare e vërtetë, sepse atyre ligjërisht u takojnë tre anëtarë të Bordit.

Domethënë, thjesht për të dhënë dezinformata dhe, në fund për të kaluar nga vetingu, dëshiroj ta mbyll fjalën time me një diçka. Po, profesori nuk është këtu, e ta pyes Avdullah Hotin, por ndoshta dikush prej ministrave mund të përgjigjet. Pse, vëlla, ju nuk po e diskutoni, një pjesë e Lidhjes Demokratike, me fajin e kujt po duhet t’i paguhen 60 milionë “Bechtel Enkës”? A duhet të shkojë dikush në përgjegjësi për këtë punë? 6 mijë euro po të ishin, duhet të të lëkundet kapaku i kresë! Tjetër, dëshiroj të pyes që në seancën e ardhshme profesori pa qëllim të keq të ma japë një përgjigje. Si ka mundësi që zëvendësministrat në bazë të Rregullores së qeverive të kaluara, jo të qeverisë aktuale, si ka mundësi, ja pyeteni kolegun tim, ish-gazetar, qe ku është aty, zotin Muharrem Nitaj. Muharrem, dil në foltore, kallëzo kur ke qenë zëvendësministër, sa mijë euro i ke pasur në kartelën tënde? A i ke pasur 3 mijë euro?

Jo, jo, dil këtu, se dëgjoni, disa hipokritë këtu që po shesin moral fals, e që kanë harxhuar në emër të kartelave ka 6 mijë euro duke u blerë dhurata dashnoreve të veta. Po dëgjo, a e dini pse ia bëni ju mirë Ramush Haradinajt? Ju ia bëni fort mirë Ramushit, bile edhe në burg ta çoni, se po të isha unë kryeministër pa jua nxjerrë krejt fëlliqësirat mbi tavolinë s’e kisha lënë! Çka keni blerë dhurata kur keni qenë ministra? Qysh e keni licencuar në emër të MTI-së Laboratorin për konfeksion, e ka dhënë leje për derivate të naftës? Nuk po të them ty, e nderuar, ndoshta e ka bërë kolegja jote, po, po, njëra e kanë bërë, ose Mimoza, ose Hykmetja, unë për Hykmetën nuk po flas, dhe kush i ka licencuar ato? Krejt këto gjëra kryeministri duhet t’i qesë në shesh.

Ku keni parë, more ju të bëni Rregullore 3 mijë euro, 6 mijë euro. Monika Salin ka pasur 100% të bëhej kryeministre e Suedisë, për një fustan që e ka paguar 100 dollarë me kartelën zyrtare, e kanë detyruar të japë dorëheqje. Prandaj, rregullojini një herë punët tuaja, tani flasim për tema të mëdha. Edhe në gjë, bre, gjithçka kritikojeni Ramush Haradinaj, veç për demarkacion mos, se demarkacionin e ka bllokuar ekskluzivisht Lidhja Demokratike e Kosovës dhe PDK-ja, edhe për ata ka rënë Qeveria, për kurr gjë tjetër. A kemi bërë ne mirë që jemi shkuar me Partinë Demokratike në koalicion, hiq mirë s’kemi bërë, po s’kemi pas qare, sepse prej të gjitha të këqijave, i kemi zgjedhur këta më të mirët. Kaq, faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Haxhi Avdyli a është këtu? A, po! Zoti Nitaj e keni fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, Milaim, që ma dhe mundësinë të paktën në formë replike ta marr fjalën. Unë si zëvendësministër nuk kam pasur kartë prej 3 mijë eurosh, por realisht krejt zëvendësministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës e kanë kartën që mund t'i shpenzojnë 3 mijë euro në muaj dhe ky standard nuk është standard i Qeverisë Haradinaj, por është një standard që është gjetur nga qeveritë e mëparshme, aq më tepër nga Qeveria që është kryesuar nga zoti Mustafa.

Realisht që të akuzosh të tjerët për një standard, për një normë që e ke vendosur vetë dhe që e ke zbatuar gjatë gjithë kohës, kjo më së paku është hipokrizi. Unë e njoh standardin e dëshirës, e vullnetit të njerëzve të dalin në televizor dhe të flasin, këtë standard e kam takuar, a kam hasur edhe në partinë ku unë tashmë jam, prandaj i kam propozuar Kryesisë së Kuvendit të debatet parlamentare të caktohen në kohën kur nuk ka transmetim të drejtpërdrejtë televiziv, në mënyrë që ne të mos merremi me debate kotë, siç realisht ishte edhe debati i sotëm për 100-ditëshin e Qeverisë Haradinaj në kohën kur kjo Qeveri tashmë po i bën 200 ditë.

Unë e kuptoj mosdurimin e një pjese të opozitës ndaj kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe e kuptoj kursin, që deputetët e shumicës parlamentare domosdoshmërisht do të duhej që ta mbrojnë, siç tha kolegu Zeka, Qeverinë, ose ministrat e partive që përfaqësojnë, por nuk e kuptoj të drejton, ose nuk e kuptoj etjen që secili deputet ta shfrytëzojë të drejtën e tij që të flasë dhjetë minuta në foltore pa thënë asnjë gjë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bajrami, e keni fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit.

Fillimisht, për kartela të zëvendësministrave kjo është praktikë e të gjitha qeverive, kartela të bankës, kredit kartela kanë edhe ministrat, mirëpo janë të specifikuar shpenzimet që mund t'i bëjë secili ministër dhe zëvendësministër dhe ato kufizohen me pagesë të hotelit. Dhe, në kohën e Qeverisjes Mustafë ka pasur kontroll të plotë dhe unë i bëj thirrje kryeministrit Ramush Haradinaj që t'i bëjë publike të gjitha shpenzimet që ne i kemi bërë në qeverisjen e kaluar. Edhe me i bë publike edhe të zëvendësministrave dhe të ministrave të kësaj, kështu që qytetarët e Republikës së Kosovës të mund ta bëjnë krahasimin.

Tjetra është, zoti Zeka, që sa herë po e përmend çështjen e naftës, asnjëherë në mandatin tim nuk është akredituar, nuk është licencuar, asnjë laborator që merret me analiza të konfeksionit dhe bën analiza të naftës. E keni gabim. Ka pasur raste të raportuara në medie, kur nafta në pika doganore ka ardhur me certifikata nga laboratorë të huaj që janë të akredituara për konfeksion dhe kanë lëshuar certifikata të analizave të naftës. Duke parë këto keqpërdorime, unë me udhëzim administrativ kam larguar trupat inspektuese nga pikat doganore dhe e kam kaluar



kompetencën e kontrollit të cilësisë së naftës në Dogana. Ministri aktual, që është ministër i partisë së Nismës, e ka marrë këtë kompetencë mbrapa edhe me Udhëzim Administrativ të ri thotë që ka me e autorizua një trupë inspektuese dhe jo disa trupa inspektuese.

Andaj, është mirë mos me manipulua me opinionin dhe informatat me i konfirmua para se me i qitë në publik, sepse nuk është korrekte. Kjo është e dhjeta herë që po e sqaroj këtë këtu në Kuvend. Çfarëdo që keni qitni, mirëpo ju lutem informata të sakta...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: E nderuar Hykmete!

Unë e thashë në mënyrë absolute nuk shpifa, se nuk thash për ty, por meqenëse e përmende vet, po ta them. Një gabim trashanik të pafalshëm e ke bërë kur e ke kaluar kontrollin e cilësisë së derivateve të naftës nga laboratorët në Doganë.

Në qoftë se, ma gjen një vend të Botës, në qoftë se ma gjen një vend të Bashkimit Evropian që dogana e kontrollon cilësinë e naftës, unë publikisht të kërkoj falje. Ky ka qenë gabimi yt më i madh, ndërsa ato laboratorët tjera s'të ka ardhur ty rendi hiq me u marrë me atë punë, se është marrë zonja Mimoza Kusari.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Danush Ademi e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Sa i përket Qeverisë Haradinaj ne e falënderojmë, se me të vërtetë është duke dhënë një mbështetje komuniteteve në përgjithësi. Por, ne desha ta ngre një shqetësim se vazhdimisht kur flitet për komunitete ka shumë kolegë deputetë tanë që u mëshojnë flakareshë, u mëshojnë të gjitha komuniteteve. Unë kërkoj nga kolegët që duhet të mendojnë se unë që përfaqësoj komunitetin këtu komunitetin tim ashkalinj po ua rikujtoj se tre deputetë nga komuniteti ashkalinj janë nënshkruar të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Këtë dua edhe një herë ta përkujtoj, le ta marrin e ta këqyrin, se të tre deputetët janë nga subjekti që unë e përfaqësoj sot dhe është mirë, është mirë që kur të përmenden komunitetet të dallohen pak komunitetet e jo të gjitha komunitetet të shtihen në një pako. Edhe një dua t'ua rikujtoj, sepse komuniteti ashkalinj nuk ka vend tjetër rezervë e të shkojë t'i pyes a të votojë dikë apo jo. Ne si komunitet asnjëherë nuk kemi kërkuar asnjë kushtëzim s'ia kemi bërë, as s'kemi kërkuar kushte për ndonjë votë që i është dashur Qeverisë së Republikës së Kosovës. Prandaj, edhe një herë kërkoj nga kolegët tonë deputetë që asnjëherë nuk kemi qenë edhe kundër ushtrisë, na jemi

sot. Të nderuar deputetë, nëse ju sot e keni atë fuqi, e keni atë mundësi, futeni në rend dite votimin e ushtrisë, ne do të jemi të parët që do ta votojmë.

Mos i kritikoni të gjitha komunitetet. Është mirë t'i dalloni këto pak, komunitetin serb prej komuniteteve tjera. Nuk jemi pjesë e kushtëzimeve. Prandaj, kërkojmë që ta keni parasysh. Jo, nuk është Emilija, sepse unë jam që dhjetë vjet deputet, i nderuar, këtu. Katër mandate jam deputet në Parlamentin e Kosovës. Nuk foli me gjuhë të huaj, foli me gjuhën time e me atë që më ka dërguar komuniteti im ashkalinj, që jam që katër mandate në Parlamentin e Kosovës, por këtë të drejtë ma garanton edhe e drejta kushtetuese.

U fol që edhe për vendet e rezervuara, pa marrë parasysh a kemi vende të rezervuara apo s'kemi por do t'u vijë përfundimi vendeve të garantuara. Unë jam i bindur se prapë komunitetet, nëse nuk i kanë dhjetë do t'i kenë pesë anëtarë këtu, sepse mbi 50 mijë vota i kemi. Ne kemi deputetë këtu në Parlamentin e Kosovës që me votat e komuniteteve janë. të ishte folur kur të vijë koha e votimeve në shumë dyer shkojnë e kërkojnë votat e komuniteteve. I kemi parë vetë dhe jemi prezentë këtu, prandaj kisha kërkuar një mirëkuptim nga të gjithë deputetët, që të kenë mirëkuptim ndaj të gjitha pakicave këtu. Le t'i dallojnë pakicat. Nuk jemi pjesë e kushtëzimeve. Edhe një herë po e potencoj, nëse sot ka fuqi Kuvendi e pas një ore është Kryesia e Kuvendit prej orës 6, le ta qesin në rend dite, ne do të jemi numër një për ta votuar ushtrinë e Republikës së Kosovës. Jo, nuk jemi pjesë e kushtëzimeve.

Asnjë herë, asnjë herë s'kemi qenë pjesë e kushtëzimeve. Prandaj, duhet të kërkoj që të keni konsideratë ndaj pakicave.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sali Zyba, a është këtu?

SALI ZYBA: Përshëndetje, të dashur qytetarë!

Të nderuar të pranishëm,

Ne sot qysh në orën dhjetë kemi filluar diskutimin për raportin 100 ditor të Qeverisë së Kosovës.

Në ndërhyrjen që pati më herët zëvendëskryeministri Hoxhaj u përpoq të ngrejë një temë të madhe, temë që tashmë është e ditur, i cili përdori një kërcënim për Lëvizjen "Vetëvendosje", e që u përpoq e tha për demarkacionin se së shpejti do të vijë e kërcënimin për "Vetëvendosjen" ishte që "duhet ta votoni, në të kundërtën do të votojmë me Listën serpska". Ky kërcënim nuk vlen për Lëvizjen "Vetëvendosje", andaj po përpiqem të vazhdoj për raportin 100-ditor të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Zoti Blerim Kuçi më parë në fjalën e tij iu falënderua kryeministrit për raportimin, tha, këtij Kuvendi për 100 ditë të qeverisjes. Sigurisht nuk e dëgjoi fjalën e tij, sepse kryeministri në asnjë moment nuk foli për raportin. Kryeministri fillimisht ironizoi kur tha "e kam harruar" dhe më pas

e injoroi kur lëshoi këtë sallë. Kryesuesi i Grupit Parlamentar Ahmet Isufi kur filloi të flasë për 100-ditëshin tha “Çka është kjo zhurmë e opozitës, që po bëhet për raportin 100-ditor?” Po bëhet zhurmë, sepse s’ka punë, zoti Ahmet Isufi. Më pas, ai vazhdoi me ironinë që shkaktoi me LDK-në kur tha “Kur i bëni thirrje LDK-së, të jetë më e durueshme.” Domethënë, Ahmet Isufi i bën thirrje LDK-së për durim, ndërsa në fjalën e saj Vjosa Osmani tha “I vetmi subjekt që ka krijuar, ose që ka kërkuar krijimin e ushtrisë, ka qenë LDK-ja.” Edhe kjo është e habitshme.

Unë tregoj çka di se kam mundësi me tregua, po mos ndërhyj se kryesuesi është për këtë punë.

Po përpiqem të shkëpus diçka prej këtij raporti, i cili është i botuar e ia kujtoj kryeministrit, i cili me krahun plot, me bërryla i ka hapur dyert e Kuvendit, dyert e Presidencës, për të shpërndarë edhe te deputetët këtë raport 100 ditor. Unë kam kritika për mënyrën e raportimit, përveçse edhe raporti me të vërtet s’ka çka të diskutohet, sepse nuk ka kurrgjë në të.

Po shkëpus pjesë të raportit, po citoj raportin në shumicën e rasteve. Po filloj nga më e rëndësishmja, ku thotë se janë 224 vendime. Keni parasysh, ky raport është në tri pjesë, të tri pjesët e kanë përshkrimin e njëjtë, vetëm se është ndarë diku me tika, diku me numër rendor e diku, qe besa edhe në formë tabelore, por ka të bëjë me të njëjtin raport. Në këto 224 vendime janë përfshirë edhe procesverbalet. Keni parasysh në secilin procesverbal në pjesën e tretë vendim e kanë quajtur edhe aprovimin e procesverbalit të mbledhjes paraprake. Prandaj, e kritikoj këtë mënyrë, këtë logjikë të raportimit.

Në pjesën hyrëse te Zyra e kryeministrit raportohet se është shtuar buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë për 18 milionë dedikuar për shërbimet e qytetarëve jashtë institucioneve shëndetësore publike. E dimë këtë punë, po le të bëhet një sqarim, një raportim për institucionet publike se ajo është gjendja e mjerueshme në ato institucione.

Po vazhdoj me disa prej temave. Thuhet se është shkarkuar Bordi i Agjencisë së Akreditimit të Cilësisë në Arsim. Po, ka pesë muaj, po ende Qeveria me propozimet e veta dhe mënyrën e saj nuk e ka krijuar mundësinë për t’u votuar ai bord. Po kaloj nëpër disa ministri për të cilat ky raport që e përmenda është në tri pjesë. Ky raport nuk i përfshin as 100 faqe, e lëre më 100 fletë, për të cilin do të duhej së paku nga një fletë në ditë ta ketë përmbledhje kjo Qeveri.

Po i përmend disa prej ministrive, por po e filloj te e Bujqësisë, meqenëse emërimi i ministrit të parë ka qenë arsyeja e shumë protestave, shumë shqetësimeve të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Thuhet këtu se janë bërë të gjitha përgatitjet për realizimin e mbjelljes dhe më pas thotë “janë mbjellë gjithsej 70 513,3 hektarë, e tjerë...”. Asnjë moment nuk e përshkruan kush i ka mbjellë këto. Mos i ka mbjellë kjo Qeveri me këta zëvendësministra edhe pyetja është me çka? Me ato kartela që u përmendën, nga tremijë euro apo me çka? Këtë pyetje duhet ministrat të kenë njëfarë përshkrimi të paktën.

Ministria e Drejtësisë në paraqitje ka bërë shumë paraqitje, por ja që drejtësi në të nuk ka, se dikush e përmendi sa i guximshëm është ministri i drejtësisë. S’do të duhej të ishte i guximshëm, por i drejtë dhe vendimmarrës.

Ministri Hamzaj ka përmbledhur këtu rreth një faqe, më pak se një faqe, ndërsa në fjalimin e vet përshkroi shumë detaje por të cilat nuk janë pjesë e raportit. Edhe këtu do të duhej, se ne po bëjmë fjalë ose kërkesa e deputetëve ka qenë për këtë seancë që të flasim për raportin, jo për të gjetura që i integrojnë më pas këta. Për ministrin e financave, Bedri Hamzën, e kam një pyetje. Thuhet se për herë të parë është propozuar implementimi i rregullimit mbi pagat, që parasheh rritjen te pagat e sektorit ekonomik në linjë me rritjen ekonomike. Për sektorin publik po, por asnjëherë s’u bë fjalë për pagën minimale si dhe ato në sektorin privat.

Po kaloj nëpër disa, sepse sigurisht së paku edhe 20 folës ishin të paraqitur. E kemi Ministrinë e Kulturës, të paktën duhet ta kemi parasysh, Ministria e Kulturës i ka këtu vetëm katër pika. Këto katër pika, në këta katër rreshta, janë për mjerim. Paraqesin vetëm katër raporte të shpenzimeve, vlerave monetare. As nuk ka asnjë aktivitet, aq më pak kulturor, i cili do të duhej t’i referohej një suksesi apo një paraqitjeje, një prezantimi publik!

Mos e tepro, të lutem, se kryesuesi është këtu. Drejtoju kryesuesit, mos më pengo!

E kemi Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që i ka vetëm tri pika. I përmendi pjesërisht prej tyre, ka ndërmjetësuar në punësim, ka ndërmjetësuar dikë. Praktikë në punë dhe marrëveshje bashkëpunimi. Kategoritë e dala prej lufte, kategoritë tjera sociale, pensionistët dhe problemet tjera, as nuk i ka paraqitur, por as nuk ka referuar asnjë të dhënë, asnjë shifër këtu.

E kemi Ministrinë e Shëndetësisë, ku thotë: “janë dhuruar 6 autoambulanca”. Kush i ka dhuruar, ku janë blerë... s’ka asnjë përshkrim, as te vlera, as te sasia. Për Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë kam një pyetje, pika e dytë sigurisht, thotë “... janë organizuar tri panairë ndërkombëtare jashtë vendit”. Nëse flasim për panairë të organizuara jashtë vendit do të duhej të përshkruheshin pak, nëse ka marrë pjesë dikush në panairë është diçka tjetër, prandaj kjo pyetje i dedikohet ministrit përkatës.

Po kaloj te Ministria e Zhvillimit Ekonomik, e cila nuk paraqet zhvillim, përpos që i përmend tri pika: strategjinë që është për energjetikë, “Contour Global” dhe ndërmarrjen publike. S’ka këtu zhvillim, s’ka përparim, s’ka... Ndërsa, format tjera është për keqardhje se si janë paraqitur e njëjta formë me mënyrën e tretë, trefish domethënë është shpenzuar kot letër, ka mundur të përfshihet me një të vetme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Haxhi Avdyli e ka fjalën.

HAXHI AVDYLI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë fjalimin tim dua t'ia filloj duke theksuar uljen e nivelit të gjuhës së komunikimit, i cili ka mbretëruar dhe po mbretëron në raport Qeveri - Kuvend, por edhe prishja e gjuhës dhe nivelit të gjuhës edhe në raport me publikun, si dhe normalisht tensionet sociale të cilat janë ngritur gjithandej në gjithë sektorët edhe si pasojë e vendimeve jo të duhura, vendimeve të ngutshme që si pasojë kanë sjellë pakënaqësi të mëdha, veçanërisht te punëtorët shëndetësor, te punëtorët e arsimit dhe Prokurorisë dhe sektorëve tjerë, ku rritja e pagave të kryeministrit dhe qeveritarëve tjerë ka shkaktuar pakënaqësinë e tyre të madhe dhe tani në këtë drejtim kjo gjë është e vështirë për t'u ndaluar.

Shpenzimet që po i shkaktohen këtij shteti dhe alarmi që e ka dhënë ministri i Financave për rënien e nivelit të rezervave të shtetit është një alarm, i cili duhet të na brengos të gjithëve, sepse një shtet gjithmonë duhet ta ketë një rezervë të mirë, sepse gjithmonë mund të vijë deri te ndonjë fatkeqësi, tërmet, vërshim, e këto rezerva duhet të shfrytëzohen në të mirë të qytetarëve. Shpenzimi i këtyre rezervave është një papërgjegjësi e rendit, e radhës, e kryeministrit dhe Qeverisë dhe kjo do të shkaktojë pasoja të mëdha në të gjitha drejtimet.

Normalisht, vendimet e kësaj Qeverie, siç janë vendimet e mëdha, tani janë shndërruar në dështime të mëdha dhe zbrapsje të mëdha, duke filluar nga tendenca e shfuqizimit të Gjykatës Speciale, rritja e pagave, pastaj Ligji për demarkacionin dhe shumë vendime tjera. Në këtë drejtim vendimet e kryeministrit kanë qenë vendime "ad hoc" dhe zakonisht aty ku ka mundur të marrë vendime në dobi të grupit të interesit dhe ithtarëve të tij, siç janë edhe punësimet nepotiste nëpër ministri, unë dua ta vë theksin edhe në një ministri, e cila tani është një ministri e re, siç është Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe nga ueb-faqja e tyre dhe nga profilet e ministrit Demiri, shohim që diku në mënyrë të çuditshme ndahen nga 30 mijë, 50 mijë, për salla të sporteve, për investime të ndryshme, pa i përfillur procedurat që duhej të vazhdonin këtu dhe mendoj se një sjellje e tillë ndaj parasë publike duhet të jetë edhe objekt i hetimeve, sepse paraja publike dhe paraja e taksapaguesve janë duke u keqpërdorur me të madhe, jo vetëm nga kryeministri, por edhe në ministri të ndryshme.

Theksi i lëmit të shëndetësisë, mund të themi se tani shëndetësia është në nivelin më të ulët të zhvillimit të saj. E dimë se shëndetësia me vite vazhdimisht ka pasur probleme. Nuk ka qenë në nivelin më të mirë të saj, ka pasur mungesa, ka pasur ngecje, por tani në këtë Qeveri kemi mungesa të mëdha të barërave, mungesa të tilla që asnjëherë nuk i kemi pasur edhe më përpara, siç është edhe mungesa e jodit nëpër salla, mungesa e manteleve për kirurgët e shumë mungesa të tjera elementare, të cilat janë të pakuptueshme dhe krejt kjo është pasojë e mos planifikimit të mirë dhe ndoshta, këtu përgjegjësia këtu do të duhej të ulet nën nivelin e ministrit, ndoshta edhe te menaxherët e sektorit, por mendoj se kjo është e pafalshme dhe është dekurajuese për gjithë atë numër të madh të pacientëve dhe nevojave të mëdha këta pacientë.

Qeveria aktuale dhe ministri i Shëndetësisë, si duket kanë hequr dorë nga sigurimet shëndetësore dhe normalisht, se një reformë e tillë ku do të duhej të ndodhnin sigurimet shëndetësore është një reformë e thellë dhe është e vështirë që kjo Qeveri ta bartë këtë reformë dhe si duket kanë hequr dorë. Unë i kuptoj, sepse nuk i kanë as kapacitetet intelektuale, as profesionale, që kjo ministri të arrijë një reformë të tillë, e cila përfshin shumë sektor dhe është një reformë thelbësore e gjithë sistemit shëndetësor.

Normalisht, sistemi i informimit shëndetësor është para kolapsit, sistem ky i cili është hallka e parë që do të duhej të ishte para sigurimeve shëndetësore. Sistemi i informimit shëndetësor është para kolapsit dhe faktikisht është hequr dorë edhe nga kjo. Kështu që, duhet thënë haptazi se Ministria e Shëndetësisë më shumë është duke u marrë me shuarjen e zjarreve e më pak me zgjidhjen afatgjate të problemeve në shëndetësi.

Tani ne si Kosovë për këto muaj jemi duke bërë hapa mbrapa në shumë drejtime dhe mendoj se tani është koha që të krijohet një momentum i ri në skenën politike dhe duhet që të gjithë aktorët politikë të fillojnë të mendojnë, jo për interesa të ngushta, por interesa të përgjithshme dhe t'i vendosin interesat e qytetarëve mbi interesat e ngushta klanore, familjare dhe të fillohet me reforma në të gjithë sektorët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Beqaj.

HAJDAR BEQAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë do të fokusohem kryesisht në ministrinë apo në dikasteret përkatëse të komisionit të cilit i takoj si Komision për Legjislacion, në cilësinë e zëvendëskryetarit të parë të komisionit, në ato punë që i kemi përcjellë dhe që bien në fushëveprimtarinë e Komisionit për Legjislacion, pa i dalluar arritjet e ministrave të tjerë apo të Qeverisë që i ka pasur për këto që po bëhen tash gjashtë muaj.

Përmes fjalës sime sot dua të vë theks në rëndësinë e përbushjes së obligimeve institucionale, që dalin nga agjenda e reformës evropiane, ndërsa jam i zëshëm, por edhe kritik, përballë trajtimit të Republikës së Kosovës nga ana e Bashkimit Evropian. Institucionet tona duhet të jenë shumë më të përkushtuara çdo ditë që të përbushin obligimet e përcaktuara si prioritet të kësaj agjende.

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ministrinë përgjegjëse duhet të punojnë aktivisht në adresimin e të gjitha përgjegjësiave sektoriale. Megjithatë, një shembull i mirë që vlen të theksohet është gatishmëria dhe përkushtimi i Ministrisë së Drejtësisë, i cili në afate rekorde ka

përmbushur të gjitha obligimet e agjendës për reforma evropiane të përcaktuara për Ministrinë e Drejtësisë. Vetëm në periudhën tremujore të punës së kësaj Qeverie Ministria e Drejtësisë ka kryer tri obligime që implikojnë plotësimin dhe ndryshimin e nevojshëm dhe të domosdoshëm të legjislacionit dhe kanë për qëllim që të avancojnë dhe forcojnë sundimin e ligjit, forcimin dhe konsolidimin e mëtejme të fushës së drejtësisë, të institucioneve gjyqësore të pavarura dhe eficiente, si dhe luftimin e dukurive negative, si korrupsioni dhe krimi i organizuar.

Në kuadër të agjendës për reformë evropiane Ministria e Drejtësisë e ka adresuar hartimin e Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, të cilin e kemi miratuar në lexim të parë dhe do ta japim kontributin tonë që i njëjti të procedohet për miratim brenda afateve më të shkurta kohore. Po ashtu, në adresim të prioriteteve mbi çështjet e suspendimit të zyrtarëve publikë me rastin e ngritjes së aktakuzave që ndërlidhen me korrupsion, krimin e organizuar si dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare, ka miratuar koncept-dokumentin në Qeveri dhe opsionin e rekomanduar përmes tij e ka inkorporuar në dispozita përkatëse të Kodit Penal dhe të kodit të procedurës penale, të cilat do të vijnë shumë shpejt edhe në seancë plenare për shqyrtim dhe në komisione përkatëse.

Gjithashtu është adresuar edhe çështja e rishikimit të Projektligjit për Prokurorinë e Shtetit.

Ky projektligj për vazhdimin të fuqizimit të regjistrimit mbi luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, përfshin nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të prokurorit special që heton dhe ndjek penalisht raste të nivelit të lartë, do të mundësojë rritjen e numrit të prokurorëve në Prokurorinë speciale për hetim dhe ndjekje penale të rasteve të korrupsionit dhe krimin të nivelit të lartë si dhe ofrimin e trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të Prokurorisë speciale për të kryer hetime financiare dhe për të konfiskuar pasuri, e cila është fituar në mënyrë të paligjshme, në bashkëpunim me institucionet gjyqësore.

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Zbatimi i Agjendës për Reformë Evropiane, në të cilin janë identifikuar veprimet prioritare, të cilat duhet të ndërmerren për shfrytëzimin sa më të mirë dhe më të gjerë të mundësive që ofron MSA-ja, Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës është obligim i institucioneve tona. Prandaj, ne duhet të punojmë bashkërisht që të mbështesim zbatimin efektiv të detyrave që i kemi marrë si shtet përballë Bashkimit Evropian, për kontratën që e kemi nënshkruar, në mënyrë që të tregojmë seriozitetin dhe përkushtimin e nevojshëm në rrugën integruese të vendit tonë.

Qeveria e Republikës së Kosovës në njërin nga mbledhjet e saj, para dy javësh, i kushtoi rëndësi të veçantë miratimit të pakos së projektligjit të fushës së gjyqësorit dhe për këtë qëllim kryeministri Haradinaj, së bashku me ministrin Tahiri organizuar konferencën për media,

nëpërmjet së cilës e njoftuan publikun për përmbajtjen e këtyre projektligjeve dhe reformave që do të realizohen.

Me këtë rast përgëzoj ministrin e Drejtësisë, Tahiri, për përkushtimin e tij që ka ndërmarrë në drejtësi, duke punuar konkretisht në adresimin e të gjeturave në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian të vitit 2016.

Projektligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Projektligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Projektligji për gjykatat, si dhe Projektligji për përgjegjësinë disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorët.

Këto janë projektligje, me anë të të cilave do të konsolidohen dhe avancohen institucionet e drejtësisë.

Puna në hartimin dhe finalizimin e këtyre projektligjeve duhet vlerësuar, sepse në funksion të avancimit të kuadrit ligjor, ka për qëllim të rrisë llogaridhënien dhe përgjegjësinë e sistemit gjyqësor prokurorial, e veçanërisht llogaridhënien dhe përgjegjësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët shërbejnë në kuadër të sistemit të drejtësisë.

Angazhimin dhe zbatimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës për fushën e drejtësisë si dhe përmbushjen dhe realizimin e objektivave që janë pjesë e dokumenteve strategjike, është një hap i duhur dhe përgjegjësi konkrete përballë nevojave të sistemit të drejtësisë, nga njëra anë, si dhe obligime ndërkombëtare të vendit tonë, nga ana tjetër.

Prandaj, mirëpresim reformat e ndërmarra në sistemin e drejtësisë dhe besoj që së bashku me kolegët deputetë do ta japim kontributin tonë që kjo pako e ligjeve reformuese të mbështetet në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe në këtë mënyrë të dëshmojmë dhe reflektimin tonë përballë standardeve më të larta për sigurinë në qasjes efektive në drejtësi, për të gjithë pa dallim, për sistemin gjyqësor, prokurorial të pavarur, të paanshëm dhe kredibil si dhe për transparencën dhe llogaridhënien më të madhe në sistemin e drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Labinot Tahiri, nuk është. Zoti Shemsi Syla e ka fjalën.

SHEMSI SYLA: I nderuar kryesues,

Të nderuar ministra,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Edhe disa parafolës e theksuan se është i vonshëm ky debat për të biseduar për 100-ditëshin e qeverisjes, edhe për mendimin tim është i vonuar.



Megjithatë, 100 ditët e para të Qeverisë konsideroj se ishin 100 ditët e pasionit të zotit Haradinaj për të qenë në krye të Qeverisë.

Nuk thuhet kot se aty ku dominon pasioni, arsyeja rri larg. Ky pasion i zotit Haradinaj tani në 100-ditëshin e dytë ka filluar të zbehet, por kjo zbehje ende nuk i ka hapur rrugë arsyes për t'u marrë me tema të veprimit konkret që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Në raportin 100-ditësh të Qeverisë janë përshkruar një sërë ligjesh, vendimesh, por në jetën e përditshme ende nuk ka asnjë përmirësim.

Ato të arritura që kemi dëgjuar nga Qeveria nuk po përputhen me ato që po shohim në terren, e në takime të shpeshta me qytetarë gjithandej.

Kryeministri Haradinaj, para disa viteve në TV Klan, në një emision opinion me gazetarin Blendi Fevziu pati deklaruar, po citoj: “Ka dy kategori njerëzish, në kategorinë e parë bëjnë pjesë ata që prodhojnë ide, kurse në kategorinë e dytë bëjnë pjesë ata që i zbatojnë idetë, unë i takoj kategorisë së dytë”, pati deklaruar Haradinaj. Pra ajo që po ashtu Haradinaj e ka deklaruar publikisht se a ka pasion në postin e kryeministrit, është zbehur.

Ende nuk e kemi parë ata që prodhojnë ide në Qeverinë e tij, edhe pse pranë tij kemi një armatë të tërë të ministrave, të zëvendësministrave, këshilltarëve të fushave të ndryshme, analistë, profesionistë dhe që pasioni i tyre është zbehur. Njerëzit që prodhojnë ide nuk po duken.

Kështu që kryeministri, me gjasë, ka mbetur pa punë, prandaj edhe po punohet pa afate, duke mos ditur kur kryhet një punë dhe kur fillon tjetra.

Kjo Qeveri të gjitha temat që preokupojnë Kosovën po përpiqet t'i trajtojë si prioritet. Prandaj, edhe janë ngatërruar punët dhe po mungojnë rezultatet në mungesë të një plan-programi konkret të qeverisjes.

Siç po duket, edhe Qeveria Haradinaj ka vendosur që infrastruktura rrugore të jetë në plan të parë. Shkaku i tenderëve dhe i një mundësie për të përdorur ndërtimin e autostradave edhe për fushata elektorale.

Ministri i Infrastrukturës këto ditë deklaroi se në Kosovë do të ndërtohen ura me më të gjatë në Ballkan. Ky është një sihariq shtesë, pasi që edhe rrethrotullimet e autostradave i kemi më të mëdhatë në Ballkan. Kanë marrë formën e labirintit, ndoshta edhe për t'i provokuar ata që kalojnë aty pari me makina se a po mund të gjejnë daljen.

Në sistemin arsimor nuk po vërehet ndonjë përmirësim.

Në zhvillimin ekonomik dhe në punësim nuk ka asnjë avancim, e në shëndetësi këto ditë ministri i këtij resori na dha lajme se për krijimin e Fondit të Sigurimit Shëndetësor duhen së paku edhe dy vjet. Është interesat kjo, secili ministër që vjen deklaron të njëjtën gjë.

Korrupsioni ka përfshirë çdo pore të jetës, e gjithë ajo që thuhet është sa për t'u thënë, pasi që jo që po luftohet korrupsioni, por po rritet duke rrënuar e përbaltur çdo vlerë.

Prej temave që është rrahur gjoks më së shumti, e që u përsërit edhe sot këtu dhe që gjithnjë është vënë si prioritet, është ushtria, gjegjësisht krijimi i Forcave të Armatosura të Kosovës.

Në raportin 100-ditësh vërtetohet se mu në këtë fushë nuk është bërë asnjë hap konkret dhe nuk është marrë asnjë iniciativë drejt avancimit të kapaciteteve të reja të FSK-së, e as të themelimit të Forcave të Armatosura të Kosovës.

Kjo qeveri ka vazhduar me traditën e qeverive të kaluara që ushtrinë e Kosovës e përmendin vetëm për marketing politik dhe në fushata zgjedhore.

Meqenëse FSK-ja ka herë i ka plotësuar kapacitetet e veta operationale dhe është e aftë të marrë misionin e ushtrisë, po për shkak të politikave nuk po ndodh kjo. Është duke u sjellë në rreth të mbyllur, bashkë me Ministrinë e Forcës së Sigurisë.

Vitin që e lamë pas institucionet e sistemit u përfshin në mashtrimin e qytetarëve se gjëja po e formojnë ushtrinë ose Forcat e Armatosura të Kosovës po i shndërrojnë në një mision tjetër, herë me kushtetutë e herë me ligj, e në fakt, nuk bënë asgjë.

Në vend të avancimit të FSK-së, është organizuar parakalimi i trupave të FSK-së me rastin e 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës dhe, në fakt, ky ishte parakalim mashtrues, i përsëritur, për të pakësuar pakënaqësinë e gjithë brezave atdhetarë që luftuan për të pasur Kosova ushtri dhe sovranitet. Kosova vazhdon të vendnumërojë sa i përket sigurisë. Në kohën kur Serbia nuk fsheh dhe nuk ka hequr dorë nga pretendimet ndaj vendit tonë. Ajo armatoset e përgatitet për çdo ditë me armë më të sofistikuar dhe kërcënon Kosovën në vazhdimësi.

Më 27 nëntor është mbajtur mbledhja e përbashkët e Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, aty janë nënshkruar 12 marrëveshje, asnjë marrëveshje nuk është nënshkruar për siguri të përbashkët të Kosovës me Shqipërinë.

Sa i përket Policisë së Kosovës, më mbetet shumë pak për të thënë nga ajo çfarë është thënë në media lidhur me skandalet e fundit dhe në komisionet për siguri. Ministria e Punëve të

Brendshme dhe Policia kanë dështuar plotësisht në misionin e tyre, ata tashmë janë të pabesueshëm para qytetarëve.

Sukseset që i numërohen Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë gjatë 100-ditëshit janë minore dhe të papërfillshme para skandaleve që kanë shpërthyer aty.

Në Inspektoratin Policor dhe Hetuesi të Krimit, si shtylla kryesore, është konstatuar rrjeti i organizuar kriminal i lidhur me politikën, e cila ndëshkon çdo kënd që nuk u pëlqen klaneve të caktuara që e kanë kapur shtetin.

Çdo ditë bandat kriminale të maskuara të armatosura, edhe me kallashnikov, plaçkitin edhe në pikë të ditës qytetarët, duke i terrorizuar, duke i rrahur, plagosur e vrarë në shtëpitë e tyre, në lokalet e pasuritë e tyre, kurse Policia nuk zbulon dhe nuk kap këto banda. Nga një polici që duhet të luftonte korrupsionin e krimin, shpeshherë është kthyer në burim të tij.

Dhe krejt në fund, duke i parë gjithë këto zhvillime në sektorin e sigurisë nuk po mund të gjej dallimin assesi në mes të Qeverisë Haradinaj, Qeverisë Mustafa dhe Qeverisë Thaçi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Labinot Tahiri, regjia, edhe një herë zotit Tahiri mikrofonin.

LABINOT TAHIRI: Faleminderit deputetëve që kërkuan të dal këtu në foltore. I përshëndes shqiptarët e Maqedonisë për miratimin e Ligjit për gjuhën shqipe.

E dyta, Fitim Shala, mos fol shumë se atëherë thoshe nuk bëhet kryeministër Ramushi, po u bë, të pata thënë që do të bëhet Ramushi kryeministër.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kryesues,

Normalisht jam mësuar të dal para 2-3 mijë vetëve, jemi pak deputetë, megjithatë, ju respektoj të gjithëve njëjtë.

Krejt folët për ushtri sikur u bë ushtria, uroj. Unë kam një kërkesë veç për demarkacion, se e vetmja pyetja po më bëhet kjo nëpër komente se kur kalon.

Kisha pasur dëshirë që dikush prej “Vetëvendosjes” të mos i japë mundësi Listës serbe të na i kërkojë ato kushte, mirë, mirë, më fal. Dikush si figurë, qe Adem Mikullovc, ka qenë njeri që ka sakrifikuar për Kosovën në atë kohë, pasi është 70% e popullsisë që e do demarkacionin, bashkë me miqtë tanë, Amerikën e Evropën.

Megjithatë kërkoj nga ti, zotëri, të më përkrahësh në aspektin politik, se mua s'ma sheh sherrin Kosova, veç hairin.

E dyta, debate personale këtu nuk duhet të bëhen shumë, se askujt s'i intereson jashtë Parlamentit, po bëni debate veç çka është konkrete për të mirën e vendit.

Tani, ata që më kanë kërkuar se a i kam dorëzuar pasaportat. Unë ju them, në rast se shkohet në votim, nuk kalon demarkacioni, unë i dorëzoj pasaportat, një gjë të tillë e kërkoj prej krejt deputetëve t'i dorëzojnë pasaportat. Faleminderit!

KRYESUESI: Edhe një herë zotit Tahiri fjalën.

LABINOT TAHIRI: Faleminderit!

Jo desha të them shumë seriozisht. Nuk i gëzohem fatit që është ndarë "Vetëvendosja", megjithëse ka pasur popullata shpresë të madhe për ndryshim. Megjithatë, uroj që edhe Grupi Parlamentar tjetër të punojë për të mirën e vendit, siç kanë punuar bashkë. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!

Dëshiroj të mos mërzhitemi prej këtij debati dhe po e filloj me një, ta quaj, konstatim të kryeministrit të tanishëm Haradinaj, në vitin 2016, kur thotë: "Me një gjendje socio-ekonomike siç gjendet Kosova, Qeveria nuk guxon të ketë më shumë zëvendësministra sa kishte në atë kohë", e shumë shqetësuese dhe e papranueshme që pos numrit rekord të ministrive, Qeveria e Republikës së Kosovës të ketë më shumë se një zëvendësministër për ministri.

Rritja e pakuptimit e shpenzimeve qeveritare po kalon në abuzim arrogant me pushtetin, vetëm për interesa të ngushta klienteliste.

Zvogëlimi i Kabinetit qeveritar është domosdoshmëri, qasja e tanishme po tregon se Kosova po forcohet me parti shtet dhe kjo është një ndër sukseset e para të kësaj Qeverie, afërsia për të arritur që Kosovën ta shndërrojë në parti shtet. Po këtë kombinim fatkeqësisht e prishi emërimi i Numan Baliqit dhe shkarkimi i tij si zëvendësministër.

Më lejoni pak të dal nga aspekti opozitar të numëroj disa nga sukseset e kësaj Qeverie për këto 200 ditë që të mos mbesim vetëm nën hijen e kritikave dhe të asaj që po shihet si abuzim me pushtetin.

Suksesi i parë ka të bëjë me këtë që po apostrofojmë rritjen e numrit të ministrave e zëvendësministrave që, në gjuhën popullore i bie që ua kemi ftoh Kinës e Rosisë për nga numri i madh i Kabinetit qeveritar.

E dyta, është krijimi i Ministrisë së Inovacionit, e cila e ka shpikur vrapin, vrapin qeveritar, domethënë kjo është gjëja më inovative që ka ndodhur për këto 185-186 ditë që thanë për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

E treta, kanë arritur të fitojnë një donacion të rëndësishëm për kravata dhe këmisha sa që ishin numër të madh, disa i shfrytëzuan edhe qytetarët e vendit, edhe këshilltarët, edhe Kabineti i kryeministrit.

E katërta, është që kanë paguar në afat rekord pesë milionët e tenderit kriminal të pasaportave. Pasi e kanë paguar në afat rekord këto 5 milionë në afat rekord, ia kanë fshirë edhe obligimet tatimore prej 500 mijë euro të kësaj kompanie.

Suksesi tjetër është që e kanë rritur koston e shpërblimit për shpronësimin në Hade nga 4.5 milionë që ishte planifikuar, në 21 milionë, e çdo ditë është në tendencë të rritjes së saj. Tjetër sukses është tërheqja nga aplikimi për anëtarësim në Interpol, sepse duhet t'u krijojë akoma mundësi grupeve të ndryshme të interesit, grupeve kriminale që të shëtisin lirshëm nëpër Kosovë dhe të mos atakohen nga drejtësia vendore dhe ndërkombëtare. Dhe, ajo çka është më e rëndësishmja për këtë Qeveri, është rritja e përqindjes së tenderomanisë, sidomos për infrastrukturë. Nga ajo që jemi mësuar ta dëgjojmë në të kaluarën, tash edhe avanca është rritur, edhe paraja kesh, edhe përqindja për këto 188 ditë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Tash po flas për pjesën tjetër, çka ka obligim Qeveria për të bërë, e cila është shumë e rëndësishme. 200 mijë kilogramë mish të importuar me etiketa false nga Belgjika. Paramendoni qytetarët e Republikës së Kosovës, neve të gjithëve, pa përjashtim, se me çka jemi ushqyer në këto vitet e fundit. Unë dëshiroj, bëj thirrje, krahas prokurorisë gjithmonë, kësaj prokurorie të brishtë, që Qeveria të marrë masa adekuate, të hetojë dhe të parandalojë, sidomos ata që pretendohet që kanë futur këtë mish me etiketa të falsifikuara. Pyetja tjetër, i cili është obligim që Qeveria të raportojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës bashkëpunimin që e ka me kriminelin e Veriut, Radojçiqin dhe i cili tash është bërë pjesë e atij elementit që e quajmë ne ndarjes së pushtetit dhe mbizotërimin mbi listën e deputetëve nga komuniteti serb.

Dhe, e fundit ajo që ishte sot temë debati për qëllim për t'i ikur më shumë debatit, antagonizmi që bëhet për formimin apo për krijimin e ushtrisë së re të Kosovës. Ka shumë elemente që e kanë penguar formimin e të krijimit të ushtrisë së Kosovës. Po elementi kryesor, kolegë deputetë, fatkeqësisht po duhet ta përmendim, është vrasja e ushtarakëve që ka ndodhur në Republikën e

Kosovës, gjatë luftës dhe pas luftës. Ky është elementi i parë që i ka munguar elementi profesional dhe kam lejuar që bashibuzukët të udhëheqin edhe me TMK-në, edhe me FSK-në, edhe tash transformimin në ushtri të Kosovës.

Pjesa tjetër ka të bëjë akoma më shumë, në kuadër të këtij elementi kanë qenë edhe pjesë e listave të zeza që është e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe fatkeqësisht këto janë elemente që pengojnë krijimin e institucioneve kredibile edhe asaj që ne po dëshirojmë, ushtrinë e Kosovës.

Kështu që ajo e fundit, çka ishte me rëndësi, të mos ketë nevojë dikush ta përsërisë memorien institucionale për ta nxjerrë dikë në një pozitë të palakmueshme, përgjigjen më të mirë për ngjarjet rreth krijimit të ushtrisë e dha një anëtar tash i pozitës, i cili nuk është pjesë e Kuvendit, por ka qenë kryetar i Kuvendit, gjithë asaj që u ngre kjo zhurmë gjatë ditës së sotme në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shkumbin Demaliaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Ministra të Qeverisë së Kosovës,

Kolegë të nderuar deputetë,

Kemi ardhur deri te pesë deputetë që kanë për të folur sot dhe që ta përmbyllim këtë temën e 100-ditëshit të qeverisjes Haradinaj.

Propozuesi i debatit ka bërë mirë që e ka nisur këtë temë, por e para e kësaj është se, duke mos mundur ta përcjellim Qeverinë Haradinaj në dinamikën e saj, unë mendoj se në 200-ditëshin do ta shtjellojmë nga propozuesit vitin e ardhshëm, sepse u është dhënë mundësia shumë njerëzve për të biseduar dhe për të kritikuar. Fatkeqësisht, hapa Facebookun kur dola në bufe, njerëzit që sot kanë folur këtu, kanë propozuar, nuk rrinë në seanca, për shkak se kanë punë të tjera më të forta ndoshta deputetët e opozitës. Po e lexoj në një vend për një deputet, thotë ja fjalimi im sot në Kuvendin e Kosovës kundër qeverisjes Haradinaj. Fatkeqësisht, dhjetë komentuesit e tij të parë ia kishin sharë nënën, thashë që këto komente. Sot në fjalimet që u mbajtën lidhur me këtë element, dy fjalime më kanë pëlqyer. Më ka pëlqyer fjalimi i ministrit Hamza dhe fjala e Albin Kurtit, por jo ajo çka ka thënë, po qysh ka fol, sepse ministri Hamza e tha sot për atë elementin financiar që ka qenë shqetësim i opozitës, por në mënyrë krahasuese.

Kemi folur edhe më herët, kur në elementet e qeverisjes përdoren metodat krahasuese në 100-ditëshin, se sot u fol nga opozita edhe për Qeverinë Thaçi, 100-ditëshin e parë. E kuptojmë vuajtjen e opozitës, ende do të vuani, derisa ta pranoni realitetin. Nuk mund ta akuzoni askënd përderisa kemi pasur vetëm, se keni qenë edhe ju me Listën serbe, edhe në qeverinë e kaluar, edhe para kësaj qeverie, edhe të gjitha qeveritë janë ndërtuar, se është kategori kushtetuese dhe e

dini mirë. I keni pasur 89 vota të partive shqiptare dhe s'keni mundur, po e di që dy deputetë kanë dalë haptazi atëherë. Të gjitha këto vendime që keni menduar për të mirën e Kosovës, keni mundur t'i ndërmerrni dhe t'i kryeni atëherë. S'i kishim vuajtur këto procese, mirëpo ka qenë mosguximi, padituria, ka qenë elementi që vazhdimisht Kosovën e ka lënë mbrapa. Flas për Lidhjen Demokratike, Lidhja Demokratike e Kosovës sot ushqehet me urrejtjen ndaj kryeministrit Ramush Haradinaj. Ishte pikërisht Ibrahim Rugova që kryeministrin e parë që e ka vendosur vetë është Ramush Haradinaj, unë e di se s'jeni më ajo LDK, sepse sot i keni këta burrështetasit që vetëm kanë folur dhe kanë ikur, dhe duan ta vlerësojnë kush është burrështetas në Kosovë, Driton Selmanaj dhe Lumir Abdixhiku.

Driton Selmanaj do ta nxjerrë burrështetas, është foshnjë politike, sa ka qeveria jetë, aq ka jetë në politikë, sepse nuk ka qenë as anëtar i LDK-së më herët. S'ka qenë anëtar i LDK-së, ka qenë njëri që ka dashur të përfitojë nëpërmjet OJQ-ve dhe mekanizmave të thjeshtë, sikur të kishte qenë anëtar edhe më herët i LDK-së, ka pasur të drejtë të jetë edhe deputet. Lumir Abdixhiku dha shumë vërejtje, u mundua edhe atë qysh përgjigjet Ramushi të flasë. Por, nuk e përmendi, nuk dha asnjë vërejtje për KEK-un, sepse vjehëria e tij kanë marrë tenderë në Qeverinë Mustafa nga 40 milionë, duhet cekur edhe ato, sepse tash e dimë si iu ka hequr torta nga goja.

Edhe Mimoza Kusari-Lila po na interpreton nganjëherë kur po flasim, po thotë po më ngjiteni menjëherë fjalëve të mia. Foli për pasaportën e kryeministrit, pasaportën shqiptare, nënshtetësinë shqiptare. Nuk e ka marrë kryeministri nënshtetësinë shqiptare pasi u bë kryeministër, në kohën kur ka qenë i ndaluar nga vetë ajo Serbia që sot po mundoheni të ushqeheni me të dhe po flisni edhe për Rusinë këtu. Unë nuk e di degëzimin kah i merrni informacionet, mirëpo atë pasaportë ia ka ndarë Presidenca shqiptare kur ka qenë në Francë i ndaluar me fletarrestimin e Interpolit. E dini fort mirë, ka qenë një pritje simbolike e Presidencës së Shqipërisë kur ia ka dhënë atë nënshtetësi para disa jave. Nuk ka mund të shkojë si klandestin, hajnisht e ta marrë pasaportën, por e ka pritur shteti kryeministrin. Edhe e dini, kur flisni për kryeministrin Haradinaj është e vetmja figurë politike e pandotur prej fjalëve, edhe është i vetmi politikan në Kosovë, drejtues i një subjekti politik që shteti shqiptar e ka dekoruar me Urdhrin Skënderbeu. Ju s'dini të trajtoni asnjë vlerë, vlerat kur trajtohen, duhet të dini kënd je duke e njollosur.

Ne mund ta rrëzojmë Qeverinë kur të duam, e kam thënë, nuk e kemi me tapi Qeverinë, ka pasur kryeministra më herët, ministra e të tjerë, po nuk i përkrasni proceset e të arriturat e 100-ditëshit, janë 185 ditë, unë e di që ju ndalet ora, por mendoj se po mundoheni ta bëni vetëm më të vështirë këtë proces. Foli zonja Kusari, po më vjen keq që s'janë këtu të replikojnë. Për Ligjin për Specialen tha: "Ju ia keni bërë terrin Kosovës prej shpalljes së pavarësisë", lidhur me Gjykatën Speciale. Duhet ta dimë se edhe marrëveshjen e demarkacionit, edhe Ligjin për Gjykatën Speciale, edhe vendosjen në Kushtetutë e keni bërë gabim, e tha ish-ministrja, tha "e keni tradhtuar elektoratin tuaj". Nuk e kemi tradhtuar ne elektoratin tonë, jemi pikërisht për atë çka kemi protestuar dhe kemi dalë aty, ne jemi duke e futur në ligj ratifikimin. Është marrëveshja e

dy presidentëve, presidentët e kanë nënshkruar të parën, por kanë bërë edhe një marrëveshje ekstra. Sa keni qenë në qeveri, Qeveria malazeze ka thënë asnjëherë ne nuk merremi me këtë trajtim, ne e kemi përfunduar, zgjidheni problemin në Prishtinë. Tash po thotë jemi për konsensus, jemi për zgjidhje më të mirë dhe e kanë ndryshuar deklaratën. Po e kemi vendosur edhe një element brenda këtij ligji, raportin e Shpëtim Bulliqit që ne lidhur me transparencën nuk e fshehim, ka qenë deputet i Lidhjes Demokratike të Kosovës, i kemi besuar, kemi besuar te Shpëtimi se është ekspert, e kemi sjellë edhe një raport që e formëson dhe e rumbullakon një përmbyllje të një procesi integruar, se ato marrëveshje po shkojnë drejt përfundimit.

S'keni çka të ankoheni, nëse doni ta votoni, votojeni, nëse doni, mos e votoni. Edhe, Ligji për demarkacionin, jo, po vajtojnë dhe po mundohen të shthurin, për të krijuar sa më shumë elemente të mosforcimit të kësaj Qeverie. Për LDK-në, kam thënë edhe mbrëmë në televizion, isha me zotën, s'po ia përmend emrin, e vetmja e arritur e Qeverisë Mustafa ka qenë një intervistë në shesh, kur ka dalë Adem Salihaj dhe na ka zbuluar një popull vëlla në juglindje të Afganistanit, edhe mund ta quaj lirisht se ajo qeveri ka qenë qeveri e kalashëve. Unë e mendoj se këta duhet t'i ruajnë raportet diplomatike me ta dhe të na tregojnë se i kishim do vëllezër në Arabi, e s'po mund të merremi me vëllezërit tanë këtu.

Zoti Glauk Konjufca ka folur në mëngjes për shëndetësinë, i iu drejtua ministrit të Shëndetësisë, e pashë se ishte bërë edhe doktor se i thoshte ti nuk je adekuat. Edhe folke për laboratorë e për të tjera praktika. Por iu drejtua edhe për tri raste të vdekjes në javën e parë të ardhjes së Qeverisë Haradinaj. Kanë vdekur tre njerëz të sëmurë, familjarët e tyre duhet të ndihen keq, por më erdhi mirë që ministri tha se kemi nisur procedura hetimore lidhur me rastet, janë angazhuar inspektoratet dhe del një raport final. Por duhet ta dinë se një komunë e ka drejtuar "Vetëvendosja" në zgjedhjet e kaluara dhe kanë vdekur fëmijë të shëndoshë në gropa, në hapësirat komunale janë mbytur në qeverisjen e LDK-së. A kanë kërkuar hetime lidhur me atë çështje?

Nuk duhet të bëhemi naivë, për këtë po kërkojmë një konsensus e po thirrremi nganjëherë që të mos jemi gjithmonë kundërshtues, për shkak se e njëjta retorikë është që 20 vjet, fjalimet e LDK-së edhe këto të viteve të fundit të "Vetëvendosjes". Neve e dimë edhe nuk kërkojmë asnjëherë që të na mbështetni me votë, nëse e bëjnë, është e mirë edhe për ata, por e kemi parë atë edhe te Ligji për Gjykatën Speciale. Sonte po e sollët, sonde e votoj, se është i keq, është i njëanshëm, edhe nuk ka qenë iniciativë, i them nga këtu zonjës Mimoza Kusari Lila që ia atribuojë qeverisjes Haradinaj, ka qenë iniciativë e deputetëve.

Sa herë të vijë diçka e keqe që e keni votuar, do ta largojmë, është tjetri element kur deklarohen, thonë pse s'po e bie këtë ligj Qeveria, pse s'po e bie edhe këtë, edhe këtë, kishe ne po i njohim ligjet. I dinë do rregullore komunale, sepse nuk kanë përvoja në pushtetin qendror. Ligjet mund t'i sjellin edhe vetë deputetët, vetë "Vetëvendosja", LDK-ja, Aleanca, PDK-ja, gjashtë deputetë



mund ta marrin një nismë ligjore dhe e sjellin në Kuvend, por ata edhe ato çka i flasin këtu, edhe prej këtu ikin e kurrë nuk flasin, për shkak se atë angazhimin e tyre në atë trajtimin e atij shkrimi që ua ka shkruar dikush, mua më kishte ardhur marre të ma kishte shkruar dikush fjalimin, të flitet në Kuvend e t'i drejtohesh dikujt, por edhe gabimet gjuhësore duke e lexuar fjalimin.

Ejani të përgatitur për diçka të mirë, jo vetëm një diçka kundërshtuese, ne e kuptojmë rolin opozitar. Askush më shumë se Aleanca s'ka qëndruar në opozitë, por ia kemi dhënë rastin zoti Haradinaj, është duke punuar, janë 185 ditë, por këto foshnjat politike ndalini nga pak, se jua kanë marrë atributet...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Rekalju.

FIDAN REKALJU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kolegë deputetë,

Qeverisja e sotme dhe institucionet e Republikës së Kosovës në gjendjen çfarë janë sot, me veprimet dhe qasjet e tyre në vazhdimësi më së shumti po dëmtojnë të rinjtë e Kosovës.

Nuk është vetëm çështja e izolimit të padrejtë në kontekstin e liberalizimit të vizave, perspektiva e rinisë tonë po dëmtohet në shumë drejtime njëherësh. Problemet janë thelbësore dhe shtrihen në segmentin e arsimit, punësimit, por edhe të programeve e politikave rinore. Është konstatuar nga të gjithë se punësimi të të rinjtë është një problem i madh, në kufijtë e papranueshëm dhe nuk po jepet asnjë sinjal për të filluar trajtimin serioz institucional të këtij problemi.

Personalisht, por besoj as pjesa dërmuese e rinisë kosovare, nuk presin që Qeveria që sot që është në detyrë të ketë kreativitetin, vullnetin, dijen dhe pasionin për formulim e zbatim të politikave dhe programeve që ndikojnë në zbutjen e papunësisë tek të rinjtë. Kjo është një kërkesë që është e tepërt nëse e kërkojmë në këtë periudhë, fatkeqësisht, është më se e qartë se problem dhe shqetësim kryesor i çdo të riu është punësimi dhe më konkretisht, çështja e përvojës së punës që atyre u kërkohet kur ata aplikojnë për pune, në kushtet kur s'kanë asnjë mundësi të krijuar gjatë periudhës së hershme të shkollimit dhe formësimit të tyre profesional për të krijuar atë përvojë pune.

Të nderuar kolegë deputetë,

Një politikan i mirëfilltë në vendet me demokraci të konsoliduar është po ashtu një model për t'u ndjekur nga qytetarët e sidomos nga të rinjtë. Ky klan politik, i cili tashmë është në pozitë më të larta në vend po dëshmon ditë e më shumë që modeli që ata ofrojnë është degradues e i dëmshëm për t'u ndjekur. Cili është modeli që kjo qeveri synon të promovojë kur ka thyer rekordin për nga numri i kabinetit qeveritar, 22 ministrave dhe 75 zëvendësministrave, dhe çuditërisht asnjëri prej

tyre, kam përsërit edhe në seancat e mëhershme, nuk vjen nga komuna e Podujevës, duke ditur që komuna e Podujevës është komuna për nga territori më e madhja në vend, si dhe bënë pjesë në komunat me popullsinë më të madhe në Kosovë. Ne si shoqëri duhet të bëjmë reformën e administratës publike e të orientojmë më shumë të rinjtë nga sektori privat, nga ndërmarrësia e inovacioni.

Shpresa ime dhe e të rinjve të Kosovës, besoj, është që sa më shpejt kjo përbërje qeverisje t'i kalojë së kaluarës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti i Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: Të nderuar qytetarë!

Unë të flas për dështimet e kësaj Qeverie, nuk desha të marr fjalën, meqenëse shumë parafolës me fakte konkrete e dëshmuar këtë, por më intrigoi një parafolës, i cili foli për punën në shëndetësi dhe desha veç një vërejtje të vogël t'ia them, një gjë që të gjithë qytetarët e Kosovës e dinë. Le ta dinë në Klinikën e Kirurgjisë Maksilofaciale nuk keni, zoti ministër, le ta dinë në Kirurgjinë Vaskulare nuk keni, zoti ministër, sisteme për infuzion e shiringa nuk keni në QKUK, zoti ministër, insulinë për diabetikët nuk keni, zoti ministër, edhe ju avokatë të kësaj qeverisjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Konsideroj që imazhi, profili dhe identiteti i një shtetit përcaktohet me prodhimin e politikave të brendshme, të cilat pastaj reflektohen edhe në opinion ndërkombëtar, në opinionin e jashtëm. Varësisht prej prodhimit të atyre politikave, menaxhimin me shtetin, me dikasteret shtetërore dhe institucionale, atëherë do të na respektojnë edhe të tjerët, edhe fqinjët, edhe rajoni, por edhe bashkësia ndërkombëtare.

Si deputet i opozitës kam bërë apel disa herë që gjërat t'i diskutojmë në rrafshin racional, profesional dhe për çështje të rëndësishme për interesin e qytetarëve dhe të vendit të kemi konsensus.

Qasja e koalicionit qeverisës, diskursi i gjuhës së komunikimit, në radhë të parë me qytetarët dhe në radhë të dytë me opozitën, konsideroj që i tejkalon normat e një bontoni sjelljes së qeveritarëve, të njerëzve të zgjedhur dhe të atyre që i përfaqësojnë institucionet e Republikës së Kosovës, shtetin e Kosovës, përfaqësojnë popullin e Kosovës. Në këtë kuptim bëj apel për gjuhë parlamentare, në radhë të parë, për normalitet të debatit në Kuvendin e Republikës së Kosovës

dhe t'i kthehemi punës, sepse po merremi shumë me vetveten, po merremi me gjëra sekondare dhe terciare e kemi aq shumë punë.

Kjo Qeveri që ka një përbërje heterogjene dhe si duket nuk po mund ta gjejë veten në harmonizimin e prioriteteve, por si duket ka prioritete të partnerëve të koalicionit dhe po bëjnë garë se cilat t'i realizojnë së pari.

Këtu u diskutuan shumë tema, u diskutuan edhe tema të së kaluarës, kur ne përballemi me çështje akute që rëndojnë mbi jetën e qytetarëve dhe nuk po merremi me prioritetet, me alternativat, me zgjidhjen dhe me përmirësimin e cilësisë së jetës së atyre qytetarëve që me votën e tyre na kanë sjellë në këtë Kuvend. Konsideroj që debate të tilla nuk na bëjnë nder, as neve, nuk i bëjnë nder as Qeverisë. Tani po flas në cilësinë e përfaqësuesit të grupit më të madh parlamentar të Republikës së Kosovës, me përgjegjësinë më të madhe elektorale dhe qytetare.

Ju lutem, duhet të ju vëmë pikë punëve të kota, debateve të kota, inateve klanore, personale e politike, dhe t'u kthehemi përgjegjësi kushtetuese dhe institucionale që i kemi.

U diskutua shumë për konsensusin nacional. Ju lutem, përgjegjësinë në radhë të parë për konsensus nacional e ka mazhoranca dhe duhet falënderuar, duhet falënderuar Lidhjen Demokratike të Kosovës për qasjen e saj, por unë kërkoj edhe nga kolegët e “Vetëvendosjes” që për çështje të rëndësishme ne 100 deputetët e popullatës shumicë në Kuvend të jemi bashkë dhe të gjejmë zgjidhje. Konsideroj që këtë mund ta bëjmë.

U përmend demarkacioni, njëri nga zëvendëskryeministrat tha se është çështje teknike. Absolutisht, është çështje politike, është çështje shumë sensitive, është çështje shumë e rëndësishme dhe kërkoj nga mazhoranca që mos të propozojë seancë për demarkacionin në 6 të mbrëmjes, në 7 të mbrëmjes apo natën. Po ajo seancë të jetë seancë e rregullt e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe t'u japim hapësirë dhe mundësi debati të gjithë spektrit politik të Kosovës.

U përmend edhe ushtria. Shikoni, komplet spektri politik në Kosovë sa i takon formimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës ka rënë në provim për inate të çuditshme, për logjika ballkanike e keni hequr R-në nga Forca të Armatosura të Republikës së Kosovës. Ne jemi Republikë e Kosovës, kemi rregullim parlamentar dhe emri i Kushtetutës nuk ka rëndësi kush e ka vënë i pari në një Kushtetutë të Kaçanikut, me të cilën krenohemi dhe falë edhe angazhimit të atyre njerëzve jemi sot këtu ku jemi. Edhe këtu duhet konsensus nacional ne emër të shtetit dhe që kësaj ushtrie t'i japim prerogativat e ushtrive me doktrina moderne, që nesër duhet të jetë pjesë e NATO-s.

Unë krenohem me pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe i ndiej për ushtri timen dhe janë ushtri edhe e dy fëmijëve të mi. Ju lutem, këtu nuk guxojmë të kemi ndarje. Kjo logjikë e tjerres së këtyre teorive të konspiracionit, konsideroj që u ka dalë afati.

Dua të kthehem te dialogu me Serbinë. A mund një herë si spektër politik, si 100 deputetë të popullsisë mazhorancë në këtë vend, thjesht ta rikornizojmë, ta riformatojmë këtë dialog, me limite kohore dhe me qasje pragmatike në interes të vendit tonë, sepse po ka ide dhe jo bash të mira rreth qasjes që e ka Serbia në raport me Kosovën. Duhet t'ua bëjmë me dije që Republika e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran, i integruar në BE dhe në NATO dhe në miqësi permanente me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më shumë se dy dekada e gjysmë, kemi hyrë në dekadën e tretë, është vullnet politik, është konsensus nacional i popullit të Kosovës.

Dua të ndalem te arsimit dhe shëndetësia, që sot pak i rrahëm këto tema. Ju lutem, nga statistikat zyrtare i kemi 228 956 mungesa vetëm në kryeqendrën e Republikës së Kosovës, mungesa në arsimin fillor e rreth 203 000 në arsimin e mesëm. Ku jemi ne si të zgjedhur të popullit? Nuk dua ta fajësoj askënd sot, por ne duhet të merremi, Qeveria duhet të merret me këtë çështje. Kemi probleme serioze në arsimin universitar, kemi mungesë të kreativitetit në qasje të reformave në arsimin e lartë në vend.

Ku janë hapjet e vendeve të reja të punës, ku janë premtimet? Po kemi greva, po kemi paralajmërime për greva. Si njeri që vi edhe nga sektori i shëndetësisë, po edhe ai i arsimit, nuk ndihem mirë të jem pacient i mundshëm kur mjekët në SHSKUK paralajmërojnë grevë, as nuk ndihem mirë kur humben orë mësimi e edhe fëmijët e mi qëndrojnë në shtëpi. Kush do t'i zëvendësojë këto orë? Kush po merret me këtë problematikë? 400 000 mungesa vetëm në kryeqytet! Ju lutem!

Andaj, t'i kthehemi qasjes racionale, një debati politik normal me konkurrencë të ideve dhe alternativave. Përndryshe, po e humbim autoritetin edhe si të zgjedhur të popullit, po bëjmë debate koti dhe po e dëmtojmë perspektivën e këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: E fundit është Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues,  
Të nderuar kolegë deputetë,

Unë jam diskutuesja e fundit dhe po mundohem, edhe pse u debatua shumë rreth kësaj çështjeje, të mos i përsëris gjërat. Është e pamundur ndoshta, të mos përsëris diçka.

Që në fillim po dua të sqaroj diçka për qytetarët, sepse shumë deputetë sidomos nga koalicioni qeverisës e theksuan se edhe vetë kryeministri, se këtu po diskutohet shumë vonë, pa relevantë, është tema 100-ditëshi i qeverisjes dhe unë po dua ta sqaroj për qytetarët e vendit, se Lidhja

Demokratike e Kosovës e ka bërë kërkesën për debat në dhjetor të vitit 2017 dhe me hilet e kryetarit të Kuvendit dhe të Kryesisë debati është zhvendosur në mars të 2018-tës.

Konsideroj dhe kam menduar se me këtë shtyrje të qëllimshme që i është bërë këtij debat, Qeveria ta shfrytëzojë kohën edhe për 100 ditë tjera apo 80 a sa janë, e së paku të na sjellë edhe ndonjë rezultat të punës se sa për 100-ditshin, sepse vërtet për 100 ditë s’kemi pasur çka diskutojmë. Por, fatkeqësisht ne i kemi edhe 200 ditë tash punë të kësaj Qeverie dhe vërtet nuk kemi asnjë rezultat dhe asnjë sukses të cilin kishte premtuar vet kryeministri dhe kjo mazhorancë apo ky koalicion qeverisës.

Ishin ardhur këtu në krye të kësaj Qeverie duke na premtuar për vendime të mëdha e që për gjashtë muaj nuk është marrë asnjë. Ishte premtuar që për tre muaj me e pas liberalizimin e vizave, ishte premtuar për përmirësimin e cilësisë në arsim, përmirësimin e shëndetësisë, shërbimeve shëndetësore, luftën kundër krimit e korrupsionit, zhvillimin ekonomik, sundimin e ligjit e plotë premtime të tjera që janë përkthyer në këto vendime që do t’i numëroj pak më vonë.

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju ministra, që jeni këtu të këtij Kabineti qeveritar, në mungesë të kryeministrit, dua të ju them se Qeveria nuk është kreu vendime e buxhet, Qeveria është imazh dhe imazhi i kësaj Qeverie është përtokë. Imazhi i kësaj Qeverie me vet koalicionin qeverisës, fatkeqësisht përbërjen e këtyre deputetëve sot që janë në mazhorancë kemi risi për të keq, njerëz që na tregojnë arrogancë, shkelje ligjore, fyerje, banalitete... ky është koalicioni i juaj qeverisës.

Na shitni moral politik, na shitni patriotizëm, të njëjtit njerëz që ditën na shitni patriotizëm, natën takoheni në takime formale e joformale me kriminelë, siç është Milan Radojçiq e siç është vet presidenti i vendit, që takohet me Vuçiqin e s’i jep përgjigje kurrkujt e s’e di as Kuvendi, as Qeveria çka po flitet. Këta jeni ju, këta patriotë jeni ju. Kontrabandim të deputetëve që bëni, nuk e dimë me sa e qysh e si, deputetë pa etikë politike, që bëjnë salto politike të paparashikueshme e të pashpjegueshme.

Po cilat vendime, kështu shkarazi apo në mënyrë telegrafike po u them që ka marrë kjo Qeveri. Para se t’ia nis t’i numëroj këto “rezultate” të kësaj Qeverie, po e ricitoj sepse shumë kolegë të mi e thanë, po e them edhe unë, Qeveria jonë është qeveria më e madhe në Evropë, mos të them edhe më larg, ndoshta mund të krahasohemi edhe me Kinën diku.

Vendimet e para të kësaj Qeverie:

- rritja e pagave vetvetes dhe Kabinetit qeveritar në kundërshtim me ligjin dhe normalisht konflikt interesi është vendim i pezulluar;
- falja e borxheve të ambalazhuesve të ujit, vendim i pezulluar;

- shpronësimi në Hade dhe në Shipitullë në kundërshtim me ligjin, me koston e shpronësimit që i tejkalon të gjitha rregullat dhe vendimet që janë marrë nga 50 mijë ka shkuar në 200 mijë për një shtëpi;

- shpenzimi i rezervave të shtetit pa asnjë kriter, si me qenë prej bahçes së babës.

Nëse kalojmë te arsimit rezultati i vetëm është shkarkimi i Agjencisë së Akreditimit të Arsimit e që është cilësuar si ndërhyrje politike dhe ka implikim përjashtimin e Republikës së Kosovës nga një organizatë evropiane, siç është ajo e Regjistrimit Evropian të Sigurimit të Cilësisë.

Ne çdo ditë jemi dëshmitarë dhe prekim nivelin dhe temën e cilësisë së arsimit në Kosovë. Edhe juve, sidomos kryeministrin e kam parë duke vizituar disa institucione arsimore e duke cekur testin PISA. Po, kah po e çojmë ne arsimin? Për vetëm gjashtë muaj qeverisje të juaj ne kemi degradim ose përjashtim nga konkurrenca evropiane e cilësisë. Performanca e ministrave tuaj është deri në atë shkallë, sa edhe ahengjet kur i bëjnë për kënaqësinë e tyre zbrazin armë dhe s'janë hiç zyrtarë më të ulët se sa vetë ministra ose zëvendëskryeministra. Ky është imazhi i Qeverisë sonë.

Kur jemi në zbatimin e politikave fiskale, sidomos mosvënien në funksion të pakos nr. 2, që ishte nga ish-Qeveria e Republikës së Kosovës. Për gjashtë muaj ju s'keni arritur që ta keni Bordin e "Trepçës", që ish-Qeveria e Republikës së Kosovës e ka filluar ditët e para të punës me protestat e juaja duke kërkuar Ligjin për "Trepçën". Ne e kemi bërë Ligjin për "Trepçën" edhe janë bërë gjashtë muaj e ju ende s'e keni zgjedhur Bordin e këtij gjiganti, siç është "Trepça". Për çudi, e kam dëgjuar mbrëmë këtë ministrin Lluka, i cili thotë: "Për t'u vënë në funksion "Trepça" duhet bashkëbisedim edhe me minoritetin serb." Ju lutem shumë, keni parasysh këto ditë që po bëni kalkulime e kompromise. Ligji thotë decidivisht qysh duhet të funksionojë bordi dhe qysh duhet të funksionojnë minierat e "Trepçës" në tërësi, e jo ajo në veri e në jug, të ndara, siç po mendonit ju ta bëni. Edhe tentimi i shfuqizimit të Ligjit për Gjykatën Speciale, me ç'rast shkaktoi dridhje politike dhe humbje të besimit me partnerët ndërkombëtarë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë shpresoj shumë që kjo Qeveria jonë duhet të reflektojë shumë urgjentisht, që të jetë shumë serioze në marrjen e vendimeve të saj dhe respektimin e ligjit, për të qenë ndoshta pak më në nivel, ose më ndershëm, kishte me qenë mirë pasi që në fillim, në start, po e shohim se nuk ka kapacitete për të menaxhuar, ose për të udhëhequr vendin, që të japë dorëheqje dhe ne të shkojmë në zgjedhje sa më shpejt. Edhe ashtu, Lidhja Demokratike e Kosovës tashmë është grupi i parë parlamentar në Republikën e Kosovës dhe është subjekti i parë politik dhe prandaj ne kërkojmë sa më shpejt zgjedhje, që vërtet vendit t'i sjellim zgjidhje. Faleminderit!

KRYESUESI: A do me ta qitë në votim, a qysh? Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Konsideroj se debati ka përfunduar dhe si pikë të rendit të ditës e konsideroj të mbyllur.

Vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës:

**12. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi për ratifikimin e nëntë (9) anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë**

Fjalën e ka zoti Reçica, i autorizuar nga Qeveria.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Atëherë, pas debatit të fundit të mbledhjes së fundit të Parlamentit, që u debatua për Këshillin e Lartë të Cilësisë, në emër të ministrit të Arsimit, ju lus që propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ratifikimin e 9 anëtarëve të Këshillit të Lartë të Cilësisë ta tërhiqni prej rendit të ditës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, ne na mbetet vetëm ta konsiderojmë të tërhequr vendimin nga Qeveria e Kosovës.

***14. Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016***

Sa deputetë janë në sallë?

Diskutimet për këtë raport kanë përfunduar në seancën e mbajtur më 9 shkurt 2018, por në mungesë të kuorumit nuk është proceduar me votimin e tij. Andaj, vazhdojmë... nuk kemi kuorum të mjaftueshëm, i kemi vetëm 57 deputetë në sallë. Edhe katër deputetë duhet të jenë.

Atëherë, unë e mbyll seancën, meqenëse s'ka kuorum, s'mund ta votojmë. Është pika e fundit si pikë e rendit të ditës e hedhim në fund të pikave tjera të rendit të ditës për seancën e nesërme. Faleminderit!

\* \* \*

*E enjte, 15 mars 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 8, 9, 13 shkurt dhe 1, 13 dhe 14 mars 2018*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

KRYESUESI: Filloj me pikën që ka mbetur dje pa përfunduar.

#### ***14. Votimi i raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016***

Diskutimet për këtë raport kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 9 shkurt 2018. Por, në mungesë të kuorumit nuk është proceduar për votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Në rregull, a nuk po dëshironi të votoni, apo si është puna?

Edhe një herë, sepse ka ankesa që s'po dëgjothem.

Diskutimet për këtë raport kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 9 shkurt 2018. Por, në mungesë të kuorumit nuk është proceduar për votim.

Andaj vazhdojmë me votimin e raportit për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016.

Ju lus që t'i zini vendet!

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani! Faleminderit!

Kanë votuar 60 deputetë me kartelë, një pa kartelë, do të thotë 61 deputetë.

Për kanë votuar 49 deputetë, kundër 8 dhe 3 kanë abstenuar.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2016. Faleminderit! Mirupafshim!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*